

ENVER HOXHA

VEPRA

38

PROLETARË TË TË GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNI!

ENVER HOXHA

VEPRA

BOTOHET ME VENDIM TË KOMITETIT
QENDROR TË PARTISE SË PUNËS TË
SHQIPERISE



ENVER HOXHA

INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE-LENINISTE
PRANË KQ TË PPSH

ENVER HOXHA

VËLLIMI

38

MAJ 1968 - KORRIK 1968

SHTËPIA BOTUESE «8 NËNTORI»
TIRANË, 1983

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 38-TË

Vëllimi i 38-të i Veprave të shokut Enver Hoxha përfshin dokumente të periudhës maj-korrik 1968, pjesa më e madhe e të cilave botohen për herë të parë.

Në qendër të këtij vëllimi janë materiale ku pasqyrohet një pjesë e përvojës së Partisë, në luftë për zbatimin e vendimeve historike të Kongresit të 5-të të saj. Thelbin kryesor të kësaj përvoje e përbën revolucionarizimi i mëtejshëm i Partisë dhe i të gjithë jetës së vendit.

Kalitja ideologjike dhe forcimi organizativ i Partisë është një nga çështjet kryesore që trajtohet në dokumentet e këtij vëllimi. Vëmendje e veçantë u kushtohet detyrave që kanë të bëjnë me gjallërimin e mëtejshëm të organizatave-bazë të Partisë, me zbatimin e drejtë të normave të saj, me luftën kundër shfaqjeve të formalizmit, për një punë më shkencore në shpërndarjen e forcave të Partisë, për shtimin e rradhëve të saj me gjak të ri, sidomos nga klasa punëtore. Në këto dokumente theksohet edhe një herë që komunistët të qëndrojnë kurdoherë në ballë të punës në sektorët ku militojnë, të prijnë me shembullin e tyre personal, të jenë të lidhur me masat punonjëse. Një shembull të lartë të lidhjeve të ngushta me masat na jep vetë shoku Enver Hoxha, i cili shkon te populli, ulet gju më gju, këshillohet e bisedon me të. Këtë e shohim

qartë në disa fjalime e në biseda të mbajtura para kua-drove e masave punonjëse, që botohen në këtë vëllim.

Përmes dokumenteve të kësaj periudhe, sidomos në diskutimet e mbajtura nga shoku Enver Hoxha në mbledhjet e Byrosë Politike e të Sekretariatit të KQ të Partisë, trajtohen një sërë problemesh të rëndësishme të ndërtimit socialist e të diktaturës së proletariatit. Në diskutimin «Zhvillimi i drejtë i luftës së klasave kërkon pjekuri dhe partishmëri të lartë» nxirren konkluzione e mësimë për të zbatuar me konsekuencë politikën e Partisë në këtë fushë, për të mos rënë as në oportuni-zëm e as në sektarizëm. Zgjidhja e drejtë e këtyre problemeve, thekson shoku Enver, ndihmon edhe në forcimin e unitetit moralo-politik të popullit rreth Partisë, si dhe të unitetit revolucionar midis njerëzve tanë.

Në kuadrin e gjerë të revolucionarizimit të jetës së Partisë e të masave punonjëse, një vend të dukshëm në materialet e këtij vëllimi, zë problemi i luftës për emancipimin e plotë të gruas. «Ky problem, — thotë shoku Enver Hoxha, — qëndron dhe do të qëndrojë si një nga problemet më të rëndësishme të jetës së popullit shqiptar». Për të arritur rezultate sa më të mira në këtë çështje, theksohet se ajo është e lidhur ngushtë edhe me revolucionarizimin e familjes socialiste, me përmirësimin e vazhdueshëm të mënyrës së jetesës dhe të strukturës së ushqimit, sidomos në fshat. Këto probleme gjejnë shprehje veçanërisht në bisedat e shokut Enver Hoxha gjatë vizitës së tij në Mirditë, në kursin e organizuar në Durrës me të rejat e malësisë së Veriut etj., ku jepen mësimë shumë të vlefshme për zgjidhjen në praktikë të detyrave nëpërmjet aksio-

neve konkrete, kurseve të ndryshme, vizitave të kooperativistëve nga Veriu në Jug etj.

Në vëllim vihet theksi në nevojën e rritjes së mobilizimit të komunistëve, të punëtorëve, të kooperativistëve, të kuadrove e të specialistëve për realizimin e detyrave ekonomike të planit. Porositë e këshillat, që jepen për sektorët ekonomikë të vendit, hedhin dritë në rrugën e zhvillimit aktual e perspektiv të industrisë, sidomos të asaj minerare, nxjerrëse e përpunuese, për zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë, për rritjen e rendimenteve dhe për mekanizimin e saj, për zhvillimin e zonave të thella etj., sepse «Industria socialiste, nga njëra anë, dhe bujqësia socialiste, nga ana tjetër, të dyja së bashku përbëjnë kolonat bazë, mbi të cilat mbështetet fort dhe do të ecë përpara, pa u penguar, ekonomia jonë socialiste». Ngritja në një shkallë më të lartë e mobilizimit të popullit në këta sektorë përbënte një kërkesë të kohës dhe të situatave, që kalonte vendi ynë në kushtet e rrethimit e të bllokadës imperialisto-revizioniste. Për përmirësimin e punës në këta sektorë, në materiale vihet në dukje se është e nevojshme që masat, punëtorët ta thonë fjalën e mendimin e tyre hapur, për këdo, të zhvillohen më me forcë kritika dhe autokritika, sepse kështu ndihmohet Partia në zgjidhjen e shpejtë e të drejtë të problemeve. Duke trajtuar marrëdhëniet midis njerëzve në punë, rëndësi e veçantë u kushtohet marrëdhënieve midis kuadrove dhe masave, që përbëjnë thelbin e luftës kundër burokratizmit. Në këtë drejtim merrnin përparësi kuptimi i rolit hegjemon të klasës punëtore, rritja e përgjegjësisë së saj dhe kërkesa e

llogarisë për zbatimin e detyrave, edukimi i kuadrove me frymën e Partisë, rritja e rolit të komunistëve e të organizatave-bazë të Partisë, si faktorë vendimtarë edhe për forcimin e këtyre marrëdhënieve.

Në vëllim botohen edhe dokumente, që flasin për probleme të zhvillimit botëror, për luftën kundër imperializmit e revizionizmit, për forcimin e lëvizjes marksiste-leniniste. Sqarimi i shumë problemeve të kohës është një ndihmë e madhe internacionaliste edhe për marksistë-leninistët e revolucionarët kudo në botë. Në artikullin «Le të shpërthejë e fuqishme stuhia e revolucionit» i bëhet një analizë e thellë procesit degjenerues të revizionizmit modern, demaskohet demagogjia e veshur me frazeologji marksiste, tregohen kontradiktat midis rrymave të ndryshme të revizionizmit etj. Në mënyrë të veçantë demaskohen revizionistët jugosllavë, si shërbëtorë besnikë të imperializmit, për qëndrimin shovinist e reaksionar ndaj shqiptarëve me banim në Jugosllavi. Në artikullin «Pasqyrim i degjenerimit dhe i falimentimit të vetadministrimit titist» dhe në materiale të tjera duket edhe një herë lufta e vendosur e Partisë sonë për të mbrojtur marksizëm-leninizmin, si dhe të drejtat legjitime të shqiptarëve të Kosovës dhe të viseve të tjera në Jugosllavi.

Studimi i materialeve të vëllimit të 38-të të Veprave të shokut Enver Hoxha, përveç të tjerave, ka rëndësi aktuale. Duke e njohur më nga afër këtë periudhë, komunistët, klasa punëtore, mbarë populli do të reflektojnë për të nxjerrë mësimë e detyra të kohës, që lidhen ngushtë me zbatimin e vendimeve historike të Kongresit të 8-të të PPSH.

**PËR T'Ë SHKUAR GJER NË FUND ÇDO PROBLEMI,
MË PARË TË MENDOHET PËR MASAT
ORGANIZATIVE**

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

8 maj 1968

Për çështjet organizative të Partisë, shokë, duhet të tregojmë kujdesin më të madh, se janë nga më të rëndësishmet. E them këtë se kam përshtypjen që atyre nuk po u vihet rëndësia e duhur. Mua më duket se shokët në rrethe, bile, edhe ata sekretarë të parë të komiteteve të Partisë që merren me çështjet organizative, disa prej të cilëve janë ftuar në këtë mbledhje, i kalojnë ato përciptas, gjë që, natyrisht, nuk është aspak e mirë, ashtu sikurse nuk është mirë që me çështjet organizative të Partisë të merresh në mënyrë burokratike.

1 Në këtë mbledhje u diskutua për disa probleme që dilnin nga apelimet e komunistëve për vitin 1967, sipas një informacioni të paraqitur nga Komisioni Qendror i Kontrollit e i Revizionimit të PPSH.

Sekretarët e parë ose cilido nga sekretarët e komiteteve të Partisë, që merren me çështjet organizative, duhet t'u hyjnë më thellë dhe seriozisht këtyre problemeve kapitale, sepse, sikurse thotë Stalini, nga kjo punë varet zbatimi i vijës politike të partisë. Partia jonë, qysh në momentet e vështira të Luftës Nacionalçlirimtare, u kushtoi rëndësinë më të madhe çështjeve organizative të Partisë, problemeve të punës me kuadrin, zgjedhjes dhe edukimit të tyre, kujdesit për ta etj. Në sajë të këtij kujdesi Partia jonë u forcua vazhdimisht. Prandaj, edhe në të ardhmen, këtyre problemeve duhet të vazhdojmë t'u kushtojmë vëmendjen më të madhe.

Kur flasim për kujdesin, që duhet treguar ndaj çështjeve organizative të Partisë, nuk do të thotë që këto t'i shkëputim nga problemet politike dhe ideologjike. Sekretari i komitetit të Partisë, që merret me çështjet organizative, nuk duhet të shkëputet në asnjë mënyrë nga problemet politike dhe ideologjike që preokupojnë Partinë.

Të marrim çështjen e shpërndarjes së forcave të Partisë. Ky problem i madh organizativ nuk mund të kuptohet e nuk mund të zgjidhet duke vepruar në mënyrë fare të thjeshtë, por duke u thelluar e duke e parë në mënyrë të gjithanshme. Në rast se duhet të kemi, fjala vjen, organizatë-bazë të Partisë në çdo fshat të një kooperative të bashkuar, në radhë të parë, atje duhet të njihen mirë situata politike dhe ekonomike e kësaj kooperative, gjendja e popullit, ç'mbeturina ekzistojnë te njerëzit, ç'ndikim ka puna e armikut; të njihen ku janë pikat e dobëta dhe në cilat fshatra; të

njihen perspektivat e zhvillimit ekonomik të kooperativës, të hapjes së tokave të reja, të dihet në cilat fshatra zbatohen më shpejt direktivat e Partisë, ku njerëzit janë akoma më të ngathët etj.

Duke i ditur mirë të gjitha këto, sekretari i komitetit të Partisë të rrethit që merret me çështjet organizative, studion me kujdes, sidomos, si janë shpërndarë komunistët e organizatës-bazë të Partisë të kësaj kooperative dhe, kur konstaton se gjendja në lidhje me realizimin e detyrave në perspektivë nuk paraqitet mirë, se numri i komunistëve nuk është i mjaftueshëm për realizimin e të gjitha këtyre detyrave të mëdha që dalin, atëherë nxjerr konkluzionin se duhet punuar me shumë kujdes për rritjen e efektivitetit të Partisë me gjak të ri dhe se situata nuk mund të përmbyset duke dërguar dy-tre komunistë nga një fabrikë e qytetit. Për këtë qëllim duhet hartuar një plan organizativ perspektiv, i menduar thellë, në mënyrë që, pas një viti e gjysmë ose pas dy vjetësh, të arrihet objektivi që në njërin fshat të kooperativës të ketë të paktën një grup partie me disa të rinj, në tjetrin të jetë përgatitur një grup partie me komunistë dhe disa gra etj., me synimin që këta elementë të rinj, duke u edukuar e duke u mbajtur afër, të përgatiten dhe, kur të plotësojnë kushtet, të pranohen në Parti.

Për ta arritur këtë objektiv, sekretari për çështjet organizative mendon që në këtë kooperativë të organizohet, në radhë të parë, një punë politike e planifikuar, në bazë të studimit të gjithanshëm të gjendjes, në mënyrë që atje ku sot nuk shkon gazeta ose shkon në numër të vogël, të dërgohet një numër kopjesh më i

madh i «Zërit të popullit», i «Zërit të rinisë», i «Shqiptares së re» etj., dhe këtë numër ai nuk e cakton kulture, po në bazë të studimit që ka bërë për këtë çështje.

Për të ndihmuar, gjithashtu, në edukimin e kooperativistëve, ai mendon të dërgohet atje 1 ose 2 hcrë në muaj autokinemaja për të shfaqur filma dokumentarë. Prandaj për këtë punë ai mund të ngarkojë, për shembull, një instruktor të sektorit të edukimit ose një kuadër tjetër të pushtetit, që merret me këtë çështje, për të gjetur ata filma që janë të përshtatshëm për njerëzit e kooperativës në fjalë, që ai i njeh dhe di për çfarë subjektsh kanë nevojë, si dhe për të siguruar shfaqjen e tyre në afatin e caktuar. Sekretari që merret me çështjet organizative nuk e lë çështjen me kaq. Për të siguruar zbatimin gjer në fund të këtyre masave, duke e koordinuar punën edhe me sektorët e tjerë të aparatit të Partisë, ngarkon instruktorin, organizatat e masave dhe sektorët përkatës të pushtetit për t'i ndjekur e për t'i kontrolluar të gjitha këto që thamë.

Gjatë kësaj kohe, në bazë të planit të hartuar me kujdes, në kooperativë do të jetë bërë një punë e mirë edukative e politike me njerëzit, do të jenë organizuar konferenca e biseda politike, kurse të ndryshme, do të jenë lexuar e punuar në mënyrë të organizuar gazeta, revista, libra, do të jenë parë filma, do të jenë organizuar shfaqje artistike etj. Me një punë të tillë të organizuar situata atje do të ndryshojë, do të forcohet organizata e Partisë, masat do të jenë edukuar e do të jenë bërë më të ndërgjegjshme dhe do të mobilizohen

me të gjitha forcat për realizimin e orientimeve të Partisë. Si rrjedhim, do të hapen edhe tokat e reja të parashikuara, do të mbillet gruri, do të shtohet numri i lopëve sipas parashikimeve. Kështu, pra, duke vepruar e duke marrë gjithë këto masa organizative, brenda një kohe të caktuar, do të mund të jenë përgatitur për këtë kooperativë aq komunistë, gra, vajza, të rinj e kooperativistë, nga aktivistët më të shquar, për sa ka nevojë ajo.

Kur vjen puna që sekretari i komitetit të Partisë që merret me çështjet organizative, studion gjendjen e masave ndëshkimore dhe shikon se ndaj komunistëve të rrethit janë marrë shumë masa, një pjesë e mirë e të cilave në rrugë jo të drejtë, atëherë ai reflekton thellë për këtë çështje, sepse kjo është me rëndësi të madhe politike dhe ideologjike për Partinë. Prandaj kërkon nga aparati t'i sjellin dokumentet e të gjithë komunistëve të ndëshkuar dhe qëndron me to jo një orë, por tri ditë me radhë, duke i studiuar një për një dhe, më në fund, del me disa konkluzione, në bazë të të cilave i propozon komitetit të Partisë të rrethit t'u tërheqë vëmendjen organizatave-bazë për të gjitha masat e marra pa kriter ndaj komunistëve të ndëshkuar, t'u tregojë në cilat drejtime kanë gabuar dhe t'u shpjegojë ç'dëm të madh i sjellin Partisë të tilla veprime të papjekura. Masat ndëshkimore të bazuara dhe që kanë karakter edukativ komiteti i Partisë i aprovon, kurse për të tjerat, që nuk i gjen me vend, u jep porosi organizatave-bazë t'i rishikojnë, të tregohen më të thelluara dhe u tërheq vëmendjen që në të ardhmen të mos shpejtohen e të mos vepronë pa i gjykuar me

drejtësi. Me një studim të mirë të këtij problemi, sekretari i komitetit të Partisë që merret me çështjet organizative, ndihmon udhëheqjen e Partisë në rreth për të nxjerrë konkluzionin se për ç'qëllim duhen marrë në Parti masat ndëshkimore ndaj komunistëve, që Partisë t'i bëhet e qartë se ato duhen marrë për çështje shumë serioze dhe me karakter politik, për shmangie nga vija e Partisë e jo edhe për gjënë më të vogël.

Unë jam dakord me mendimin që u shfaq këtu, sipas të cilit, në organizatën-bazë të Partisë, kur shqyrtohet veprimtaria e një komunisti, të rrihen mirë mendimet, të bindet komunisti që ka gabuar dhe jo të kalohet menjëherë në marrje mase kundër tij. Me atë që gabon, organizata-bazë duhet të punojë, që ai të kuptojë se gabimi i tij e dëmton Partinë. Kur komunisti bindet, atëherë përse të merret masë? Sigurisht, ka edhe raste që edhe masë duhet marrë, po rëndësi t'i vihet punës me atë që gabon, pra, të punohet që të bindet dhe të ndreqet.

Kështu duhet vepruar edhe për shumë çështje të tjera organizative, sepse Partia nuk mund të rrojë e të zhvillohet pa i shikuar e pa i zbatuar drejt e gjer në një, një numër të madh problemesh të tilla.

Çdo direktivë politike, ideologjike, ekonomike etj., e dërguar nga Komiteti Qendror, ose e nxjerrë nga vetë komiteti i rrethit nuk duhet t'i shpëtojë sekretarit të komitetit të Partisë që merret me çështjet organizative dhe t'u kalojë organizatave-bazë të Partisë, pa menduar edhe ky vetë më parë çfarë masash organizative (bile këto duhet të jenë të një niveli të lartë) duhen marrë për të siguruar zbatimin e tyre. Ai, pra,

duhet të mendojë mirë për masat organizative që do të sigurojnë kontrollin dhe zbatimin e çdo direktive të rëndësishme të Partisë.

Mirëpo kështu siç po veprohet, kam përshtypjen se shokët e komiteteve të Partisë nuk po e kuptojnë sa duhet rëndësinë e këtyre problemeve të mëdha, siç janë çështjet organizative të Partisë. Si rrjedhim, nuk po u kushtohet kujdes i veçantë si këtyre çështjeve, ashtu edhe detyrave që kanë komisionet e kontrollit e të revizionimit të Partisë në rrethe.

Në qoftë se duam që punët e Partisë të na shkojnë mirë, atëherë, shokë, duhet që edhe apelimet të shqyrtohen me vëmendje të madhe, që zëri i masës së Partisë, zëri i atyre që ndëshkohen të dëgjohen më me kujdes. Kur ka ankesa nga ata ndaj të cilëve merren masa partie, këta duhen mësuar që t'i drejtojnë letra edhe kryetarit ose komisionit të kontrollit e të revizionimit në rreth, në mënyrë që edhe ai të japë mendimin e tij të pavarur për masat ndëshkimore të marra nga organizata-bazë ose nga byroja e komitetit të Partisë.

Përse i ka zgjedhur organizata e Partisë këta pesë ose shtatë veta në komisionin e kontrollit e të revizionimit në rreth? Në qoftë se këto komisione u bëjnë clozhe shokëve të byrosë së komitetit të Partisë, atëherë kot që janë zgjedhur. Përse këta të jenë ndryshe nga Komisioni Qendror i Kontrollit dhe i Revizionimit apo për arsye se ky i fundit është zgjedhur nga Kongresi? Në qoftë se ai është zgjedhur nga Kongresi i Partisë për të bërë punën e vet, edhe komisioni i kontrollit dhe i revizionimit në rreth është zgjedhur nga

konferenca e Partisë e rrethit për të bërë punën e tij në kuadrin e rrethit, në bazë të kompetencave që i ngarkon Statuti i Partisë. Komisioni i kontrollit e i revizionimit në rreth nuk ka të drejtë të anulojë vendimin e organizatës-bazë dhe as të byrosë së komitetit të Partisë të rrethit për të kthyer në Parti një komunist të përjashtuar, për arsye se këtë të drejtë Kongresi ia ka dhënë vetëm Komisionit Qendror të Kontrollit e të Revizionimit, por komiteti i Partisë i rrethit duhet t'i edukojë komunistët të kenë besim te njerëzit, që ata vetë i kanë zgjedhur në komisionin e kontrollit dhe të revizionimit në rreth dhe t'u drejtohen për masat ndëshkimore dhe për ankesat e tjera që kanë për organizatat-bazë dhe për komitetet e Partisë, të cilat janë në kompetencën e këtij komisioni. Megjithatë, demokracia e brendshme e Partisë i lejon komunistit që, po të dëshirojë, ai mund t'i drejtohet edhe Komitetit Qendror, Komisionit Qendror të Kontrollit dhe të Revizionimit, Byrosë Politike ose Sekretarit të parë të Komitetit Qendror, por në qoftë se asnjëri prej tyre nuk i drejtohet komisionit të kontrollit dhe të revizionimit në rreth, kjo do të thotë se askush s'ka besim te ky organ që e ka zgjedhur Partia. Prandaj sekretarët e komiteteve të Partisë duhet t'i preokupojë kjo gjendje, t'i marrin më shtruar çështjet organizative, sepse ato janë shumë të rëndësishme për Partinë.

Përjashtimi i komunistëve nga Partia është një problem mjaft serioz, prandaj duhet të na preokupojë gjithnjë. Asnjëri nuk duhet të niset nga pikëpamja se në kohën e luftës tregohej më shumë kujdes për anëtarët e Partisë, për arsye se i kishim me krëk dhe ishin

shumë të vlefshëm, kurse tani i kemi të shumtë në numër, prandaj edhe për një gabim të vogël që mund të bëjë njëri, mund të përjashtohet me lehtësi dhe si pagjë të keq nga Partia. Një pikëpamje e tillë nuk është e drejtë. Në Parti ne duhet të pranojmë dhe pranojmë njerëzit më të mirë dhe këta jo me një punë shkel e shko, po pas një pune të veçantë dhe pasi provohen mirë gjatë stazhit të kandidatit. Prandaj, ashtu si punojmë dhe kujdesemi për t'i pranuar, të njëjtat përpjekje duhet të bëjmë për t'i shpëtuar dhe për t'i shëruar komunistët që gabojnë e që kanë të meta dhe vetëm pasi të jetë bërë çdo përpjekje dhe komunisti nuk jep shenja se do të korrigohet, atëherë mund të vendoset që të përjashtohet nga Partia dhe jo siç veprohet në disa raste.

Raportet që na paraqiten për këto probleme na shërbejnë të gjithëve, sepse na shkundin, na ndihmojnë të zbulojmë të metat dhe të marrim masat e nevojshme për të përmirësuar punën tonë. Udhëheqja e Partisë ka besim te ju, shokë sekretarë të komiteteve të Partisë, që jeni po aq të vjetër në Parti e në moshë, keni po aq përvojë në punët e Partisë, sa edhe ne. Prandaj ajo që thoni ndonjëherë se këtë ose atë çështje nuk e menduam dot mirë, nuk qëndron më këmbë. Natyrisht, po të mendoni dhe t'u futeni më thellë çështjeve, ju jeni në gjendje të bëni një punë më të mirë, të pjekur, të pastër. E vërteta është se punë nuk keni pak, punët tuaja nuk janë të një sektori të kufizuar, përgjegjësitë, pra, nuk i keni të vogla, por është, gjithashtu, e vërtetë se Partia në çdo rreth ka tani plot shokë e kuadro, vetëm se ju duhet të dini t'i organi-

zoni dhe t'i aktivizoni më mirë, të shfrytëzoni të gjitha kapacitetet që kanë, me qëllim që ata të japin kontributin e tyre edhe për këto çështje. Kjo ka rëndësi të madhe, prandaj ju duhet t'u kushtoni më shumë kujdes problemeve organizative të Partisë.

Unë dhe shokët e tjerë të Sekretariatit jemi të bindur se ju jeni në gjendje t'i kryeni shumë mirë, si gjithë detyrat e tjera, edhe ato organizative, vetëm duhet të reflektoni edhe më mirë për to, të përcaktoni dhe të merrni masa për çdo detyrë që del në këtë drejtim, të shfrytëzoni dhe të aktivizoni si duhet shokët që keni përreth, pa të cilët punët nuk do të kryhen mirë dhe shpejt. Ne mund të pranojmë që ndonjë gjë të bëhet edhe ngadalë, po të bëhet saktë dhe jo duke u kaluar çështjeve përciptas. Kohë për të menduar keni, por është pikërisht për arsye se ju nuk mendoni si duhet për masat organizative, që duhen marrë për zgjidhjen e një problemi, prandaj punët nganjëherë nuk i bëni si duhet.

Organizoni mirë punët, shokë, mendoni mirë për to dhe se kush do të ngarkohet për t'i kryer, u jepni udhëzime të qarta shokëve, i kapni dhe u hyni thellë problemeve, i lidhni pastaj ato me njëri-tjetrin. Në qoftë se flasim për zgjidhjen e një problemi, për punën politike e ideologjike me masat, për zhvillimin e ekonomisë, për mbjelljet, për korrjet, për shtimin e për përmirësimin e blegtorisë etj., etj., për t'i shkuar gjer në fund çdo problemi, duhet menduar më parë për masat organizative, që do të sigurojnë zgjidhjen e tyre.

Tani po ngremë çështjen që punëtorët të vijnë në

udhëheqje të Partisë. Ky është një problem i madh politik e organizativ dhe duhet menduar seriozisht si ta organizojmë punën për ta vënë në jetë këtë direktivë të rëndësishme. Në rast se këtij problemi do t'i hyjmë mirë, në rast se atë do ta kuptojmë si duhet politikisht dhe organizativisht dhe do ta konkretizojmë në rrugë të vërtetë partie, atëherë do të kemi suksese. Megjithatë, rezultatet nuk do të jenë ato që dëshirojmë, mund të mos arrijmë në zgjidhjen që duam ne, sepse mund të ketë komunistë dhe kuadro që nuk do ta kuptojnë mirë këtë situatë, disa të tjerëve mund t'u mbetet qejfi dhe të thonë se ai që u ngrit është vërtet punëtor, por nuk mund të barazohet me mua që kam këto merita etj., etj.

Për një vendim, gjithashtu, mund të thuhet që e ka marrë organizata-bazë e Partisë (dhe ne duhet të kemi besim të madh tek ajo), por, nga ana tjetër, komiteti i Partisë i rrethit duhet të dijë në hollësi si është diskutuar problemi para se të merrej ky vendim. E tërheqim vëmendjen, sepse ka raste që dy-tre veta e sjellin vërdallë organizatën-bazë e, nga ana tjetër, pa e njohur mirë situatën kur është marrë ky vendim, thuhet lehtë-lehtë se për të ka vendosur organizata, kurse vendimi, në fakt, nuk përfaqëson vullnetin e saj, po atë të dy-tre vetave.

Por a e rrëzon kjo konceptin e drejtë filozofik që organizata-bazë është kryesorja? Në asnjë mënyrë, pse në rastin kur nuk veprojnë drejt dy ose tre veta, janë këta që prishin punë dhe jo organizata-bazë. Prandaj të kemi kujdes në gjithë këto çështje. Ndonjërit, që ka qenë sekretar partie gjer përpara, megjithëse mund të

jetë shok i ngritur e me përvojë, mund t'i mbetet qejfi kur të mos zgjidhet më në këtë detyrë, po në vend të tij të ngrihet një punëtor. Ai mund të thotë me mendjen e tij: «Si është e mundur që tani të ngrihet ky, i cili as me «hutën» time nuk barazohet!», pale të ketë mbaruar universitetin ai. Të mos harrojmë se ekzistojnë pikëpamje të tilla te njerëzit, prandaj t'i kemi parasysh që t'i zhdukim me punë partie, të menduar mirë në të gjitha drejtimet, në radhë të parë ideopolitike, po edhe organizative.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

VAZHDIMISHT TË TREGOJMË VËMENDJE PËR PUNËN ME RININË

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

8 maj 1968

Raportet, që na janë paraqitur, flasin për anët shumë pozitive që kanë aksionet e mëdha të rinisë, të organizuara nga Partia dhe nga Qeveria. Ne konstatojmë se të gjithë të rinjtë e të rejtat e krahinave të ndryshme të vendit tonë tregohen shumë të zgjuar, të vendosur e revolucionarë. Kjo është shumë inkurajuese dhe na jep shpresa se edhe mjaft mbeturina të së kaluarës, që ekzistojnë akoma në krahinat e Veriut, ashtu sikurse edhe në ato të Jugut, që në kushte të tjera nuk mund të zhduken aq lehtë, do të vijë koha, bile jo shumë larg, që të likuidohen, sepse ne kemi një brumë shumë të mirë. Duke i parë çështjet në

1 Në këtë mbledhje u diskutua për punën e organizatave të Partisë e të rinisë me të rejtat dhe me të rinjtë që kthehen nga aksionet. Për këtë problem raportuan KQ i BRPSH dhe komitetet e Partisë të rretheve Librazhd, Mat, Mirditë e Pukë.

prizmin real, ne shohim se këto mbeturina vijnë vazhdimisht duke u zhdukur, por, natyrisht, jo tërësisht menjëherë. Këtë na e provuan aksionet, nëpërmjet të cilave është bërë një punë e madhe edukuese. Prandaj, edhe në të ardhmen, me sa kemi mundësi, ne duhet të ecim me vendosmëri në këtë rrugë, të përpiqemi që këto aksione kombëtare të vazhdojnë, bile duhet menduar për të organizuar edhe aksione të tjera lokale, deri brenda çdo fshati, pse edhe këto kanë rëndësinë e tyre.

Të gjitha këto punë të marra së toku, duke filluar që nga shkuarja e rinisë në aksione e gjer te vajtja e kooperativistëve në grupe nga Veriu në Jug, nga malësia në fushë e anasjelltas etj., të cilat na kanë krijuar një situatë shumë revolucionare në gjithë vendin, sidomos në fshat, ku ne shikojmë një bazë të mirë të punës sonë, të gjitha këto, pra, ne duhet t'i kuptojmë në të njëjtin kuadër, të lidhura e jo të shkëputura nga njëra-tjetra.

Është e domosdoshme që gjatë zhvillimit të propagandës për dërgimin e vullnetarëve në aksione të mos kufizohemi vetëm me të rinjtë dhe me të rejat, po të përfshihen në këtë punë edhe prindërit. E them këtë se nga mungesa e punës sonë bindëse propagandistike me ta, disa prindër futen nganjëherë, si pa gjë të keq, në radhën e konservatorëve, për arsye se, duke mos qenë të qartë, ata mund të thonë nga një fjalë, sjellin pengesa, rezistojnë për dërgimin e vajzave të tyre. Ne duhet të kemi parasysh se shumë nga këta prindër, që sjellin pengesa, janë akoma analfabetë, të prapambetur, ruajnë në veten e tyre mentalitete dhe zakone

të vjetra. Pastaj, duhet kuptuar drejt se këtë kemi të bëjmë edhe me interesimin e natyrshëm të babait dhe të nënës, me kujdesin dhe me shqetësimet e tyre për fëmijët, që do t'u largohen për disa javë nga shtëpia, aq më tepër kur këto janë vajza të reja 16-17-vjeçare.

Prandaj, duke i njohur mirë këto çështje, organizata e Partisë, organizata e Frontit dhe ajo e gruas, ashtu siç bën organizata e rinisë me të rinjtë dhe me të rejat, duhet të marrin masa për të zhvilluar edhe me prindërit një propagandë intensive. Kuptohet se me të rinjtë e me të rejat puna është më e lehtë, për arsye se ata, me thirrjen e parë të Partisë, shkojnë kudo që të jetë nevoja. Edhe në qoftë se mund të ketë ndonjë vajzë, që aty për aty lëkundet ca, këtë e bën jo se nuk dëshiron të vejë në aksion, por se gjen rezistencë nga ai që rri lart «në kullë», sepse, sikur nëna dhe babai t'i thonë të shkojë, ajo është e gatshme të vejë menjëherë. Këtë mungesë të propagandës sonë me prindërit ne nuk e shohim si duhet, punojmë vetëm kur gjejmë rezistencë nga ana e tyre, në vend që të bëjmë një punë të vazhdueshme e të organizuar, gjë që do të na sillte shumë të mira.

Propaganda jonë me prindërit nuk duhet të ketë për qëllim vetëm sa t'i nxitë ata për të lejuar vajzat të venë në hekurudhë. Ajo duhet të synojë në thyerjen e koncepteve e të mentaliteteve të vjetra, në zhdukjen e shumë pikëpamjeve jo të drejta, për t'u ngjallur atyre besimin e madh te vajza e vet, se ajo është me karakter të fortë, prandaj, si e tillë, kudo që të vejë, nuk pëson gjë. Pastaj, në aksion, atë do ta ketë vazhdimisht në kujdes Partia. Propaganda jonë duhet

t'u bëjë, gjithashtu, të qartë prindërve se, duke vajtur vajza në aksion, do të mësojë shumë gjëra, do të bëhet më e zonja, më e aftë për shoqërinë, për familjen, për veten e saj dhe për prindërit; duke u kujtuar prindërve të kaluarën e tyre të hidhur, këta do të ndihmojnë që sot bijtë e bijat e tyre të mos vuajnë, siç kanë vuajtur vetë kur kanë qenë të rinj.

Me një punë të tillë të organizuar të propagandës sonë, në mënyrë të dyanshme, ne do të thyejmë një mur të madh. Këtë mendoj ta keni parasysh në punën tuaj, shokë, të mos e lini pas dore. Mos mendoni se tani njerëzit u mësuan që fëmijët e tyre venë në hekurudhë dhe s'paska më nevojë të punohet me prindërit. Prandaj organizata e Frontit dhe organizatat e tjera të masave e kanë për detyrë të punojnë frontalisht jo vetëm me të rinjtë e me të rejat, por edhe me prindërit, në mënyrë që ata të mos i pengojnë fëmijët e tyre për të shkuar në aksione, t'u flasin për rëndësinë e çdo aksioni, për vetë edukimin e rinisë dhe për interesat e vendit. Të jeni të bindur se në këtë rast prindërit nuk do të sjellin pengesa. Aq më tepër duhet bërë kjo punë me fshatarët, të cilët duhen sqaruar me durim të madh.

Siç na thonë shokët e rinisë të rrethit të Mirditës, atje është krijuar një lëvizje e tillë sa sot nuk ka fshat ku të mos kenë shkuar lart nga 15-20 të rinj e të reja nëpër aksione. Kjo ka shumë rëndësi dhe do të thotë se këta 15-20 veta kanë parë dhe kanë mësuar shumë gjëra, u janë hapur horizonte dhe, kur kthehen, duke pasur plot energji, nuk mund të rrinë dot të qetë, prandaj duhen aktivizuar. Rëndësi tani ka çësh-

tja që këta njerëz të dimë t'i organizojmë, t'i vëmë në lëvizje dhe të na aktivizojnë, në radhë të parë, tërë rininë e fshatit.

Shumë të rinj e të reja shkojnë sot nga fshati në hekurudhë, ka nga ata që dërgohen në aksione të tjera, pastaj në kurse, si: në Durrës, në Elbasan etj., që organizohen nga qendra, por që organizon edhe vetë rrethi. Të gjithë këta venë në aksione ose në kurse, me qëllim që të kthehen përsëri në fshat, por gjatë kësaj kohe ata kanë rast të shohin krahina të ndryshme të Shqipërisë, të vizitojnë fabrika, uzina e vepra të tjera, me një fjalë njihen me vendin, u rritet dashuria për atdheun dhe për fshatin e tyre, që është pjesë përbërëse e atdheut. Këto horizonte të gjera, që u hapen aksionistëve, duhet të shfrytëzohen për ta përmirësuar gjithnjë më shumë e më shpejt jetën e fshatit, që ata të lidhen më ngushtë me vendlindjen e tyre dhe jo me të shkuar në aksion, t'u bëhet mendja çarçaf, siç ndodh me ndonjërin që, porsa vete në hekurudhë ose në një kurs, bën ç'është e mundur të mos kthehet më në fshat. Një prirje e tillë nuk është e mirë. Prandaj të rinjtë e të rejat, që shkojnë vullnetarë në hekurudhë ose në çdo aksion tjetër, në kurse apo në shkolla, t'i edukojmë që gjithçka që do të mësojnë atje, ta vënë në shërbim për të mirën e fshatit, me të cilin është lidhur jeta e tyre dhe, kur t'i thërrisë përsëri Partia, të jenë të gatshëm të punojnë kudo, të mësojnë dhe përsëri të rikthehen për t'i shërbyer fshatit, bashkëfshatarëve të tyre.

Prandaj ju, shokë të Partisë dhe të rinisë, i kush-toni një kujdes më të madh punës për edukimin e

thellë revolucionar e patriotik të rinisë në fshat. Mos e lini në gjumë këtë anë të rëndësishme të punës suaj, mos punoni vetëm sa për të dalë të rinjtë e të rejat në aksione, por merruni me rininë gjatë gjithë kohës, në mënyrë që në fshatin tonë të ndihen vazhdimisht gjallëria dhe entuziazmi i madh i saj në punë, në familje, në jetën shoqërore. Është detyra juaj që ta bëni këtë punë.

Po si do të bëhet një gjë e tillë? Sigurisht, nëpërmjet një veprimtarie të gjithanshme, nëpërmjet punës në prodhim, aktiviteteve të ndryshme shoqërore, formave të punës politike, organizimit të mirë të kohës për dëfrim, me lodra, me sport, me këngë, me valle etj., nëpërmjet këmbimit të përvojës me njëri-tjetrin, kooperativë më kooperativë, zonë më zonë, rreth më rreth e, më së fundi, edhe në aksionet e mëdha kombëtare. Rinia, në të gjitha këto shkallë, duhet të futet në gara, vetë ju duhet të vini më shumë në lëvizje trupin dhe mendjen tuaj që gjithë këto aktivitete të mos jenë stereotipe, sepse e kuptoni më mirë se kushdo që rinia kërkon vazhdimisht diçka të re, jo të vjetruar e të përsëritur shumë herë. Rëndësi ka të gjenden forma të ndryshme edukimi, mbledhjeje, forma të ndryshme pune, çlodhjeje, që rinia jonë të mos mërzhitet kurrë dhe jetën t'ia bëjmë të bukur, të këndshme, sepse kështu do të jetë më mirë në gjendje të punojë e të prodhojë, të dëfrojë e të edukohet.

Të rinjtë dhe të rejat nuk duhet t'i mësojmë si në kazermë, vetëm sa të shkojnë për të punuar në brigadë, të venë në mbledhje, të dëgjojnë vetëm ndonjërin që i bie fizarmonikës, ose të shohin ndonjë që di të

luajë me top dhe për të tjerat të mos interesohet njeri. Natyrisht, të rinjtë e të rejat do të punojnë dhe duhet të punojnë mirë në brigadë, por, pas punës, ata kanë nevojë të luajnë e të dëfrenjë, prandaj, përveç aktiviteteve që zhvillohen, të gjallërohen edhe lodrat popullore, që kanë ekzistuar kudo në vendin tonë. Në çdo fshat ka kushedi sa lodra të ndryshme popullore, që tani gati janë lënë pas dore, në mos janë harruar fare, pse është krijuar një pikëpamje jo e drejtë se, që t'i zhvillosh sportin dhe artin, ose duhet të kesh stadione e fizarmonika, ose ndryshe asgjë nuk bëhet. Kjo nuk është e drejtë, prandaj të mos lihen mënjanë, po të praktikohen të gjitha lodrat, këngët e vallet popullore, që i kemi trashëguar me shumicë, të cilat janë shumë të bukura dhe ndihmojnë mjaft si për edukimin, ashtu edhe për dëfrimin e rinisë, bile të përpiqemi të krijojmë të tjera të reja.

«Shkoni në klub ose në vatrën e kulturës!», u thuhet të rinjve e të rejave të kooperativës. Por ato mund të jenë larg shtëpisë; ka edhe prindër që janë ca prapanikë dhe nuk e lejojnë me një të thënë vajzën të dalë natën nga shtëpia, sepse shqetësohen për të. Por, në qoftë se në shtëpinë e tyre do të venë pas punës 5-6 vajza fqinje për të luajtur, për të bërë punë dore, ose diçka tjetër të dobishme, ata, me siguri nuk kanë për të thënë gjë. Në grupe të tilla të rejash organizata e rinisë mund të dërgojë një të re aktiviste ose komuniste që, krahas lodrave dhe punës së dorës, në kohën ndërmjet tyre ose pas një kënge, t'u lexojë shoqeve të saj një artikull gazete apo reviste, një libër e t'u tregojë diçka të dobishme etj. Prindërit, që do t'i sho-

hin me se merren këto vajza kur u mblidhen në shtëpi, kanë për ta lënë vajzën kur ta thërresin në klub, në vatrën e kulturës ose në mbledhjen e rinisë.

Ju, shokë të rinisë, duhet, gjithashtu, t'i braktisni disa forma edukimi e pune me rininë, që tashmë janë vjetruar. Këtë Partia e ka thënë kurdoherë, po s'ka gjë pse e përsërit edhe me këtë rast. Përfitoni nga përvoja e njerëzve të gatshëm, të zotë e me talent, që kemi në fshatrat tona, mbështetuni kurdoherë në ta, merrni parasysh mendimet e tyre dhe i ngarkoni të organizojnë, si e mendojnë ata vetë, punën, i lini të veprojnë si mendojnë ata, mos u rekomandoni receta. Kur del nevoja, le ta mbrojnë siç e mendojnë vetë një vajzë, në qoftë se të drejtat e saj merren nëpër këmbë. Kur ndonjërin e fejojnë në moshë të mitur, le të venë vetë të rinjtë e të rejat më aktive e t'u thonë prindërve të mos e fejojnë vajzën e tyre në moshë të re dhe të përpiqen t'i bindin, ashtu si mendojnë vetë. Vajzat dhe djemtë e fshatit tonë sot janë në gjendje ta bëjnë shumë mirë dhe si duhet një gjë të tillë. Kjo do të ndihmojë të krijohet edhe një kontakt shumë i ngushtë, i sigurtë, i dashur, i thjeshtë, jo i imponuar dhe i rekomanduar me receta në mes brezit të ri dhe brezit më të moshuar.

Ju ju revoltton akti i një prindi kur vajzës së tij, që u kthye nga aksioni me leshra të prera, ai i imponon ta vërë përsëri shaminë në kokë, ose të veshë rrobat e saj të mëparshme. Mos u revolttoni, shokë, për një gjë të tillë. Duhet menduar pak për këtë problem. Së pari, prerja e flokëve të vajzës në malësitë tona ishte turp i madh, ndërrimi i veshjes dhe çdo gjë e re malësorit i duket e vështirë, sidomos kur këto janë në

raste të kufizuara. Së dyti, kjo ndodh edhe për arsye se organizata e Partisë dhe ato të masave në fshat nuk kanë bërë një punë të thellë ideopolitike me këtë njeri, në mënyrë që ai t'i kuptojë drejt këto çështje dhe të evitohet konflikti brenda në familje. Organizata e Partisë dhe ato të masave nuk duhet të rrinë duarlidhur përpara këtij qëndrimi, ato duhet të punojnë për ta bindur prindin, në mënyrë që dhe ai vetë ta kuptojë dhe t'i thotë së bijës të mos e vërë më shaminë në kokë dhe të vishet si shoqet e saj.

Partia duhet t'i mbështetë të rejat e të rinjtë që shkojnë nëpër aksione, që tregojnë kaq shumë gatishmëri dhe frymë revolucionare në punë e dëshirë për të përvetësuar të renë. Do të jetë shumë e dëmshme në rast se këta njerëz Partia nuk i përkrah dhe nuk i organizon, nuk i udhëzon e nuk i drejton që të punojnë edhe me të tjerët në fshat. Këta të rinj e të reja këtej e tutje do të na shtohen kudo. Në qoftë se nga një fshat tani kemi dy që kanë shkuar në aksion, vitin tjetër do të na bëhen 7, pastaj 27 e kështu çdo vit më shumë. Po sa të tjerë të rinj e të reja ka në fshat, që nuk janë njerëz prapanikë, se atje ka organizatë partie dhe rinie që punojnë me ta, që u lexojnë shtypin, që udhëhiqen në çdo drejtim nga vija e Partisë dhe përparojnë. Pra, nuk janë të mirë vetëm ata që shkojnë nëpër aksione, po dhe të tjerët, sepse fshati ynë përparon në sajë të punës së të gjithëve. Megjithatë, vullnetarët janë njerëz që, përveç punës në fshat, kanë shkuar edhe në aksione, ku kanë pasur rast të shohin vendin, të mësojnë shumë gjëra që të rinjtë e të rejat e tjerë nuk i dinë, se të dalësh jashtë fshatit është një

shkollë dhe mësim i madh. Prandaj, pa lënë mënjanë punën me të rejat e me të rinjtë, që nuk kanë shkuar në aksione, të punohet edhe me ata që kanë qenë, për ta mbajtur kurdoherë lart frymën e aksionit.

Një mungesë e tillë pune mund të bëjë që disa nga vajzat e reja, që dërgohen për të kryer kurse në qytete, të kenë, për shembull, tendencën që ta përdorin këtë mësim të shkurtër që u jepet, fjala vjen, për rrobaqepëse, për kuzhinë ose për higjienë, vetëm për interesin e tyre. Organizata e rinisë duhet të punojë me to politikisht dhe ideologjikisht që aftësitë e fituara t'i përdorin jo si stoli për vete, po për të mësuar edhe vajzat e tjera të fshatit, që nuk kanë pasur rastin të shkojnë në kurs. Mundet që te këto të lindë dëshira për të punuar me ditë-punë në fshat për zanatin e mësuar. Në qoftë se kooperativa ka nevojë të krijohet një repart artizanati për rrobaqepësi, atëherë, pse të mos ngrihet dhe ato të punojnë me ditë-punë? Këtyre grave ose vajzave, që kanë mësuar në kursin e rrobaqepësisë, mund t'u blihet ndonjë makinë qepëse dhe rreth vetes të grumbullojnë gra apo vajza të tjera aq sa nevojiten, t'u mësojnë zanatin, ose, po të jetë kjo e vështirë për to, të pamësuarat të dërgohen të mësojnë, gjithashtu, në kurs në qytet si të parat dhe, pasi të jenë përgatitur, me të gjitha së bashku, të hapet një repart për rrobaqepësi në kooperativë.

Kjo punë në fshat të organizohet mirë, sepse çështja nuk mbaron vetëm me dërgimin e vajzave në kurs, po të mendohet sidomos për ato që duhen bërë më vonë. Një vajze që është dërguar të kryejë një kurs për higjienë, i është mësuar atje si duhet mbajtur hi-

gjiena personale e burrit dhe e gruas. Higjiena e gruas sidomos ka disa veçori, të cilat duhet t'i kuptojnë drejt përgjegjësit në ndërmarrjet shtetërore, e veçanërisht në kooperativat bujqësore, me qëllim që gruaja të plotësojë nevojat që kanë të bëjnë me higjienën, e cila lidhet me ruajtjen e shëndetit të saj dhe të mos ndodhë si me ndonjë përgjegjës që, pse ajo vjen pesë minuta me vonesë në punë, merr masa kundër saj. Për nevojat e tyre të veçanta grave u duhen edhe disa mjete materiale për të cilat të merren masa nga organet përkatëse që ato të gjenden në dyqanin e fshatit.

Dyqani i kooperativës duhet t'i tregtojë këto sende të nevojshme për ruajtjen e higjienës personale të grave dhe të burrave. Në qoftë se në kooperativë hapet reparti i rrobaqepësisë dhe rrobaqepëset, që fillojnë nga puna, nuk kanë material për të prerë e për të qepur ndërresa në sasi të mjaftueshme për burrat dhe për gratë, që punojnë në shi e në diell, që lodhen e djersijnë dhe pas punës kanë nevojë të veshin ndërresa të pastra, atëherë, flasim kot për higjienën personale. Si mund të mbahet kjo higjienë kur njeriu nuk gjen në dyqan të blejë kur i duhet e sa i duhet pëlhurë e basme, këmishë, veshmbathje e sende të tjera? Prandaj, krahas propagandës dhe që kjo të mos qëndrojë në hava, duhet të merren masa për t'i siguruar këto sende, sepse, po nuk e shoqëruam propagandën për higjienën me bazën materiale të nevojshme, të gjitha ato për të cilat u flasim njerëzve, nuk do të zënë vend, nuk do të zbatohen.

Njerëzit, që mësojnë e përparojnë, nesër do t'i rritin kërkesat, që i lind vetë zhvillimi ynë, prandaj

këtyre duhet t'u dalim me kohë përpara. Ne kemi bërë posaçërisht një plenum të Komitetit Qendror në vitin 1963 për problemet socialkulturore të fshatit, po flasim vazhdimisht për zbatimin e detyrave të këtij plenumi, por, në realitet, jemi akoma larg realizimit të vendimeve që kemi marrë. Ne themi se fshatari duhet të lahët, po akoma jo në çdo fshat njerëzit kanë enë të mjaftueshme e të përshtatshme ku të ngrohin ujët për t'u larë një herë në javë të gjithë pjesëtarët e familjes. Prandaj këto çështje duhen pasur mirë parasysh, me qëllim që të luftojmë të gjithë gjer në fund derisa t'i plotësojmë.

Gjithë këto që keni bërë, shokë të rinisë, janë të mira. Gjendja në vendin tonë është kudo shumë e mirë, rinia ka punuar me të gjitha forcat në drejtimet që po diskutojmë, prandaj ju përgëzojmë për sa keni bërë. Këtë vit do të vazhdojmë të dërgojmë akoma të rinj e të reja vullnetarë në hekurudhën Rrogozhinë-Fier dhe të keni parasysh që atje të mos venë po ata njerëz të cilët kanë shkuar vitin e kaluar, po të dërgohen të tjerë, që nuk kanë shkuar ndonjëherë. Kujdes të ketë në këtë çështje, sidomos, rrethi i Dibrës, i cili duhet të marrë shembull nga ai i Mirditës, ku edhe nuset e reja shkojnë grupe-grupe në hekurudhë, kurse vajzat në disa fshatra të rrethit të Dibrës, nga sa kam dëgjuar, kur martohen, rrinë një vit pa dalë në punët e kooperativës. Mendoj se kanë bërë shumë mirë shokët e Mirditës, që kanë bërë thirrje dhe kanë dërguar të reja të sapomartuara në hekurudhë. Ata tani qahen se ka vajza që martohen 18-19 vjeç dhe, pas martesës, nuk shkojnë më në organizatën e rinisë, po

shkojnë më lehtë në atë të gruas. Kjo nuk ka shumë rëndësi. Rëndësi ka çështja që ato të bëjnë diku jetën politike, të shkojnë në aksione, në hekurudhë etj.

Shoku i rinisë i rrethit të Pukës ngriti problemin e koordinimit të punës edukuese midis bashkimeve profesionale dhe organizatës së rinisë për punëtorët e rinj, që banojnë në fshat. Unë mendoj se ju, shokë të organizatës së rinisë, së bashku me ata të bashkimeve profesionale, mund të bëni njëfarë ndarjeje pune për punën politike e ideologjike, që do të zhvilloni me punëtorët që punojnë në ndërmarrjet shtetërore, po që banojnë në fshat, në mënyrë që me ta të mos bëhet punë paralele. Bashkimet profesionale mund të organizojnë me këta punëtorë punën edukuese dhe ideologjike, që ka lidhje me problemet e qendrës së punës, kurse organizata e rinisë të interesohet për punën dhe për aktivizimin e tyre, për kohën që këta të rinj e kalojnë në fshat pas punës. Kështu, puna edukuese me këta të rinj kombinohet si me problemet e qendrës së punës, ashtu edhe me ato të fshatit. Në këtë mënyrë, puna politike dhe ideologjike me ta nuk do të bëhet e mërzhitshme, do t'ia arrinte më mirë qëllimit dhe punëtorët e rinj, që s'janë shkëputur krejtësisht nga fshati, do të marrin një edukim më të plotë e të detajuar, në mënyrë që, gjatë kohës që do të jenë në fshat, të çojnë atje frymën e klasës punëtore, ideologjinë e saj. Me këta të rinj duhet bërë kjo punë edukuese e organizuar mirë që ata të mos bien nën presionin e pikëpamjeve të huaja, që mund të ndeshin në fshat, përkundrazi, duke u kujdesur qysh në qendrën e punës për ta, ne i armatosim të bëhen propagandistë të vijës së

Partisë dhe aktivistë të organizatës së rinisë në fshat.

Tani mendojmë që, mbasi të mbarojmë linjën Rrogozhinë-Fier, të ndërtojmë një hekurudhë të re në drejtimin Elbasan-Librazhd, ku duhet të vazhdohet tradita e aksioneve të rinisë. Kështu do të kemi punë me rininë edhe në të ardhmen. Prandaj ju urojmë, shokë të rinisë, suksese të reja më të mëdha në punën tuaj.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

T'I MËSOJMË NJERËZIT TË MENDOJNË ME PJEKURI

*Nga diskutimi në mbledhjen e organizatës-bazë
të Partisë ku bën pjesë*

9 maj 1968

Dhënia e rekomandimeve për pranime në Parti është me rëndësi për organizatën-bazë dhe për të gjithë Partinë. Për sa i përket lëshimit të rekomandimit prej sekretarit të organizatës-bazë, kjo duhet parë, sidomos në organizatat e vogla, ku ka dhe lidhje farefisnie dhe mund të ndodhë që sekretari apo ndonjë komunist tjetër të lëshojë rekomandime për njerëzit e afërm të tij, kështu që, në të njëjtën organizatë-bazë partie, futen njerëz të një fisi.

Ju, punonjësit e aparatit të Komitetit Qendror të Partisë, herë pas here duhet t'u rekomandoni sekretarëve të komiteteve të Partisë të rretheve që, në disa ndërmarrje, ku mendohet se janë mundësitë, të shtrojnë e të diskutojnë disa probleme partie, jashtë rendit të ditës, të bëjnë bisedime të lira me komunistë dhe me punëtorë të paorganizuar në Parti për nevojën e shtimit të radhëve të Partisë nga klasa punëtore, jo vetëm për vetë ndërmarrjen, por edhe për t'i dërguar në

vende dhe në sektorë të tjerë ku ka më shumë nevojë. Në këto qendra pune ka elementë mjaft të mirë për në Parti, por shokët, duke u nisur nga interesi i ngushtë i ndërmarrjes së tyre, tremben se, po t'i pranohet këta punëtorë në Parti, ua marrin dhe kështu, sipas tyre, u dobësohet ndërmarrja.

Duke vepruar siç thashë më lart do t'u hapen horizontet e perspektiva shokëve të bazës dhe do të bëhen pranime në Parti edhe në ato organizata-bazë të qendrave të punës, ku efektiviteti i anëtarëve të Partisë është i madh, por që Partia ka nevojë t'i dërgojë në vende të tjera.

Kur shokët e aparatit të Komitetit Qendror bëjnë takime me shokët e udhëheqjes së Partisë, problemet që marrin prej tyre duhet t'i shtrojnë me një pjesë të sekretarëve të komiteteve të Partisë të rretheve, të bëjnë konsultime me ta për problemin e dhënë, të evidentojnë propozimet, që dalin nga baza për këto probleme dhe t'ia japin udhëheqjes. Po të bëhet një gjë e tillë, do të dalë se në ndërmarrjet e ndryshme ka elementë të mirë për t'u pranuar në Parti. Kështu, duke ua vënë në dukje dhe duke i orientuar, ata patjetër do ta kuptojnë më drejt problemin e përgatitjes së elementit të ri që plotëson kushtet për t'u pranuar në Parti, do të marrin masa ata vetë për të hapur edhe kurse të veçanta me tema ideologjike, organizative e të tjera, për t'i edukuar dhe për t'i përgatitur këta punëtorë sipas destinacionit ku do të dërgohen për të punuar në sektorët e ndryshëm të jetës së vendit ose në fshat. Kështu do të veprojmë në mënyrë dinamike e jo me metoda shabllone.

Gjithashtu, t'u jepet porosi rretheve që të sqarojnë se nga anëtarët e Partisë, me gjendje punëtorë, sa prej tyre kanë stazhin e nevojshëm si punëtor. Për pranimet në Parti nga radhët e punëtorëve duhet të insistojmë, në radhë të parë, tek ato rrethe që janë të mëdha e që kanë një klasë punëtorë të madhe. Pra, çështjet organizative, çështjet e kuadrit, çështjet e pranimeve në Parti, çështjet e edukimit t'i gjallërojmë akoma më shumë, duke krijuar situata të reja luftarake.

Edhe në përbërjen e komisioneve të kontrollit dhe të revizionimit në rrethe duhet të zgjidhen elementë me përbërje punëtorë, sepse këta kërkojnë më shumë llogari për punën. Kjo ka rëndësi, sepse, po të futet në rrugë të drejtë ky problem, në konferencat dhe në kongreset e Partisë do të ketë më shumë kritikë direkt e me emër ndaj sekretarëve të komiteteve të Partisë.

Kur një shok kritikoi në një mbledhje të Sekretariatit të Komitetit Qendror të Partisë me emër disa shokë të rretheve për gabimet që ata kishin bërë, kritika që e drejtë dhe u bëri shumë efekt. Kjo do të bëjë që ata të kenë më shumë kujdes në punën e tyre në të ardhmen.

T'i mësojmë njerëzit të mendojnë me pjekuri dhe të thonë fjalën e tyre hapur, para cilitdo qoftë. Për shembull, në Ndërmarrjen Bujqësore të Gosës, në rrethin e Durrësit, kur u punua materiali për kontrollin punëtor, në fillim të mbledhjes pati pak pjesëmarrës e diskutime, por, kur plasi mirë kritika, mbledhja u bë më e gjallë dhe vazhdoi tri ditë, duke marrë pjesë të gjithë punëtorët. Nga diskutimet dhe nga kritikrat e punëtorëve, doli se për dëmtimet që kishin bërë disa

punëtorë ishin marrë masa ndëshkimore, kurse për dëmtime të bëra nga punonjës të administratës nuk ishte mbajtur qëndrim. Pra, drejtuesit dhe punonjësit e tjerë të administratës të kësaj qendre pune gabimet e tyre i mbulojnë, kurse për gabime që bëjnë punëtorët tregohen të ashpër dhe marrin masa ndëshkimore. Ky rast, edhe pse është i rrallë, nuk është i drejtë, është i dënueshëm. Ndaj gjithë dëmtuesve të pronës socialiste duhet mbajtur qëndrim i rreptë e i prerë. Këto gjëra dolën në këtë mbledhje kur punëtorëve iu dha mundësia të kritikonin hapur dhe pa druajtje gabimet dhe të metat e punonjësve të administratës.

Kështu ndodhi edhe në Ndërmarrjen e Peshkimit të Durrësit, ku, para ca kohësh, shokë të administratës morën vendim, pa të drejtë, për pushim nga puna të disa punëtorëve. Për ta rishqyrtuar këtë çështje u desh të bëhej një mbledhje tjetër që nxori të vërtetën she-shit. Pra, të jemi vigjilentë ndaj veprimeve të padrejta, që u bëhen punëtorëve nga ndonjë administrator apo edhe nga ndonjë sekretar i organizatës-bazë i pakalitur si duhet.

Në Parti gjërat duhet t'i thuhën secilit shok ashtu siç janë. Çështja është që njerëzit të thonë me pjekuri fjalën e tyre. T'ia thuash kujtdo të vërtetën me gjuhën e Partisë kjo do të thotë që ta ndihmosh atë të ecë përpara.

*Botohet për herë të parë sipas
shënimeve të nxjerra nga pro-
tokolli i mbledhjes së organi-
zatës-bazë të Partisë që
gjendet në AQP*

JU FALËNDEROJ, SHOKË PUNËTORE, PËR KËTE VEPËR KAQ TË ÇMUAR

*Nga biseda me një grup punëtorësh
të shtypshkronjës «Mihal Duri»¹*

9 maj 1968

Jam shumë i gëzuar, shokë, që më sollët si dhuratë këtë vepër: kaq të çmuar, të cilën e pashë që e mbanit në duar kur parakaluat para tribunës, gjatë manifestimit popullor të 1 Majit. Ju e shtypët atë në prag të 150-vjetorit të lindjes së Marksit, themeluesit të komunizmit shkencor, mësuesit dhe udhëheqësit të proletariatit ndërkombëtar. Dhe libri është lidhur shumë bukur. Kështu si ky, besoj, kanë për të dalë edhe librat e tjerë të «Kapitalit». Në emër të Partisë, të Komitetit Qendror dhe timin ju falënderoj me gjithë zemër, ju tipografë, që arritët të botonit në gjuhën shqipe këtë libër kaq me vlerë e të domosdoshëm, siç

¹ Këta punëtorë i dorëzuan shokut Enver Hoxha kopjen e parë të «Kapitalit» të shtypur nga kolektivi i shtypshkronjës «Mihal Duri». Botimi i këtij libri, për herë të parë në gjuhën shqipe, u bë me vendim të posaçëm të Komitetit Qendror të Partisë.

është «Kapitali», kryevepra e mësuesit tonë të madh, Karl Marksit, e cila ka rëndësi të jashtëzakonshme si për çdo vend, ashtu edhe për lëvizjen komuniste në Shqipëri. Botimi i «Kapitalit» në gjuhën shqipe është ngjarje e rëndësishme për jetën shkencore e kulturore në vendin tonë.

Siç po shikoj, ju keni punuar me mjeshtëri, keni treguar zotësi të madhe. Vepra që më dhuroni, mund të ketë ndonjë të metë teknike, por dëshiroj të përsërit mendimin se ju keni bërë një punë të paqme, shumë të mirë. Kam shumë libra në shtëpi dhe e di me ç'mjete moderne botohen ata në vendet e tjera, megjithatë ky botim qëndron shumë më lart se shumica e botimeve që kam unë në raftet e bibliotekës sime.

Unë i ndjek me dashuri të madhe librat. Herë pas here më bien në dorë shumë libra me përmbajtje marksiste dhe jomarksiste e, përveç përmbajtjes së tyre, vërej në ta edhe punën që bëjnë tipografët e vendeve të tjera. Duke krahasuar cilësinë e punës së tyre me botimin e «Kapitalit» në shqip, mund të them se kjo nuk qëndron pas prej shumë botimeve të shtëpive botuese të vendeve të tjera, që jo vetëm kanë një eksperiencë të gjatë në këto çështje, por kanë edhe mjete teknike shumë më tepër nga ne. Kurse po të krahasojmë botimin e «Kapitalit» në shqip me botimet e bëra në vendet ku janë në fuqi revizionistët, si në Bashkimin Sovjetik e gjetkë (të cilët i kanë botuar veprat e Marksit më përpara se ne, por idetë e tij, idetë e Leninit dhe të Stalinit i kanë tradhtuar), mund të them se nuk janë lidhur më bukur se ky vëllim, edhe pse ata kanë mjete teknike më shumë e më të

perfeksionuara. Këtë botim tuajin mund ta barazojmë me botimin e tyre të fundit të veprave komplete të Marksit dhe të Engelsit, që i kanë nxjerrë me kapak bojë kafe të thellë, kurse gjithë botimet e tjera të tyre nuk janë në këtë nivel. Ja përse ne mund të mburremi me punën tuaj.

Për sa i përket cilësisë së botimeve të veprave të Marksit, në vendet kapitaliste, nga partitë e vjetra, të quajtura komuniste, (të cilat tani, gjithashtu, janë bërë revizioniste) ato qëndrojnë larg botimit tonë, megjithëse këto parti nuk kanë qenë në ilegalitet dhe pa mjete financiare. Ato marrin fonde të mëdha më parë nga Kominterni dhe më pas nga Byroja Informativë, domethënë, nga partitë komuniste që ishin në fuqi. Këto parti, me mjetet që grumbulluan, mundën të krijonin deri edhe shtëpi botuese të vetat, që tani janë kthyer në truste kapitaliste. Megjithatë, botimet e tyre nuk mund të krahasohen kurrë me botimin tonë të «Kapitalit» të Marksit.

Këto shtatë-tetë vjetët e fundit Partia Komuniste Franceze mori mundimin të përkthente¹ dhe «të korrigjonte» «Kapitalin» e Karl Marksit, nën pretekstin se do të korrigjonte përkthimin e sindikalistëve dhe të

1 Përkthimi i parë i vitit 1875 i «Kapitalit» në frëngjisht është bërë nga Zhozef Rua dhe është rishikuar i tëri nga Marksi. Për këtë botim frëngjisht, midis të tjerash, Marksi ka shkruar:

«... ai ka një vlerë shkencore të pavarur nga origjinali, prandaj atë duhet ta përdorin edhe lexuesit që njohin gjermanishten». Shih: K. Marks. «Kapitali», vëll. I, libri I, bot. i dytë, f. 38. Tiranë, 1976.

Molitorit, një ish-inspektor akademie i partisë socialiste. Nën drejtimin e Moris Torezit, gjashtë a shtatë veta të grupit komunist përgatitën dhe nxorën një përkthim të ri të kësaj vepre të Marksit, që, po ta krahasojmë me këtë që më dhatë ju, për sa i përket cilësisë së shtypit, e them me bindje se ne jemi shumë më përpara dhe merita për këtë punë të mirë ju takon juve, prandaj ju falënderoj.

Detyrën e madhe që ju ngarkoi Partia, ju dhe të gjithë tipografët e kolektivit tuaj e kryet me sukses, e shtypët dhe e lidhët teknikisht bukur këtë vepër gjerniale. Partia tani duhet të punojë që përmbajtja e saj të zbërthehet me kujdes dhe të studiohet me vëmendje prej komunistëve e masave tona punonjëse, sepse në këtë vepër është baza e teorisë nga e cila udhëhiqemi ne. Të gjithë duhet të përpiqemi ta studiojmë me vëmendje «Kapitalin», i cili është pak i rëndë për t'u kuptuar, por Engelsi jep edhe udhëzime se si duhet ta studiojë çdonjëri dhe rekomandon se, po të zbatohen këto udhëzime, nuk do të jetë vështirë për të kuptuar këtë vepër.

Për komunistët, për klasën punëtore dhe për proletariatin mbarë, «Kapitali» dhe të gjitha veprat e Marksit janë sintezë e eksperiencës së madhe historike të proletariatit botëror.

Në vendin tonë udhëheq Partia marksiste-leniniste, e ndriçuar dhe e orientuar në punën e saj nga teoria filozofike e Marksit, e Engelsit, e Leninit dhe e Stalinit; klasa punëtore është në fuqi, të gjitha ngjarjet dhe veprimet në vend, të udhëhequra nga pararoja e klasës, Partia, zhvillohen në interes të vënies në jetë

të ideologjisë së klasës, prandaj dhe nuk është shumë vështirë të kuptohet «Kapitali» i Karl Marksit.

Tani, natyrisht, Partia duhet të marrë disa masa për ta organizuar këtë studim, pse është më lehtë të kuptosh një artikull gazete ose një fjalim siç është «Kontrolli i klasës punëtore», që u botua në broshurë para pak kohësh, sesa këtë vepër të Marksit, ku përmbledhet tërë filozofia që na ndriçon rrugën, thesari më i madh i marksizëm-leninizmit.

«Kapitali» është një vepër e madhe, në të cilën çdo fjalë është e peshuar, e matur. Në studimin e kësaj vepre, përveç ndihmës së Partisë për organizimin e punës, duhen edhe përpjekje e vullnet nga secili. Për këtë çështje të bëjmë kujdes të veçantë dhe t'i vëmë detyrë vetes, se me vullnet çdo gjë mësohet.

Kur isha akoma i ri, shumë kohë përpara, unë, që kisha ca shkollë, e lexoja në frëngjisht «Kapitalin», por, duke mos ditur si ta studioja, nuk e kuptoja si duhet këtë vepër, që trajtonte në prizëm filozofik problemet e ekonomisë politike. Kjo vinte edhe për faktin se atëherë ne, studentët, në ato shkolla ku studionim, i mësonim gjërat vetëm në teori, pa pasur shpjegim për realizimin praktik të tyre. Mirëpo më vonë, kur filloi Lufta Nacionalçlirimtare, kur filluan të na binin detyra të mëdha mbi supe dhe kur, pas Çlirimit, të udhëhequr nga Partia, filluam të ndërtojmë ekonominë, të punojmë për konsolidimin e pushtetit tonë popullor e për shumë probleme të tjera, veprat e Marksit filluan të na bëheshin më të qarta, termat e ekonomisë politike marksiste, siç janë: renta, mbivlera e të tjera, i kuptonim më mirë. Ju, punëtorët, qoftë në

uzina ose në fabrika, jeni të lidhur ngushtë me prodhimin, me normat, me rendimentet, me kursimet, me zhvillimin e industrisë e me të tjera probleme të ekonomisë socialiste, prandaj e kuptoni dhe duhet ta kuptoni akoma më mirë këtë vepër të madhe.

Më përpara, në vendin tonë mund t'i lexonin veprat e Marksit vetëm ata që dinin gjuhë të huaja, kurse tani të gjithë ata që dëshirojnë mund ta marrin dhe duhet ta marrin ta lexojnë në shqip. Është mirë, bile, të bëjnë edhe plan e ta studiojnë dhe Partia ka për t'i ndihmuar në këtë drejtim.

Veçanërisht, ka rëndësi të madhe që vepra e Marksit, doktrina e tij, të kuptohet thellë, sepse ajo është udhëheqje për veprim dhe, si e tillë, duhet studiuar e jo të mësohen disa citate përmendsh. Kjo është e gabuar. Këtë gjë e ndalonte edhe vetë Marksi, prandaj duhen bërë përpjekje që «Kapitali» të asimilohet si ushqimi që përtypet, kalon në stomak, tretet dhe, pasi bëhet metabolizmi, domethënë transformimi kimik i tij, kthehet në gjak dhe shpërndahet pastaj për të ushqyer gjithë pjesët e trupit. Studimi i marksizëm-leninizmit dhe në mënyrë të veçantë i veprave të Marksit, duhet të jetë i thellë e këmbëngulës, me qëllim që të kuptohen qartë dhe të përvetësohen kapitull pas kapitulli, se në këto vepra mbështeten vendime e direktiva të Partisë sonë.

«Kapitali» është vepra kryesore e Marksit, i cili ka shkruar edhe vepra të tjera të mëdha. Partia e ka detyrë të kujdeset për përkthimin dhe botimin e veprave të tjera të tij, ashtu siç po përkthehet edhe «Kapitali». Këtë Partia jonë e ka bërë dhe do ta bëjë gra-

dualisht edhe në të ardhmen. Ne kemi bërë gjer tani përkthime të veçanta të shumë veprave të Marksit, që ju i dini, sepse i keni shtypur dhe i keni kaluar nëpër duar gjatë këtij procesi. Marksit ka shkruar për shumë probleme, ka qenë njeri i madh, krijues prandaj, tani që kemi më shumë mundësi, do t'i botojmë veprat e tij, duke u kujdesur edhe për lidhjen e tyre sa më të mirë e estetike, si kjo e «Kapitalit». Kësaj detyre t'i vihemi me të gjitha forcat tona dhe ta kryejmë sa më shpejt, se këto vepra janë për ne të nevojshme si ushqimi i përditshëm.

Lufta, revolucioni ynë që ecën përpara, do të na krijojnë në të ardhmen mundësi të tjera më të mëdha. Mendimet e Marksit, të Engelsit, të Leninit dhe të Stalinit, të shprehura në teorinë e pavdekshme marksiste-leniniste, dita-ditës po triumfojnë në botë, kurse revizionizmi, kjo rrymë dekadente e borgjezisë kapitaliste, e ngritur si reaksion kundër marksizmit fill pas lindjes së tij, do të mundet, do të dështojë.

Të shumtë kanë qenë e janë filozofët e shkrimtarët e borgjezisë botërore, që janë ngritur si divizione e si armata të njëpasnjëshme për të luftuar mendimet gjeniale të Karl Marksit, por, gjatë këtyre 150 vjetëve, që të gjithë këta kalemxhinj janë përmbysur, kurse idetë e Marksit, teoria marksiste dhe vazhdimi i saj, teoria leniniste, qëndrojnë të patundura si kolos dhe u bëjnë ballë me sukses të gjitha rrymave filozofike reaksionare, borgjeze, duke i mposhtur çdo herë e më shumë me vërtetësinë dhe me gjenialitetin e tyre. Edhe revizionistët modernë, ashtu si paraardhësit e tyre të vjetër, do të bien në hendekun e ndyrë ku janë zhy-

tur të gjithë tradhtarët. Kur shfleton botimet e vjetra të «Kapitalit», gjen në to parathënie të shkruara edhe nga Kautski e Bernshtajni, më vonë mund të gjejmë edhe nga revizionistë të tjerë, por vlerësimet që i janë bërë veprës gjeniale të Marksit e që do të mbeten të pashlyeshme e të pavdekshme, janë ato që janë bërë nga vazhduesit e tij, gjithnjë besnikë, nga Engelsi, nga Lenini dhe nga Stalini.

Juve, tipografëve të Tiranës, dëshiroj t'ju përgëzoj qysh tani për punën shumë të lavdërueshme që keni bërë dhe t'ju uroj suksese të reja për të ardhmen. Punëtorët tipografë janë nga njerëzit pararojë të klasës punëtore, dhe, si të tillë, karakterizohen nga disiplina, nga partishmëria dhe nga fryma luftarake. Tipografët ecin përpara me guximin që i karakterizon dhe kurrë nuk tremben nga vështirësitë. Të tillë jeni ju dhe kështu ju do dhe ju mëson Partia: Të jeni kurdoherë më këmbë, të kuptoni mirë edhe detyrat e mëdha që keni para popullit, edhe detyrat internacionaliste. Klasës punëtore i duhet të udhëheqë me guxim e me sukses në beteja fitimtare aleatët e saj, fshatarësinë, inteligjencien, t'i udhëzojë ata dhe të mos lejojë t'u hipin në zverk, siç ndodhi në vendet revizioniste. Fshatarësia dhe inteligjencia ecin përpara, me klasën punëtore në ballë, të udhëhequr nga Partia e saj, në rrugën e socializmit. Në vendet ku proletariati merr fuqinë dhe vendos diktaturën e tij, duhet të jetë gjithnjë vigjilent, të luftojë që ta ruajë këtë diktaturë, të ruajë pushtetin e klasës punëtore; kështu na mëson marksizëm-leninizmi, ndryshe, kush humb vigjilencën, ditët i ka të numëruara. Pushteti ynë popullor është

pushtet i diktaturës së proletariatit, pushtet i klasës punëtore në fuqi dhe faktori kryesor për ruajtjen e tij nga armiqtë, nga burokratizmi dhe nga të gjithë ata që e dëmtojnë, janë Partia dhe klasa punëtore.

Por, duke punuar si punëtorë në shtypshkronjë, ju kurrë nuk duhet të mendoni se aparati administrativ nuk është i nevojshëm, përkundrazi, ai bashkëvepron me ju dhe ju shërben, pra, i duhet diktaturës. Aparatet janë si rrotat e makinës, pa të cilat kjo nuk ecën dot. Kështu, pra, edhe aparatet administrative janë të nevojshme, por duhet të kemi kujdes që ato të jenë sa më të thjeshta, sa më operative, sepse, nganjëherë, këto aparate zënë ndryshk dhe Partia me klasën punëtore duhet t'i pastrojnë prej tij. Aparatet administrative e shtetërore nuk duhen konfunduar me personat që punojnë në to. Kështu, për shembull, funksioni i drejtorit është i nevojshëm dhe në rast se kemi një drejtor që nuk punon mirë, fjala këtu është për një person të caktuar, të cilin duhet ta heqim e ta zëvendësojmë me një tjetër dhe ky të punojë me ndërgjegje në këtë funksion. Ky dallim, midis drejtuesit që punon keq dhe funksionit të tij, duhet të bëhet mirë dhe të jetë i qartë. Në qoftë se gabimet e shefit nuk janë dhe aq të mëdha, mund të mos e heqim atë, por më parë «t'ia lajmë» mirë kokën me sapun përpara kolektivit, pra, ta kritikojmë dhe në qoftë se shohim që koka «nuk i kruhet më», atëherë e lëmë të vazhdojë punën, ndryshe, po të vazhdojë me të vjetrën, e heqim.

Por mund të ndodhë edhe rasti tjetër, mund të ketë midis punëtorëve, të cilët në përgjithësi janë të

disiplinuar, ndonjë që thyen disiplinën, nuk shfrytëzon mirë kohën e punës, ose ka të meta të tjera. Në këtë rast, drejtori ose shefi duhet ta kritikojë punëtorin për këto qëndrime dhe ka plotësisht të drejtë ta bëjë këtë, t'i heqë veshin atij punëtori, që nuk është i disiplinuar e i mobilizuar për realizimin e detyrave të ndërmarrjes dhe, në këto raste, drejtori duhet të gjejë mbështetjen e punëtorëve. Kritika ka për qëllim t'i edukojë njerëzit që secili të jetë në sulm, të jetë njeri i sakrificës, prandaj, kur kritikohet me vend, askush të mos ketë frikë, po të reflektojë drejt e të bëjë autokritikë. Jo vetëm drejtuesit, por çdo punëtor, kur shikon se shoku i tij nuk është në rregull me punën, duhet t'i flasë, ta qortojë dhe të punojë shumë për ta bindur që edhe ky shok të mos mbetet pas të tjerëve. Kështu na mëson Marksi, të cilin klasa punëtore e ka mësuesin më të madh.

Ju punoni në shtypshkronjën e botimit të librit politik, i cili ka perspektivë të madhe në vendin tonë. Mua më duket që kapaciteti i saj nuk është akoma në atë shkallë sa të jetë në gjendje të përballojë të gjitha nevojat dhe kërkesat tona në rritje, prandaj, në të ardhmen, ne do t'i shtojmë makineritë.

Më thatë se nuk jeni të kënaqur sa duhet për cilësinë e punës në shtypjen e veprës së Marksit, që unë jua lëvdova. Të mos jesh i kënaqur me atë që ke realizuar, nuk është gjë e keqe, sepse kjo të nxit të punosh më mirë. Partia kurdoherë na mëson të mos kënaqemi kurrë me atë që kemi realizuar, por të luftojmë për të rritur cilësinë, të punojmë me kurajë dhe me besim se do ta arrijmë këtë.

Shumë drejt mendoni ju, shokë, kur thoni se do të luftoni akoma për ta rritur cilësinë. Jashtë ka edhe botime luksi, shumica e të cilave nuk kanë asnjë vlerë për njerëzimin, megjithatë kostojnë nga 80 e 90 dollarë copa, se janë të shtypura bukur, kanë letër shumë të mirë dhe janë lidhur bukur. Por, të tillë libra i blejnë vetëm borgjezët, ata nuk janë për masën, e cila, në fund të fundit, edhe po t'i blejë s'ka asnjë përfitim prej tyre. Por neve të tillë libra, që s'i shërbejnë popullit, s'kanë ç'na duhen.

Nevojat tona për shtypshkronja janë shumë të mëdha, se ne nuk i kemi krijuar akoma të gjitha mundësitë që të sigurojmë çdo botim në sasi dhe në cilësi të mjaftueshme. Ne nuk e kemi akoma sasinë e duhur të letrës, bile, për nevojat e mëdha që kemi, sikur edhe tri fabrika të tjera letre të kishim, prodhimet e tyre nuk do të na mjaftonin, prandaj po studiojmë mundësitë që të ndërtojmë fabrika të tjera, jo vetëm për prodhimin në sasi më të madhe të letrës, por edhe për rritjen e cilësisë së saj, që letra të mos dalë shtupellë dhe gazetatat të mos kenë letër të keqe.

Sidoqoftë, nevojat ne do t'i plotësojmë gradualisht, njërën pas tjetrës. Çdo gjë te ne shkon mirë. Industria po bën përparime të mëdha. Shpresojmë që edhe bujqësia sivjet të jetë e mbarë, me prodhime të bollshme, sidomos po të na bjerë edhe pak shi, sepse një shi tani, siç thotë populli, nuk ka të çmuar.

Edhe një herë ju falënderoj për dhuratën që më sollët dhe uroni e falënderoni, në emër të Partisë, të Komitetit Qendror dhe timin, të gjithë kolektivin tuaj për arritjet dhe cilësinë e mirë gjatë punës suaj për ta

shtypur dhe për ta lidhur këtë libër, duke u dhënë mundësi Partisë dhe popullit të marrin në duar, në shqip, kryeveprën e Karl Marksit. Ju uroj suksese të vazhdueshme në punë dhe sidomos në përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë për vëllimet e ardhshme të «Kapitalit».

*Botohet për herë të parë si-
pas shënimeve të mbajtura në
këtë takim që gjenden
në AQP*

LE TË SHPËRTHEJË E FUQISHME STUHIA E REVOLUCIONIT

Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»

17 maj 1968

Ndryshimet e mëdha, që kanë ndodhur e po ndodhin në botë, si rezultat i luftës së popujve, kanë krijuar dhe krijojnë vazhdimisht një situatë të favorshme për forcat revolucionare, që luftojnë për çlirimin shoqëror e kombëtar, për ndërtimin e një bote të re pa kapitalistë e kolonialistë. Problemi themelor, që qëndron tani përpara komunistëve dhe revolucionarëve të vërtetë, si në vendet kapitaliste, ashtu edhe atje ku sundojnë revizionistët, është të veprojnë me guxim dhe me konsekuencë në rrugë revolucionare, në luftën kundër imperializmit dhe veglave të tij — revizionistëve modernë.

Borgjezia kapitaliste botërore ka mobilizuar të gjitha forcat dhe lufton, pikërisht që revolucioni të shuhet atje ku ka filluar, të mos ndizet atje ku po përgatitet dhe të zhduket atje ku ka fituar. Në pararojë të luftës së saj të egër ideologjike e politike borgjezia ka vendosur revizionistët modernë, tradhtarët

më të ulët e më të djallëzuar të marksizëm-leninizmit. Në këto kushte, revizionizmi modern përbën një rrezik të madh aktual për revolucionin dhe për socializmin.

Përse marksistë-leninistët insistojnë në këtë çështje, përse ata e kanë cilësuar dhe e cilësojnë revizionizmin modern si një rrezik të madh për revolucionin e socializmin, përse ata u bëjnë thirrje gjithë revolucionarëve të bashkojnë radhët dhe të luftojnë me guxim dhe pa kompromis deri në shkatërrimin e plotë ideologjik e politik të revizionizmit?

Përgjigjja është e qartë. Revizionizmi modern përbën një rrezik të tillë, pasi në krye të tij qëndrojnë revizionistët sovjetikë, të cilët kanë uzurpuar frenat e Partisë Komuniste dhe të shtetit sovjetik, të vendit ku u krye Revolucioni i Tetorit dhe ku për herë të parë fitoi socializmi. Ai përbën një rrezik të tillë, pasi, në vendet e ish-demokracisë popullore të Evropës, revizionizmi ka rrëmbyer pushtetin, pasi në shumë parti komuniste e punëtore të botës, ku kuadrot kryesorë janë borgjezuar, klikat revizioniste kanë shtënë në dorë udhëheqjen dhe aparatet e partisë, shfrytëzojnë për qëllimet e veta traditat e organizimit të punonjësve, mbajnë nën drejtimin e tyre sindikatat e punëtorëve dhe aparatet e kuadrot e tyre të borgjezuar. Revizionistët disponojnë fonde e materiale kolosale për të financuar diversionin politik, ideologjik dhe organizativ në gjithë botën, disponojnë mjete të mëdha propagandistike për të shtrembëruar teorinë marksiste-leniniste, për ta revizionuar atë dhe për ta paraqitur këtë deformim si «zhvillim aktual e realist në kushtet e epokës sonë», me një fjalë, për t'ua përshtatur në

mënyrë të kamufluar marksizëm-leninizmin e revizionuar interesave të borgjezisë, së cilës ata i shërbejnë me zell.

Në këto kushte, revizionistët përpiqen ta identifikojnë veten e tyre me komunizmin. Sipas propagandës që ata bëjnë, revizionizmin e tyre modern e paragasin si «komunizmin ndërkombëtar». Për revizionistët, «aleanca e proletariatit ndërkombëtar» nuk është veçse aleanca e klikave revizioniste dhe «internacionalizmi proletar» është për ta, në fakt, internacionalizmi trocist, revizionist.

E keqja është se përpjekjet për identifikimin e revizionizmit modern me komunizmin ndërkombëtar, vënie e shenjës së barazimit midis tyre, nuk i bëjnë vetëm krerët e revizionizmit modern. Pikëpamjet e shtrembra, të përhapura nga ata, zënë vend edhe te shumë komunistë sovjetikë, bile edhe në një pjesë të klasës punëtore sovjetike. Dhe pikërisht qenia e partisë revizioniste sovjetike në krye të rrymës së fortë antimarksiste të revizionizmit të tanishëm influencon shumë që të ruhen këto pikëpamje e, çka është më keq, të konfondoher shapi me sheqerin dhe të pengohet revolucioni.

Gjithashtu, akoma nuk është kuptuar si duhet nga të gjithë komunistët e vendeve të ndryshme dhe nga proletariati botëror se në Bashkimin Sovjetik ekziston sot një parti e quajtur komuniste, që nuk ka asgjë të përbashkët me Partinë Komuniste (bolshevike) të Lenin-Stalinit. Partia e sotme në Bashkimin Sovjetik është një parti revizioniste, kundërrevolucionare, anti-komuniste. «Komuniste» ajo ka vetëm emrin, hiqet si

leniniste, por e ka deformuar fund e krye e në çdo gjë Leninin. Ajo hiqet sikur ndërton komunizmin, por, në praktikë, po restauron kapitalizmin dhe ndihmon edhe partitë e tjera revizioniste të ecin në rrugën e saj. Në qoftë se Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik ishte përpara e bolshevikëve, tani partia revizioniste e Bashkimit Sovjetik është e menshevikëve, e trockistëve dhe e buharinistëve të rinj.

Por, me gjithë faktin se jo të gjithë komunistët dhe klasa punëtore e Bashkimit Sovjetik e shohin se partia e tyre e vjetër heroike ka ndryshuar dhe ka degjeneruar, bolshevizmi nuk mund të humbasë dhe bolshevikëve nuk mund t'u zbutet zemra e nuk mund të rrinë më duarlidhur përpara tragjedisë që jetojnë. Tek ata po duken shenjat e një ringjalljeje revolucionare dhe ato janë inkurajuese.

Bandat e zeza hrushoviane përpiqen të shtrëngojnë radhët e tyre kundër bolshevikëve dhe klasës punëtore

Krerët hrushovianë, që proklamojnë si papët *urbi et orbi* se po «ndërtojnë komunizmin» në Bashkimin Sovjetik, se, meqë u zhdukën klasat antagoniste, u dashka shuar edhe lufta e klasave, kërkojnë tani nga partia «të vendosë disiplinën e hekurt». Kujt i nevojitet dhe kundër kujt duhet kjo «disiplinë e hekurt» për të cilën insistoi kryerevizionisti Leonid Brezhnjev në konferencën e partisë të qytetit të Moskës, në javën

e fundit të marsit e që tani trumbetohet me forcë të madhe nga i gjithë shtypi revizionist sovjetik?

«Disiplina e hekurit» që kërkojnë udhëheqësit sovjetikë, është disiplinë e bandave të zeza, e eserëve të rinj revizionistë, që, në shikimin e parë, duket se drejtohet kundër elementëve ultra të djathtë, të cilët, të lindur në atmosferën e krijuar nga vetë kursi hrushovian, tani, nga ngjarjet në Çekoslovakia e në Polonia, kanë filluar të aktivizohen edhe më tepër. Grupi i Brezhnjev-Kosiginit trembet se mos pëson fatin e Hrushovit apo të Novotnit, se mos një ditë këta «liberalë», po t'u jepet shumë liri, mund të përmbysin edhe vetë klikën në fuqi. Duke i sulmuar revizionistët ekstremistë, Brezhnjevi dhe shokët e tij kërkojnë që, nga njëra anë, t'i mbajnë këta në fre, ta kontrollojnë vetë procesin e degjenerimit borgjez dhe, nga ana tjetër, t'i shfrytëzojnë urrejtjen e përbuzjen e masave punonjëse për këta elementë dhe t'i bëjnë me vete e të mbështeten në to në çdo situatë që do të rrezikonte pozitën e tyre sunduese.

Njëkohësisht, udhëheqësit revizionistë sovjetikë, duke kritikuar ultra të djathtët, mundohen të krijojnë iluzionin se ata luftojnë jo vetëm kundër «dogmatikëve», por edhe kundër «revizionistëve», se ata, gjoja, ndjekin rrugën «leniniste» të luftës në dy fronte. Në të vërtetë kjo taktikë synon t'i konsolidojë pozitat e klikës në fuqi dhe të intensifikojë në qetësi dhe me sa më pak telashe luftën kundër marksizëm-leninizmit, revolucionit e socializmit. Kjo është një taktikë e rrezikshme, e cila duhet demaskuar dhe duhet shpartalluar. Asnjë iluzion nuk duhet të ketë se klikën e de-

gjeneruar të Brezhnjevi-Kosiginit, të zhytur kokë e këmbë në tradhti, ngjarjet e Çekosllovakisë, të Polonisë dhe aktivizimi i «liberalëve» brenda Bashkimit Sovjetik mund ta sjellin në vete. Lufta kundër «ultrave» është një luftë për pushtet midis klikave revizioniste. Këto klika asgjë s'mund t'i korrigojë. Vetëm revolucioni për përmbysjen e atyre që janë në fuqi, ose që luftojnë për të marrë fuqinë, do t'i vërë partinë dhe shtetin sovjetik në rrugën e drejtë që hapi Revolucioni i Torit.

Pikërisht, këtij revolucioni klika e Brezhnjevi-Kosiginit i trembet më shumë se çdo gjëje tjetër. Ajo ka frikë jo aq nga «liberalët» sesa nga masat popullore. Ajo e di fort mirë se një aktivizim i hapur i forcave ultrarevizioniste në Bashkimin Sovjetik, me tradita të mëdha revolucionare, nuk mund të shkojë aq lehtë si në Çekosllovakia. Një proces i tillë në Bashkimin Sovjetik nuk mund të mos shkaktojnë rezistencën dhe revoltimin e revolucionarëve bolshevikë, të klasës punëtore etj., që do të fshinte, së bashku me «ultrat», edhe vetë klikën sunduese hrushoviane. Prandaj «disiplina» që kërkon Brezhnjevi drejtohet, në radhë të parë e mbi të gjitha, kundër bolshevikëve, kundër popullit, kundër gjithë atyre që guxojnë ose do të guxojnë të ngrihen kundër tradhtisë revizioniste.

Zhvillimi i ngjarjeve të kohëve të fundit në Çekosllovakia e në Poloni u ka shkaktuar revizionistëve sovjetikë kokëçarje shumë serioze. Ato jo vetëm që po thellojnë përçarjen revizioniste, jo vetëm po shkaktojnë dezekuilibër në qëndrimet politike, shturje në marrëdhëniet reciproke ekonomike, por shkaktojnë mos-

bindje edhe ndaj vetë traktateve të tyre ushtarako-politike.

Për revizionistët sovjetikë këto ngjarje ndikojnë rëndë në vetë politikën dhe në strukturën e brendshme të regjimit të tyre. Në qoftë se deri tani klika Brezhnev-Kosigin mendonte se, pasi kishte hequr qafe Hrushovin, kishte krijuar njëfarë stabiliteti të brendshëm, ngjarjet e Çekosllovakisë, të Polonisë e të tjerat krijuan lëkundje të thella në gjirin e udhëheqjes së saj dhe treguan se «stabiliteti» i saj ishte i dobët. U vërtetua në këtë mënyrë edhe një herë tjetër, se në udhëheqjen revizioniste sovjetike nuk ka dhe nuk do të ketë kurrë stabilitet.

Në fjalimin e revizionistit Brezhnev, ky shqetësim i madh duket haptazi, prandaj ai i vuri theksin më të madh çështjes së «unitetit në parti», «unitetit leninist» në mes partisë e klasës punëtore, «unitetit të çeliktë» në mes popullit dhe «Komitetit Qendror leninist» e të tjera profka të tilla.

Për unitet të vërtetë mund të flitet vetëm në një parti marksiste-leniniste. Ky unitet arrihet duke ruajtur vijën e drejtë, parimet marksiste-leniniste të pashtrembëruara, normat leniniste të partisë të pabastarduara. Por, në partinë aktuale revizioniste të Bashkimit Sovjetik, nuk mund të flitet as për unitetin marksist-leninist dhe as për të gjitha ato parime që e formojnë, e ruajnë dhe e kalitin atë. Kjo ngjet pasi nuk ka dhe nuk mund të ketë unitet mendimi e veprimi ndërmjet klikave të ndryshme revizioniste, që sundojnë në partinë revizioniste të Bashkimit Sovjetik dhe në shtetin sovjetik.

Uniteti bolshevik, i formuluar dhe i zbatuar nga Lenini, nga Stalini dhe nga Partia Bolshevike e Lenin-Stalinit, është ai unitet që u duhet partive marksiste-leniniste dhe pikërisht këtë unitet luftojnë, shkatërrojnë dhe nuk mund ta kenë kurrë revizionistët modernë.

Uniteti bolshevik u arrit në luftëra të ashpra dhe të paprera të Leninit, të Stalinit dhe të Partisë Bolshevike jo vetëm kundër armiqve të jashtëm, imperialistëve dhe kapitalistëve, por edhe kundër carizmit dhe gjithë partive borgjeze kapitaliste të këtij regjimi, kundër partive pseudorevolucionare, gjatë dhe pas revolucionit, kundër eserëve, trockistëve, zinovievistëve, buharinistëve dhe të gjithë oportunistëve të tjerë, të djathtë e «të majtë», agjentë të borgjezisë e të reaksionit, brenda dhe jashtë partisë.

Uniteti bolshevik eliminoi fraksionet antileniniste në Partinë Bolshevike. Ai nuk lejoi dhe nuk mund të lejonte kurrë, as legalisht, as ilegalisht, fraksione në gjirin e partisë marksiste-leniniste. Në qoftë se ngjet e kundërta dhe nuk luftohet për shembjen e plotë të çdo lloj fraksioni, partia komuniste nuk mund të jetë dhe as mund të quhet kurrë parti leniniste, pasi në çështjen kryesore ajo ka mohuar atëherë ato parime dhe ato norma që e bëjnë atë detashmentin e organizuar marksist-leninist të proletariatit. Një parti e tillë e humbet, e zhduk qëllimin vendimtar të qenies së saj si një parti monolite e proletariatit, për vendosjen e diktaturës, për ndërtimin e socializmit dhe të komunizmit. Një parti e tillë shndërrohet në një arenë ku grupe të veçanta, me interesa të veçantë, me qëllime të veçanta, luftojnë për epërsi, për fuqi. Një

parti e tillë përpiket të ruajë vetëm maskat, pamjen e jashtme të një partie të vetme, me qëllim që të gënjëjë dhe asgjë tjetër.

Në një parti të tillë është degjeneruar sot edhe Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik. Në partinë aktuale revizioniste të Bashkimit Sovjetik nuk ekziston dhe nuk mund të ekzistojë unitet. Prandaj, shtrohet pyetja: Për cilin unitet bëjnë fjalë revizionistët sovjetikë, me Brezhnjevin në krye?

Ata bëjnë thirrje për një unitet të klikave të ndryshme në gjirin e partisë dhe në udhëheqjen e partisë revizioniste të Bashkimit Sovjetik përpara rreziqeve të mëdha që i kërcënojnë, si nga jashtë, ashtu edhe nga brenda.

Rreziku i brendshëm është i madh për ta. Ai vjen edhe nga përçarja brenda gjirit të tyre revizionist, por edhe nga traditat e mira revolucionare të Partisë Bolshevike të Lenin-Stalinit, tradita që revizionistët sovjetikë përpiqen t'i shtypin, t'i bastardojnë ose, me demagogji, t'i kanalizojnë për interesat e tyre.

Këto tradita janë krijuar nga Revolucioni i Madh i Tetorit dhe nga lufta e bolshevikëve, nga idetë e Leninit e të Stalinit, mbi bazën e të cilave u formua dhe u kalit një parti e madhe, u vendos diktatura e proletariatit, u ngrit shteti i parë socialist i punëtorëve e i fshatarëve, u ndërtua me sukses socializmi, u zgjidh drejt edhe çështja nacionale, aq e koklavitur në Bashkimin Sovjetik. Në procesin e luftës së klasave, të udhëhequr në mënyrë energjike nga Lenini dhe nga Stalini, u forcua diktatura e proletariatit, u ngrit dhe u kalit ndërgjegjja e punonjësve, u forcua aleanca e

klasës punëtore me fshatarësinë, u dërrmuan fraksionet brenda dhe jashtë partisë dhe u zhdukën mundësitë e vegjetimit, qoftë në heshtje, qoftë për formë, të bërthamave të partive të tjera, borgjeze, gjoja përparimtare. Që nga fitorja e revolucionit e deri tani, edhe në Bashkimin Sovjetik ka pasur dhe ka vetëm një parti politike.

Partia Bolshevike e Bashkimit Sovjetik hodhi traditën e një partie të vetme në fuqi dhe gjeneratat e reja të Bashkimit Sovjetik, pas revolucionit, nuk kanë njohur dhe nuk njohin veçse një parti, prandaj ato janë të lidhura me këtë traditë.

Por, me ardhjen e hrushovianëve në fuqi, u atakua frontalisht sistemi socialist i ndërtuar në Bashkimin Sovjetik nën maskën se «po kalohet në komunizëm», u atakua diktatura e proletariatit nën maskën e «pushtetit të të gjithë popullit», që do të thotë liberalizim i pushtetit, u rehabilituan tradhtarët e revolucionit, tradhtarë të çdo ngjyre dhe u bë përgatitja e terrenit për rimëkëmbjen e bazës së re shoqërore kapitaliste, me strukturë dhe me superstrukturë të re. Shpallja e PK të Bashkimit Sovjetik «partia e gjithë popullit» është ura kalimtare drejt kënetës oportuniste dhe eliminimit të të gjitha traditave revolucionare të Partisë Komuniste Bolshevike. Të gjitha këto krijojnë kushtet e favorshme për likuidimin edhe të traditës së partisë së vetme udhëheqëse, megjithëse kjo nuk është në interesin e hegjemonisë së shtetit të madh revizionist sovjetik dhe të lidhjeve të kombësive të ndryshme, që rrojnë në Bashkimin Sovjetik.

Revizionizmi modern sovjetik është përçarja e sigurt. Zbatimi me përpikëri dhe mbrojtja e mësimëve

të Lenin-Stalinit janë uniteti. Mbi bazën e këtyre mësimëve u zgjidh drejt çështja e kombësive dhe u krijua Bashkimi i Republikave Socialiste Sovjetike. Vetëm mbrojtja e ideve të Leninit e të Stalinit mund ta ruajë unitetin e Bashkimit Sovjetik dhe të kombësive që e formojnë atë. Revizionizmi modern hrushovian do t'i shkallmojë Bashkimin e Republikave Socialiste Sovjetike dhe unitetin leninist në mes të kombësive.

Krijimi i partive të tjera borgjeze revizioniste në Bashkimin Sovjetik do të vijë si rezultat i mëvonshëm i shthurjes dhe i degjenerimit të Bashkimit Sovjetik, si nga ana politiko-ideologjike e morale, ashtu edhe nga ana ekonomiko-shtetërore. Rruga e revizionizmit është rruga e tradhtisë së komunizmit, e lëshimeve ndaj borgjezisë, e nacionalizmit. Eksperienca e deritanishme tregon se sa më thellë zhvillohet procesi i degjenerimit revizionist, aq më shumë koncesione u bëhen imperialistëve, borgjezisë dhe nacionalistëve të ndryshëm. Klikat e reja revizioniste, që vijnë në pushet, pasi përmbysin klikat e vjetra, janë gjithnjë e më të gatshme për të ecur në këtë rrugë. Revizionistët sovjetikë nuk bëjnë përjashtim. Ata do të detyrohen të lëshojnë qoftë përpara borgjezisë së brendshme, qoftë përpara nacionalizmit të republikave të ndryshme, ashtu siç po lëshojnë para imperialistëve dhe në marrëdhëniet me aleatët e tyre revizionistë të vendeve të tjera.

Revizionistët sovjetikë hiqen si internacionalistë dhe akuzojnë Titon e Dubçekun si nacionalistë e shovinistë, siç janë në të vërtetë, por, në fakt, edhe vetë ata janë po aq, në mos më tepër, nacionalistë e shovinistë. Ata, për të maskuar fytyrën e tyre tradhtarë,

edhe udhëheqjen e kanë ujdisur, duke sjellë njerëz nga kombësi të ndryshme, në mënyrë të tillë sikur përfaqësohen kombësitë e ndryshme të Bashkimit Sovjetik. Por, në fakt, gjithë veprimtaria e tyre karakterizohet nga shovinizmi i shtetit të madh, nga tendenca hegjemoniste ruso-ukrainase, nga një politikë reaksionare nacionaliste, që nuk mund të çojë veçse në sundimin me anën e forcës, gjë që do të shpjerë në çarjen e Bashkimit.

Degjenerimi i plotë do të vijë me çarjen e Bashkimit Sovjetik në shumë shtete nacionale, të sunduara nga klika borgjeze kapitaliste, që do të marrin fuqinë në to. Procesi i degjenerimit titist në çështjen nacionale, për të mos folur për anët e tjera, procesi i shturjes së partisë në Çekosllovakia dhe ngjallja e ndjenjave shoviniste nacionale të çekëve e të sllovakëve, janë preludi i simfonisë së madhe revizioniste, që do të luhet në Bashkimin Sovjetik.

Revizionistët sovjetikë do të përpiqen me çdo kusht dhe me forcë ta evitojnë këtë shturje të madhe, sepse atyre, edhe si shtet i madh hegjemon kapitalist, nuk u intereson një gjë e tillë, por, në këtë rast, ata do të tregohen që s'janë veçse shovinistë të shtetit të madh dhe s'mund të gënjejnë më njeri me maskën e një shteti socialist. Ata përpiqen dhe do të përpiqen që, për interesat e tyre, ta ruajnë traditën e një partie të vetme udhëheqëse, të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Lufta e fraksioneve të ndryshme revizioniste, brenda në gjirin e partisë dhe të udhëheqjes, do të zhvillohet për një kohë të gjatë, brenda-përbreanda në parti. në udhëheqje, por ajo do të kalojë

dhe jashtë saj, në partitë e republikave dhe në republikat vetë.

Në luftën për pushtet klikat revizioniste nuk do të mungojnë të shfrytëzohen edhe traditën e Partisë Komuniste (bolshevike) kundër fraksionistëve dhe deviatorëve. Nën këtë maskë Hrushovi dhe hrushovianët, përveç përgatitjes së terrenit nga ana politiko-ideologjike dhe organizative kundër Stalinit dhe leninizmit, goditën grupin e Molotovit, si «antiparti». Pas kësaj, ndodhi elimnimi i vetë Hrushovit dhe i njerëzve të tij.

Por, megjithëkëtë, aktualisht, në udhëheqjen sovjetike dhe në tërë partinë ekzistojnë divergjenca të thella, ekzistojnë grupe aktive që luftojnë për dominim, ekziston, pra, edhe luftë e ashpër në mes tyre. Ai që do të sundojë përkohësisht, do të përpiqet të dobësojë klikat kundërshtarë, t'i neutralizojë ato dhe, më në fund, po të bëhen të rrezikshme, t'i eliminojë duke u vënë etiketën «grup antiparti», sepse pseudopartia për ta është tani për tani strumbullari që mund të gënjejë masat e popullit sovjetik, të mësuara me traditën. Por, mbi të gjitha, klikat që do të fitojnë e do të sundojnë, do të mbështeten efektivisht në armët e diktaturës së tyre, në forcat e sigurimit dhe në ushtrinë.

Është fakt se hrushovianët, në të gjitha vendet revizioniste, që në fillim, goditën sigurimin, Ministrinë e Punëve të Brendshme, «duke e pastruar» sistematikisht.

Tani, në përgjithësi, armën e sigurimit revizionistët e kanë spastruar nga kundërshtarët dhe e kanë të tyren. Por e kujt është ajo, e cilës klikë? Ajo është e më të fuqishmes. Këtë e tregon heqja e Shelepinit dhe e Sëmiçasnit, dy revizionistë të rinj këta, që, me

siguri, janë në opozitë me të tjerët. Kurse në ushtri vepruan gjithashtu, por këtu jo aq brutalisht. Duke e konsideruar atë si një forcë të madhe e të rrezikshme, ata vepruan dhe veprojnë me kujdes, sidomos nëpërmjet krerëve të saj. Atje përkëdhelin krerët, i heqin kuadrot me dhjetëra mijë, i dekorojnë, u japin vila, i nxjerrin në pension, i komprometojnë etj. Tendenca kryesore, si kudo, edhe në ushtri, është degjenerimi dhe edukimi me politikën antiproletare, lidhja e krerëve pas qerres së klikës më të fuqishme, me qëllim që ta përdorin edhe ushtrinë si armën e shtypjes dhe të dhunës kundërrevolucionare.

Revizionistët sovjetikë kanë shumë kujdes që degjenerimi i partisë, i shtetit dhe i ekonomisë të mos bëhet në mënyrë anarkiste, siç e filloi sharlatani bufon, Hrushovi, të cilin e eliminuan, sepse u shkaktonte rreziqe të parakohshme, siç u shkaktoi. Pasardhësit e Hrushovit, duke degjeneruar partinë, në dukje i ruajnë format e organizimit të përgjithshëm. Ata bëjnë shumë organizime dhe riorganizime në administrata të ndryshme, po, për t'u maskuar, i ruajnë format e përgjithshme të shtetit. Ata flasin për «ndryshim të Kushtetutës» dhe gjoja punojnë për të, por nuk nguten. Pushtetin sovjetik ata e minojnë, por, njëkohësisht, mundohen t'i vënë maska, të ruajnë pamjen socialiste.

Për sa u përket organizimit të ekonomisë, ndryshimeve që bëjnë në këtë drejtim, ata shkojnë më hapur drejt likuidimit të ekonomisë socialiste dhe transformimit të saj në një ekonomi kapitaliste. Dhe nuk mund të ngjasë ndryshe, pasi është një gjë që nuk mund të maskohet. Këtë e lyp objektiviteti i krijimit

të klasës së re kapitaliste revizioniste, e lyp interesi i klikave në fuqi, e lypin aleancat e reja me kapitalizmin botëror dhe, në radhë të parë, me imperializmin amerikan, e lyp nevoja e diktaturës së tyre borgjeze, e cila shtyp dhe do të shtypë gjithnjë më me forcë masat e popullit e revolucionin brenda dhe do të aktivizojë luftën për hegjemoni jashtë.

Por, në të gjithë këtë proces, që po zhvillohet në Bashkimin Sovjetik dhe në gjirin e partisë revizioniste të Bashkimit Sovjetik, nuk janë vetëm klikat revizioniste që punojnë e veprojnë. Vërtet që ato sundojnë, aktualisht, nëpërmjet një partie të vetme udhëheqëse, ashtu siç udhëhiqnin bolshevikët më parë, por kjo nuk do të thotë se në gjirin e partisë revizioniste të Bashkimit Sovjetik dhe jashtë partisë, në gjirin e klasës dhe të masës, nuk punon edhe bolshevizmi, megjithëse tani ai ndodhet në minoritet, në gjysmilegealit, ose në ilegalitet të rëndë.

Në Bashkimin Sovjetik, ndryshe nga vendet e tjera, bolshevikët mund ta kenë filluar ose do ta fillojnë punën e tyre brendapërbrenda partisë, si fraksion akoma i vogël dhe në ilegalitet të rëndë, ashtu siç mund ta fillojnë ose ta kenë filluar jashtë partisë, ose, njëkohësisht, nga brenda dhe nga jashtë për të rikrijuar Partinë e lavdishme Bolshevike të Lenin-Stalinit. Revolucionarët sovjetikë, sigurisht, do t'i shfrytëzojnë edhe format, metodat e taktikat e sprovuara të Partisë Bolshevike. Edhe rrethanat dhe kushtet e reja do t'i kenë parasysh dhe do të dinë t'i shfrytëzojnë. Eksperienca që do të fitohet, do të ketë patjetër një rëndësi të madhe për të ardhmen.

Zhvillimi i ngjarjeve në botë dhe në lëvizjen komuniste ndërkombëtare na e ka bërë të qartë se revizionistët sovjetikë, në aleancë të ngushtë me imperializmin amerikan, janë bërë armiqtë e betuar e dinakë të revolucionit dhe të luftërave çlirimtare të popujve të botës.

Këta veprojnë në arenën ndërkombëtare në emër të Bashkimit Sovjetik, këta veprojnë në lëvizjen komuniste ndërkombëtare në emër të leninizmit, në emër të Partisë Komuniste (bolshevike) të Bashkimit Sovjetik.

Ky është një rrezik i madh, që kërcënon lirinë e popujve, revolucionin, socializmin dhe komunizmin.

Partia e Punës e Shqipërisë këto pozita mashtruese, që kanë zënë revizionistët sovjetikë, i ka demaskuar, i ka luftuar dhe do t'i demaskojë e do t'i luftojë deri në fund, pasi ajo mendon se është e vetmja rrugë e luftës revolucionare marksiste-leniniste, për të bërë dallimin midis Partisë Komuniste (bolshevike) të Bashkimit Sovjetik të Lenin-Stalinit dhe partisë aktuale revizioniste sovjetike, për të bërë dallimin në mes Bashkimit Sovjetik, që krijuan dhe ndërtuan Lenini, Stalini dhe bolshevikët, dhe Bashkimit Sovjetik aktual, që revizionistët modernë sovjetikë e kanë degjeneruar.

Pa e bërë këtë dallim dhe pa e bërë këtë luftë të ashpër dhe pa kompromis kundër rrymës revizioniste dhe mjeteve të pushtetit dhe të fuqisë së saj, lufta kundër imperializmit botëror, me atë amerikan në krye, nuk mund të bëhet si duhet dhe as revolucioni botëror nuk mund të ecë përpara me ritmin e duhur.

Interesi i madh i popujve dhe i revolucionarëve sovjetikë, interesi i komunizmit botëror, është të ri-

përtërihet Bashkimi Sovjetik i vërtetë socialist, siç e krijuan Lenini, Stalini dhe bolshevikët. Interesi i revolucionit kërkon që Bashkimi Sovjetik i vërtetë socialist të jetë i fortë, me autoritet të paprekshëm ndërkombëtar, siç ishte në kohën e Leninit dhe të Stalinit. Tani, revizionistët hrushovianë i kanë ulur përtokë prestigjin dhe autoritetin si të Bashkimit Sovjetik, ashtu edhe të Partisë së tij Komuniste. Në këtë situatë duhet shpëtuar Bashkimi i vërtetë Sovjetik, krijesa e Revolucionit të Tetorit. Por si mund të arrihet kjo? Vetëm një rrugë ka dhe kjo është rruga e luftës revolucionare për shkatërrimin e klikës revizioniste që sundon tani në Bashkimin Sovjetik. Kjo është detyrë historike, që qëndron para klasës punëtore të Bashkimit Sovjetik, para bolshevikëve dhe revolucionarëve të vërtetë sovjetikë. Stuhia e një revolucioni të dytë të madh proletar në Bashkimin Sovjetik do të fshijë nga faqja e dheut revizionistët hrushovianë.

Kontradiktat midis klikave revizioniste kanë degjeneruar në një luftë për jetë a vdekje midis tyre

Tani është fakt se hegjemonia e krerëve sovjetikë në stanin revizionist po çahet, pasi revizionizmi, si rrymë borgjeze që është, ka në gjirin e vet kontradikta të shumta dhe, në praktikë, ndeshet në kundërshtime me partnerët dhe me aleatët e tij. Ne sot jemi dëshmitarë të faktit që klikat revizioniste, të cilat janë ose jo në fuqi, po grinden, po ndahen dhe po futen në

luftë me revizionistët sovjetikë. Këtë gjendje marksistë-leninistët e kanë parashikuar prej kohësh, prandaj, asnjë komunist, asnjë fraksion i klasës punëtore të ndonjë vendi, nuk duhet të gënjejhet nga veprimet gjoja «independente», «sovrane» të ndonjë klike revizioniste dhe të ketë iluzionin më të vogël se këto klika u bënë «burra të mirë», pasi u ndanë nga revizionistët sovjetikë. Vendimtarë në gjykimin e këtij fenomeni janë orientimi klasor, lufta klasore, besnikëria ndaj mësimeve të Marksit, të Engelsit, të Leninit, të Stalinit dhe zbatimi i tyre në mënyrë konkrete, me konsekuencë, me trimëri, pa marrë parasysh asnjë sakrificë.

Duhet të mbajmë parasysh se revizionistët modernë tani nuk i preokupon më aq shumë, si në kohët e para, koordinimi midis tyre i formulave stereotipe revizioniste, të fabrikuara nga ofiçinat hrushoviane të Kremlinit dhe të servitura me zell në çdo supë nga neofitët revizionistë. Ato u bënë bajate dhe u përsëritën aq shumë, sa u doli boja. Të gjithë e lanë në llucë frazeologjinë boshe të hrushovianëve. Çdo grup revizionist, në fuqi ose jo, mori përsipër, në emër të «leninizmit», «të çlirohej» përgjithmonë nga çdo zgjedhë, sidomos nga zgjedha e «diktaturës së proletariatit» dhe e «ideologjisë marksiste-leniniste». Çdo teori e tyre, jo vetëm e revizionistëve, por edhe e aleatëve të tyre të rinj ideologjikë ose politikë, çonte, sipas tyre, në socializëm me disa të shtyra, me disa slogane, me shumë gënjeshtër, por «çdo gjë tani çonte në socializëm».

Çdo grup revizionist filloi tani të jetë i lirë dhe të ndërtojë planet e tij të shkëputjes dhe të ribashkimit, të shkatërrimit dhe të riintegritit. Këndej doli, naty-

risht, e bazuar në teorinë «e ndritur» hrushoviane, se çdo vend, meqë ka specifikat e tij, duhet të ndërtojë edhe një socializëm specifik. Dhe cilido vend revizionist filloi të mos u vërë më veshin frazave stereotype që nxirrte ofiçina e Kremlinit, filloi të formulonte formulat e veta specifike, të formulonte teoritë e veta si ta organizonte shtetin e ri kapitalist në vendin e tij, si t'ia adaptonte këtij shteti ekonominë, si ta likuidonte partinë komuniste, si të krijonte partitë e tjera borgjeze dhe ta ndante fuqinë me to, si ta bënte me vete armën e sigurimit e ushtrinë dhe, nga armë të diktaturës së proletariatit, t'i kthente këto në armë kundër proletariatit dhe punonjësve.

Përveç këtyre drejtimeve kryesore, revizionistët në fuqi në këto vende i preokuponte shumë, e në radhë të parë, mënyra dhe forma se si do të ndaheshin me revizionistët sovjetikë. Ky ishte zinxhiri i madh, që duhej shkëputur. Ata kishin midis tyre shumë lidhje, ideologjike, ekonomike, politike, kulturore, ushtarakë etj., të hapëta e të fshehta, lidhje shtetërore, lidhje ndërshtetërore, lidhje klikash, lidhje personash, lidhje spiunazhi. Një rrjet i tërë i ndyrë!

Natyrisht, midis tyre do të ngjiste, siç ngjet midis gangsterëve, «rregullimi i hesapeve». Dhe ky rregullim i hesapeve ka filluar, bile ka ecur mjaft përpara. Prandaj, këtu tani nuk është më shumë çështja «e korigjimit të formulave të teorisë», por ata veprojnë me kobure në dorë, «o çantën, o jetën», si të thuash. Revizionistët kanë filluar një luftë për jetë a për vdekje midis tyre.

E famshmja mbledhje e Moskës, që u vendos në

«karnavalet e Budapestit», siç e tregoi tani edhe mbledhja tjetër në Budapest, e komisionit për përgatitjen e mbledhjes së «nivelit të lartë», zor se merret vesh për ç'qëllim bëhet, për të vendosur «paqen» në Vietnam, apo për të vendosur «paqen» në stanin revizionist, domethënë, për të pajtuar gangsterët revizionistë, që i kanë nxjerrë thikat njëri-tjetrit. Kjo konferencë, ndër të tjera, duhet të mbulojë të gjithë gjendjen mizerabël në të cilën ndodhet partia revizioniste e Bashkimit Sovjetik dhe disfatat e revizionistëve sovjetikë. Kjo nuk është një konferencë komuniste dhe mbledhjet e ndryshme përgatitore që po zhvillohen, u përngjasin prapaskenave të tregjeve të kuajve, të kurseve të tyre dhe të ekspozitave tregtare, ku janë mbledhur lloj-lloj matrapazësh, tregtarësh, hajdutësh dhe bëjnë allishverishe, japin e marrin firma, fjalë, rubla e dollarë, për të thënë kështu, për të mos thënë ashtu, për të mbrojtur këtë, ose për të sharë atë.

Mbledhja e re e Budapestit tregoi akoma më qartë kalbëzimin dhe degjenerimin e mëtejshëm të stanit revizionist. Vetëm pak javë kaluan nga mbledhja e mëparshme, në të cilën morën pjesë 67 parti revizioniste, dhe në seancën e re erdhën, çalë-çalë, 54 parti. Të shohim sa do të venë në Moskë në nëntor. Atje do të bëhet bilanci, por duket që tani se ai do të jetë i vajtueshëm. Mbledhja e re revizioniste e Budapestit, për numrin dhe për kualitetin e pjesëmarrësve të saj, qe një dështim i plotë për revizionistët sovjetikë. Prandaj, edhe pjesa më e madhe e pjesëmarrësve, u dëbuan dhe mbetën vetëm 22 që të përgatitnin çorbën, që do të serviret në mbledhjen e ardhshme të Moskës.

Një nga objektivat kryesorë të mbledhjes së këtyre banditëve do të jetë përsëri lufta kundër Partisë Komuniste të Kinës¹, Partisë së Punës të Shqipërisë dhe marksizëm-leninizmit. Këtë ata nuk do ta harrojnë kurrë, pasi lufta që bëjnë partitë e vërteta marksiste-leniniste për demaskimin e revizionizmit, u rri si shpata e Damokleut mbi kokë. Roli i partive revizioniste, vetë ekzistenca e tyre janë të shtypin revolucionin në vendin e tyre dhe në botë e, në radhë të parë, të mposhtin ato vende të cilat mbajnë lart flamurin e marksizëm-leninizmit, të revolucionit dhe të çlirimit të popujve.

Çdo ditë tregon dobësinë e revizionistëve modernë dhe, pikërisht, ky vit po bëhet për ta dhe, në radhë të parë, për revizionistët sovjetikë, viti i katastrofës. Këtë vit u shkëput nga zinxhiri Çekosllovakia. Në këtë rrugë është edhe Polonia. Më pas do t'u vijë radha Hungarisë. Bullgarisë e satelitëve të tjerë. Këto probleme revizionistëve sovjetikë, sigurisht, nuk do t'ua zgjidhin as bohema revizioniste, as «numri» i partive revizioniste të vendeve kapitaliste, që vijnë në mbledhje-panaire për të marrë shpërblimet e premtuara.

Kontradiktat e mëdha, që i brejnë revizionistët në mes tyre, shprehen gjithnjë e më qartë në formën e puçeve e të kompleteve të nëndheshme për të rrëzuar njëri-tjetrin dhe në formën e kritikave të brendshme në partitë e gjithsecilit.

1 Në atë kohë besohej se Partia Komuniste e Kinës ishte në pozita të drejta, por, më vonë, faktet treguan qartë se ajo asnjëherë s'ka qenë një parti e vërtetë marksiste-leniniste.

Por të gjitha këto halle, që u kanë rënë mbi kokë revizionistëve modernë e, në radhë të parë, revizionistëve sovjetikë, këta përpiqen t'i mbulojnë me një perde tymi sa më të errët, që të mos munden dot të shohin qartë as anëtarët e partisë revizioniste të Bashkimit Sovjetik, as popujt sovjetikë. Dhe, pikërisht, në këtë drejtim punon propaganda e tyre, për ta bërë sa më të ngathët, sa më të fjetur, sa më apolitike kokën e njerëzve sovjetikë, për t'i bërë këta të rrojnë dhe të gjykojnë me disa formula që u servir udhëheqja, të mos shohin më larg se hunda e tyre dhe, në rast se arrijnë të shohin diçka më tej, t'i shohin gjërat me syzet e megalomanit. Duke spekuluar dhe duke fryrë qëllimisht ato që mund të jenë krenari e ligjshme e qytetarit sovjetik, si të «njeriut që lindi në vendin ku lindi Lenini», të «njeriut që shkoi i pari në Kozmos», të «njeriut që do të vejë i pari në Hënë» etj., udhëheqësit sovjetikë kërkojnë t'i bëjnë njerëzit sovjetikë që të tjerët t'i shikojnë si miza, që të mendojnë se të tjerët s'dinë gjë, se të tjerët janë të vegjël, prandaj duhet të rrojnë nën hijen e tyre. Për t'i bërë njerëzit t'i shohin gjërat me syrin e megalomanit, herë pas here, udhëheqësit sovjetikë kanë nevojë edhe për organizimin e ndonjë spektakli të madh, që t'i shërbejë këtij qëllimi. Për këtë arsye organizohet edhe konferenca antikomuniste e Moskës, që u vendos në «karnavalet e Budapestit».

A mund të veprojnë ndryshe revizionistët modernë me partitë dhe me popujt e tyre? A mund të veprojnë ndryshe revizionistët modernë në lëvizjen komuniste ndërkombëtare? Jo, në asnjë mënyrë.

Revizionizmi modern ka frikë nga komunistët e vërtetë, nga populli dhe nga lëvizja komuniste marksiste-leniniste ndërkombëtare për t'i shtruar hapur problemet dhe për t'ua nënshtruar ato kritikës serioze dhe analizës bolshevike nga ana e partisë, e popullit dhe e komunizmit ndërkombëtar. Ai ka frikë se demaskohet keq dhe shpartallohet plotësisht. Revizionistët i japin partisë së tyre atë që u intereson atyre, të përgatitur, të zbukuruar, me plot gënjeshtër, me shtrembërime dhe me shpifje. «Pse Partia e Punës e Shqipërisë hyri në konflikt me Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe me udhëheqjen revizioniste sovjetike?». «Fare thjeshtë, — u thanë tradhtarët revizionistë anëtarëve të partisë së tyre, — udhëheqja e Partisë së Punës të Shqipërisë dhe e shtetit shqiptar u shit te kapitalistët perëndimorë» e kështu me radhë për çdo gjë.

Klikat revizioniste në vendet e tyre u kanë hedhur zinxhirë të rëndë luftës politike dhe ideologjike të revolucionarëve, polemikës leniniste. Me të gjitha mjetet dhe me të gjitha forcat, revizionistët modernë po e sulmojnë marksizëm-leninizmin, po e shtrembërojnë atë. Partia e Punës e Shqipërisë, duke i qëndruar besnike marksizëm-leninizmit dhe duke kryer detyrën e saj internacionaliste, flet hapur dhe demaskon me guxim parimor të gjitha këto tradhti që po bëhen. Pikërisht për këtë, revizionistët modernë, së bashku me aleatët e tyre kapitalistë, e sulmojnë Partinë e Punës të Shqipërisë dhe kanë vendosur ligjin e heshtjes mbi të vërtetat që përhap ajo.

Por, sado përpjekje që të bëjnë revizionistët, ata nuk mund të mbulojnë kalbëzimin dhe degjenerimin

gjithnjë e më të madh të partive të tyre, ashtu siç nuk mund të ndalojnë shkatërrimin e frontit revizionist dhe të falimentimit të hegjemonisë sovjetike mbi të. Asnjë mbledhje, asnjë takim, qofshin këto dypalëshe e pesëpalëshe, apo më shumë, siç ishin ato që u zhvilluan ditët e fundit në Moskë, nuk mund të vërë rregull në stanin revizionist. Shovinizmi i shtetit të madh i udhëheqësve sovjetikë, përpjekjet e tij për sundim e për nënshtrim të aleatëve të tij, favorizojnë dhe rritin nacionalizmin dhe tendencat centrifugale në anën tjetër. Ashtu si lufta midis grupeve të ndryshme përbën një nga tiparet kryesore të jetës politike brenda çdo vendi revizionist, përçarjet dhe konfliktet midis vendeve revizioniste karakterizojnë shportën e karavidheve të revizionistëve modernë.

Shpërthimi i tanishëm i grindjeve midis klikës së revizionistëve sovjetikë dhe partnerëve të saj revizionistë, nga njëra anë, si dhe grindjet për çështjet politike, ekonomike e ushtarake midis klikave të vendeve të ndryshme revizioniste, nga ana tjetër, po duken sheshit. Kontradiktat midis tyre janë të thella dhe ato nuk mund të pajtohen kurrë. Në një të ardhme jo të largët, ne do të jemi dëshmitarë të përleshjeve dhe të shturjeve akoma më të mëdha, gjerësia dhe thellësia e të cilave duken mjaft qartë që tani.

Procesi i degjenerimit të mëtejshëm të revizionizmit modern në vende të ndryshme, megjithëse në përgjithësi ndjek të njëjtën rrugë dhe të njëjtat qëllime, në veçanti ka karakteristika jo të njëllojta, gjë që u detyrohet veçorive të çdo vendi ku sundojnë klikat revizioniste. Analiza e ngjarjeve në çdo vend revizio-

nist në veçanti, format dhe metodat që përdor secili grup i veçantë revizionist kundër marksizëm-leninizmit për degjenerimin e partive marksiste-leniniste dhe të diktaturës së proletariatit, kanë një rëndësi të veçantë dhe nuk duhen nënvleftësuar.

Lufta e marksistë-leninistëve kundër revizionistëve duhet të zhvillohet në front të gjerë, por ata nuk duhet të harrojnë edhe luftën e veçantë kundër revizionistëve të veçantë, të cilët përdorin taktika jo të njëllojta për t'ia arritur të njëjtit qëllim. Revizionizmi modern ka tiparet e tij kryesore të përbashkëta, ka strategjinë e tij të njëjtë, por ai përdor forma dhe taktika të ndryshme, të cilave duhet t'u vësh përballë forma dhe taktika lufte të veçanta, për çdo situatë, për çdo stad të zhvillimit të tij, për çdo vend dhe parti ku ai shfaqet, merr pushtetin, ose merr tatëpjetën.

Një analizë e tillë objektive është e domosdoshme të bëhet nga të gjitha partitë marksiste-leniniste, nga grupet revolucionare dhe nga gjithë komunistët dhe revolucionarët e çdo vendi, që seriozisht u kanë shpallur luftë imperializmit dhe lakenjve të tij, revizionistëve modernë.

Në aksione konkrete dhe në luftë organizohet partia marksiste-leniniste, mobilizohen dhe edukohen masat punonjëse për revolucion

Klasa punëtore në vendet ku në fuqi kanë ardhur revizionistët, duhet të bëhet e ndërgjegjshme për momentet historike shoqërore nëpër të cilat kalon bota

dhe veçanërisht në këto vende. Ajo duhet të realizojë se ndodhet para një katastrofe të madhe dhe gjendja e saj është më e ndërlikuar dhe më e vështirë se e proletariatit në vendet ku sundon kapitali. Proletarët e vendeve kapitaliste e shohin kush është, si fshihet dhe si duhet luftuar armiku, kurse klasa punëtore në vendet ku sundojnë revizionistët, këta kapitalistë të rinj që hiqen si «marksistë», po mashtrohet, po gënjehet, po kthehet në skllave. Kjo klasë punëtore, që po futet nën zgjedhën kapitaliste, nuk ka të drejtë as të flasë, as të bëjë grevë, siç po bëjnë shokët e saj të vendeve kapitaliste. Në maskën se gjoja punëtorët s'mund të ngrihen kundër «regjimit të punëtorëve», nën maskën se diktatura është «diktatura e tyre, ligjet janë të tyre dhe, pra, nuk kanë pse të ngrihen, pse të lëvizin», klasa e re kapitaliste në fuqi në vendet ish-socialiste po kalon muajt e mjalitit me kapitalistët përëndimorë në ato toka ku u derdh si lumë gjaku i proletarëve dhe i fshatarëve, që luftuan për revolucionin nën flamurin e Marksit, të Engelsit, të Leninit, të Stalinit.

Në stadin aktual të kalbëzimit të imperializmit, ne shohim rolin e madh që ky i ka vënë shtresës së inteligjencies, të teknokratëve, të burokratëve, shohim se si ai e ka korrptuar një pjesë të mirë të kësaj shtrese dhe e ka futur në shërbim të vet, bile, e ka nxjerrë në pararojë të luftës së tij për sundimin e botës, për shtypjen e revolucionit dhe të luftërave nacionalçlirimtare të popujve. Kjo shtresë e korrptuar dhe në shërbim të kapitalit, me të gjitha mjetet që i vihen në dispozicion, të cilat nuk janë të pakta, përpiqet të

korruptojë, të gënjejë, të neutralizojë klasën punëtore, forcën kryesore dhe vendimtare kundërshtare të kapitalizmit. Në këtë mënyrë dhe në këtë rrugë kapitalizmi kërkon të zgjatë jetën e tij.

Kjo vijë po zhvillohet gjerësisht edhe nga revizionizmi modern, atje ku ka ardhur në fuqi dhe atje ku nuk ka ardhur. Intelektualët e korruptuar dhe burokratët janë bërë dhe po bëhen mbështetja e tij kryesore për të realizuar transformimin e shoqërisë socialiste në një shoqëri kapitaliste. Po shkohet drejt nënshtrimit të klasës punëtore, drejt kufizimit në minimum të rolit të saj historik në revolucion e në socializëm, po shkohet drejt dekompozimit, korruptimit dhe kthimit të saj jo më në një forcë politike, por në një apendiks ekonomik, në një mjet të destinuar jo të drejtojë, por vetëm të punojë për të tjerët, të prodhojë pak për veten e saj dhe shumë për borgjezinë e re kapitaliste, që po krijohet, pikërisht nga shtresa e inteligjencies, e burokratëve, e teknokratëve dhe e aristokracisë punëtore.

Në vendet ku janë në fuqi revizionistët po ecet më shpejt në këtë rrugë të çarë nga kapitalizmi botëror.

Por ky proces i përgjithshëm ka, gjithashtu, ndryshimet e veta në vendet e ndryshme revizioniste, që varen nga shkalla e zhvillimit të revizionizmit në çdo vend të veçantë.

Mund të bëhet pyetja: Si u bë kjo kthesë nga e djathta, e një pjese mjaft të rëndësishme të inteligjencies, në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e tjera revizioniste? Kjo kthesë mund të themi se është një proces i gjatë, prej vjetësh, dhe që nuk ka marrë ako-

ma fund, balanca lëkundet. Kjo ka ardhur, përveç të tjerave, pasi partia në këto vende nuk ka pasur parasysh sa duhet çështjen e ngritjes ideologjike klasore të inteligjencies në dy drejtime. Nga njëra anë, atyre që u mësohej ideologjia teorikisht, as merrnin mundimin t'u tregonin ç'ishte, fjala vjen, edhe kizma. Këtë kategori njerëzish me shkollë, qofshin këta bij punëtorësh, nëpunësish, kolkozianësh, e përpinin administrata, zyrat, udhëheqjet. Këta formonin «elitën», si të thuash, të regjimit proletar, inteligjencien e re proletare, që zinte zyrat, universitetet, dekanatet, drejtoritë, teatrot, redaksitë etj. Këta bëheshin njerëz të shquar, filozofë, artistë, shkrimtarë dhe të tërë kishin titullin proletarë. Disa prej këtyre ishin dhe qëndronin me të vërtetë të tillë, por të tjerë deformoheshin tok me administratën, pasi administrata, nga një mjet i diktaturës së proletariatit, po kthehej në një përbindësh që e sundonte, e mbyste dhe e drejtonte si donte ajo pushtetin e proletarëve. Nga ana tjetër, një pjesë e madhe e inteligjencies shkonte në prodhim, jetonte e punonte bashkë me klasën punëtoresh dhe me fshatarësinë. Ajo kishte një ngritje mjaft të ndjeshme teknike, së cilës i ishte vënë veçanërisht rëndësi, kurse pak rëndësi i qe dhënë kalitjes së saj ideologjike dhe politike.

Në këto dy fusha «inteligjencia e lartë proletare» e burokratizuar, sipas traditës, kishte zënë postet dhe as i shkonte kurrë në mend t'i lëshonte. Ajo e ndiente veten «shumë të zonjën», «të paarritshme në dituri», të destinuar të udhëheqë e të drejtojë të tjerët, masën, domethënë, klasën punëtoresh dhe fshatarësinë, të cilat,

«nga natyra» dhe «nga funksionet», duhet vetëm të punojnë, kurse ajo bën ligjin, ose, më drejt të themi, ajo shtrembëron ligjin proletar dhe i përdor diktaturën e proletariatit, partinë kundër socializmit dhe kundër vetë partisë së proletariatit.

Pra, në vendet revizioniste janë ish-proletarët ose bij proletarësh të intelektualizuar, të borgjezuar, të degjeneruar, që kanë humbur sensin e klasës, që kanë zënë pozitë në parti e në shtet pas një procesi të gjatë e të komplikuar dhe tani, me anë të aparateve të forta të partisë dhe të pushtetit kanë paralizuar pushtetin proletar dhe partinë. Në fakt, në vendet revizioniste nuk veprojnë as pushteti i diktaturës së proletariatit, as partia e proletariatit.

Në këto rrethana bëhet e domosdoshme që, kudo, partitë marksiste-leniniste dhe revolucionarët në botë, në radhë të parë, të zgjojnë klasën punëtore, t'i hapin sytë, ta armatosin atë dhe ta hedhin pa humbur kohë në luftë dhe në revolucion. Revolucioni proletar është një nga çështjet më serioze të jetës së njerëzimit mbarë dhe është, në radhë të parë, një revolucion politik, që duhet të udhëhiqet, të organizohet në mënyrë të çeliktë, pasi ai, pa asnjë dyshim, është në çdo kohë dhe në çdo vend një përpjekje e përgjakshme në mes klasës punëtore dhe borgjezisë kapitaliste. Prandaj, në krye të këtij revolucioni duhet të jenë proletarët dhe partia e tyre komuniste. Pa partinë komuniste të organizuar si duhet, me parime të qarta politike, organizative dhe ideologjike marksiste-leniniste, nuk ka asnjë revolucion, nuk mund të fitojë asnjë revolucion proletar. Asnjë i tillë nuk ka fituar deri tani.

Kjo është një nga çështjet parimore që komunistët dhe klasa punëtore ndërkombëtare duhet ta kenë kurdoherë parasysh në rrugën e tyre revolucionare. Për marksistë-leninistët revolucionarë të botës është e domosdoshme ekzistenca e partive me të vërtetë bolshevike, e tipit Lenin-Stalin, ndryshe nuk mund të organizohet dhe të udhëhiqet revolucioni. Për çdo militant komunist në botë është e domosdoshme të njihet me materialet përkatëse të klasikëve të marksizëm-leninizmit për çështjet e revolucionit proletar e të ndërtimit të partisë dhe t'i zbatojë ato me besnikëri në situatat konkrete të vendit të tij. Të gjitha konsideratat e revizionistëve hrushovianë dhe të borgjezisë për këto çështje, që na akuzojnë si «stalinistë», «dogmatikë» etj., janë profka, që synojnë të na largojnë nga rruga e vërtetë.

Mësimet e Leninit e të Stalinit, eksperiencia revolucionare e Partisë Bolshevike, janë një shembull i ndritur se si ndërtohet partia, se si ndërtohet diktatura e proletariatit, se si ndërtohet socializmi, kurse çdo gjë e hrushovianëve duhet të shqelmohet, të demaskohet, të luftohet pa mëshirë, pasi janë pikërisht ata që po e kthejnë Bashkimin Sovjetik në një vend kapitalist.

Revizionistët modernë kanë tani në duart e tyre udhëheqjen dhe aparatet e partive komuniste punëtore, si dhe bashkimet profesionale. Ata e dinë se rreziku u vjen nga klasa punëtore, prandaj përpiqen ta mbajnë të rrethuar vendin e gjahut. Socialdemokracia e vjetër, që me slogane vazhdon të gënjejë një pjesë të klasës punëtore dhe ta mbajë atë të lidhur me par-

titë e saj, tani gjoja polemizon me partitë revizioniste, por çështja, në të vërtetë, qëndron në ndarjen e thërrimeve të sofrës kapitaliste në mes tyre. Sot midis revizionistëve dhe socialdemokratëve nuk ka asnjë ndryshim. Të gjithë këta po e mashtrojnë dhe do të përpiqen ta mashtrojnë me çdo mënyrë klasën punëtore, për ta mbajtur atë nën sundimin e nën influencën e tyre.

Partitë revizioniste, atje ku këto janë në fuqi, nën petkun «legal», nën forcën e «centralizmit demokratik», pa demokraci në fakt, nën ligjet e pushtetit gjoja të diktaturës së proletariatit, që në të vërtetë është shndërruar në një diktaturë të burokracisë së re teknokrate, i mbajnë komunistët në zinxhirë të rëndë, kurse në vendet kapitaliste partitë komuniste dhe punëtore, që janë shndërruar në revizioniste, përpiqen t'i mbajnë komunistët nën ndikimin e tyre, duke transformuar dhe duke degjeneruar normat e partisë, duke i bërë ato të ngjashme me të partive borgjeze, në mënyrë që komunisti të ketë vetëm tesserën, por asnjë detyrim. Me një fjalë, ai nuk dallohet më nga masa, nuk është më në pararojë.

Në këto rrethana vihet detyra imperative që marksistë-leninistët të thyejnë rrethimin revizionisto-socialdemokrat të klasës punëtore, ta çlirojnë këtë nga ideologjia borgjeze e reformiste, ta pajisin me ndërgjegjen e klasës, që ajo të mos humbasë as busullën, as trimërinë që e karakterizon. Vlerësimi sa duhet dhe si duhet në praktikë e në teori i rolit të klasës punëtore dhe i punës e i luftës në gjirin e saj, ka një rëndësi vendimtare. Këtej, absolutisht këtej, duhet të fillohet

dhe jo në mënyrë të mbyllur dhe në rreth të ngushtë me ndonjë intelektual të shkëputur ose me disa studentë të veçantë.

Klasa punëtore duhet të shtrëngojë radhët, të organizohet, të nxjerrë nga gjiri i saj udhëheqësit e vet, trima, besnikë, luftëtarë, njerëz të sakrificës dhe të mos lejojë më që elementë hipokritë, llafazanë të marrin në duar udhëheqjen e saj dhe ta përdorin atë për qëllimet e tyre karrieriste ose për interesat e borgjezisë. Klasa punëtore do njerëz të kalitur, të hekurt, të patrembur e të qartë në parime. Të tillë njerëz ajo do t'i dojë, do t'i dëgjojë e do t'i ndjekë në organizatibazë, në barrikada, në greva e në revolucion. Kështu do të formohen e do të kaliten kuadrot e rinj revolucionarë, kështu do të fitojnë klasa punëtore dhe aleatët e saj, kështu do të demaskohen revizionistët modernë dhe socialdemokratët, kështu do të luftohen imperializmi e kapitalizmi.

Në këtë rrugë klasa punëtore do të krijojë partitë e reja bolshevike, besnike të traditave të lavdishme revolucionare e të ndërtimit të socializmit, të devotshme për kauzën e marksizëm-leninizmit dhe të afta për mbrojtjen e tij nga të gjithë armiqtë e jashtëm e të brendshëm.

Komunistët e vërtetë, revolucionarët, nuk mund t'i shmangen kësaj detyre imperative. Është e vërtetë se kjo kërkon punë dhe luftë vetëmohuese, por ata nuk u janë trembur kurrë sakrificave, sado të mëdha që të kenë qenë ato. Luftë pa dëme e pa dhimbje nuk ka. Revizionistët që kanë uzurpuar pushtetin, natyrisht, nuk do t'i lejojnë revolucionarët, bolshevikët, të

organizohen lirisht, të veprojnë legalisht etj. Me siguri ata do t'i persekutojnë, do t'i burgosin, do t'i torturojnë e do t'i vrasin. Por kjo s'do të thotë se ata duhet të tërhiqen nga lufta, nga aksioni. Komunistët i mbrojnë haptas pikëpamjet e tyre edhe përpara litarit. Ata s'kanë frikë, kur është nevoja, të dalin në rrugë për të protestuar, të mbledhin e t'u flasin punëtorëve në fabrikë, të demaskojnë tradhtarët nëpër konferenca, të shkruajnë libra dhe të shpërndajnë trakte. Bolshevikët e Leninit dhe të Stalinit asnjëherë nuk i trembën as Siberia, as gjyqet cariste. Në aksione konkrete organizohet partia marksiste-leniniste, nëpërmjet aksioneve konkrete edukohen masat punonjëse për luftë e për revolucion, nga aksionet dalin elementët e shëndoshë të klasës punëtore, që do ta udhëheqin atë në luftën për përmbysjen e klikave revizioniste. Revolucionarët bolshevikë nëpërmjet luftës së përditshme konkrete revolucionare, mund dhe do të ndërtojnë organizatat e tyre ilegale në gjirin e klasës punëtore, të fshatarësisë kolkoziane e të ushtrisë, të sigurimit të shtetit, në aparatet e ndryshme të pushtetit etj., për ta sulmuar kështu, në front të gjerë, nga jashtë e nga brenda, klikën sunduese revizioniste, për shkatërrimin e saj të plotë. Kështu, ata mund dhe duhet të mbrohen nga goditjet e saj dhe ta bëjnë më efikase luftën e tyre.

Tani revolucionarët, në vendet ku sundojnë revizionistët, si numër mund të mos jenë të shumtë brenda vetë partisë. Por ata duhet të marrin shembull nga historia e kaluar e Partisë Komuniste Bolshevike të Bashkimit Sovjetik, nga Lenini, i cili, kur mbetej në minoritet, i bindur në drejtësinë e vijës së tij, i ruante

vetes të drejtën dhe e zbatonte atë për t'iu drejtuar direkt klasës punëtore për t'u bashkuar me të kundër oportunitizmit ose tradhtisë së fraksioneve të ndryshme të djathta ose të majta.

Proletariatit në shumë vende të botës i duhet të organizohet rishtas, të udhëhiqet nga ideologjia e tij e vërtetë marksiste-leniniste, të hidhet në revolucion të armatosur dhe të thyejë çdo aparat të borgjezisë kapitaliste, socialdemokrate, revizioniste, që janë hallka të vargonjve të robërisë së tij. Në luftë të vendosur dhe në revolucion proletariati botëror do të ketë edhe aleatët e tij, të cilët, në këto periudha revolucionare, do t'i sqarojnë më mirë pozitën dhe qëndrimet e tyre. Këta aleatë presin udhëheqësen e tyre të dalë në fushën e betejës. Fusha e betejës vendos, shpata zhveshur kundër imperializmit dhe revizionizmit modern dhe jo atantizmi dhe kompromisi. Këta të fundit i mbajnë kurdoherë në lëkundje aleatët e mundshëm dhe të natyrshëm të proletariatit. Këtu synojnë gjithë politika dhe dredhitë e socialdemokratëve dhe të revizionistëve modernë me imperialistët dhe me kapitalizmin botëror.

Një përgjegjësi e veçantë historike, një rol veçanërisht i madh në luftën kundër revizionizmit u takon klasës punëtore dhe revolucionarëve sovjetikë, të cilët i ka pllakosur tradhtia më e rëndë që i është bërë një populli dhe rreziku më i egër që i kërcënohet një vendi të madh dhe me një të kaluar të lavdishme siç është Bashkimi Sovjetik. A nuk e shohin ata, drejt çfarë greminë po vete atdheu i tyre? A nuk e shohin ata se ç'dëm të madh po u sjell veprimtaria e revizionistëve

sovjetikë lëvizjes komuniste ndërkombëtare dhe luftës nacionalçlirimtare të popujve? Sigurisht që e shohin dhe marksistë-leninistët e popujt e të gjithë botës kanë besim se klasa punëtore e Bashkimit Sovjetik, kolkozianët, intelektualët popullorë, ushtarët dhe rinia sovjetike do t'i kapërcejnë tronditjet e përkohshme që u kanë shkaktuar revizionistët, do të hedhin poshtë iltuzionet e dëmshme të përhapura nga udhëheqja tradhtarë hrushoviane dhe do të zbresin në fushën e betejës, për të përmbysur klikën revizioniste dhe për të ngritur përsëri mbi Kremlin dhe mbi gjithë Bashkimin Sovjetik flamurin e Leninit e të Stalinit. Populli i madh sovjetik do të ngrihet me siguri një ditë dhe do t'i shkundë përsëri supet e tij të fuqishme. Çështja është që kjo ditë të afrohet sa më shumë, për t'i shkurtuar vuajtjet e tij, për të ndihmuar edhe popujt e tjerë që ndodhen nën zgjedhën revizioniste.

Revolucionarët bolshevikë sovjetikë, siç e thoshin në traktin e tyre programatik, e kanë përcaktuar qartë rrugën e tyre: «Për përmbysjen e rendit burokratik në BRSS duhet të organizohen revolucionarët, duhet një shtrat në të cilin të kalojë indinjata popullore dhe të zhvillohet lufta popullore. Dhe për këtë ne s'kemi pse të kërkojmë. Para nesh është rruga e sprovuar — rruga e rikrijimit të partisë proletare... Të gjithë ata që janë gati të luftojnë kundër burokracisë, të gjithë ata për të cilët janë të shtrenjta fitoret e mëdha revolucionare të popullit tonë, duhet të kalojnë vendosmërisht në këtë rrugë. Nga celulat e shumta e të veçuara të PK (b) të BS deri te shkrirja e tyre në një lavë të fuqishme e të pamposhtur, e cila do të

fshijë burokratët — ja rruga që duhet të bëjnë komunistët sovjetikë. Veprimtaria e celulave të PK (b) të BS, parullat dhe traktet e tyre duhet të kthehen në një luftë partizane të vërtetë. Burokratëve duhet t'u digjet toka nën këmbë».

Marksistë-leninistët, revolucionarët, popujt e gjithë botës besojnë se zjarri i revolucionit, zjarri i bolshevizmit dhe i internacionalizmit proletar, sado përpjekje që kanë bërë revizionistët, nuk është shuar akoma në Bashkimin Sovjetik. Ata kanë jo vetëm shpresën, por edhe bindjen e sigurt se një ditë bolshevikët e vjetër e të rinj sovjetikë do ta ndezin përsëri këtë zjarr revolucionar, për të djegur në të revizionizmin dhe për t'i dhënë një shkëlqim të ri historisë së lavdishme të bolshevizmit, veprës së pavdekshme revolucionare të Leninit e të Stalinit, të atyre miliona heronjve që bënë Revolucionin e Tetorit, që mbrojtën atdheun e tyre nga hordhitë hitleriane dhe që ndër-tuan me sukses socializmin.

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 118 (6157), 17 maj 1968

Botohet sipas librit: Enver Hoxha. «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1968-1970», f. 119

KËTO QË MËSUAT NË KURS, I VINI NË ZBATIM, I BËNI JETË TË DYTË

*Fjala me të rejat e malësisë së Veriut, pjesëmarrëse
në kursin që u organizua në Durrës*

20 maj 1968

Të dashura shoqe,

Partia, shokët edhe unë jemi shumë të gëzuar që ju, gra dhe vajza të reja, të ardhura nga kooperativat e ndryshme të malësive tona të Veriut, u mbledhët në këtë kurs tremujor dhe kryet me sukses mësimeve sipas programit që ju ishte caktuar. Ne nuk kishim asnjë dyshim që ju do t'i përvetësonit mirë këto mësime, për arsye se, bashkë me zgjuarsinë e madhe natyrore, ju keni edhe ngritje të mirë politike e nivel arsimor, pavarësisht se ky, në përgjithësi, është akoma i ulët. Megjithatë, ai nivel arsimor që keni, i bashkuar edhe me edukatën e lartë politike dhe me zgjuarsinë tuaj natyrore, ju dha mundësi t'i përvetësonit shpejt, me sukses dhe mirë mësime që u zhvilluan këtu, bile unë mendoj se këto mësime kanë qenë të lehta për nivelin tuaj, pse jeni të zonjat dhe, në të ardhmen, me

siguri do të bëheni akoma më të zonjat, për të përveçësuar njohuri edhe më të thella.

Ju u treguat të gatshme për përvetësimin e këtyre mësimeve. Kjo ka rëndësi të madhe e bashkë me të edhe etja e vazhdueshme që keni për mësim e përparim. Megjithatë, çështja nuk ishte se ju nuk dinit të qepnit, të gatuanit, apo të mbanit pastër shtëpinë, pse këto gjëra elementare, të nevojshme për jetën e njeriut, ju i keni mësuar qysh në vogëli në familje, dhe jo vetëm kaq, sepse organizatat-bazë të Partisë, organizatat e rinisë dhe ato të gruas, ju kanë shpjeguar e ju kanë mësuar vazhdimisht si për shumë çështje politike e shoqërore, ashtu edhe për këto të jetës së përditshme, për pastërtinë, për higjienën, për rëndësinë e ushqimit etj., etj. Këtu është fjala për diçka më të madhe. Tani ka ardhur koha që ne të ecim përpara edhe më shpejt, të kalojmë nga gjendja që akoma ekziston në fshatrat e malësisë, në një gjendje shumë më të përparuar. Dhe përparimin, siç na mëson Partia, e sjellin, në radhë të parë, njerëzit, prandaj duhet punuar pa u lodhur që njerëzit tanë të mësojnë e të ngrihen vazhdimisht në të gjitha drejtimet. Këtë qëllim ka edhe hapja e kurseve, siç është edhe ky juaji.

Po, mbi të gjitha, rëndësi të veçantë kanë miqësia dhe dashuria që ju fituat për njëra-tjetrën. Ju u mësuat këtu me të mirat e jetës së përbashkët kolektive. Këtu prej disa muajsh jetuat e punuat së toku, ditë dhe natë. Asnjëherë në jetën tuaj nuk jeni ndodhur kaq shumë vajza dhe gra së bashku në një vend dhe për një kohë kaq të gjatë. Kurrë në jetën tuaj deri tash nuk keni qenë në një shoqëri të tillë të madhe,

në një ambient kaq të shëndoshë plot punë, plot mendime, plot mësim dhe kaq shumë të gëzuara, të singerta e të hapëta me njëra-tjetrën. Kjo ka shumë rëndësi.

Ardhja këtu do të ndihmojë, në radhë të parë, që të zhduket nga ndërgjegjja juaj mentaliteti i vjetër i jetës së vetmuar në kullë apo në familje. Ju atje keni qenë të mbyllura si zogu në kafaz dhe kjo ju pengonte të shikonit më larg se muret e shtëpisë apo, shumë shumë, më tej kufijve të fshatit. Edhe kur ndonjëra prej jush mendonte për diçka më larg fshatit, këtë e bënte me druajtje të madhe, sepse zakonet, feja, paragjykimet, thashethemet në të kaluarën ju kishin mbyllur në disa hallka të rënda.

Kështu ndodhte përpara, kurse tani Partia ka krijuar mundësi të tjera, të reja, që edhe vajzat e gratë e malësive të vijnë, siç erdhët ju këtu në këtë kurs, ku për tre muaj rresht u takuat, u njohët, jetuat, biseduat dhe punuat me shoqe, të cilat nuk i kishit parë kurrë më parë. Këtu ju u njohët e u deshët si motra të vërteta, prandaj jam i bindur që kurrë nuk do ta harroni njëra-tjetrën. Ky është një përparim i madh në jetën tuaj. Dhe kjo gjë kështu duhet kuptuar, si një hap i guximshëm përpara jo vetëm juaji, por edhe i prindërve tuaj, i burrave apo i vëllezërve tuaj. Pa mendoni pak se edhe ata, pavarësisht se një pjesë dominin, pjesa tjetër e ka pasur të vështirë t'ju dërgonte. Kishte edhe nga ata që nuk pranonin, jo për gjë tjetër, por se kishin merak për ju se si do të kalonit, ç'do të thoshin në fshat njëri apo tjetri, pasi ju të largoheshit nga familjet. Ishin vallë të drejta këto shqetësime nga

ana e burrave, e prindërve, e vëllezërve tuaj? Unë mendoj se ata kishin të drejtë, prandaj Partia i kupton shqetësimet e tyre. Megjithatë, derisa ata e dëgjuan fjalën e Partisë dhe ju lejuan të vinit në kurs, do të thotë se në ndërgjegjen e tyre është bërë një hap i madh drejt përparimit dhe kjo, gjithashtu, është me shumë rëndësi.

Ju u grumbulluat këtu dhe përfituat shumë jo vetëm nga mësimet që morët, po edhe në mjaft drejtime të tjera. Unë mësova se çështjet e para që ju preokuponin çdo ditë këtu, ishin ato me karakter politik. Kjo, pa dyshim, është shumë pozitive. Është një gëzim i madh që ju keni arritur t'i kuptoni problemet mirë politikisht, sepse në këtë mënyrë njeriu i zgjidh ato me sukses, sado të mëdha e të vështira që të jenë. Kështu na këshillon dhe na orienton përditë Partia me mësimet e saj nëpërmjet bisedave, librave, gazetave, radios etj.

Mund të lindë pyetja se ku e kanë burimin mësimet që Partia i jep popullit. Partia ato i gjen te marksizëm-leninizmi, i gjen te ju, te masat punonjëse, tek eksperiencia e tyre e madhe. Anëtarët e Partisë janë të lidhur ngushtë me popullin. Ata nxjerrin prej tij këtë eksperiencë të madhe politike, e përpunojnë dhe ia japin përsëri popullit, i cili shkon me të përpara dhe zgjidh me sukses të gjitha problemet që i dalin, pa varësisht nga vështirësitë që mund të ndeshë.

Kështu ndodhi me popullin tonë gjatë luftës, të cilit i dolën përpara vështirësi të mëdha politike, por Partia i zgjidhi ato një e nga një me radhë, fitoi luftën, përmbysi pushtetin e feudo-borgjezisë dhe vendos-

si diktaturën e proletariatit, domethënë, pushtetin e klasës punëtore. Kjo ishte një fitore historike me rëndësi shumë të madhe për vendin tonë. Pas vendosjes së pushtetit popullor, tani ne vazhdojmë të ndërtojmë me sukses socializmin në rrugën që na udhëheq Partia. Gjatë gjithë këtyre periudhave Partia u shpjegoi masave shumë gjëra, sqaroi shumë njerëz, gjë që krijoi mundësi të realizonim vepra të mëdha për të mirën e popullit. Partia na mëson, gjithashtu, të mos kënaqemi kurrë me rezultatet e arritura, po të vazhdojmë pa ndërprerë punën për revolucionarizimin e gjithë jetës së vendit e, në radhë të parë, të mendjes së njerëzve, sepse në kokën e tyre ka edhe ndryshk të mbetur nga e kaluara.

Ju e dini se si Partia ka dhënë një rën pas tjetrës orientime të mëdha, që kanë të bëjnë me probleme të arsimit, të emancipimit të gruas, të shtimit të prodhimit, të zhvillimit të mëtejshëm të industrisë, të kontrollit punëtor etj., etj., të cilat i ka përqaftuar me dëshirë mbarë populli ynë.

Le të ndalemi pak tani te çështja që ka të bëjë me emancipimin e gruas. Ky problem qëndron dhe do të qëndrojë si një nga problemet më të rëndësishme të jetës së popullit shqiptar. Në luftën për emancipimin e gruas, në këtë revolucion të madh që po bëhet te ne, vetë ju, gratë, jeni faktori që do të luani rolin vendimtar. Ju keni me vete Partinë, që ju ndihmon dhe do t'ju mbështetë në çdo veprim të drejtë tuajin, prandaj i dëgjoni me kujdes dhe i zbatoni me vendosmëri mësimet e saj të urta, pse kështu do të kapërceni çdo vështirësi që mund t'ju pengojë në rrugën e drejtë. Kë-

to vështirësi mund ta kenë burimin te pikëpamjet e disa njerëzve prapanikë dhe këta më të shumtët janë burra, po mund të jenë edhe gra, sidomos nga ato që nuk kanë qartësi politike dhe që ruajnë mbeturina të shumta ideologjike në ndërgjegjen e tyre. Kjo kërkon që pikëpamjet e njerëzve të tillë për gratë dhe për vajzat të luftohen me punë bindëse, të pandërprerë, me punë politike dhe ideologjike dhe jo me konflikte, se mëmën dhe babanë duhet t'i sqarojmë për këtë problem e jo t'i luftojmë. Ata ne i duam e do t'i duam, po, kur na pengojnë, duhet të përpiqemi, pa u lodhur, t'i bindim e t'i sjellim në rrugën e drejtë të Partisë. Po do të arrijmë vallë t'i sjellim ata në rrugën që duam ne dhe që na mëson Partia? Të jemi plotësisht të bindur se, duke punuar me durim, do t'ia arrijmë qëllimit. Dhe ata, në mos sot, nesër, medoemos do të vijnë në rrugën e Partisë.

Thonë se të moshuarit kanë shumë durim. Dhe kjo është e vërtetë, sepse ata kanë eksperiencë të madhe nga jeta. Po kjo nuk do të thotë se të rinjtë nuk kanë durim. Të rinjtë e të rejat tona janë politikisht të zhvilluara dhe ai që është i përgatitur politikisht, është njëkohësisht edhe i pjekur dhe ai që është i pjekur, ka edhe durim. I riu ynë, i pjekur politikisht, i edukuar me mësimet e Partisë, di dhe do të dijë të ketë durim për të punuar me më të kaluarit nga mosha, për t'u hequr atyre gradualisht mbeturinat e vjetra që kanë në ndërgjegje, ashtu si për çdo gjë, edhe për problemin e emancipimit të plotë të gruas.

Emancipimi i gruas është nga faktorët më të rëndësishëm për përparimin e fshatit dhe të gjithë jetës

së vendit. Kësaj çështjeje Partia i kushton një kujdes të veçantë. Këtë qëllim ka puna e gjithanshme që bën Partia për ngritjen e gruas jo vetëm nga ana ideopolitike, por edhe në të gjitha drejtimet e tjera. Natyrisht, në vitet e para, mundësitë për realizimin e këtij qëllimi nuk kanë qenë aq të mëdha, kurse tani janë duke u krijuar mundësi të shumta.

Ja, për shembull, vitet e kaluara nuk kemi pasur mundësi të organizonim kurse, si ky që kryet ju këtu në Durrës, ndërsa sivjet organizuam edhe në disa qytete të tjera dhe, në vitet e ardhshme, do të hapim edhe më shumë, kështu pjesëmarrja në to do të shtohet. Pra, në qoftë se sivjet nga një fshat i Tropojës ose i Kukësit, për shembull, kanë ardhur 1 ose 2 vajza apo gra, brenda 5 vjetëve duhet të arrijmë që numri i tyre të shtohet 5-6 herë. Kjo është një gjë me rëndësi të madhe. Nga ana tjetër, më pas, do të përpiqemi të organizojmë kurse edhe më të gjata, ku do të kualifikojmë kuadrot. Ju këtu morët disa dijeni, sado të përcipta, për problemet e higjienës ose të infermierisë, mirëpo ne, qysh tani, na duhet dhe do të përpiqemi të kemi në çdo fshat nga një infermiere. Për infermiere, në radhë të parë, duhet të përgatitim gra të reja dhe vajza. Partia dhe Qeveria i kanë krijuar tani të gjitha mundësitë që në vitet e ardhshme të kemi në çdo fshat nga një infermiere, e cila, përveç shërbimeve të tjera, të bëjë punë edhe me gratë dhe vajzat e fshatit, t'i mësojë ato si të ruajnë shëndetin e tyre, të fëmijëve dhe të pjesëtarëve të tjerë të familjes, t'u flasë për higjienën, për pastërtinë etj. Atje ne do të kemi edhe nga një ambulancë të vogël, ku njerëzit

të marrin ndihmën e parë e të shpejtë sanitare dhe profilaktike.

Gjithashtu, në të ardhmen, ne do të hapim një sërë kursesh, ku djemtë e sidomos vajzat e fshatrave të mësojnë, për disa muaj me radhë, jo vetëm në këtë drejtim, por edhe në fusha të tjera. Shumë prej tyre do të shkojnë nëpër aksione të mëdha kombëtare, si: në hekurudha, në punime veprash bujqësore etj., që janë edhe këto një tjetër shkollë e madhe. Tani Partia ka organizuar aksione ku marrin pjesë jo vetëm të rinj e të reja, por edhe të moshuar, që edhe këta të shohin ç'bëhet në vendin tonë. Ky fakt do të ndikojë pozitivisht edhe në gjykimin e tyre për të rinjtë e për të rejat që marrin pjesë në aksione, në kurse e në shkolla që, kur të kthehen në fshat, të mos i shohin veprimet e tyre me syrin e vjetër, të mos flasin keq për ta, apo t'i pengojnë në përpjekjet për të çuar në fshat dijen dhe përparimin. Partia, pra, e gjykon se është shumë mirë që edhe pleqtë e plakat të dalin jashtë fshatrave, të vizitojnë edhe krahina të tjera, të shohin Shqipërinë tonë të bukur, nga Veriu në Jug e nga Jugu në Veri. Kështu do të shikojnë edhe ç'bëhet në krahinat e tjera të atdheut, do të mësojnë si rrojnë, si punojnë, si ndërtojnë e si mendojnë edhe gjatë e do të vëllazërohen me ta. Kjo do të ndihmojë që ata të kthehen në fshatrat e tyre me mendime e ndjenja të reja.

Duke marrë të tilla masa, brenda 5-6 vjetësh, ne do të arrijmë të krijojmë në fshatrat tona një situatë krejt të re, do të na pakësohen thashethemet, fjalët prapa krahëve. bisedat për çështje të kota, të bëra

nga ata që s'kanë punë dhe marrin të tjerët nëpër gojë e që diskutojnë jo pse ajo i preu leshrat kështu, jo pse ajo tjetra hoqi shaminë etj. Natyrisht, këtu në mes tuaj nuk ka gjëra të tilla. Asnjë nga ju nuk i thotë shoqes pse i preu gërshetat, përse u vesh me fustan, apo s'bëri mirë që hoqi shaminë. Ne duhet të përiqemi që një situatë të tillë, si kjo juaja këtu, ta krijojmë kudo, sepse ajo do të jetë edhe një barrikadë kundër thashethemeve. Arsyeja që ngjasin këto, shpjegohet me disnivele që ekziston në mes përgatitjes suaj politike dhe ideologjike dhe masës së grave e të vajzave, që jetojnë në fshat e s'kanë dalë ndonjëherë më tej. Ato vetëm kanë dëgjuar se ç'bëhet, po akoma nuk e marrin dot me mend realitetin, se nuk kanë pasur rast ta shohin Shqipërinë si është. Nga ana tjetër, janë lidhur fort pas disa traditash jo të mira e pas disa zakonesh prapanike, saqë kujtojnë se, po u prishën ato, prishet bota, kujtojnë se, po i preu leshrat cuca, u turpërua përjetë dhe shkeli nderin e saj e të familjes. Mirëpo kjo s'është e vërtetë. Nga kjo cucës nuk i shkelet nderi, përkundrazi, duke shkuar në kurse, në aksione apo në shkolla, asaj i hapen më shumë horizonte, bëhet më e ndërgjegjshme dhe nderi i forcohet më tepër. Kështu, ajo bëhet në çdo drejtim më e aftë dhe luftëtare për të mbrojtur të drejtat e saj dhe, kur kthehet në familje, babai me nënën gëzohen që e shohin të tillë. Mbase në fillim babait të ndonjërës nga ju do t'i vijë pak hidhur kur të shohë që vajza i preu flokët në kurs. Ky shqetësim do t'i vijë jo për gjë tjetër, por se do që të mos thonë për cucën fjalë të këqija, të cilat i thonë ata që kanë mendime të mykura.

Ju, shoqe, kur të shkoni në fshat, t'i keni parasysh këto situata, se atje mund t'ju ndodhin gjëra të tilla, por mos u përkulni, bëni durim dhe punoni me këmbëngulje, se edhe atje nuk do të jeni vetëm. Ju do t'i keni kurdoherë me vete Partinë dhe organizatën e rinisë të udhëhequr nga organizata-bazë. Përpiquni që edhe në organizatën e rinisë të jeni të bashkuara si këtu dhe të shkoni në rregull në mbledhjet e saj. Mund të thotë ndonjëra se babai dhe nëna e ndalojnë të marrë pjesë në mbledhjet e rinisë. Këtë unë nuk e besoj, sepse ata që nuk ju ndaluan të largoheshit tre muaj të tërë nga familja, s'ka arsye t'ju ndalojnë të shkoni një ose dy orë në mbledhjen e rinisë aty, brenda në fshat. Edhe po t'i ndodhë ndonjërës një gjë e tillë, ajo nuk duhet të përkulet, po të përpiqet t'i bindë prindërit. Çdonjëra nga ju duhet të jetë agjitatore e flaktë, t'u flasë njerëzve, edhe prindërve e t'u thotë se vetëm duke ecur në rrugën e bashkimit e të unitetit, si na mëson Partia, duke u grumbulluar si një trup i vetëm, populli mund të bëjë shumë punë të mira. Për të thyer koncepte e paragjykime të vjetra, kërkohen forcë, unitet dhe vullnet i përbashkët, prandaj edhe ju, kudo që të jeni: në organizatën e rinisë, në organizatën e gruas, në atë të Frontit e kudo gjetkë, në udhëheqjen e organizatës-bazë të Partisë në fshat, të luftoni në mënyrë sistematike për t'i bindur njerëzit politikisht. Nëpërmjet kësaj praktike ata do të shohin e do të kuptojnë se me të vërtetë gjatë kohës që kaluat këtu ju keni ndryshuar shumë, keni mësuar gjëra të reja e të dobishme për jetën. Prindërit ju duan shumë, ata janë njerëz të zgjuar, që nuk mund të mos e ma-

rrin parasysh këtë ndryshim tuajin, prandaj, në qoftë se përpara se të vinit këtu keni pasë vënë shami, tani, kur të ktheheni në fshat, mos e vini më atë, se s'kanë për t'ju thënë gjë dhe të mos tërhiqeni në qoftë se ndonjë gojë e keqe ju përflet, po të dini t'i tregoni vendin.

Më treguan se këtu pat ardhur burri i njëjës prej jush për të parë gruan e vet. Ai pa që ajo kishte hequr shaminë dhe për këtë nuk i bëri asnjë vërejtje. Gruaja i tha se do ta merrte me vete shaminë, kur të vinte koha për t'u kthyer në shtëpi, kurse i shoqi, një djalë përparimtar, e këshilloi ta linte shaminë, të mos e vinte më në kokë, gjë për të cilën edhe ajo ishte plotësisht dakord. Megjithatë, ajo shprehu mendimin se do të merrte me vete tutat, po edhe për këto i shoqi i tha të mos i vishte dhe në fshat të kthehej me atë veshje që kishte këtu në kurs. Partia e kishte mësuar këtë djalë të mbante qëndrim të sjellshëm e të drejtë me gruan e vet. Shihni, pra, se nga puna e pareshtur e Partisë konceptet e njerëzve ndryshojnë. Po të gjitha ju, mund të mos gjeni një ambient të tillë dhe mund të ketë rast që të hasni pengesa si në fshat, edhe në familje e, megjithatë, mos u tërhiqni. Këto që ju mësoi Partia këtu, i mbron në rrugë të drejtë, i zbatoni me vendosmëri dhe të jeni të sigurt se njerëzit, gradualisht, do t'ju dëgjojnë, do t'ju kuptojnë. Jam i bindur se këto që mësuat këtu nuk do t'i mbani si një stoli vetëm për vete, po do t'i vini edhe në shërbim të shoqeve e të motrave tuaja të vendlindjes dhe kjo ka shumë rëndësi.

Pra, me shoqet tuaja, që nuk kanë qenë në kurs,

të bisedoni kur të ktheheni në fshat e t'u mësoni, fjala vjen, si të presin e të qepin, si të mbajnë higjienën personale dhe të familjes, si të gatujnë më mirë. Po, pa u mjaftuar me kaq, të punoni që këto mësimet t'i vini në jetë, t'i bëni një jetë të dytë tuajën, se vetëm kështu thyhen shumë paragjykime e mendime konservatore që i kanë qoftë edhe njerëzit e familjes.

Ne me njëri-tjetrin jemi vëllezër dhe motra, prandaj si të mirat, ashtu edhe të këqijat i themi në sy në mes tonë dhe pa druajtje. I nisur nga kjo, dëshiroj të flas diçka për një dobësi që ne e kemi akoma dhe që duhet të luftojmë shumë për ta zhdukur. E kam fjalën për çështjen e pastërtisë, e cila ka rëndësi të madhe për jetën e njeriut. Pastërti do të thotë qytetërim, do të thotë shëndet dhe jo luks. Socializmi synon që njeriu të punojë kurdoherë me nder dhe të rrojë i gëzuar, i shëndetshëm dhe sa më gjatë që të jetë e mundur. Një nga faktorët e zgjatjes së jetës së njeriut dhe që e bën atë të gëzuar e të kulturuar, është edhe pastërtia. Kjo do të thotë të rrosh në ambient të pastër, të hash në mënyrë të pastër dhe trupin ta mbash pastër. Çështja nuk është vetëm të kesh sapun për t'u larë, kryesorja është që mbajtja e pastërtisë të bëhet edukatë e të gjithëve.

Duhet të dini se në vendin tonë vazhdojnë të na vdesin akoma shumë kalamaj, sidomos në malësi, kryesisht për arsye të papastërtisë. Akoma në malësi konsumohet fare pak sapun për frymë në vit. Kjo do të thotë se ne duhet të luftojmë shumë për të rrënjosur, në radhë të parë, tek anëtarët e Partisë dhe të mbarë

rinisë sonë ndjenjën e bukur të pastërtisë. Rrobat mund t'i kemi edhe të vjetra e të arnuara, kjo s'prish punë për shëndetin, mjafton që ato të jenë të pastra. Sapun tani kemi kudo, por edhe po të qëllojë në ndonjë rast që të mos ketë, mund të përdoren në vend të tij finja, kopani, rëra e çdo mjet tjetër pastrimi. Pastërtinë duhet ta vini kudo në rendin e ditës. Të përpqemi që të futim edhe në fshat zakonin e mirë që, të paktën, një herë në javë çdo njeri në familje, kalamani ose i rritur, të lajë trupin. Në kooperativat bujqësore kemi dhënë direktivën që kudo ku janë ndërtuar furrat e përbashkëta, pranë tyre të ndërtohen edhe banjat, të shfrytëzohet zjarri e të ketë vazhdimisht ujë të ngrohtë. Përveç kësaj janë të gjitha mundësitë që në çdo shtëpi të përgatitet ujë i ngrohtë, me të cilin të lahen tërë pjesëtarët e familjes, se trupi i palarë është i prirur për çdo sëmundje. Veç kësaj, për të ruajtur pastërtinë dhe shëndetin e njerëzve, çdo vit duhet të lyhen shtëpitë me gëlqere. Rëndësi të madhe ka, gjithashtu, higjiena e ushqimeve.

Po kështu, për shëndetin ka rëndësi që prodhimet të jenë të bollshme dhe të shumëllojshme. Prandaj është e nevojshme që në çdo kooperativë të realizohen sa më shumë ditë-punë efektive, në radhë të parë, për të prodhuar bukën, pastaj për rritjen e blegtorisë, si dhe për frutat e perimet, ose, siç u thonë ndryshe, zarzavatet. Në malësi nuk para i njohin të tëra llojet e zarzavateve, si: domatet, patëllxhanët, bamjet, karrotat, spinaqin e gjithë të tjerat me radhë. Ju njihni më shumë bulmetin, fasulet, vezët, mishin. Në malësi kanë mish një herë në muaj, bile një herë në dy muaj

ose edhe më rrallë. Ju që mësuar në kurs për rëndësinë e ushqimeve dhe filluar të lexoni për këtë problem, po kuptoni se pjesa më e madhe dhe më e rëndësishme e ushqimeve të njeriut përbëhet nga zarzavatet. Mjekët nuk e këshillojnë të ushqyerit me mish në sasi të mëdha, se një gjë e tillë e dëmton organizmin, kurse zarzavatet janë gjithmonë shumë më të dobishme dhe të domosdoshme për shëndetin e njeriut, prandaj është mirë të përdoren sa më me bollëk. Mirëpo, pikërisht nga këto, ju nuk i mbillni sa duhet në kooperativat tuaja. Prandaj, në këtë drejtim, duhet të bëni një kthesë të fortë dhe, që ta bëni këtë kthesë, duhet të mësoni si t'i përgatitni gjellët me zarzavate.

Këtu në kurs ju morët disa mësimë edhe për çështjet e kuzhinës, por ato janë akoma të pamjaftueshme, prandaj duhet të vazhdoni të mësoni. Rëndësi ka që ato t'i vini në zbatim. Kjo kërkon nga ju të ngulni fort këmbë për këto çështje, jo vetëm në familje, se atje jeni zonja vetë dhe kam besim se kështu do të veproni, por të ndihmoni edhe gratë e vajzat e tjera të fshatit, që edhe ato të mësojnë si të gatujnë. Përpiquni që në kooperativat tuaja të mbillen të gjitha llojet e zarzavateve. Kështu do të krijohen mundësi që në familjet fshatare të përgatiten gjellë më të mira, më të shijshme e më të ushqyeshme se ato që hani tani.

Dëshiroj t'ju këshilloj, gjithashtu, që, me t'u kthyer në fshat, krahas përpjekjeve për të vënë në jetë këto që mësuar në kurs, të keni shumë kujdes e të mos e hiqni veten si disa që u rritet mendja dhe, me

të mbaruar një kurs apo shkollë, lëvdohen përpara të tjerave që akoma s'kanë dalë jashtë fshatit. Unë nuk e besoj të mbahet një qëndrim i tillë nga ana juaj, se ju jeni vajza të thjeshta fshati. Sidoqoftë, jua jap këtë këshillë që të keni kujdes dhe sjelljet e qëndrimet tuaja të jenë të matura e të mos i lëndojnë shoqet e tjera, që kanë mbetur atje. Ju duhet të tregoheni të thjeshta, të dashura e të afrueshme me to, të përpiqeni t'u tregoni atyre se asnjë nga cilësitë tuaja të mira prej vajzash fshati nuk ka humbur pas ardhjes në kurs, përkundrazi, ato karakteristika, si: thjeshtësia, ndershmëria etj., jo vetëm janë ruajtur, po dhe janë shtuar nga dita në ditë. Kjo është e domosdoshme, sepse do të ketë në fshat ndonjë gojë të ligë që, porsa të ktheheni ju nga kursi, do të mundohet të flasë keq për njërën ose për tjetrën. Për të vënë në dukje punën e mirë që u bë këtu në kurs, ju përpiquni të jeni sa më korrekte dhe kështu të tjerat do të marrin shembull nga ju e llafazanëve do t'u mbyllet goja.

Këshilla e dytë që dëshiroj t'ju jap është që në punë të jeni të parat. Kudo ku t'ju caktojnë, të tregoheni të gatshme, më të mobilizuara e më punëtore nga sa ishit, t'u tregoni të gjithëve se, duke ardhur në kurs, ju jo vetëm mësuat gjithë këto gjëra të vlefshme, por edhe punën në kooperativë, në blegtori, në bujqësi, në ara, në mbjellje, në korrje e kudo nuk e harruat, përkundrazi, u bëtë edhe më të zonjat. Dhe është e domosdoshme që këtë zotësi ta thëlloni më tej. Njëkohësisht, përpiquni me këmbëngulje që mësimet, të cilat i morët këtu, të vlerësohen nga organizata-bazë e Partisë e kooperativës, nga kryetari dhe nga

gjithë kooperativistët. Kërkoni t'i vini ato në shërbim të kooperativës për të plotësuar disa nga nevojat më të ngutshme, për të mësuar edhe shoqet tuaja atje. Me këtë dua të them që, në rast se në fshat nuk ka, fjala vjen, infermier, sekretari i organizatës-bazë të Partisë ose kryetari i këshillit popullor t'ju japë juve mundësinë që, në një orë të caktuar, t'i mblidhni gratë e vajzat e fshatit, të cilave t'u flitni për këto që keni mësuar këtu për higjienën, për pastërtinë, për shëndetin etj. Ato që kanë mësuar për rrobaqepësi, t'u mësojnë shoqeve të tyre si pritet e si qepet një jelek, një fustan etj. Për këtë qëllim kooperativa duhet të blejë edhe një makinë qepëse.

Veç keni kujdes të mos shkoni me mendimin që, meqenëse mësuar në kurs diçka për prerje e për qepje, të kërkonit të punoni në kooperativë në këtë profesion e të paguheni me ditë-punë fikse. Me ditë-punë fikse ju mund të punoni pasi të keni arritur një shkallë të lartë përgatitjeje si rrobaqepëse, që kooperativës t'i bëni një shërbim me të vërtetë të madh. Këtë e theksoj se, me një kurs kaq të shkurtër, nuk mund të shërbesh si rrobaqepëse. Për t'u bërë rrobaqepëse e mirë, përveç këtij kursi, duhet kaluar në disa kurse të tjera më të larta. Pasi të kryhen edhe këto, atëherë mund të themi se jeni në gjendje t'ia dilni mbanë për të përballuar punën e rrobaqepëses, për të plotësuar nevojat që kanë në këtë drejtim të gjitha familjet e kooperativës së bashku. Pas kësaj kooperativistët mund të vijnë të presin te ju rroba për fëmijë, për gra e për burra dhe kështu të krijohet në kooperativë një dhomë e veçantë rrobaqepësie. Vetëm në këtë rast

ndonjëra nga ju mund të bëhet punëtore rrobaqepëse dhe të paguhet me ditë-punë fikse. Megjithatë, të mos përtoni, të punoni vullnetarisht për t'u mësuar edhe shoqeve të kooperativës ato që mësuar vetë.

Jam i bindur se ju në fshatrat tuaja, tani pas kryerjes së këtij kursi, do t'i bëni një shërbim të madh Partisë. Në radhë të parë, ju do të çoni te shoqet tuaja dhe te të gjithë njerëzit e kooperativave frymën revolucionare me të cilën ju edukuan Partia dhe mësueset e pedagoget që keni pasur gjatë këtyre muajve. Mësueset tuaja nuk ndienë kurrë lodhje për t'ju mësuar, për t'ju edukuar dhe për t'ju sqaruar çdo gjë. Partia ka besim të madh se ju do të bëni një punë shumë të mirë në fshat. Prandaj, çdo kooperativë ku jetoni e punoni, duhet të nxjerrë përfitime sa më të mëdha pas kthimit tuaj, sidomos, në drejtim të zhvillimit e të emancipimit të mëtejshëm të gruas, për të cilën kemi vënë tani gjithë kujdesin tonë.

Dëshira e madhe e Partisë është që gruaja kudo të ecë përpara. Ju që u edukuat këtu, të jeni kurdoherë nga pionieret e para në këtë lëvizje revolucionare. Në fshat ju do të gjeni shoqe të tjera, disa nga të cilat kanë punuar në hekurudhë, të tjera kanë vizituar e kanë parë Jugun, apo kanë vajtur në fshatra të tjera, do të gjeni gra e vajza që kanë bërë ndonjë shkollë jashtë fshatit etj., prandaj, së bashku me këto gra e vajza të përparuara, përpiquni të krijoni një situatë të favorshme për gruan, me qëllim që Partisë t'i krijohen mundësi për një përparim të shpejtë në emancipimin e gruas. Të punoni e të nxirrni për në

kurse e për në shkolla shoqe të tjera, gra e vajza që edhe ato të arrijnë të zhdukim gradualisht pengesat, të cilat ushqehen nga mbeturina të kohëve të kaluara.

Ne jemi të sigurt se në vitet e ardhshme gratë e reja e vajzat do të shkojnë më me lehtësi në kurse. në aksione, në shkolla etj., sepse populli po ngrihet çdo ditë e më shumë, sidomos politikisht. Dalja juaj nga fshati ka kurdoherë për qëllim të zhvillojë mendjen tuaj, të forcojë diturinë dhe aftësitë tuaja, të cilat do të ndihmojnë që kooperativa të zhvillohet sa më shpejt dhe kështu do të arrijmë të vëmë në jetë një nga orientimet e Partisë, të ngushtojmë gradualisht dallimin në mes qytetit dhe fshatit.

Ju e dini se gjatë këtyre 20 e ca vjetëve pas Çlirimit, si kudo, edhe në fshatrat tona, janë bërë përparime të mëdha në çdo drejtim dhe jo vetëm në zona fushore, por edhe lart në malësi. Megjithatë, na mbetet akoma shumë për të bërë. Tash që ju mbaruat kursin, me gëzim të madh do të ktheheni përsëri në fshat pranë prindërve e pranë familjeve tuaja. Por mos e harroni këtë kohë të bukur që kaluat këtu së bashku, kujtojeni atë dhe përpiquni që të bëhet për ju një stimul, një shtytës për të ecur kurdoherë përpara. Dhe, krahas kësaj, të mos shuhet kurrë në zemrat tuaja, dashuria për fshatin ku keni lindur e jeni rritur, përkundrazi, ajo të shtohet gjithnjë e më shumë. Kështu na mëson Partia.

Politika e Partisë synon që fshatin tonë ta bëjmë gjithnjë më të bukur e të përparuar, sa edhe qytetin, që përparimi i qytetit të shkojë deri në fshatrat tona

më të thella të malësisë. Në këtë drejtim ne po zhvillojmë një luftë të pandërprerë.

Ju keni mësuar se kudo, në çdo fshat të vendit tonë, do të ketë së shpejti dritë elektrike. Ky është një sukses me rëndësi të madhe. Elektriку do të sjellë radion në të gjitha fshatrat ku gjer tani s'ka dritë elektrike. Më vonë, veç radios, Partia në fshat do të sjellë edhe televizorin. Ju me ca vështirësi keni shkuar gjer tani në shtëpinë ose në vatrën e kulturës, po, kur të keni në fshat televizorin, do të shikoni kurdoherë shfaqje artistike të organizuara në Tiranë dhe në kra-hina të tjera të vendit, pra, në sallën e kulturës nuk do të ketë vend të lirë për të nderitur, se të tërë, pas punës, jo vetëm të rinjtë e të rejtat, pra, djemtë e vajzat, po edhe burrat, edhe gratë, deri edhe pleqtë e plakat, do të venë të çlodhen e të argëtohen. Të tëra këto ne do t'i realizojmë patjetër, sepse vendimet për të janë marrë në rrugën e drejtë të Partisë.

Ju po e shikoni vetë ç'përparime të mëdha po bëhen kudo në vendin tonë. Situata moralo-politike e popullit forcohet, ekonomia zhvillohet, industria jonë zgjerohet, bujqësia shkon çdo vit e më mirë. Kemi shpresa të mëdha që sivjet të marrim prodhime të mbara bujqësore se edhe shiu që ra ditët e fundit, bëri shumë dobi.

Të gjitha këto rezultate që kemi arritur, u dedikohen vijës së drejtë të Partisë, vendosmërisë së popullit, ngritjes së tij politike dhe ideologjike, forcës dhe vendosmërisë së rinisë, të grave e të të rejave tona, që janë në unitet të plotë me Partinë, që e kuptojnë dhe e zbatojnë drejt vijën e saj. Kështu duhet të

qëndrojmë ne çdo ditë, të mobilizuar si në luftë dhe, në fakt, si në luftë jemi, se armët për asnjë çast nuk i lëshojmë nga dora, se e dimë që kemi armiq të shumë të rreth e rrotull që nuk na e duan të mirën. Po ata nuk kanë ç'të na bëjnë dhe sa më të bashkuar e të fortë të jemi ne, aq më të dobët bëhen ata. Armiqtë e Shqipërisë dhe të socializmit, imperialistët dhe revizionistët, janë të dobët përpara forcave revolucionare, që gjithnjë shtohen dhe forcohen.

Revizionistët modernë janë në grindje të mëdha me njëri-tjetrin, gjë që shkaktohet nga rruga antimarksiste e antipopullore që ata ndjekin. Por popujt dalngadalë po i kuptojnë se cilët janë e ç'qëllime kanë, prandaj gjithnjë e më shumë i kundërshtojnë. Popujt luftojnë të organizohen dhe do të vijë një ditë që do të hidhen edhe në luftë kundër klikave tradhtare revizioniste, që janë në fuqi në Bashkimin Sovjetik, në Jugosllavi, në Bullgari, në Rumani etj.

Krejt ndryshe është situata në vendin tonë, ajo është kurdoherë në ngjijtje. Ky realitet u detyrohet shpirtit revolucionar të popullit dhe udhëheqjes së drejtë të Partisë. Partia jonë është një parti revolucionare marksiste-leniniste; ajo ndjek një rrugë të drejtë, prandaj edhe uniteti i popullit me të është i çeliktë. Këtë unitet ne duhet ta ruajmë e të punojmë me të gjitha forcat që ta kalitim çdo ditë e më shumë. Për këtë qëllim është e domosdoshme të jemi më këmbë ditë dhe natë, të luftojmë pa u lodhur kundër mbeturinave të botës së vjetër në ndërgjegjen e njerëzve, të punojmë për të ruajtur unitetin e popullit dhe për të çuar fjalën e Partisë deri në skajin më të

largët të vendit, të luftojmë pa u lodhur për të prodhuar më shumë, për të mësuar më shumë dhe për të rritur sa më shumë fuqinë mbrojtëse të atdheut.

Prandaj, shoqe dhe motra, në emër të Partisë dhe të të gjithë shokëve, unë, me këtë rast, ju uroj juve shëndet dhe sukses në punë. U çoni shumë të fala prindërve, burrave dhe vëllëzërve. Edhe një herë dëshiroj t'ju përsërit që, këto mësimë që morët këtu, le t'ju shërbejnë për t'u hedhur të parat në punë në fshatrat tuaja. Të jeni kurdoherë të gatshme të shkoni kudo ku t'ju kërkojë Partia, qoftë në kurse të tjera ose në çdo punë tjetër. Kështu, me forcat tona, me forcën e popullit, nën udhëheqjen e Partisë, do të bëhet më e bukur jeta e njerëzve tanë dhe kjo do të vijë vazhdimisht duke u përmirësuar.

Rroftë Partia!

Rroftë rinia!

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

KLASA PUNËTORE FRANCEZE NË LUFTË PËR TË DREJTAT E SAJ

Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»

24 maj 1968

Agjencitë borgjeze të lajmeve po u bien këto ditë me sa fuqi kanë kambanave të alarmit: «Franca është zhytur në kaos dhe në shqetësim të madh», «nëntë milionë punëtorë në grevë», «punëtorët pushtojnë fabrikat dhe ngrenë flamurin e kuq», «Franca është shkëputur nga bota e jashtme», «trenat e anijet qëndrojnë në vend, në aerodromet nuk ndihet zhurma e motorëve të aeroplanëve, në shkollat nuk bëhet më mësim» etj., etj. Me shqetësim të madh dhe me habi ato bëjnë pyetjen se si mund të ndodhin këto tronditje në Francë, që deri më sot konsiderohej si vendi i vetëm kapitalist me njëfarë stabiliteti ekonomik, që kishte mbetur jashtë krizës financiare, e cila ka mbërthyer Anglinë, SHBA-në dhe vendet e tjera perëndimore, si vendi ku pushteti borgjez dukej i konsoliduar, ku klasat sunduese dukeshin se kishin mundur të krijonin një sistem të tërë aleancash, kompromisesh e lëshimesh për të mënjnuar dhe për të paralizuar klasën punëto-re.

Në të vërtetë i gjithë prosperiteti i reklamuar nga borgjezia franceze rezultoi se ishte një mit i ndërtuar mbi një bazë false, se degjenerimin dhe kalbëzimin e regjimit kapitalist të Francës së sotme e mbulonte vetëm një lustër e jashtme e dobët. Është fakt se në gjirin e klasës punëtore franceze ziente një pakënaqësi e madhe kundër sundimit të padurueshëm të monopoleve, e cila nuk mund të mbytej as me shtypjen e me demagogjinë e borgjezisë, as me reformizmin dhe me tradhtinë e revizionistëve modernë e të socialdemokracisë së vjetër. Grevat e tanishme, më të mëdhatë që nga mbarimi i Luftës së Dytë Botërore, treguan se klasa punëtore nuk mund të pajtohej më gjatë me shtypjen dhe me shfrytëzimin e egër të monopoleve, se ajo nuk mund të pajtohej me diskriminimin shoqëror e politik që borgjezia ushtron ndaj saj, se ajo kërkon të drejtat e mohuara, kërkon garanci për punë, për sigurimet shoqërore, për pensionet, kërkon të thotë fjalën e vet dhe t'i dëgjohet zëri në zgjidhjen e problemeve ekonomike, shoqërore e politike të vendit.

Punonjësit francezë, të mbajtur me premtime mashtruese për një kohë të gjatë, i flakën tej një pjesë të mirë të iluzioneve dhe, kundër dëshirave të kreëve sindikalistë reformistë, u ngritën për të kërkuar ndryshime rrënjësore, për kufizimin e pushtetit të monopoleve, për një sistem pune demokratik, që të garantojë minimumin e jetesës së punëtorit dhe të familjes së tij. Me grevat e punëtorëve bashkohet edhe lëvizja e fuqishme e protestës së mijëra studentëve universitarë, të cilët ngrenë zërin e tyre kundër sistemit dekadent të arsimit dhe të pasigurisë së të ardhmes së tyre.

Se ç'rrugë do të marrin ngjarjet dhe sa do të plotësohen kërkesat e punëtorëve e të studentëve nuk mund të përcaktohet që tani. Kjo varet nga shumë faktorë, të cilët mund t'i japin drejtime të papritura gjendjes. Lufta e fortë, që klasa punëtore franceze po bën tani kundër regjimit kapitalist të monopoleve, e ka futur këtë në vështirësi të mëdha, të cilat nuk mund të kapërcehen lehtë.

Por grevat e mëdha të tanishme treguan se ç'forcë kolosale ekziston në klasën punëtore, e cila po të jetë e ndërgjegjshme dhe të kuptojë si duhet rolin e saj vendimtar, po të jetë e bashkuar dhe këmbëngulëse, do të bëjë që problemet e mëdha që kanë mbërthyer Francën të mos zgjidhen ashtu siç mendojnë dhe përpiqen kapitalistët-monopolistë dhe lakenjtë e tyre — revizionistët e socialdemokratët, por të zgjidhen në interes të punonjësve, të demokracisë e të përparimit.

Kundër klasës punëtore, për shuarjen e luftës dhe për nënshtrimin e saj veprojnë jo vetëm borgjezia e monopolet, por edhe revizionistët e reformistët e tjerë, të cilët luajnë hapur rolin e sabotatorëve e të grevëthyesve. Lufta e studentëve universitarë dhe grevat e mëdha të punëtorëve u plasën në duar si bomba të papritura qendrave të sindikatave revizioniste e socialdemokrate. Grevat shpërthyen jo vetëm pa iniciativën e këtyre sindikatave, por edhe kundër vullnetit të tyre. Vetëm kur masat u ngritën më këmbë dhe nuk i dëgjuan këshillat e tyre për «përmbajtje» e «moderim» dhe kur e ndienë në palcë rrezikun e izolimit e të demaskimit të plotë, krrerët e partisë revizioniste franceze, të Konfederatës së Përgjithshme të Punës, që

drejtohet prej saj, socialdemokratët e të tjerët u detyruan të pranenin faktin e kryer dhe të përkrahin me fjalë lëvizjen e madhe të rezistencës së punëtorëve e të studentëve.

Por edhe tani qëndrimi i tyre është fund e krye kapitullues, sabotues, tradhtar. Ata, duke bashkëpunuar hapur me borgjezinë dhe me pushtetin e saj, mundohen me të gjitha mjetet që kanë në dispozicion, t'i frenojnë punonjësit, t'i përmbajnë «brenda rregullit», që grevat të mos dalin, në asnjë mënyrë, jashtë kuadrit «rivendikativ e sindikal», siç shpallte një deklaratë e Konfederatës së Përgjithshme të Punës.

Ndërsa borgjezia përdor presionin ekonomik dhe dhunën për të mposhtur revoltën e studentëve dhe grevat e punëtorëve, revizionistët e socialdemokratët u shkojnë në ndihmë monopoleve, duke përçarë unitetin e masave dhe duke u përpjekur që lëvizja të qëndrojë brenda legalitetit borgjez. Ata ngritën në parlament çështjen e heqjes së besimit ndaj qeverisë, për të krijuar iluzionin se vetë punëtorët, fshatarët, studentët me aksionet e me veprimet e tyre nuk mund të zgjidhin asgjë, se kërkesat e tyre mund t'u plotësohen vetëm nga lart, nga parlamenti, nga qeveria, nga ai ose nga ky ministër, nga ky ose nga ai institucion qeveritar.

Revizionistët e dinë mirë se lufta greviste është një mjet i fuqishëm lufte i klasës punëtoare, se ajo, edhe pse në bazë të saj ka zakonisht rivendikime ekonomike, merr gjithnjë një karakter politik, qoftë edhe për të vetmin fakt se vë në luftë drejt për së drejti proletariatin me borgjezinë. Çdo grevë, e çfarëdo naty-

re qoftë e sidomos me përpjesëtime dhe me intensitet të tillë, siç është ajo që ka shpërthyer tani në Francë, ndihmon në ashpërsimin e luftës politike, në luftën e madhe politiko-ideologjike të proletariatit kundër borgjezisë kapitaliste dhe pushtetit të saj. Greva nuk është kurrë një veprim i shkëputur për plotësimin e një nevoje në vetvete, por pjesë përbërëse e luftës klasore të proletariatit kundër borgjezisë, e përgatitjes së revolucionit për të përmbysur kapitalizmin.

Pikërisht kësaj i tremben revizionistët, socialdemokratët e reformistët e tjerë francezë. Ata kanë shumë frikë nga politizimi i grevës, se mos proletariati francez, në luftë me borgjezinë, edukohet edhe politikisht e ideologjikisht. Prandaj ata bëjnë një luftë të ashpër dhe pa princip kundër të gjithë atyre elementëve të shëndoshë revolucionarë në gjirin e klasës punëtore, që përpiqen, në luftë e sipër, ta edukojnë proletariatin edhe politikisht, ta bëjnë atë të shohë ku është burimi i shtypjes e i shfrytëzimit kapitalist, cilët janë miqtë dhe armiqtë e tij. Vija oportuniste e kapitulluese, që ndjekin tani krerët e partisë revizioniste franceze, liderët e sindikatave të ndryshme dhe reformistët e çdo kallëpi, duket fare qartë. Nga presioni i bazës dhe në pamundësi që t'i shpëtojnë atij, këta grevëthyes profesionistë mundohen të rrëmbejnë drejtimin e grevave dhe, në bashkëpunim me kapitalistët e me pushtetin e tyre, të bëjnë çmos për të thyer rezistencën e vullnetin e punonjësve.

Në punën e tyre sabotuese, antipunëtore e kundërrevolucionare revizionistëve dhe gjithë grevëthyesve të tjerë francezë u vijnë në ndihmë edhe udhëhe-

qësit sovjetikë. Njëpërmjet një artikulli të gazetës «Izvestia», botuar më 21 maj, ata kundërshtojnë hapur lëvizjen e fuqishme të klasës punëtore franceze dhe marrin nën mbrojtje monopolet e mëdha kapitaliste dhe pushtetin e tyre, me të cilët janë aleatë të ngushtë. Në mënyrë aspak të maskuar fajin për gjendjen e rëndë që është krijuar tani në Francë ata ua hedhin disa «aventurierëve» dhe «ekstremistëve». Pikërisht këstu shkruajnë këto ditë edhe «Figaro», «Oror» e shtypi tjetër i patronatit francez. Ky është një avaz i njohur i borgjezisë dhe i revizionistëve sovjetikë dhe ata nuk janë origjinalë. E re në këtë mes është se ata zbulojnë fytyrën e tyre të vërtetë si grevëthyes ndërkombëtarë, si njerëz që përkrahin në ditët e këqija vëllezërit e tyre të klasës borgjeze. Në një lajm të agjencisë franceze të lajmeve thuhej se «Vëzhguesit në Moskë janë të mendimit se qeveria sovjetike ngurron të kritikojë një shtet, të cilit i çmon si politikën e jashtme, ashtu edhe personalitetin e kryetarit të tij», se «Tani Bashkimi Sovjetik i shmanget vullnetarisht shfrytëzimit të temave si ato që bëjnë fjalë për falimentimin e kapitalizmit dhe për epërsinë e socializmit». Ky është një falënderim i hapët që borgjezia franceze u bën revizionistëve sovjetikë, të cilët janë të shqetësuar për gjendjen në Francë, ashtu si «çdo herë që kërcënohet një statukuo e gjykuar prej tyre si e leverdishme».

Monopolet kapitaliste dhe krerët tradhtarë të klasës punëtore franceze do të bëjnë çmos që të merren vesh midis tyre për të thyer grevën dhe për të bërë, në një mënyrë ose në tjetrën, ndonjë kompromis të ndyrë. Në këto kushte klasa punëtore franceze nuk

mund të mos bëjë bilancin e grevës së saj të fuqishme, të mos sqarojë pozitën e vet në jetën politike, ekonomike e shoqërore të Francës, të mos analizojë e të mos sqarojë qëndrimin dhe sjelljen e krerëve reaksionarë të sindikatave, që nga revizionistët, të socialdemokratët e deri te katolikët e të tjerët.

Klasa punëtore franceze mund të fitojë dhe të plotësojë tërësisht kërkesat e saj, në qoftë se ajo do të dijë të nxjerrë mësimet e nevojshme politike nga grevat e tanishme, në qoftë se do të vazhdojë të rezistojë dhe të luftojë me këmbëngulje për të drejtat e saj ekonomike e politike, të shikojë qartë tradhtinë e krerëve revizionistë, socialdemokratë, reformistë e të tjerë, të cilët mbajnë akoma frenat e partive të ashtuquajtura të klasës punëtore, të sindikatave dhe të organizatave të ndryshme shoqërore. Asaj do t'i duhet medoemos të ndajë shapin nga sheqeri, të braktisë udhëheqësit tradhtarë revizionistë, socialdemokratë reformistë dhe të nxjerrë nga gjiri i saj udhëheqës të rinj, revolucionarë konsekuentë e të pamposhtur për çështjen e proletariatit.

Në mënyrë të veçantë, në situatën e tanishme, shumë të favorshme për luftën klasore të proletariatit, që është krijuar në Francë, probleme të rëndësishme qëndrojnë përpara marksistë-leninistëve dhe forcave të shëndosha revolucionare. Duke marrë pjesë aktive në këto greva dhe duke mbështetur fuqimisht rivendikimet e punëtorëve, duke u dalluar jo vetëm me veprimet e tyre të guximit dhe të vendosmërisë, por edhe me qartësinë e tyre politike e ideologjike, ata demaskojnë vijën dhe qëndrimet reaksionare të krerëve dhe

të qendrave sindikale oportuniste, goditin dhe demaskojnë manovrat e taktikat e atyre për të thyer grevën, për ta frenuar atë, ose për t'u dhënë minimumin e rivendikimeve të punëtorëve. Në qoftë se klasa punëtoare do të qëndrojë e bashkuar dhe do të luftojë që, sipas mësimëve të marksizëm-leninizmit, të sigurojë aleancën me fshatarësinë punonjëse, me studentët e me rininë punëtoare dhe me gjithë shtresat e shfrytëzuara të popullsisë, aksionet e saj të mëdha e të vogla, lufta e saj do të përfundojnë me sukses. Vetëm kështu mund të plotësohen kërkesat e saj, vetëm kështu mund të imponohet vullneti i saj.

Sigurisht, një punë e tillë nuk është e lehtë dhe as mendohet se ajo mund të kryhet brenda periudhës që zgjat një grevë. Por baza që mund të hedhin revolucionarët gjatë ngjarjeve të tanishme, të cilat nuk do të shlyhen kollaj nga mendja e punonjësve, kanë një rëndësi të madhe për të ardhmen. Çdo pozitë të re atyre u duhet ta fitojnë me luftë, me rrugë revolucionare, duke mbrojtur me vendosmëri parimet e marksizëm-leninizmit dhe duke i zbatuar ato drejt në situatat konkrete që krijohen.

Revizionistët francezë, të cilët janë trembur më shumë se borgjezia nga përpjesëtimet e mëdha që morën grevat, përpiqen t'i mbajnë punëtorët të izoluar, të veçuar dhe larg kontakteve me shtresat e tjera të pakënaqura të popullsisë. Sidomos, një qëndrim të tillë ata mbajnë kundër studentëve, lëvizja e të cilëve, aktualisht, përshkohet nga disa parulla që kanë një karakter të theksuar politik. Në të vërtetë, revizionistët nuk e kanë hallin te roli udhëheqës i klasës punëtoare,

por ata, për t'i shërbyer sa më mirë borgjezisë, kërkojnë të përçajjnë masat e ndryshme që luftojnë kundër sundimit të monopoleve, duan ta lënë klasën punëtore pa aleatë dhe, për më tepër, ta vënë në konflikte artificiale me ta. Është detyrë e komunistëve të vërtetë, e revolucionarëve dhe e të gjithë elementëve të ndërgjegjshëm të proletariatit të forcojnë dhe të kalitin në luftën e përbashkët unitetin e klasës punëtore me masat e tjera punonjëse të qytetit e të fshatit, me studentët dhe me rininë punëtore, me të gjithë ata që, nën drejtimin e domosdoshëm të klasës punëtore, janë të vendosur të thyejnë shtypjen e sundimit të monopoleve e të borgjezisë.

Ngjarjet e fundit në Francë vërtetojnë nevojën se jo vetëm atje, por edhe në shumë vende të botës kapitaliste proletariati duhet të organizohet rishtaz, të udhëhiqet nga ideologjia e tij e vërtetë marksiste-leniniste për të kryer revolucionin dhe për të thyer sistemin e fuqishëm të aparateve politike, ekonomike e shoqërore, që borgjezia, socialdemokracia dhe revizionistët i kanë krijuar për të mbajtur në robëri klasën punëtore.

Hovi revolucionar i klasës punëtore të lavdishme franceze, fryma luftarake e studentëve dhe e punonjësve të tjerë kanë ngjallur simpati dhe admirim të madh në të gjithë botën. Me punonjësit francezë janë solidarë të gjithë vëllezërit e tyre të klasës, kudo që ndodhen, të gjithë ata që luftojnë për çlirimin e plotë të klasës punëtore dhe për ndërtimin e socializmit, të gjithë ata që luftojnë për lirinë e për pavarësinë e popujve, kundër imperializmit dhe shërbëtorëve të tij

— socialreformistëve, revizionistëve e të tjerëve. Populli shqiptar, klasa e tij punëtore e përshëndetin dhe e përkrahin me gjithë zemër luftën e drejtë të punonjësve francezë kundër monopoleve dhe pushtetit të tyre shtypës. Shembulli francez do të jetë frymëzues edhe për vendet e tjera kapitaliste perëndimore. Ai shënon fillimin e një ngritjeje të re të lëvizjes punëtore në vendet e mëdha kapitaliste, e cila, në të ardhmen, do të ketë, me siguri, zhvillime të reja edhe më të rëndësishme.

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 124 (6163), 24 maj 1968

Botohet sipas librit: «E vërteta marksiste-leniniste do të triumfojë mbi revizionizmin», vëll. VIII, f. 139. Tiranë, 1969

**PUNËTORËT T'I KUPTOJNË MIRË DETYRAT,
ROLIN DHE RËNDËSINË E MADHE
TË KLASËS**

*Nga biseda me punëtorë, me kooperativistë
e me kuadro të Rubikut*

27 maj 1968

Pasi u takua me punëtorët e Ndërmarrjes Minerare të Rubikut dhe me kooperativistë të kësaj zone dhe pas vizitës që bëri në Uzinën e Përpunimit e të Rafinimit të Bakrit, shoku Enver zhvilloi në klubin e ndërmarrjes një bisedë shumë të ngrohtë me punëtorë e me drejtues të uzinës, të Ndërmarrjes Gjeologjike, me kooperativistë e me kuadro drejtues. Në fillim, shoku Enver bisedën e nisi me disa pyetje për punën e nëse punëtorët kishin ndonjë kërkesë ose dëshirë për të shprehur. Pasi dëgjoji disa punëtorë, ndër të tjera, shoku Enver tha:

Vërejtja e shokut minator se këtu te ju kam ardhur rrallë, është e drejtë. Kjo kritikë që më bëhet zë, si të thuash, vendin e një fletërrufeje të pashkruar. Pra, fletërrufetë nuk janë të dobishme vetëm kur u drejtohen punonjësve të thjeshtë, por vlejné shumë,

sidomos, kur u adresohen drejtuesve, deri edhe Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të Partisë, siç bëri këtu, në rastin konkret, një shok minator.

Ju punëtorë e kooperativistë mund të bëni shumë fletërrufe e kritika për punën tonë, për punën e drejtuesve në qendër. Nuk ka përse të druheni për këtë e zakonisht punëtorët nuk kanë druajtje. Prandaj, në qoftë se keni parë që këtu te ju diçka nuk ecën mirë, për arsye të ndryshme, apo pse mund të bëhen pengesë drejtorja, ministritë përkatëse ose aparatet e Partisë dhe të pushtetit në rreth e në qendër, na e thoni që të marrim masa dhe të bëjmë korrigjimet e nevojshme.

Ashtu siç më bëtë ju me të drejtë një fletërrufe, më lejoni tani t'ju bëj edhe unë një kritikë, sidomos shokëve drejtues, që «nuk më lënë» të flas shtruar, si në rrogoz, me punëtorët, me qëllim që ju të më thoni lirisht të metat e dobësitë që ekzistojnë në kolektivin tuaj dhe të më paraqitni nevojat që keni. Këtë e them, pse, shpesh, kur shkoj në bazë dhe pyes si shkojnë punët, të tërë më përgjigjen: «Shumë mirë». Kështu unë dëgjoj vetëm fjalë të mira dhe asnjë të metë. Natyrisht, kjo nuk është e drejtë, pse e vërteta është se ne, bashkë me sukseset, kemi edhe të meta. Prandaj, kur shkoj në bazë, shokët punëtorë duhet të më flasin edhe për të mirat, por edhe për ato që nuk ecin, pra, të më vënë në dijeni edhe për anët negative, të më flasin hapur për punët, për njerëzit e për qëndrimet e tyre etj.

Dëshiroj, gjithashtu, që, kur shkoj në bazë, të bëhen më pak zhurmë e brohoritje në adresën time dhe

të kemi më shumë bisedime të hapëta pune. Dashuria për Partinë dhe për udhëheqjen nuk tregohet vetëm duke thirrur e duke duartrokitur për to, po edhe duke diskutuar seriozisht për problemet, duke rrahur së bashku mendimet për zgjidhjen e tyre, duke qarë hallet, siç thotë populli. Në këto takime duhet të flitet më pak për ato punë që na venë mirë dhe më shumë për të tjerat, për të metat e dobësitë që kemi, se akoma ka punë që s'na ecin si duhet.

Po përse ndodh kjo? Këtë duhet të na e thoni ju, se faj për këtë kemi edhe ne, por keni edhe ju, se nuk e ngrini zërin t'i kritikoni ata që nuk kanë ardhur t'i rrahin me ju problemet, shqetësimet e punës, të mendojnë e të djersijne bashkë me ju për rrugët e zgjidhjes, për mënyrën e realizimit etj. Të flisni hapur për ta, qofshin nga qendra ose nga rrethi, qofshin ministra apo sekretarë të komitetit të Partisë, qofshin kryetarë a nënkryetarë të pushtetit e të tjerë, që ju kanë premtuar se do t'i studiojnë dhe do t'i zgjidhin këtë ose atë çështje, por, në fakt, i kanë lënë dhe ato kanë mbetur pa u zgjidhur. Për atë gjë që s'ka mundësi të bëhet, shokët e Partisë dhe të pushtetit duhet, dhe është më mirë, t'ju thonë hapur, qysh në fillim, sesa t'ju lënë me shpresa, t'ju premtojnë se do ta studiojnë dhe, në fakt, pastaj të mos bëhet asgjë.

Rëndësi të madhe kanë edhe marrëdhëniet që duhet të ekzistojnë në mes punëtorëve dhe drejtuesve, si dhe kuptimi i drejtë i këtyre marrëdhënieve. Kryeinxhinieri juaj më vuri në dijeni se në marrëdhëniet tuaja nuk ka ndonjë gjë që s'shkon dhe kjo është shumë e mirë. Duhet të punohet vazhdimisht që punë-

torët t'i kuptojnë drejt dhe mirë detyrat dhe rolin e tyre të madh, ashtu siç duhet t'i kuptojnë mirë detyrat e tyre funksionarët, drejtorët, udhëheqësit. Uzina, e Përpunimit dhe e Rafinimit, miniera juaj apo kooperativat bujqësore të kësaj zone të Rubikut nuk janë as të drejtorit, as të kryeinxhinierit, as të kryetarit të kooperativës apo të agronomit, ato janë pronë kolektive e klasës punëtoresh, e kooperativistëve, ato janë, pra, njëkohësisht të punëtorëve, të kooperativistëve, të drejtorëve, të llogaritarëve, të intelektualëve etj., me një fjalë, të mbarë popullit. Prandaj duhet të administrohen e të drejtohen në bazë të ligjeve, zbatimi me rreptësi i të cilave u shërben interesave të klasës punëtoresh, të fshatarësisë dhe të inteligjencies sonë.

Por ka, aty-këtu, ndonjë shok që, kur ngrihet në përgjegjësi e bëhet, bie fjala, drejtor, mendon se është ai i vetmi përgjegjës për planin dhe e heq veten sikur është kompetent për çdo punë. Një mendim i tillë është krejt i gabuar. Këtë fakt çdo njeri duhet ta shikojë me partishmëri dhe me thjeshtësi, sepse caktohet drejtor për disa cilësi pozitive dhe zotësi që ka: mund të jetë, fjala vjen, organizator i mirë, ose ka mbaruar një shkollë, ose është inxhinier apo njeri me horizont të gjerë, pra, është i aftë të drejtojë, të organizojë dhe të nxitë të tjerët të punojnë. Kushdo që emërohet drejtor duhet të punojë më shumë dhe me aftësitë e tij të kontribuojë që i gjithë kolektivi të ecë përpara. Natyrisht, drejtori mban përgjegjësi përpara Partisë dhe shtetit për gjithçka ndodh e bëhet në ndërmarrje, megjithatë, ai nuk duhet të thotë kurrë se është atje i vetmi përgjegjës, kurse të tjerët nuk

janë gjë. Një drejtues që mendon kështu, gabon. Ai ka me të vërtetë përgjegjësitë e tij përsa i është ngarkuar, por bashkë me të ka përgjegjësi edhe kolektivi. Një drejtor mund të mendojë kështu vetëm kur shumë gjëra nuk i kupton akoma drejt dhe kujton se, meqë u bë drejtor, e gjithë barra e përgjegjësisë bie mbi të. Por barra bie kryesisht mbi punëtorët, sepse ata janë forca vendimtare dhe pa ta, në asnjë mënyrë nuk mund të ecë përpara prodhimi, të realizohet plani. Pa punëtorët nuk ka prodhim, nuk ka drejtor, pa punëtorët makineritë janë vetëm hekura, që nuk vlejnë asnjë grosh.

Dhjetë milionë punëtorë janë hedhur këto ditë në greva të mëdha në Francë, prandaj jeta e këtij vendi të madh është paralizuar. Nga kjo njerëzit nuk gjejnë bukë të hanë, sepse transporti është ndërprerë, nuk ka energji elektrike, furrat nuk pjejnë, nuk ka gaz dhe lëndë të tjera djegëse etj., pra, jeta e vendit është paralizuar. Shihni ç'forcë të madhe ka në gjirin e saj klasa punëtore! Prandaj te çdo drejtues duhet të rrënjoset koncepti i drejtë se klasa punëtore, në fabrikë, në uzinë e kudo është forca kryesore, është gjithçka, kurse drejtori, kryetari i kooperativës janë vërtet përgjegjës, po jo gjithçka. Kur qëndrimet, pikëpamjet dhe puna e një përgjegjësi puqen me ato të klasës punëtore, kur përgjegjësinë e tij ky drejtues e lidh ngushtë me përgjegjësinë e klasës punëtore, s'ka dyshim që punët do të ecin mirë, planet do të realizohen e do të tejkalohen. Kur ky drejtues shkon për të kërkuar diçka që i nevojitet ndërmarrjes, ose për të dhënë llogari për punën tek eprori i tij direkt, te

ministri apo në komitetin e Partisë, duhet të vejë atje jo me mendimin që të tregohet i mirë përpara tyre, që ata ta marrin me sy të mirë dhe kështu, nesër, ta ndihmojnë për t'i dhënë ndonjë shtytje përpara, për ta bërë drejtor të një ndërmarrjeje tjetër më të madhe ose zëvendësministër etj., por të përpiqet t'ua paraqesë sa më drejt dhe objektivisht gjendjen e ndërmarrjes, me të mirat dhe me anët e saj negative, t'ua paraqesë pikëpamjet e gjithë kolektivit, rezultatet e punës në uzinë, problemet që dalin etj. Ai duhet të ketë guxim dhe t'u raportojë eprorëve ose Partisë se dobësitë që ekzistojnë në ndërmarrjen ku punon vijnë për shkak të punës së tij të pamjaftueshme dhe, për sa u përket rezultateve pozitive, megjithëse edhe ai ka dhënë kontributin e tij si drejtues, me modesti të vërë në dukje dhe ta ndiejë se ky kontribut i tij është si i të gjithëve, kurse merita kryesore u përket kolektivit, punëtorëve, pastaj mjeshtërvë, inxhinierëve, kryeinxhinierit, bashkë me të cilët punon edhe ai.

Kështu duhet ta kuptojë drejtori rolin e tij, kështu duhet ta kuptojë edhe kryeinxhinieri e çdo drejtues tjetër, kështu duhet ta kuptojë, dhe kjo ka rëndësi të veçantë, edhe vetë klasa punëtoare. E them këtë pse, në fakt, nganjëherë, vetë punëtorët, kur kanë për t'i bërë ndonjë vërejtje drejtorit ose kryeinxhinierit, harrojnë kolektivin, forcën e tij vendimtare. Kjo është shumë e keqe. Kur një punëtor shkon në zyrën e drejtorit për të diskutuar me të probleme pune, nuk duhet të harrojë që është pjesëtar i kolektivit të ndërmarrjes. Në një rast të tillë ai duhet të flasë aty si pjesëtar i këtij kolektivi, të shtrojë pro-

bleme dhe të theksojë se mendimet që do të hedhë përpara drejtuesit janë në interesin e Partisë, të klasës punëtore dhe të sqarojë, gjithashtu, se këtë e bën sepse dëshiron të mirën e të gjithë shokëve të tij punëtorë. Në këtë rast ai duhet të kërkojë nga drejtori që këto ose ato të meta, të cilat mund të jenë në ndërmarrje, të marrin fund. Ai mund t'i bëjë të ditur, për shembull, se, kur punëtorët dalin nga miniera, nuk kanë ku lahen dhe, në emër të tyre, mund të kërkojë që të zgjidhet ky problem. Ose t'i thotë se normat që janë vendosur nuk po zbatohen, jo se nuk duan punëtorët, por për mungesë interesimi nga drejtuesit, të cilët nuk marrin masa për sigurimin e lëndës së parë etj. Në këto kushte, normat nuk mund të realizohen dhe, si rrjedhim, kur punëtorët nuk i realizojnë normat, nuk e marrin pagën e plotë, kurse ti, shoku drejtor, duhet t'i thotë punëtori, që ke përgjegjësi për këto çrregullime pagën e merr të plotë, 100 për qind. Kjo nuk është e drejtë, t'i theksojë ai, se Partia na mëson që normat janë në interes të klasës punëtore, prandaj ato duhen realizuar, po për këtë duhen marrë të gjitha masat organizative nga ana e drejtorisë, të sigurohen veglat, materialet, lënda e parë etj. Dhe ne, punëtorët, duhet të sqarojë ai, jemi gati të ndërhyjmë, të vëmë rregull, të luftojmë të metat tona.

Mirëpo, jo rrallë, punëtorit që mendon të shkojë te drejtori e t'i parashtojë këto, para se të hapë derën e zyrës së drejtorisë, qëllon t'i humbasë sensi i trimërisë së klasës dhe të mos mendojë se përfaqëson 100 veta, pra, shokët e tij punëtorë të kolektivit, por

të paraqitet para tij si individ, si njësh i vetmuar. Nuk është e drejtë që punëtori të veprojë kështu, të mendojë se ai që e pret është drejtor, ka lidhje me kryetarin e komitetit ekzekutiv, me sekretarët e komitetit të Partisë të rrethit, e të mendojë se ai punëtori nuk ka asnjë lidhje me ta dhe kështu ta ndiejë veten në pozita inferioriteti. Përkundrazi, ai duhet të mendojë se është pjesëtar i një kolektivi të madh, pa të cilin asgjë nuk bën dot drejtuesi. Ndjenja e inferioritetit shkaktohet, pse, shpesh, kur në uzinë vjen nga qendra ministri ose çdo shok tjetër drejtues, ai nuk takohet fare me punëtorët, kurse me drejtorin takohet. Edhe kur vjen nganjëherë, në të rrallë, ndonjë shok tjetër akoma më me përgjegjësi, gjatë vizitës që bën në ndërmarrje, merr me vete drejtorin, sekretarin e organizatës-bazë të Partisë, kryetarin e komitetit profesional, kryeinxhinierin dhe bisedon me ta, kurse punëtorët i sheh e i përshëndet vetëm së largu. Kjo, natyrisht, ndikon negativisht tek ata dhe, kur vjen rasti që punëtori të flasë me drejtorin, i duket sikur ka përpara një kala të madhe, kurse vetja i duket mizë dhe, në vend që të thotë ato që ka për të thënë, druhet. Po të jetë drejtori punëtor i mirë partie, i jep zemër dhe të drejtë punëtorit, ndryshe i bërtet, i thotë se nuk ka nge të bisedojë me të. Këto rrethana punëtorin shpesh e bëjnë të tërhiqet. Ata punëtorë që kanë koncepte të tilla duhen sqaruar. Punëtorët t'i kuptojnë mirë detyrat, rolin dhe rëndësinë e madhe të klasës.

Por edhe drejtori, inxhinieri, kryeinxhinieri nuk janë të huaj për çështjen e klasës punëtore. Edhe këta janë me klasën punëtore, pse janë bij të punëtorëve,

të luftëtarëve, të kooperativistëve me një fjalë, janë bij të popullit, Partia u dha mundësi të mësojnë, të mbarojnë shkolla, të fitojnë profesione dhe secilit, sipas aftësisë e sipas profilit të punës së vet, i është dhënë një funksion i caktuar. Prandaj edhe ata që kanë pasur rastin të mësojnë dhe janë vënë në vende drejtuese, gjithashtu, duhet t'i kuptojnë mirë detyrat.

Në radhë të parë, ata duhet të jenë të lidhur ngushtë me masat, të kërkojnë dhe të marrin ndihmë nga punëtorët. Por, kur është rasti dhe u konstatohen të meta e gabime në punë, kur planet s'realizohen, që të ndihmohen prej punëtorëve drejtuesit duhet të pranojnë që edhe punëtorët t'u kërkojnë llogari, ashtu sikurse drejtori, kryeinxhinieri, inxhinierët, përgjegjësit e reparteve dhe të turneve, brigadierët u kërkojnë llogari punëtorëve për punën. Pra, kërkesa e llogarisë të jetë e dyanshme, ndryshe ndërmarrja nuk mund të ecë përpara.

Punëtorët, në përgjithësi, janë njerëz të disiplinuar, ata u përgjigjen kërkesave që u drejton Partia, si dhe atyre që u bëhen nga drejtuesit e ndërmarrjes, po ka edhe ndonjë që nuk i kupton si duhet detyrat, nuk kupton se në çfarëdolloj pune kërkohet disiplinë e fortë. Kjo do të thotë që punëtorët të jenë shembull në të gjitha drejtimet, të venë të parët në punë, të respektojnë orarin e caktuar, të shfrytëzojnë në maksimum kohën e punës, të mirëmbajnë dhe të shfrytëzojnë si duhet makineritë, pse vetëm kështu do të kenë pastaj guximin dhe forcën morale t'u kërkojnë llogari të tjerëve.

Kështu duhet të veprojnë edhe drejtuesit. Në qoftë

se kryeinxhinieri shkon, ta zëmë, në një repart për të bërë punën në prodhim, ai të qëndrojë vazhdimisht e të punojë 8 orë, si gjithë punëtorët, dhe, kur të vijë koha e pushimit për të gjithë, atëherë të pushojë edhe ai. Mirëpo ka ndonjë drejtues që i bën bisht shfrytëzimit të kohës së punës në prodhim, sepse nuk është mësuar, prandaj largohet prej saj duke u justifikuar se e presin punë të tjera. Punëtorët që punojnë me të, po të jenë vetë në rregull, të jenë shembull pune e disipline, kanë të drejtë dhe duhet ta këshillojnë atë kryeinxhinier të mos largohet, të qëndrojë në krye të detyrës, të pushojë kur është orari dhe për aq kohë sa pushojnë punëtorët dhe «punën», që pretendon se ka për të bërë, t'i thonë ta kryejë në kohën e pushimit, po të dojë. Një punëtor që është vetë në rregull, duhet dhe e ka më të lehtë t'i thotë kryeinxhinierit ose drejtorit, që ka ardhur aty për të bërë punën në prodhim, se s'ka arsye pse të bëjë lëvizje andej-këtej, përkundrazi, të punojë njëlloj si të gjithë dhe të mos përpiqet të gjejë shkak për t'i bërë bisht punës. Të jetë e qartë se, gjatë kohës së punës në prodhim, kryeinxhinieri nuk është më kryeinxhinier, por punëtor, njëlloj si të tjerët, që janë aty krah për krah tij. Si të gjithë punëtorët, edhe ai të respektojë disiplinën e punës dhe, në rast se e shkel, punëtorët të ngrihen, sepse kanë të drejtë dhe detyrë ta këshillojnë, ta kritikojnë dhe të mos e lënë të vazhdojë në rrugë të gabuar. Po kjo arrihet kur vetë punëtorët janë në rregull, ndryshe nuk mund të kenë guximin t'i kritikojnë drejtuesit kur këta gabojnë.

Ndryshon çështja kur një drejtues është duke

kryer funksionin si drejtor, si kryeinxhinier, si brigadier etj. Në këtë rast ai ka të drejtë dhe mund të largohet për njëfarë kohe nga puna, natyrisht, për nevoja të punës, kurse kur është duke bërë punën në prodhim, duhet të jetë i disiplinuar e i rregullt si gjithë punëtorët.

Mund të ndodhin pakënaqësi e fërkime në mes punëtorëve dhe drejtuesve, kur këta të fundit, që janë shoqet dhe shokët tuaj, mund të mos i kuptojnë ngandongjëherë mirë detyrat. Në raste të tilla, në çdo ndërmarrje industriale, në miniera, në uzina e në fabrika, në kooperativa bujqësore e kudo, Partia duhet të punojë shumë për rritjen e nivelit politik dhe ideologjik të tyre, me qëllim që ata, si kuadro me përgjegjësi, të cilët drejtojnë grupe me një numër jo të paktë punëtorësh ose kooperativistësh, të kuptojnë se nuk janë vetëm për të drejtuar. Brigadieri vërtet ngarkohet të drejtojë brigadën, por ai duhet të jetë kurdoherë pranë punëtorëve, të punojë vetë mirë së bashku me ta dhe, njëkohësisht, t'i organizojë dhe t'i nxitë ata të punojnë me ndërgjegje. Kur ai shikon që ndonjë nga punëtorët, në vend që të punojë, shtrihet në hije të fikut gjatë kohës së punës, ka të drejtë t'i tërheqë vëmendjen, t'i bëjë thirrje të punojë me seriozitet, t'i kërkojë të realizojë normat dhe t'i luftojë qëndrimin e gabuar, sorollatjet e panevojshme jashtë repartit, qoftë edhe për pesë minuta.

Ka edhe njerëz, të cilët, për një arsye ose për tjetrën, i shikojnë shtrembër vërejtjet dhe këshillat që brigadieri i bën një punëtori të padisiplinuar, nuk u vjen mirë dhe, duke përfituar nga këshilla e drejtë që

jep Partia, për të hapur gojën, për të ngritur zërin cilido kundër kujt do që sillet në mënyrë arrogante me punëtorët, fillojnë pa të drejtë të bërtasin dhe të kritikojnë brigadierin, në vend që të kritikojnë shokun e tyre që s'është në rregull. Kur një brigadier ose përgjegjës punon mirë dhe është i lidhur me masën e punëtorëve, i kërkon llogari ndonjërit që nuk punon, ai duhet të mbështetet edhe nga punëtorët, kurse elementi i padisiplinuar të vihet në vend. Ndaj kujt do, qoftë ai edhe punëtor që shkel disiplinën, thyen rregullat e punës në ndërmarrje, ankohet pa të drejtë kur e kritikojnë pikërisht për thyerjen e këtyre rregullave e të disiplinës, të gjithë duhet të mbajnë qëndrim, të mos e lënë të livadhisë e të dëmtojë punën. Njerëz të tillë është e nevojshme t'i njohë mirë kolektivi, në të gjitha drejtimet, dhe kjo, sigurisht, jo për t'i dënuar, po për t'i ndihmuar, për t'i edukuar politikisht dhe ideologjikisht, për t'i bërë të ndërgjegjshëm në punë. Pra, të bëhet diferencimi, nga pozita të drejta partie, dhe të gjykohet me drejtësi e me ndershmëri në dobi të punës dhe të formimit të njeriut tonë.

Këto i themi se na kanë ngjarë dhe na ngjasin, aty-këtu, në qendra pune. Ne kemi edhe drejtorë të mirë, që qëllon të bëjnë ndonjë gabim. Po ka edhe ndonjë njeri të parregullt në punë, që e shfrytëzon këtë situatë, me qëllim për ta bërë leckë drejtorin. Në këtë rast do të ishte qëndrim shumë negativ që njerëzit e tjerë të këtij kolektivi, të mos flitnin. Kjo ngjet më rrallë, pse, zakonisht, njerëzit i njohin, ose ngrihet ndonjë e pyet se kush është ky që flet kaq rëndë

për një gabim të vogël të drejtorit dhe kështu, si gërmohet çështja, del se ai që flet në këtë mënyrë është i biri i njërit që babanë ia kemi pushkatuar ne, që dy dajo i ka në burg dhe një tjetër të arratisur. Ja, pra, ka edhe raste të tilla që një element me përbërje të keqe politike, vetëm për faktin që punon në ndërmarrje e heq veten punëtor dhe përfiton nga kjo për t'u hedhur në sulm kundër njeriut tonë të mirë, duke u përpjekur ta njollosë atë, ta denigrojë kuadrin. Kurse, në realitet, ky njeri ka bërë një gabim për të cilin duhet ta kritikojmë, por edhe ta mbajmë afër që të korrigojohet sa më shpejt. Prandaj është e mira t'i njohim anëtarët e kolektivit, të dimë kush është njëri ose tjetri, jo me qëllim që të hidhet jashtë ndërmarrjes, po për ta pasur parasysh nga ç'pozita niset ai në qëndrimin që mban ndaj punës, ndaj shokëve, kur diskuton, kur bën kritikën etj. Kur e njohim përbërjen e punëtorit mund ta edukojmë e ta kalitim si gjithë punëtorët e mirë të ndërmarrjes, mund të neutralizojmë synimet e tij kur janë të këqija dhe mund ta ruajmë kolektivin nga influencimi i gabuar prej thënieve të tij. Me këtë nuk dua të them që t'i fshehim gabimet e njërit dhe të tjetrit, qoftë të drejtorit, të inxhinierit ose të kryeinxhinierit, qoftë të çdo punëtori, kur vërtetohet se këta gabojnë. Gabimet e të metat e kujtdo duhen kritikuar pa hezitim dhe duhen korrigjuar.

Një punëtor i ndershëm, i mirë, i aftë, i zoti të ngjall nderim e respekt me punën e tij. Mirëpo, kur në sajë të këtyre aftësive e cilësive të mira bëhet drejtor, qëllon që ndonjërit i rritet mendja dhe, me dashje e

pa dashje, kujton se qëndron përmbi të tjerët. Ndoth kjo edhe me ndonjë që zgjidhet sekretar partie në bazë ose në rreth e që pastaj mendon se është mbi të gjithë. Duhet të jetë e qartë se një njeri të tillë, qoftë në Parti ose jo, Partia e zgjedh për ta ngarkuar me një detyrë të caktuar, të cilën ai duhet ta kryejë me nder, ta kryejë mirë dhe të mos bëjë gabime. Dhe, që të mos bjerë në gabime, ai duhet të pyesë e të këshillohet me të tjerët, me shokët, me masat, të jetë i sjellshëm, i dëgjueshëm dhe shumë i ndershëm. Kur një gjë nuk e di, të thotë ndershmërisht, të pranojë me thjeshtësi që nuk e di dhe po kështu të përpiqet ta mësojë nga të tjerët. Por, nganjëherë, te ndonjëri që ngrihet në përgjegjësi, siç thashë, nxjerr veshët egoizmi dhe meqenëse u bë drejtor apo sekretar partie mendon shtrembër për të tjerët, sillet keq me ta dhe, kur me punë e aftësi nuk arrin të gëzojë respekt, kërkon ta fitojë këtë me arrogancë, me frikë, me masa ndëshkimore.

Të gjithë duhet të kemi kuptim të drejtë për lidhjet dhe për respektin prej komunisti të udhëheqësve të ndërmarrjeve ndaj klasës punëtore dhe, anasjelltas, për lidhjet dhe për respektin e punëtorëve për drejtuesit e ndërmarrjeve, të shtetit ose të Partisë. Udhëheqësit e Partisë ose të shtetit duhet të dëgjojnë kurdoherë me shumë vëmendje fjalën e punëtorëve, pse nga kjo nuk humbasin gjë. Prandaj, për çdo problem që përbën rëndësi të veçantë, duhet të mblidhet kolektivi, qoftë edhe për pak minuta dhe të informohet për atë që mendon të bëjë udhëheqja, të kërkohet mendimi i punëtorëve dhe të merret aprovimi i tyre

për çdo vendim apo masë. Po të veprohet kështu s'ka dyshim se atje do të forcohet situata, punët do të shkojnë mirë dhe do të forcohen lidhjet dhe respekti reciprok midis punëtorëve dhe drejtuesve.

Shokut sekretar të parë të komitetit të Partisë të rrethit i thashë se tani kudo, në uzina, në fabrika e në miniera duhet të planifikohen sa më shumë kadro që të ndjekin kurset e shkollat profesionale, me qëllim që jo vetëm ata që janë duke punuar në sektorët përkatës të marrin arsim profesional e të kualifikohen, por të përgatitim edhe të tjerë, që t'i zëvendësojnë kur të jetë nevoja. Zëvendësit, njerëzit e tjerë nga jashtë, ne do t'i marrim vetëm në raste të rralla. Dhe kudo, në çdo ndërmarrje ku ka punëtorë që punojnë në sektorë të ndryshëm deri edhe te portieri, duhet të synojmë t'i mësojmë me këmbëngulje, që nesër të bëhen, po të jetë e mundur, të tërë specialistë. Kështu, kur duam të ndërtojmë një ndërmarrje të re, ose kur të vijë puna që të zgjerojmë më tej veprimtarinë e ndërmarrjes ekzistuese, si në rastin tuaj, kadrot që do të na nevojiten për të duhet t'i kemi përgatitur me kohë. Ose, kur të kemi nevojë për një numër kadrosh specialistë në një rreth ose në një ndërmarrje tjetër, mund të marrim pa vështirësi të madhe nga ata që kemi përgatitur, të cilët, gjithashtu, mund t'i zëvendësojmë në punën e tyre me të tjerë që kemi kualifikuar po aty. Punëtorët është e nevojshme të kalojnë nëpër kurse kualifikimi. Ky orientim kërkon të synohet në arritjen e specializimit më të thellë të punëtorëve të kualifikuar dhe të të tjerëve që mund t'i zëvendësojnë këta. Çdo specialist, pra, duhet të dublo-

het në vend, shokët që do ta zëvendësojnë të zgjidhen në mes atyre që punojnë rreth e qark tij dhe jo të kërkojmë t'i sjellim nga krahina të tjera e të kujtohemi për ta vetëm atëherë kur vjen koha që na nevojiten.

Mirdita ka një perspektivë të madhe, po, që të përgatitet kjo sa më shpejt e më mirë, organizata e Partisë duhet të punojë e të kërkojë shumë nga ju punëtorët, t'ju edukojë dhe t'ju kalitë të bëheni me të vërtetë të papërkulur, njerëz të klasës e të Partisë. Minatorët dhe metalurgët ushtrojnë nga profesionet më të vështira, prandaj, pikërisht për këtë, këtu janë edhe mundësitë më të mëdha për kalitjen e çelikosjen e punëtorëve që janë në Parti dhe të atyre të paorganizuar në Parti. Ne duhet t'i shfrytëzojmë në maksimum këto mundësi, jo vetëm për t'i çuar më përpara industrinë, minierat dhe bujqësinë e rrethit të Mirditës, por edhe për të përgatitur nga radhët e punëtorëve mirditorë kuadro të fortë, me cilësi të vërteta proletare, me të cilët të ndihmohen edhe ndërmarrjet e institucionet e ndryshme të rretheve të tjera të vendit.

Këtë synim duhet ta ushqejë te punëtorët e minierave, të fabrikave e të uzinave të rrethit tuaj organizata juaj e Partisë. Ajo duhet të punojë sistematikisht me minatorët e me metalurgët, t'i kalitë çdo ditë e më shumë me ndërjegje proletare, të punojë për t'u ngritur nivelin politik dhe ideologjik dhe kështu, pas pesë, gjashtë ose pas dhjetë vjetësh, do të mund të arrijë të përgatitë dhe të vërë në dispozicion të udhëheqjes dhjetëra e dhjetëra kuadro, komunistë

dhe të paorganizuar në Parti, që mund të punojnë në vende drejtuese, në punë nga më të rëndësishmet, ku të kenë nevojë Partia dhe pushteti. Ju vetë e dini se një njeri, që ka punuar për dhjetëra vjet me radhë në minierë, që ka kaluar kush e di sa herë kushte të rënda, në të ftohtë dhe në ujë gjer në gju, deri në të provuarit e rrezikut të mbytjes, që ka qëndruar vazhdimisht thellë nën tokë e nuk ka parë si të tjerët diell me sy, që ka jetuar larg familjes e ka përballuar vështirësi të mëdha e të panumërta, është shumë i kalitur, është si çeliku. Atë asgjë s'e mposht. Kurse një fshatar, ca më tepër një intelektual, mund të thyhet e të gënjehet më lehtë. Fshatari e ka më të theksuar ndjenjën e pronës dhe intelektual i mendon ta ketë të vetën diçka që ia pëlqen syri, kurse minatori është më stoik. Të tillë njerëz do Partia, të kalitur e të papërkulur. Ajo është e bindur se Rubiku është një qendër ku kaliten punëtorë të tillë. Atëherë nga gjiri juaj do të dalin shumë kuadro. Më treguan se kryetari i kooperativës bujqësore që gjendet afër Rubikut, ka punuar 30 vjet në minierë. Ja, ky është një kuadër i mirë, i dalë nga gjiri juaj, shokë punëtorë. Unë jam i bindur se ai nuk bëhet fodull, as nuk bie në plogështi e t'ju lërë juve pa bukë, atij nuk do t'i rritet mendja, siç mund të ndodhë me ndonjë tjetër, për shembull, me një intelektual ose me një fshatar të paformuar mirë. Miniera atë e ka bërë të çeliktë, prandaj ai do ta çojë medoemos frymën e minatorëve edhe në fshat.

Ju në Mirditë jeni ca të favorizuar në krahasim me disa rrethe të tjera, pse këtu burrat, në përgjithësi.

punojnë në fabrika e në miniera, ata janë edhe punëtorë, po edhe fshatarë. Duke qenë të tillë ata sjellin në fshatrat tuaja frymën e klasës punëtore.

Meqë në kooperativat tuaja gati nga çdo familje ka nga një ose dy pjesëtarë, që punojnë në fabrikat e në minierat e Mirditës, kjo do të thotë se bujqësia në rrethin tuaj mbahet më këmbë në sajë të punës së grave. Në kooperativat tuaja ato përbëjnë shumicën e fuqisë punëtore, prandaj mbështetuni fort në to.

Meqenëse ra fjala, le të bisedojmë tani pak për problemin e gruas. Ju, gratë kooperativiste, komuniste ose jo, duhet të keni kërkesa ndaj burrave, vëllezërve dhe djemve tuaj punëtorë. Kërkoni që ata të jenë akoma më përparimtarë, më të sjellshëm e më dashamirë ndaj jush. Burrat e vëllezërit tuaj, që punojnë në kooperativë, pra, që nuk janë punëtorë, zakonisht qëndrojnë ca më prapa se punëtorët. Prandaj, ju shoqe kooperativiste do të bëni mirë të kërkoni më shumë nga burrat e vëllezërit, që punojnë në fabrikat e në minierat e rrethit, ata duhet të jenë medoemos në pararojë në çdo drejtim, në mënyrë të veçantë për çështjen e madhe të gruas, bile të jenë edhe më përpara nga ju vetë, sepse, atje ku punojnë, edukohen me frymën e klasës, të cilën, në një mënyrë ose në një tjetër, e sjellin dhe duhet ta sjellin edhe në fshat. Në qoftë se ata këtë frymë nuk jua sjellin plotësisht, i kritikoni kur ju vijnë në shtëpi. Kur konstatooni tek ata mungesa e dobësi të këtij lloji, të shkoni edhe deri në organizatën-bazë të Partisë, kur është fjala për komunistë ose në kolektivin e minierës ku punojnë, në qoftë se janë të paorganizuar në Parti.

Për shembull, një komuniste në kooperativë, kur sheh se burri apo vëllai i saj ose një burrë tjetër nga një familje e fshatit të vet, i cili punon në një fabrikë ose në minierë, ka pikëpamje prapanike për gruan dhe që, me gjithë përpjekjet që bën ajo, nuk ia lufton dot as në familje, as në kooperativë, atëherë le t'i drejtohet organizatës-bazë të Partisë të fabrikës apo të minierës. Atje, në prani të burrit, të vëllait ose të bashkëfshatarit, ajo mund të kërkojë të bisedojë me komunistët, ta shtrojë çështjen hapur me ta. Natyrisht, këtë punë duhet ta bëjë me takt në mënyrë të atillë që burri, vëllai ose bashkëfshatari i saj të mos fyhet, të mos mendojë kur të kthehet në shtëpi se gruaja, motra ose bashkëfshatarja, duke ardhur në minierë, e ka koritë, sepse, përpara shokëve, i vuri në dukje të gjitha të metat e dobësitë. Para organizatës së Partisë apo para kolektivit të ndërmarrjes ajo mund të thotë që burrin ose vëllanë e vet e do shumë, bashkëfshatarin e respekton se është punëtor i mirë e i ndershëm, por, pikërisht se e do dhe e respekton, ka ardhur aty ta ndihmojë, duke i vënë në dukje këtë ose atë dobësi, duke besuar se pas kësaj ai do të korrigjohet, do të bëhet edhe më i mirë. Është mirë të shprehet se ajo ka luftuar kundër të metave të tij, ka bërë shumë përpjekje, ka punuar për ta ndihmuar atë të korrigjohet, por me keqardhje ka vërejtur se, me gjithë këshillat e kritikën, ai nuk është korrigjuar. Ajo do të shpjegojë se fakti që e shtyu t'i drejtohet kolektivit është dëshira dhe detyra prej komunisteje për t'i luftuar këto qëndrime nga të cilat rrjedhin shumë të këqija dhe se ajo e shoqëria, që e duan aq shumë,

bashkërisht do të përpiqen ta korrigojnë. Në këtë rast, punëtorët e fabrikës apo të minierës, do t'i flasin e do ta këshillojnë shokun e tyre në mënyrë të atillë shoqërore që, kur ky të kthehet në shtëpi, të mos jetë i zemëruar me gruan, me motrën apo me bashkëfshataren, po t'i shtohet më shumë dashuria për familjen dhe për njerëzit.

Ose mund të ndodhë kështu: Në një familje, në kooperativë, një burrë nuk sillet mirë me bashkëshorten. Sekretari i organizatës-bazë të Partisë, pasi ka dëgjuar e ka gjykuar për këto marrëdhënie familjare dhe ka krijuar bindjen se burri nuk ka të drejtë, arrin në mendimin se duhet ndërhyrë për t'i përmirësuar marrëdhëniet në këtë familje. Por, përpara se këto të bëhen çështje të opinionit të fshatit, sekretari i organizatës, si njeri partie, e fton atë person në shtëpinë e vet, i thotë se ka dëgjuar që po sillet keq me gruan, gjë që, natyrisht, nuk është e drejtë, prandaj duhet hequr dorë nga një qëndrim i tillë e duhet bërë kthesë. Në qoftë se ai hidhet e i thotë sekretarit të mos përzihet në punët e familjes së tij, sekretari t'i qëndrojë, t'i thotë se do të përzihet patjetër, t'i shpjegojë se kjo nuk është përzierje në kuptimin e keq të fjalës, por është interesimi i Partisë për jetën e njerëzve. Sekretari i organizatës, si përfaqësues i Partisë, me durim, duhet t'i shpjegojë atij se ia do të mirën, se Partia dëshiron që në familjen e çdo njeriu të sundojnë dashuria, harmonia dhe nuk do që ky burrë dhe familja e tij të turpërohen para opinionit. Ai t'i shpjegojë, gjithashtu, se Partia nuk do që në fshat njëri e tjetri të flasin keq për fëmijët e tyre;

se këta paskan një baba dhe nënë të parregullt. Sekretari i organizatës-bazë të Partisë të kooperativës duhet ta bëjë këtë ndërhyrje për ta sjellë atë njeri në rrugë të mirë dhe të mos i ndahet, gjersa ta ndreqë. Po të shohë se ai, edhe pas kësaj bisede, nuk është i bindur që e ka gabim, sekretari i organizatës le të ndahet miqësisht me të, ta lërë disa ditë, gjatë të cilave ai patjetër do të mendojë. Pastaj të përpiqet ta takojë përsëri, por më parë të pyesë gruan e tij se si po i sillet tani i shoqi, a ka ndryshuar gjë në qëndrimin ndaj saj apo jo. Në qoftë se i këshilluari nuk ka ndryshuar, sekretari takohet dhe bisedon edhe një herë të dytë me të, bile edhe një herë të tretë dhe vetëm kur të shohë se nuk po bën asnjë kthesë, atëherë ta bëjë këtë problem të opinionit të fshatit, ta shtrojë në popull, por kurdoherë, dhe në këtë rast, për të mirën e tij, të gruas së tij, të familjes dhe të shoqërisë. Kështu duhet dhe mund të veprohet nga organizata-bazë e Partisë dhe nga sekretari i saj për çdo gjë jo të mirë që mund të ndodhë në fshat.

Por të mbahet parasysh se në marrëdhëniet familjare ka disa çështje delikate, për të cilat më parë vetë komunisti duhet të gjykojë me shumë kujdes. Në këto raste ka gjëra që thuhën, por ka të atilla që nuk mund të thuhën me të tjerët, prandaj duhet punuar me shumë takt me njerëzit. Komunisti është njeri me zemër dhe me mendje, si i tillë ai duhet të mendojë dhe të ketë kujdes që çdo çështje të zgjidhet kurdoherë drejt, pa skandale. Por kur konstatohet se shkelen ligjet dhe normat dhe, pasi janë bërë të gjitha përpjekjet që një ose dy persona të vihen në rrugë të

drejtë, ndërsa shihet se ata qëndrojnë në të njëjtat pozita, atëherë të veprohet haptazi kundër tyre, sipas ligjeve. Kështu duhet vepruar për të luftuar gjithë ato mbeeturina që ekzistojnë sidomos në qëndrimin ndaj gruas.

Ka akoma te ne njerëz që kanë pikëpamje të dëmshme për gruan dhe me ndërgegje e pengojnë përparimin e saj. Me këta duhet bërë punë e vazhdueshme e me durim.

Në vendin tonë ka marrë hov të madh revolucionarizimi i jetës së njerëzve, i mendimit të tyre, sidomos për emancipimin e gruas. Kjo është shumë e mirë dhe duhet punuar me kujdes e me këmbëngulje për ta çuar përpara, gjer në fund, dhe me pjekuri këtë çështje.

Burrat që jetojnë e punojnë në fshat, te ju japin, gjithashtu, kontributin e tyre në punët e kooperativës. Ata marrin pjesë edhe në përgatitjen ushtarake, e cila ka rëndësi të madhe për mbrojtjen e fitoreve tona. Shokët që merren me drejtimin e kësaj pune të mendojnë me seriozitet si për sasinë e ditëve të përgatitjes ushtarake, ashtu edhe për kohën më të përshtatshme për t'i zhvilluar ato. Kur flas për kohë më të përshtatshme kam parasysh anën ekonomike të këtij problemi, sepse sekretarët e komiteteve të Partisë të rretheve na ankohen kur u merren kooperativistët, për në stërvitje ushtarake, në mes të valës së punëve bujqësore. Kjo bën që patatet, gruri, misri etj., në disa raste të mbeten pa mbjellë, pa prashitur etj. Sigurimi i gatishmërisë ushtarake të vendit është një problem që duhet shikuar në radhë të parë, por edhe ana ekonomike të mos lihet pas dore.

Për këto probleme është e nevojshme të diskutojnë e të shfaqin mendimet e tyre vetë shokët pjesëmarrës në stërvitje. Në ditët e stërvitjes ushtarake mund të bëhet rifreskimi i njohurive të mësuara gjatë shërbimit të rregullt në ushtri, si dhe të mësohen njohuri të reja. Shokët të venë rregullisht në stërvitje ushtarake, të përgatiten mirë, t'u mësohet e t'u bëhet edukatë që ta kenë parasysh këtë detyrë edhe gjatë kohës së tyre të lirë. Ky problem të shikohet me seriozitet, se vetëm kështu do të jemi të gatshëm për mbrojtjen e atdheut në çdo kohë, nga cilido armik.

Sa punë të madhe duhet të bëjë akoma Partia që njerëzit të arrijnë të mos u vijë keq kur kritikohen për gabimet e bëra. Kjo është një nga punët më të vështira dhe kërkon, edhe nga vetë njeriu që ka gabuar, të bëjë luftë të vazhdueshme kundër pikëpamjeve mikroborgjeze në ndërgjegje, të cilat ekzistojnë, ku më shumë e ku më pak, te çdo individ. Ne luftojmë që t'i hedhim poshtë këto pikëpamje, por ato qëndrojnë me këmbëngulje, pra, nuk zhduken lehtë. Ne luftojmë kundër tyre çdo ditë, luftojmë që t'i shkullim nga rrënjët dhe gradualisht po i zhdukim, po, aty-këtu, mbetet akoma ndonjë që lëshon rrënjë të reja.

Këto mbeturina e kanë burimin te prona private, nga e cila lindin ndjenja sa të dëmshme për shoqërinë, aq edhe të egra, lind egoizmi personal, dëshira për t'u dukur e për të pasur vetëm për vete etj. Pikërisht në këto drejtime duhet bërë gjithë lufta jonë. Po u zhvillua lufta për të vënë interesin e përgjithshëm mbi atë personal, atëherë për çdo njeri do të hapet, me siguri, një horizont i ri i kthjellët, ai

do ta shikojë botën krejt ndryshe dhe njerëzit do t'i shohë si vëllezër. Në këto kushte mund ta kritikosh tjetrin më lehtë dhe pa druajtje. Veç kësaj, kur veten e ke të pastër, të qartë se ke bërë me sukses luftë të madhe në ndërgjegjen tënde dhe ke kapërcyer mbeturinat e këqija që ke pasur e që si ferra të kanë çjerrë trupin gjithë jetën, atëherë ke guximin t'ua luftosh pa frikë të tjerëve, t'i ndihmosh edhe ata për spastrimin e mbeturinave të së kaluarës që u rëndojnë në ndërgjegje. Pas kësaj do të kesh një shikim tjetër për botën, për shoqërinë, do të kesh një shikim më të përparuar dhe kjo gjendje do të të japë një nxitje të madhe revolucionare.

Kur themi se është e domosdoshme të kritikohet një njeri që gabon, nuk e bëjmë këtë se i duam atij të keqen, por sepse duam, në radhë të parë, të mirën e atdheut, të popullit, të Partisë dhe se kështu sigurohet edhe e mira e individëve të veçantë. Nga kjo, sigurisht, nuk ka pse të ofendohet njeri, sepse diskutimet, kritikën ne i bëjmë në gjirin e popullit tonë, jo përpara armiqve. Prandaj, për të vlerësuar drejtësinë e një pune apo të një veprimi, duhet të tërhiqet mendimi i masave, gjykimi i tyre për çështjen. Mirë do të ishte të mos gabonte kurrë njeri, por është e zorshme të ndodhë kjo praktikisht. Jeta këtë provon, njerëzit që punojnë edhe gabojnë. Vetëm ata që s'punojnë, nuk gabojnë, por duhet thënë se këta gabojnë më shumë për faktin se nuk punojnë.

Në mbledhjen e asamblesë së një kooperative qëllon që një anëtar kritikoi mësuesin, i cili, pavarësisht se në shkollë e kryente mirë detyrën, në koo-

perativë nuk ia kishin parë ndonjëherë fytyrën, pse nuk kishte shkuar të bënte qoftë edhe një konferencë me fshatarët, ose t'u jepte ndonjë ndihmë në punët shoqërore. Për këtë qëndrim jo të drejtë, kooperativisti e kritikoi mësuesin dhe e këshilloi të ndryshojë metodën e tij të punës. Ky anëtar i kooperativës i drejtoi një kritikë edhe sekretarit të organizatës-bazë të Partisë për disa qëndrime të padrejta në punë, për hatëre etj. Pati edhe të tjerë që morën shtytje nga ky diskutim dhe e kritikuan sekretarin, bile edhe kryetarin, por pati edhe nga ata që i përkrahën. Meqenëse u bënë shumë kritika, presidiumi i mbledhjes kërkoi nga asambleja që kësaj t'i jepeshin shpjegime javën tjetër, pasi «të studioheshin» këto kritika. Mirëpo, kur erdhi koha për të dhënë llogari, për këto probleme, sekretari i organizatës-bazë i hodhi ujë verës, gjeti plot justifikime.

Veç kësaj në mbledhje u njoftua se ishte marrë masë edhe për llogaritarin e kooperativës, i cili do të zëvendësohej me një tjetër. Anëtar i kooperativës që kritikoi në mbledhjen e parë u ngrit e kërkoi shpjegime për këtë, për arsyen pse merrej kjo masë dhe pastaj u shpreh kundër saj, pasi nuk iu duk e drejtë. Mirëpo, pas kësaj dhe pas debatesh të tjera, atij filluan t'i bëjnë presion, ta kërcënojnë deri edhe me gjyqin. Dhe ai iu drejtua Partisë. Na shkroi letër. Pas verifikimit që bëri në vend instruktori i aparatit të Komitetit Qendror të Partisë doli se, ato që ai shkruante në letër, ishin të drejta.

E shikoni shoqe dhe shokë punëtorë ç'bëhet nganjëherë, se si veprojnë për keq mbeturinat, që rrojnë

akoma në ndërgjegjen e njerëzve? Prandaj u duhet qëndruar fort atyre. Në kushtet e demokracisë sonë popullore, çdo njeri ka të drejtë të thotë pa frikë dhe kudo mendimin e vet, vetëm të jetë objektiv, të mos shpifë dhe të dëgjojë me vëmendje edhe të tjerët. Secili që është me mend në kokë, s'ka pse të mendojë për t'i bërë të keqe shokut. Këtë kërkon Partia, këtë kërkon demokracia jonë socialiste. Njerëzit, në përgjithësi, i kemi të mirë, por pikëpamjet e vjetra nganjëherë i prishin, prandaj Partia duhet të punojë shumë, në radhë të parë, për t'i ngritur ideologjikisht, për t'i spastruar nga këto mbeturina. Kjo bëhet duke vepruar me sinçeritet, duke kritikuar drejt e pa frikë çdo të metë e gabim të tjetrit, cilido qoftë ai, dhe duke mos lejuar që, nën maskën e forcimit të kurajës e të kritikës, të bëhen kritika të pabazuara, të padrejta për njerëzit tanë. Çdo njeri, në rrugë marksiste, ka plotësisht të drejtë të mbrohet, të japë arsyet në mënyrë të argumentuar, cilat janë të drejta nga kritikantët që i bëhen dhe cilat nuk janë të drejta, të tjerët të flasin edhe ata dhe të japin mendimin e tyre për çështjen që diskutohet dhe për të tjera, të godasin dhe të tregojnë se ku e çon rruga një njeri që nuk kritikon me bazë. Më në fund, kur përfundojnë diskutimet, pro ose kundër mendimeve të atij që kritikohet, i kritikuari me të drejtë mund të reflektojë dhe të arrijë në përfundimin se nuk duhet të insistojë në një çështje të padrejtë, ashtu sikurse nuk duhet «të bindet» kot së koti për diçka që s'e gjen të arsyeshme. Njeriu duhet t'u bindet arsyes, logjikës së masës, të cilat janë më të forta dhe t'i pranojë ato si të drejta.

Megjithatë, kur nuk i mbushet mendja për diçka, t'u thotë të tjerëve se ata mund të kenë të drejtë, po ai për vete nuk është i bindur akoma, prandaj të kërkojë kohë të mendohet edhe ca për çështjen që është në diskutim. Gjithashtu, t'u kërkojë ndihmë edhe shokëve, që të arrijë ta kuptojë si ata.

Kur një njeri mban qëndrime të drejta ndaj kritikave me bazë, edhe dashuria e shokëve për të rritet. Pas kësaj ata shikojnë tek ai një njeri të arsyeshëm, të ndershëm, jofodull, një njeri që vepron drejt dhe di të përcaktojë ku është e mira dhe ku është e keqja. Po ka disa që nuk pranojnë t'i kritikojë njeri, që e presin kritikën e drejtë me këmbët e para, që nuk i përfillin fare ata që i kritikojnë. Njerëz të tillë janë ata, të cilëve u rritet mendja, ngaqë kanë bërë shkollë, ose janë ngarkuar me përgjegjësi të mëdha: kush kryetar, dikush sekretar partie apo deputet e të tjerë. Bile ndonjëri, si kundërpërgjigje për kritikën që i bën dikush, e sulmon duke arritur deri në shpifje, duke pretenduar sikur gjoja një ditë s'kishte realizuar normën, ose sikur e gjeti duke fjetur në kohën e punës e për të tjera gjëra. Por një shpifës mund të shkojë edhe më larg. Në rast se ajo që e ka kritikuar është grua, i thur diçka të poshtër, duke thënë se gjoja e njeh mirë dhe, megjithëse asgjë s'di për jetën e saj, kurdis shumë gjëra kundër saj, vetëm e vetëm për ta diskredituar, për ta dëmtuar e për ta dërrmuar moralisht. Natyrisht, qëndrime të tilla, nuk kalojnë lehtë në popull, ose fundja mund të kalojnë për njëfarë kohe, por nuk qëndrojnë dot mbi ujë përgjithnjë, pse është e pamundur të gënjenen të tërë komunistët

dhe për një kohë të gjatë. Një njeri i keq mund të gënjë një ose dy veta, ose edhe organizatën-bazë për një kohë, po nuk do të mund ta bëjë këtë edhe për një periudhë të gjatë. E drejta, me siguri do të dalë në shesh. Dhe kur organizata-bazë ose kolektivi do ta kuptojë më në fund se kjo çështje nuk qëndron, por është një trillim, një gënjeshtër ose shpifje, atëherë, kësaj pune i vjen fundi. Ai që shpif, që gënjen, që trillon do të vihet patjetër me shpatulla për muri dhe do të marrë dënimin e rreptë e të merituar.

Partia i mëson njerëzit të mos kenë frikë për të thënë mendimet e tyre, qofshin këto të drejta ose të gabuara. Gjithashtu, të dëgjojnë me kujdes vërejtjet dhe gjykimin e të tjerëve për mendimin që kanë shfaqur. Kur shokët e vlerësojnë atë të gabuar, njeriu duhet të reflektojë e të reagojë drejt, të pranojë se e ka gabim. Qëndrimi i kundërt do të thotë se ai është një egoist apo mendjemadh, njeri që kujton se mendimi i tij është i paapelueshëm. Kush mendon dhe vepron kështu, është në rrugë të gabuar. Një njeri që dëshiron të shfaqë mendimet e veta para masës, duhet të dëgjojë, gjithashtu, me vëmendje edhe diskutimet, kritikën e vlerësimet që masa u bën pikëpamjeve të tij. Dhe kështu, të mirat të bëhen të përbashkëta, kurse të këqijat ai me kurajë t'i pranojë dhe të punojë që t'i hedhë në shportë. Kush mban qëndrim të tillë të drejtë para gjyqimit të masës, është me të vërtetë njeri i mirë. Këtë frymë ta çojmë te të gjithë njerëzit tanë. Puna e Partisë në këtë drejtim ka rëndësi të madhe kudo, në uzina e në fabrika, në kooperativa, në shkolla, me punëtorët, me

fshatarët, me kooperativistët, me nxënësit e me intelektualët, me qëllim që të gjithë të kaliten drejt, sipas mësimeve të Partisë, pse ka edhe njerëz që, kur i kritikon u mbetet qejfi, ca të tjerë zemërohen, ose u vjen thartë nga kritikata. Po kjo s'prish shumë punë, në mos u ardh të mirë disa të paktëve, do t'i vijë mirë shumicës, masës, që është në rrugë të drejtë dhe kjo do të ndikojë që individët e gabuar të ndreqen.

Prandaj, shokë, të punohet me shumë kujdes me njerëzit. Kur shokët udhëheqës të Partisë ose të pushtetit shkojnë në një ndërmarrje ose në ndonjë kooperativë, nuk duhet të kalojnë andej si era dhe pastaj, me lehtësi, të thonë se çdo gjë atje shkon mirë.

Një herë më erdhën disa letra nga anëtarë të një kooperative bujqësore të rrethit të Fierit. Në to shkruhej për punën jo të mirë të kryetarit të kooperativës bujqësore, i cili, bashkë me kryesinë nuk e përdorën kredinë që kishin marrë nga shteti për të bërë pagesën e anëtarëve, po për qëllime të tjera, duke gënjyer kështu edhe shtetin, edhe anëtarët. Megjithëse në këtë kooperativë kishin shkuar plot shokë të Partisë dhe të pushtetit nga Fieri dhe nga qendra, të cilët gjoja ishin interesuar për gjendjen e kooperativës, nuk kishin hyrë në thellësi të çështjeve, pra, nuk kishin zbuluar të vërtetën. As ministri dhe as sekretari i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit nuk e dinin gjendjen e atjeshme, përkundrazi, përgjigjeshin se atje punët shkonin: «Shumë mirë». Mirëpo, në bazë të verifikimit që i bënë çështjes në vend instruktorët e aparatit të Komitetit Qendror, që i dërguam menjëherë pas marrjes së këtyre letrave, e vër-

teta doli krejt ndryshe, pikërisht siç thuhej në letra. Kur instruktorët e Komitetit Qendror mblodhën popullin, konstatuan se të gjitha ato që shkruheshin në letra ishin të vërteta dhe populli kishte plotësisht të drejtë të ankohej.

Verifikimi në vend i çështjes, në radhë të parë, zbuloi të dhëna për biografinë e kryetarit të kooperativës, i cili na paskësh dalë përmbi ujë e ishte bërë kryetar kooperative, në sajë të gjakut të vëllait të tij dëshmor, por që vetë na qenkësh një ish-xhandar dhe si xhandar sillej me kooperativistët. Kurse sekretarëve të komitetit të Partisë, kryetarit të komitetit ekzekutiv dhe shokëve të tjerë përgjegjës të rrethit, ua kishte hedhur vazhdimisht me marifet. Kur këta venin për të parë gjendjen në kooperativë, s'merrnin takim me masën, po vetëm me drejtuesit, sidomos me kryetarin e kooperativës, i cili u sillej si qengj, kurse kooperativistëve u punonte të gjitha ato që thashë. Kur vajtën instruktorët e Komitetit Qendror në vend, anëtarët e kooperativës që kishin shkruar letrat, pasi u siguruan që udhëheqja ishte informuar për çështjen, u treguan të gatshëm t'i lexonin vetë letrat e tyre para popullit. Ata thanë se u kishin bërë kritika edhe më parë drejtuesve të kooperativës, por asnjë masë nuk ishte marrë kundër kryetarit. Pas të parit folën edhe të tjerët, që më kishin drejtuar letra, pastaj folën anëtarët dhe e bënë leckë kryetarin, të cilit Partia dhe masa e kooperativistëve më në fund i treguan vendin.

Duhet t'i lejojë Partia në bazë gjëra të tilla? Ç'bënte atje organizata-bazë, ç'priste, pse nuk vepron-

te? Është e drejtë dhe e mundur që të dërgohen për çdo gjë, për të zbuluar e për të luftuar shfaqje të tilla, njerëz që nga Komiteti Qendror i Partisë? Jo! Në këto raste duhet të ngrihet medoemos më këmbë vetë organizata-bazë.

Po ju tregoj edhe një ngjarje tjetër. Një vajzë e re përgatiti dokumentet dhe bëri kërkesën për t'u pranuar në Parti. Ajo është një punëtore e mirë në një ndërmarrje bujqësore të Durrësit, po që ka ardhur aty bashkë me familjen nga një rreth tjetër. Para se të diskutohej çështja e pranimit të saj si kandidate partie, asaj i duhej të merrte nga fshati një dokument ku të përcaktohej gjendja shoqërore dhe qëndrimi politik i familjes gjatë Luftës dhe pas Çlirimit, gjer në kohën kur u vendos në këtë ndërmarrje bujqësore. Komiteti i Partisë i Rrethit të Durrësit u njoftua nga fshati i lindjes së vajzës sikur babai, xhaxhai, daja dhe të gjithë pjesëtarët e tjerë të familjes së saj paskëshin qenë ballistë. Mirëpo të tëra këto ishin vetëm shpifje. Për këtë arsye vajza më dërgoi një letër ku më shkruante për padrejtësitë e shpifjet që ishin thurur kundër saj. Ajo shpjegonte se i ati nuk kishte qenë ballist, përkundrazi, kishte qenë kryetar i këshillit nacionalçlirimtar të fshatit që në fillim të luftës, se xhaxhai kishte qenë, gjithashtu, i lidhur me Partinë, po kështu edhe dajoja e gjithë të tjerët me radhë. Dhe më poshtë vazhdonte se këto shpifje i kishte thurur kryetari i kooperativës bujqësore të fshatit, i cili më parë kishte punuar në ndërmarrjen bujqësore ku jetonte e punonte tani familja e saj. Ajo sqaronte se kur ky kryetar punonte në ndërmarrjen

bujqësore, megjithëse kjo atëherë ishte akoma e vogël, edhe pse që anëtar partie, kishte degjeneruar, se Partia kishte marrë gradualisht masa ndëshkimore për të për imoralitet, e kishte kthyer në kandidat partie, e kishin kritikuar shumë herë për punë jo të mirë. Dhe ndër ata që e kishin kritikuar rëndë atëherë, sqaronte vajza, ishin dy vëllezërit e saj. Përveç këtyre, ai kishte bërë edhe falsifikim dokumenti, kishte gënjyer shtetin dhe merrte pa të drejtë pension për nënën e tij për disa vjet me radhë, duke përvetësuar një shumë që arrinte rreth 8-9 000 lekë. Kur ia zbuluan edhe këto, vëllezërit e vajzës dhe shokët e tjerë komunistë, ia ngritën përsëri në organizatën-bazë dhe kërkuan të dënohej veprimtaria e tij. Mirëpo, në vend që organizata-bazë dhe prokuroria ta çonin çështjen në gjyq, që ai sipas ligjeve të dënohej, e mbajtën përsëri në Parti, i bënë ngarkim të hollat dhe e dërguan punëtor të thjeshtë. Ai atëherë u largua fare nga ndërmarrja bujqësore dhe shkoi në fshat, ku populli, duke mos ditur gjë për të gjitha këto, e zgjodhi kryetar në kooperativë. Ishte pikërisht ky njeri, me të kaluar të keqe, që kërkoi t'i nxijë jetën një vajze të thjeshtë.

Instruktori i Komitetit Qendror, që u dërgua për verifikimin e çështjes, mblodhi fshatin. Aty asnjëri nuk dinte përse do të flitej, sepse nuk dinin gjë si kishte degjeneruar dhe çfarë kishte bërë ky vagabond, se të gjitha këto i kishin mbajtur fshehur. Fshati, posa mësoi të vërtetën, ia mblodhi këmbët në një këpucë kryetarit, e shkarkoi menjëherë nga kryesia e kooperativës dhe e dërgoi të punojë në prodhim, me qëllim që atje të riedukohej. Kështu na mëson Partia të vep-

rojmë, të ecim drejt dhe njerëzve të tillë t'u tregohet vendi.

Dëshiroj të theksoj përsëri se nuk është e drejtë të pritet që çështje të tilla, që ngjasin nganjëherë në bazë, t'i zgjidhë qendra. Kjo duhet kuptuar mirë, pse janë të tëra mundësitë që ato t'i zgjidhë vetë çdo kolektiv, i udhëhequr nga organizata-bazë. Kjo arrihet kur organizatën-bazë të Partisë ta bëjmë luftarake. Kështu edhe qendrës do t'i vijnë më pak ankesa.

Organizata-bazë duhet të ngrihet në nivel që të mos lejojë të kalojnë lehtë gjëra të tilla, përkundrazi, ajo duhet të zhvillojë një luftë të ashpër kundër çdo padrejtësie, shkeljeje, hajnije, shpifjeje e trillimi, që mund të bëjë njëri ose tjetri. Vetëm kështu do të ecim përpara me sukses në rrugën ku na udhëheq Partia për ndërtimin e socializmit. Kështu, në radhë të parë, do të forcohet vetë Partia, do të përparojnë industria, bujqësia, kultura, arsimit etj.

Pikëpamja që «ujët del i kulluar nga burimi, kurse poshtë turbullohet», krijohet, pse, shpeshherë, në bazë nuk luftohet sa duhet për të drejtën. Prandaj duhet luftuar që ujët të jetë i pastër kudo, në burim dhe gjatë gjithë rrjedhës, gjer në fund.

Por thuhet, gjithashtu, se «peshku prishet më parë nga koka», edhe kjo është e drejtë. Natyrisht, kjo thuhet kur aludohet për udhëheqjen e një vendi dhe kur ndodh kjo, është shumë e rrezikshme, është fatkeqësi e madhe dhe me pasoja të rënda për shoqërinë. Katastrofa që ndodhi në Bashkimin Sovjetik, pas vdekjes së Stalinit, e ka burimin pikërisht te tradhtia e krerëve dhe jo te baza e partisë. Dhe që të mos

ngjasë në të ardhmen një fatkeqësi tjetër si kjo, është e domosdoshme që në çdo parti baza të jetë e shëndoshë dhe udhëheqjen ta zgjedhë të shëndoshë si veten, ta ndihmojë, ta kontrollojë, ta ketë kurdoherë nën kujdesin e vet. Ndryshe do të ngjasin përsëri katastrofa, siç ngjanë në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e tjera revizioniste.

Kur flasim për kontrollin e masës, për kontrollin e klasës punëtore, me këtë kuptojmë kontrollin e Partisë dhe të masës mbi udhëheqjen. Sidomos kontrolli mbi aparatet, qofshin ato të Partisë apo të pushtetit, është shumë i domosdoshëm. Çdo problem që i shtrohet Partisë, duhet të kalojë nëpër një diskutim të zjarrtë të masave. Vendimet e Komitetit Qendror, të Byrosë Politike, të Sekretariatit, të komitetit të Partisë të rrethit, organizatat-bazë duhet më parë t'i studiojnë, pastaj t'i diskutojnë, të bëjnë vërejtje, të kritikojnë ato anë që nuk janë të drejta, ose që nuk janë plotësisht të drejta dhe pastaj t'i aprovojnë. Kjo nuk do të thotë se, duke kritikuar një të metë që konstaton, je kundër Partisë dhe nga kjo të krijohet mendimi i gabuar se nuk duhet të kritikosh. Kur organizata-bazë e Partisë studion një vendim të Komitetit Qendror dhe komunisti konstaton se shumica e çështjeve janë të drejta, kurse një ose dy nuk i duken të drejta, s'ka përse të mos flasë haptazi në organizatën-bazë. Ai duhet ta thotë hapur mendimin e tij, të shprehet përse kjo ose ajo çështje nuk i duket e drejtë dhe të propozojë si duhet bërë e si duhet vepruar më mirë. Asnjë keqkuptim nuk duhet të ndodhë në këtë rast, asnjë nga shokët nuk duhet të mendojë se,

ai që bën një vërejtje të tillë për vendimin, është kundër Komitetit Qendror ose kundër Partisë. Në asnjë mënyrë! Komunisti ka të drejtë të thotë mendimin në organizatë, të shprehet kur gjykon se duhet parë edhe një herë më mirë kjo ose ajo çështje, e cila, sipas pikëpamjes së tij, nuk është e drejtë.

Kur zhvillohet konferenca e Partisë, ku bëhet analiza e punës dyvjeçare të të gjithë organizatës së Partisë të rrethit, zakonisht, sekretari i parë mban raportin dhe pas tij delegatët ngrihen e diskutojnë për problemet që trajtchen në raport. Kështu, një shoqe delegate mund të diskutojë në konferencë për rezultatet që janë arritur në kooperativën e saj, një tjetër mund të tregojë se, në ndërmarrjen ku punon, plani është realizuar mirë e kështu mund të flasin me radhë të gjithë ata që dëshirojnë. Mirëpo, krahas punëve të mira, shoqe dhe shokë, zbulohen e duhet të zbulohen edhe detyrat që s'janë realizuar, se kudo ka edhe të meta e dobësi, prandaj, në çdo rast, krahas sukseseve që duhen vënë në dukje, ka vend edhe për kritika. Por kritika nuk para bëhen, megjithëse Partia porosit vazhdimisht që, sidomos në konferencat e Partisë, problemet të rrihen mirë, të trajtohen në gjerësi e në thellësi. Konferencat e Partisë për dhënie llogari e zgjedhje, që do të bëhen së afërmi, duhet të zhvillohen në lartësinë e duhur. Komiteti Qendror ka lëshuar direktivën që në organizatat-bazë, në komitetet e Partisë, edhe në byrotë e tyre, të zgjidhen më shumë punëtorë se gjer tani, jo se Partia nuk ka besim në elementët e shtresave të tjera shoqërore, Partia ka besim të plotë te të gjithë anëtarët e saj,

por është në interes të forcimit të Partisë që në udhëheqje të Partisë, në bazë e në rrethe, të vijnë gjithnjë e më shumë shokë nga radhët e klasës sonë punëtore.

Në organizatën e Partisë të rrethit të Mirditës ne kemi një numër të mirë punëtorësh, njerëz të një brumi të çeliktë. Shumë nga këta janë zgjedhur nga Partia në udhëheqjet e organizatave-bazë. Dhe është e domosdoshme që të tjerë të zgjidhen edhe në byronë e në komitetin e Partisë të rrethit. Shokët punëtorë nuk janë aq të zotë të fjalës sa mund të jenë intelektualët, por ata kanë gjykime të shëndosha, të forta, janë të vendosur dhe me qëndrim të drejtë politik. Në diskutimin e një problemi nuk kanë rëndësi llafet, po thelbi i çështjes. Punëtorët e nuhatin situatën dhe dinë ku të kapen për t'i zgjidhur drejt problemet. Prandaj, kur këtu te ju kemi, për shembull, një njeri besnik, një komunist me nivel të mirë politik dhe ideologjik, që është edhe punëtor shumë i mirë, i përgatitur, njeh profesionin e tij, çështjen e bakrit, atëherë këtë element të klasës, pavarësisht se në fillim mund të mos dijë shumë gjëra, përse të mos e zgjedhim në byronë e komitetit të Partisë? Një njeri i tillë do të mobilizohet me të gjitha forcat ta ndjekë punën, ta çojë e ta zgjidhë gjer në fund problemin ose vendimin që mund të merret në byro. Kur ky anëtar byroje, me gjendje punëtore, të shkojë në ndërmarrje e të vërë në dijeni organizatën-bazë dhe kolektivin për vendimin që ka marrë udhëheqja e Partisë në rreth, të informojë për detyrat dhe për afatin e caktuar, brenda të cilit duhet t'i kryejë këto ndërmarrja, të njoftojë për kurset që është e nevoj-

shme të hapen, për numrin e specialistëve që duhet të dalin prej tyre etj., të jemi të sigurt se ai jo vetëm do të kërkojë nga organizata e Partisë dhe nga kolektivi i ndërmarrjes që të gjithë të mobilizohen për të zbatuar gjer në fund vendimin e byrosë, por edhe do ta ndjekë personalisht realizimin e tij. Në qoftë se këtë punëtor do ta pengojë ndonjë burokrat, që mund të jetë në aparatin e komitetit të Partisë, ai nuk heziton nga kjo, nuk tërhiqet, por vjen deri në Komitetin Qendror. Atje parashtron mendimin e tij për zgjidhjen e problemit, shpreh bindjen se kjo është diçka e mundshme, por në rreth ose në bazë po e pengojnë, kërkon të vihet rregull për të kryer këtë punë, ose kërkon t'i jepet ndihmë për të marrë medoemos masa të shpejta. Një njeri i tillë, me kurajë, që njeh mirë problemet dhe njerëzit, kur shikon se një punë nuk është e mundur të kryhet për disa arsye të caktuara, e thotë haptas, megjithatë, ai vihet vetë në dispozicion të punës, bashkë me specialistët, të cilëve u kërkon ndihmë, kërkon prej tyre të mendojnë, të rrinë pa gjumë dhe të tërë bashkë, me atë në ballë, ta zgjidhin problemin.

Kështu i do Partia drejtuesit dhe punëtorët e saj, të jenë energjikë e të mos tërhiqen, të jenë të vendosur, siç është vetë klasa punëtore. Po të zgjidhen në udhëheqje të Partisë njerëz të tillë energjikë, të palodhur, të vendosur e të sakrificës, atëherë do të shohim ç'besim i madh do të krijohet te njerëzit për Partinë, në bazë dhe në rreth. Prandaj zgjedhja e elementit punëtor në udhëheqje është e domosdoshme. Kur shtroj këtë problem nuk dua të them se ne nuk

kemi fare punëtorë në byrotë ose në komitetet e Partisë, por nuk kemi sa duhet. Kjo ka ardhur se nuk kishim një klasë punëtoresh të madhe, kurse tani e kemi klasën punëtoresh të gjerë, të formuar, të zonjën. Ajo ka arritur nivel pjekurie të atillë sa që është në gjendje të mbajë frenat e drejtimit dhe të vërë në lëvizje të gjitha hallkat e jetës së vendit.

Gjer tani ne kemi praktikuar disa norma, sipas të cilave, në byronë dhe në komitetin e Partisë të çdo rrethi, zgjidheshin gati të gjithë kuadrot drejtues të Partisë, të organizatave shoqërore e shtetërore, pra, në shumicën dërrmuese, zyrtarët. Tani Partia ka hedhur direktivën që kudo të ketë më shumë punëtorë.

Aparatet e Partisë dhe të shtetit janë të domosdoshme për pushtetin e demokracisë sonë popullore, për diktaturën e proletariatit, por në to bëjnë pjesë punonjës të emëruar, që nuk janë të zgjedhur nga populli ose nga Partia. Njerëzit e aparateve, për shembull, instruktorë, kryetarë dege, shefa e të tjerë, janë punonjës të emëruar, që punojnë në zyra, pra, janë në dispozicion të udhëheqjes së Partisë dhe të pushtetit dhe nën drejtimin e tyre vihen në lëvizje për të zgjidhur shpejt, drejt dhe mirë problemet e ndryshme. Në qoftë se aparatet i lëmë të trashen e të burokratizohen, ato, pak nga pak, fillojnë t'i hipin në kokë udhëheqjes dhe pastaj, gradualisht, vjen koha që aparatet e mbytin, nuk lejojnë të veprojnë pushteti i demokracisë popullore, paralizojnë veprimin e diktaturës së proletariatit. Kjo do të thotë që, në vend të organeve të zgjedhura, të bëhen zot administratorët, shefat, instruktorët e të tjerët. Po të ndodhë kjo, është

shumë e rrezikshme, sepse në aparatet nuk do të dëgjohet më fjala e masës, e Partisë, e klasës punëtore. Atëherë, ç'të bëjmë që të mos na ndodhë një gjë e tillë? Të ngremë më këmbë masat, me në krye komunistët, të bëjmë që klasa punëtore t'i kuptojë mirë parimet e demokracisë sonë socialiste, të centralizmit demokratik, të kuptojë mirë ç'është pushteti ynë i diktaturës së proletariatit dhe cili është roli i administratës te ne, të kuptojë përse duhet dhe si duhet të shfrytëzohet e të kontrollohet administrata, cilat janë sëmundjet që e prekin atë më shpejt dhe si duhen shëruar. Të gjitha këto parime Partia i ka sqaruar vazhdimisht.

Në vendin tonë masat, nën drejtimin e klasës punëtore, të udhëhequr nga Partia, janë në fuqi, prandaj duhet të jenë ato që të kontrollojnë çdo gjë, drejtuesit, komitetet, vendimet që marrin ato etj. Kjo duhet të kuptohet drejt dhe të zbatohet mirë në jetë, me qëllim që diktatura jonë e proletariatit të mos zërë ndryshk, të mos mund të burokratizohen aparatet e të mbytin këtë diktaturë dhe Partinë, siç ndodhi në vendet ku kanë ardhur në fuqi revizionistët, ose siç është realiteti në vendet kapitaliste. Kjo është një luftë e përditshme, e vazhdueshme, që bëhet në vendin tonë nën udhëheqjen e Partisë. Ajo është shumë e rëndësishme dhe ka të bëjë me fatet e Shqipërisë, me të tashmen dhe me të ardhmen e atdheut.

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në
AQP

ÇONI NË FSHAT FRYMËN REVOLUCIONARE TË KLASËS PUNËTORE

Nga biseda me një grup metalurgësh në Rubik

27 maj 1968

Pasi u interesua për kushtet e punës dhe të jetesës së punëtorëve, për higjienën, për veshjen e metalurgëve, për gjendjen e tyre shëndetësore, shoku Enver tha:

Nuk duhet të lejoni që ekipet që vijnë këtu nga rrethi ose nga qendra për t'ju vizituar, të bëjnë një punë të përciptë, pastaj të marrin çantat nën sqetull e të ikin. Ju mos i lejoni mjekët të largohen, pa ju dhënë llogari për atë që bënë e konstatuan, mos lejoni të largohen pa ju thënë ç'rezultate nxorën nga vizita apo nga studimi që bënë.

Mendoj se për mbrojtjen e shëndetit të punëtorëve, duhet të vijë këtu një ekip mjekësh, që të kontrollojë nëse ka gazra helmuese apo jo, veprimin e tyre etj., pse kjo ka rëndësi të madhe për shëndetin tuaj, për jetën tuaj. Në rast se ekipi do të gjykojë se nuk ka rrezik helmimi, se erërat fryjnë në mënyrë që i lar-

gojnë gazrat, të përgatitin raportin përkatës, të cilin t'jua komunikojnë juve. Vetëm pas kësaj mund të largohen mjekët. Asnjë nga ekipet nuk duhet të veprojë, siç është bërë zakon të veprohet, duke u larguar pa i dhënë llogari njeriu. Është e qartë se edhe andej lart nga qendra ka dhe veprojnë akoma metoda burokratike, kundër të cilave duhet të luftojmë të gjithë.

Juve, shokë e vëllezër punëtorë të Rubikut, këtu ju jepet qumësht, të cilin duhet ta pini, pse ai është një ushqim antitoksik dhe që ndihmon për të pastruar organizmin nga helmet. Qumështi nuk ju jepet që të hani drekën ose darkën me të, po për tjetër funksion. Në rastin tuaj ai duhet përdorur vetëm për t'u pirë.

Kujdes i veçantë duhet treguar dhe duhen krijuar kushte që punëtorët të mos ftohen. Brenda në repartin e shkrirjes pashë se bën shumë nxehtë, kurse jashtë ka korrente erërash të forta e të ftohta, që janë shumë të rrezikshme. Për këtë qëllim, shikoni nëse mund të bëhet ndonjë mur mbrojtës për t'i penguar ato e për të ruajtur shëndetin e punëtorëve.

Duke bërë bilancin e ndryshimeve që janë bërë, si kudo në Shqipëri, edhe në Mirditë ka përparime dhe është ecur shumë përpara. Në këtë drejtim ka ndikuar edhe karakteri i njeriut mirditor, që, në përgjithësi, nga natyra, është i zgjuar, por kjo nuk është e gjitha dhe e vetmja. Në këtë zhvillim të madh në rrethin tuaj kanë luajtur rol të rëndësishëm vetë hapja e minierave, mbrojtja juaj me vështirësitë e mëdha të natyrës, lufta për të fituar bukën etj. Të gjithë këta faktorë ju kanë kalitur jo vetëm fizikisht, por edhe mendërisht. Prandaj te ju shumë anë të mira të karak-

terit tuaj po vihen re gjithnjë e më shumë gjatë revolucionarizimit të madh, që ka shpërthyer kudo në jetën e vendit tonë. Kjo duket edhe në qëndrimin që mbani për emancipimin e gruas.

Në fillim gratë, gati kudo në Shqipëri, gjenin shumë pengesa, sidomos kur u bëhej thirrje të shkonin nëpër aksione. Ndryshe ishte gjendja në Mirditë. Qysh në vitet e para pas Çlirimit, shumë vajza e gra të reja mirditore kanë shkuar në aksione, pavarësisht se reaksioni në rrethin tuaj në ato kohë ka qenë me të vërtetë i egër. Ai na ka vrarë, siç e dini, mjaft vajza e gra heroina. Gjaku i tyre, forca dhe rezistenca e popullit, e klasës punëtore dhe e Partisë kanë bërë që sot pjesëmarrja e grave dhe e të rejave mirditore në aksionet e mëdha kombëtare, si në hekurudhën e rinisë etj., të jetë mjaft e gjerë.

Megjithatë kemi akoma rrethe ku ka vajza të reja, të cilat, pasi martohen, rrinë deri motmot pa punë, mbyllen brenda në shtëpi, pra, në njëfarë mënyre dembelosen. Ky është një zakon shumë i keq. Në Mirditën tuaj, vajzat jo vetëm nuk rrinë mbyllur brenda shtëpisë, por, pas dasmës, ato dalin pa vonesë në punë, bile shumë vajza mirditore të porsamartuara kanë shkuar në hekurudhë, në kurse etj.

Javën e kaluar bëra një vizitë në kursin e vajzave e të grave të reja, që kemi hapur në Durrës¹. Midis të tjerave, më doli përpara një vajzë rreth 19 vjeçe, e cila më tregoi se ishte nga Mirdita. Qe veshur me rroba mirditore, që mua më pëlqejnë shumë, pra-

¹ Shih në këtë vëllim f. 79.

ndaj e këshillova të mos i hiqte, siç u kishin thënë disa shokë, se janë me të vërtetë të bukura. Po, natyrisht, ato duhet të vishen në ditë festash e jo në punë. Vajza më tregoi se ishte martuar pak ditë më parë se të vinte në kurs. Po sa bukur fliste! E pyeta, si e lejoi burri kaq shpejt dhe m'u përgjigj se ai jo vetëm e kishte lejuar, por edhe e kishte porositur të mësonte sa më mirë në kurs dhe të kthehej në fshat e mësuar. Kur i thashë se paskësh një burrë shumë të mirë, më tha se ai ishte komunist. Jo vetëm ajo, po të tëra vajzat dhe gratë e këtij kursi mësonin për mrekulli, si të bënin gjellë, të prisnin e të qepnin, mësonin për higjienën etj. Edhe këto kanë rëndësi të madhe për jetën. Vajzat, që i mësuan këto gjëra, do të çojnë elemente të së resë në mënyrën e jetesës në fshat.

Ju, shoqe dhe shokë kooperativistë, përveç punëve të tjera, mësohuni të përgatitni vetë në kooperativat tuaja edhe petë, kritharaqe, trahana etj., siç e kanë traditë të bëjnë në shumë krahina të vendit tonë. Kam dëgjuar se tani, në rrethin e Durrësit, nëpër kooperativa kanë çuar disa makina të vogla, me të cilat kanë filluar të bëjnë nga të gjitha llojet e makaronave, makarona fidhe për supë, makarona të gjata, të shkurtra etj. Këto janë gjëra të vogla, prandaj s'ka arsye të mos bëhen edhe te ju. Edhe ju mbillni grurë, prandaj janë të gjitha mundësitë që të përgatitni nga këto ushqime.

Shokët punëtorë të metalurgjisë, që i kanë familjet në fshat, në radhë të parë, duhet të çojnë në kooperativat e tyre frymën revolucionare të klasës punëtore. Kurdoherë, në çdo gjë, të jenë në pararojë, sidomos në luftën kundër zakoneve prapanike, kundër fesë e

bestytive, kundër qëndrimeve të padrejta ndaj grave e vajzave. Të jenë përkrahës dhe luftëtarë për futjen e së resë përparimtare në jetën e fshatit për higjienizimin e tij etj. Në qoftë se ata nuk e bëjnë këtë, kjo, nganjëherë, vjen edhe për shkak se, kur kthehen nga ndërmarrja në fshat, fizikisht e ndiejnë veten ca të lodhur, mirëpo lodhja nuk duhet ta mposhtë kurrë hovin luftarak të punëtorit. Pastaj keni parasysh që gratë, mëmat, motrat e vajzat tuaja nuk punojnë më pak se ju, ato punojnë në shtëpi dhe në kooperativë, prandaj mund të themi pa frikë që punojnë më shumë nga burrat.

Ju, metalurgët e minatorët e Rubikut, kryeni punë nga më të rëndat. Nuk e them për t'ju bërë qejfin, por e vërteta është se ju jeni njerëz të pararojës. Ju jeni nga punëtorët më të vjetër e më të kualifikuar të minierave në vendin tonë. Nga gjiri juaj dalin njerëz të kalitur të klasës. Fryma që çoni ju në fshatra ndikon dhe do të ndikojë akoma më shumë te kooperativistët, por mos u kënaqni me këtë, vazhdoni t'i çoni mësimet e Partisë dhe të klasës akoma më mirë në fshat, pse kjo është një punë mjaft e dobishme dhe që do të kurorëzohet me rezultate të mëdha.

Ju, metalurgët e bakrit, elementë nga më përparimtarët, më të ndërgjegjshmit e më të lavdishmit të klasës sonë punëtoare, të keni parasysh që, kur shkoni në kohën e lirë pranë familjeve, të çoni atje çdo gjë përparimtare që mësoni e përvetësoni këtu, sidomos rregullat, disiplinën proletare, politikën e Partisë, drejtësinë, kulturën që merrni, ndershmërinë. Luftoni për vënien në vend të autoritetit të gruas, për respektin komunist reciprok të burrit ndaj gruas dhe të kësaj

ndaj burrit. Punoni që dashuria në mes gruas dhe burrit të kalitet në frymën proletare, dashuria në mes prindërve dhe fëmijëve të jetë e shëndoshë, komuniste. Këmbënguljen, dashurinë dhe respektin që keni ju për punën, këtë forcë shpirtërore që tregoni këtu, në zjarrin e furrave ku shkrini metalin, çojeni edhe në familjet e në kooperativat tuaja, që edhe atje në frontet e punës në bujqësi të sigurohen realizime akoma më të mëdha, pse, me gjithë përparimet e shumta që kemi bërë, akoma jemi prapa.

Çfarë mund dhe duhet të bëjmë ne akoma këtu në Mirditë? Të kënaqemi vetëm me këto që kemi bërë? Në asnjë mënyrë! E para e punës, këtu ne duhet të hapim dhe të ndërtojmë miniera të tjera, të reja bakri, i cili ka një perspektivë të madhe në vendin tonë. Këto miniera të përpiqemi t'i ndërtojmë me një ritëm më të shpejtë se ato gjer tani, sigurisht, pa lënë pas dore zgjerimin e kapacitetit të minierave, të uzinave e të fabrikave ekzistuese. Kjo do të bëjë që klasa punëtore e rrethit tuaj, që përbën forcën, kolonën vertebrore të pushtetit tonë popullor, të rritet më tej dhe të ngrihet niveli i saj politik, edukativ dhe material.

Por zhvillimi i industrisë përbën një rën këmbë të organizimit të ekonomisë sonë, që të mbahet gjallë ajo e të ecë drejt, duhet të jetë e shëndoshë edhe këmba tjetër, bujqësia, kurse kjo, ta themi haptazi, këtu te ju është akoma prapa. Nuk duhet të kënaqemi vetëm me sigurimin e bukës dhe me rritjen e 200 ose të 300 deleve apo dhive në një kooperativë. Në radhë të parë, të hapim kudo sipërfaqe të mëdha tokash të reja. Të tilla këtu te ju ka plot, prandaj, me krahë e me trak-

torë, të punojmë për t'i zhdukur sa më parë pyjet e degraduara, t'i kthejmë këto ose në pyje të vërteta, ose në ara pjellore. Zgjerimi i tokave të mbjella do të na detyrojë të pakësojmë dhitë dhe delet, prandaj, në vend të tyre, të shtojmë numrin e lopëve dhe të synojmë rritjen e lopëve që kanë prodhimtari të lartë qumështi dhe që japin nga 1 500-2 000 e më shumë litra qumësht në vit, si dhe sasi të mëdha plehu, i cili na nevojitet për të siguruar rendiment më të lartë në misër e në grurë. Në tokat e reja që do të hapni, mbillni misër, grurë, foragjere e tagji për rritjen e kafshëve dhe për shtimin e pjellorisë së tyre, për t'i siguruar kështu popullit sa më shumë bukë, mish, qumësht, djathë, gjalpë e të tjera.

Në këtë drejtim ne kemi shumë për të bërë dhe do t'i bëjmë vetë, do t'i bëjë forca e njeriut tonë, nën udhëheqjen e drejtë të Partisë, do t'i bëjnë puna e mirë organizuese, disiplina, ndërgjegjja revolucionare e klasës sonë punëtoare.

Nga vjeshta që vjen do të bëhet konferenca e Partisë e rrethit tuaj. Atje ju, komunistët punëtorë, do të dërgoni përfaqësuesit tuaj më të mirë. Përpiquni që në komitet dhe në byro të zgjidhen punëtorë nga ata më të dalluarit, më të vendosurit, që ushqejnë dashuri të thellë për popullin dhe për Partinë, që janë gati të bëjnë për to sakrificën më të madhe. Ne edhe intelektualë do të kemi në udhëheqje, kur ata janë anëtarë partie, të edukuar me frymën e klasës, se janë, gjithashtu, shokë, që i qëndrojnë besnikë Partisë deri në fund, deri në vdekje, por Partia thekson që në udhëheqje shumica të jenë punëtorë, sepse, kur bie ndonjë

«tërmet i fortë» dhe ndonjë intelektual lëkundet, punëtori, si më i qëndrueshëm e më rezistent që është, i jep zemër atij, i jep forcë të mbahet. Ne, intelektualët, nuk kemi vuajtur si ju punëtorët, prandaj kemi shumë nevojë për kalitjen tuaj.

Kur ndodh ndonjë furtunë, që rrezikon diçka dhe bëhet thirrje për ta shpëtuar, intelektual, para se të dalë, do të veshë fanellën, kurse punëtori del në çast, edhe pa fanellë, zbathur, ashtu si të ndodhet. Ne, intelektualët, kemi shumë nevojë për nxitjen tuaj, për forcën dhe për qëndrueshmërinë tuaj, por kjo është më e efektshme për Partinë kur ju punëtorët zotëroni, në radhë të parë, teorinë marksiste-leniniste, prandaj, me durimin dhe me vullnetin që ju karakterizon, futjuni punës për përvetësimin e saj dita-ditës e më mirë.

Për t'i realizuar këta objektiva duhet që klasa jonë punëtore të jetë kudo në pararojë, të kontrollojë çdo gjë, çdo veprimtari të jetës së vendit, të kërkojë që të zbatohen gjer në fund vendimet që merr Partia, pararoja e saj. Klasa punëtore të punojë që të vendoset kudo disiplina e hekurt e klasës. Të vendosësh disiplinë të hekurt, do të thotë të krijosh një unitet të çeliktë në popull, deri edhe në familje të ekzistojë një dashuri e pakufishme në mes gruas dhe burrit, në mes nënës e babës, djalit e vajzës, t'u krijojmë të gjithëve besimin e madh në jetën që ka ndërtuar e po ndërton Partia, në të ardhmen tonë të bukur socialiste dhe komuniste.

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në AQP

KUJDESI PËR SHËNDETIN E NJERIUT — DETYRË E MADHE E PARTISË

*Nga biseda me anëtarët e byrosë së Komitetit
të Partisë të Rrethit të Rrëshenit*

27 maj 1968

Pasi u informua për gjendjen politike, shoqërore dhe ekonomike të rrethit të Rrëshenit, për realizimin e detyrave dhe për vënien në jetë të direktivave të Kongresit të 5-të të Partisë, për iniciativat e shumta, për sukseset në kolektivizimin e bujqësisë, për mënyrën e jetesës dhe për kurajën me të cilën njerëzit kritikojnë të metat e dobësitë, e mori fjalën shoku Enver Hoxha:

Ju në rrethin tuaj, siç më raportuat, keni një situatë shumë të mirë. Kjo i dedikohet punës së palodhur të Partisë. Pozitiv është, gjithashtu, fakti që kritika po forcohet, sepse, pa të, gjendja në çdo vend do të ishte njëlloj si ajo e ujit të ndenjtur. Prandaj, kudo ku ka gabime e të meta, duhet të ketë medoemos edhe kritikë, pse kështu do të gjendet rruga e drejtë e zgjidhjes së çdo problemi, kështu do të ndreqen gabimet. Na-

tyrisht, kritikë do të bëhet aty ku është e nevojshme e jo kritikë për kritikë. Kur diku, për një kohë nuk ka gabime, nuk është e thënë të ketë medoemos kritikë. Megjithatë, kjo gjendje duhet të na shqetësojë, të na bëjë të mendojmë, se përvoja na mëson që njerëzit, sado eksperiencë dhe zotësi të kenë, sado të matur të jenë, në punë e sipër edhe gabojnë. Ka momente kur njeriu nuk u jep dot zgjidhjen e duhur të gjitha çështjeve, ose nuk u futet dot thellë të gjitha problemeve. Ndosht, nganjëherë, të të duket sikur e ke zgjidhur drejt një problem, kurse kjo zgjidhje mund të jetë e çalë. Këto dobësi e të meta në punën e kuadrove masat i shohin, i gjejnë, prandaj dhe duhet të bëjnë kritika.

Kritika nuk duhet të ketë qëllime të këqija, poshtëruese, shkatërruese, përkundrazi, ajo kurdoherë të jetë me karakter konstruktiv. Që punët të na ecin mbarë është e nevojshme pikërisht një kritikë e tillë, bile është shumë e domosdoshme. Prandaj, kur shohim se kritika bëhet nga këto pozita, jo vetëm të jemi të kënaqur dhe ta mirëpresim, por edhe ta inkurajojmë.

Është gjë shumë e mirë fakti që keni dërguar në ndihmë të kooperativave bujqësore kuadro punëtorë nga minierat. Tani duhet punuar akoma që ata të lidhen mirë me jetën, me tokën dhe me ekonominë e kooperativës.

Gjithashtu, mirë keni punuar, më duket mua, edhe në drejtim të luftës kundër rriteve dhe zakoneve fetare, por lufta kundër tyre akoma duhet të vazhdojë dhe komunistët të jenë në ballë të saj. Duhet punuar

pa pushim me njerëzit, sepse ka nga ata që, fshehë-
razi, vazhdojnë të falen nëpër shtëpi. Shokët e Partisë
në Elbasan na kishin raportuar se besimtarët hoqën
dorë nga agjërimi, mirëpo, në një fshat, ku kishin
shkuar disa shokë për të bërë një konferencë, pikë-
risht për probleme të luftës kundër fesë, fshatarët i
dëgjuan dhe i aprovuan me fjalë gjithë sa u thanë. Më
pas, kur të deleguarit provuan të ndiznin bashkë me
ta nga një cigare gjatë pushimit të mbledhjes, shumë
prej tyre refuzuan, sepse mbanin ramazan. Përpara
i përgatitnin haptazi vezët e kuqe për pashkë, kurse
tani jo, veçse, aty-këtu, fshehtazi, ato janë dukur në
ditën e pashkëve, bile ka njerëz edhe në qytete, që në
ditë festash fetare bëjnë ëmbëlsira.

Natyrisht, besimet fetare janë futur në popull she-
kuj me radhë, prandaj nuk zhduken dot menjëherë.
Nuk mund t'i qortojmë pleqtë për ëmbëlsirat e pash-
këve ose të bajramit, po punën edukative, politike
me ta ta bëjmë vazhdimisht, pa u ndalur. Ndonjërit,
që ditën e pashkës ose të bajramit vishet më mirë se
ditët e tjera, është e udhës t'i themi se ruan në veten
e tij besimin fetar, se ai e konsideron këtë ditë, një
ditë feste dhe kështu e ndien në zemrën e vet. Prandaj
atij i duhet shpjeguar me durim e gjakftohtësi se
pashka apo bajrami asnjëherë nuk u ka sjellë njerëzve
ndonjë të mirë. Propaganda jonë të ndikojë që pleqtë,
gradualisht, të binden për kotësinë e fesë dhe kështu,
brenda tre, katër ose pesë vjetësh, të çlirohen nga zin-
xhirët e saj.

Puna që bëni ju për leximin e shtypit në brigada
dhe në familje, me anën e të rinjve që kanë qenë ak-

sionistë, është gjë e mirë. Në kursin e grave dhe të vajzave të reja, që vizitova javën e kaluar në Durrës, kishte dhe disa mirditore, për të cilat më thanë se gjatë kohës së kursit e kanë kuptuar rëndësinë e leximit të gazetës. Në fillim, gjatë orëve të lira, u lexonin ndonjë artikull, që kishte të bënte me çështje të bujqësisë, kurse më pas, në ditët e mbarimit të qëndrimit të tyre në kurs, u lexonin edhe për shumë probleme të tjera, saqë kursantet filluan të shfaqin dëshirë për ta lexuar vetë gazetën dhe, pas kësaj, të merrnin me mend, të kuptonin sa shumë kishin humbur ngaqë nuk kishin lexuar më parë. Vajzat e rrethit tuaj, që ishin në këtë kurs, më thanë se disa nuk kishin kapur laps me dorë që kur kishin mbaruar shkollën fillore, bile nuk kishin lexuar një gazetë apo revistë e jo më libër, prandaj shkruanin e lexonin me shumë vështirësi. Në kurs kishin punuar për t'u riaftësuar dhe donin të mësonin më shumë. Njëra më tregoi edhe sa vështirë e pati ditët e para të shkruajë, qoftë edhe një radhë sa t'i çonte një letër familjes, kurse më vonë mësoi për bukuri. Të tëra vajzat dhe gratë ishin të pajisura me fletore, ku kishin praktikuar shkrimin, kishin mësuar të mbanin edhe shënime gjatë mësimeve që u jepeshin për gatimin e gjellëve, për të prerë e për të qepur, për të mbajtur më mirë higjienën personale dhe të familjes etj. Disa më treguan fletoret e tyre, në të cilat kishin bërë shkrim shumë të bukur. Të gjithave u ishte ngjallur një dëshirë e madhe për shkrim e lexim.

I përmenda këto për të theksuar se leximi i shtypit duhet të bëhet edukatë për njerëzit. Këtë punë gati e kemi neglizhuar, ose e bëjmë në mënyrë shumë të

cekët. Kështu, nëpër brigada, kooperativistëve u lexohet nga pak gjatë pushimit, në vend që kjo punë të organizohet mirë dhe të zgjerohet, në mënyrë që asnjë kooperativist të mos mbetet pa lexuar, ose pa dëgjuar problemet që ngre shtypi ynë i përditshëm.

Mendoj që ju shokët e rinisë, në planet tuaja të punës, të keni kujdes dhe të parashikoni që aktivistët e organizatës së rinisë në kooperativa t'u mësojnë kooperativisteve të reja, nëpër brigada, si ta lexojnë gazetën. Kjo punë duhet bërë me durim. Po të jetë e mundur ata t'i udhëzojnë shoqet e tyre edhe si të lexojnë sot një artikull, nesër një tjetër e kështu me radhë për njëfarë kohe, gjersa leximi t'u bëhet shprehë dhe nevojë. Në këtë mënyrë ju do të bëni një punë shumë të madhe, se çdo artikull në vetvete synon dhe ndikon në edukimin e njeriut për shumë probleme. Një vajze kooperativiste, me shoqet e saj, pasi të kenë lexuar një artikull, sipas rekomandimit të aktivistit, mund t'u ngjallet dëshira t'i kapërcejnë kufijtë e rekomandimit. Pas ca kohësh, ato vetë do t'i thyejnë këta kufij e dëshira për të lexuar më shumë do të jetë e madhe. Kështu, ato, do të përfshihen më gjerë në procesin e edukimit, që Partia po e zhvillon me çdo njeri, me qëllim që secili të edukohet e të kalitë ndër-gjegjen. Puna me shtypin duhet zhvilluar rregullisht se është lënë pas dore. Ne kemi trajtuar si më të rëndësishme çështjen, që shokë përgjegjës nga rrethi, ose përgjegjësja e gruas të venë në kooperativë e t'u bëjnë kooperativistëve dhe grave e vajzave kooperativiste nga një bisedë. Natyrisht, edhe kjo duhet bërë, por nuk mjafton. Njerëzit tanë kanë nevojë për më

shumë, për një ushqim më të bollshëm e të përditshëm, i cili merret edhe nëpërmjet shtypit.

Për sa i përket një problemi tjetër, atij të prishjes së fejesave, me të mitur ose me diferenca të mëdha moshe, ju thoni se keni bërë përparime. Megjithatë, mos harroni se duhet të ketë dhe ka raste që ndonjëri, ndoshta me shumë frikë, po përsëri vepron në mënyrë ilegale. Këta njerëz, që veprojnë në mënyrë të tillë, në kundërshtim me ligjet tona, natyrisht, do të kenë dhe le të kenë frikë nga ligji, po Partia duhet të punojë që, kundër tyre, në një shkallë të lartë, të ngrihet më këmbë tërë opinioni shoqëror, me qëllim që njerëz të tillë të mos marrin guximin të fejojnë vajzat me moshë të vogël, kur ato akoma nuk janë në gjendje të kuptojnë aktin e rëndësishëm të fejesës e të martesës. Partia dhe levat e saj në rreth të marrin masa për të popullarizuar ligjet e t'u thonë punonjësve se nuk duhet lidhur asnjë martesë në kundërshtim me ligjin dhe, nëqoftëse ka njerëz, që e bëjnë fakt të kryer një martesë të tillë, ajo ligjërisht nuk njihet. Ju duhet të propagandoni me forcë që martesat të lidhen në rrugë ligjore, të regjistrohen më parë në zyrat përkatëse të gjendjes civile, të cilat, para ligjërimit të martesës, do të shikojnë plotësimin e të gjitha kushteve, moshën e të dy palëve, pëlqimin e bashkëshortëve të ardhshëm e të tjera. Gjithashtu, prindërve duhet t'u bëhet edukatë se nuk kanë të drejtë morale ose ligjore t'u imponojnë fëmijëve vullnetin e tyre për martesë, ashtu siç bëhej më parë. Djali dhe vajza duhet ta shprehin vetë vullnetin e tyre të lirë për t'u bashkuar në martesë.

Puna edukative e Partisë me masat të vlejë që ato të kuptojnë se veprimet ilegale dhe presionet për martesë, që mund t'i bëhen vajzës ose djalit, nuk mund të përfundojnë mirë, sepse e vërteta, në mos në çastin kur të dy të ndodhen përpara gjendjes civile dhe t'u kërkohet të shprehen nëse e duan njëri-tjetrin apo jo, do të dalë, patjetër, më vonë. Duke bërë punë të pandërprerë edukative me të rinjtë e të rejat, ata, kur të arrijnë në moshë, do të jenë të përgatitur ideologjikisht, të pjekur dhe do të kenë guximin të ngrihen kundër atij akti të padrejtë, që kreu ndaj tyre një prind i padenjë, i cili shfrytëzoi ndjenjat e fëmijës së vet.

Të punohet me prindërit, që kanë mendime të prapambetura, që ta kuptojnë se opinionin dhe masën e popullit janë në gjendje të marrin vesh çdo lloj dallave që mund të punojë kushdo, sidomos në kurriz të vajzës së vet. Partia duhet t'i bëjë të qarta këto çështje, duke demaskuar, njëkohësisht, edhe ndonjë, që del kundër normave të moralit tonë komunist. Kështu, mund të ketë të tjerë që mendojnë të bëjnë akte të tilla kundër fëmijëve dhe, në veprofshin kështu, do të ndiejnë se syrit të masës askush nuk i shpëton dot e do të mbledhin veten, do të tërhiqen. Kurse ai që nuk do të tërhiqet nga rruga e shtrembër, të jetë i sigurt se një ditë do të demaskohet. Këto masa që po marrim janë parandaluese dhe do t'i ndihmojnë të vijnë në rrugë të drejtë, ata që mendojnë e që veprojnë në kundërshtim me normat e moralit e me ligjet tona.

Nga ana tjetër, organizata e rinisë t'i japë rëndësi këtij problemi, ta mbajë në qendër të vëmendjes

dhe të bëjë punë të organizuar. Ajo duhet të jetë e përgatitur që, kur të marrë vesh një rast të tillë, të dijë si të punojë, qoftë me të riun e një fshati ose të një rrethi tjetër, që jashtë dëshirës e kanë fejuar me një vajzë nga fshati apo nga rrethi i tij ose nga një rreth tjetër. Organizata e rinisë, në këtë rast, të njoftojë organizatën e rinisë të fshatit ose të rrethit tjetër dhe vetë të punojë me prindërit e vajzës.

Kudo po bëhen tani përpjekje që në martesat të futen normat e reja. Përpara, edhe për gjëra që sot na duken të thjeshta, nuk ka qenë e lehtë, sepse dhëndri, për shembull, e kishte të zorshme edhe të shkonte të merrte nusen, ose të dilte në fotografi me të ditën e martesës etj. Tani, këto na duken si të çuditshme, por për atë, që për herë të parë thyen një normë të së vjetrës, ky është një hap i madh përpara. Në kohën kur janë martuar prindërit tanë, përveç këtyre, kishte edhe shumë bestytни, si: «ruajtja nga syri i lig», «nga magjitë» etj. Kështu, nuses i vinin tiganin përpara «për të mos e marrë sysh», ose bënë plot veprime të tjera të kota si këto. Ishte edhe zakoni që nusja të mos kalonte në rrugën nga kishin ardhur krushqit, ose që mund të kishte kaluar një nuse tjetër atë ditë, pse, sipas besimtarëve, mundet t'i kishin bërë «magji». Këto bestytни, para Çlirimit, kishin ngulur rrënjë jo vetëm në fshatra, po edhe në qytete. Tani, në qytete, këto i përkasin së kaluarës dhe të rinjtë tanë, kur i dëgjojnë, çuditën, por në fshatra, me gjithë përpimet e mëdha, ka akoma më shumë mbeturina të cilat Partia duhet t'i luftojë vazhdimisht, me kujdes dhe me durim.

Këtu u tha për përpjekjet që bëhen lidhur me konservimin e ushqimeve për dimër, si: lakra, turshi, fasule, mish derri etj. Mishi i dërrit me lakrën janë dy ushqime që, të kombinuara me njëra-tjetrën, shkojnë shumë mirë dhe japin gjellë të shijshme. Nga ana tjetër, ju duhet të luftoni që, veç lakrës, të prodhoni edhe zarzavate të tjera. Çdo kooperativë të mendojë seriozisht të mbjellë domate, patëllxhanë, pipërka, bamje, kastraveca, kunguj, karota, spinaq, lakër, presh etj., etj. Dhe, në radhë të parë, përpiquni që fshatarët të mësojnë mënyrën e përdorimit dhe të gatimit të këtyre zarzavateve dhe t'i shfrytëzojnë në ushqimin e tyre, bile me shumicë. Pra, në këtë drejtim komunistët të parët, duhet të bëjnë një punë të madhe bindëse, se akoma ka fshatarë të cilët ekziston mendimi i gabuar se njerëzit nuk mund të hanë barëra, si kafshët. Gratë dhe vajzat tuaja në kursin e Durrësit, kur i provuan gjellët me barishte, i pëlqyen dhe u kënaqën, se ato gjellë janë shumë të mira e të shijshme. Jo vetëm kaq, por gjatë muajve që mësuani në kurs, ato njohën edhe vlerën e madhe ushqimore të zarzavateve, mësuani për vitaminat që përmbajnë dhe që ndikojnë në forcimin e organizmit. Shumë gjëra ne nuk i dimë, por duhet t'i mësojmë edhe në punë e sipër, edhe duke lexuar.

Një ditë po lexoja një libër për këto çështje dhe aty pashë diçka që nuk e dija. Një profesor, nga më të mëdhenjtë në mjekësi, shkruante se majdanozi përmban disa lëndë ushqyese që janë shumë të nevojshme për organizmin e njeriut dhe për gjakun. Nuk më kishte shkuar në mendje që kjo barishte, të cilën ne e

hedhim në gjellë për t'i dhënë erë të këndshme, të kishite disa substanca që nuk i kanë bimë të tjera. Për këto, mjekësia rekomandon si të domosdoshëm përdorimin e tij edhe në ato gjellë që na duket sikur nuk shkon.

Të gjitha këto njohuri ne duhet t'ua japim qytetarëve e fshatarëve, që të kuptojnë se organizmi i njeriut nuk rron vetëm me mish, edhe sikur këtë ta kishim me bollëk. Tani për tani ne nuk e kemi akoma sasinë e duhur të mishit për frymë. Megjithatë, mishi nuk është ushqim shumë i rekomanduar, sepse përmban lëndë toksike dhe kur hahet pa masë, dëmton. Ka vende që, në përgjithësi, e përdorin mishin më shumë, por meqenëse kanë konstatuar që nuk u bën mirë, përpiqen të sigurojnë sa më shumë zarzavate nga vende të tjera, sepse vetë kanë klimë të ftohtë, e cila është e papërshtatshme për rritjen e tyre. Ato kërkojnë të blejnë me shumicë edhe nga ne. Kështu, austriakët, hungarezët, francezët e gjermanët na i kërkojnë shumë domatet e hershme dhe na i paguajnë mirë. Ata ua dinë vlerën, prandaj na i blejnë shtrenjtë, kurse neve, që i prodhojmë vetë, nuk na lejohet të mos e vlerësojmë rëndësinë e tyre ushqimore dhe vetëm të themi: «Oburra mish», duke mos menduar që mishi nuk shkon pa zarzavate.

I solla këta shembuj që çdo njeri ta kuptojë mirë nevojën dhe domosdoshmërinë e përdorimit të zarzavateve në ushqimin e popullsisë. Kur kooperativisti kupton vlerën e tyre të madhe, ai, me siguri, edhe do t'i mbjellë ato e do t'i përdorë për ushqim. Për shembull, në kohën kur piqen domatet, po të hajë çdo

njeri nga 4-5 kokrra ditën, qoftë edhe si fruta, kjo do të bëjë mirë për shëndetin. Prandaj këto prodhime t'i futim në përdorim të gjerë në masë e të mos kënaqemi me ato pak suksese që kemi arritur në këtë drejtim.

Natyrisht, çdo organizëm ka veçoritë e tij, ai ka nevojë për lëndë të ndryshme, si: për squfur, për hekur, për sheqernë, për vitamina etj. Disa nga këto lëndë gjenden te mishi, ca të tjera te domatet, të tjera te patatet e kështu me radhë. Çështja s'qëndron vetëm te shija e mirë e këtyre ushqimeve, kryesore është se ato forcojnë shëndetin e njeriut. Të gjitha këto duhen parë e kuptuar të lidhura ngushtë me luftën për futjen e së resë në mënyrën e jetesës, me luftën kundër mentalitetit, kundër mendimeve që të rrojmë, ashtu siç e kemi gjetur nga të parët, pa ndryshuar gjë, të marrim mishin e ta pjekim në hell, ose ta futim në pilaf, siç ka bërë edhe babagjyshi. Jo, kjo mënyrë të ushqyeri nuk është e drejtë. Ajo edhe kushton shtrenjtë, edhe nuk të jep në masë të mjaftueshme të gjitha ato lëndë ushqyese për të cilat ka nevojë organizmi.

Partia i rekomandon këto gjëra, sepse vë në plan të parë ruajtjen e shëndetit dhe përmirësimin e jetës së njerëzve tanë, të cilët tani punojnë shumë, harxhojnë energji, prandaj dhe duhet të dinë t'i zëvendësojnë ato. Puna që bëjnë ata, lodhja e tyre nervore, është më e madhe se më parë. Anëtarin e Partisë sot nuk e zë gjumi, se ai nuk mendon vetëm për shtëpinë dhe për ushqimin e kalamanëve të vet. Komunisti i fshatit mendon për të gjithë njerëzit e fshatit. Partia i ka edukuar dhe i edukon punonjësit tanë me

frymën e përgjegjësisë dhe të solidaritetit socialist, prandaj, te ne, shikon, bie fjala, punonjës që, në palcë të dimrit, shkojnë në kodra e në male, fill të vetëm, për të lidhur linjat e këputura të telefonit, që të mos ndërpritet ndërlidhja, komunikimi i njerëzve e si ky ka edhe shumë shembuj të tjerë. Kështu veprojnë njerëzit tanë kudo, në çdo sektor, ku ata punojnë me heroizëm të madh.

Në procesin e kësaj pune intensive, punonjësit tanë harxhojnë mjaft energji, kanë gjithë këto preokupacione e përgjegjësi dhe kanë nevojë për një trajtim që t'u përgjigjet nevojave të organizmit të tyre, gjithnjë në punë e në lëvizje. Po të tregohet kujdes, siç thashë, dhe organizmi të marrë ushqimin që i nevojitet, trupi nuk pëson gjë nga puna intensive, nervat e njeriut ruhen të shëndoshë.

Në të kaluarën, në Gjirokastrë, në qendër të qytetit, ishte një vend i quajtur Hasojmer, ku rrinin pleqtë, që nuk e vritnin mendjen për asgjë, që nuk kishin punë tjetër veç të pyetnin cilindo që kalonte rrugës: «Ku shkon?», «Kur erdhe?», «Ç'kemi ndonjë gjë?» etj. Natyrisht, duke mos harxhuar asnjë energji fizike dhe mendore, siç bënin ata, organizmi s'pësonte gjë. Po tani është ndryshe, njerëzit bëjnë punë të madhe, socializmi kërkon mund e sakrifica që angazhojnë energji fizike e mendore, prandaj Partia interesohet shumë e në mënyrë të gjithanshme, në radhë të parë, për njeriun, që edhe punën ta bëjmë, edhe shëndetin ta kemi, edhe jetën ta zgjatim. Interesimi ynë nuk duhet të kufizohet vetëm që të kemi një spital, të kemi disa mjekë dhe aparate mjekësore e

ilaçe. Këto po e po, por duhet të marrim edhe masat parandaluese, në mënyrë që nëpër spitale të shtrohen sa më pak njerëz, që fëmijët e vegjël të mos na vdesin, por të rrojnë dhe të rriten të shëndetshëm.

Për këtë qëllim, ne duhet ta organizojmë punën që, edhe grave në kooperativat bujqësore, ashtu si punëtoreve dhe nëpunëseve t'u jepet dhe të zbatohet me rigorozitet pushimi përpara dhe pas lindjes. Partia të luftojë me rreptësi mendimin e ndonjë mendjelehti, në kooperativë bujqësore, i cili thotë që gruaja, pas lindjes, të marrë menjëherë shatën dhe të prashitë misër ose duhan, duke arsyetuar në mënyrë krejt të gabuar, se kështu kanë punuar edhe nënat tona pas lindjes. Të kuptohet mirë se kujdesi për gratë shtatzëna dhe për lehonat, ndikon shumë në shëndetin e tyre dhe të fëmijëve, për të cilët duhet të tregohet kujdes i vazhdueshëm. Gjatë kohës së shtatzënësisë është e nevojshme që nëna të ushqehet më mirë, se kjo gjë ndikon në zhvillimin normal të fëmijës.

Komunistët duhet të mendojnë për këto çështje me rëndësi të madhe jetike, të tërheqin vëmendjen e kolektivit, për të ngritur nivelin ekonomik të kooperativave tona, për përmirësimin e mëtejshëm të mënyrës së jetesës, të interesohen për të gjitha problemet, derisa t'u jepen kooperativistëve qumësht e sende të tjera. Ndonjë drejtues mund të thotë se, po të bëhen këto që po them, na pengohet plani i shtetit. Kjo nuk është e vërtetë dhe nuk duhet menduar kështu, përkundrazi, duhen bërë përpjekje që edhe plani të realizohet, edhe kooperativistëve t'u jepet qumësht për t'u ushqyer. Për këtë çështje ne kemi marrë shumë

vendime, por konstatohet se nuk po zbatohen si duhet. Pikërisht këtu është pengesa dhe jo te plani i shtetit.

Për realizimin e planit duhen bërë të gjitha përpjekjet dhe duhet mobilizim i përgjithshëm. Të punoni e të kujdeseni që plani i drithërave të plotësohet, por, njëkohësisht, të mos lini pas dore pataten, se rendimenti i saj, që keni marrë vitin e kaluar, është shumë i ulët. Kjo nuk u intereson ekonomisë sonë, as kooperativës. Duhet të marrim nga çdo hektar të paktën 120 kuintalë patate. Vetëm kështu ka leverdi ta mbjellësh atë.

Në perspektivë, i kushtoni vëmendje sidomos zhvillimit të lopës, duke u kujdesur për ta rritur atë si në numër, edhe në cilësi, në kurriz të bagëtive të imëta. Natyrisht, kjo nuk arrihet menjëherë, por, gradualisht, duke përgatitur terrenin, pse ky proces kërkon kohë. Shumë nga ne, shqiptarët, jemi çobanë, të tërë jemi mësuar me delen e me dhinë, të cilat, me shekuj, i kemi mbajtur, jemi kujdesur për to e na janë futur në zemër. Kjo frymë, kjo dashuri për to, me të cilën jemi rritur, na pengon ta ndryshojmë gjendjen. Kështu, po të mendojmë t'i zëvendësojmë bagëtitë e imëta me lopë, na duket sikur ndodh ndonjë katastrofë. Mirëpo mbajtja e deles në një sasi të tillë, pengon intensifikimin e bujqësisë dhe kjo për disa arsye. Po sjell një shembull. Katundi Kuç i Kurveleshit ka sot aq dele, sa del problemi se ku do të kullotin ato në dimër. Përpara, gjatë dimrit Kuçi i çonte delet në Sarandë, kurse beharit i mbante nëpër malet e Gjirokastrës. Mirëpo tani këto burime u

prenë, prandaj kanë filluar grindjet, aq sa, shpesh, drejtojnë letra deri në Komitetin Qendror për sigurimin e kullotave. Një blegtori e tillë ekstensive bëhet pengesë për zhvillimin intensiv të bujqësisë, që ne po e bëjmë tani dhe që është i domosdoshëm ta bëjmë.

Tre vjet përpara kalova bregdetit të Jugut, nga Himara e Piqerasi dhe dola në Nivicë, në Finiq e në Konispol. Vura re se tërë shpatet e maleve, në atë kohë, ishin mbuluar me shkurre. Më pas, këto toka, u kthyen në tarraca shumë të bukura, ku u mbollën fruta, ullinj e agrume. Tani, kur kthen fytyrën nga Saranda, syri të zë kodrina të bukura e të këndshme, të mbjella plot me pemë, në të cilat më parë mund të kullotnin rreth 500 kokë bagëti të imëta. Kështu ishte kollaj, por me humbje, sepse, të mbash në tërë ato sipërfaqe vetëm aq pak bagëti, s'ka leverdi. Prandaj u vendos që këto toka të mbillen, me qëllim që prej tyre të merren shumë prodhime të cilësisë së mirë. E tërë kjo tokë është hapur, bile është punuar edhe mbi rrugë, ku kishte guriçka dhe tani me qindra hektarë janë kthyer në tokë shumë pjellore. Dhe kështu nuk ka mbetur më vend për të kullotur bagëtitë e imëta. Prandaj duhet kuptuar drejt se domosdoshmëria e hapjes së tokave të reja lidhet edhe me zëvendësimin e bagëtive të imëta medoemos me lopë.

Me këtë nuk dua të them që delet ose dhitë t'i themin menjëherë. Fjalën e kam për perspektivën që, në qoftë se duam bujqësi e blegtori moderne, nga e cila të marrim prodhime të larta, duhet të marrim masa që dhinë e delen, gradualisht, t'i zëvendësojmë

me lopën. Po edhe këtë të fundit është e nevojshme ta përmirësojmë, të mos kënaqemi me 200 litra qumësht, që marrim në vit nga lopa e racës së vendit. Duhet të punojmë që prej saj të marrim të paktën 1 500 litra qumësht në vit dhe bile, shkallë-shkallë, të arrijmë të marrim 2 000-3 000 e më shumë litra qumësht në vit nga çdo kokë, ndryshe s'kemi gjë në vijë. Ka kooperativa bujqësore, si në zonat fushore të Fierit, të Lushnjës apo të Durrësit, të cilat, që tani, marrin mesatarisht nga 1 500 e 2 000 litra qumësht nga çdo lopë. Në këto kooperativa i kanë seleksionuar lopët, kanë eliminuar ato me rendiment të ulët, kurse delet i kanë kufizuar shumë.

Dashuria e madhe që ka populli ynë për delen dhe «shpirti i çobanit» kanë arritur gjer atje sa, edhe në ndërmarrjet bujqësore, të rritin tufë prej dhjetëra mijë kokë delesh, në vend që ato t'i zëvendësojnë me lopë. Kështu, për shembull, ndodh në Vrinë. Kurse në Ndërmarrjen Bujqësore të Vorës me të drejtë është vepruar ndryshe. Mos vallë atje nuk ka vend për të kullotur një numër bagëtish të imëta? Sigurisht ka. Megjithatë, kjo ndërmarrje nuk mban dele, por rrit vetëm lopë. Kolektivi i saj punon me seriozitet dhe nuk lë fije bari të shkojë kot, çdo gjë ua hedh lopëve dhe merr prej tyre mesatarisht 3 000-4 000 litra qumësht në vit, bile nga disa merr deri edhe 6 000 litra qumësht në vit. Dhe ngjan kjo prodhimtari sikur të kishim të bënim me një fabrikë të vërtetë. Për këtë çështje të rëndësishme të zhvillimit të blegtorisë sonë, kështu duhet vepruar dhe në këtë rrugë duhet të ecim. Nga ana tjetër, është e natyrshme dhe jemi të

ndërgjegjshëm se kooperativat bujqësore këtü objektiv nuk mund ta arrijnë menjëherë.

Unë jam dakord që në rrethin tuaj ka vende me të vërtetë të përshtatshme për mbajtjen e dhisë, ku nuk ha dot as delja, as lopa. Po edhe dhia kërkon kujdes, ajo duhet mbajtur mirë që të na japë rendiment të lartë. Të marrim shembull nga rezultatet e Lezan Pislit¹, i cili është zotuar të marrë 140 litra qumësht në vit nga çdo dhi. Bagëti të imëta të mbajmë për të shfrytëzuar ato kullota që nuk bëjnë për gjedhë, por vëmendjen kryesore ta përqendrojmë në krijimin e mundësive për të rritur lopët, të cilat t'i mbajmë e t'i ushqejmë në stalla.

Faktori kryesor për rritjen dhe për zhvillimin e mirë të lopës është sigurimi i ushqimit të bollshëm të saj. Për këtë arsye i duhet rezervuar lopës sasi e mjaftueshme toke për ushqim, por pa cenuar sipërfaqen e tokës për mbjellje. Të kihet parasysh se lopën nuk mund ta mbajmë pa siguruar tokën që nevojitet për të prodhuar ushqimin e saj. Të luftojmë që sipërfaqja e tokës të na japë çdo vit më shumë prodhimë për njerëzit, po të kujdesemi edhe për lopët, se edhe ato që prodhon lopa janë ushqim për njeriun. Sektorin e lopëve, gradualisht, do ta shtojmë, prandaj që tani t'i kushtojmë vëmendje dhe të punojmë në dobi të tij. Kështu, për shembull, kur vjen koha për të bërë skartimin e bagëtive, ta zëmë, në kooperativën e Kuçit dhe të Tërbaçit, të ardhurat nga delet dhe nga dhitë e skartuara ata mund t'i përdorin fare mirë

1 Shih: Enver Hoxha. Vepra, vëll. 35, f. 361.

për të blerë lopë, farëra të zgjedhura ushqimesh foragjere e të tjera. Kështu vjen koha që edhe të bëhemi me lopë, edhe të kemi mundësi t'u sigurojmë kushte më të mira atyre pak deleve që do të mbajmë dhe të marrim prej tyre rendimente më të larta se gjer tani në qumësht, në mish dhe në lesh, si rrjedhim, këto nuk do të na bëhen pengesë për zhvillimin e blegtorisë. Dhe dhitë mund t'i mbajmë në atë masë që të mos pengojnë rritjen e numrit të lopëve, po, për këtë rast, duhet bërë kujdes në përmirësimin e cilësisë së tyre.

Për të këmbyer eksperiencën pozitive u zhvilluan edhe vizita të kooperativistëve të Veriut në kooperativat e Jugut. Për këtë problem duhet të kemi parasysh disa gjëra. Të moshuarit, që kanë vajtur si miq në kooperativat bujqësore të Jugut, duhen pyetur me kujdes, mos vallë është kohë e gjatë qëndrimi i tyre atje për një muaj e gjysmë. Ndofta është e mjaftueshme të qëndrojnë vetëm një muaj ose tri javë. Prandaj i dëgjoni me vëmendje vërejtjet dhe mendimet e tyre, lidhur me këtë çështje. Atyre u ka ardhur shumë mirë që i dërguan dhe e pritën këtë me kënaqësi, po, pas tri javësh, dukeshin pak si të shqetësuar, pasi nuk dinin për punën në kooperativë, për shëndetin e njerëzve në familjet e tyre.

Kooperativistët e Veriut, gjatë qëndrimit në kooperativat e Jugut, janë sjellë shumë mirë. Më thanë se malësorët që shkuan nga Dukagjini në Labëri, jo vetëm qëndruan me dinjitet, si miq, por punuan shumë më mirë nga kurveleshasit, kurse gratë e Kurveleshit, megjithëse ngriheshin të parat, në orën 4 të

mëngjesit, dhe flinin të fundit, në orën 11 të natës, punonin shumë më mirë nga burrat e tyre dhe nga ata të Veriut.

Njerëzit që shkuan nga Veriu në Jug ishin sjellë shumë korrektë me mikpritësit. Ata qenë veshur me rroba të mira e të pastra, ndryshe nga vendasit. Mëqenëse ra fjala për pastërtinë, dëshiroj të them se edukimi i popullit me ndjenjën e pastërtisë ka shumë rëndësi dhe luan rol në ruajtjen e shëndetit të tij. Në rrethin tuaj, siç më kanë thënë, përdoret akoma pak sapun. Kështu ka ndodhur edhe në Labëri, ku burrat, siç mund të keni parë ndonjë, vishnin këmbë me mëngë të gjera, që i shfrytëzonin si peshqirë, për të fshirë djersën ose fytyrën kur laheshin. Natyrisht, edhe në Labëri tani janë bërë ndryshime, sikurse janë bërë edhe këtu te ju, por prapë, përdorimi i sapunit, mesatarisht për frymë në vit, është akoma shumë pak. Ju e shikoni vetë se ç'përpjekje të mëdha duhet të bëni në këtë drejtim. Po të vesh në Dukagjin, mundet që njerëzit nuk i gjen çdo ditë të veshur me rroba të pastra, por ata dukagjinas, që shkuan miq në kooperativat tona të Jugut, rrobat i mbanin shumë pastër. Dukagjinasit shquheshin edhe për sedër të lartë në punë, në biseda e në shoqëri dhe fituan respektin e madh të mikpritësve. Më treguan se i vëllai i dëshmorit Mehmet Shpendi nga Dukagjini, megjithëse nuk kishte shumë kulturë, u kishte lënë përshtypje të mira kurveleshasve, sepse ishte njeri i thjeshtë, njeri i popullit, ishte i pjekur dhe kishte horizont. Kudo që shkonte ai, të gjithë i ngriheshin në këmbë, e donin dhe e respektonin.

Dërgimi i grupeve të kooperativistëve nga Veriu në Jug është një punë e vlefshme. Ajo i ndihmon njerëzit të njohin atdheun, të njohin punën e njëri-tjetrit, të mësojnë nga zakonet e mira të shoqi-shoqit. Ata që shkuan në Jug panë se, në familjet kooperativiste, edhe gratë, ashtu si burrat, hanin bashkë me ta në një tryezë. Kjo ishte gjë e re për ta dhe u bëri shumë përshtypje, u la mbresa, të cilat i shprehën kur u kthyen në fshatrat e tyre. Gjithashtu, ata treguan se, në fillim, ndienin njëfarë shqetësimi, ngaqë mendonin se do të shkonin të jetonin mes njerëzve të panjohur, nuk dinin si do t'i pritnin dhe si do të sillleshin këta vetë me gratë dhe me fëmijët e tyre, që nuk i njihnin. Prandaj, ditët e para, ishin, si të themi, në një hall të madh. Mirëpo qëndrimi dhe sjelljet e grave dhe të burrave të familjeve mikpritëse i bënë miqtë që shpejt ta ndienin veten në një ambient të ngrohtë e bujar.

Gratë e Veriut janë të zgjuara, por të zgjuara janë edhe labet. Gjatë kësaj kohe gratë labe ua përgatitnin ushqimin miqve të Veriut dhe kryesitë e kooperativave u kujdesën që familjet e tyre të furnizoheshin më mirë, sidomos me gjalpë. Të zonjat e shtëpisë u jepnin mundësi edhe mikeshave të përgatitnin e të bënin gjellë të shijshme, me qëllim që të mësonin të gatuarin më mirë. Kur vinin burrat të hanin drekë ose darkë pyetnin se kush e kishte bërë këtë ose atë gjellë dhe kur amvisat vendase u thoshin që e kishin gatuar mysafiret, ata i përgëzonin për ato gjellë aq të shijshme.

Këto lëvizje u bënë mirë sidomos të moshuarve,

prandaj kini kujdes të dërgoni më shumë prej tyre, se mësojnë shumë gjëra kur dalin nga fshati. Pleqve nga Veriu, përveç të tjerave, u kanë bërë përshtypje edhe ato që panë rrugës, gjatë udhëtimit për në viset e Jugut. Bashkë me kooperativistët, që shkuan nga Veriu në Jug, ishte edhe një shok i aparatit të Komitetit Qendror, i cili na tha se në atë kooperativë ku qëndruan, për nder të miqve, vendasit kishin organizuar dhe dhanë shfaqje artistike me grupin e tyre dhe të fshatrave përreth. (Bile kishin menduar të organizonin edhe një dasëm socialiste në fshat, por gjatë kësaj kohe nuk u martua ndonjë çift. Duket që ky ishte një plan burokrat, i hartuar nga lart.) Në familjet ku qëndruan, miqve u kishte bërë përshtypje edhe fakti që burrat e shtëpisë këshilloheshin me gratë e tyre për punët familjare. Kur, sipas ditëve të punës që kishin bërë, u ndanë paradhënie, për vendasit dhe miqtë, këta të fundit u pyetën nga vendasit se çfarë do të blenin për familjen. Në këtë mënyrë ata mësuan dhe panë se ishte shumë mirë të pyetnin dhe të këshilloheshin edhe me gratë, qoftë edhe me fëmijët, për ato që duheshin blerë me të hollat e fituara.

Miqtë mësuan, midis të tjerash, se si duhen luftuar zakonet e vjetra të malësisë së Veriut, ku burrat rrinë dhe hanë të veçuar nga gratë. Atje ku shkuan, vunë re që burrat dhe gratë, vajzat dhe djemtë hanin së bashku. Në malësi, sikundër e dini, zakoni i vjetër nuk lejon që gratë dhe vajzat të ulen në një sofër me burrat. Ata që panë se njerëzit në familjet tona në Jug rrinë bashkërisht, me siguri, pa vonesë, do ta

shkelmojnë zakonin e vjetër të malësisë e, pas tyre, edhe malësorët e tjerë që do të dërgohen në të ardhmen në kooperativat tona të Jugut, ose që do të marrin shembull nga shokët e tyre, që patën rast të venë. Ky realitet ata do t'i futë në mendime dhe me vete do të thonë: «Në ishim të huaj, po të zotët e shtëpisë na konsideruan aq të afërt, saqë hanim në një sofër, bashkë me gratë dhe me vajzat e tyre, atëherë përse ne në familjet tona të mos hamë bashkërisht me gratë, me vajzat, me nënat dhe me motrat tona?».

Këto këmbime e vizita midis kooperativistëve duhet edhe t'i perfeksionojmë, pra, të kujdesemi që të mos bëhen barrë për ata që i presin, përkundrazi, të jenë edhe instruktive, por edhe argëtuese njëkohësisht. Kur të vijnë kooperativistë nga fshatrat e Jugut në Veri, këshillohuni me ta që kooperativistët tuaj të mos bëjnë ndryshime në ushqimin e zakonshëm të familjes, të mos harxhohen, se në këtë drejtim kooperativistët e Jugut e shkelën ca, duke i konsideruar ata të Veriut si miq, gjatë gjithë kohës që qëndruan. Për këtë kooperativistët miq nga Veriu u treguan shumë të arsyeshëm dhe u tërhoqën vëmendjen të zotëve të shtëpisë qysh ditën e dytë dhe të tretë. Ata, me të drejtë, u thanë atyre se kishin shkuar për miqësi e për të këmbyer eksperiencën me njëri-tjetrin dhe jo për të ngrënë ditë e natë mish e gjellë të shumta. Ata u shprehën që këtij zakoni t'i jepnin fund, se do të dëmtoheshin ekonomikisht të dy palët, për arsye se kur të vinin shokët e Jugut në kooperativat e Veriut, edhe këta për të mos u turpëruar, do të detyroheshin

t'i pritnin me shpenzime të mëdha. Prandaj shfaqën dëshirën që të hanin së bashku, ashtu siç ushqeheshin zakonisht në familjen vendase, asgjë më shumë.

Me pak fjalë, malësorët e Veriut, gjatë qëndrimit të tyre në kooperativat e Jugut lanë përshtypje shumë të mira, u miqësuan me vëllezërit e tyre të Jugut, punuan dhe mësuan së bashku. Kur të vijnë kooperativistët e Jugut nga anët tuaja, u thoni malësorëve, që do t'i presin nëpër familjet, të mos nxitin sedrën, por t'i presin si miq e vëllezër dhe të hanë e të pinë, ashtu siç ushqehen zakonisht për vete.

Një pjesë e madhe e burrave të fshatrave tuaja punojnë nëpër fabrika e në miniera. Tani që në kooperativat bujqësore do të punoni e do të zbërtheni udhëzimet e Partisë «Mbi kontrollin e klasës punëtore», të keni kujdes dhe të tërhiqni ndihmën e punëtorëve që banojnë në fshat, të cilët duhet të sjellin këtu frymën dhe ndjenjën e kontrollit të klasës punëtore, me qëllim që të ndihmojnë në forcimin e kontrollit të masës kooperativiste dhe të asambleve ndaj njerëzve të zgjedhur, ndaj kryesisë, kryetarit, brigadierëve etj. Gjithashtu, të forcohet kontrolli i komunistëve në organizatën-bazë ndaj byrosë dhe sekretarit e zëvendës sekretarit të organizatës. Kur ta punoni këtë material në kooperativat tuaja bujqësore, jam i bindur se do të gjeni një mirëkuptim dhe mbështetje shumë të madhe nga ana e grave, të cilat, në të kaluarën, e kanë ndier shumë shtypjen e egër të zakoneve patriarkale. Në kooperativat tuaja shumica dërrmuese e njerëzve që punojnë përbëhet nga gra, sepse, siç e thamë,

një pjesë e mirë e burrave janë punëtorë. Dhe si kudo, edhe në rrethin tuaj, gratë nuk kanë tendencë të sundojnë mbi burrat, të bëhen bajraktare. Ndjenja e bajraktarizmit në marrëdhëniet familjare shfaqet kryesisht te burrat, të cilët përpiqen të jenë si kaposhë. Prandaj, kur ta shtroni çështjen e «Kontrollit të klasës punëtore» në kooperativat, përpiquni të arrini që gratë ta kuptojnë mirë politikisht këtë direktivë të madhe të Partisë dhe ta mbështetin.

Nëpër aparatet e Partisë, në ndërmarrjet ekonomike në përgjithësi dhe në aparatet qendrore, lufta për emancipimin e gruas po bëhet më e efektshme dhe orientimi i Partisë, fryma e klasës punëtore ndihen më fuqishëm. Ne, gjithashtu, luftojmë që aparatet të mos burokratizohen, që punonjësit e aparateve të mos shndërrohen në burokratë. Të kuptohemi, Partia nuk është kundër institucioneve, por kundër atyre funksionarëve të institucioneve, që nuk i zbatojnë si duhet normat, rregullat dhe ligjet e Partisë e të shtetit tonë. Të kemi parasysh që t'i thjeshtojmë vazhdimisht organizmat e diktaturës së proletariatit, t'i bëjmë më operative, që të veprojnë më gjallërisht e me shpejtësi të madhe në shërbim të popullit. Këta organizma duhet t'i transformojmë gradualisht, me qëllim që t'u përgjigjen gjithnjë e më mirë detyrave të mëdha të ndërtimit socialist të vendit. Pra, gjatë praktikës, lind nevoja e ndryshimit të organikave, e transformimit të organizmave. Megjithatë, aparatet na duhen medoemos, ashtu sikundër na duhen njerëzit që caktojmë të punojnë në to, të cilët Partia i edukon politikisht

të punojnë mirë, t'i shërbejnë popullit me devocion, të mos bëjnë gabime, sidomos të mos na ndryshkin aparatet, gjë që ndodh pa u kuptuar e dalngadalë u sjell dëme të mëdha masave, popullit dhe Partisë.

*Botohet për herë të parë sipas
shënimeve të mbajtura në këtë
takim që gjenden në AQP*

POPULLI YNË MENDON, PUNON, KRIJON DHE MBRON FITORET E TIJ

*Nga fjala në drekën e shtruar në mensën
e punëtorëve të Minierës së Kurbneshit*

28 maj 1968

Jam shumë i gëzuar që erdha sot këtu në mes jush dhe pashë me sytë e mi punën e palodhur që keni bërë dhe ju them se udhëheqja e Partisë dhe e Qeverisë është e kënaqur për sukseset që keni arritur. Shoku drejtor më raportoi se ju do ta tejkaloni planin e këtij viti. Ju uroj ta realizoni me sukses këtë zotim dhe jam i bindur se do ta realizoni. Drejtori më tha se ju jeni të kënaqur nga zhvillimi i punëve në Kurbnesh, por, edhe në qoftë se ka diçka që nuk ecën, merrni sa më parë masa ta vini në rrugë, sidomos çështjen që ka të bëjë me furnizimin dhe me trajtimin e punëtorëve.

Partia dhe Qeveria janë në dijeni për punën dhe për përpjekjet e minatorëve dhe të punëtorëve të Kurbneshit. Puna juaj është studiuar shumë herë, si nga Byroja Politike e Komitetit Qendror, ashtu dhe nga Qeveria. Ajo, gjithashtu, është marrë në shqyrtim

edhe në disa raste të tjera, kur kemi diskutuar për zhvillimin e minierave në përgjithësi dhe në mënyrë të veçantë për minierat e bakrit.

Miniera dhe Uzina e Kurbneshit kanë qenë në vëmendjen kryesore të udhëheqjes së Partisë dhe të shtetit, sepse janë nga ndërmarrjet më të rëndësishme të vendit tonë. Këtu rron dhe punon një kolektiv i mrekullueshëm minatorësh, punëtorësh, teknikësh dhe inxhinierësh, që e kanë kuptuar mirë vijën politike, ideologjike, ekonomike dhe organizative të Partisë. Kuptimi i vërtetë dhe i thellë i kësaj vije shprehet në realizimin e detyrave nga ana juaj dhe në sukseset që korrni në punë. Ai që e kupton thellë vijën e Partisë, u shkon çështjeve deri në fund, përmirëson vazhdimisht punën në çdo drejtim, pavarësisht nga pengesat e nga vështirësitë që i dalin. Por ka edhe njerëz që, në dukje, krijojnë përshtypjen sikur e kanë kuptuar mirë vijën politike të Partisë dhe këtë ata mund ta shprehin me fjalë shumë bukur, por kur vjen puna për të parë ç'mbetet mbi shoshë, ç'kanë realizuar dhe si i kanë kryer konkretisht detyrat, atëherë duket qartë sa cekët e kanë kuptuar këtë vijë, sa lehtë i kanë marrë detyrat që shtron Partia.

Kurse udhëheqja e Partisë vazhdimisht ka konstatuar se miniera juaj ecën kurdoherë përpara. Kjo, në radhë të parë, ju detyrohet juve, shokë punëtorë, e, bashkë me ju, gjithë kolektivit të minierës. Unë mund t'u them punëtorëve të Mirditës, veçanërisht juve, minatorëve e punëtorëve të Kurbneshit, jo për t'ju bërë qejfin, se dalloheni nga të gjithë punëtorët e tjerë të profesionit tuaj të lavdërueshëm e të vështirë.

Kryerja e detyrave në minierat, si kudo, kërkon, në radhë të parë, kuptim të thellë politik të detyrës. Për t'u futur nën tokë, për të punuar atje 8 orë rresht, pa parë diell me sy, për të rrëmbyer nga gjiri i saj pasuritë që përmban dhe për t'ia dhënë popullit, kjo kërkon vullnet të madh, kurajë e guxim prej minatori, kërkon vendosmëri dhe energji të madhe revolucionare. Dhe mirditorët i kanë këto cilësi, prandaj qëndrojnë në ballë të masave revolucionare të vendit, të Partisë dhe të popullit tonë. Partia e ka për detyrë t'i edukojë me vendosmëri të madhe, me shpirt vetëmohimi, guxim dhe sakrifice, si këto që tregoni ju që punoni në sektorët më të vështirë, gjithë komunistët dhe, në shembullin e tyre, masat e gjera të popullit.

Në Shqipëri ne kemi tashmë shumë miniera dhe perspektiva është e tillë që, në të ardhmen jo të largët, do të kemi të tjera akoma më të rëndësishme. Ne kemi nxjerrë dhe vazhdojmë të nxjerrim prej tyre minerale të ndryshme, numri i të cilave shtohet jo vetëm në sasi dhe në cilësi, por edhe në lloje. Megjithatë, unë mund të them se prapë jemi në fillim të kësaj pune, se perspektiva e zhvillimit të minierave në vendin tonë, nga sa tregojnë të dhënat paraprake, është e madhe, megjithëse ato që keni zbuluar gjer tani nuk janë të vogla. Burimet nëntokësore të vendit tonë nuk janë zbuluar akoma të gjitha, bile mund të them se ne jemi në fillim të kësaj pune, prandaj në të ardhmen duhet të punojmë akoma më me vendosmëri për të zbuluar çdo pasuri të nëntokës sonë, për ta njohur këtë pëllëmbë për pëllëmbë. Kjo kërkon njerëz të vendosur, po edhe të mësuar dhe pikërisht për këtë qëllim janë

hapur kudo shkolla e kurse, nga të cilat kanë dalë dhjetëra e qindra djem e vajza të popullit, bijtë dhe bijat tuaja, që kanë arritur rezultate të mira edhe në mësim, ashtu sikundër në punë.

Të tillë janë edhe gjeologët tanë, të cilët, pavarësisht nga mosha e re, kanë dhënë me të vërtetë rezultate të dukshme në punë. Ata po tregojnë praktikisht në jetë se janë të zotë nga ana teknike, se gjithçka që kanë mësuar në shkolla, e kanë përvetësuar mirë. Por ajo që ka rëndësi të dorës së parë është se Partia i ka edukuar ata ta kuptojnë, në radhë të parë, politikisht dhe ideologjikisht rëndësinë e mësimit që kanë marrë në shkollë, si dhe qëllimin e lartë për t'i vënë atë mësim, atë zotësi, atë teknikë që kanë përvetësuar, në shërbim të popullit. Të gjitha këto t'u shërbejnë për të zbuluar e për të vënë në shfrytëzim sa më parë e sa më mirë të gjitha ato burime minerare të vlefshme, që qëndrojnë të fshehura akoma në thellësitë e tokës, shfrytëzimi i të cilave ka një rëndësi të madhe ekonomike dhe politike për vendin tonë, për forcimin dhe për të ardhmen e Republikës sonë Popullore. Në këtë kuptim dhe të pajisur me një vendosmëri të madhe, gjeologët tanë i shikon të punojnë me vetëmohim, dimër e verë, në borë e në shi, të veçuar nëpër pyje, në male e në gërxhe, duke fjetur nëpër çadra, bile, shpesh, edhe në qiell të hapët, në kushte që nga ndonjëherë edhe buka nuk u vete rregullisht e, megjithatë, ata përsëri shpojnë, gërmojnë, mbledhin të dhëna, pyesin, zbulojnë dhe mund të themi se rezultatet e punës së tyre janë të kënaqshme.

Me punën e madhe që bëjnë gjeologët tanë, megjithse janë akoma të rinj e pa shumë eksperiencë, kanë rrëzuar teoritë e shumë prej gjeologëve të huaj, që kanë pasë ardhur nëpër Shqipëri, të cilët me qëllim na kanë fshehur shumë gjëra, na kanë mbyllur shumë perspektiva, na kanë dhënë në mjaft raste informata të rreme, duke na thënë se në vendet ku kanë bërë kërkime, nuk paska, sipas tyre, as bakër, as naftë, as krom etj., prandaj, sipas tyre, ato vende duheshin mbyllur dhe duheshin konsideruar të pavlefshme. Ata kanë qenë njerëz të mbrujtur me pikëpamje ideologjike armiqësore, revizioniste, të huaja për socializmin. Kjo vërteton edhe një herë se revizionistët që erdhën në fuqi, pas vdekjes së Stalinit, në Bashkimin Sovjetik dhe në disa vende socialiste të Evropës, si: në Bullgari, në Republikën Demokratike Gjermane, në Çekoslovakia etj., kanë pasur qëllime të caktuara. Këta, njëlloj si kapitalistët, nën maskën e miqësisë me popullin tonë dërguan në Shqipëri specialistë gjoja për të na ndihmuar, por, në fakt, për të na nxjerrë pengesa e për të na sabotuar. Mirëpo këto nuk mund të qëndronin dhe nuk qëndruan për shumë kohë, pse Partia jonë marksiste-leniniste diti të çante mjegullën, të shpërndante errësirën, të dallonte të bardhën nga e zeza, të ndante shapin nga sheqeri, të njihte kush ishte armik dhe kush ishte mik, armikut t'i binte në kokë, kurse popujve dhe komunistëve t'u hapte sytë dhe t'i ndihmonte për të marrë në dorë fatet e vendit, për të ndjekur me besnikëri mësimet e Marksit, të Engelsit, të Leninit, të Stalinit, për të shfrytëzuar eksperiencën e madhe të Partisë dhe të popullit tonë dhe me heroi-

zëm, me vendosmëri e me kuptim të thellë politik t'i përvisheshin revolucionit.

Partia i ka edukuar gjeologët tanë dhe u ka hapur perspektiva të mëdha për zbulimin e mineraleve. Gjeologët tanë, me besim të pakufishëm te Partia, me vetëmohim e me punë të palodhur, zbuluan shumë minerale të dobishme. Sidomos për ato vende ku specialistët e huaj kishin njoftuar se nuk kishte burime, Partia i porosiste gjeologët tanë që pikërisht atje të goditnin dhe të gjenin minerale, pse atje duhej të ishte nafta ose bakri, kromi ose hekuri etj. Dhe në të vërtetë kështu ngjau. Në arkivat e ministrive tona ruhen dokumente të firmosura nga specialistët që na dërguan revizionistët sovjetikë, çekë, gjermanë, në të cilat «vërtetohet» se në pikat ku ata kanë pasë bërë kërkime e studime nuk paska gjë.

Partia e kishte të qartë rrugën e vet, prandaj ajo diti të bënte dallimin në mes marksistë-leninistëve, nga njëra anë, dhe armiqve të socializmit, nga ana tjetër. Revizionistët, që kishin pllakosur në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e tjera ish-socialiste, bënë çmos që asgjë të mos zbulohet nga gjithë këto pasuri të mëdha që fsheh nëntoka jonë. Përkundrazi, ata u munduan që Shqipëria të kthehej në një vend kapitalist, që bujqësia jonë të bënte hapa prapa, të kthehej si më parë, në një bujqësi të prapambetur kapitaliste, që industria e porsafilluar të qëndronte në vend, që makineritë e saj të mos perfeksionoheshin dhe të mos bëhej asnjë hap më përpara, të mos shfrytëzoheshin të gjitha kapacitetet që kemi mundësi të realizojmë dhe çdo pasuri tjetër e vendit të shër-

bente vetëm e vetëm për të furnizuar klikat e reja borgjeze kapitaliste, që do të silleshin në fuqi, në krye të popullit shqiptar, me përkrahjen e revizionistëve. Kështu, Shqipëria të bëhej vetëm një furnizuese e thjeshtë perimesh, frutash, limonash dhe portokallësh për klikat e Hrushovit, të Gomulkës, të Novotnit e të tjerëve.

Sikur Partia jonë të mos bënte dallimin në vijë, në politikë dhe në ideologji, sikur të mos shihte se rruga që ndiqnin revizionistët modernë ishte kundër-revolucionare, antipopullore, ishte rrugë e tradhtisë ndaj klasës punëtore, megjithëse revizionistët bërtitnin me të madhe për socializmin dhe për komunizmin, ajo nuk do t'i kishte shpëtuar popullin dhe atdheun tonë nga ky rrezik i madh që e kërcënonte. Partia pa qartë se prapa fjalëve dhe frazave të revizionistëve fshihej diçka tjetër, fshihej lufta kundër interesave të vërtetë të klasës sonë punëtore, fshihej qëllimi për ta hequr atë nga fuqia dhe për të sjellë në vend të saj elementë të degjeneruar e kundër-revolucionarë, kundërshtarë të hapët të interesave të klasës punëtore, për ta futur këtë dhe së bashku me të edhe fshatarësinë tonë nën zinxhirët e robërisë.

Në veprimet e revizionistëve Partia jonë pa që në fillim se këta armiq të maskuar të marksizëm-leninizmit po poshtëronin Stalinin, duke bërtitur nga të katër anët se ai qenkësh një kriminel. Për Partinë tonë, kjo ishte një shenjë shumë domethënëse, që i dha të kuptojë se ata që shanin Stalinin ishin dhe janë me të vërtetë armiq të egër të socializmit, sepse Stalini ka qenë një revolucionar i madh, nxënës besnik dhe ba-

shkëlufëtëtar i ngushtë i Leninit në revolucion dhe më pas udhëheqës i shquar i Bashkimit Sovjetik gjatë periudhës së lavdishme të ndërtimit të socializmit, të industrisë së rëndë, që ishte bazë e industrializimit socialist të Bashkimit Sovjetik. Stalini udhëhoqi ndërtimin socialist të fshatit, udhëhoqi me lavdi Luftën e Madhe Patriotike të popujve sovjetikë dhe siguroi fitoren historike mbi fashizmin.

Partia jonë kuptoi me kohë dredhitë e shumta të revizionistëve. Ata sulmonin Stalinin, duke mos sharë dot haptazi Leninin, por qëllimi i tyre si antimarksistë, si revizionistë ishte i qartë: të rrëzonin në Bashkimin Sovjetik pushtetin e klasës punëtore, diktaturën e proletariatit, të merrnin fuqinë në dorë dhe të sillnin në krye atje dhe në vendet e tjera socialiste elementë kundërrevolucionarë.

Partia jonë pati zotësinë të dallojë me kohë që udhëheqësit e rinj sovjetikë ishin armiq, ajo pati, njëkohësisht, guximin dhe trimërinë e madhe, që u shpalli luftë këtyre armiqve. Guximi dhe trimëria janë karakteristika të mbarë popullit tonë dhe duke qenë se në Parti bëjnë pjesë bijat dhe bijtë e popullit, anëtarët e Partisë sonë janë të pajisur me këto karakteristika të mira, që i ndihmojnë komunistët shqiptarë të mos u tremben vështirësive, sado të mëdha që të jenë, të mos u shmangen sakrificave, qoftë edhe me jetën e tyre. Partia jonë, pra, u shpalli luftë revizionistëve, ajo mori parasysh të gjitha vështirësitë e mëdha që parashikoi se do t'i dilnin përpara. Duke mbajtur këto qëndrime Partia jonë, Komiteti Qendror, nuk ecën symbyllur. Në luftën që ndërmori kundër të gji-

tha klikave revizioniste, sado që ato ishin në krye të shteteve të mëdha, Partia i bëri mirë llogaritë dhe eci me besimin e plotë se ne do t'i përballonim me sukses vështirësitë, gjer në fitore. Ne llogaritëm se revizionistët modernë janë me të vërtetë në fuqi në vende më të mëdha se Shqipëria, se ata kanë në dispozicion ushtri të mëdha e të pajisura me të gjitha llojet e armëve, por kjo gjë nuk na frikësonte, se ne ishim dhe jemi me të drejtën dhe e drejta kurdoherë fiton. Partia pati, gjithashtu, parasysh se, përveç gjithë këtyre armiqve të rinj, ne duhet të përballonim, siç kishim përballuar gjer atëherë, edhe imperialistët amerikanë, që i kishim kurdoherë mbi kokë, fashistët italianë, titistët jugosllavë, monarko-fashistët grekë e të tjerë. Të gjithëve duhet t'u qëndronim dhe u qëndruam. Po të mos u qëndronim, atëherë do të merrnin fund liria dhe pavarësia e atdheut, do të përmysej diktatura e proletariatit, do të merrnin fund socializmi dhe komunizmi në Shqipëri dhe populli ynë do të binte në robëri.

Të gjitha këto llogari Partia i bëri së bashku me popullin. Ajo pati parasysh se faktori kryesor, që vendos për triumfin e kësaj beteje, populli, ishte dhe është qind për qind me Partinë. Edhe ndonjë tip i paformuar, që llotit për ndonjë pakënaqësi, nuk mund të mos bashkohet me popullin në kohë rreziku, ai, bile, do të jetë i detyruar nga situatat të futet në valën e madhe të luftës çlirimtare. Populli është i gjithë me Partinë, me vijën e saj të drejtë. Gjersa punët qëndronin kështu, s'kishte përse të kishim frikë, prandaj u hapëm zjarr të gjithë armiqve,

të cilët u mobilizuan me çdo mjet që kishin në dispozicion, dhanë e morën për të na mbytur, organizuan komplete të shumta e të njëpasnjëshme për të na sulmuar, hodhën në territorin tonë banda diversantësh¹, na bënë bllokada e sabotazhe, na prenë kreditë e çfarë nuk bënë tjetër, por të gjitha orvatjet u dështuan, për arsye se Parti dhe popull ishin dhe janë të bashkuar si një trup i vetëm, se vija e Partisë në çdo drejtim ka qenë dhe është e drejtë.

Në radhë të parë, të gjitha masat e popullit janë të bindura se Partia lufton për mbrojtjen e pavarësisë së atdheut, për lirinë e popullit, për jetën e lumtur e të begatshme, për ndërtimin e socializmit, për sigurimin e këtyre fitoreve, që i kemi arritur me gjak. Partia lufton për të mbrojtur tokën, shtëpinë, pasurinë, nderin e nënave, të grave dhe të motrave tona. I madh dhe i vogël në Shqipëri ishin gati të jepnin jetën, por kurrë të mos i lëshonin nga duart këto fitore të mëdha historike, që i siguruan të udhëhequr nga Partia. Duke parë këtë gatishmëri të madhe, Partia i bëri thirrje popullit të ecte kurdoherë përpara në këtë rrugë, të ruante me vendosmëri e pa u përkulur, në asnjë rast, të gjitha ato që kishte fituar e kishte ndërtuar, t'u tregonim miqve dhe armiqve se ne vërtet jemi një popull i vogël, por edhe në gjendje të bëjmë gjëra të mëdha, siç kemi bërë, sepse jemi të vendosur në rrugën tonë. Populli ynë mban të tilla qëndrime se udhëhiqet nga

¹ Në periudhën 1948-1953 u zbuluan e u asgjësuan 358 banda diversantësh të armatosur, me 2 000 veta, që u vranë, u kapën, ose u dorëzuan.

Partia, se ka një shpirt të çeliktë dhe është i zgjuar, pra, i zoti të mendojë, të krijojë, të prodhojë vetë dhe t'i mbrojë me siguri frytet e punës së tij.

Me qëndrimin e tij të lartë populli shqiptar u dha të kuptojnë revizionistëve sovjetikë, çekë, gjermanë e të tjerë, të mos mendonin se, me tërheqjen e disa inxhinierëve, gjeologëve ose specialistëve që kishin dërguar në Shqipëri, do të paralizohet puna për ndërtimin e socializmit, do të pezullohet puna në minierat, në fabrikat dhe në bujqësinë e vendit tonë. Jo. Shqipëria jonë nuk vdes kurrë, tha Partia, sepse njerëzit tanë të mrekullueshëm do t'i përvishen me hov e me të gjitha forcat fizike e mendore punës dhe do të çajnë me sukses gjithnjë përpara.

Qëllimi i Partisë është që populli të rrojë gjithnjë i lumtur dhe të përmirësojë çdo ditë e më mirë jetën e tij. Këto ai mund t'i arrijë vetëm duke punuar e duke luftuar, tjetër rrugë nuk ka. Partia e kishte të qartë se në rrugën e lavdishme, ku na udhëhiqte e na udhëheq, do të kishim dhe kemi vështirësi, prandaj, gjatë gjithë kësaj kohe, na është dashur dhe kemi kapërcyer vështirësi shumë të mëdha, megjithëse kemi qenë pothuajse fare vetëm.

Ndihmat e kreditë janë të vogla përpara forcës ndërtimtare të popullit, e cila është shumë herë më e madhe, sepse në rast se ato kushtojnë, ta zëmë, një, mudi, djersa dhe shpenzimet e tjera që bën populli ynë për ndërtimin e veprave të planeve tona pesëvjeçare, janë njëqind, shpenzime këto që do t'i përballojë vetë populli shqiptar, do t'i përballoni ju, shoqe dhe shokë minatorë dhe kooperativistë të Mirditës, do t'i

përballojë forca e bashkuar e mbarë popullit tonë, sepse ajo është forcë e madhe ekonomike dhe morale shpirtërore, e organizuar në mënyrë marksiste-leniniste nga Partia dhe nga Qeveria jonë.

Populli është mobilizuar tani me të gjitha forcat për realizimin e planit të katërt pesëvjeçar. Realizimi i këtij plani do të japë mundësi që ekonomia dhe kultura të na të ecin edhe më përpara. Për t'ua arritur sa më shpejt e më mirë qëllimeve tona, Partia, si kurdoherë, na porosit që vazhdimisht të mësojmë. Realizimi i këtij orientimi do të krijojë mundësi më të shumta që i madh e i vogël të marrin pjesë gjallërisht në revolucionarizimin e gjithë jetës së vendit. Partia këshillon që i madh e i vogël të ndjekin shkolla, kurse dhe çdo formë tjetër arsimit. Pra, punët do të na ecin gjithnjë përpara dhe planet, që në bujqësi, në industri, në miniera e kudo i kemi tejkaluar, do t'i tejkalojmë akoma më shumë. Kështu ngjet jo vetëm në rrethin tuaj, po në gjithë Shqipërinë.

Partia na këshillon të mbështetemi në mundësitë tona dhe të mos presim nga të tjerët, jo se nuk kemi nevojë dhe se nuk e duam ndihmën e miqve, por se kështu është më drejt. Ndihamat e miqve janë kurdoherë të pamjaftueshme, prandaj ne po ndërtojmë socializmin me forcat tona.

Revizionistët modernë, kur tërhoqën specialistët dhe na prenë kreditë, llogotitën se industria jonë pas kësaj do të merrte fund, por jeta tregoi të kundërtën e atyre që parashikuan dhe deshën ata; industria jonë jo vetëm nuk mbaroi, por eci edhe më përpara, vendi ynë u pasurua më shumë.

Ju e dini vetë, më mirë se kushdo, si ka qenë Mirdita juaj në të kaluarën dhe si është tani, por edhe unë mund t'ju them se ajo, aktualisht, është një nga rrethet më të pasura të vendit tonë me mineral bakri, i cili është me perspektivë të shkëlqyer. Në të ardhmen, minierat e bakrit në rrethin tuaj do të shtohen, gjë që do të bëjë të domosdoshme ndërtimin e fabrikave të tjera, të reja, akoma më moderne se këto që kemi ndërtuar gjer tani për përpunimin e këtij minerali të vlefshëm e të dobishëm, për shfrytëzimin më të mirë e gjer në fund të të cilit edhe ne duhet të jemi më kërkues ndaj vetes. Por ndërtimi i minierave e i fabrikave të tjera, për nxjerrjen dhe për përpunimin e mineralit të bakrit në Mirditë, do të sjellë edhe pasurimin e përparimin e mëtejshëm të rrethit dhe do t'i japë një hov më të madh bujqësisë suaj. Ju po e shikoni vetë ç'ndihmë e madhe, nga çdo pikëpamje, dhe, në radhë të parë, nga ana ekonomike, është për popullin e Mirditës ekzistenca e këtyre minierave dhe, siç na kanë thënë, çdo familje mirditore ka të paktën nga një, po ka që kanë edhe nga dy punëtorë në miniera. Në vitet e ardhshme, kur minierat të shtohen edhe më tepër në numër, do të jemi të detyruar të shtojmë shumë mekanizimin e punëve, se forcat njerëzore që ka rrethi juaj nuk do të na mjaftojnë, ndryshe do të detyrohemi të sjellim njerëz nga rrethe të tjera. Pjesëmarrja në punë e shumë fshatarëve mirditorë në minierat e bakrit, ka ndikuar në rritjen e mirëqenies ekonomike të popullsisë të rrethit tuaj. Ajo ka ndihmuar në rritjen e të ardhurave të familjeve në mesatarisht 6-7 mijë lekë të vjetra për secilën, mbi shumën e atyre

të ardhurave që familja i siguron nga ekonomia kooperativiste.

Por ajo që ka më shumë rëndësi është se ju, punëtorët e minierave, çoni në kooperativat tuaja frymën revolucionare të klasës punëtore, që është shumë e nevojshme për përparimin socialist të jetës së fshatit tonë. Ju çoni atje tiparet e vendosmërisë dhe të heroizmit të klasës sonë punëtore, disiplinën dhe organizimin në punë, kuptimin politik të detyrave, të cilat janë shumë të domosdoshme për fshatarësinë tonë kooperativiste, që e ndien nga afër nevojën për t'u udhëhequr nga klasa punëtore.

Pleksja e fshatit me minierën, e klasës punëtore me fshatarësinë, është një favor i madh për rrethin e Mirditës. Ju, minatorët, jeni nga elementët më të përparuar të klasës punëtore, prandaj duhet të bëni kujdes dhe, gjatë kohës së lirë, kur shkoni në fshat, me punën e me fjalën tuaj, të përpiqeni të qëndroni kurdoherë në pararojë dhe të mos bini në pozitat e njerëzve me mentalitete të vjetra. Partia këtë kërkon nga ju. Juve ju bie barra të ngrini lart, nga çdo pikëpamje, fshatin mirditor. Ju, punëtorët e minierave e të fabrikave, kur shkoni në fshat, duhet të dalloheni në çdo drejtim, si nga puna, ashtu edhe nga edukimi politik, të ndiqni e të zbatoni me kujdes çdo porosi të Partisë për fshatin. Për këtë qëllim kërkon nga organizata e Partisë, qoftë si anëtarë partie ose si pjesëtarë të kolektivit punëtor të minierave e të fabrikave ku punoni, që të kujdesen më shumë për edukimin tuaj politik. Takimi juaj, sa më i dendur, me kuadro të Partisë dhe me drejtuesit e ndërmarrjeve, të cilët kanë ngritje

ideopolitike, teorike, kulturore dhe teknike më të madhe, do t'ju shërbejë dhe do t'ju ndihmojë që, kur të jeni në fshat, të ndikoni në ngritjen e nivelit të jetës së kooperativistëve në të gjitha drejtimet. Kjo punë do të bëjë të zhduket nga fshati mirditor prapambetja kulturore, të mos ketë më analfabetë, që në Mirditë jo vetëm djemtë e vajzat, por edhe burrat dhe gratë të mbarojnë shkollat fillore, bile edhe ato 8-vjeçare. Po edhe kur t'i kenë mbaruar, të mos ndodhë, siç ndodh në disa raste, që, sidomos gratë e vajzat, rrinë me vite të tëra pa lexuar një libër apo gazetë derisa pothuajse harrojnë fare të shkruajnë e të këndojnë edhe ato që kanë mësuar në shkollë, përkundrazi, të dinë të lexojnë dhe të shkruajnë mirë. Këtë detyrë ta kryeni të gjithë ju, me qëllim që në rreth të mos mbetet njeri pa lexuar libra e gazeta, në të cilat pasqyrohen shpirti i popullit, dëshirat e tij, vija e Partisë, eksperiencia e njerëzve tanë e grumbulluar në shekuj.

Të gjithë kemi nevojë të lexojmë libra dhe gazeta, ashtu siç kemi nevojë të hamë bukë çdo ditë. Prandaj, si anëtarët e Partisë dhe të tjerët, duhet ta bëjnë këtë gjë zakon, të gjejnë kohë për lexim. Unë, çdo mëngjes, para se të vete në punë, lexoj artikujt më interesantë të gazetave të ditës dhe jo vetëm kaq, por gjatë leximit mbaj edhe shënimet që më duhen. Kurse pasdarke zakonisht lexoj libra.

Kur duhet të përgatit ndonjë fjalim, unë mbështetem në eksperiencën dhe në mendimet e të gjithë punonjësve tanë. Konsultohem për probleme e këmbej mendime, në radhë të parë, me shokët e udhëheqjes, me të cilët bashkëpunoj ngushtë çdo ditë, pastaj me

shokë të tjerë komunistë e të paorganizuar në Parti, me masat, lexoj çdo ditë shtypin, dëgjoj me vëmendje mendimet që shfaqin shokët në mbledhjet e ndryshme ku marr pjesë etj.

Si komunist, si anëtar i Partisë e ndiej për detyrë të punoj edhe me njerëzit, prandaj, qysh më parë, mendoj çfarë do t'i them një komunisti që nuk e ka kuptuar një problem, çfarë këshillash do t'i jap një tjetri kur nuk punon mirë, çfarë do t'u them punëtorëve ose fshatarëve kur vete për t'u takuar me ta etj. Gjatë këtyre takimeve të gjithë japin mendime nga më të ndryshmet për problemet që bisedojmë, të cilat i dëgjoj me vëmendje. Prandaj them se në fjalimet tona shprehet eksperiencia e Partisë, eksperiencia e masës, e të gjithëve juve. Ju shokë të klasës punëtore duhet ta lexoni shtypin çdo ditë që në mëngjes. Komunistët, sidomos, e kanë detyrë leximin e rregullt të tij dhe veç kësaj ata duhet t'jua lexojnë edhe juve. Për ta bërë mirë këtë punë, ata duhet të gjejnë kohën për të menduar si t'jua paraqesin juve sa më të përmbledhur pasqyrën e shtypit të përditshëm. Gjatë 5 ose 10 minutave ata mund t'ju flasin për çështjet më të rëndësishme, në mënyrë që ato t'ju mbeten në kokë.

U fola dje shokëve në Rubik për gjendjen në Francë, ku janë ngritur në grevë kundër kapitalistëve monopolistë francezë 10 milionë punëtorë. Kjo ka bërë që gjithë jeta e këtij vendi të paralizohet, pse trenat, autobusët, avionët nuk lëvizin, telefonat nuk punojnë, gjithashtu edhe mjekët; farmacitë, teatrot, dyqanet janë mbyllur, saqë vetë kapitalistët nuk kanë ku të blejnë bukë dhe ushqime, çdo gjë është bllokuar. Ja

pra, sa e madhe është forca e klasës punëtore, e cila, po të rrëmbejë armët dhe të jetë e bashkuar e të udhëhiqet nga marksizëm-leninizmi, mund ta rrëzojë regjimin kapitalist. Por në Francë ajo nuk ia arrin dot këtij qëllimi, sepse në krye të organizatave të punëtorëve kanë zënë vend tradhtarët revizionistë. Partia revizioniste në Francë dhe parti të tjera që hiqen gjoja si socialiste paguhen nga kapitalistët. Pikërisht, pse janë në shërbim të borgjezisë, ato mundohen të përçajnë grevat e punëtorëve dhe organizatat e tyre, krerët po bien në marrëveshje me qeverinë e Dë Golit, bëjnë çdo gjë që klasa punëtore të mos bashkohet.

Ja, shoqe dhe shokë, në 2 minuta unë përmblodha ngjarjet e Francës, kurse në më shumë minuta mund t'ju bëja një informacion politik, t'ju flisja edhe për çështje të tjera. Komunistët, duke vepruar në këtë mënyrë çdo ditë, do t'ju hapin horizonte të gjera. Një ditë, gjatë informacionit, ata mund t'ju flasin për rëndësinë që ka në këto ditë thatësire ujitja e bimëve pranverore, mund t'ju tregojnë pastaj një ngjarje që ka ndodhur në Gjirokastër, ose për heroizmin e Shkurte Pal Vatës, të kësaj bije nga malësia e Dukagjinit etj. Pra, çdo ditë, brenda disa minutave mund t'ju flitet shkurt e në mënyrë të përmbledhur për ngjarjet kryesore të jashtme e të vendit. Dhe ai që do të ndjekë rregullisht informacionin politik, do të nxitet me kohë ta marrë vetë gazetën, ta lexojë dhe ta kuptojë. Megjithatë, edhe kur të arrihet në këtë fazë, komunistët mund dhe duhet t'ju rekomandojnë çfarë të lexoni që, kur të shkoni në shtëpi, të mendoni vetë dhe të dini si t'i lidhni ngjarjet. Kështu, kur t'ju rekoman-

dohet të lexoni një artikull që ka të bëjë, ta zëmë, me lëvizjen greviste të punëtorëve dhe të studentëve francezë, komentet dhe leximet e mëparshme do t'ju ndihmojnë të kuptoni dhe të lidhni ngjarjet, të kuptoni kështu se si kjo lëvizje ka ndikuar edhe në lëvizjet e punëtorëve e të studentëve në Norvegji, në Belgjikë, në Gjermani, në Spanjë e në Itali, ku studentët kanë pushtuar universitetet në shumë qytete. Nga të gjitha këto ju do të kuptoni çdo ditë e më mirë se kapitalizmi, nën presionin dhe luftën e klasës punëtore, ndodhet në një krizë të rëndë.

Revizionistët dridhen, ata kanë frikë të madhe se mos lëvizja e klasës punëtore dhe e studentëve në vendet kapitaliste u ngjitet si epidemi edhe në vendet e tyre. Revizionistët sovjetikë janë në ethe sidomos nga zhvillimi i ngjarjeve në Çekosllovakë, e cila po shkon me hapa të shpejtë drejt kapitalizmit. Borgjezia kapitaliste çeke ka marrë tani frenat në dorë. Tendencat e saj reaksionare, si një sëmundje ngjitëse, mund të përhapen edhe në vendet e tjera revizioniste. Është për këtë arsye që revizionistët sovjetikë kanë frikë të madhe se mos edhe në Bashkimin Sovjetik marrin kurajë elementët më ekstremistë kapitalistë dhe i rrëzojnë ata që janë sot në fuqi. Prandaj krerët revizionistë sovjetikë po bëjnë presione të mëdha në Çekosllovakë, i kërcënojnë krerët e rinj revizionistë çekosllovakë, kërkojnë prej tyre të qëndrojnë në kuadrin e pozitive në të cilat qëndronte gjer tani Novotni, ndryshe do t'i sulmojnë. Krerët çekosllovakë janë trembur nga presionet e sovjetikëve dhe janë prapsur disi.

Pas ngjarjeve të Çekosllovakisë, filloi lëvizja e studentëve dhe një lëvizje e madhe greviste e punëtorëve francezë. Ky është një fenomen ngjites e i rrezikshëm për botën kapitaliste dhe revizioniste. Nga kjo kanë frikë revizionistët sovjetikë, të cilët janë në aleancë jo vetëm me imperialistët amerikanë, por edhe me kreun e me përfaqësuesin e monopoleve të mëdha franceze, Charl de Golin. Por këto ngjarje do ta ndihmojnë klasën punëtore në Bashkimin Sovjetik që të mendojë, dhe me siguri çdo ditë e më shumë do të mendojë, se udhëheqësit e saj të tanishëm janë lidhur ngushtë me krerët kapitalistë, kundër të cilëve është ngritur në këmbë klasa punëtore e këtyre vendeve. Atëherë, çdo njeri sovjetik me gjykim të shëndoshë do të mendojë dhe do ta kuptojë sa të poshtër janë revizionistët sovjetikë. Këta, bile, me paturpësinë më të madhe, botojnë tani artikuj në të cilët flasin hapur kundër grevave të punëtorëve dhe të studentëve francezë. Shikoni gjer ku ka arritur poshtërsia e këtyre tradhtarëve! Ata, që me fjalë hiqen si mbrojtësit e klasës punëtore në botë, në fakt, janë dhe dalin kundër grevave të punëtorëve dhe të studentëve francezë, i quajnë punëtorët dhe studentët francezë deri edhe vagabondë, u bëjnë thirrje të futen në rrugën «legale», të mos përdorin dhunën etj. Por punëtorët dhe studentët francezë nuk ua kanë vënë veshin thirrjeve të tradhtarëve, përkundrazi, ata janë gjakosur në përleshjet e tyre me policinë borgjeze. Në Paris një lagje e tërë pranë universitetit është bllokuar krejtësisht nga studentët, atje janë prishur kalldrëmet e rrugëve dhe me gurët e tyre punëtorët e studentët po ndërtojnë

barrikada për t'i përdorur kundër dhunës kundërrevolucionare borgjeze. Nga një anë e këtyre barrikadave qëndron policia, nga ana tjetër, studentët. Policët i godasin studentët me bomba me gaz lotsjellës, por edhe studentët godasin policinë me ç't'u bjerë në dorë, me gurë, me shishe e me çdo mjet tjetër që kanë. Nga të dy palët janë plagosur me qindra, prandaj ndërtesa të universitetit të Parisit janë kthyer në spital, sepse qeveritarët nuk i çojnë të plagosurit në institucionet shëndetësore të qytetit.

Populli dhe Partia te ne përkrahin luftën greviste të proletariatit e të studentëve francezë. Kurse revizionistët sovjetikë, nga frika se mos ngjasin gjëra të tilla edhe në Bashkimin Sovjetik e në vendet e tjera ku sundojnë pasuesit e tyre, kanë filluar me të madhe të flasin kundër lëvizjes së studentëve dhe grevave të punëtorëve.

Kujdesi i organizatës së Partisë duhet të synojë që ju, punëtorët e Minierës së Kurbneshit dhe në përgjithësi të gjithë punëtorët mirditorë, që punojnë në fabrika dhe në miniera, të ngriheni çdo ditë e më shumë politikisht dhe ideologjikisht. Kështu, do të rritet akoma më tepër ndërgjegjja e klasës dhe, si bij të lavdishëm të Partisë, do të punoni dhe e keni për detyrë të punoni për të ndihmuar që edhe niveli i fshatarësisë të rrethit tuaj të ngrihet sa më shpejt. Ju duhet të shquheni në luftën për zhdukjen e zakoneve prapanike në fshatrat tuaja, për revolucionarizimin e mendjes së njerëzve, të dalloheni në luftën për emancipimin, për ndihmën e për përkrahjen që duhet t'u jepni grave, në luftën që u duhet bërë fejesave në moshë të mitur,

gjithashtu, t'u bëni një luftë të pamëshirshme mbeturinave të ideologjisë fetare, kishës, gënjeshtreve dhe poshtërsive të priftërinjve etj.

Klasa punëtore është e destinuar nga historia të mbrojë fatet dhe të ardhmen e njerëzimit, në luftë për ndërtimin e shoqërisë pa klasa, të shoqërisë komuniste. Klasa punëtore duhet të mbajë kurdoherë lart flamurin e luftës klasore, pse kështu do të arrihet ndërtimi i shoqërisë pa klasa dhe do të sigurohet jeta e lumtur për njerëzit.

Klasa punëtore e çdo vendi, me partinë e saj në krye dhe në aleancë me fshatarësinë punonjëse, ecën në këtë rrugë. Prandaj edhe juve këtu ju bie konkretisht detyra historike që fshatin kooperativist ta ngrini në një nivel më të lartë. Me këtë rast, dëshiroj të them se ju, mirditorët, burra dhe gra, nga natyra, jeni njerëz jashtëzakonisht të zgjuar dhe me karakter të fortë. Partia shikon te ju njerëz me tipare burrërore, njerëz që e kuptojnë shpejt e mirë dhe e zbatojnë drejt vijën e saj.

Me kënaqësi konstatojmë se në Mirditë prej vitesh është zhdukur zakoni i hakmarrjes, pra, nuk ndodhin më vrasje që në të kaluarën bëheshin pothuaj përditë. Kjo vjen se populli i rrethit tuaj e ka kuptuar mirë vijën e Partisë, ka kuptuar politikisht të këqijat që sillte ky zakon barbar. Mirditorit të ri, nuk ia lejon ndërgjegjja prej njeriu të rritur në socializëm e të edukuar nga Partia të mendojë të vrasë një njeri. Përkundrazi, ai thotë se kush i ka bërë dikujt një të keqe, le të lihet ta gjykojë drejtësia e popullit dhe, po të jetë nevoja, në qoftë se duhet vrarë, le ta vrasë ligji. Ja, kështu mendon dhe mendon drejt mirditori.

Ka edhe njerëz që trashëgojnë nga e kaluara ndonjë mosmarrëveshje. Kështu, ndonjë mirditor që e di se gjyshi apo babai ka qenë dikur në armiqësi me një bashkëfshatar, e ka pak të thyer zemrën dhe i qëndron larg tjetrit. Mirëpo ata tani punojnë të dy në një ekonomi të përbashkët, pra, në kooperativë, po për arsye të kësaj mbeturine që u rëndon në ndërgjegje nuk ndiejnë të njëjtën dashuri për njëri-tjetrin, ashtu sikurse për fshatarët e tjerë. Partia na mëson që këtë ndjenjë të turbullt ta zhdukim nga ndërgjegjja. Me fjalën e dhënë për të mos e marrë hakun vetë, është bërë një hap përpara. Tani Partia na mëson të jemi të gjithë si vëllezër dhe jo vetëm të zhdukim në mes tonë ato mosmarrëveshje që i kemi trashëguar nga e kaluara, por edhe sikur një njeri të bëjë sot një gabim ndaj një tjetri, ky duhet ta konsiderojë atë si vëlla dhe Partia duhet të përpiqet ta edukojë, ta kritikojë dhe të luftojë tek ai ndjenjën e vjetër të hakmarrjes, me qëllim që të gjithë së bashku në kooperativë të ecin në rrugë të drejtë, të jenë të bashkuar si vëllezër. Shikoni ç'ndjenja fisnike janë këto, të cilat organizatibazë e Partisë duhet t'i zhvillojë gjithnjë më shumë.

Mirdita ka një popull shumë përparimtar dhe arsimdashës. Në gjirin e popullit tuaj punoi arsimtari i lavdishëm Ndrec Ndue Gjoka, në ato kohë të vështira menjëherë fill pas Çlirimit, kur në të gjithë rrethin gati nuk kishte as kurse, pa lëre pastaj shkolla. Pikërisht në këto kushte, ky djalë i guximshëm dhe përparimtar, i ndihmuar nga populli i rrethit tuaj dhe i rrethuar nga dashuria e tij e zjarrtë, hapi këtu në Mirditë me dhjetëra shkolla. Kjo nuk u arrit vetëm në

sajë të përpjekjeve e të punës së palodhur të Ndrecës, po, në radhë të parë, në sajë të kuptimit të lartë të kësaj çështjeje të madhe prej vetë popullit. Pikëpamjet e Ndrec Ndue Gjokës si njeri politik, përpjekjet e tij si një komunist bolshevik, për të punuar e për të luftuar pa u lodhur, për t'i dhënë popullit dritë dhe mësim, u bashkuan me dashurinë e madhe për përparim dhe arsim, që ai i gjeti te të gjithë ju, malësorët trima të Mirditës, në ato momente të vështira, kur vendi ynë sapo kishte dalë nga lufta dhe reaksioni bënte çdo përpjekje për të na penguar. Dhe ishte pikërisht reaksioni që na e vrau Ndrecën, kurse populli i Mirditës i dha atij përkrahje të gjithanshme e të pakursyer. Kështu duhet gjykuar veprimtaria e tij revolucionare, kështu duhet gjykuar qëndrimi përparimtar i popullit të Mirditës dhe jo ndryshe.

Edhe në Mirditë rronin elementë antipopullorë, siç ishin bajraktarët, që vepronin kundër Partisë dhe popullit. Të tillë ka pasur kudo në vendin tonë, në Veri dhe në Jug të Shqipërisë. Nga Jugu ishin tradhtarët shumë të rrezikshëm për fatet e popullit, si: Ali bej Këlcyra, Qazim Koculi me shokë e të tjerë, ashtu si Gjon Marka Gjoni në Mirditë. Qofshin bajraktarët e Mirditës apo të Veriut, qofshin krerët e reaksionit në Jug të Shqipërisë, të gjithë ishin njerëz të një kallëpi, të gjithë e kishin shitur Shqipërinë tek i huaji, kurse populli shqiptar, duke përfshirë edhe atë të Mirditës, ishte i mburrur, si kurdoherë gjatë historisë, me ndjenja përparimtare. Mësimet e Partisë gjatë Luftës Nacionalçlirimtare i ndriçuan rrugën edhe popullit të Mirditës, të mos flasim pastaj për periudhën

pas Çlirimit, gjatë së cilës malësorët mirditorë janë shquar për patriotizmin e lartë dhe për ndjenjat e tyre përparimtare.

Kjo solli ndryshime të mëdha, veçanërisht te gratë dhe ne shikojmë tani me kënaqësi se gratë, nusët dhe vajzat tuaja shquhen mbi të gjitha të tjerat, kudo, në shkollë, në kurse, në aksione e jo vetëm në punë e në mësim, por edhe në zgjuarsin, në qëndrime revolucionare. Ato janë bërë shembull për të gjitha gratë dhe vajzat e tjera të Veriut dhe të Jugut të Shqipërisë.

Më poshtë shoku Enver foli për qëndrimin revolucionar të grave dhe të vajzave mirditore ndaj punës, për pjesëmarrjen e tyre në aksione, qoftë dhe menjëherë pas martesës dhe vazhdoi:

Gratë dhe vajzat tuaja, që ishin në kurs në Durrës, mësuan të pritnin, të qepnin, të gatuanin, mësuan për higjienën, për rregullin etj. Të gjitha këto janë të rëndësishme për jetën. Ju do të shihni ç'ndryshim kanë bërë vajzat tuaja, që kenë dërguar në shkollë për t'u bërë oficere. Kur të kthehen, ju nuk keni për t'i njohur fare, pse kanë ndryshuar krejtësisht, janë shëndoshur, janë zbukuruar e janë bërë më të forta. Të tilla i bëri ushtria. Atje ato jetojnë me regjim të caktuar, hanë dhe pinë mirë, ngrihen në orar, vërtet punojnë, stërviten dhe mësojnë, pra, lodhen, por edhe ushqehen mirë. Për to tregohet kujdes i madh dhe i gjithanshëm. Disa prej tyre janë hedhur edhe me parashutë nga aeroplani. Edhe vajzat e gratë që do t'ju kthehen nga kurset, gjithashtu, nuk keni për t'i njohur, se edhe atje kanë rregull në çdo gjë. Kjo do të thotë se për mbrojtjen e shëndetit të njerëzve, në radhë të

parë, nevojiten regjim dhe ushqim. Sigurisht, në kursin tremujor gratë dhe vajzat mësuan abëcënë e këtyre profesioneve, po vajzat e Mirditës do të dinë si t'i zgjerojnë këto dijeni dhe të bëjnë gjëra të mrekullueshme. Shokët më thanë se ju i pritni dhe i qepni vetë kostumet kaq të bukura të krahinës suaj. Unë mendoja përpara se këto ua pritnin dhe ua qepnin artizanët e vjetër të Shkodrës, kurse ju qenkeni vetë mjeshtre për këtë punë. Kur ju pritni e qepni kostume kaq të bukura, s'ka dyshim se një bluzë si ato që veshin në qytet, vajzat dhe gratë tuaja janë në gjendje ta presin dhe ta qepin akoma më bukur e më lehtë. Partia do të organizojë përsëri në të ardhmen kurse të tilla, ku ju të mësoni. Vajzat dhe gratë e Mirditës janë të zonjat që, brenda tre muajve, pa qenë nevoja të largohen fare nga fshati, të bëhen modiste të mrekullueshme, të qepin në mënyrë të hijshme rroba për veten e për fëmijët e tyre, po të duan ato mund t'u presin e t'u qepin kostume edhe qytetarëve, bile edhe t'ua qëndisin e t'ua zbukurojnë, pse janë gra të zgjuara dhe në gjendje të mësojnë çdo gjë.

Partia kërkon, sidomos nga ju, shokë punëtorë, që ta ndihmoni fshatin në këto drejtime, t'i ndihmoni, në radhë të parë, gratë dhe vajzat. Gjatë punës suaj me kooperativistët të jeni të durueshëm, sidomos me pleqtë dhe me plakat, që mund të kenë dhe kanë disa mendime të prapambetura. Pleqtë dhe plakat trashëgojnë më shumë mbeturina, pse ata janë mburjtur dhe janë edukuar me to për dhjetëra e dhjetëra vjet me radhë, prandaj duhet pasur durim dhe të mos pretendojmë që këto pikëpamje që kanë t'ua ndryshojmë

brenda ditës, ose me një bisedë, qoftë edhe brenda një viti. Rëndësi ka të dimë t'u marrim krahët pikëpamjeve të tyre. Ata na duan, se na kanë djem dhe vajza, por, njëkohësisht kanë edhe disa koncepte që s'pajtohen me ideologjinë e Partisë. Prandaj të punojmë që ato t'ua zhdukim gradualisht, me durim, me punë të vazhdueshme bindëse e sqaruese, me qëllim që të arrijmë të mbizotërojnë në familje, në kolektivin e fshatit e kudo, qëndrimi marksist-leninist, harmonia e mirëkuptimi, të krijohet dashuri e pakufishme për njëri-tjetrin, të zhduket në ambientet tona socialiste çdo ndjenjë mërie, zënke, hatëri të mbetur, të krijohet në fshat një jetë e re, e sinqertë, e hapët, një dashuri e respekt i vërtetë për njerëzit. Kështu, kur unë të kem për të thënë ty diçka, këtë ta bëj me zemër të hapët, qoftë e ëmbël ose e thartë ajo dhe ti të mos ma marrësh për keq, të mos e vësh në dyshim qëllimin e mirë për të cilin ta thashë. Por edhe kur ti të më përgjigjesh, pavarësisht nga mënyra si do të ma thuash, unë, gjithashtu, nuk duhet të ta marr për të keq. Një gjë e tillë është e nevojshme të bëhet kudo, megjithëse në fillim është pak e zorshme. Ajo duhet të kuptohet politikisht, sepse ndikon për të krijuar kudo, në çdo kolektiv, unitetin e ngushtë të popullit, unitetin e çeliktë në mes popullit dhe Partisë. Ajo ndikon për të ngritur në një nivel të lartë kuptimin e drejtë të interesit të përgjithshëm në raport me atë personal, për të kuptuar nga të gjithë se më e mirë dhe më e ëmbël është jeta e përbashkët. Jeta e izoluar e njeriut në kullë, i vetmuar me gruan dhe me kalamanët, i pushtuar nga mendimi si të sigurojë mirëqenien për

këta tre-katër veta, moskokëçarës për brengat e qederet e të tjerëve, ose i angazhuar me përpjekjet për të përfituar në rrugë jo të drejta nga njëri dhe nga tjetri, për të grumbulluar sa më shumë për vete dhe për pjesëtarët e familjes së tij, janë të huaja për sistemin tonë socialist, se nuk janë të drejta dhe nuk pajtohen me moralin tonë.

Socializmi i kushton rëndësi të jashtëzakonshme përmirësimit të jetës së të gjithë njerëzve tanë. Partia mendon dhe punon që në familjen e secilit të sundojë lumturia, që gruaja të jetojë kudo e gëzuar dhe në harmoni me burrin dhe me fëmijët, me babanë dhe me nënën. Partia lufton që jeta e çdo njeriu në familje të jetë pa mungesa, që të ketë çdo vit e më shumë ushqime, veshmbathje dhe sende të tjera të nevojshme. Partia na edukon se lumturia e secilit nuk sigurohet duke punuar e duke jetuar të veçuar, por në kolektiv, të gjithë së bashku, pse, që të ngrihet në një nivel të lartë jetesa e secilit, nevojitet bashkëpunimi i të gjitha forcave të kolektivit. «Bashkimi bën fuqinë» thotë populli dhe, me të vërtetë, po të bashkohemi të gjithë, duhet të bëhemi të gjerë dhe të sakrifikojmë interesin personal, të mos mendojmë si përpara «kjo gjë është e imja», «këtë e dua unë» etj., etj. Prandaj fjalët që mund të lëshojë poshtë e lart ndonjë mendjeshkurtër, duke thënë: «Kjo të përket ty», «Mos pyet njeri, merre» etj., i shërbejnë një qëllimi të keq dhe ai njeri që e bën, së pari, duhet të këshillohet e t'i tërhiqet vërejtja. Vetëm kur të të thotë dhe të ta japë kolektivi atë që të përket, vetëm atëherë mund ta marrësh dhe kështu do të ndiesh edhe kënaqësinë e punës dhe të

kontributit që ke dhënë edhe ti për të mirën e përgjithshme. Kurse po të marrësh, pra, të përvetësosh diçka që nuk të takon, nuk do të kesh edhe ndërgjegjen të qetë, se do të mendosh kurdoherë që nuk ke bërë mirë.

Socializmi nuk ka për qëllim të zhdukë personalitetin e njeriut. Ne, komunistët, na akuzojnë sikur gjoja jemi kundër ngritjes së personalitetit të individit, sikur ne prishim familjen etj. Këto nuk janë të vërteta. Përkundrazi, e vërteta është se gjithë puna politike dhe edukative që bën Partia ka për qëllim ta ngrejë personalitetin e njeriut në të gjitha drejtimet, në radhë të parë, nga pikëpamja politike. Gjithashtu, ajo punon të ngrejë nivelin arsimor dhe kulturor të secilit, që çdo njeri të ketë mundësinë të shprehë lirisht mendimin e tij, të kritikojë cilindo pa frikë dhe të marrë masa, të veprojë praktikisht. Kjo gjë flet për personalitet të njeriut tonë. Kurse në vendet kapitaliste nuk ndodh kështu, njerëzit atje nuk kanë mundësi të mendojnë të gjithë për probleme shoqërore, të krijojnë, të rritin nivelin e tyre politik, kulturor, profesional etj., etj., pra, me një fjalë, kapitalizmi nuk lejon, nuk krijon kushte për formimin e personalitetit të njeriut. Ato që predikon propaganda borgjeze «për ngritjen e personalitetit të njeriut» janë vetëm fjalë, pse, kur punëtorët ngrihen në greva e demonstrata, kapitalistët u drejtojnë tytat e pushkëve. Ndërsa në vendin tonë, ku po ndërtohet shoqëria socialiste, ndodh krejt e kundërta. Te ne bëhet luftë e rreptë kundër të gjithë atyre që përpiqen të shuajnë kritikën, që mundohen të ulin personalitetin e njeriut dhe ta poshtërojnë atë.

Një njeri që gabon ne nuk e futim në dhe, por bëjmë përpjekje ta korrigjojmë. Partia nuk na mëson të mbajmë qëndrime ekstremiste, përkundrazi, na orienton të punojmë me njerëzit. Kolektivi në socializëm e ka për detyrë dhe përpiket një herë, dy, tri herë dhe gjer në fund për ta ndihmuar atë që gabon, të futet në rrugë të drejtë dhe vetëm kur mbush kupën e kur nuk dëshiron të korrigjohet, atëherë i tregon vendin.

Nuk është e vërtetë që në vendin tonë socialist kolektivi është indiferent ndaj interesave të familjes sonë. Anëtarët e Partisë dhe të kolektivit, ta zëmë në fshat, nuk i zë gjumi po të dëgjojnë se 2-3 fëmijë janë të sëmurë. Ata bëjnë të gjitha përpjekjet që fëmijët, sa më parë, të vizitohen nga mjeku, ose të shtrohen në spital kur është e nevojshme dhe të gjitha këto bëhen që fëmijët të shërohen sa më shpejt. Ata nuk i zë gjumi, gjithashtu, kur marrin vesh se ndonjëri ka ndonjë shqetësim. Dhe në qoftë se ka ndonjë që nuk tregon kujdes në këtë drejtim, organizata e Partisë dhe gjithë kolektivi bëjnë punë politike dhe edukative me të, e kritikojnë, i thonë se në këtë rast nuk ka vënë politikën në radhë të parë.

Të gjitha të këqijat dhe anët negative, që ekzistojnë akoma aty-këtu në vendin tonë, e kanë burimin në atë që ndërgjegjja e këtyre njerëzve nuk është ngritur akoma në nivelin që duhet, se te këta vihet, në radhë të parë, interesi i vogël personal, i cili shfaqet në mënyra të ndryshme, prandaj gjithnjë duhet luftuar. Zhdukjen e këtyre të këqijave ne mund ta arrijmë nëpërmjet ngritjes politike dhe ideologjike të klasës punëtore, e cila është në gjendje të spastrojë

veten sa më parë e të bëhet flamurtare dhe bartëse e vijës së Partisë në të gjitha drejtimet. Klasa punëtore ka në gjirin e saj atë pjesë të lavdishme, që mbron dhe zbaton me vendosmëri vijën e Partisë, që rron dhe punon në vështirësi të mëdha, në frontet më të rënda të punës dhe këta janë minatorët tanë, siç jeni ju këtu.

Punët në vendin tonë në përgjithësi shkojnë mirë. Kemi besim se bujqësia këtë vit do të jetë e mbarë. Shiu që ra ditët e fundit gati në gjithë Shqipërinë, siç ra mbrëmë këtu te ju, tokës e bimëve u ka bërë shumë mirë. Në përgjithësi, kudo, edhe grurin e kemi të mbarë, prandaj planin e shtetit, me siguri, do ta realizojmë. Çështja tani është që të bëjmë të gjitha përpjekjet për të realizuar zotimet.

Me punët për bimët e tjera jemi më përpara se vitin e kaluar. Misrin pothuaj e kemi mbjellë. Tani kanë mbetur vetëm përqindjet e fundit, po kjo, në këto momente, nuk përbën ndonjë gjë të madhe dhe do të realizohet medoemos, pse ka akoma kohë për ta mbjellë. Edhe lulen e diellit dhe të gjitha kulturat e tjera pranverore i kemi mbjellë. Kanalet ujitëse janë kudo në gatishmëri, por, në qoftë se do të na ndihmojë edhe koha dhe do të na bien shira të tjera gjatë qershorit, bujqësinë do ta kemi jashtëzakonisht të mbarë këtë vit, si dy vitet e para të këtij pesëvjeçari.

Edhe ju, këtu në Mirditë, të mendoni ca më mirë se gjer tani për çështjen e bujqësisë. Të hapni toka të reja më shumë dhe më shpejt, duke menduar, njëkohësisht, edhe për mekanizimin e disa proceseve të punës, sepse duhet të kursejmë fuqinë punëtore. Organet

e pushtetit duhet të shikojnë, gjithashtu, ç'mundësi ka akoma për ujitjen. Ju vetë të bëni më shumë përpjekje për të mbjellë grurë kudo ku ka toka të përshtatshme dhe mos u kënaqni me pak e kur themi pak, nënkuptojmë edhe 20 apo 25 kv/ha, duke menduar se me të tilla rendimente e siguron bukën. Neve na duhet të kemi bukë më shumë dhe jo vetëm bukë, por të rritim edhe lopën, me të cilën, ju sidomos, jeni shumë prapa, prandaj në këtë drejtim është e nevojshme të bëni kthesë. Kur ngrihet problemi i rritjes së lopës, ndonjë nga ju mund të pyesë se ku do t'i kullotë ato, me se do t'i ushqejë, dhe ne i themi atij të mësojë, të marrë eksperiencë nga Kurbneshi, që mban lopë në këtë zonë të thellë, në dimër e në behar, nga të cilat merr dy mijë e ca litra qumësht në vit prej secilës. Por që të rritësh lopë, në radhë të parë, ato duhet të kenë të hanë, prandaj të bëhen mirë llogaritë, për sigurimin e ushqimit të tyre, të mirëmbahen, sepse vetëm kështu ekonomia jonë blegtorale ka interes nga rritja e tyre. Një lopë e mirë të jep qumësht sa për 30-40 ose më shumë dele. Të kesh lopë, do të thotë të kesh më shumë qumësht, djathë, gjizë e gjalpë e, gjithashtu, të kesh edhe më shumë pleh.

Ku e keni ju plehun e dhive që mbani në shtëpi ose në kooperativë? Sigurisht, ai mbetet pyjeve e shkurreve ku ato kullotin, me një fjalë, vete dëm. Mirëpo pa pleh nuk ka bujqësi të përparuar, nuk mund të ketë rendimente të larta. Plehu kimik, që prodhojmë tani në vendin tonë, në asnjë mënyrë nuk e zëvendëson plehun organik. Pastaj, duhet pasur parasysh se plehu i lopëve është më i mirë dhe grumbullohet

i gjithë, se lopa mbahet në stallë. Sikur të llogaritim që të mos i merrnim lopës gjë tjetër, vetëm pleh, ajo prapë ka leverdi të madhe ta mbash, sepse ky ndihmon shumë në rritjen e rendimenteve të kulturave bujqësore. Shihni, pra, ç'përfitime të mëdha vijnë nga rritja e lopëve.

Me këtë nuk dua të them që ju tani t'i zhdukni fare dhinë, sepse, sidomos në Mirditë, ka shumë vende të përshtatshme për to, vetëm përpiquini t'u bëni shërbime dhe të merrni prej tyre 100-120 litra qumësht në vit për kokë, sepse kështu ato kanë leverdi. Prandaj duhet të mbani aq krerë dhi, sa është kapaciteti i kullotave që të mund të siguronin rendimente më të larta prej tyre. Gjithashtu, punoni që të merrni nga çdo dhi jo një, po nga dy keca. Lezan Pisli në rrethin e Matit aq merr dhe fshati i tij nuk është shumë larg Mirditës. Por duhet thënë se shumë nga kooperativat e rrethit tuaj nuk e njohin Lezanin, nuk dinë gjë fare për një bari kaq të zotin si ai. Ju duhej të kishit përfituar, po të paktën përpiquini të përfitoni paskëtaj, nga eksperiencia e tij e mirë.

U duhet hyrë thellë këtyre gjërave, shokë. Mua më thanë se këtu në rrethin e Mirditës keni një gjë të mirë, lopët i keni shfrytëzuar për sigurimin dhe shtimin e qeve dhe nga kjo anë jeni mirë. Këtë kujdes vazhdojeni edhe në të ardhmen. Në asnjë mënyrë mos i braktisni qetë, sikur edhe mijëra traktorë t'ju dërgohen nga Qeveria, sepse ata janë të domosdoshëm për punët bujqësore, sidomos në zonat malore, si kjo juaja, gjithashtu, përveç që duhen në sektorin e bujqësisë, qetë shërbejnë edhe për tërheqje. Kjo rrugë

që keni zgjedhur dhe që na e ka diktuar nevoja, sepse akoma ka mungesa të mjeteve të mekanikës, është e drejtë, prandaj mos e braktisni dhe përpiquni të rritni sa më shumë qe.

Lopëve që do të rritni e do të shtoni, për ato qëllime që ju thashë, përpiquni t'ua përmirësoni racën. Përmirësimi i racës arrihet, në radhë të parë, me sigurimin e ushqimit të mjaftueshëm dhe me kujdesin e madh për mbarështimin e tyre. Në qoftë se nuk i ushqeni si duhet, në qoftë se nuk u siguron stalla të përshtatshme, në qoftë se nuk i pastroni dhe nuk u bëni shërbimet e nevojshme dhe kujdesin për t'i ruajtur nga sëmundjet, atëherë nuk keni për të pasur lopë për qëllimet që thamë, si rrjedhim, nuk do të keni bulmet, viça, qe dhe pleh. Në fushat e Myzeqesë kooperativat bujqësore tani kanë arritur të mbajnë me qindra lopë, duke marrë prej secilës 2 500 deri 3 000 litra qumësht në vit, pa folur pastaj për ndërmarrjet bujqësore, ku merren nga çdo lopë 4 000-5 000 litra qumësht, bile ka disa që japin deri 6 000 litra qumësht e më shumë në vit. Rezultate kaq të larta arrihen vetëm pasi t'u bëhen lopëve gjithë shërbimet e duhura. Lopa, kur ushqehet rregullisht, shëndoshet dhe prodhon më shumë. Prandaj në këtë drejtim duhet të bëni kthesë. Edhe shteti do t'ju ndihmojë, duke ju dërguar damazë dhe, kur të kemi mundësi, do t'ju dërgojmë edhe lopë të racës, vetëm të keni kujdes që ato të mbahen mirë, që ndërzimi i tyre të bëhet sipas rregullave të shkencës. Për të gjitha këto probleme duhet të dërgoni njerëz të mësojnë në shkolla e në kurse.

Sikurse bujqësia, edhe industria, kudo në vendin

tonë, është në gjendje shumë të mirë. Planet në fushën e industrisë jo vetëm realizohen, por edhe tejkalohen. Revolucioni tekniko-shkencor, që po zhvillohet në Shqipëri, ka dhënë fryte të mira në përparimin e mëtejshëm ekonomik të vendit.

Edhe problemi i revolucionarizimit të shkollës ka vënë në lëvizje mendjen e çdo njeriu te ne. Në mbledhje të gjera punonjësit tanë të qytetit dhe të fshatit, po diskutojnë tani në masë për këtë problem të madh, propozojnë si e si ta bëjmë shkollën akoma më revolucionare, si t'i nxjerrim njerëzit tanë nga bankat e shkollës më të mësuar, si ata ta lidhin më mirë teorinë me praktikën, për t'i dhënë një hov akoma më të madh ndërtimit të socializmit. Të gjitha këto janë të pleksura dhe kanë për qëllim ta shpien akoma më përpara zhvillimin e ekonomisë dhe të kulturës në Shqipëri, të rritin edhe më shumë fuqinë mbrojtëse të atdheut, pozitën e të cilit sot janë më të forta se kurrë jo vetëm brendapërbrenda, por edhe jashtë vendit.

Këtë gjendje të mrekullueshme në atdheun tonë socialist e sigurojnë udhëheqja e drejtë e Partisë, vija e saj e drejtë marksiste-leniniste, uniteti i saj i çeliktë me popullin. Kjo bën që Republika jonë Popullore të gëzojë një autoritet të madh, simpatinë dhe respektin e të gjithë njerëzve përparimtarë në arenën ndërkombëtare. Lufta e Partisë sonë për ndërtimin e socializmit në Shqipëri, revolucioni që po bën Partia jonë në të gjitha fushat për ndërtimin me hapa të sigurt të socializmit në vendin tonë janë një ndihmë e madhe që Partia jonë i jep revolucionit botëror, i cili

do t'u japë grushte vdekjeprurëse revizionizmit modern dhe kapitalizmit botëror, që tani ndodhen në vështirësi dhe në krizë të madhe.

Imperializmi amerikan, në mënyrë të veçantë, është duke kaluar vështirësi të mëdha brenda dhe jashtë vendit. Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ekziston kriza e madhe e dollarit, vlera e të cilit, me gjithë përpjekjet e imperialistëve, vazhdimisht po bie. Dhe kjo ndodh për shkak të shpenzimeve të mëdha të luftës që bën imperializmi amerikan, sidomos në Vietnam, për shkak të bazave ushtarake që ka në vende të ndryshme të botës. Për të dalë nga kjo gjendje, monopolet e mëdha, veç të tjerash, shtojnë taksat në kurriz të popullit amerikan. Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ekziston dhe po rritet gjithnjë e më e ashpër lufta klasore. Zezakët janë ngritur në demonstrata të mëdha kundër politikës raciste të qeverisë amerikane. Atje janë mbi 20 milionë zezakë që përbëjnë, brenda kështjellës së imperializmit amerikan, një forcë gjithnjë revolucionare. Në Shtetet e Bashkuara ngrihet herë pas here vala e luftës së studentëve amerikanë me ide përparimtare, të cilët shprehin indinjatën e tyre kundër luftës në Vietnam, kundër shpenzimeve kolosale për luftën dhe kundër të këqijave të tjera nga të cilat vuan mbarë populli amerikan. Reaksionarët miliardë amerikanë duan që t'i kenë të urtë studentët dhe rininë, t'i kenë të nënshtruar që të mund t'i dërgojnë me lehtësi të vriten në Vietnam dhe kudo në vendet e tjera ku imperializmi amerikan ka baza ushtarake.

Të gjitha këto tregojnë se, brenda në vetë Shtetet

e Bashkuara të Amerikës, klikat imperialiste nuk rrojnë të qeta. Imperializmi amerikan nuk është keq vetëm brenda vendit, po edhe jashtë. Ai ka hedhur kthetrat e tij në të gjithë botën dhe kudo ka lëvizje të mëdha antiimperialiste e mbi të gjitha shquan lufta heroike që po bën populli vietnamez kundër dhunës imperialiste. E gjithë bota po shikon me sy dhe po bindet dita-ditës se si shteti më i fuqishëm kapitalist, i armatosur gjer në dhëmbë, po pëson disfata nga më kolosale nga një popull i vogël. Imperialistët amerikanë do të detyrohen më së fundi ta humbasin këtë luftë, ata kurrë nuk do të mund ta fitojnë. Kurse revizionistët sovjetikë po bëjnë çdo përpjekje që, në aleancë dhe në bashkëpunim të ngushtë me imperialistët amerikanë, t'i detyrojnë vietnamezët të futen në rrugën e tradhtisë, të bëjnë paqe. Në qoftë se vietnamezët do të bëjnë paqe me imperialistët amerikanë, kjo do të jetë në dëm të Vietnamit, kurse po të vazhdohet lufta me furi, si gjer tani, populli vietnamez do të fitojë medoemos, në mos sot, nesër.

Duke qenë përkrahës të luftës heroike të popullit vietnamez, ne u kemi thënë udhëheqësve vietnamezë, në mënyrë miqësore dhe të sinqertë, se nuk jemi dakord me bisedimet që po zhvillojnë në Paris me armiqet më të egër të tyre dhe të të gjithë njerëzimit, me imperialistët amerikanë. Vietnamezët janë në rrugën e fitores dhe me siguri do të fitojnë, prandaj është në të mirë të tyre të vazhdojnë luftën gjer në fund. Megjithatë, siç u kemi thënë, ata le të veprojnë si të duan, kjo është puna e tyre.

Ç'po bëhet tani në Paris në bisedimet midis viet-

namezëve dhe amerikanëve? Në fakt asgjë! Vietnamezët kërkojnë që imperialistët amerikanë të pushojnë bombardimet kundër Veriut. Lufta e armatosur zhvillohet në Vietnamin e Jugut, por imperialistët amerikanë vazhdojnë prej disa vjetësh bombardimet edhe kundër Republikës Demokratike të Vietnamit. Në Jug bëhet luftë partizane kundër agresorëve amerikanë dhe reaksionarëve vietnamezë. Tani vietnamezët e Veriut u thonë amerikanëve të ndërpresin bombardimet. Këta u përgjigjen se nuk do t'i ndërpresin në rast se vietnamezët e Veriut nuk deklarojnë publikisht që nuk do të dërgojnë më ndihma në Jug, gjë që ata nuk e pojnë dot. Kësaj i thonë hiq e mos e këput. Revizionistët sovjetikë, nga ana e tyre, për të turbulluar ujërat, i këshillojnë vietnamezët në prapaskenë që të vazhdojnë bisedimet.

Në të gjitha anët e botës, kudo ku ka forca të imperialistëve amerikanë, po rritet urrejtja kundër tyre. Urrejtja e popujve rritet, gjithashtu, kundër revizionistëve modernë, me ata sovjetikë në krye, që bashkëpunojnë me imperialistët, si edhe kundër gjithë atyre që hiqen sikur janë kundër amerikanëve, siç është Franca. Dë Goli mund të thotë se është kundër amerikanëve, po studentët dhe punëtorët francezë këto ditë janë ngritur edhe kundër tij, sepse edhe në Francë e në çdo vend ku sundon kapitali, klasa punëtore dhe masat e tjera të popullit shtypen e shfrytëzohen. Kjo tregon sa e thellë është kriza e kapitalizmit. Varet nga partitë marksiste-leniniste që këtë krizë ta thellojnë më shumë, të punojnë për zgjimin e klasës punëtore, për ta organizuar dhe për ta hedhur në luftë kundër

kapitalizmit, kundër reaksionit e revizionizmit, për të ngritur dalngadalë e gjithnjë më lart valën e papërbajtur të revolucionit, i cili, kur të piqen momentet, do të shpërthejë. Kjo do të ndodhë një ditë dhe është e padiskutueshme. Detyra jonë është të ndjekim, si kurdoherë, me besnikëri rrugën marksiste-leniniste që ka çaktuar Partia, ta zbatojmë atë me përpikëri në jetë, të realizojmë planet, ta mbajmë barutin kurdoherë thatë dhe të jemi vigjilentë e të bashkuar, në unitet të çeliktë, si mishi me thoin, popull-Parti.

Rroftë Partia!

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në
AQP

PER PUNËT E BUJQËSISË TË MENDOJME TË GJITHE

*Nga biseda me kooperativistë të Perlatit
në rrethin e Mirditës*

28 maj 1968

Kjo bisedë u zhvillua në një kodër të fshatit. Shoku Enver Hoxha dëgjoi një informacion të shkurtër nga kryetari i kooperativës, drejtoi disa pyetje për punën, për rendimentet, për zbatimin e direktivës që lidhet me furnizimin e mirë të anëtarëve pas shkurtimit të oborrit kooperativist etj., pastaj, ndër të tjera, tha:

Populli shqiptar është nga ata popuj të rrallë që kanë zakone nga më të mirat, të cilat ai i ruan të paprekura brez pas brezi. Këtë e themi, sepse i tillë është realiteti. Është detyra jonë që këto zakone të mira t'i ruajmë e t'i trashëgojmë.

Po të lexojmë historinë botërore, do të shohim se popuj të tjerë, shumë më të mëdhenj nga populli ynë, janë zhdukur fare, janë shuar nga faqja e dheut, kurse, duke ruajtur këto cilësi kaq të mira, siç janë: atdhe-

dashuria, trimëria, bujaria, ndershmëria, besa etj., populli ynë, edhe pse i vogël, ka mundur të përballojë gjatë shekujve sulmet e pandërprera të armiqve të mëdhenj e të tërbuar, që kanë kaluar mbi të.

Por, krahas cilësive të mira që na kanë mbajtur gjallë, kemi pasur edhe disa zakone të këqija, të trashëguara nga e kaluara, të cilat ne i luftojmë. Të tilla kanë qenë edhe qëndrimet jo të drejta ndaj gruas. Dihet se gruaja përbën gjysmën e popullsisë. Edhe në vendin tonë ajo përbën pjesën më të rëndësishme e më përparimtare të popullsisë. Gruaja lind jetën, pa të cilën nuk mund të ndërtohet socializmi. Prandaj gruas, që përbën kyçin e jetës, duhet t'i rezervohet nga të gjithë respekti më i lartë njerëzor.

Çështjen e emancipimit të gruas Partia e ngre si një problem shumë të rëndësishëm. Këtë populli ynë e ka kuptuar mirë. Po të shikojmë rrjedhimin e kësaj çështjeje që pas themelimit të Partisë, do të vëmë re se kudo janë bërë ndryshime e përparime të mëdha, në radhë të parë te njerëzit, pa të cilët nuk do të ishte e mundur të arriheshin gjithë këto realizime të mahnitshme në Shqipëri. Forca, dituria dhe zotësia e Partisë, puna e saj e madhe dhe e vazhdueshme, sukseset e njëpasnjëshme në të gjitha fushat e jetës, ndriçuan, në radhë të parë, mendjet e njerëzve, të fshatarëve dhe të punëtorëve, të grave e të burrave, të të rejave e të të rinjve, për t'i drejtuar të gjithë në rrugën e vërtetë dhe për t'i ngjitur shkallët e përparimit një nga një, për të ndryshuar, njëkohësisht, veten e tyre dhe natyrën.

Vijën e drejtë të Partisë njerëzit tanë, natyrisht, nuk mund ta kuptonin të gjithë përnjëherësh. Por Par-

tia ishte e bindur se, gradualisht, atë do ta kuptonin të gjithë. Për këtë qëllim ajo punoi vazhdimisht me durim, pa u ndalur para asnjë vështirësie. Partia kishte besim se një ditë fshatarët do ta kuptonin se duhej të krijonin kooperativat e tyre bujqësore. Ju e kishit zor ta kuptonit rëndësinë e kësaj çështjeje në fillim, kur u hodh parulla për bashkimin e tokave, të mjeteve e të kafshëve të punës. Për këtë ju nuk kishit faj dhe kush ju bën fajtorë, nuk gjykon drejt. Në tokat tona shekuj me radhë kishin sunduar bejlerët, agallarët, kapedanët e bajraktarët, që mbanin xhandarë e sejmenë të shumtë me pushkë në krahë dhe jo vetëm kaq, por, nëpërmjet tyre, ata përpiqeshin si e si të rrëmbenin tokën e çdo pasuri tjetër të popullit. Në ndërgjegjen e secilit ishte krijuar bindja se toka ishte shpëtimi, ishte jeta dhe, ndonjë, edhe pas Çlirimit, mendonte se, po t'i merrej ajo fshatarit do t'i vdiste urie e gjithë familja.

Parulla që hodhi Partia për bashkimin e tokave dhe të mjeteve të punës, nuk do të thoshte që këto t'u jepeshin bajraktarëve, si në kohën e Gjon Marka Gjonit. (Juve ju kujtohet Gjon Fusha, dhëndri i kriminelit me damkë, Gjon Marka Gjonit, që shëtiste atëherë mbi kalë dhe frikësonte fshatarët, po më në fund edhe ai hëngri plumbin ballit nga dora e popullit.) Partia vërtet do t'i bashkonte tokat, por ato do të mbeteshin prapë të kooperativistëve. Ajo bëri përpjekje që njerëzit ta kuptonin mirë këtë çështje të madhe. Nëpërmjet shpjegimeve, që Partia bëri vazhdimisht pa u lodhur, u arrit që shumica dërrmuese e njerëzve tanë ta kuptonin rëndësinë jetike të kolektivizimit. Partia

ishite e ndërgjegjshme se kjo punë do të vazhdonte me këmbëngulje, për vite me radhë, gjersa të bindeshin të gjithë. Për të realizuar këtë qëllim të lartë, shokët e Partisë vazhdimisht shkonin shtëpi më shtëpi, bisedonin me fshatarët, i sqaronin. Ndodhte shpesh që kryetari i ndonjë familjeje largohej, bëhej i sëmurë, ose fshihej, me qëllim që të mos takohet me agjitorët e Partisë dhe këtë e bënte sepse nuk ishte i qartë për problemin. Ne e kuptonim gjendjen, Partia na kishte mësuar të kishim durim me fshatarët, gjersa ata të bindeshin se kolektivizimi ishte e vetmja rrugë shpëtimi e tyre. Më në fund kësaj iu arrit dhe kolektivizimi tashmë ka përfunduar në gjithë vendin tonë¹. Kjo është një fitore e madhe. Edhe ju vetë në fshatin tuaj po i shikoni tani frytet e kësaj pune. Por, më mirë, madhështia e kësaj veprë të pavdekshme të Partisë duket në fushat e mëdha të Shqipërisë, ku janë zhdukur të gjitha gjerdhet dhe arat pjellore të kësaj zone janë ndryshuar, janë bashkuar në një, si të ishte një det i madh.

Edhe në Mirditën tuaj, që është vend jashtëzakonisht i bukur dhe me tokë shumë pjellore, ka përfunduar kolektivizimi². Ky duhet të konsiderohet, gjithashtu, një sukses i madh juaji. Në krahasim me disa rrethe të tjera, Partia te ju nuk hasi vështirësi të mëdha për kolektivizimin. Ju e kuptuat politikisht këtë çështje, ashtu si keni kuptuar mirë edhe shumë pro-

1 Në vitin 1967 përfundoi plotësisht kolektivizimi i bujqësisë në Shqipëri.

2 Kolektivizimi i bujqësisë në rrethin e Mirditës përfundoi më 26 dhjetor 1966.

bleme të tjera shoqërore për të cilat fola sot edhe në Kurbnesh.

Me kënaqësi vërejmë se për shumë vite me radhë në rrethin e Mirditës nuk ka ndodhur ndonjë vrasje për hakmarrje, zakon ky i egër e barbar, që i armiqësonte njerëzit. Kjo do të thotë se orientimet e Partisë ju i keni kuptuar politikisht, keni kuptuar drejt se këto zakone që i kanë lënë të huajt, duhen zhdukur njëherë e përgjithmonë, se jeta e tjetrit nuk duhet prekur, prandaj, kur dikush të bën një dëm ose faj, kundër tij duhet ankuar në gjykatë, pse drejtësia e diktaturës sonë të proletariatit do ta gjykojë dhe do ta dënojë fajtorin sipas fajit ose dëmit që ka bërë. Prandaj kush arrin ta zhdukë këtë shfaqje të shëmtuar, tregon se i ka kuptuar mirë mësimet e Partisë.

Juve ju mbetet tani të punoni pa u lodhur për ta forcuar kooperativën tuaj, në mënyrën e organizimit dhe në zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë, prandaj nuk duhet të kënaqeni me rezultatet e para që keni arritur. Në asnjë mënyrë mos e flini mendjen në prodhimin e patates, se 60 kuintalë patate për hektar që keni marrë vitin e kaluar janë pak, ky është një rendiment i ulët. Të luftoni të merrni 130, 140, 150 dhe 160 e më shumë kuintalë për hektar, ndryshe patatja, me këtë rendiment, nuk ka leverdi të mbillet. Natyra këtu në Perlat është e freskët, prandaj mendoj se patatja bëhet shumë mirë.

Është mirë të bëni studime më të thella për zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë në Mirditë dhe këto studime t'i bëni me forcat tuaja dhe me ndihmën e Partisë e të shtetit.

Në radhë të parë, punoni me të gjitha forcat për hapjen e tokave të reja për të realizuar zotimin që keni marrë. Në qoftë se nuk gabohem, ju keni dhënë fjalën që deri në fund të këtij pesëvjeçari do të shtoni tokën e punueshme. Jam i sigurt se këtë mund ta realizoni që sivjet, prandaj shikoni ku ka mundësi të zgjeroni sa më shumë sipërfaqen e tokës. Vetëm duke parë vendin nga automobili, njeriu vëren se në kooperativën tuaj ka akoma faqe të tëra tokash të tjera për të hapur. Pra, me qindra hektarë tokë të re mund të hapë vetëm kooperativa juaj. Kështu që, po të studiohet me kujdes kjo çështje nga të gjitha kooperativat e rrethit, sipërfaqja e tokave të reja në Mirditë mund të dyfishohet. Për t'ia arritur këtij qëllimi duhet të përdoret, në radhë të parë, puna e njeriut, por, meqenëse nuk ka mundësi që të arrihen të gjitha me këtë mënyrë, Partia dhe pushteti do të mendojnë për t'ju dhënë disa mekanizma për shpyllëzim, sigurisht, të pyjeve të degraduara.

Të keni parasysh, motra dhe vëllezër, se pyjet janë një pasuri e madhe e Shqipërisë dhe juaja, prandaj jo vetëm t'i ruajmë ato me kujdes e të mos i braktisim, po t'i kthejmë në pasuri me vlerë të madhe. Në këto pyje të vendosim sharra dhe në zemër të tyre të ngremë industrinë e lëndës së drurit.

Nga ana tjetër, të bëhen përpjekje për t'i pasuruar pyjet me kafshë të shumta e të ndryshme gjuetie, siç kanë vepruar e veprojnë në vende të tjera, si, për shembull, me sorkadhe, me derra të egër e me lloj-lloj kafshësh të tjera e shpendësh me vlerë ekonomike. Në këto pyje ne mund të kultivojmë, gjithashtu, një sërë

bimësh mjekësore, si, për shembull, sherbelin dhe shumë të tjera të përshtatshme, që t'ju sjellin juve dhe gjithë Shqipërisë të ardhura të mira. Të gjithë e dimë se nëpër pyje mbijnë lloj-lloj kërpudhash, një pjesë e të cilave janë vërtet të dëmshme, po pjesa tjetër jo. Megjithatë, edhe të hidhurat mund të mblidhen për të përgatitur barna mjekësore, kurse ato që janë të mira mund të përdoren për të ngrënë, sepse kanë vlerë të mirë ushqimore. Pastaj, duhet menduar që pyjet t'i spastrojmë nga ferrat e nga shkurret, t'i rregullojmë, t'i mbjellim si duhet, sepse përbëjnë një pasuri të madhe. Kurse pyjet e vogla, me shkurre e me drurë të tjerë të degraduar, të cilat nuk kanë perspektivë zhvillimi, të hapen me traktorë dhe në to të mbillen kultura të ndryshme. Atje ku sipas studimeve që duhen bërë, del se ka leverdi dhe rriten mirë, të mbillen patate, grurë, misër. Pra, të ndërtojmë edhe te ju një bujqësi moderne e të lulëzojnë jo vetëm misri dhe gruri, por edhe patatet, zorzavatet, frutat, bimët mjekësore, të rritim lopët, shpendët etj.

Ju, në Mirditë, nuk e vini në llogari lopën, kurse kjo duhet të vihet në plan të parë, pse, pa zhvillimin e saj, nuk ka bujqësi të përparuar. Neve, shqiptarëve, na është bërë zakon shekullor që të merremi me bagëti të imëta, aq sa nuk ndahemi dot prej tyre, ashtu siç nuk ndahemi nga kalamajtë që i duam si shpirtin. Mirëpo delja e dhia kërkojnë hapësira të mëdha kullotash dhe nuk japin atë sasi qumështi, gjalpi e mishi sikundër jep lopa. Pastaj, këto hapësira ekzistonin një herë e një kohë, kur në vendin tonë bujqësia ishte e prapambetur. Tani nuk ka e akoma më pak toka të

pashfrytëzuara do të ketë në të ardhmen, sepse kudo, çdo vit e më shumë, ato punohen e mbillen. Kur diku shihet një pëllëmbë tokë e përshtatshme për bujqësinë, ajo menjëherë hapet, punohet e mbillet. Në këto kushte deles e dhisë po u shkurtohet vazhdimisht çairi.

Edhe në të ardhmen ne do të vazhdojmë ta shtojmë sipërfaqen e tokës së punueshme dhe do ta punojmë mirë, me kujdes. Tani keni 420 hektarë tokë më shumë se ç'kishit kur ngritët kooperativën¹. Kjo ju ka dhënë mundësi këta 2-3 vjetët e fundit që ta siguronit vetë bukën. Por mos u kënaqni vetëm me këtë, bëni përpjekje që të realizoni, bile t'i tejkaloni rendimentet që keni caktuar në planin e brendshëm për grurin e për misrin, kështu të rritni sipërfaqen e mbjellë me drithëra, të rritni dhe rendimentet. Në këtë mënyrë ju mund të siguronit jo vetëm bukën, por një pjesë të tokës ta rezervoni për lopën.

Lopa ka nevojë të hajë. Po i dhe, ajo të jep qumësht e gjalpë. Lopa pastaj jep shumë mish, jep një viç ose mëshqerrë çdo vit, por jep edhe plehun, që është shumë i domosdoshëm për rritjen e rendimenteve në bujqësi. Nga ana tjetër, në krahasim me plehun e dhisë e të deles që mbetet ferrave, nëpër kullota, plehu i lopës grumbullohet lehtë në stallë. Po t'u hedhësh bimëve, bashkë me plehun organik, edhe ca pleh kimik, pleh azotik ose superfosfat, duke i bërë edhe shërbimet e nevojshme tokës, mund të marrësh 40-50 kv misër ose 30-40 kv grurë për hektar. Kështu,

1 Në vitin 1982, në kooperativën e Perlatit kishte 635 hektarë tokë më shumë nga sa kishte në krijimin e saj.

duke rritur rendimentin, krijohet mundësia për të shkurtuar sipërfaqet e mbjella me drithë, sepse në këtë rast, në një sipërfaqe më të paktë, mund të marrësh më shumë se dyfishin e drithërave të planifikuara në rendimente të ulëta. Kur të arrini këtë, atëherë ju këtu në Perlat mund të rritni 100-150 lopë të mira dhe në këtë mënyrë do të keni krijuar kushtet për përpunimin e qumështit, të gjalpit, të djathit dhe kjo jo vetëm për plotësimin e nevojave të fshatit, por edhe për t'i shitur një pjesë të këtyre produkteve, qoftë edhe jashtë, dhe blerësit do t'i preferojnë, pse në to do të ndihet era e mirë e maleve tona. Kësaj i thonë bujqësi e përparuar.

Por a mund ta arrijmë ne këtë? Për objektiva të tillë as mund të bëhej fjalë kur ishit të hallakatur dhe punonit si individë të veçuar. Tani që jeni të bashkuar dhe punoni për një qëllim, ata mund të arrihen fare mirë, sepse zgjerohen vazhdimisht fushat e punueshme, organizohet më mirë forca e fuqisë punëtore në mënyrë kolektive, me brigada. Shteti ka e do të ketë çdo vit mundësi t'ju japë më shumë traktorë për të punuar tokat. Tani jemi në gjendje të ndërtojmë edhe uzina të tjera për prodhimin e plehrave kimike, si ato që kemi ngritur deri tani.

Po nga dalin gjithë këto mundësi për ngritjen e fabrikave, për importimin e traktorëve, për elektrifikimin e fshatit, për ndërtimin e veprave të shumta që po ngrihen e do të ngrihen në të katër anët e vendit dhe pa i marrë taksa popullit, siç merr borgjezia në vendet e tjera? Shteti ynë socialist, si pushtet i popullit, i punëtorëve dhe i fshatarëve punonjës, mendon

e punon si nikoqir i mirë. Ai di dhe i rregullon planet ekonomike në mënyrë që të ardhurat, që vijnë nga fabrikat, nga minierat dhe nga ndërmarrjet e ndryshme ekonomike të vendit, të përdoren për interesin e popullit, për zhvillimin e pandërprerë të ekonomisë e të kulturës së tij. Këto të ardhura nuk venë më si përpara në xhepat e Ahmet Zogollëve, të Gjon Marka Gjonëve, të ministrave e të funksionarëve të tjerë, siç ndodhte e siç ndodh në qeveritë antipopullore të feudalëve e të kapitalistëve. Të ardhurat kombëtare sot shkojnë në arkën e popullit dhe përdoren për të ndërtuar hidrocentralet, uzinat, fabrikat, kanalet ujitëse e kulluese, hekurudhat etj., që shtohen çdo vit, të cilat ndihmojnë që mbi këtë bazë të re të zhvillohen gjithnjë e më shumë e të ecin akoma më përpara industria, bujqësia, kultura dhe arsimi ynë popullor, të rritet mirëqenia e popullit. Në çdo pesëvjeçar që kalon, pasuria e përbashkët rritet dhe popullit i sigurohen më shumë të ardhura, sepse shtohen prodhimet, me të cilat zhvillohet më tej ekonomia popullore.

Ju në Perlat keni mundësi të mëdha për zhvillimin e gjithanshëm të kooperativës. Planin që keni bërë për sivjet dhe për gjithë këtë pesëvjeçar duhet jo vetëm ta realizoni, por në krye të çdo viti të studioni me imtësi ç'mundësi të tjera mund të krijohen për zhvillimin e mëtejshëm dhe, mbi bazën e kësaj, t'i bëni planit ekzistues shtesat dhe ndryshimet e nevojshme. Të gjithëve ju, e jo vetëm kryetarit të kooperativës dhe sekretarit të organizatës-bazë të Partisë, duhet t'ju punojë mendja, të shfaqni mendime, të bëni propozime të ndryshme për të mirën e punës. Mund të propozoni,

fjala vjen, se në këtë ose në atë parcelë ka mundësi të marrim kaq ose aq kuintalë më shumë për hektar, se ka mundësi të bëhen tri prashitje etj. Gjithashtu, të flitni për punën tuaj dhe të shokëve, të shprehni lirisht kur mendoni se një brigadier mund ta bëjë punën më mirë, se ky ose ai kooperativist mund të punojë më me ndërgjegje, se kryetari i kooperativës duhet të ketë kujdes të drejtë më mirë, se ky ose ai anëtar partie në këtë rast nuk e ka dhënë shembullin personal etj. I kritikoni pa druajtje të gjithë ata që nuk i kryejnë mirë detyrat. Mësohuni që kritikën t'ia bëni secilit kurdoherë në sy, përpara shokëve dhe luftoni që çdo njeri, cilidoqoftë, të japë llogari para masës së kooperativistëve. Kur një njeri me përgjegjësi bën gabime, ai duhet ta pohojë vetë gabimin, të shpjegojë shkaqet, pse e bëri, të zotohet e të përpiqet që të mos e përsëritë. Në qoftë se populli ia fal, ai të vazhdojë atje ku është, po të punojë më mirë. Në qoftë se nuk e fal, të merren masa, të hiqet nga përgjegjësia dhe, në vend të tij, të zgjidhet një tjetër më i zoti. Vetëm kështu do të përparojë kooperativa juaj, si dhe të tjerat në gjithë vendin tonë. Për kooperativën duhet të mendojmë të gjithë sepse ekonomia e saj është e përbashkët. Për të nuk duhet të mendojnë vetëm 3-4 veta që janë zgjedhur në kryesi. I takon secilit të kuptojë mirë detyrat që i janë caktuar dhe t'i zbatojë ato, sepse kjo është për të mirën e të gjithëve.

Mobilizohuni mirë për realizimin e vendimit që keni marrë për të hapur toka të reja dhe këtë punë ta bëni me forcat tuaja. Në qoftë se do t'ju duhet ndonjë ndihmë apo mekanizëm, bisedoni me komunistët dhe

me shokët e pushtetit në rreth dhe në qoftë se këta nuk do të kenë mundësi t'jua japin, atëherë drejtojuni Komitetit Qendror dhe Qeverisë që të shikojnë se si mund t'ju vijnë në ndihmë.

Shikoni, gjithashtu, ç'mundësi keni për të zgjeruar ujitjen¹, sepse edhe kjo ka rëndësi të madhe. Të gjitha mundësitë që keni në dispozicion në kooperativë, i «shtroni» mbi tavolinë, i diskutoni mirë, përcaktoni çfarë do të bëni vetë me forcat tuaja dhe merrni vendime. Për ato që s'keni mundësi t'i bëni vetë, kërkoni ndihmën e Qeverisë, e cila do t'ju njoftojë se sa ndihmë do të mund t'ju japë për çdo vit. Po të mos ketë mundësi të bëjë diçka, prapë do t'ju thotë haptazi, motra e vëllezër, këtë që kërkoni sivjet nuk jua japim dot, do të shohim çfarë mund të bëjmë vitin tjetër apo pas dy vjetësh. Në këtë rast, gjersa t'ju vijë ndihma, përpiquni të realizoni me forcat tuaja ato që keni vendosur, duke punuar në kooperativë me rregull e me disiplinë të fortë.

Jam i bindur se populli i Mirditës i ndien dhe i kupton shpejt dhe drejt të gjitha këto probleme. Kjo ngjet për arsye se në rrethin tuaj janë gërshetuar më mirë se kudo elementë të klasës punëtore me fshatarësinë dhe kjo, sepse gati nga çdo familje kooperativiste ka një ose dy veta që punojnë në miniera ose në fabrika. Ky fakt luan dhe do të luajë rol të madh për Mirditën dhe për gjithë Shqipërinë. Ne konstatojmë se te mirditorët kemi një popull besnik të Partisë, të

1 Në vitin 1982, u arrit që 54 për qind e sipërfaqes së tokës të Kooperativës Bujqësore të Perlatit të jetë nën ujë.

zgjuar, të vendosur, që i kupton dhe i zbaton drejt, me mençuri, me pjekuri dhe me disiplinë, mësimet e marksizëm-leninizmit, direktivat e Partisë. Këtë bindje shprehin edhe shokët e Komitetit Qendror e të Qeverisë, që vijnë herë pas here këtu midis jush, si dhe shokët përgjegjës të Partisë e të pushtetit të rrethit, kur i thërresim në Komitetin Qendror të Partisë, në Byronë Politike dhe në Qeveri për të raportuar. Populli i Mirditës i ka këto cilësi në ndjenjat e tij të pastra, të cilat ia forcon edhe më shumë fryma e klasës punëtore që punon me ndërgjegje të lartë në minierat dhe në fabrikat e rrethit tuaj.

Zhvillimi i minierave në Mirditë ka një rëndësi të jashtëzakonshme për gjithë Shqipërinë. Rrethi juaj, aktualisht, është nga qendrat më të rëndësishme minërare të vendit tonë dhe i tillë parashikohet të jetë edhe në të ardhmen. Nëntoka juaj fshëh në gjirin e vet pasuri të mëdha, të cilat do t'i nxjerrin vajzat dhe djemtë tuaj e do të përdoren për të mirën tuaj dhe të të gjithë vendit tonë, për përparimin e gjithë Shqipërisë.

Mirdita ka dhënë një kontribut të madh në zhvillimin e revolucionit tonë socialist. Përpjekjet e Partisë pas Çlirimit kishin për objektiv që populli, kudo në Shqipëri, të merrte arsim dhe kulturë, të luftoeshin errësira e prapambetja. Këtu te ju lindi mësuesi i lavdishëm Ndrec Ndue Gjoka, që u bë pishtar i përhapjes së dritës dhe të arsimit, një nga përçuesit më të flaktë të vijës së Partisë. Ai, pa marrë parasysh rrezikun e jetës që ia kërcënonin këlyshët e Gjon Marka Gjonit, shkante fshat më fshat, hapte shkolla, mbledhte djemtë e cucat dhe, me mjetet e pakta që

dispononte, herë me kalema e herë pa kalema, me letër e pa letër, u mësonte abëcënë të rinjve e të rejave, gjer në çastin e fundit kur reaksioni na e vrau.

Vendimi që ka marrë Partia për elektrifikimin e gjithë fshatrave të Shqipërisë ka një rëndësi të madhe historike¹. Në bazë të tij dhe brenda një kohe shumë të shkurtër, katërvjeçare, të gjitha shtëpitë e fshatrave do të ndriçohen me dritë, që prodhohet e do të prodhohet edhe në të ardhmen nga hidrocentralet tona, si dhe nga centralet që punojnë me naftë. Por, që të shpërndahet e të vihet në përdorim energjia elektrike, duhen tela bakri. Bakrin, me të cilin bëhet ky tel, e prodhoni ju, e prodhon Mirdita. Kështu, e parë me këtë sy, Mirdita do të bëhet edhe përçuese e dritës elektrike në Shqipëri. Ajo po merr pjesë aktivisht në këtë proces të transformimit revolucionar të vendit tonë, që ecën drejt socializmit.

Zhvillimi i ekonomisë, shtimi i prodhimeve industriale e bujqësore, kërkon edhe zgjerimin e vazhdueshëm të transportit, ndërtimin e rrugëve e të hekurudhave. Për realizimin e këtyre detyrave të mëdha është mobilizuar gjithë populli. Nga të katër anët e vendit

1 Në Plenumin e 4-t të Komitetit Qendror të PPSH, që zhvilloi punimet në datën 11-12 dhjetor 1967, u mor vendim për përfundimin e elektrifikimit të të gjitha fshatrave të vendit tonë deri më 8 Nëntor 1971, në festën jubilarë të 30-vjetorit të themelimit të Partisë, 14 vjet para afatit të parashikuar nga plani perspektiv i elektrifikimit të fshatit.

Me punën heroike të popullit të udhëhequr nga Partia elektrifikimi përfundoi më 25 tetor 1970, 13 muaj para afatit dhe 15 vjet përpara nga sa e parashikonte plani perspektiv.

kanë dalë vullnetarë të rinisë, ndër të parët e të cilëve ishin edhe vajzat e rrethit tuaj, me katër herëinat në ballë. Ato luftuan për të vënë në jetë vijën e Partisë, mësimet e saj dhe si burrnesha çanë errësirën, prapambetjen, shkuan vullnetarisht në hekurudhë, u kthyen plot energji në fshatrat e tyre, por reaksioni, që e kishte punën e tyre halë në sy, i kapi dhe i torturoi, kurse ato qëndruan të patundura gjer në fund. Kësisoj, prapë nga Mirdita, katër cucat të edukuara me mësimet e Partisë u ngritën si pishtarë në historinë e ndritur të popullit shqiptar. Këto katër cuca mirditore: Mrikë Lokja, Shkurte Cara, Marta dhe Prenda Tarazhi dhanë jetën e tyre të re për ndërtimin e hekurudhave të Shqipërisë, për përparimin e vendit.

Shikoni ç'rëndësi të madhe ka për Shqipërinë zhvillimi i shumanshëm i Mirditës! Këto përparime të mëdha në rrethin tuaj u arritën, pse në Mirditë njerëzit janë të vendosur deri në fund për të zbatuar vijën e Partisë. Por, që të arrihen suksese më të mëdha, bashkë me vendosmërinë, duhet edhe dituria. Ajo është një nevojë për zhvillimin e mëtejshëm të vendit, prandaj dëshira për të mësuar t'u bëhet edukatë të gjithëve, asnjë të mos i pengojë për në shkollë djemtë e cucat, sepse, duke mësuar, ata do të bëhen shumë të vlefshëm jo vetëm për Mirditën, por për gjithë vendin tonë.

Për njerëz të mësuar nuk ka nevojë vetëm Mirdita, për ta ka nevojë gjithë Shqipëria. Këta vocrrakë, që kam tani përpara, pas 15-20 vjetësh do të jenë nga ndërtuesit aktivë të socializmit në vendin tonë, do të derdhin edhe ata djersën e tyre që atdheu të ecë në

rrugën drejt komunizmit. Partia i ka hapur dyert e shkollave për të gjithë dhe u jep njerëzve përkrahjen e saj, prandaj të mos u sillen pengesa djemve dhe cucave për të mësuar, për të ecur kurdoherë në rrugën që u tregon Partia me qëllim që të bëhen njerëz të ditur, të lidhur me popullin, që ta duan atë, të duan atdheun, Partinë, të duan mësimin dhe të bëhen të zotë për ta çuar punën përpara. Në të ardhmen do të kërkohet akoma më shumë nga ju, sepse punët që do të bëjmë do të jenë më të mëdha e më të rënda. Dituria jonë tani nuk është akoma aq e madhe, megjithëse këto që po bëjmë, nënave dhe baballarëve me të drejtë u duken si çudi dhe habiten se si djemtë e vajzat e tyre po ndërtojnë gjithë këto vepra të mëdha. Fabrikat që kemi ndërtuar ne sot, nesër do të duken si gjëra të vjetra, sepse, kur këta, pionierët e sotëm të bëhen nga 40 vjeç, do të ndërtojnë vepra më moderne dhe do ta çojnë shumë më përpara ndërtimin e socializmit në Shqipëri.

Detyra jonë është që brezit të ri t'i japim mundësi të mësojë në çdo drejtim, në çdo degë: në industri, në bujqësi, në matematikë, në fizikë, në mjekësi etj. pra, në çdo fushë të diturisë.

Por, para së gjithash, mos harroni ushtrinë. Partia kërkon të përgatitë për oficerë edhe djem nga rrethi i Mirditës, sepse këtu te ju ka plot njerëz të aftë të zotërojnë shkencën ushtarake. Njerëz të tillë të zotë na duhen për vende drejtuese në ushtri, në Ministrinë e Punëve të Brendshme e gjetkë. Që të sigurohen gjithë këta njerëz, në radhë të parë, duhet të kuptohet mirë nga gjithsecili vija e madhe e Partisë.

Partia i do me gjithë shpirt njerëzit e mirë, pse ajo tek ata mbështetet. Partia përbëhet nga komunistët, po këta, si gjithë njerëzit, nuk janë pa të meta, kanë edhe ata të meta e bëjnë gabime. Bile, edhe ne udhëheqësit mund të gabojmë. Prandaj, në qoftë se këto nuk na i vë njeri në dukje, nuk na i kritikojnë shokët dhe populli, atëherë na mori lumi, sepse komunistit ose udhëheqësit do t'i rritet mendja, do të mendojë se s'ka si ai, do të flejë mbi dafina, do të vërë festen mënjanë dhe të tjerët do t'i duken si miza. Mirëpo, nga gabimet që mund të bëjmë ne, do të vuajë populli. Kur bëjnë gabime komunistët, shkaktohet më shumë dëm sesa kur gabon një i paorganizuar në Parti. Prandaj Partia e ka mësuar dhe e mëson çdo anëtar të saj të ecë në rrugë të drejtë, të punojë e të kujdeset që të mos gabojë, që detyrat t'i kryejë sa më mirë dhe, në qoftë se ndodh që gabon, të përpiqet ta kuptojë gabimin dhe ta korrigjojë.

Partia i ka mësuar dhe i mëson komunistët të kuptojnë se cila punë është e mirë dhe cila është e keqe, t'i kuptojnë gabimet më shpejt se të tjerët dhe kurrë të mos i fshehin ato, po të flasin dhe t'i pranojnë hapur para Partisë dhe para masave. Fshehja e gabimeve dhe mungesa e sinqeritetit nuk janë punë e pastër dhe ata që veprojnë kështu s'janë komunistë të mirë. Në qoftë se një komunist gabon, shokët që punojnë me të duhet «t'i lajnë kokën». Me këtë dua të them se shokët duhet ta kritikojnë atë dhe, me kritikën, me qëndrimin e tyre të drejtë, ta pastrojnë nga të metat e këtë ta bëjnë pa frikë. Në qoftë se nuk e bëjnë këtë shokët e Partisë, atëherë ta bëni ju, ta bëjë populli.

Dikush mund të thotë se nga ta dijë populli nëse komunistin e kanë kritikuar shokët e organizatës-bazë apo jo. Populli këtë e di, sepse komunisti nuk rron i mbyllur në kullë, një pjesë e shokëve të kolektivit janë anëtarë të organizatës-bazë të Partisë, pastaj, qëndrimet dhe puna e komunistit duken çdo ditë nga të gjithë. Kur një njeri shkon te komunisti në zyrë për të qarë një hall dhe ky i fundit mban qëndrim brutal ndaj tij, i thotë të qërohet andej etj., njerëzit duhet të reflektojnë thellë për këtë sjellje e të mendojnë se ky komunist nuk është në terezi, se po sillet siç sillej dikur, në të kaluarën, bajraktari. Dhe, pas kësaj, të arrijnë në konkluzionin se ky komunist nuk vepron sipas mësimëve të Partisë. Në këtë rast duhet të kërkohet të zhvillohet mbledhja e popullit, ku t'i thuhet këtij komunisti një për një dhe hapur të gjitha të metat dhe ta vënë me shpatulla pas muri.

Partia nuk e mëson komunistin të sillet me popullin si kapadai dhe si bajraktar dhe çdo komunist duhet t'i ketë të qarta e t'i zbatojë në praktikë normat dhe mësimet e Partisë. Në qoftë se ai nuk bindet e nuk ndreqet, atëherë populli t'i drejtohet Partisë, po qe nevoja të drejtohet deri në Komitetin Qendror dhe të merren masa ndaj komunistit që mban një qëndrim të tillë, të shikohet me sy kritik posti ose përgjegjësia që ai ka. Duke vepruar kështu ndaj atij që gabon, qoftë ky komunist ose i paorganizuar në Parti, ai e mbledh veten dhe, po të jetë njeri i mirë, do të mendojë se shokët dhe masat që e kritikuan kanë të drejtë, pra, do të kuptojë gabimin dhe do të japë fjalën se do të ndreqet. Në këtë rast populli mund ta falë po t'i duket bi-

ndëse dhe po të bjerë dakord me autokritikën, por në të ardhmen do ta ndjekë veprimtarinë e tij në punë për të parë se si po përpiqet ai të vërë në jetë këshillat e popullit. Po u konstatua se përsëri do të bëjë të tilla gjëra, çështja e tij të shqyrtohet përsëri, të mbahet qëndrim i rreptë dhe, në qoftë se faji do të jetë i rëndë, Partia të marrë masa deri në përjashtimin e tij nga radhët e saj.

Ky është ilaçi i vetëm për të shëruar komunistët kur gabojnë, por ky është, gjithashtu, ilaçi edhe për të tjerët, sepse nuk gabojnë vetëm komunistët, po edhe njerëz që s'janë të organizuar në Parti. Këta ndodh që gabojnë ca më tepër, kurse komunistët, me edukatën e kontrollin e vazhdueshëm të Partisë, bëjnë punë të madhe për t'i zhdukur gradualisht mbeturinat. Partia nuk i lë ata të përsëritin gabimet, i këshillon vazhdimisht si të punojnë e si të veprojnë dhe kur ndonjëri gabon, si ushtar i Partisë që është, dërgohet në punët më të vështira që atje të korrigojë. Kurse një person tjetër, që nuk është i organizuar në Parti, shokët komunistë e këshillojnë një ose disa herë, derisa të bindet. Prandaj Partia duhet të vërë të gjitha forcat që edhe njerëzit e paorganizuar në Parti t'i bindë, t'i sqarojë për gabimet ose për të metat e tyre, sepse sqarimi është shërim për njerëzit. Pikërisht nga ky qëndrim i drejtë, i gjerë, i matur dhe i hapët me njerëzit buron edhe dashuria e popullit shqiptar për Partinë.

Kritika e popullit është një kontroll i madh dhe i nevojshëm për komunistët. Edukata e brendshme e Partisë dhe ndihma shoqërore e komunistëve për njëri-tjetrin janë vërtet mjete të rëndësishme për kalitjen

revolucionare të anëtarëve të Partisë, por kjo shpesh nuk është e mjaftë. Kur komunisti bën gabime dhe kritikohet në organizatën-bazë, nuk ka të drejtë të thotë se, meqë u kritikova atje, nuk duhet të kritikohem në asamblenë e kooperativës dhe t'i vijë thartë kur shtrohet çështja e tij dhe i kërkohet llogari nga masat. Jo, populli ka të drejtë ta kritikojë drejtpërsëdrejti dhe t'i kërkojë llogari komunistit për gabimet që ka bërë dhe ai është i detyruar të japë sqarime, të përgjigjet ndershmërisht për to. Por në qoftë se ndonjëri shpif, atëherë komunisti, ose kushdo tjetër qoftë, ka të drejtë të mbrohet, të argumentojë se ato për të cilat akuzohet nuk janë të vërteta dhe, kur ka të drejtë, të nxjerrë edhe shokët që e kanë parë për të provuar ato që thotë.

Kritikën dhe autokritikën duhet t'i bëjmë armë shumë të rëndësishme për forcimin e unitetit dhe të dashurisë së popullit për Partinë, të asamblesë me kryesinë e kooperativës. Zbatimi në jetë i tyre zhvillon demokracinë. Prandaj, kur mblidhet asambleja e kooperativës, mos mendoni se kryetari ofendohet kur i kërkoni llogari. Në qoftë se nuk i kërkoni atij llogari, bëni gabim të madh; në qoftë se nuk e keni kritikuar për gabimet që ka bërë, keni bërë, gjithashtu, një gabim të madh për kolektivin; në qoftë se nuk e mbron kryetarin nga ai njeri që shpif, përsëri keni bërë gabim të madh; në qoftë se nuk e mbron kryetarin ose brigadierin kur këta kërkojnë të zbatohen direktivat e Partisë dhe vendimet që keni marrë në mbledhjet tuaja, do të thotë se ju nuk luftoni për interesin e përbashkët, pse, shoqe dhe shokë, ka

akoma njerëz që duan t'u shpëtojnë ligjeve e vendimeve, t'i shpëtojnë disiplinës sonë proletare.

Socializmi ka rregullat e tij, të cilat duhet t'i kuptojmë e t'i zbatojmë mirë të gjithë. Kush nuk i zbaton, ta kritikojmë ndershmërisht dhe ta bëjmë këtë për cilindo që të jetë, i madh ose i vogël në funksion. Të mësohemi ta pranojmë kritikën kur është e drejtë, kurse, kur është shpifje, të mos e pranojmë, përkundrazi, ta luftojmë edhe sikur për një çast shumica të jenë kundër. Lenini thoshte se sikur të tërë të jenë kundër një çështjeje për të cilin njeriu është i bindur se ka të drejtë, ai nuk duhet të tërhiqet. Në këtë rast njeriu edhe mund të largohet nga puna, të shkojë të punojë në një punë më të vështirë, atje ku e caktojnë, po kurrë të mos e pranojë shpifjen, të mos pranojë e të bjerë dakord me një çështje për të cilën është i bindur që nuk është e drejtë. Prandaj, kur je i bindur në ndershmërinë tënde, mos u tund. Sikur të ketë një ose dy njerëz, që, për një arsye ose tjetër, shpifin për ty, thonë se ke vjedhur, arrijnë për një moment t'u mbushin mendjen edhe të tjerëve, ti, që je i ndershëm dhe e ke ndërgjegjen të pastër, i thuaj kooperativës që nuk ke vjedhur dhe këtë ta thuash me bindje të plotë, me nder, me ndërgjegje të pastër, sepse e vërteta do të dalë dhe syrit të Partisë e të popullit nuk i shpëton gjë. Në të kundërt, po ta kesh bërë fajin, duhet ta pohosh haptazi përpara të gjithëve, si e bërë dhe pse e bërë, në mënyrë që edhe vetë të korrigolesh, edhe të tjerët të mësojnë nga gabimi yt.

Rëndësi, vëllezër e motra, ka çështja e edukimit të njerëzve. Njeriu është krijesa më e mrekulluesh-

me, ai bën çdo gjë, prandaj Partia tregon për të kujdesin më të madh. Njeriu ynë i socializmit duhet të ketë ndërgjegje të lartë, duar të pastra, zemër të zjarrtë. Pasuria e përbashkët është e gjithë popullit, vetjake është vetëm ajo që shoqëria i jep secilit, të tjerat janë të përbashkëta dhe është detyrë e çdo njeriu t'i ruajë si sytë e ballit, kështu jeta e tij do të jetë kurdoherë e pastër. Kjo ka rëndësi të madhe, prandaj, për kalitjen e këtij virtyti të njerëzve tanë, të luftohet nga të gjithë.

Në këtë takim të gëzueshëm të gjithë kemi dëshirë të rrimë akoma bashkë, por, meqenëse një pjesë i kanë shtëpitë larg, mendoj ta mbyllim bisedën me kaq.

Mirupafshim!

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në AQP

PARTIA DHE POPULLI KANË BESIM TË MADH E TË PALËKUNDUR TE NJËRI-TJETRI

Fjala në mitingun e popullit të Mirditës

29 maj 1968

Të dashur shokë dhe shoqe,

Motra dhe vëllezër mirditorë, ushtarë dhe oficerë,

Jam jashtëzakonisht i lumtur dhe i gëzuar që ndodhem këto ditë në këtë vend të bukur, në mes popullit të mrekullueshëm dhe heroik të Mirditës së shumëvuajtur gjatë së kaluarës, të Mirditës që sot ka dalë në dritë dhe që e pret një e ardhme e ndritur, e lumtur, e begatshme, ashtu si gjithë Shqipërinë tonë socialiste.

Ju falënderoj nga zemra, motra dhe vëllezër, që keni ardhur nga skajet më të largëta të Mirditës për të dëgjuar fjalën e Partisë, të shpëtimtares së atdheut dhe më lejoni, me këtë rast, t'ju sjell përshëndetjet më të zjarrta të Komitetit Qendror të Partisë dhe të Qeverisë.

Puna dhe vepra e Partisë sonë janë aq të mëdha,

sa është vështirë të përshkruhen brenda një kohe të shkurtër, apo të përmbliidhen me pak fjalë në një 'miting, sepse ato përfaqësojnë luftën dhe punën e madhe që ka bërë gjithë populli heroik shqiptar, përpjekjet e gjithsecilit prej jush, të bashkuar të gjithë si një trup e me një zemër rreth Partisë, për të ecur përpara në rrugën e ndritur të socializmit, rrugë që përfaqëson dëshirat dhe aspiratat e mbarë popullit punonjës të Shqipërisë. Të gjitha këto, pra, njeriu i ka të zorshme t'i shprehë me pak fjalë, prandaj unë do të përpiqem të them vetëm disa nga ato që kanë rëndësi të madhe për sot dhe për të ardhmen dhe që kanë luajtur dhe luajnë rol të madh në historinë e popullit tonë.

Populli i Mirditës, ashtu sikurse i gjithë populli shqiptar, në të kaluarën e në të tashmen, ka qenë dhe është kurdoherë në luftë dhe në revolucion. Të gjitha masat punonjëse të rrethit tuaj kanë luftuar kundër shtypjes dhe shfrytëzimit. Vetëm ndonjë mendjeshkurtër mund të thotë se populli i Mirditës nuk mori pjesë në Luftën Nacionalçlirimtare, si pjesa tjetër e popullit të Shqipërisë.

Karl Marksi, mësuesi ynë i madh, na mëson se, pavarësisht nga pjesëmarrja në revolucion, kur një popull shtypet, kur mbi kurrizin e tij veprojnë shtypës e gjakpirës, nuk është e mundur të mos luftojë kundër tyre. Mbi popullin e Mirditës, si kudo te ne, në Veri dhe në Jug, kanë ekzistuar në të kaluarën, bile në formë shumë të egër, shtypja dhe shfrytëzimi, prandaj ka pasur rezistencë kundër të gjithë atyre që i shtypnin dhe u pinin gjakun mirditorëve. Populli i Mirditës ka luftuar kundër bajraktarëve dhe kundër këlyshëve të

Gjon Marka Gjonit. Ai ka luftuar me ato mjete që kishte, me aq sa ia lejonin mundësitë dhe në asnjë mënyrë nuk u është nënshtruar ligjeve të feudalizmit.

Është fakt se kur shokët tanë të lavdishëm, me shokun e vjetër të Partisë dhe të luftës Bardhoq Bibën në ballë, ngritën krye kundër pushtuesve fashistë dhe bajraktarëve, kur edhe këtu u krijuan organizatat-bazë të Partisë, u pa se si populli i Mirditës filloi menjëherë të lëvizte dhe të kuptonte se në Shqipëri diçka po fillonte të ndryshonte. Me punën e palodhur të Partisë, pak nga pak, populli nisi të kuptojë (sepse çështjen e madhe të Partisë nuk e kuptuan të gjithë dhe kudo njëherësh), se kjo luftë e madhe revolucionare do të trondiste e do të shkulte nga rrënjët, ashtu siç ngjau, të gjithë ata armiq që e hiqnin veten si shkëmb të patundur përjetë. Por Partia ngriti popullin më këmbë, e sqaroi politikisht, e armatosi, e hodhi në betejë dhe kështu, me luftë të ashpër e të përgjakshme, shporri pushtesit e huaj, shkatërroi e përmbysi përgjithmonë nga pushteti gjakpirësit e popullit, feudalët, bajraktarët, bejlerët, agallarët, vendosi në Shqipëri pushtetin e popullit, diktaturën e klasës punëtore. Pas kësaj fitoreje, Partia iu përvesh punës për ndërtimin e socializmit dhe tani të gjithë shohim ç'ndryshime të mëdha janë bërë, si kudo në vendin tonë, edhe këtu në Mirditë.

Të gjithë ju e dini dhe unë dëshiroj t'ju them se e ardhmja e rrethit të Mirditës është e ndritur. Po kush e bën këtë të ardhme të ndritur? Cila është kjo siguri? Ku bazohet Partia kur flet kështu për rrethin tuaj? Në

radhë të parë, Partia bazohet te ju, te populli, pa të cilin nuk mund të ketë Shqipëri të lirë, nuk mund të ketë përparim, nuk mund të ketë socializëm. Është populli te ne ai që, i udhëhequr nga Partia, bëri revolucionin, çliroi Shqipërinë, po ndërton socializmin dhe krijon të gjitha të mirat, jo për shtypësit e për shfrytëzuesit e dikurshëm, po për veten e tij. Pra, kur themi se e ardhmja e Mirditës është e ndritur, bazohemi te populli i saj, që përbëhet nga gra dhe burra të mrekullueshëm dhe është popull krenar, shumë i zgjuar, trim e punëtor, që di t'i thithë shumë shpejt diturinë, të vërtetën, mësimet e Partisë. Këtë nuk jua them për t'ju bërë qejfin, por se këto cilësi ju i keni treguar me punën dhe me luftën tuaj dhe këtë do t'jua vërtetoj edhe me shembuj konkretë. Ndonjë mund të thotë se të tërë kështu i thithim, po nuk është kështu. Ka disa që mësimet e Partisë, të vërtetën, diturinë, i thithin shpejt, ka të tjerë që i thithin më ngadalë, disa i vënë në zbatim menjëherë dhe me vendosmëri të madhe, po ka edhe nga ata që hiqen zvarrë; ka njerëz që, për çështjen e madhe të Partisë, hidhen aty për aty dhe pa hezitim në zjarr, në luftë, por ka edhe nga ata që nuk e bëjnë si duhet këtë.

Në përgjithësi, mund të themi se te mirditorët gjejmë cilësitë më të mira të popullit tonë, të njeriut tonë të ri, të revolucionarit të kalitur nga Partia. Nga gjiri i tij, gjatë kohës së luftës, dolën burra trima, si Bardhok Biba dhe të tjerë, që luftuan me vendosmëri dhe u vranë për lirinë e popullit shqiptar.

Më vonë, nga kjo tokë e shumëvuaajtur, dolën heronj të rinj, që luftuan sypatrembur e me zgjuars

të madhe kundër bandave të diversantëve, të organizuara nga bajraktarët, nga fashistët italianë dhe nga Vatikani. Ne sot njohim të tillë heronj të heshtur nga Mirdita, si Pal Mëlyshi, veprimtarinë e të cilit, në kohën kur ai luftonte me armiqtë, vetëm unë edhe tre-katër veta e dinim, kurse gjithë të tjerët mendonin se ai ishte tradhtar. E merrni me mend ç'forcë të madhe shpirtërore kishte Pal Mëlyshi, që luftonte në këto kushte për çështjen e madhe të Partisë dhe të popullit. «Ruhu Pal», — e porosiste atë Partia. «Partia dëshiron të dalësh gjallë e i paprekur nga kjo ndërmarrje heroike, që populli shqiptar të shohë si luftojnë mirditorët për lirinë e atdheut!» Por Pali na u vra. Deri dhe nëna e motra e tij, gjer atëherë e dinin sikur ai ishte një tradhtar. Neve na qante zemra për këtë, po më në fund familja e tij dhe mbarë populli ynë e morën vesh se ai nuk ishte tradhtar, por hero.

Nga gjiri i këtij populli, të edukuar me mësimet e Partisë, dolën katër vajzat trimëresha të Mirditës, katër heroinat: Mrikë Lokja, Shkurte Cara, Marta Tarazhi dhe Prenda Tarazhi, që u ngritën në luftë kundër reaksionit, hodhën poshtë zakonet e vjetra, shkuan vullnetare për ndërtimin e hekurudhës, u kthyen përsëri pranë familjeve, kësaj radhe më të forta e më të kalitura, prandaj, si burrnesha, me mësimet e Partisë në zemër, filluan të punojnë për zbatimin e vijës së drejtë të saj. Pikërisht për këtë arsye reaksionarët i kapën, i torturuan dhe na i vranë. Por ato u bënë pishtarë dhe lëshuan dritë mbi gjithë Shqipërinë, duke u thënë brezave të rinj: «Ecni gjithnjë përpara, mos kini frikë, se Partia na udhëheq në rrugën

e drejtë! Të ndërtojmë Shqipërinë, të ardhmen tonë dhe armikun kurdoherë ta mposhtim!».

Në rrethin tuaj jetojnë e punojnë punëtorë nga më të lavdishmit e Shqipërisë, minatorë dhe metalurgë, që janë shembull trimërie, zgjuarsie, besnikërie dhe disipline në punë për të gjithë minatorët dhe metalurgët e vendit tonë. Si u bënë të tillë këta njerëz? Ata i bën të tillë vetë ambienti, i bën populli që i ka lindur dhe i ka rritur, i bëni ju, mëmat e baballarët e tyre, që i keni ushqyer e i ushqeni me frymën e patriotizmit të flaktë, i bëjnë mësimet e Partisë, që i kanë mbrujtur e i kanë kalitur në luftë dhe në punë, i bëjnë shembujt e heronjve të Luftës Nacionalçlirimtare.

Këtu në Mirditë kemi, gjithashtu, kooperativistë punëtorë të palodhur. Kolektivizimi, si kudo në Shqipëri, ka përfunduar tani në çdo fshat edhe këtu te ju. Thirrja e Partisë për kolektivizimin u dëgjua me vëmendje, u përçafua dhe u zbatua edhe nga ju dhe ky qe një sukses i madh. Ata që kanë bërë rezistencë e kundërshtime për krijimin e kooperativave kanë qenë pak dhe këta, ose kanë qenë armiq, ose kanë qenë elementë të gënjer nga mbeturinat e bajraktarëve, nga kishëtarët, nga priftërinjtë e bastarduar, këto vegla të ndyra të Vatikanit, që kurdoherë i kanë bërë gjëmën popullit. Fakt është se kolektivizimi, si në çdo rreth, edhe këtu, nuk u bë me forcë, por me bindje dhe me vullnetin e lirë të fshatarëve. Natyrisht, jo e gjithë fshatarësia e kuptoi menjëherë dhe që në fillim se kolektivizimi ishte rruga më e mirë për të, megjithatë, gradualisht e duke u bërë të ndërgegjegjshëm, këtë rrugë e pranuan të gjithë fshatarët, të cilët kishin be-

sim të madh te Partia, te mësimit e saj, sepse, gjithçka që kishte thënë e kishte bërë ajo, ishte për të mirën e përgjithshme, prandaj populli e ka dëgjuar kurdoherë me besim fjalën e Partisë.

Populli i Mirditës, si gjithë populli shqiptar, në të kaluarën kishte parë shumë mbretër, ministra, kapetanë e bajraktarë dhe e dinte fare mirë se të gjithë ata kishin sunduar pa mëshirë mbi të, kishin vjedhur e kishin grabitur pasurinë e popullit, e kishin vrarë, e kishin shtypur e shfrytëzuar gjer në palcë. Kurse, fill pas Çlirimit, populli pa diçka të re, pa se njerëzit e Partisë, udhëheqësit e saj, ishin bijtë e tij, ishin njerëz të thjeshtë e të ndershëm, të cilët jo vetëm nuk e shtypnin dhe nuk e grabitnin, por, përkundrazi, kur diktohej se ndonjë vidhte, bënte matrapazllëqe ose padrejtësi në kurriz të popullit, kur zbulohesh se dikush shkelte nderin e gruas e të vajzës, Partia dhe udhëheqja e saj i jepnin atij dënimin e merituar. Sa herë që njërit ose tjetrit i bëhej ndonjë padrejtësi nga dikush, Partia dhe anëtarët e saj e merrnin vesh medoemos, në mos menjëherë, më vonë dhe kurdoherë mbahej qëndrim kundër shkaktarëve që i bënin ato. Të gjitha këto populli i vinte re, prandaj i shtohej besimi te Partia dhe tek anëtarët e saj.

Më vonë populli pa se Partia bëri shumë gjëra të tjera për të mirën e tij dhe të atdheut. Partia që erdhi në fuqi, e përbërë nga djemtë dhe vajzat e popullit, mobilizoi njerëzit në punë për ndërtimin e fabrikave, të minierave, të uzinave, të hidrocentraleve, për ndërtimin e rrugëve e të hekurudhave, të kanaleve kulluese e ujitëse e të sa e sa veprave të tjera. Shekuj me

radhë në Mirditën tuaj fshatari as që dinte ç'ishte një fabrikë, por ja që te ju qysh në fillim u ngrit një e tillë, pastaj u bënë dy, u hap një minierë, më vonë u ndërtua një tjetër e, kështu me radhë, u zhvillua artizanati etj., etj. Të gjitha këto zgjeruan shumë frontin e punës për ju, duke ju rritur të ardhurat. Pra, te ju ndodhi ashtu si në të gjithë Shqipërinë, ku u ndërtuan me qindra fabrika, uzina e shumë vepra të tjera, në të cilat njerëzit tanë punojnë e prodhojnë për lumturinë e për begatinë e tyre.

Nga ana tjetër, bashkimi i tokave në kooperativa solli një përparim të madh në jetën e fshatit. Në krahësim me kohën para Çlirimit filluan të shtohen prodhimet bujqësore e blegtorale, buka, mishi, qumështi, gjalpi etj. Megjithatë, në këtë drejtim ne jemi akoma prapa asaj që synojmë, kemi akoma shumë për të bërë. Të gjitha sukseset e mëdha, të realizuara pas Çlirimit, i arriti populli i udhëhequr nga Partia. Vetë komunistët, në çdo vepër, në çdo ndërmarrje të madhe apo të vogël, punonin krah për krah me popullin, e udhëhiqnin atë sipas mësimëve të Partisë dhe fitonin besimin e tij.

Me këto rezultate, me kolektivizimin e bujqësisë, që është një sukses i madh në rrugën e ndritur të socializmit, me hapjen e minierave e me ndërtimin e veprave industriale në rrethin tuaj, në të cilat punojnë minatorë e metalurgë të zotë, populli i Mirditës do të ecë akoma edhe më përpara.

Sa për rininë mirditore, për nxënësit e për nxënëset e shkollave, për djemtë dhe për vajzat tuaja, që ndjekin kurse të ndryshme ose që venë në shkolla, siç

është ajo që përgatit oficerë e sa e sa të tjera, mund të thuhet fjalët më të lavdërueshme. Fëmijët tuaj shquhen në shumë drejtime, ata janë të zgjuar, kanë dëshirë të madhe të mësojnë sa më shumë, janë të etur për dituri, janë si një vullkan që lëshon zjarr. Sa e bukur dhe madhështore është kjo!

Partia, vëllezër dhe motra të moshuar, kërkon nga ju të mos i sillni pengesa brezit të ri, sepse djemtë dhe vajzat tuaja, si në gjithë Shqipërinë, duhet të punojnë, të ndjekin njëkohësisht edhe shkollat, pse jo vetëm Mirdita, por e gjithë Shqipëria ka nevojë që ata të mësojnë, të përgatiten edhe për të drejtuar vende pune nga më të rëndësishmet, kudo që të kenë nevojë Partia dhe pushteti ynë popullor. Nga bijtë dhe bijat tuaja, nga klasa juaj punëtore, nga radhët e minatorëve e të metalurgëve të shquar mirditorë, Partia pret të përgatiten elementë të aftë për t'u bërë sekretarë partie, anëtarë të Komitetit Qendror të Partisë dhe të Qeverisë, komandantë e komisarë të ushtrisë sonë të lavdishme e ku të ketë nevojë dhe s'ka dyshim se shumë prej tyre do të bëhen, pse i tillë është populli i Mirditës, i cili jeton në këtë vend të bukur e të mrekullueshëm dhe ecën me besnikëri e besim të patundur në rrugën ku e udhëheq Partia.

Në të ardhmen, si kurdoherë, i udhëhequr nga Partia jonë heroike, brenda disa pesëvjeçarëve, populli i Mirditës do t'ia ndryshojë krejtësisht faqen rrethit të vet. Përveç minierave ekzistuese, po bëhen kërkime të shumta për të zbuluar burime të reja bakri. Perspektiva është e tillë që jep mundësi të ngrihen miniera të tjera. Të dhënat kërkimore tregojnë se nën-

toka e Mirditës është e pasur në bakër dhe ky mineral përbën një nga pasuritë më të çmueshme, që i sjell të ardhura të mëdha vendit tonë. Hapja e minierave të reja në Mirditë do të bëjë të rritet më tej numri i fabrikave e i uzinave të reja dhe këto do të ndihmojnë të shtohet begatia juaj ekonomike, të rritet më tej niveli kulturor i mirditorëve, sepse do të rritet numri i punëtorëve.

Në Fabrikën e Rafinimit të Bakrit në Rubik punojnë djemtë dhe vajzat tuaja. Ndonjë plaku përpara s'ia merrte kurrë mendja që cuca e tij të vinte në lëvizje tërë ato makineri moderne të fabrikës. E, megjithatë, ne themi se tani kjo fabrikë është e vogël dhe s'mjafton për rafinimin e gjithë mineralit që nxjerrim, prandaj do të përpiqemi ta dyfishojmë dhe ta trefishojmë kapacitetin e saj. E njëjta gjë do të ndodhë edhe me Uzinën e Shkrirjes së Bakrit. Kur të kemi zbuluar gjithë sasinë e mineraleve që ka nëntoka e rrethit tuaj dhe të kemi ndërtuar miniera të reja, ajo nuk do të jetë e mjaftueshme. Kur të prodhojmë më shumë bakër, nuk do të na mjaftojë vetëm fabrika për prodhimin e telave prej bakri që kemi ngritur në Shkodër dhe, ndoshta, do të na duhet të ndërtojmë edhe një tjetër. Dhe kur të vijë koha për ngritjen e saj, besoj do të jetë e arsyeshme të ndërtohet këtu, në rrethin tuaj, ku është edhe lënda e parë. Shikoni, motra dhe vëllezër, ç'perspektivë të shkëlqyer ka zhvillimi industrial i Mirditës në të ardhmen! Dhe këtë të ardhme do ta realizoni ju, me Partinë në krye, së bashku me gjithë popullin shqiptar.

Ndërtimi me ritme të shpejta i socializmit në ve-

ndin tonë kërkon të përgatitim, më shumë nga sa kemi sot, gjeologë, elektrikistë, agronomë, mjekë, punonjës të shkencës e të tjerë. Është për këtë arsye që në të gjitha anët e Shqipërisë tani njerëzit mësojnë. Midis tyre ka shumë edhe nga rrethi juaj. Kështu, sa më shumë gjeologë të kemi, sa më shumë kërkime të bëjnë këta, aq më tepër minerale dhe nga më të ndryshmet, do të zbulojmë. Kjo ka rëndësi të madhe për ekonominë dhe do t'i sjellë përfitime gjithë Shqipërisë, pra, edhe Mirditës, që është pjesë e pandarë e saj, si rrjedhim, do të rritet mirëqenia e gjithë popullit, pra, edhe juaja. Nga ana tjetër, kjo ka rëndësi të madhe edhe nga ana politike dhe ideologjike, sepse do të rritet numri i minatorëve, gjë që do të ndihmojë të kaliten më shumë njerëz të vendosur. Kjo do ta bëjë Mirditën si një shkëmb graniti.

Dihet se s'ka njerëz më të fortë ideologjikasht dhe politikisht se minatorët. Njerëzit e galerive, që me orë të tëra rrinë brenda në zemrën e tokës, në thellësitë e saj dhe luftojnë pa u përkulur me vështirësi të mëdha, janë më të qëndrueshmit e më të patundurit. Minatorët janë nga njerëzit që e kuptojnë më shpejt, më drejt dhe e mbrojnë më mirë vijën e Partisë. Minatorët e metalurgët janë pjesa më revolucionare e punëtorëve, ata qëndrojnë në pararojë të klasës sonë punëtore.

Rritja e numrit të punëtorëve të minierave do të sjellë përparime të mëdha në rrethin tuaj, do të rritë kalitjen e njerëzve, mirëqenien e tyre, sepse fjala dhe fryma e tyre revolucionare përparimtare, dituria, të ardhurat ekonomike, që do të shkojnë në fshatrat, në

kooperativat dhe në familjet e tyre do t'i sjellin këto përparime.

Mirdita është kthyer tani në një krahinë ku zhvillohen edhe ekonomia bujqësore dhe ajo industriale. Partia po studion dhe vazhdimisht do të shikojë që gërshetimi ndërmjet tyre të bëhet sa më mirë, me qëllim që edhe industria të ecë përpara, por edhe bujqësia të mos mbetet prapa. Kështu do t'i sjellim popullit më shumë të mira dhe më shpejt.

Në Mirditë duhet të zhvillojmë edhe bujqësinë, sepse edhe kjo ka perspektiva të mëdha. Ju këtu keni një terren të përshtatshëm për të zhvilluar bujqësi intensive, pavarësisht se vendi është kodrinor e gjysmë-kodrinor.

Në këtë vend, në këtë ambient ku fusha plekset me pyllin, ju po ndërtoni jetën tuaj të re e të bukur. Në të kaluarën, bajraktarët dhe regjimet antipopullore, me shtypjen dhe shfrytëzimin e tyre u kanë diktuar mirditorëve mënyrën e jetesës së vetmuar, kanë ndikuar që te të parët tuaj të krijohej mendimi se është mirë të rrosh i mbyllur në vetvete. Kjo ka bërë që ju, për t'u mbrojtur nga regjimet e kohëve të kaluara, t'i ndërtoni kullat larg njëri-tjetrit. Këtë jua diktonte, veç të tjerave, edhe pylli, mbasi, duke mos pasur toka, në pyll ju gjenit mundësi për të hapur pak tokë e për të ngritur në mes të saj kullën.

Tani, në kushtet e pushtetit popullor, çdo gjë ka ndryshuar. Tokat, pyjet, ujërat, minierat etj., janë tuajat, janë pasuri e gjithë popullit. Partia këshillon që këto pasuri të mëdha t'i zhvillojmë, t'i shfrytëzojmë në të mirë të rritjes së mirëqenies së popullit, prandaj

komunistët, tok me popullin, duhet të gjykojnë se cilat miniera duhen hapur më parë, cilat lloj fabrikash duhen ndërtuar, cilat toka duhen hapur, cilat pyje duhen ruajtur, duhen mirëmbajtur e duhen shfrytëzuar më parë. Të gjitha këto probleme të mëdha jetike duhen biseduar e duhen gjykuar bashkë, ndërmjet Partisë dhe popullit. Kështu, pasi të jetë studiuar e gjykuar, se në Mirditë mund të hapen, për shembull, 5 ose 10 mijë hektarë toka të reja, duhen bërë llogaritë e duhet studiuar me kujdes se sa tokë mund të hapen me fuqinë tuaj punëtore, kurse për tjetrën, që s'ka mundësi të bëhet në këtë rrugë, Partia dhe Qeveria do të mendojnë t'ju dërgojnë traktorë, me të cilët do të spastroni pyjet nga drurët dhe nga shkurret. E gjithë kjo punë duhet të organizohet mirë e të ndahet me plan të detajuar në vite, kështu, të përcaktohen që më parë sa toka duhen hapur sivjet, sa mot, sa pas tre vjetësh e kështu me radhë, pas pesë ose pas dhjetë vjetësh.

Duke menduar e duke punuar kështu, me spastrimin e pyjeve nga shkurret, Mirdita do të bëhet, ashtu siç ëndërron populli, siç thotë Partia. Do të hapen me mijëra hektarë toka të reja, të cilat do të punohen me traktorë, do të ndërtohen hauzet për t'i ujitur, do të shtohet kështu prodhimi i drithërave, i pasurive të mëdha pyjore, i bagëtive, do të hapen më shumë shkolla e kurse, ku njerëzit do të mësojnë për të zhvilluar më tej, përveç industrisë, edhe bujqësinë, blegtorinë dhe pyjet.

Dëshiroj të them se pyjet nuk duhet t'i lëmë, siç janë sot, por t'ua ndërrojmë pamjen, të ngremë brenda

tyre sharra për të prodhuar lëndë ndërtimi, me kritere të caktuara të kullotim në to bagëti, të rritim kafshë për gjueti, bimë industriale e mjekësore, në mënyrë që të gjitha këto pasuri t'u sjellin Shqipërisë dhe juve të ardhura të tjera gjithnjë e më të mëdha. Këto tani mund të duken si ëndrra, por ato do t'i bëjë të gjitha populli shqiptar, pra, edhe populli i Mirditës, i udhëhequr nga Partia.

Në rrethin tuaj, nga një anë, po zhvillohen me ritme të shpejta industria dhe minierat, që kanë një të ardhme të shkëlqyer, sepse prej tyre, me forcën e punës dhe të mendjes të klasës punëtore, nxirren e do të nxirren sasi të mëdha bakri. Gjithashtu, po zhvillohet e po konsolidohet rendi kooperativist, megjithëse disa ekonomi janë akoma në fazën e parë të jetës së tyre. Pra, vihet detyrë për zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë socialiste, për të cilën duhet të vëmë të gjitha forcat. Të punojmë që bujqësinë ta çojmë përpara dhe me ritëm më të shpejtë, sepse edhe kjo ka për Mirditën perspektivë të madhe në të ardhmen, realizimin e së cilës duhet ta studiojmë dhe ta përgatitim me kujdes.

Realizimi i detyrave të planit pesëvjeçar në rrethin tuaj për zhvillimin e minierave, të industrisë dhe të bujqësisë, me sa jam në dijeni dhe siç më informuan shokët e Partisë, si dhe punëtorët e kooperativistët, me të cilët u poqa në ndërmarrjet e kooperativat që vizitova, është në rrugë të mirë. Plani i këtij viti në miniera dhe në industri jo vetëm do të realizohet, por do të tejkalohet. Plani i prodhimit bujqësor, gjithashtu, do të realizohet, bile shumë kooperativistë më infor-

muen se gruri paraqitet i mirë. Për grurin tani nuk synohet më në realizimin e planit, por në tejkalimin e tij. Prandaj përpiquuni ta arrini këtë objektiv dhe kam besim të plotë se do të dilni faqebardhë.

Shoqe dhe shokë,

Nga sa jam në dijeni dhe siç u informova, në kooperativat tuaja bujqësore gratë përbëjnë shumicën e forcave të punës dhe kjo për arsye se një pjesë e mirë e burrave punojnë në miniera. Ky realitet është shumë i bukur, shumë i mirë.

Gratë mirditore janë një forcë e madhe revolucionare për kooperativat, që ju të gjithë, sidomos burrat, duhet ta vlerësoni lart dhe ta nderoni, sepse gruaja është me të vërtetë një pjesë e madhe, e lavdishme e popullit shqiptar. Në të kaluarën ajo ka vuajtur shumë, më shumë nga burrat, sepse mbi të ushtrohej shfrytëzim i dyfishtë, edhe nga regjimet e klasat shtypëse, edhe nga vetë burrat, pra, ajo trajtohej jo e barabartë me ta, por si rob.

Që me lindjen e Partisë, situata për gruan ndryshoi. Menjëherë pas Çlirimit ajo u vu në vendin që meriton dhe puna e përpjekjet për përparimin e saj po ecin gjithnjë përpara. Kjo nuk ishte e lehtë të realizohej, sepse kishim të bënim me mendime e koncepte të rrënjosura brez pas brezi, që, për qindra e mijëra vjet me radhë, ishin bërë si ligje të pashkruara, të ngulitura thellë në kokën e njerëzve. Këta mendonin se gruaja qëndron më ulët, prandaj kundër saj mund

të bëhej çdo gjë, deri edhe të shitej si kafshë, të rrihej apo, më keq, të vritej. Partia nuk mund të pajtohej me një gjendje të tillë, të trashëguar nga e kaluara, në qëndrimin ndaj gruas, prandaj ajo ka luftuar dhe lufton vazhdimisht për zhdukjen e zakoneve të këqija, që poshtërojnë gruan shqiptare. Mbeturinat që ekzistonin në trajtimin e gruas duheshin spastruar me fshesë të madhe, porosiste Partia, sepse ato pengojnë edhe përparimin e Shqipërisë, edhe mirëqenien ekonomike të vendit, edhe dashurinë dhe unitetin e familjes. Për këtë qëllim, Partia iu drejtua popullit edhe një herë kohët e fundit dhe i bëri thirrje për mbrojtjen e të drejtave të gruas¹, për të dërrmuar ligjet e zakonet e vjetra të Kanunit, që rëndonin mbi të. Gruan ta keni shoqe të jetës në familje dhe në punë, shokë mirditorë, me të të qani hallin, të punoni bashkë, të rroni si duhet, të ndihmoni e të respektoni shoqi-shoqin.

Edhe vajzën ta doni me gjithë shpirt dhe ta ndihmoni kur ka ndonjë hall, ta dëgjoni me vëmendje, të mësoni e të kuptoni drejt çfarë do e ç'mendon ajo. Kur vajza shfaq një dëshirë të mirë e të drejtë, babai, nëna ose vëllai nuk ka pse ta pengojnë dhe nuk duhet t'i imponojnë asaj dëshirat e tyre, aq më tepër,

1 Në fjalimin e vet të 6 shkurtit 1967 «Revolucionarizimi i mëtejshëm i Partisë dhe i pushtetit», shoku Enver Hoxha, ndër të tjera, tha: «Gjithë Partia dhe vendi duhet të ngrihen më këmbë, të djegin me zjarr zakonet prapanike e t'i këputin kokën cilitdo që merr nëpër këmbë ligjin e shenjtë të Partisë për mbrojtjen e të drejtave të grave dhe të vajzave». (Shih: Vëpra, vëll. 35, f. 4.)

ta detyrojnë të bëjë si thonë ata. Po të ngjasë një gjë e tillë nuk është e drejtë dhe Partia nuk e lejon këtë, ndryshe, qoftë vajzës, qoftë gruas, i heqim lirinë. I vjen mirë ndonjë burri kur sheh se dikush po i ha të drejtën? Sigurisht jo, prandaj e ndjek çështjen, nuk pranon që tjetri, kur nuk ka të drejtë, të ndërhyjë për këtë ose për atë punë që i takon këtij dhe që do ta zgjidhë si mendon vetë.

Ne nuk kemi të drejtë, vëllezër dhe motra, të ndërhyjmë në dëshirat e të rinjve e të rejave, kur ato janë të pastra, të drejta, sipas mësimeve të Partisë, bile ne duhet t'i inkurajojmë ata të ecin në këtë rrugë. Kjo nuk do të thotë që, kur i riu ose e reja bën ndonjë gabim, ose kur ndonjëri nuk është në rrugë të drejtë, babai dhe nëna të mos e kritikojnë. Jo, në qoftë se prindërit nuk e kritikojnë në një rast të tillë, bëjnë gabim, ashtu sikurse bëjnë gabim kur nuk ua plotësojnë dëshirat e mira dhe të ligjshme.

Te gruaja e fshatit ju keni një forcë të madhe përparimtare. Unë i kam parë vetë gratë e vajzat mirditore në konferenca, në kongrese e në kurse dhe ju them sinqerisht se ato dallohen për zgjuarsinë, për zotësinë e për vendosmërinë e tyre. Këto cilësi ato nuk i tregojnë vetëm në kongrese, në konferenca e në aksione, por edhe në shtëpinë e tyre, në punët e përditshme. Prandaj, shokë, i ndihmoni nënat, gratë, vajzat e motrat tuaja në kooperativa, i ndihmoni të mësojnë dhe të edukohen çdo ditë e më mirë, i mbronin ato nga lla-fazanët, nga njerëzit me mendime të vjetra, të cilëve nuk u pëlqen që gruaja të bëhet brigadiere, të bëhet skuadërkomandante, të bëhet sekretare partie etj. Lu-

ftoni pa mëshirë kundër atyre që bëjnë një mijë e një shpifje, duke përshpëritur sa andej-këtej se filania shkoi me atë ose me këtë. Njerëz të tillë jo vetëm nuk ia duan të mirën gruas që marrin nëpër gojë, por nuk u duan të mirën as Partisë, as Shqipërisë, as socializmit.

Në goftë se shoqen Martë [Lleshi] e kanë zgjedhur sekretare të organizatës-bazë të Partisë në Orosh, komunistët nuk e kanë bërë këtë për sytë e saj të bukur, por sepse ajo është një komuniste e zgjuar, e vendosur, e papërtuar, që e gjen kudo, që nuk e zë gjumi për çështjen e Partisë dhe të popullit, prandaj shkon te kooperativistët, qan hallet me ta, me burrat e me gratë, bisedon me njërin dhe me tjetrin për zgjidhjen e problemeve etj. Gjersa është sekretare e organizatës-bazë të Partisë, si e tillë ajo do të takohet medoemos me njerëzit, burra ose gra qofshin, do të bisedojë me ta. Kur njëri i drejtohet asaj për një problem, ajo ulet e bisedon me të shtruar. Mirëpo ndonjë i lig përgjon nga vrima se kush u takua me Martën. Mund të ndodhë që asaj t'i venë për të biseduar edhe 20 veta në ditë, sepse drejtohen tek ajo si te njeriu i Partisë, se ajo është komuniste, është bijë e ndershme e popullit, kurse është i poshtër ai që përgjon nga vrima dhe shpif. Një i tillë është njeriu i priftit, dallaveraxhi dhe intrigant. I luftoni, shoqe dhe shokë, këta njerëz të këqij, që kërkojnë, me një mijë mënyra, të njollosin njerëzit tanë më të mirë dhe vijën e drejtë të Partisë, që kërkojnë të prishin të ardhmen e bukur që po ndërton populli shqiptar.

Vëllezër dhe motra, shokë punëtorë, minatorë dhe

metalurgë që punoni në miniera e në fabrika, mos i nënvleftësoni gratë, motrat dhe vajzat tuaja, që punojnë nëpër kooperativa, sepse ato janë një forcë e madhe për kooperativën dhe për atdheun. Ato janë trimëresha, prandaj bëhuni ndihmësit kryesorë të tyre, çoni në fshat e në familjet tuaja fjalën e Partisë, frymën e klasës punëtore, në mënyrë që kooperativat tuaja në Mirditë të ecin përpara me ritëm më të shpejtë, të ngrihen në to niveli politik, ideologjik, kulturor dhe mirëqenia ekonomike e kooperativistëve.

Zhvillimi i ekonomisë në vendin tonë ka bërë përparime të mëdha, por kjo nuk duhet të na kënaqë. Megjithëse kemi bërë përparime në të gjithë sektorët. në atë të bujqësisë, në Mirditë, jemi akoma më prapa. Ju, shokë dhe shoqe, mos mendoni vetëm për bukën, të cilën medoemos duhet ta shtoni dhe ta siguronit plotësisht, por në kooperativat bujqësore duhet të rritni edhe lopën, të cilën pothuajse nuk e njihni fare. Ju tani preferoni më mirë dhinë dhe delen, sepse për to keni troje të përshtatshme, por, krahas tyre, punoni që të përgatitni mundësi edhe për lopën, sepse një lopë jep qumësht sa për 30 dhi ose sa për 40 dele bashkë. Dikush mund të thotë, vallë mund të mbahen lopë të tilla në Mirditë? Po, mund të mbahen. Shkoni shikoni stallën e lopëve të Minierës së Kurbneshit dhe do të mësoni se atje, në mes të maleve, merren nga secila lopë 2 000 litra qumësht në vit, bile, po përpiqen për të marrë më shumë. Kur i rritin atje thellë, në një zonë të ftohtë, përse të mos rriten lopë në të gjitha kooperativat e rrethit tuaj? Mundësitë ekzistojnë kudo, edhe te ju, prandaj filloni të mendoni qysh tani për zhvi-

llimin e lopës, ashtu siç mendoni edhe për kaun. Ju keni punuar mirë për të siguruar qetë e punës dhe për këtë jeni për t'u lavdëruar. Edhe në të ardhmen vazhdoni në këtë rrugë, se terreni i Mirditës është malor, prandaj dhe qetë janë të nevojshëm për bujqësinë. Bile, edhe kur të keni më shumë traktorë, prapë duhet të vazhdoni t'i rritni qetë, sepse do t'ju duhen. Dhe krahas qeve duhet të filloni sa më parë punën për rritjen dhe për përmirësimin e lopës.

Kooperativat dhe ndërmarrjet bujqësore të Jugut, në frymën e solidaritetit vëllazëror, ju dhuruan një numër lopësh, por ato janë akoma shumë pak, në krahasim me mundësitë dhe me nevojat e mëdha që keni këtu. Prandaj merreni seriozisht këtë problem. Kërkoni për këtë qëllim nga Qeveria t'ju dërgohen damazë të racës dhe ne andej nga qendra duhet të bëjmë çmos t'juja plotësojmë këtë në mënyrë që, dalngadalë, në bazë të një planifikimi dhe brenda një kohe të caktuar, të krijohen tufa lopësh në numër të mjaftueshëm në të gjitha kooperativat e rrethit tuaj. Kështu, pra, punoni të shtoni edhe numrin e lopëve dhe, tok me shtimin e sipërfaqeve të tokave të reja, do të dalë vetvetiu nevoja që delet e dhitë të pakësohen, sepse pyjet e shkurret, ku ato kullotin tani, do të pakësohen pas hapjes së këtyre tokave.

Çështja tjetër që dëshiroj t'ju them, shoqe dhe shokë, lidhet me përmirësimin e mënyrës së ushqimit. Ushqimi i rregullt i njeriut nuk përbëhet vetëm nga buka dhe nga mishi. Natyrisht, mishi duhet të përdoret në ushqim e jo vetëm një herë në muaj ose në dy javë, por më shpesh, dhe të gjithë ne duhet të për-

dorim çdo ditë, në radhë të parë, zarzavatet, të cilat janë shumë të nevojshme për trupin e njeriut. Tani që populli ha më shumë zarzavate, njerëzit jo vetëm nuk vdesin në moshë të re si përpara, por jeta e tyre, përkundrazi, është rritur mesatarisht mbi 65 vjet. Në të kaluarën njerëzit në Shqipëri jetonin mesatarisht 35-40 vjet. Atëherë edhe fshatari tridhjetëvjeçar të dukej sikur ishte plak dhe kjo, sepse jetonte në kushte të vështira dhe ushqehet keq, bile nuk kishte ç'të hante.

Ushqimi ka rëndësi të madhe për organizmin e njeriut. Kur njeriu punon, energjitë e tij konsumohen, prandaj duhen zëvendësuar. Në qoftë se këto energji nuk zëvendësohen me ushqim, atëherë ai vdes shpejt. Por, për të zëvendësuar energjitë e harxhuara, trupi i njeriut ka nevojë për ushqime të shumëllojshme jo vetëm për bukë e për mish, po edhe për zarzavate të ndryshme, si: për domate, patëllxhanë, bamje, kastraveca, angjinare etj., etj., shumë nga të cilat ju nuk i mbillni fare, bile disa prej tyre nuk i njihni, nuk ua dini as emrat. Këto ushqime janë të domosdoshme për jetën e njeriut. Prandaj po ju drejtohem juve, vëllezër dhe motra të Mirditës, që fjalën e Partisë nuk e bëni dy, të interesoheni seriozisht edhe për këto probleme, të gjeni e të mbillni farë zarzavatesh të të gjitha llojeve. Kjo nuk është punë e vështirë. Në fillim mbillni 2-3 dynym, i rritni dhe i provoni si rriten. Pastaj dërgoni cucat në kurse që të mësojnë si duhen gatuar zarzavatet dhe, më pas, pa dyshim, do të provoni sa të mira janë, sa të shijshme do të bëhen dreka dhe darka juaj. Kur të ktheheni të lodhur nga puna dhe të hani një gjellë të tillë, do të provoni jo vetëm shijen

e saj të mirë, por, duke marrë këto ushqime të nevojshme, do të fitoni edhe forca të reja e të nesërmen do të shkoni në punë me energji të shtuara.

Partia jua rekomandon këto për të forcuar shëndetin tuaj, për të përmirësuar e për të zbukuruar jetesën. Këto ushqime ne duhet medoemos t'i prodhojmë dhe t'i përdorim, se kanë rëndësi të madhe për jetesën e popullit, prandaj jam i sigurt se organizata e Partisë e rrethit tuaj do të kujdeset që këto detyra të zbatohen nga ju. Kështu, kur të kaloj ndonjëherë tjetër nga Proseku ose në ndonjë kooperativë tjetër, besoj se do të shoh tokë të mbjellë me zarzavate dhe mund të takoj në rrugë njerëz, që marrin nga furra tava të gatuar shijshëm me zarzavate: me domate, me bamje, me patëllxhanë etj. Sigurisht, të gjitha këto detyra nuk kryhen në një ditë, por duhen parashikuar dhe duhen planifikuar, pse realizimi i tyre i plotë kërkon punë të vazhdueshme dhe organizim të fortë.

Edhe një porosi tjetër kisha për ju dhe kam besim se do ta plotësoni. Duke iu përgjigjur thirrjes së Partisë, nga Mirdita dhe nga malësitë e tjera të Veriut, grupe malësorësh shkuan në fshatrat e Jugut të Shqipërisë. Ata ndenjën atje deri një muaj e gjysmë së bashku me motrat e vëllezërit e tyre kooperativistë të Jugut. Bashkë me ta punuan, kuvenduan, kënduan, festuan e gëzuan si një familje dhe, më në fund, që të dy palët u ndanë nga njëra-tjetra me ndjenja të mëdha gëzimi e miqësie, që nuk i kishin njohur kurrë më parë. Tani u vjen radha kooperativistëve të Jugut të vij në këtu. Jam i bindur se te ju ata do të gjejnë po atë ngrohtësi, bile edhe më të madhe, që gjetët ju tek ata.

Me këtë rast dëshiroj t'ju jap një këshillë që të mos bini edhe ju në atë gabim që ranë ata të Jugut, të cilët, kur pritën miqtë nga Veriu, bënë shpenzime të tepërta dhe miqtë, me të drejtë, i kritikuan për këtë. Prandaj, kur të vijnë te ju miq nga kooperativat e Vlorës, të Korçës, të Gjirokastrës etj., të përgatitni nga ato ushqime që hani edhe vetë. Miqtë do të mjaftohen me dashurinë dhe me ngrohtësinë tuaj të pastër dhe të jeni të sigurt se do të mbeten jashtëzakonisht të kënaqur nga miqësia dhe nga gjithçka që do të mësojnë prej jush.

Partia kishte një qëllim të madh politik kur i organizoi këto vizita. Shokëve të Partisë, qoftë atyre të Veriut, ashtu edhe të Jugut, u sugjerova që në këto ekipe të marrin pjesë edhe kooperativistë të moshuar, mundësisht nga ata që s'kanë dalë kurrë nga fshati, me qëllim që të shkëputen një herë nga jeta e ngushtë e fshatit dhe e kullës së tyre e të shohin ç'është Shqipëria, ç'bën populli shqiptar, ç'bën Partia, ç'ka ndërtuar ajo, të shohin fabrikat e uzinat e shumta që janë ngritur, fushat e bukura të atdheut, rrugët që po zgjaten anembanë, hekurudhat, hidrocentralet e çdo gjë tjetër dhe t'u bëhet zemra mal. Është e natyrshme se, sado që t'i përshkruash me fjalë gjithë këto vepra, të shkruash për to nëpër gazeta, nuk ke mundësi t'i përfytyrosh qartë, ashtu siç janë në realitet, sepse është ndryshe kur i shikon me sy.

Sigurisht, koha prej një muaj e gjysmë, që malësorët e Veriut ndenjën pranë vëllezërve të tyre në Jug ishte e shkurtër, por e vlefshme dhe u shërbeu atyre të shohin e të mësojnë shumë gjëra që s'i dinin. Partia e bëri këtë, shokë, që t'i ndihmojë kooperati-

vistët, në radhë të parë, të mendojnë politikisht, pastaj edhe për të dalë nga rrethi i ngushtë i familjes dhe i fshatit, nga jeta e vetmuar, për të parë më mirë atdheun e tyre e për të mësuar më shumë, për të forcuar dashurinë dhe unitetin me njëri-tjetrin, pse kështu s'ka armik që të na thyejë.

Tani dua të flas pak edhe për kullat, për shtëpitë tuaja. Dje vizitova kooperativën e Perlatit dhe vura re se shtëpitë janë ndërtuar shumë larg njëra-tjetrës. Kështu, besoj unë, larg i keni edhe në fshatrat e tjera. Një gjendje e tillë në të kaluarën ka qenë e shpjegueshme, sepse të tilla ishin kushtet. Fshatari hapte një copë tokë atje ku gjente dhe kur e lejonte bajraktari e, megjithëse me vështirësi të mëdha, ndërtonte kullën e vet. Por tashti kushtet kanë ndryshuar, kanë ndryshuar, në radhë të parë, vetë njerëzit, por edhe tokat nuk janë si përpara, ato u bashkuan në kooperativë dhe sipërfaqja e tyre vjen gjithnjë duke u shtuar. Tani na del problemi, ç'do të bëjmë me këto kulla? Do t'i lëmë të shpërndara si përpara? Po, a mund të grumbullohet i tërë Perlati në një vend? Të thuash një gjë të tillë pa e studiuar mirë më parë, nuk do të ishte e drejtë. Prandaj vetë populli, nën kujdesin e Partisë, ta studiojë këtë problem dhe pastaj të vendosë që shtëpitë të grumbullohen qoftë edhe në tre ose në katër vende, duke llogaritur që edhe tokat të jenë afër me grupet e shtëpive që do të ndërtohen. Kështu mund të bëjnë edhe fshatrat e tjera.

Përse është më mirë që të grumbullohen së toku shtëpitë e fshatrave? E para që njerëzit të jenë bashkë, sepse socializmi kërkon që të rrojmë në shoqëri,

të rrojmë si vëllezër, jo larg e të veçuar si më parë, po sa më afër e në miqësi të ngushtë me njëri-tjetrin. Këtë e kërkon interesi i përgjithshëm, që socializmi e ka vënë mbi interesin personal, e kërkon interesi i Shqipërisë, i mbrojtjes së atdheut që fshatarët të rrojnë sa më të bashkuar, si për kohë të mira, ashtu edhe për kohë të vështira. Grumbullimi forcon miqësinë dhe shoqërinë. Kështu, njeriu, pas punës, në kohën e pushimit, sidomos në stinën e dimrit, dëshiron të vejë në shtëpinë e një shoku të tij kooperativist, te një mik apo te fisi i tij dhe të bisedojë për diçka. Mirëpo si të vejë ai në dimër, kur shoku a miku e ka shtëpinë një orë larg? Ndryshe do të jetë kur shtëpitë të jenë afër, atëherë ka mundësi që njerëzit të venë më lehtë te njëri-tjetri për të shkëmbyer një mendim, për të kënduar bashkë gazetën, për të dëgjuar radion etj., etj.

Veç këtyre, ju e dini tashmë vendimin që ka marrë Partia për elektrifikimin e të gjitha fshatrave të Shqipërisë. Lidhur me këtë çështje dua t'ju them se një rol të madh revolucionar po luani ju, mirditorët, sepse, që të shkojë drita elektrike nga një vend në tjetrin, duhen tela. Mirëpo pa bakrin, që e nxirrni dhe e përpunoni ju, s'ka tela, prandaj elektriku s'mund të çohet në asnjë vend. E shihni, pra, se edhe në këtë çështje ju jepni kontribut të madh dhe jeni si pishtarë? Pra, pishtarë me Bardhok Bibën gjatë Luftës Nacional-çlirimtare, pishtarë për arsimin, në vitet e para pas Çlirimit me Ndrec Ndue Gjokën, pishtarë, më vonë, me katër heroinat që punuan për ndërtimin e hekurudhave, pishtarë po bëheni edhe sot për elektrifikimin. Mirëpo të çosh dritën elektrike në fshatrat tuaja, ku kullat ja-

në me kilometra larg njëra-tjetrës, kjo kushton shumë, kurse, po të jenë shtëpitë të grumbulluara, shpenzimet janë më të pakta dhe puna bëhet më shpejt.

Por nuk është vetëm çështja e elektrikut që na imponon t'i ndërtojmë fshatrat të përqendruara. Partia ka vendosur që së shpejti në vendin tonë të ndërtohet qendra e televizionit¹. Nuk do të jetë larg dita kur në vatrën e kulturës të çdo fshati të ketë së paku nga një aparat televizori². Atëherë, në mbrëmje, pas punës, kooperativistët, sipas dëshirës e sidomos rinia, mund të venë të ndjekin punimet e një konference që bëhet, të shohin një film ose një ndeshje futbollit që zhvillohet në Tiranë, për shembull, midis skuadrave «Dinamo» dhe «Partizani» etj. Edhe në një rast si ky, kur ne jemi mbledhur në këtë miting, nëpërmjet televizionit mund të na shohin e të na dëgjojnë edhe kooperativistët e Konispolit. Kështu, ju do të shikoni edhe djemtë e cucat tuaja vullnetare në hekurudhë, pa qenë nevoja që babai dhe nëna të ngrihen e të venë gjer atje për t'i parë. Pra, kur të ngremë qendrën e televizionit, ju mund t'i shikoni aksionistët që nga vatra juaj e kulturës, t'i dëgjoni kur të flasin e të tregojnë për punën, për jetën atje, për shëndetin etj. Por që t'i ndiqni këto duhet medoemos që shtëpitë e fshatit të jenë të grumbulluara, sepse është e vështirë të ketë çdo kullë televizor, ose që fshatari të shkojë dy orë larg për të pa-

1 Qendra e televizionit shqiptar fillol transmetimet në nëntor 1971.

2 Në vitin 1982, në rrethin e Mirditës kishte televizorë në 20 shtëpi e vatra kulture dhe 520 televizorë të tjerë në familje të kooperativistëve.

rë një shfaqje televizive në vatrën e kulturës. Në kushte të tilla si tani, ai mund të vejë shumë-shumë një herë në javë, po jo çdo mbrëmje.

Grumbullimi i shtëpive, pra, është një punë me interes të madh shoqëror, politik, ideologjik, ekonomik dhe që ndikon në përmirësimin e jetesës. Prandaj sa të jetë e mundur, në një kohë të përshtatshme, sidomos kur ndonjëri ndërton shtëpi të re, e këshilloni që ta ngrejë në qendër të fshatit. Lidhur me këtë është mirë të mendoni për hartimin e një plani të caktuar. Jo vetëm këto, po edhe ato shtëpi që sot janë larg, me plan dhe brenda një kohe të caktuar, gjithashtu, të ndërtohen gradualisht në qendër të fshatit. Këtë punë ju duhet ta bëni bashkërisht. Gjithë kooperativistët në këto raste të ndihmojnë njëri-tjetrin, të marrin gurët e trarët në krahë dhe brenda 15 ditëve të ndërtohet shtëpia e fshatarit jo në vendin ku ishte, po në qendrën e caktuar. Mund të bëhet një gjë e tillë? Në kushtet e socializmit, kur njerëzit rrojnë e punojnë të bashkuar si vëllezër, me siguri mund të bëhet.

Përshtypjet e mia, nga kontaktet që mora me ju, me minatorët, me metalurgët e me kooperativistët e Mirditës do të jenë të pashlyeshme, ato nuk kam për t'i harruar kurrë dhe do t'ua transmetoj edhe shokëve të Komitetit Qendror të Partisë dhe të Qeverisë. Unë kam besim të madh se populli i mrekullueshëm i Mirditës do të vërë të gjitha forcat që organizatën e Partisë këtu në rreth ta kalitë, ta bëjë me të vërtetë pararojë, do të punojë që në Parti të futen njerëzit më të mirë, më të ndershëm, më të vendosur të klasës punëtore, të kooperativistëve dhe të inteligjencies së po-

pullit trim të rrethit tuaj. Por që organizata e Partisë e rrethit të jetë e fortë, vetë anëtarët e Partisë duhet t'i kuptojnë drejt dhe t'i zbatojnë me rreptësi normat e Partisë dhe të mos kursehen për popullin, të jenë të lidhur me të, të jenë të sinqertë, të mos i fshehin gjë, të kërkojnë kurdoherë mendimin e tij për çdo problem, t'i dëgjojnë me vëmendje fjalën dhe propozimet e tij.

Çdo komunist duhet të punojë gjithë jetën pa u kursyer për popullin. Partia na mëson që komunistit kurrë të mos i rritet mendja. Në qoftë se ndonjë bëhet fodull, bëhet kryelartë apo gënjen, atëherë dijeni se ai s'mund të jetë komunist, prandaj duhet hequr nga Partia, se nuk e meriton. Komunisti duhet të jetë i thjeshtë, i ndershëm, i vendosur e punëtor, i lidhur ngushtë me popullin. Komunisti duhet të mendojë kurdoherë përgjegjësinë e madhe që ka, të kuptojë qartë se me ndjenjat e popullit nuk mund të luhet, të mendojë, siç thotë fjala e urtë e popullit, shumë herë, pa të presë një herë. Vetëm duke punuar kurdoherë drejt, Partia fiton besimin e madh të popullit dhe arrin të krijojë dhe ka krijuar një unitet të çeliktë me të, saqë sot s'ka forcë ta dëmtojë.

Nuk përjashtohet, në ndonjë rast të rrallë, që ndonjë komunist bën veprime të këqija, bën hilera. Njerëzve të tillë Partia jonë ua tregon shpejt vendin. Në mos sot, nesër, është e pamundur që këta të mos zbulohen, sepse forca e Partisë dhe e popullit është e madhe.

Populli i Mirditës ka një organizatë partie të mirë, këtu ka komunistë luftëtarë, por edhe ju punëtorë e

kooperativistë i ndihmoni ata që të bëhen akoma më të mirë. E keni ju në dorë t'i kalitni komunistët. Kjo bëhet kur i ndihmoni ata, kur u vini në dukje çdo të metë. Kur e shikoni që një komunist punon mirë, mos ia rritni mendjen, por ndihmoheni që të punojë edhe më mirë. Po në rast se një komunist bën gabime, mos ia fshihni, mos ia mbuloni, përkundrazi, ia thoni hap-tazi dhe mos kini frikë nga kurrkush. Njeriu që ka të drejtë, kurrë të mos ketë frikë të kritikojë cilindo, pa druajtje. Partia jonë është Partia e drejtësisë. Kushdo që ka të drejtë të mos kujtojë se është i vetmuar dhe të mos ngurrojë ndaj një personi me pozitë. Ai duhet të dijë se me të janë e gjithë Partia, i gjithë populli. Kurse kur një njeri nuk ka të drejtë, kur punon me hile, kur ka qëllime të këqija dhe bën dallavere, të jetë i sigurt se shpejt ose vonë do të zbulohet, pastaj le të bërtasë se «i hëngrën hakën». Kur një komunist është fodull dhe nuk është i thjeshtë, do të thotë se tek ai ka diçka që nuk ecën, ka një të metë, të cilën, të tjerët, duhet t'ia thonë që të përpiqet ta ndreqë.

Unë kam bindjen e plotë se organizata e Partisë e rrethit tuaj në të ardhmen do të kalitet e do të bëhet më e fortë. Në zgjedhjet e ardhshme të Partisë ne presim me gëzim të shohim që në komitetin e Partisë të rrethit dhe në byronë e tij të zgjidhen akoma më shumë nga bijtë tuaj, sidomos minatorë e metalurgë.

Tani dua t'ju flas pak për gjendjen në vendin tonë në përgjithësi. Pozitat e brendshme politike dhe ekonomike të Shqipërisë janë jashtëzakonisht të shëndosha. I tërë populli është më këmbë, në një ngritje revolucionare të paparë, i qartë politikisht dhe i lidhur

në çdo gjë me Partinë. Populli ynë ka përqaftuar të gjitha direktivat politike, ideologjike dhe ekonomike të Partisë dhe po i vë në jetë me hov të madh revolucionar në çdo sektor, në industri, në bujqësi, në arsim etj.

Në sektorin e industrisë, të minierave e të ndërtimeve planet e shtetit po tejkalohen me sukses. Revolucioni tekniko-shkencor çdo ditë e më mirë bëhet pronë e masave të gjera punonjëse dhe po jep rezultate të mëdha. Kështu, po shtohen reparte e linja të reja në fabrikat ekzistuese, bëhen propozime për krijimin e fabrikave e të makinave të ndryshme të reja, të ndërtuara me forcat tona, si dhe në shumë drejtime të tjera, të cilat kanë një rëndësi të madhe për vendin tonë.

Edhe në bujqësi punët na shkojnë mirë. Detyrat e planit të katërt pesëvjeçar për hapjen e tokave të reja po realizohen, bile shumë rrethe i kanë realizuar qysh tani. Gruri këtë vit, me gjithë vështirësitë e mëdha që janë krijuar nga ngricat e dimrit dhe nga thatësira e kohëve të fundit, paraqitet i mirë. Shiu që ra këto ditë në gjithë Shqipërinë, sido që me një çikë vonesë dhe, këtu te ju, akoma në sasi të pamjaftueshme, bëri mjaft mirë. Për grurin plani i shtetit është i siguar, bile shumë rrethe na njoftojnë se do të realizojnë planin e brendshëm, sipas të cilit mendohet të marrin nga 1/3 e sipërfaqes së mbjellë me grurë e 1/4 e sipërfaqes së mbjellë me misër respektivisht nga 30 kv grurë e 40 kv misër për hektar. Ky do të jetë një sukses, një inkurajim i madh për fshatarësinë tonë kooperativiste, një bazë e mirë edhe për rritjen e

prodhimit në vitet e ardhshme. Ky sukses i detyrohet punës së palodhur të kooperativistëve tanë, të agromëve, të brigadierëve e të teknikëve që ditën të kuptojnë drejt dhe t'i vënë në jetë direktivat e Partisë, që përpigën të zbatojnë kodin agroteknik.

Në qoftë se ne do të arrijmë t'i marrim këto prodhime, si në grurë, ashtu edhe në misër, bujqësisë sonë, për vitet e tjera të këtij pesëvjeçari dhe për pesëvjeçarin e ardhshëm, i hapen perspektiva të mëdha. Rritja e prodhimeve në bujqësi na detyron që qysh sivjet të marrim një sërë masash për mekanizim më të gjerë të punimeve bujqësore¹, sepse, me shtimin e prodhimit të grurit, duhen disa makina të posaçme për korrje më të shpejtë, të cilat ne do t'i importojmë. Atëherë, edhe këtu, në kodrat e Mirditës, do të sjellim makina për të korrur më shpejt. Korrja me makina dhe në kohë mënjanon firon e drithit, kurse duke korrur me drapër, gruri thërmohet, pasi nuk arrijmë ta korrim shpejt. Pastaj, edhe kur korret, po të lihet në arë pa u transportuar, gjithashtu, ka humbje ngaqë thahet tepër, bie përtokë, e hanë zogjtë etj. Prandaj na vihet detyrë ta korrim, ta shijmë e ta futim prodhimin brenda sa më shpejt. Me krahë nuk mund t'ua dalim dot gjithë fushave të gjera të Shqipërisë. Duke e korrur grurin me makina në fushat ku është mbjellë dhe kur ato ujiten, do të krijohet mundësia që, menjëherë pas korrjes, këto të mbillen me misër hamu-

1 Në vitin 1982 në rrethin e Mirditës 55 për qind e sipërfaqes së tokës plugohej me traktor, shirja e grurit u bë 100 për qind me makinë.

llor, nga i cili do të marrim një prodhim plus që mund të arrijë 23 deri 25 kv për hektar dhe kjo në ato toka ku kemi marrë një herë grurë. Shikoni, pra, e tillë është perspektiva.

Përveç grurit, në gjendje të mirë paraqiten edhe bimët e tjera bujqësore. Misri tani është mbjellë gati kudo, kanë mbetur vetëm disa qindra hektarë që janë nën ujë, por edhe ato së shpejti do të mbillen. Pambuku është mbjellë, gjithashtu, në kushte të mira, po kështu edhe luledielli, duhani etj. Pra, deri tani bujqësia na paraqitet mirë. Prandaj shpresojmë që viti i sivjetëm, ashtu si viti i kaluar, të jetë një vit me rendimente e me prodhime të mira në industri edhe në bujqësi.

Edhe në sektorin e arsimit e të kulturës kemi e do të kemi edhe në të ardhmen rezultate të mira. Për revolucionarizimin e shkollës tani po bëhet kudo një punë e madhe. Të gjithë, nxënës, mësues, pedagogë, punëtorë, kooperativistë, nëpunës po diskutojnë se si shkolla jonë të bëhet sa më e përshtatshme për djemtë dhe për vajzat, për të gjithë punonjësit e vendit tonë, që i madh e i vogël të mësojnë në to, që njerëzit tanë të bëhen më të ditur, të aftë për veten e tyre, për popullin, për shoqërinë. Qëllimi i shkollës është që mësimi të jetë jo një stoli, por një armë e fuqishme për jetën, që t'i shërbejë njeriut në punë për ngritjen e rendimentit të prodhimit, për të krijuar bollëkun për popullin. Ne kemi bindjen se bollëkun do ta krijojmë patjetër duke punuar dhe duke mësuar, sepse populli ynë është punëtor, i etur për mësim e dituri, është popull heroik, i zgjuar, i vendosur, që ecën me bindje në rrugën ku e udhëheq Partia për

ndërtimin e socializmit dhe për ruajtjen me vigjilencë të fitoreve të arritura.

Ruajtja e fitoreve dhe mbrojtja e atdheut janë nga detyrat e dorës së parë të popullit tonë. Ushtria jonë Popullore është tani më e fortë se kurrë. Oficerët dhe ushtarët tanë, rezervistët, mbarë populli, janë në çdo moment në gatishmëri të plotë, si një trup i vetëm të godasin çdo armik, porsa të jepet sinjali për ndonjë kërcënim eventual që mund t'i bëhet atdheut.

Te ne i gjithë populli është i armatosur. Kjo është një karakteristikë e veçantë dhe e natyrshme për vendin tonë. Në Shqipëri populli dhe Partia janë një, besimi i popullit te Partia dhe i Partisë te populli është shumë i madh, i palëkundur. Përgatitja ushtarake dhe stërvitja e çdo individi te ne janë organizuar në mënyrë të tillë që secili jo vetëm të jetë i pajisur me armë, po edhe të stërvitet që të bëhet i aftë dhe të dijë ta përdorë atë si duhet, të dijë taktikën, strategjinë dhe format si të sulmojë e si të mbrohet nga armiku, të njohë format e luftës partizane, të njohë, njëkohësisht, format e luftës moderne, të dijë edhe format e luftës që mund të përdorë armiku i mundshëm.

Kjo situatë e mrekullueshme në vendin tonë u dedikohet mësimeve të Partisë dhe punës së palodhur të oficerëve tanë, këtyre bijve heroikë të Partisë dhe të popullit, që kanë dalë nga shkolla e madhe e Luftës Nacionalçlirimtare dhe nga shkollat që hapëm pas Çlirimit. Ata kanë përvetësuar si duhet artin ushtarak të popullit dhe këtë po ua mësojnë tani, në forma të ndryshme, të gjithë të rriturve, burra e gra e, sido-

mos, të rinjve e të rejave. Këto forma ne do t'i perfeksionojmë akoma, do t'i bëjmë edhe më të mira e më të efektshme, si për oficerët e ushtarët, ashtu edhe për rezervistët. Kështu, ato do të pëlqehen më tepër dhe do të përvetësohen më shpejt prej ushtarëve, oficerëve dhe rezervistëve, të cilët pas kësaj do të dalin më të fortë, më të edukuar e më të gatshëm nga sa kanë qenë më parë.

Situata në botë, shoqe dhe shokë, zhvillohet kurdoherë në favorin tonë, në favorin e forcave revolucionare të popujve dhe në dëm të imperialistëve, të kapitalistëve dhe të revizionistëve modernë.

Imperialistët amerikanë janë në krye të të gjithë reaksionit botëror, në luftë kundër socializmit dhe kundër lirisë e pavarësisë së popujve, ndërsa revizionistët modernë sovjetikë janë vënë në krye të revizionistëve të vendeve të ndryshme, duke u shërbyer me zell imperialistëve. Imperialistët amerikanë dhe revizionistët sovjetikë janë në miqësi të ngushtë me njëri-tjetrin, ata duan të forcojnë bashkëpunimin e tyre të gjithanshëm me synimin që të sundojnë botën, të shkatërrojnë komunizmin dhe të vendosin kapitalizmin kudo, në çdo vend.

Por, nga ana tjetër, në botë qëndrojnë dhe rriten dita-ditës forcat e revolucionit, që mbrojnë socializmin e komunizmin dhe ndihmojnë luftërat nacionalçlirimtare të popujve kundër imperializmit, kapitalizmit, revizionizmit, mbrojnë revolucionarët, që po ngrenë krye kundër klikave dhe partive revizioniste që janë në fuqi. Këto forca të mëdha revolucionare në botë udhëhiqen nga idetë e marksizëm-leninizmit. Ato kanë

shndërruar në një flamur të papërkulur thirrjen që Marksi dhe Engelsi hodhën që me Manifestin e Partisë Komuniste: «Proletarë të të gjitha vendeve, bashkohuni!». Kjo do të thotë se punëtorët dhe popujt e shtypur të gjithë botës duhet të bashkohen, të ngrihen në revolucion kundër imperializmit, kapitalizmit dhe revizionizmit, të përmbysin pushtetin e tyre dhe të vendosin kudo diktaturën e proletariatit.

Të udhëhequr nga mësimet e Marksit, të Engelsit, të Leninit dhe të Stalinit, klasa punëtore, fshatarësia punonjëse dhe popujt korrën fitore, thyen zinxhirë të skllavërisë kapitaliste, fituan lirinë dhe, në të ardhmen, në flamurin e këtyre fitoreve do të shkruhen përsëri fitore të tjera të reja të popujve që luftojnë kundër shtypjes e shfrytëzimit kapitalist. Këtë flamur po e ngrenë lart dhe po e mbajnë të papërlyer e pa u përkulur, në luftën kundër imperializmit dhe revizionizmit modern, Partia heroike e Punës dhe partitë e vërteta marksiste-leniniste në botë.

Komunistët e vërtetë, punëtorët, fshatarët dhe demokratët revolucionarë, kudo në botë, përgëzojnë Partinë e Punës të Shqipërisë, Qeverinë dhe popullin shqiptar për politikën e drejtë, për guximin, për trimërinë dhe për vendosmërinë e tyre. Bile, çdo ditë, na vijnë lajme se edhe qeveri borgjeze janë të detyruara të njohin politikën e guximshme të Qeverisë Shqiptare, që u ka qëndruar ballë për ballë qëndrimeve armiqësore të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Bashkimit Sovjetik dhe veglave të tyre rreth kufijve tanë e kudo që janë në botë. Ne nuk trembemi nga bllokada dhe nga presionet imperialisto-revizioniste. Këta, për vite

e vite me radhë, u përpoqën të na mposhtnin, të na gjunjëzonin, por ne u treguam vendin dhe qëndrimi ynë konsekuent i zbrapsi ata, kurse armiqtë të brendshëm u thyem e do t'u thyejmë kokën. Armiqtë tanë e dinë fare mirë se, po të prekin Shqipërinë, ka për t'u ndezur një zjarr i madh në botë që do t'i përvelej të gjithë, pse ne, pavarësisht se jemi të vegjël në numër, jemi të fortë, luftojmë për një çështje të drejtë, për çështjen e madhe të socializmit, luftojmë për të mbrojtur atdheun, për të drejtat tona.

Me gjithë këto Partia na ka mësuar e na mëson të jemi kurdoherë vigjilentë, ta mbajmë pushkën gjithnjë në dorë dhe të dimë kundër kujt ta shkrehim. Ju e dini se armët që kemi sot nuk janë më pushkët e mitralozët e vjetër, por janë nga më modernet. Ne kemi sot nga të gjitha ato lloj armësh që kanë edhe armiqtë tanë, prandaj ata i kanë zënë frika. Mirë, le të na kenë frikë, frika kurrë mos u daltë nga barku, po dihet se Shqipëria kurrë nuk ka sulmuar dhe nuk ka ndër mend të sulmojë kurrkënd, këtë ajo as e ka bërë dhe as e bën sot e në të ardhmen, përkundrazi, kanë qenë të tjerët që e kanë sulmuar atë.

Në Shqipëri situata aktuale është më e shëndoshë se kurrë. Ekziston një unitet i çeliktë i popullit rreth Partisë. Populli është i gëzuar, punon dhe prodhon. Ne e kemi të qartë se sot ai nuk i ka të gjitha të mirat që duhet të ketë, sepse kemi akoma shumë për të bërë, por, me siguri, çdo gjë do ta kemi me bollëk në të ardhmen tonë të ndritur, që po e përgatitim me mendjen, me punën dhe me djersën tonë.

Ç'ndodh në vendet e tjera? Shtetet e Bashkuara

të Amerikës, që janë vendi më i pasur kapitalist në botë, vendi i dollarit dhe i pasurive të mëdha, të vëna me gjakun dhe me djersën e popujve, që kanë dërguar sa e sa sputnikë në qiell, po pësojnë disfata të mëdha nga lufta e popullit heroik vietnamez. Vite me radhë imperializmi amerikan, duke vënë në përdorim mijëra aeroplanë, anije dhe qindra mijëra ushtarë të vet dhe kukulla, po bombardon nga deti dhe nga ajri Republikën Demokratike të Vietnamit. Më se gjysmë milion ushtarë kanë dërguar Shtetet e Bashkuara të Amerikës në Vietnamin e Jugut, me qëllim që të shuajnë rezistencën e këtij populli, i cili lufton me të gjitha forcat për të fituar lirinë e tij. Dhe të gjitha ushtritë e imperializmit janki, të satelitëve e të kukullave të tij janë mbyllur e janë gozhduar nga lufta e partizanëve trima vietnamezë, në disa baza dhe qytete, të cilat luftëtarët vietnamezë po i sulmojnë vazhdimisht, duke u futur tmerrin imperialistëve amerikanë. Merrni me mend ç'do të ndodhte në rast se imperializmi amerikan do ta zgjeronte më tej dhe në të njëjtën kohë luftën kundër popujve të tjerë. Gazetarë të ndryshëm amerikanë po e këshillojnë tani presidentin e tyre të tërhiqet nga deti i luftës së partizanëve vietnamezë, ku po mbyten çdo ditë me qindra ushtarë amerikanë.

Gjithashtu, Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë në vështirësi të mëdha në pikat e ndryshme të globit, ku kanë ndërtuar qindra e mijëra baza ushtarake, të cilat kërkojnë njerëz e fonde të pallogaritshme, kërkojnë shuma kolosale, që nxirren nga kurrizi i popullit punonjës amerikan. Imperialistët amerikanë organi-

zojnë kudo diversione kundër popujve, përkrahin kudo klikat vendase më antipopullore, pra, bëjnë veprime që ngjallin urrejtjen e thellë të masave të popujve, kundër të cilave veprojnë. Është për këtë arsye që në të gjitha vendet ku ekzistojnë baza ushtarake amerikane ka lëvizje, diku ka filluar dhe po rritet lufta nacionalçlirimtare, diku bëhen greva e demonstrata, diku akoma ka rezistencë të heshtur, por që nesër, me siguri, do të kthehet në një furtunë të papërmbajtur, që do t'i përlejë këta barbarë, armiq të popujve. Pra, kudo ku sundon apo ushtrohet ndikimi i imperializmit amerikan ndihet edhe një revoltë e madhe. E njëjta gjë ndodh edhe me satelitët dhe me aleatët e tij.

Aleancat e Shteteve të Bashkuara të Amerikës tani janë tronditur. Imperializmi amerikan nuk është në gjendje t'i mbajë aleatët e tij të lidhur me traktate dhe t'i vërë në lëvizje sipas dëshirës, siç bënte disa vite më parë, prandaj, në rast se ai do të orvatet të ndër marrë një aventurë ushtarake kundër ndonjë vendi tjetër, kjo do të ishte katastrofike për politikën e jashtme dhe për gjendjen e brendshme të Shteteve të Bashkuara, pse duhet të llogaritin që në këtë përpjekje do të mbeten vetëm dhe do të shemben.

Ekonomia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës ndodhet sot në vështirësi të mëdha, që shprehen edhe në krizën e rëndë të dollarit. Kjo vjen për arsye të shpenzimeve të shumta ushtarake që po bëjnë, të cilat gjithnjë e më tepër rëndojnë në kurrizin e punëtorëve dhe të masave të tjera punonjëse amerikane. Kjo u ka dhënë shtytje punëtorëve dhe studentëve të ngrihen në greva e në demonstrata dhe të kundërshtojnë

hapur politikën aventureske të qeverisë amerikane. Nga ana tjetër, të 20 e ca milionë zezakët në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që rrojnë nën një shtypje të egër raciale nga të bardhët, shpërthejnë herë pas here në demonstrata të furishme, që shpesh arrijnë deri në përleshje të përgjakshme, saqë qeveria amerikane detyrohet të lëshojë mbi ta ushtrinë. E tillë është, në vija të përgjithshme, gjendja politike e jashtme dhe e brendshme e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Në Francën kapitaliste kanë shpërthyer greva të mëdha, të cilat flasin për gjendjen e vërtetë në këtë vend. Një mëngjes të mirë studentët francezë u ngritën kundër qeverisë monopoliste të Dë Golit, pushtuan lagje të studentëve në Paris, zunë rrugët, dogjën dhe rrëzuan makina, ngritën barrikada. Filloi kështu një tërmet i fortë kundër qeverisë. Bashkë me studentët francezë, u hodh në greva e demonstrata madhështore klasa punëtore dhe numri i demonstruesve arriti në 10 milionë veta. Nga kjo Parisi mbeti për shumë ditë pa bukë, pa mish, pa ujë, pa energji elektrike, pa gaz etj. Pra, u paralizua gjithë jeta e vendit, nuk punonin tramvajet, trenat, telefonat, avionët dhe anijet nuk lëviznin nga vendi. Në këto kushte, gjenerali Dë Gol, i cili kishte shkuar për vizitë në Rumani, ku u prit me trëndafila nga krerët revizionistë të këtij vendi, u detyrua ta linte përgjysmë vizitën dhe të kthehej shpejt në Paris. Ai premtoi në televizion se do të bëhen «reforma», se organizimi aktual ekonomik dhe politik i vendit është i vjetruar, se organizimi i universiteteve franceze është, gjithashtu, i vjetruar, prandaj «duhen bërë ndryshime». Deri dje ai nuk i zinte në gojë këto

probleme, por ishte forca e madhe e klasës punëtore, që e detyroi të flasë, të bëjë lëshime.

Shembulli i punëtorëve dhe i studentëve francezë po ndiqet edhe në vende të tjera kapitaliste të Evropës. Në Itali studentët e Romës, të Milanos kanë pushtuar universitetet, bashkë me ta edhe studentë të qyteteve të tjera të Italisë janë ngritur në grevë, për të drejtat e tyre, janë solidarizuar me studentët francezë. Në Gjermani, në Spanjë, në Angli, në Holandë, në Belgjikë e kudo punëtorët e studentët janë në sulm. Ç'tregon kjo? Kjo tregon se revolucioni po ecën me sukses përpara. Pavarësisht se këto lëvizje nuk udhëhiqen të tëra dhe plotësisht nga marksistë-leninistë, fryma e marksizëm-leninizmit, fryma e revolucionit, lufta kundër imperializmit, kundër kapitalizmit i frymëzon proletariatin dhe aleatët e tij, i bën këta të ecin përpara drejt rrugës së vërtetë.

E tillë është situata edhe në vendet revizioniste, ku gjendja mbahet me presion, me terror dhe me burgje. Në Çekoslovakë, revizionistët e krahut të djathtë duan ta shpejtojnë rivendosjen e kapitalizmit, mirëpo një shpejtim i tillë është i rrezikshëm për revizionistët sovjetikë, prandaj këta kanë kërcënuar krerët e rinj tradhtarë çekoslovakë të mos shkojnë më tutje, sepse kanë frikë që kjo do të ndikojë që edhe në Bashkimin Sovjetik të turbullohen gjakrat. Kjo tregon sa e vështirë është situata në Bashkimin Sovjetik, në Poloni, në Bullgari, në Gjermani e kudo në vendet revizioniste.

Sa për vendin tonë ne e shohim vetë si është situata dhe për këtë të gjithë na e kanë zilinë. Kjo ngjet për arsye të vijës së drejtë marksiste-leniniste

të Partisë. Me mijëra letra i vijnë Radio Tiranës nga të katër anët e botës, me të cilat njerëz të shtresave të ndryshme përgëzojnë Partinë tonë për vijën e drejtë, për të vërtetën që ajo përhap. Shokë marksistë-leninistë nga vende të ndryshme na shkruajnë se artikujt e «Zërit të popullit» dhe materialet e tjera të Partisë sonë u shiten si buka.

Në këto situata optimiste revolucionare, le të ecim kurdoherë, shoqe dhe shokë, me besim përpara, të bashkuar si gjithnjë, në unitet të çeliktë me Partinë tonë të lavdishme në krye. Të vëmë të gjitha forcat për të realizuar planet tona ekonomike në çdo sektor, pse, duke kryer dhe duke tejkaluar me sukses detyrat e caktuara nga Partia, ne ndihmojmë, njëkohësisht, vëllezërit tanë komunistë dhe popujt luftëtarë të vendeve të tjera, ndihmojmë Vietnamin dhe gjithë popujt revolucionarë, që luftojnë e derdhin gjakun për të fituar lirinë dhe për të shpëtuar njëherë e përgjithmonë nga shtypja e nga shfrytëzimi i egër kapitalist.

Mendoni kohët e kaluara të robërisë sonë, motra dhe vëllezër, vuajtjet dhe sakrificat e panumërta që bëme për ta fituar dhe më pas për ta konsoliduar këtë liri dhe fitoret e tjera të arritura. Prandaj t'i ruajmë me vigjilencë të dhjetëfishuar të gjitha këto fitore, të kalitim unitetin dhe t'i shumfishojmë forcat për realizimin e detyrave tona, për të ndihmuar, njëkohësisht, edhe shokët e vëllezërit tanë, që akoma janë nën zgjedhën e robërisë kapitaliste, por që sapo e kanë filluar luftën heroike, ashtu siç e kemi bërë edhe ne më parë, kur derdhëm gjak vite me radhë. Detyrat tona të brendshme janë të lidhura ngushtë me detyrat e

jashtme. Këto detyra, që na ka caktuar Partia, ne i kemi kryer kurdoherë me nder dhe do t'i kryejmë, gjithashtu, me nder edhe në të ardhmen, pse janë të shenjta për ne komunistët dhe për popullin. Ne nuk na tremb asgjë, nuk na trembin vështirësitë, pengesat, armiqtë, prandaj detyrat që na ngarkon Partia t'i kryejmë me sukses, me guxim, me heroizëm, edhe me çfarëdo sakrifice që do të kërkohet.

Rroftë Partia!

Rroftë populli heroik i Mirditës!

Dalshi kurdoherë faqebardhë!

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

KURRË TË MOS DEHEMI NGA SUKSESET DHE TË MOS E ULIM VIGJILENCËN

Nga biseda me kuadro të rrethit të Mirditës

29 maj 1968

Sa bukur qenka në këtë sallë të konviktit të shkollës 12-vjeçare, në të cilën jemi mbledhur sonte! Më duket sikur u kthyem edhe një herë në konviktore dhe për këtë na vjen shumë mirë, sidomos disave nga ne që, kur ishim të rinj, kemi jetuar në konvikto, të cilat, edhe pse ishin hapur në kohën e Zogut, qenë çerdhe revolucionarësh.

Këngët e vallet tona popullore i kemi të bukura dhe një pjesë e tyre janë jashtëzakonisht të bukura. Gjatë periudhës pas Çlirimit kudo ato janë zhvilluar shumë, vetëm duhen bërë përpjekje që të mos ua ndërrojnë karakterin, ritmin e harmoninë e tyre të bukur popullore. Karakteristikat popullore, goftë të këngëve, ashtu edhe të valleve tona, të kujdesemi t'i ruajmë të paprekura. Natyrisht, ato mund të harmonizohen, të stilizohen pak, por jo t'u humbasë ngjyra popullore, siç kanë tendencë disa. Një tendencë e tillë

është e dëmshme dhe luftohet nga Partia, prandaj njerëzit tanë të artit tani po bëjnë përpjekje që gjithë krijimtarinë tonë popullore të trashëguar gjatë shekujve jo vetëm ta ruajmë, por edhe ta zhvillojmë më tej, duke e konsideruar atë si një thesar të madh shpirtëror të popullit.

Çifteli, me të cilën shoqëroi këngën pionieri që posa e ekzekutoi atë, nuk kemi në Gjirokastër. Këngët nga ajo anë i kemi një çikë të shtruara. Ato mund të këndohen edhe me 3 veta, nga të cilët njeri ia merr, tjetri ia kthen dhe i treti mban iso, si i themi ne. Kur grupi ka më shumë njerëz që mbajnë iso, kënga del më e bukur. Ndryshe është me këngët e me vallet tuaja, ato janë më dinamike, më të gjalla, por, sidoqoftë, ne që jemi rritur me tonat, na pëlqejnë shumë, ato sikur na përtërijnë kur i dëgjojmë. Lëre pastaj sikur shokët ushtarakë të na marrin nja 15 ditë në marshim nëpër bjeshkët tuaja kaq të bukura, do të shikoni si do të bëhemi, lule fare. Ne edhe malit jemi në gjendje të ngjitemi.

Muzika jonë, që mbështetet në melodinë dhe në shpirtin luftarak të popullit, është e tillë që jep mundësi për krijime shumë të bukura. Në vendet borgjeze muzika është bastarduar fare, ajo është bërë e neveritshme. Kjo është një vijë e tërë që ndjek borgjezia për të degjeneruar masat e gjera të popullit dhe, në radhë të parë, rininë, prandaj edhe muzikës dhe gjithë artit ajo u jep karakter përherë e më shumë dekadent, antishoqëror, antisocialist dhe amoral. Në vendin tonë, në sajë të vijës së drejtë të Partisë, të gjitha llojet e krijimtarisë artistike ecin në rrugë të drejtë revolu-

cionare dhe çdo ditë e më tepër zhvillohen e bëhen më të bukura.

Shfaqja që pashë mbrëmë këtu, ishte mjaft e bukur dhe më pëlqeu shumë. Aktorët që morën pjesë në të ishin njerëz të punës, asnjë prej tyre nuk ishte artist profesionist dhe në përgjithësi luajtën mirë. Dy-tre prej tyre, siç ishte ai që luante rolin e kulakut, ai që luante atë të plakut dhe ai që luante rolin e metalurgut, sipas mendimit tim, janë aktorë të klasit të parë. Gjithashtu, mirë interpretuan edhe vajzat. Pra, me disa shkallëzime, të gjithë luanin mirë. Autori i pjesës e kishte thurur mirë ngjarjen. Disave mund t'u duket se në këtë shfaqje kishte gjëra të thjeshta, simpliste, mirëpo idetë që përçon vepra janë të larta. Zhvillimi i ngjarjeve dhe i luftës, kontradiktat aty janë trajtuar mirë, bile janë shtruar shumë bukur. Shfaqja, me një fjalë, më pëlqeu dhe mendoj se ka bërë përshtypje të mirë në popull. Njerëzit e thjeshtë nuk kanë shumë pretendime si disa artistë, të cilët, edhe kur luajnë vetë, kanë mjaft të meta. Artistët amatorë punën e bëjnë me pasion, prandaj Partia duhet të punojë me masat për të zbuluar në radhët e tyre talentet më të mira, nga të cilat ka shumë në gjirin e popullit.

Puna e mirë që ka bërë dhe bën Partia për edukimin e njerëzve, ka krijuar tani një gjendje të tillë që cilido punëtor, fshatar, mësues, nxënës, vajzë ose grua e martuar, kur ka njëfarë talenti nuk ka më turp të dalë në skenë. Si ka qenë gjendja më përpara te ne në këtë drejtim e ku jemi sot? Një ndryshim i madh, si nata me ditën, është bërë. Kjo do të thotë se populli e ka kuptuar rëndësinë e artit dhe të kulturës. Tani

jemi larg asaj kohe, kur flitej me përcmim për një njeri që dilte në skenë. Te ne ka ndryshuar kuptimi i vjetër reaksionar për punonjësit e artit.

Jeta nuk është e thjeshtë. Njeriu ynë nuk rron vetëm për të ngrënë e për të pirë, ai, krahas punës e mësimit, ka nevojë edhe për të mësuar, për të dëfryer, për të luajtur, për t'u marrë me sport, për të parë një shfaqje në teatër ose në kinema, për të luajtur vetë një rol në skenë ose gjatë xhirimit të një filmi, pra, për të qenë vetë edhe aktor, edhe spektator. Në vendin tonë Partia ka krijuar mundësitë që çdo njeri të zhvillojë prirjet e talentet dhe të edukohet në atë fushë të jetës që dëshiron, prandaj, si kudo, edhe në fushën e artit janë bërë përparime të mëdha, është rritur pjesëmarrja e masave të gjera të popullit, të qytetit dhe të fshatit.

Miq dhe shokë të huaj, komunistë e patriotë, që luftojnë në të shumtat e rasteve në ilegalitet, për lirinë e popujve të tyre në vendet e ndryshme të Afrikës, si në Kongo etj., apo në vendet e Amerikës Latine, si në Brazil etj., kur vijnë në vendin tonë dhe dëgjojnë këngë partizane, i pëlqejnë jashtëzakonisht shumë, prandaj, para se të largohen, marrin të shkruara notat dhe fjalët e tyre, përpiqen t'i mësojnë, pse ato jo vetëm janë të bukura, melodioze, por edhe me përmbajtje revolucionare. Ata interesohen të njohin, në radhë të parë, luftën e popullit tonë dhe ne, sado që jemi një vend i vogël, me aq sa mundim i ndihmojmë. Këta njerëz revolucionarë, nga katër anët e botës, çajnë dete dhe oqeanë, vënë shpesh kokën në torbë për të ardhur në Shqipërinë e vogël, pikërisht sepse këtu ekzistojnë

një Parti dhe një popull që i duan dhe i mbështetin. Komunistët dhe revolucionarët e këtyre vendeve e kanë mjaft vështirë punën, por lufta e tyre çdo ditë është në rritje. Kështu kemi ecur edhe ne në fillim, pak veta kemi qenë, pastaj u bëmë shumë, sa që arritëm t'i vëmë përpara armiqtë dhe të fitojmë plotësisht mbi ta. Kështu do të ndodhë edhe në vendet e tyre, qofshin larg apo afër vendit tonë.

Para disa ditësh shkoi në Prishtinë një delegacion studiuesish shqiptarë për të marrë pjesë në një simpozium¹, që kishin organizuar shqiptarët e Kosovës me rastin e 500-vjetorit të vdekjes së Skënderbeut. Nuk është parë kurrë ajo që ndodhi në ato ditë që qëndruan njerëzit tanë atje! Rinia dilte rrugëve të Prishtinës dhe brohoriste për Shqipërinë dhe këndonin në masë këngë patriotike.

Në sallën ku kryetari i delegacionit tonë, Aleks Buda, do të mbante referatin, edhe pse ajo mernte deri 700-800 veta, ishin lejuar të merrnin pjesë vetëm 250 veta. Autoritetet lokale nga frika nuk kishin lejuar të hynin më tepër pjesëmarrës, po, pavarësisht nga kjo, jashtë ndërtesës ishte dyndur një masë e madhe njerëzish. Kosovarët, kur mësuan se do të fliste kryetari i delegacionit shqiptar, sulmuan dyert e dritaret dhe u futën brenda, kështu salla u mbush plot e, megjithatë, shumë të tjerë që donin të dëgjonin, mbetën jashtë. Fjala e të deleguarit të Shqipërisë u prit me duartrokitje të gjata e të vazhdueshme.

¹ Ky simpozium i zhvilloi punimet në Prishtinë nga 9 deri më 11 maj 1968.

Nga fshatrat e ndryshme të Kosovës vinin në Prishtinë shumë njerëz, të cilët takoheshin me mall me shokët e delegacionit tonë. Ja, e tillë është situata në Kosovë, e madhe është dashuria e kosovarëve për Shqipërinë. Ata shprehnin hapur ndjenjat e dashurisë për Shqipërinë dhe kërkonin t'u dërgoheshin libra nga Shqipëria mëmë.

Populli shqiptar i Kosovës kërkon që gjuha shqipe të përdoret kudo në krahinë dhe kjo është një e drejtë e tij. Për këtë të drejtë në Kosovë flasin shumë njerëz. Titistët janë detyruar ta pranojnë një kërkesë të tillë, sepse e duan dhe e kërkojnë populli dhe rinia, që bëjnë presion të madh.

Revizionistët jugosllavë, pra, janë në situata të vështira, të cilat gjithnjë e më shumë do të vështirësohen. Në këtë situatë reaksioni serb ka filluar të egërsohet, për arsye se lufta në mes të klikave brenda vendit ka acaruar marrëdhëniet në mes të kombësive, që përbëjnë Federatën Jugosllave, kështu ka acarime midis serbëve e kroatëve, serbëve dhe sllovenëve, serbëve e boshnjakëve, serbëve e maqedonasve etj. Grindjet në mes të kombësive të ndryshme atje janë të mëdha. Në këto situata edhe shqiptarët e Kosovës janë ngritur të kërkojnë të drejtat e tyre. Titistët, aktualisht, nuk janë në gjendje të marrin masa të ashpra kundër tyre, se e dinë që në një rast të tillë do të kishte nga ana e popullit kosovar kundërshtime e revolta të mëdha.

Në kohën e Rankoviçit nga ana e qeverisë jugosllave ka pasur reaksion të madh kundër kosovarëve. Titoja dhe Rankoviçi kanë vrarë, kanë prerë e kanë bërë shumë krime në Kosovë. Tani që klika e Ranko-

viçit u mënjanua situata i detyroi titistët t'u bëjnë ndonjë lëshim të vogël kosovarëve. Pikërisht këto situata populli dhe rinia e Kosovës përpiqen t'i shfrytëzojnë për të ngritur edhe një herë zërin në favor të çështjes së tyre të drejtë.

Pra, në Jugosllavi ka kontradikta të mëdha, njerëzit dhe kombësitë janë përçarë. Titistët përpiqen të krijojnë përshtypjen sikur Titoja përfaqëson një regjim të palëkundur, por, në realitet, regjimi në Jugosllavi është i kalbur. Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë, pavarësisht nga emri, është një parti revizioniste, bile atje as që ekziston fare parti. Jugosllavia është kthyer në një vend të krimbur kapitalist, ku pasuritë kryesore kanë rënë në duart e të huajve. Në të gjitha ndërmarrjet ekonomike të Jugosllavisë shumicën e aksioneve më të mëdha i kanë kapitalistët amerikanë, francezë, anglezë, gjermanoperëndimorë, italianë, sesa vetë jugosllavët.

Në Jugosllavi, në të katër anët e vendit, sundon një kaos i madh jo vetëm në ekonomi, por sidomos në politikë e në ideologji, si dhe një shovinizëm i tërbuar. Frikën më të madhe titistët tani e kanë nga kosovarët, të cilët i ruajnë me kujdes traditat, gjuhën, zakonet shqiptare, luftojnë për të siguruar të drejtat e tyre dhe nuk përkulen para asnjë shtypjeje të regjimit titist.

Edhe në Bashkimin Sovjetik situatat për revizionistët janë, gjithashtu, të vështira. Përveç grupit bolshevik, që hodhi traktin që botuam¹, të cilin ju e ke-

1 Shih gazetën «Zëri i popullit», nr. 305 (5715), 20 dhjetor 1966 dhe nr. 306 (5716), 21 dhjetor 1966.

ni lexuar, ka dalë edhe një grup tjetër, që ka shpërndarë edhe ky trakte. Në këto trakte bëhet thirrje që klasa punëtore sovjetike të ngrihet më këmbë dhe me luftë të rrëzojë klikën revizioniste, bëhet thirrje për një revolucion të dytë socialist në Bashkimin Sovjetik.

Po të flasim për Bullgarinë duhet të themi se atje udhëheqja revizioniste bullgare i ka mbushur burgjet plot me revolucionarë. Në qoftë se dikush në Bullgari flet kundër udhëheqjes, menjëherë e pret burgu. Deri kur do të zgjatë një gjendje e tillë? Ne këtë nuk e dimë me siguri, po këto veprime të përditshme, të vogla në sasi, një mëngjes do të kthehen në cilësi. Pra, do të vijë koha që kushtet të piqen aq sa të arrijnë në gjendje shpërthimi. Kështu do të ndodhë edhe në vendet e tjera revizioniste.

Edhe në Kinë revolucioni socialist ishte në rrezik, sepse brenda radhëve të partisë kineze ishin shumë elementë revizionistë. Revizionistët kinezë kishin lidhje me imperialistët amerikanë. Ngjarjet vërtetuan se një pjesë e krerëve revizionistë kinezë kanë qenë me kohë agjentë të imperialistëve amerikanë. Këtë e vërtetojnë dokumentet e zbuluara, që dëshmojnë se këta agjentë dhe spiunë të rrezikshëm kishin arritur deri në krye të partisë dhe bënë veprime armiqësore, ata sollën në parti dhe në pushtet plot spiunë të tjerë, falsifikuan dhe zhdukën sa mundën të gjitha ato dokumente, që vërtetonin qenien e tyre agjentë të Guomindanit. Gjendja ishte e tillë që në Komitetin Qendror dhe në parti në Kinë ekzistonin dy vija.

Ndryshe është gjendja te ne. Ne ecim përpara, sukseset janë të mëdha në të gjitha fushat. Në per-

spektivë vendi ynë do të zhvillojë akoma më shumë industrinë me objekte të reja të mëdha industriale, energjetike, kimike etj., për të cilat popullit tonë do t'i duhen, natyrisht, të shpenzojë shumë forca, mjete materiale e monetare. Këto objekte ne do t'i ndërtojmë, në radhë të parë, me forcat tona. Ndërtimi i veprave, që kemi parashikuar në planin e ardhshëm pesëvjeçar, do të zhvillojë akoma më shumë ekonominë tonë, do t'i fuqizojë më tepër industrinë dhe bujqësinë tonë aktuale, do t'i ndihmojë kërkimet tona gjeologjike, të dhënat e të cilave japin shpresa për rezultate të mëdha në të ardhmen. Kjo na vë përpara detyrën të mendojmë që rezervat minerare të mos i përdorim më si deri tani, por t'i trajtojmë në mënyra sa më të leverdishme. Me një fjalë, të ngremë në vend industrinë e përpunimit të mineraleve dhe të mos i shesim ato si lëndë të para, si kemi bërë deri tani, sepse me përpunimin e tyre në vend ekonomia jonë popullore do të përfitojë më shumë.

Në këto situata ne duhet edhe të punojmë, por edhe të vigjilojmë, sepse armiqtë, qofshin të jashtëm apo të brendshëm, janë të pabesë, prandaj asnjëherë të mos na zbutet zemra ndaj tyre. As të mos mendojmë se, duke qenë të fortë, armiku s'ka ç'na bën. Ndonjë element armik, që leh si qen në shkretëtirë, natyrisht s'ka ç'na bën, megjithatë ne duhet të punojmë që edhe atë ta sjellim në rrugë të drejtë dhe vetëm kur edhe pas përpjekjeve tona nuk arrihet rezultat, atëherë ta demaskojmë përpara popullit që ky ta njohë mirë atë reaksionar të fëlliqur dhe t'i gjejë vendin, atje ku e meriton.

Partia na mëson, gjithashtu, që kurrë të mos dehem nga sukseset dhe kurrë të mos e ulim vigjilencën, edhe pse situata zhvillohet në favorin tonë, të forcave revolucionare. Në asnjë moment nuk duhet të mendojmë se armiq si shovinistët titistë, revizionistët modernë me ata sovjetikë në krye, imperialistët amerikanë, neofashistët italianë, Vatikani e të tjerë, nuk janë të rrezikshëm, përkundrazi, sytë t'i kemi kurdoherë hapur. Midis tyre ekzistojnë kontradikta të mëdha, të cilat ne i njohim dhe i shfrytëzojmë në interes të marksizëm-leninizmit. Po për sa i përket qëndrimit ndaj komunizmit dhe popujve ata të gjithë janë armiq dhe për këtë janë në unitet. Ne i luftojmë që të gjithë ata, pa u bërë as lëshimin më të vogël, u kemi treguar dhe u tregojmë kurdoherë ku e kanë kufirin dhe u kemi thënë qartë, që ta dinë mirë se Shqipëria, pavarësisht se është një vend i vogël, nuk është një kockë që gëlltitet lehtë, bile do të jetë shumë vështirë për ta. Lufta me Shqipërinë nuk është një çështje që mbaron me një ditë, me një vit ose me pesë, sepse ajo nuk do të jetë vetëm. Armiqtë duhet ta dinë mirë se Shqipëria do t'u sjellë pasoja të rënda, mbasi ajo ka miq kudo në botë. Me Shqipërinë janë gjithë marksistë-leninistët dhe popujt e botës. Lufta e popullit tonë dhe e Partisë së Punës të Shqipërisë njihet tani në botë, prandaj vendi ynë gëzon kudo simpati të madhe. Dhe në qoftë se armiqtë imperialistë ose revizionistë a kushdo armik tjetër, guxojnë të sulmojnë Shqipërinë, popujt dhe njerëzit përparimtarë të çdo vendi nuk do të rrinë duarlidhur, ata do t'u qesin armiqve tanë të përbashkët pengesa të mëdha dhe do ta ndihmojnë luftën tonë. Prandaj,

në çdo veprim që mund të ndërmarrin kundër vendit tonë, armiqtë do të dalin të humbur. Dhe ata i kanë bërë këto llogari. Ne e dimë mirë se këta ujë shikojnë me keqardhje të madhe që në një pikë më të rëndësishme të Evropës ekziston një vend i vogël, i cili ndërton me sukses socializmin, duke ua prishur atyre planet.

Imperialistët dhe revizionistët përpiqen me çdo mënyrë të na futin në kthetra, duke na premtuar miqësinë e tyre, duke na propozuar të bëjmë tregti, duke kërkuar të dërgojnë turistë etj., etj. Mirëpo ne i dimë qëllimet e tyre, e dimë përse bëhen këto propozime dhe ç'janë turistët, që duan të na dërgojnë dhe kur nuk ua pranojmë, na akuzojnë për njerëz të mbyllur e të egër. Ata bëjnë çmos të shtojnë tregtinë me ne dhe habiten përse ne nuk marrim kredi prej tyre, edhe pse ata janë gati të na japin. Jo, kredi nga ata ne nuk duam. Sa për tregti jemi gati të bëjmë, por gjithmonë tregti në baza reciprociteti dhe pariteti. Ata thonë se i vetmi vend në botë që nuk merr kredi është Shqipëria.

Qëndrimet tona korrekte kanë bërë që në vendet e huaja të kenë respekt për njerëzit tanë. Kështu, për marinarët dhe për personelin e vaporëve të Flotës sonë Tregtare, që shkojnë në portet e ndryshme të botës, kanë kudo besim të madh.

Tregti ne bëjmë edhe me vendet kapitaliste, por turistë nuk pranojmë në kushtet që duan ata. Ata dëshirojnë të vijnë e të shëtitin në vendin tonë kur e ku të duan, që të bëjnë spiunllëqe, të fotografojnë objekte strategjike etj., etj. Ne kemi luftuar me trimëri ku-

ndër armiqve, të cilët për një kohë të gjatë kanë dërguar te ne, për qëllimet e tyre të errëta, diversantë e spiunë. Në luftë me ta, neve na janë vrarë shumë shokë, midis tyre burra trima edhe nga Mirdita. Prandaj Partia nuk lejon që armiqtë të na futen, të na dëmtojnë me çfarëdo rruge, të hapur ose të fshehtë. Ne ecim përpara, punojmë me forcat tona e vigjilojmë, s'kemi nevojë për të ardhurat nga turizmi, ne e shohim ç'bëjnë turistët në vendet revizioniste. Me anën e atyre imperialistët futin minat për të shkallmuar në këto vende çdo gjë socialiste, që mund të ketë mbetur akoma qoftë edhe në formë.

Le ta pimë këtë dolli, shokë e shoqe, për shëndetin tuaj!

Të rrojë Partia!

Për shëndetin e popullit shqiptar dhe për shëndetin e popullit të Mirditës!

Mirupafshim dhe ju premtoj se do të vij përsëri!

Botohet për herë të parë, me disa shkurtime, sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në AQP

NË SOCIALIZËM PLANET KANË NË THEMEL INTERESIN JETIK TË POPULLIT

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

10 qershor 1968

Vendimet që kemi marrë për zhvillimin e bujqësisë kanë një rëndësi të madhe për të gjithë ekonominë e vendit dhe për rritjen e mirëqenies së popullit. Në bujqësi po hyn gjerësisht mekanizimi dhe ky është një sukses i madh, por bujqësia ka nevoja të shumta kë-shtu që, krahas makinerive, asaj i duhet ta organizojë më mirë edhe transportia e thjeshtë. Fshatari ynë në malësi i konsideronte kalin dhe mushkën si mjete pune të rëndësishme për t'i përdorur për nevojat e familjes së tij. Edhe kooperativat bujqësore duhet t'ua dinë më shumë vlerën njëthundrakëve, se makina ose zetori nuk mund të shkojnë në terrene të thyera për

1 Në këtë mbledhje u diskutua mbi gjendjen e njëthundrakëve dhe masat që duheshin marrë për shtimin e tyre, si dhe për organizimin e për zhvillimin e transportit të thjeshtë.

të transportuar prodhimin. Pra, njëhundra-këta nuk duhet t'i trajtojmë si mjete pune, që u ka ikur koha.

Në materialin që na kanë paraqitur shokët e Ministrisë së Bujqësisë do të ishte mirë të na jepeshin disa argumente të bazuara shkencërisht për zhvillimin e njëhundra-këve në vendin tonë, si: për shpërndarjen, për llojet, për moshën, për bazën ushqimore, për ri-prodhimin e tyre etj. Për shembull, kur bëtë këtë studim për të gjitha këto kafshë (kuaj, pela, mushka e gomarë), ju, shokët e bujqësisë, duhej të kishit studiuar edhe sa rrojnë ato, edhe cila është harmonia e zhvillimit të natyrshëm të këtyre kafshëve. Neglizhenca ose tendenca për të shkaktuar rënien e njërit prej llojeve, pavarësisht nga interesat ekonomike që mund të kemi, nga pikëpamja shkencore shkakton perturbacione në llojet e tjera. Këputet, me një fjalë, harmonia e zhvillimit natyral të llojeve të njëhundra-këve. Është shumë kollaj të themi t'i lëmë gomarët dhe mushkat pa shtuar, po a është studiuar se mos prishet kjo lidhje harmonike?

Të marrim anën ekonomike. Duhet bërë llogari ç'sasi ushqimi nevojitet për njërin lloj të njëhundra-këve e ç'sasi për tjetrin, për të parë se cili prej tyre është i leverdishëm. Kjo analizë duhet bërë duke marrë parasysh edhe natyrën e vendit tonë, stadin e zhvillimit ekonomik dhe mundësitë reale të bimëve që janë aktualisht në zhvillim. Duke pasur në dorë këtë studim ne mund të përcaktojmë më mirë se cilat lloje kafshësh na duhen më shumë e cilat bimë duhet të zhvillojmë për t'i ushqyer ato. Nga njëra anë, mund të na interesojnë kafshët me forcë fizike më të madhe,

por ato duan ushqim më shumë, kështu që llogaritë duhen bërë duke vënë në balancë të dyja anët. Në qoftë se e keni bërë këtë studim të na e thoni, se nuk jam i bindur për sa na keni paraqitur këtu. Mbase familja e kooperativistit, në mjaft raste, nuk ka nevojë të mbajë kafshë pune tani që buka i piqet secilit në furrën kolektive, uji u është afruar në fshat, drutë po ia siguron kooperativa çdo anëtarit etj., po vetë kooperativës i duhen njëthundrakët. Se sa do të mbajë e nga cili lloj, këtë ajo do ta gjykojë sipas nevojave e mundësive që ka.

Pra, shokët specialistë të bujqësisë e të blegtorisë duhet të studiojnë edhe leverdinë ekonomike të llojeve të ndryshme të njëthundrakëve, të njohin mirë edhe ligjin natyror, që rregullon zhvillimin e harmonishëm të tyre.

Ju, si drejtues të bujqësisë, duhet të mendoni dhe të kujdeseni për të ruajtur harmoninë natyrale në të gjithë sektorët. Ligjet e natyrës ne duhet t'i njohim, se shkelja e një ligji bëhet shkak për pasoja të dëmshme. U tha këtu se nevojitet gjithë ai bar i thatë, mirëpo, për ta siguruar atë, nuk duhen lejuar bagëtitë e imëta të venë të hanë gjithë barin e njomë në livadh ose në bjeshkë. Pra, po të na nevojitet bar i thatë për njëthundrakët, atëherë duhet menduar se ku do t'u sigurohet ushqimi bagëtitë të imëta. Ju, shokë të Ministrisë së Bujqësisë, mund të thoni se barin e thatë do ta marrim nga mali, po a keni menduar se si mund të shfrytëzohet mali në mënyrë shkencore? Si njerëz të shkencës, ju, duhet të mendoni edhe për brezat e ardhshëm dhe të mos lejoni që në male të kullotin tufa të mëdha ba-

gëtish, që kanë barin deri në rrënjë, duke penguar zhvillimin bimor. Bimësia dhe pyllëzimi i maleve ruajnë luginat dhe fushat nga erozioni, rregullojnë rezervat dhe regjimin ujqor etj., të cilët luajnë një rol vendimtar në bujqësi. Prandaj, kur marrim disa vendime që kanë rëndësi të madhe për socializmin, nevojat urgjente duhet t'i zgjidhim në rrugë të drejtë dhe duke pasur parasysh perspektivën, në mënyrë që këto vendime jo vetëm të mos na mbeten në letër, por, njëkohësisht, të mos dëmtojnë edhe harmoninë e bujqësisë.

Përdorimi i plehut kimik, për shembull, dihet që shton rendimentin e bimëve bujqësore, por hedhja e tij jashtë mase bëhet i padobishëm për bimët. E njëjta gjë duhet thënë edhe për herbicidet. Nga përdorimi jashtë mase i herbicideve, bota kapitaliste sot është e alarmuar për shëndetin e kafshëve dhe të bimëve, sepse zogjtë kanë filluar të bëhen sterilë dhe insektet e dëmshme, në luftën e tyre për ekzistencë, fitojnë imunitet.

Më parë toka jonë nuk ka qenë e shfrytëzuar në thellësi, por në sipërfaqe. Shfrytëzimi i tokës në thellësi të mëdha, për të marrë rendimente të larta në prodhimet bujqësore, e varfëron atë, kështu që ne do të mendojmë për pasurimin e saj, por duke pasur parasysh që ky pasurim të bëhet duke përdorur në një raport të drejtë plehun organik dhe plehun kimik. Nga gjendja që jemi të mos bëhemi neofitë, të mos na zërë ethja e modernizimit dhe të lëmë pa zhvilluar më tej përvojën dhe praktikën popullore. Metodatat eksperimentale të popullit nuk mund t'i hedhim poshtë, kështu

që plehun kimik dhe herbicidet duhet t'i përdorim, por në doza të atilla që të mos dëmtohen mikroorganizmat e tokës, të cilët janë të nevojshëm.

Pra, këto të shikohen në kompleks dhe të mos vini e të na thoni se bari i thatë na duhet për një-thundrakët, ndërsa për të shtuar dhentë e dhinë duhet të prishen pyjet, ta bëjmë vendin fushë. Të gjitha këto të studiohen me kujdesin më të madh.

Ju duhet të studioni edhe perspektivën e këtyre kafshëve sipas zonave. Në zonat fushore, ku ka mundësi të bëhet transporti me mjete të mekanizuara, nuk del aq nevoja të rritim numrin e kuajve, por atje të luftojmë për shtimin e lopës dhe të drithërave të bukës. Kështu, atje ku ka mundësi që të rritim numrin e lopëve dhe prodhimin e drithërave, të shtojmë edhe mekanizimin e transportit, pa lënë pas dore edhe transportin me qetë e punës, kurse në vendet e tjera, ku nuk ka mundësi të bëhet kjo, të shtojmë numrin e njëthundrakëve.

Kur studiojmë gjendjen e njëthundrakëve dhe perspektivën e zhvillimit të tyre, duhet të mbajmë parasysh edhe nevojat për mbrojtjen e vendit. Në qoftë se flasim për mbrojtjen, kjo kërkon mushka e jo kuaj, kurse në këtë studim jepet mendimi për ta kufizuar numrin e mushkave. Krahas luftës për të rritur nivelin e jetesës së punonjësve, ne luftojmë e punojmë edhe për të forcuar mbrojtjen, prandaj do të na duhen më shumë bukë, vaj, çimento, veshje, mbathje e gjëra të tjera. Të gjithë këta interesa duhet të shikohen e të zhvillohen në harmoni dhe jo të shkëputur nga njëri-tjetri. Po të hartojmë një plan të tillë, që në fushë të

bëjmë një mekanizim më të madh për të rritur prodhimin e drithërave dhe në malësi të parashikojmë një rritje më të madhe të njëhundraçës, atëherë edhe kafshët do t'i kemi atje ku na duhen për çështjen e mbrojtjes.

Këtu pati një mendim, për t'u propozuar fshatarëve që t'ia dorëzojnë falas njëhundraçët kooperativës bujqësore. Në qoftë se bie dakord fshatari, mirë do të ishte që kali ose mushka e tij të bëhej pronë e kooperativës, por jam i mendimit që të zotit duhet t'i paguhet brenda një periudhe të caktuar. Kooperativa ka interes për këtë gjë, ashtu si edhe për lopën, por edhe fshatarët mbledhin mendjen, pse kooperativa do të marrë përsipër t'u shërbejë me pagesë për të gjitha nevojat që do të kenë. Mendoj se kjo është mënyra më e mirë që, sipas rasteve, këto kafshë të grumbullohen dhe të përdoren për interesin e përgjithshëm, por gjithnjë duke i sqaruar fshatarët.

Këto ishin disa vërejtje që kisha për studimin, të cilin mendoj se duhet ta rishikoni. Me këtë rast, desha të theksoj edhe një herë se për të gjitha problemet që shtrojmë dhe që kanë rëndësi të madhe për çështjen e socializmit, domethënë, për të tashmen dhe për të ardhmen e vendit tonë, duhet që kurrë të mos e largojmë vëmendjen nga faktori njeri, nga kujdesi për rritjen e mirëqenies së tij, sepse është ai që do të vërë në zbatim të gjitha këto direktiva të Partisë dhe do të ndërtojë socializmin. E them këtë, se kam përshtypjen që nuk shikohet mirë ky problem. Në të gjitha fazat e ndërtimit tonë socialist ne duhet të kemi parasysh që njeriu ynë socialist të punojë

sa të jetë e mundur më mirë e me rendiment të lartë, por atij t'i krijojmë edhe mundësi që lodhjen ta përballojë më lehtë. Lodhja fizike e njerëzve është një problem që duhet të na preokupojë, mirëpo ndodh që kësaj i vihet kujdesi më i fundit, aq sa, nganjëherë, nuk guxon njeri të thotë u lodha, se mund të quhet sikur nuk është revolucionar. Kjo nuk është e drejtë. Është fakt se, në përgjithësi, në shumicën dërrmuese, te të gjithë njerëzit ka një gatishmëri të madhe për punë, kështu që edhe lodhja e tyre është më e madhe, por forcat që konsumohen duhen zëvendësuar. Në qoftë se ne nuk marrim masa për të rritur mirëqenien e njerëzve dhe kulturën e tyre, për mënyrën e të ushqyerit, në atë shkallë që ata të kenë mundësi t'i zëvendësojnë energjitë që humbasin në punë, me ushqim të mjaftueshëm e të shumëllojshëm, atëherë, këtë çështje ne nuk e shikojmë drejt, por gabim, pra, nuk e shikojmë mirë faktorin kryesor, njeriun.

Ne na preokupon shumë problemi që popullit t'ia plotësojmë gjithnjë e më mirë nevojat me qumësht, me mish, me yndyrna, me zarzavate etj. Orientimet janë dhënë, por duhet punuar seriozisht për zbatimin e tyre.

Për sa i përket zhvillimit të lopës, ne duhet të ecim në mënyrë shkencore drejt përmirësimit racor dhe drejt shtimit të numrit të tyre në malësi e në fushë. Sasinë e qumështit, të gjalpit e të djathit që nevojitet nuk mund ta sigurojmë vetëm me bagëtitë e imëta, por të luftojmë që, në një të ardhme të afërt, nga lopët në fushë dhe në malësi të marrim

rezultate më të larta. Kështu do të plotësohen më mirë nevojat e popullit. Por, për të marrë më shumë sasi qumështi nga lopët në fushë, duhet të sigurohet edhe baza ushqimore e nevojshme. Kjo kërkon që atje ku kemi tokat më pjellore të zbatohet agroteknika në mënyrë të përsosur. Pastaj, nga shtimi i lopëve varren shumë edhe gjithë prodhimet e tjera bujqësore, në radhë të parë, shtimi i drithërave. Me gjithë përparimet që kemi bërë, akoma shumë njerëz nuk e kanë kuptuar rëndësinë që ka zhvillimi i lopës, prandaj duhet bërë një luftë e madhe për këtë problem, që, në radhë të parë, ta kuptojë mirë fshatarësia e të mobilizohet për të arritur parashikimet e caktuara nga Byroja Politike.

Shtimi i blegtorisë, e sidomos i lopës, të na çojë edhe në sigurimin e sasive të nevojshme të yndyrnave e të mishit, për të vënë në vend energjinë e madhe të këtij populli heroik që punon, lodhet dhe konsumon forcat e tij fizike për të ndërtuar socializmin. Ishte një kohë që ne i siguronim yndyrnat nga jashtë dhe u desh të luftojmë kundër pikëpamjeve frenuese për çështjen e lulediellit, derisa filloi të mbillet në sipërfaqe më të gjera, por përsëri ne kemi mungesë yndyrnash, prandaj nuk mund të ecim mëngadalë. Popullit duhet t'i sigurojmë ushqimin e nevojshëm.

Specialistët e blegtorisë ta studiojnë seriozisht çështjen se si do të arrijmë ta sigurojmë në vend gjithë sasinë e mishit që na duhet. Udhëzimet që janë dhënë për të shtuar numrin e krerëve në lopë, në dhen etj., duhet të çojnë në zbatimin e porosive për të

shtuar sasinë e mishit që do të hedhim në treg. Janë dhënë urdhra të mos theret viçi femër se do ta rritim që të na bëhet lopë, të mos theret viçi mashkull se do të na bëhet ka, të mos theren qengjat e kecat femra se duam të shtojmë bagëtitë e imëta, kurse lopën ta therim atëherë kur ajo nuk pjell më e nuk jep më qumësht, por këta urdhra duhet të zbatohen në mënyrë të studiuar, shkallë-shkallë, duke u bazuar në disa kritere shkencore, ndryshe do të thotë të mos hash as mish viçi, as mish lope, as mish qengji e keci, derisa të plotësohet numri i krerëve që është caktuar. Zbatimi i orientimeve të Partisë, për shtimin e numrit të blegtorisë, për shtimin e mishit, të qumështit etj., kërkon që specialisti i blegtorisë ta thotë me kompetencë fjalën e tij sa viça, sa qengja etj., i duhen për ripërtëritjen e tufave, duke pasur parasysh perspektivën në shtimin e krerëve e në përmirësimin e racës dhe sa do të therë; sa kohë do ta mbajë lopën ose delen në prodhimitari e kur do ta zëvendësojë, që të dimë në çdo kohë se ç'sasi mishi do të hedhim në treg e ç'masa do të marrim. Ne duhet të tregojmë një kujdes më të madh edhe për të shtuar prodhimin e mishit të dërrit. Na thuhet se ka njerëz që nuk e hanë këtë mish. Natyrisht, atij që nuk e ha nuk do t'ia japim me pahir, por ne duhet të bëjmë një politikë të tillë që edhe ai të bindet dhe ta përdorë mishin dhe dhjamin e dërrit, se është i mirë, i shëndetshëm e me kalori. Kryesorja është se nuk po realizohet plani në rritjen e dërrit dhe se mishi i tij po vazhdon të prodhohet me kosto të lartë e jo se nuk e pëlqejnë konsumatorët. Kurse mishi i pulës është bërë si dikur, kur ai që e

hante ishte zengjin i madh. Pra, mish pule duhet të hidhet më shumë në treg dhe të jetë më i lirë. Pikërisht në këtë situatë, kur ne kërkojmë të rritim vëçat, të shtojmë lopët, të rritim njëhundrakët, nuk tregohet kujdes për të shtuar pulat. Kemi mbetur me një inkubator, në vend që të kishim disa e të mbushnim tregun me pula e me vezë për punonjësit. Prandaj të synojmë ta shtojmë shumë numrin e pulave dhe të arrijmë që mishin e tyre ta prodhojmë me çmim më të ulët se mishin e kafshëve. Kështu të ruajmë edhe lopët, që të mos i therrim për mish para kohe.

Kujdes të tregojmë edhe për bagëtitë e kooperativistit. Ai ka të drejtë të bëjë ç'të dojë me to, por ne e kemi për detyrë ta këshillojmë se si mund t'i përdorë më mirë për nevojat e familjes së tij, për t'i ushqyer kalamanët me qumësht, me djathë e me mish, se për këtë qëllim i janë lënë.

Si një vend me mundësi të mëdha për zhvillimin e blegtorisë, neve nuk duhet të na mungojë mishi e djathi. Kiço Ngjelës nuk i lejohet të vijë e të thotë se jemi keq me djathin dhe më vë pyetjen si do të dalim në dimër.

Po pa perime mund të rrohet?

Në qoftë se Partia dhe pushteti nuk e ngrenë çështjen e perimeve si një nga problemet më të rëndësishme për shëndetin e njerëzve, atëherë, nuk njohin si duhet natyrën e njeriut, sepse perimet janë të një rëndësie të veçantë për të ushqyer trurin, gjakun, muskujt, kockat, me një fjalë, për të gjithë zhvillimin e organizmit. Perimet përbëhen prej një kompleksi lën-

dësh të ndryshme, të cilat mbajnë gjallë jetën e njeriut, kurse fshatari punon e lodhet për t'i prodhuar domaten, piperkën, patëllxhanin e zarzavatet e tjera dhe nuk ua di vlerën. Ne duhet të bëjmë që fshatarët t'i njohin të gjitha llojet e zarzavateve dhe t'i bindim se ato janë një ushqim i domosdoshëm për njeriun. Për këtë çështje është mbajtur edhe një plenum i veçantë i Komitetit Qendror të Partisë, por kjo nuk zgjidhet vetëm me vendime nga lart, në qoftë se nuk e marrin në dorë seriozisht Partia dhe pushteti në bazë.

Në rrethe mbjellja e domates është bërë një çështje tregtare, vetëm për ta dërguar jashtë shtetit. Në tregun e jashtëm do të shesim, kjo është e domosdoshme, por, në radhë të parë, domatja duhet prodhuar për popullin dhe të bëjmë që të përdoret edhe në ato zona që nuk e kanë në traditën e tyre përdorimin e disa llojeve të perimeve. Kooperativisti i Dukajt i prodhon domatet, por atje nuk konsumohen dhe dërgohen në Gjirokastër, domethënë, kjo çështje shikohet nga ana tregtare. Mund të na thuhet se, po të kërkojmë të rritet konsumi i zarzavateve në qytet e në fshat, nuk i përballojmë dot kërkesat me aq sa prodhojmë. Po kush ju ka ndaluar ju, shokë të rretheve, të merrni një iniciativë të tillë për të shtuar prodhimin e zarzavateve në kooperativat bujqësore? Ne flasim për luftën kundër shfaqjeve të burokratizmit, por ndaj këtij problemi mbahet qëndrim burokratik, nuk shikohet drejt as nga ana ekonomike, as nga ana politike. Prandaj Partia dhe pushteti në rreth duhet të studiojnë me vëmendje të madhe se sa perime nevojitet të

mbjellë çdo kooperativë për frymë, sa tokë duhet për mbjelljen e tyre e jo të interesohen vetëm për misrin e për grurin, sepse njeriu vetëm me bukë nuk mund të rrojë. Tani nuk jemi në gjendjen e 20 vjetëve të parë, kur mendonim si t'i siguronim fshatarit bukën dhe dy kokrra fasule.

Këto, shokë, janë probleme të mëdha shoqërore, të cilat duhet t'i shikojmë mirë. Njeriu është ai që i realizon të gjitha planet e detyrat madhështore, prandaj për njeriun të mendohet në radhë të parë, se edhe planet e detyrat në socializëm kanë në themel interesin jetik të popullit. Shokët e rretheve duhet të kenë më shumë iniciativë për këto gjëra.

Vitin e ardhshëm ne festojmë 25-vjetorin e Çlirimit. Natyrisht, në krahasim me të kaluarën, gjendja ka ndryshuar si nata me ditën, por, me këtë nivel zhvillimi që është arritur, kemi më shumë mundësi për t'i kapërcyer mungesat e punës sonë.

Prandaj edhe studimin që na është paraqitur, edhe të gjitha planet tona të perspektivës është e nevojshme t'i shikojmë në funksion të njeriut, sepse gjatë kësaj perspektive ai që do të punojë është njeriu dhe njeriu ynë është i gatshëm, revolucionar, por këtij duhet t'i krijojmë edhe konditat dhe, që t'ia krijojmë këto, duhet të mendojmë më mirë.

Atëherë, këtë çështje ta rishikoni. Mund të bisedoni më parë me shokun Hysni dhe me shokët e tjerë, pastaj t'ia paraqitni Qeverisë.

Për sa i përket pjesës së dytë të projektvendimit, që bën fjalë për prodhimin e karrove dhe të qerreve,

kjo nuk duhej t'i vinte fare Byrosë Politike. Për këtë çështje janë marrë vendimet e nevojshme dhe ato duhet të zbatohen.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

TRADITAT DHE AFTËSITË KRIJUESE TË POPULLIT T'I PËRDORIM MIRË EDHE PËR PRODHIMET E ARTIZANATIT

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

10 qershor 1968

Kisha për të pyetur shokët sekretarë të komiteve të Partisë të rretheve, që janë në këtë mbledhje: Nuk kemi ne në popullin tonë të mrekullueshëm dhe të zgjuar njerëz me shumë kapacitete, që mund të bëjnë punime të artizanatit? Kemi, bile plot. Atëherë përse prisni që çdo gjë t'jua sjellin industria dhe tregtia nga qendra? Mos kemi ne një industri kaq të përparuar sa të shkelim sustën dhe të prodhojmë çdo gjë? Kështu, duke pritur ç'do të sjellin të tjerët, nuk përmbushen nevojat e popullit. Populli vetë nuk mund të bëjë bucela, masha, furka, stromë, jorganë,

¹ Në këtë mbledhje u diskutua për plotësimin e detyrës për zhvillimin e mëtejshëm të artizanatit dhe të punishteve industriale, për përpunimin e prodhimeve bujqësore e blegtorale në kooperativat bujqësore, që caktoi Plenumi i 3-të i KQ të PPSH mbajtur më 13-14 tetor 1967.

mindere e shumë gjëra të tjera të thjeshta, që i duhen në jetën e përditshme? Ai çdo gjë mund të bëjë, por zotësinë e tij të madhe e lëmë të fjetur, pse mendohet që të gjitha do të bëhen nga industria, prandaj vihet këtu, në Komitetin Qendror e në Qeveri, me propozime që të merren vendime nga lart.

Sigurisht që vendime janë marrë e shumë gjëra janë bërë, por në vendimet e Partisë janë pasur kurdoherë parasysh edhe mundësitë që ka vetë populli për të përdorur traditën e mirë edhe për prodhimet e artizanatit. Kërkesat e tij janë kaq të mëdha, sa që nuk mund të përballohen kështu siç po ecet. Ju kënaqeni me dhjetë vajza e gra që dërgoni për të mësuar në kurse, po harroni që ka me mijëra të tjera që u zë dora dhe bëjnë gjëra jashtëzakonisht të bukura. Në fshat qepen jorganë e jastëkë, të cilët s'janë asgjë përpara qëndismave që bëhen atje e, megjithatë, nuk merret asnjë iniciativë për ta organizuar këtë punë, që të përmbushen nevojat e popullit, por vetëm kërkoni t'jua sjellë tregtia gati.

Kryesia e kooperativës bujqësore mund të caktojë katër-pesë gra, që dinë të qepin jorganë, stromë dhe mindere, të cilat të punojnë me ditë-punë për t'u plotësuar nevojat fshatarëve për këto shërbime shtëpie. Në rast se në fshat nuk ka gra që dinë të bëjnë mindere, kooperativa le të kërkojë të vijë një grua nga qyteti që të qëndrojë disa ditë për t'i mësuar ato që do të merren me prodhimin e tyre. Gratë që do të merren me këtë punë, pasi të njihen me kërkesat, të bëjnë llogari sa metro pëlhurë duhen për jorganët, për stromë dhe për minderet, sa pambuk duhet etj. Në

qoftë se nuk ka pambuk të mjaftueshëm, vendoset që munderet të bëhen me bar ose me lëvozhga misri, kurse jorganët të bëhen me pambuk ose me lecka. Kështu, i kërkohet tregtisë ta furnizojë fshatin me pëlhurë, me lecka, me pambuk dhe me spango. Edhe rrogizat janë një artikull shumë i nevojshëm, mirëpo ata prodhohen sot pothuajse vetëm për t'i shitur jashtë dhe për të mbështjellë duhanin, kurse shumë pak prodhohen për nevojat e fshatarësisë. Po kështu, mund të sjellim si shembull mjaft artikuj të tjerë të nevojshëm, të cilët mund të prodhohen edhe nga industria, edhe në forma artizanale.

Partia ka orientuar që të punojmë për të rritur shkallën e kulturës në mënyrën e jetesës, për t'i bërë edukatë të përgjithshme rregullin e pastërtinë dhe të gjithë duhet të mendojmë se si t'i zbatojmë këto orientime. Në këtë çështje edhe tregtia të bëjë një punë të studiuar. Ne e mësojmë fshatarin ta përdorë sapunin në sasi më të madhe, mirëpo edhe dyqani i fshatit duhet të furnizohet me sasi më të mëdha sapuni. Në qoftë se fshatari nuk do t'i gjejë në dyqan sendet e nevojshme, nuk ka se si t'i zbatojë ato që i thuhet për mënyrën e jetesës. Kur isha në rrethin e Mirditës vajta në familjen e një mirditori, që përbëhej prej tri kurorësh. I pyeta edhe për të ardhurat që merrnin dhe krijova bindjen se ata kishin mundësi ta pajisnin shtëpinë shumë më mirë nga ç'e kishin. Sikur t'u thoshja atyre se duhej të kishin në shtëpi këto e këto gjëra, ata, që të nesërmen, do të shkonin në dyqan dhe do të kërkonin t'i blinin, por nuk u thashë, se e dija që nuk do t'i gjenin. Këtu duhet të nxjerrin për-

gjegjësitë e veta edhe industria e tregtia, që nuk i studiojnë mirë kërkesat e nuk i ballafaqojnë me mundësitë dhe të dalin me konkluzione se ç'duhet bërë, por kanë përgjegjësi edhe këshillat popullorë të fshatrave, të cilët nuk po i përdorin mirë rezervat që kanë si në aftësitë krijuese të popullit, ashtu edhe në mjetet rrethanore. Kooperativat bujqësore të rrethit të Durrësit venë në Mirditë për të prerë qerestenë që u duhet, kurse kooperativat bujqësore të Mirditës nuk interesohen të ngrenë sharra dhe të bëjnë vetë shtretër, tavolina dhe karrige për kooperativistët. Në qoftë se fshatarëve u thuhet që të pajisen me krevate prej hekuri dhe presin sa t'u sigurohen këto, s'kemi bërë gjëkafshë, ndërsa po të marrim masa që fshatarët të bëjnë shtretër prej druri, atëherë kemi bërë një punë të mirë.

Më parë Labëria çonte djathë edhe në rrethe të tjera, kurse sot kooperativat bujqësore nuk kanë vegla pune për të prodhuar djathin. Po ku i gjenin më parë fshatarët këto mjete? Çdo familje kishte kazanin, bucelat dhe napat e saj, bagëtitë i kulloste vetë, djathin e bënte vetë dhe, më në fund, merrte mushkën dhe shkonte e ua shiste gjirokastritëve. Tani këto janë zhdukur të gjitha dhe presin pajisjet moderne për të prodhuar djathin e kooperativës.

Për banorët e zonave malore të tregojmë kujdes që të mos u mungojnë rrobat e leshta. Kjo çështje duhet parë që te plani që u caktohet atyre për dorëzimin e leshit, e deri te mundësitë që ka tregtia për t'i furnizuar me rroba të leshta. Në qoftë se tregtia nuk ka mundësi t'u dërgojë rroba e çorape të leshta, ne nuk mund t'i lëmë njerëzit të na sëmuren

nga të ftohtit, prandaj nuk do të kërkojmë që ata të dorëzojnë të gjithë sasinë e leshit, por t'u themi që për dimër të bëjnë triko dhe çorape të leshta e të gjata gjer në gju, po të duan edhe të qendisura bukur.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

ZHVILLIMI I DREJTË I LUFTËS SË KLASAVE KËRKON PJEKURI DHE PARTISHMËRI TË LARTË

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

11 qershor 1968

Kjo çështje, që po diskutojmë, është me shumë interes. Politika që ndjek Partia në zhvillimin e luftës së klasave mbetet një nga çështjet më të rëndësishme e më delikate, e cila, për t'u zbatuar drejt, kërkon pjekuri, vigjilencë dhe partishmëri të lartë. Orientimet që janë dhënë herë pas here, se si duhet zhvilluar pa lëkundje e me konsekuencë kjo luftë, se kur duhet mbajtur qëndrim i prerë e kur duhet mbajtur qëndrim i diferencuar, por pa rënë as në sektarizëm, as në oportunizëm, kanë qenë e mbeten mësim të qarta, me shumë vlerë.

Mirëpo në jetë vëmë re edhe qëndrime sektare, edhe qëndrime të lëkundshme në zbatimin e vijës së

¹ Në këtë mbledhje u diskutua për disa probleme që dalin në zbatimin e politikës së Partisë për luftën e klasave.

Partisë për anëtarësinë në Front dhe për punën me elementët pa kartë fronti. Djali i kulakut gjithë jetën kulak do të mbetet? Pastaj, fëmijët e kulakut do të lindin fëmijë dhe këta përsëri kulakë do të mbeten? Kështu na mëson marksizëm-leninizmi? Kjo është rruga e Partisë? Këto çështje Partia i ka përcaktuar me kohë, drejt dhe qartë, por, ashtu siç veprojnë disa shokë komunistë në bazë, duke zgjedhur rrugën më të lehtë, është gabim. Kur djali i kulakut sillet mirë e merr pjesë në aksione, kur nuk flet asnjëherë një fjalë të keqe, me një fjalë, kur është korrekt me vijën e Partisë, pse duhet të lihet jashtë organizatës së Frontit?

Partia kurdoherë ka dhënë orientime të qarta që me këta njerëz të punojmë për t'i edukuar e për t'i tërhequr në rrugën e saj. Me këtë synim duhet të veprojmë në praktikë çdo komunist, por, nga ana tjetër, të jetë kurdoherë vigjilent në kulm për të mbrojtur vijën e Partisë, interesat e popullit dhe të atdheut. Organizatat e Partisë, dhe, nën udhëheqjen e tyre, organizatat e Frontit, të rinisë dhe të gruas duhet ta zbatojnë me dinamikë këtë parim; në çdo rast konkret të bëjnë dallimin e çdo elementi, në bazë të qëndrimit politik personal dhe të punës së tij. Në qoftë se një element i dyshimtë nuk korrigjohet, me gjithë përpjekjet që kanë bërë organizatat e Partisë, të Frontit dhe organizatat e tjera të masave me të, atëherë ndaj tij duhet të mbahet qëndrim dhe, kur ai zhvillon veprimtari armiqësore, do të veprojnë ligjet e diktaturës së proletariatit.

Politika e Partisë është e tillë që edhe me elemen-

tët e dënuar me heqje lirie për veprimtari me rrezikshmëri shoqërore bëhet punë e gjithanshme edukative dhe, nganjëherë kur krijohet bindje se i dënuari është korrigjuar, lejohet të rikthehet përsëri në jetën normale në shoqëri, të futet në një punë, edhe para se të ketë shlyer të gjithë afatin e dënimit. Shoqëria kujdeset, në çdo kohë, që këtë ta ndihmojë të edukohet me normat politiko-morale të shoqërisë sonë socialiste, me qëllim që të punojë mirë, të rehabilitohet dhe të mos futet përsëri në rrugë armiqësore. Po e shpëtuam një njeri të tillë nga vazhdimi i rrugës së keqe, kemi bërë një gjë të mirë. Në qoftë se ai nuk korrigjohet, me gjithë ndihmën e dhënë e me kujdesin e treguar, përsëri kundër tij veprojnë organet e diktaturës së proletariatit. Shoqëria socialiste i krijon të gjitha mundësitë për të shlyer fajin, për të punuar e për të jetuar me nder, por nuk lejon në asnjë mënyrë të dëmtohen interesat e saj.

Në çështjen e qëndrimit ndaj kulakëve në fshat, në disa raste, shihen paqartësi e qëndrime të lëkundshme. Në këto raste, vija e Partisë ndaj tyre zbatohet në mënyrë të ngurtë, çështja shihet nga ana më e lehtë, prandaj kalohet në veprime e në qëndrime zakonisht sektare.

Kur u dha orientimi që kulakët të rikthehen nga qyteti në fshat, Partia pati për qëllim që këta njerëz të dërgohen atje për të qenë nën kontrollin shoqëror të fshatit e të organizatave të Partisë, sepse atje fshati i njeh më mirë nga sa i njihnin punëtorët e ndërtimit ose të fabrikave ku punonin, të cilët nuk ua dinin të kaluarën, se ç'kanë qenë e ç'kanë bërë. Ajo që vendo-

sëm, pra, ishte një masë e drejtë, pse këtyre kulakëve, duke qenë midis njerëzve të njohur, me punën edukative, me ndihmën e opinionit shoqëror që i njeh më mirë, do t'u jepej mundësia që të shkonin drejt përmirësimit. Këtë gjë duhet ta kuptojnë mirë organizatat e Partisë në fshat, organizatat e Frontit dhe komitetet e Partisë në rrethe, me qëllim që të mos kalohet as në sektarizëm, as në oportunizëm në qëndrimin ndaj tyre. Do të ishte e gabuar po të fillonte demaskimi i një kulaku pas rikthimit në fshat, në qoftë se ai punon e sillet mirë, por as të mos e vëmë mbi kokë, ngaqë ka punuar disa vjet si punëtor dhe, tani që u kthye në fshat, të mos quhet më i tillë, se na u bë «proletar».

Ta demaskosh kulakun në një kohë që nuk ke fakte se zhvillon veprimtari politike kundër Partisë e pushtetit, s'ka dyshim se do ta egërsosh më tepër dhe, në këtë rast, ai do t'i thotë djalit të vet: «Edhe ti më kot përpiqesh të punosh e të sillesh mirë, se njësoj si mua do të të trajtojnë». Por nuk është e drejtë, gjithashtu, që, sapo të kthehet në fshat, të pranohet menjëherë në organizatën e Frontit dhe të bëhet anëtar i kooperativës bujqësore. Jo, ai duhet të japë prova për t'i fituar këto të drejta. Butësia, në raste të tilla, tregon për ulje të vigjilencës, tregon se nuk është kuptuar drejt politika e Partisë dhe kjo hap rrugë për qëndrime të tjera oportuniste, aq sa tjetri merr pjesë si pa të keq në davetet që bën kulaku, ose lidh krushqi me të. Kjo mungesë vigjilence e këto qëndrime oportuniste janë me pasoja të rënda për diktaturën e proletariatit, prandaj nuk duhen lejuar. Çdo elementi,

me qëndrim jo të mirë politik, do t'i japim të gjithë ndihmën e nevojshme për t'u korrigjuar, por gjithmonë duke e pasur nën kontroll të rreptë, që të mos i lëmë asnjë mundësi për të na dëmtuar.

Partia në rreth dhe në fshat duhet të tregohet e zgjuar në punën që do të bëjë me kulakun. Organizatat e Partisë duhet të shikojnë me kujdes rrezikshmërinë e cilitdo element prej tyre dhe të mos bien në pozitë e interpretimit të gabuar të vijës së Partisë, siç e shpjegoi drejt shoku Hysni, sepse ndonjë komunist e ka më të lehtë të thotë: «Mos bisedo me kulakun», sesa të gjykojë thellë se si duhet të veprojë për të mbrojtur vijën e Partisë. Sekretari i organizatës-bazë të veprojë në çdo rast me pjekuri e me guxim dhe jo të mos merret fare me kulakun nga frika se mos e kritikojnë për oportunizëm. Të kuptohet drejt që sekretari i organizatës-bazë, në rrugë partie, mund të bisedojë me kulakun, por elementi oportunist të mos e interpretojë këtë ashtu siç ia do zemra atij dhe të shkojë te kulaku ditë e natë.

Ne kemi thënë se këta njerëz do të rrojnë në fshat, pse atje kanë shtëpinë dhe, sot ose nesër, do të punojnë bashkë në një brigadë me kooperativistët e tjerë e jo në mënyrë të izoluar, prandaj komunistët dhe anëtarët e brigadës duhet të bëjnë punë politike për t'i riedukuar ata që mund të riedukohen, me qëllim që, po të jetë e mundur, të ndryshojnë për të mirë, përndryshe, po vazhduan në rrugën armiqësore, Partia dhe populli aty janë.

Kulaku duhet të thirret në mbledhjet e Frontit, megjithëse nuk është anëtar i organizatës, që të dëgjojë

ç'thotë kolektivi, sepse kështu do të ndihmohet të ndryshojë ndërgjegjen politike e të riedukohet dhe, kur ka veprimtari armiqësore, ta ndiejë veten përgjegjës përpara opinionit shoqëror. Ndonjëri mund të thotë se nuk është mirë që kulaku të dëgjojë, për shembull, kritikën që mund t'i bëhet kryetarit të kooperativës. Vallë, nuk e merr vesh ai, jashtë mbledhjes, kur kritikohet kryetari? Në qoftë se ai fillon të veprojë kundër kryetarit që u kritikua, atëherë ne kemi të drejtë të themi se kulaku jo vetëm nuk po përmirësohet, por, përkundrazi, po vepron me qëllim armiqësor dhe marrim masa represive kundër tij.

Partia na mëson se mbledhjet e Frontit, duke zhvilluar kritikën parimore ndaj kujtdo, bëhen një shkollë e madhe e masave, prandaj edhe personi që nuk ka kartën e Frontit, kur të shohë kritikën e hapur që bëjnë masat ndaj kryesisë, kryetarit të kooperativës ose ndonjë tjetri, do të fillojë të mendojë ndryshe, se aty në Front anëtarët e organizatës kritikojnë me guxim cilindo, prandaj do të reflektojë për punën dhe për vijën e drejtë të Partisë, do të riedukohet, në qoftë se te ky njeri ka një fije mundësie shpëtimi. Sidoqoftë, Partia duhet të përpiqet që kulakët dhe elementët e lëkundur të paktën t'i neutralizojë dhe të mos i lërë të hidhen në veprimtari armiqësore kundër Partisë dhe pushtetit popullor.

Thirrja e kulakut në mbledhje, pra, bën përshtypje në mendjen e tij prej borgjezi dhe, në qoftë se ky qëndrim nuk ndikon që të edukohet ai vetë, të paktën do të ndikojë që të fillojë të mendojë për fëmijët e tij, do të thotë se për vete e piu lëngun, prandaj të mos i

nxitë fëmijët që të futen në rrugë armiqësore, në luftë me këtë Parti dhe me këtë pushtet, pse ata këtu do të rrojnë. Kështu, puna edukative e Partisë mund të ndikojë në njëfarë mënyre në pjesëtarët e familjes.

Të vijnë tani te bijat dhe bijtë e kulakëve. Organizatat e Partisë dhe ato të Frontit të tregohen më të kujdesshme e të jenë më zemërgjera, sepse tek ata duhet të kemi më shumë shpresa për t'u rehabilituar, sesa te prindërit e tyre. Edhe kur një djalë kulaku ka bërë pjesë në organizatën e rinisë dhe tani që ka mbushur moshën nuk është më në këtë organizatë, nuk ka arsye që atij të mos i jepet karta e Frontit, në qoftë se kjo kartë nuk i është dhënë që kur ishte në organizatën e rinisë. Qëndrime të tilla tregojnë se nuk është kuptuar mirë vija e Partisë për Frontin dhe kjo dëmtton shumë, sepse ky i ri do të mendojë: «Si është e mundur që gjer tani unë isha i mirë, anëtar i organizatës së rinisë, kam shkuar në aksione dhe tani nuk më pranojnë në Front?». Një pjesë e mirë e bijve të kulakëve na thuhet se prej kohësh janë anëtarë të organizatës së rinisë, punojnë mirë në kooperativa, kurse në Front ata nuk pranohen, kryesitë e organizatave të Frontit ngurrojnë t'i shqyrtojnë kërkesat e tyre. Po, kur janë të tillë, përse të mos pranohen? Përse nuk i thërresin ata në kohën e pushimit kur lexohet gazeta? Ose përse të mos lejohen të punojnë në brigada së bashku me kooperativistët e tjerë? Mua më duket se këto qëndrime mbahen nga shokë që kanë lëkundje dhe mendojnë: «Më mirë të më kritikojnë për sektarizëm, sesa për oportunizëm». Por këta shokë harrojnë se edhe sektarizmi është oportunizëm. Veprime të tilla, të

pamenduara nuk i tërheqin këta elementë në rrugën tonë. Me këta duhet punuar e u duhet shpjeguar gjithçka. Në qoftë se babai ose një tjetër nga fisi i tij ka kryer veprime politike kundër pushtetit popullor dhe atdheut, ne do t'u themi fëmijëve dhe të afërmeve të tij se ai është armik, po Partia nuk ju përziën ju me të, meqë edhe ju e keni dënuar si armik. Kështu, me sjelljet tona të drejta politike, duke u folur vazhdimisht, ne do të arrijmë t'i thyejmë dhe ata vetë do të thonë me gojën e tyre se, njerëzit e Partisë, ne nuk na kanë izoluar për shkak të tij, po na pranojnë në kooperativë, na thërresin në mbledhje e na futin në Front, na marrin në aksione, na pranojnë në radhët e organizatës së rinisë, prandaj në djall të vejë ai që deshi t'i sillte dëm kësaj Partie. Pra, organizata e Partisë dhe ato të masave duhet të punojnë me këta elementë që të paktën t'i neutralizojnë dhe, kur është e mundur, të përpiqen t'i bëjnë njerëz të mirë e të ndershëm.

Të marrim edhe çështjen e martesës. Mund të ndodhë ndonjë rast që, një vajzë kulaku, e cila është edhe në organizatën e rinisë, për arsye se ka dhënë prova dhe është e vendosur në rrugën e Partisë, shkon në aksione dhe është punëtore e mirë, në punë e sipër dashurohet me një të ri dhe martohet me të. Në këtë rast, ne nuk do ta vrasim të riun, pse u martua me këtë vajzë, por as nuk do t'u rekomandojmë të rinjve të tjerë që të martohen me vajza kulakësh. Kjo që ngjau është një rast dhe të mbetet me kaq, të kuptohet e të interpretohet drejt dhe jo të bëhet vijë që të rinjtë e familjeve të mira e patriote të na martohen me bijat e kulakëve, ndryshe do të shkonim në anën tjetër,

në oportunitizëm. Duhet të kemi parasysh se kulakët do të përpiqen që të lidhin krushqi edhe me vetë sekretarin e organizatës-bazë të Partisë ose me kryetarin e kooperativës, por prindi ta edukojë fëmijën në atë mënyrë që ai, kur të rritet, të dijë ta zgjedhë me kujdes nga çdo pikëpamje shokun ose shoqen e jetës.

Me këto që përmenda nuk thashë asgjë të re. E tillë, shumë e drejtë ka qenë dhe është vija e Partisë. Natyrisht, nuk është e domosdoshme që komunisti t'i vejë kulakut në shtëpi, të hajë e të pijë me të etj., por sekretari i organizatës-bazë të Partisë mund edhe t'i vejë në shtëpi në një moment të caktuar, për shembull, kur e sheh se ai ka filluar të ndërrojë rrugën, të përmirësohet, dhe ky është një sinjal për kulakun, që s'ka bërë gjë të keqe. Në një mbledhje të Frontit sekretari edhe mund të flasë për qëndrimin e mirë që ka mbajtur kulaku prej disa vitesh, vë në dijeni masën se i bëri një vizitë, sepse organizata e Partisë mendon që ai ka ardhur në rrugë të mirë dhe kërkon nga kjo mbledhje, nëse është dakord, që të mos cilësohet më si kulak. Kur ai e meriton me të vërtetë këtë trajtim, populli shprehët dakord dhe ky është momenti i kthesës së madhe për kulakun.

Pra, duhen kuptuar drejt çështjet. Kjo vijë ka qenë kurdoherë kështu, çështja është që ajo të zbatohet gjithnjë drejt.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

KUSHTET E JETESËS SË PUNËTORËVE TË SHIKOJMË ME KUJDES TË VEÇANTË

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

11 qershor 1968

Para se të diskutonte, shoku Enver Hoxha bëri një bisedë të ngrohtë me punëtorë, specialistë e kuadro, që ishin thirrur për të raportuar, të cilët i pyeti në mënyrë të veçantë për kushtet e jetesës së punëtorëve e të specialistëve në ndërmarrjet e tyre. Pastaj vazhdoi:

Besoj se shokët sekretarë të komiteteve të Partisë të rretheve Kukës dhe Mirditë janë të kënaqur nga paraqitja që bënë shokët e bazës dhe s'kanë ç'të thonë më tepër. Kjo tregon se Partia atje ka punuar mirë dhe nga gjiri i klasës punëtore ka përgatitur kuadro që i shikojnë shumë mirë punët e Partisë dhe të prodhimit. Tani na mbetet neve të themi ndonjë fjalë.

1 Në këtë mbledhje u diskutua për punën e organizatave të Partisë në ndërmarrjet e nxjerrjes dhe të përpunimit të bakrit në rrethin e Mirditës e të Kukësit për tejkalimin e detyrave të planit për vitin 1968.

Para pak ditësh isha në rrethin e Mirditës. Atje vizitova Rubikun dhe Kurbneshin¹, mora kontakt me minatorët e me metalurgët, me shokët e Partisë dhe të pushtetit dhe mund t'ju them se përshtypjet e mia kanë jashtëzakonisht të mira. Populli i Mirditës është me ndjenja të larta patriotike, është një popull me të vërtetë i mrekullueshëm, punëtor, i zgjuar dhe i lidhur ngushtë me Partinë.

Në përgjithësi, në Mirditë punohet shumë mirë, në radhë të parë, në minierat dhe në uzinat e përpunimit dhe të rafinimit të bakrit, por edhe bujqësia ka marrë një rrugë të mbarë. Edhe për minatorët e Kukësit më kanë folur shumë mirë shokë të udhëheqjes, që kanë qenë atje vazhdimisht. Raporti që na bënë këtu shokët sekretarë të organizatave-bazë të Partisë dhe inxhinierët e minierave, na njohu edhe më mirë me gjendjen e shëndoshë, që zotëron te punëtorët e minierave të Mirditës e të Kukësit, e cila vërtetohet nga qëndrimi i tyre parimor ndaj vijës së Partisë. Ky qëndrim parimor konkretizohet, në radhë të parë, me qëndrimin e lartë politik e me heroizmin që tregojnë ata për të kapërcyer vështirësitë e shumta e për të realizuar planet ekonomike.

Shokët e bazës na paraqitën këtu me kurajë kërkesat e tyre dhe bënë vërejtje për të metat e punës sonë. Ne duhet të shikojmë se cilat prej këtyre kërkesave duhen zgjidhur tani dhe cilat do të plotësohen në të ardhmen. Disa kërkesa të bazës janë zvarritur shumë nga organet shtetërore qendrore si rezultat i

1 Shih në këtë vëllim, f. 110, 149, 182.

veprimeve burokratike, prandaj mendoj se është e nevojshme t'i studiojmë me kujdes disa forma pune që kemi vendosur për t'u lidhur me punëtorët. Kur i vendosëm, menduam se këto janë të mira, por gjithë zhvillimi ynë revolucionar vërteton se u duhen bërë përsëri ndryshime. Te çdo formë pune që do të përdorin organet shtetërore për t'u lidhur me punëtorët të shikojnë, në radhë të parë, sa i shërben kjo kujdesit të veçantë të Partisë për klasën punëtoare. Partia ka treguar kurdoherë kujdes si për edukimin politik dhe ideologjik, ashtu edhe për jetën dhe për mirëqenien e popullit, por ka pasur raste që organet shtetërore i kanë neglizhuar detyrat që u dëjnë për të plotësuar si duhet kushtet e jetesës së njerëzve, të cilët bëjnë kaq përpjekje heroike për të realizuar planin dhe nuk ankohen për vështirësitë e mëdha që kalojnë.

T'i mësojmë punëtorët që të bëjnë vërejtje jo vetëm kur shohin se diçka nuk shkon mirë në realizimin e planit, por edhe kur nuk u plotësohet ndonjë kërkesë e drejtë për kushte më të mira jetese dhe ta dëgjojmë me kujdes zërin e tyre. Mua në Mirditë nuk më bënë shumë vërejtje dhe kërkesa, megjithëse jam i bindur që duhet të kishin edhe të tjera. Nganjëherë, kur shkoj në rrethe, shokët sikur përpiqen për të mos m'i treguar të gjitha hallet dhe nevojat e tyre. Ky është një veprim jo i mirë që duhet të luftohet, në radhë të parë, nga shokët punëtorë. Dëshira e merakut «për të mos e shqetësuar shokun Enver» duhen lënë mënjanë, pse unë duhet t'i di problemet e tyre. Në Rubik i pyeta shumë herë minatorët e metalurgët nëse i dëmton era e Fanit kur dalin të djersitur nga furra, por asnjë-

ri nuk m'u ankua. Në të vërtetë metalurgët atje kanë përpara zjarrin e fuqishëm të furrës, kurse nga prapa u bie murlani i grykës së Fanit. Dihet se, po të jesh i djersitur dhe i ekspozuar në korrente të ftohta të ajrit, shëndeti dëmtohet, por askujt nuk i ka vajtur në mendje që të ngrihet atje një mur për të pritur erën e ftohtë të Fanit dhe të mbrohen kështu metalurgët, që të mos sëmuren. Po t'u hedhësh një sy gjithë objekteve që kemi ndërtuar do të shikosh se rreth tyre janë ngritur mure si të kalasë, shpeshherë edhe atje ku s'është nevoja, kurse këtu, ku muri duhet për të mbrojtur shëndetin e punëtorëve, nuk është ngritur. Përse nuk bëhet një gjë e tillë? Sepse ata shokë që kanë shkuar nga qendra, bile edhe për probleme që kanë të bëjnë me shëndetin e punëtorëve, këtë çështje nuk e kanë vlerësuar.

Në të kaluar e sipër punëtorët më folën edhe për gazrat e dëmshme për shëndetin e tyre. Kjo çështje ka rëndësi të madhe për ne, prandaj, tok me ngritjen dhe me zgjerimin e metalurgjisë, duhen parashikuar edhe masat e sigurimit të jetës së metalurgëve dhe të një-rëzve të tjerë aty rreth e përçark, në radhë të parë, si edhe për jetën e kafshëve e për bimësinë e kësaj zone.

Atje më thanë, gjithashtu, se banjat nuk janë ngritur. Drejtori i Minierës së Kurbneshit më tregoi se janë duke marrë masa dhe ato do të ngrihen. Ai më tha se kanë nevojë për disa apartamente dhe për lavanderi, të cilat mendoj se duhen bërë sa më parë, prandaj t'i rishikojmë disa hallka që na pengojnë dhe na i zvarritin këto punë.

Kemi caktuar disa norma për rrobat e punës që u jepen punëtorëve, nga shteti. Kur i pyeta për këtë çështje, punëtorët më thanë se janë të kënaqur, megjithëse vura re që rrobat e tyre ishin shumë të vjetruara. Po çfarë do t'i kostonte shtetit që punëtorëve të disa kategorive punësh më të vështira, ku rrobat u grisen më shpejt, t'u caktonte një normë më të favorshme?

Shokët e Rrëshenit kërkuan që të zgjerohet spitali, bile të hapet edhe reparti i kirurgjisë, kurse në Rubik kërkuan të ndërtohet një spital i ri, pse ekzistuesi nuk është i përshtatshëm. Për këtë çështje bisedova me shokët e Qeverisë dhe këta më thanë se do ta studiojnë mundësinë e zgjerimit të tyre. Bisedova, gjithashtu, me shokët e ushtrisë, të cilët morën përsipër krijimin e reparteve të kirurgjisë në spitalet e disa qendrave të punës e të banimit. Kjo do të jetë një ndihmë e madhe që do të japë ushtria për popullin, prandaj duhet që nga rrethet të merren menjëherë masa, të hapen gropat e gëlqeres, të pritët lënda e nevojshme e drurit, të sigurohen tullat e çdo gjë tjetër që nevojitet dhe të gjitha këto materiale të çohen në vendet e caktuara, në mënyrë që këto vepra të ngrihen sa më parë. Përveç atyre reparteve që u kërkuan, të mendohet edhe për maternitetin.

Këto ishin disa çështje që më ngritën shokët atje. Edhe në këtë mbledhje shokët që kemi thirrur na parashtruan disa kërkesa, për të cilat duhet të marrim disa masa të shpejta.

Për çështjen e transportit, Ministria e Komunikacioneve duhet të marrë masa të menjëhershme. Dy autobusët që kërkojnë në Kukës dhe një tjetër në

Kurbnesh të dërgohen menjëherë dhe këto të jenë në gjendje të mirë pune. Në qoftë se Ministria nuk disponon autobusë të tjerë, këta të merren nga Tirana dhe të çohen atje, sepse tash për tash nuk është e domosdoshme që në rrugët e këtij qyteti të kalojë në çdo pesë minuta një autobus. Në qoftë se për punëtorët dhe për nëpunësit e qytetit, që kanë shtëpinë gjysmë ore larg nga vendi i punës, që kanë kushte më të mira banimi e jetese, që kthehen në darkë pranë familjes, që venë në kinema, në opera etj., mendohet dhe sigurohen autobusë, kurse për punëtorët e Minierës së Kurbneshit, që nisen për në punë një orë ose një orë e gjysmë në këmbë dhe po kaq edhe në kthim e karkallosen nga të ftohtit në dimër, nuk mendohet fare, ky nuk është qëndrim i drejtë, socialist. Pra, derisa të arrijmë që të sigurojmë makina të mjaftueshme për të gjithë, më mirë të ecin ca më këmbë punonjësit e qyteteve dhe jo ata të minierave. Çështjet e kësaj natyre nuk presin, prandaj duhet të merren masa të shpejta e të zgjidhen menjëherë.

Gjeologët janë si minatorët, nga njerëzit tanë më të mirë, heroikë dhe të sakrificës. Ata kanë lënë familjet e komoditetet dhe flenë në pyje e në gërxhe, në borë e në shi, shikojnë a nuk shikojnë njeri atje ku punojnë të vetmuar dhe në barangat ku flenë jo vetëm s'kanë ngrohje, po ç'bie jashtë, hyn brenda. Mendoj se vitin e ardhshëm duhet të pajisen të gjitha ekipet me çdo gjë që kanë nevojë, prandaj të kërkohen menjëherë katalogë dhe të zgjidhen nga ato baranga të mira ose çadra të veshura me vatë përbrenda, që të jenë të ngrohta, të pajisura me nga një grup elektrik

për çdo ekip, me radio, shtretër, tavolina e karrige portative, sobë elektrike e gjer te termuset e ujit. Sekretari i organizatës-bazë të Partisë të ndërmarrjes së gjeologjisë të rrethit të Mirditës na tha se, më së fundi, i pajisën ekipet e gjeologjisë me nga një radio me bateri. Gjeologu që punon i izoluar, jashtë, në shi e në borë, në majë të Shkëlzenit apo diku tjetër, duhet me doemos të jetë i pajisur me radio që të dëgjojë lajmet, të jetë i lidhur në çdo kohë me punën e madhe që bëhet në të gjithë atdheun, të jetojë me situatat, të dëgjojë edhe muzikë për t'u çlodhur. Të gjitha këto dhe sende të tjera që u nevojiten duhet t'i kenë të siguruara këta njerëz, që bëjnë sakrifica kaq të mëdha.

Një kërkesë e domosdoshme, që duhet plotësuar sa më parë, është ajo për ndërtimin e banesave për minatorët. Kjo çështje, më duket mua, nuk është parë drejt. Ne duhet të ristudiojmë formën e organizimit të ndërmarrjeve të ndërtimit, se nuk më duket me vend që të varen të gjitha nga Ministria e Ndërtimit, kurse rrethet të mos kenë asgjë në dorë, as për ndërtimet lokale. Pse duhet të jetë nën varësinë e Ministrisë së Ndërtimit çdo gjë që ndërtohet në rreth? Ministria përkatëse mund të mbajë nën kontrollin e saj veprën që ka në plan ajo vetë për ta ndërtuar, por ndërtimet që bën sektori i komunales ose ndërmarrja e ndërtimit mund të jenë nën varësinë e komitetit ekzekutiv të rrethit. Në qoftë se ju në Kukës, për shembull, keni nevojë të ndërtoni shtëpi për minatorët, këtë punë do ta bëjë ndërmarrja e ndërtimit e rrethit, por ajo duhet të ketë për këtë qëllim fondet, materialet e ndërti-

mit, specialistët, të cilët të jenë nën varësinë e komitetit ekzekutiv të rrethit dhe nën kontrollin e ministrisë investitore. Ministria e Ndërtimit nuk duhet të ketë të drejtë, siç ka tani, të marrë punëtorët prej andej dhe t'i dërgojë në një rreth ose në një objekt tjetër, ku asaj mund t'i nevojiten dhe t'i thotë rrethit të gjejë punëtorë të tjerë, ose t'i marrë lëndën e drurit, çimenton, mjetet e transportit etj. Duke vepruar në këtë mënyrë, ndërtimet lokale, si: banesat dhe objektet socialkulturore të planifikuara për rrethet, kalojnë nga një vit në tjetrin, planit të ri i shtohen edhe ndërtimet e prapambetura të vitit që mbaron, ose ato hiqen nga plani dhe kështu ngopemi me lugë të zbrazët. Një praktikë e tillë bie në kurriz të rretheve, prandaj mendoj se duhet ta shikojmë këtë përqendrim kaq të shtrënguar të ndërtimeve, i cili më duket se na pengon për ndërtimin më të shpejtë të disa objekteve, që janë shumë të nevojshme.

Ne duhet të mendojmë thellë për ato probleme që ngriti inxhinieri i Minierës së Gjegjanit. Ai është djalë i ri, i porsamartuar, gruan e ka te prindërit, në Vlorë, por nuk ka shtëpi atje ku punon. Vetë qëndron në Minierën e Kukësit, se është njeri i Partisë, por gjer kur do të qëndrojë pa shtëpi? Siç ndërtojmë shtëpi për beqarët, na bie për detyrë të mendojmë e të ndërtojmë shtëpi edhe për ata që do të krijojnë familjet e tyre. Natyrisht, punëtorë e specialistë beqarë do të ketë kurdoherë, por një i ri mund të qëndrojë 3-4 vjet beqar, pastaj vjen koha dhe ai do të martohet, bile shteti ynë do që ai të krijojë familjen, prandaj ta shikojmë me këtë perspektivë ndërtimin e banesave e jo të flemë

mendjen kur i kemi vënë tre-katër veta në një dhomë. Në qoftë se nuk e mbajmë parasysh këtë perspektivë, do të na krijohet një problem tjetër shoqëror. Zakonisht në jetë ndodh që një djalë i ri pëlqen një vajzë të re dhe ajo u përgjigjet ndjenjave të tij. Atëherë djali i shpreh dëshirën të fejohej me të e pastaj të martohet, por martesën nuk e bën dot derisa t'i jepet shtëpi. Ata vazhdojnë të dashurohen, por ka njerëz që thonë se po na prishin moralin e se duhen marrë masa ndaj atyre. Mirëpo ç'faj ka djali ose vajza në këtë rast? Këto janë probleme të mëdha shoqërore, që duhet të na preokupojnë, shokë, dhe, po të mos mendojmë ne të Partisë, kush do të mendojë? Duhet të jemi realistë, t'i njohim këto probleme që nxjerr jeta. Njerëzit tanë bëjnë sakrifica, bile sakrifica të mëdha; ne duhet t'ua shpjegojmë atyre vështirësitë që kemi për t'u siguruar të gjitha kushtet që u nevojiten për jetesën dhe ata do të na kuptojnë, se nuk mund të bëhen të gjitha menjëherë, ashtu siç i duam, por edhe të mendojmë për të gjetur mënyrat që t'ua zgjidhim nevojat sa më parë e sa më mirë që të jetë e mundur.

Ju, shokët e Ministrisë së Industrisë dhe të Minierave, bëni mirë që kritikoni edhe drejtorët, edhe kryeinxhinierët kur gabojnë, por ju duhet t'i analizoni më thellë shkaqet e gabimeve të tyre. Për disa gabime ata s'kanë aq faj sa keni ju këtu lart, se, shpeshherë, janë të detyruar të zbatojnë disa urdhëresa dhe norma prej të cilave nuk mund të dalin. Sipas mendimit tim, në radhë të parë, ju duhet të kuptoni mirë se diçka duhet ndryshuar në këta urdhra, rregulla e norma, me qëllim që metoda dhe stili i drejtimit të punëve të mos buro-

kratizohen, jo t'ua hidhni fajin për çdo gjë atyre të bazës. Drejtori i ndërmarrjes duhet kritikuar kur sillet me arrogancë, kur punon me hatër, kur punët e ndërmarrjes nuk shkojnë mirë ngaqë ai nuk drejton mirë, ose për ndonjë çështje tjetër si këto, por kur zbaton rregullat që i ke vendosur, ai nuk ka faj; fajin duhet ta kërkojmë te dikasteri që nuk kujtohet për t'u bërë ndryshimet e nevojshme atyre rregullave e urdhërësive, që jeta ka treguar se duhen ndryshuar. Drejtori, si shok i pjekur që është, duhet të bëjë vërejtje kur shikon se një rregull, që ka qenë i drejtë për një kohë, tani ngadalëson ecjen përpara. Kritika e bazës ka rëndësi të madhe, prandaj ajo duhet të vijë gjer lart dhe të analizohet, se edhe ministrat, edhe anëtarët e Komitetit Qendror apo të Byrosë Politike janë shumë të interesuar të zgjidhen të gjitha kërkesat tuaja.

Natyrisht, kërkesat nuk mund të zgjidhen dot të tëra menjëherë, por çështja është që, në një moment të caktuar, të shikohet drejt se cilës kërkesë duhet t'i japim prioritet më shumë. Në qoftë se ndihet nevojë e ngutshme për të ndërtuar banesa për minatorët në Mirditë, për shembull, ku gjysma janë punëtorë dhe gjysma fshatarë, mund të bisedohet me fshatarët dhe të merret pëlqimi i tyre që lënda e drurit, materialet e ndërtimit, mjeshtrat dhe karpentierët, që janë parashikuar për të bërë ndërtime banesash për fshatin, në vend që t'u jepen kooperativave bujqësore, ku çështja e ndërtimit të banesave nuk është aq e ngutshme, të përdoren për të ndërtuar apartamente mbi planin për punëtorët e minierave dhe, pas një viti, këto t'u kalojnë fshatarëve që të bëjnë shtëpitë e tyre të reja. Po

t'ua shtrojmë çështjen kështu, jam i bindur se fshatarët do ta kuptojnë drejt.

Ja, ky është prioriteti. Një rreth mund t'i bëjë thirrje edhe rrethit fqinj, i cili nuk ka nevoja të ngutshme për të ndërtuar banesa në fshat, që të dërgojë përkohësisht në ndihmë skuadra ndërtimi nga kooperativat bujqësore, për të punuar për disa muaj në ndërtimin e banesave për punëtorët dhe për specialistët e minierave dhe, me siguri, ai do të tregohet menjëherë i gatshëm. Në këtë mënyrë ne i japim prioritet për një kohë ndërtimit të banesave për punëtorët. Në një rast tjetër mund t'i jepet prioritet ndërtimit të një objekti të rëndësishëm, i cili i shërben gjithë rrethit, siç është spitali që kërkuan shokët e Mirditës; pra, mund t'u bëhet thirrje disa kooperativave bujqësore që lëndën e ndërtimit, që u është planifikuar, ta kalojnë me të drejtë kthimi në favor të ndërtimit të spitalit dhe jam i bindur se fshatarët do ta aprovojnë këtë propozim.

Kështu, probleme të tilla, mund t'i zgjidhim më shpejt, prandaj të mos qëndrojmë të mbërthyer pas disa rregullave e planeve, të cilat, në disa raste, na pengojnë në punë.

Tre kilometra larg është uji nga Miniera e Kukësit e, megjithatë, ujësjellësi që do të plotësonte një nevojë të domosdoshme për punëtorët nuk po ndërtohet. Si vjen kjo çështje deri në Sekretariatit e Komitetit Qendror, kur mund të zgjidhej nga vetë rrethi dhe nga ministria, në një kohë kur ne kemi bërë sa e sa gjëra të mëdha?! Tre kilometra për një ujësjellës nuk është asgjë përpara atyre që kemi bërë dhe po bëjmë vazhdimisht, por këtu pengon burokratizmi, prandaj të luf-

tojmë që t'i zhdukim nga trualli ynë këto gjëra të këqija. Po të gjykohej çështja në kompleks dhe drejt, ujësjellësi për punëtorët në Kukës do të ishte ndërtuar më parë dhe pa dëmtuar prodhimin.

Të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me përmirësimin e kushteve të jetesës së punëtorëve mendoj t'i shikojmë me kujdes të veçantë. Zgjidhja e drejtë e tyre do ta shtojë edhe më shumë hovin e madh revolucionar që ka shpërthyer kudo në punë. Ne duhet të interesohemi për prodhimin, por më parë të interesohemi për njerëzit. Në qoftë se nuk shikojmë, në radhë të parë, mirëqenien e njerëzve, në qoftë se nuk përmbushim nevojat e tyre, do të thotë se këto çështje nuk i shikojmë politikisht. Mund të flasim sa të duam «Politika në plan të parë», por kur nuk tregojmë kujdesin e duhur për mirëqenien e njerëzve (dhe këtu kam parasysh nevojat e punëtorëve, të kooperativistëve dhe të inteligjencies), atëherë, ato që themi mbeten vetëm fjalë, prandaj duhet t'i vëmë kujdes të madh përmirësimit të kushteve të jetesës së njerëzve. Natyrisht, kushtet e punës e të jetesës së punëtorëve janë përmirësuar, por duhet të përpiqemi akoma më shumë, ashtu siç thamë, duke u dhënë prioritet, sepse punëtorët nuk e bëjnë dy fjalën e Partisë. Ne duhet t'i lavdërojmë për punën e tyre, për sakrificat, për heroizmat që bëjnë dhe për zotësitë që tregojnë në realizimin e planeve, shpesh në kushte të vështira. U lumtë shokëve punëtorë!

Kur isha në Mirditë, pashë se atje kishte shumë gjëra të mira. Mirdita është një vend i bukur, me pasuri të mëdha. Ne duhet të interesohemi që atje të zhvillohet jo vetëm industria minerare, por edhe buj-

qësia dhe pyjet. Pyjet e Mirditës janë një pasuri e pazëvendësueshme. Në goftë se do të pritnim drurë pa kriter shkencor, do të bënim një krim të madh dhe me këtë do të tregonim se nuk kemi kuptuar asgjë nga bujqësia dhe nga ligjet e natyrës. Druri është një material jashtëzakonisht i vlefshëm, që nuk vihet lehtë në vend, pse, po e preve një dru, duhen 60-70 vjet për ta rritur drurin e ri, prandaj prerja e pyjeve duhet të bëhet me një disiplinë jashtëzakonisht të rreptë shkencore. Me kohë në pyje mund të shtohen edhe kafshë të egra për gjueti dhe gjithë këtë zonë mund ta kthejmë në një park të madh me pasuri të vlefshme për gjithë Republikën.

Atje duhet të kemi njerëz që të interesohen vazhdimisht për pyjet, sepse prej tyre nxjerrim pasuri të mëdha jo vetëm për lëndë ndërtimi, por edhe për të prodhuar mobilje dhe sende të tjera të vlefshme, prandaj duhen parë këto gjëra jo me syrin e neofitëve, o burra të hapim toka të reja, ose kemi nevojë për lëndë dhe damkos e pre drurët e pyjeve. Po të ecim symbyllur e pa kritere shkencore, do të dëmtojmë shumë pyjet dhe pastaj do t'i biem kokës, në mos ne, ata që do të vijnë pas nesh, por atëherë do të jetë tepër vonë. Duhet ta ruajmë këtë natyrë të mrekullueshme që kemi, pse nuk është vetëm për pejzazh e për të na kënaqur sytë, por edhe për shëndetin, edhe për bujqësinë. Nevojat tona për lëndë druri janë të mëdha, por këtë pasuri të vlefshme duhet të dimë ta shfrytëzojmë në mënyrë racionale dhe të mos tërhiqemi nga kërkesat e nevojat e çastit, pa menduar shkencërisht ku duhet të presim, ndryshe do të gabojmë.

U thashë shokëve të Mirditës se në rrethin e tyre kanë mjaft vende për të hapur toka të reja, por kjo punë duhet bërë e studiuar, në vende të përshtatshme, të cilat duhet të përcaktohen si me vijë të kuqe se ku duhen hapur, që të mos prishen pyjet e të mos themi pastaj ç'bëmë që i hapëm. Vendet që pashë ishin toka të bukura e pjellore, ku mund të zhvillohen misri, gruri, bimë të tjera dhe lopa. I tillë vend është Mirdita.

Mirditorët janë njerëz të zgjuar e përparimtarë, prandaj të kuptojnë shpejt kur u flet për të rejat që duhet të hyjnë në jetën e tyre. Ndër të tjera, u foli edhe për nevojën e grumbullimit të kullave, që sot i kanë larg njëra-tjetrës, dhe kam besim se këshillën time do ta realizojnë. Atëherë, me siguri, do të zhvillohen më mirë bujqësia, blegtoria dhe frutikultura, por edhe jeta politike e shoqërore e fshatit do të gjallërohet më shumë.

Problemet që u ngritën këtu shokët do t'i shtrojnë në mbledhjen e Qeverisë dhe do t'i shohin me një sy tjetër kur të shqyrtojnë planin vjetor.

Me kaq i japim fund kësaj çështjeje. Ju urojmë suksese të reja në punën tuaj. Ne do të përpiqemi që të metat tona t'i korrigjojmë dhe kërkesat e bazës t'i plotësojmë sa më parë që të jetë e mundur. U bëni të fala të gjithë shokëve.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

BREZI YNË I RI MARSHION NË RRUGËN REVOLUCIONARE TË PARTISË

*Nga fjala në mitingun e madh në sektorin e Gradishtës
të Hekurudhës Rrogozhinë-Fier*

28 qershor 1968

Të dashur shokë dhe shoqe,

Është një kënaqësi dhe gëzim i veçantë për mua që kam rastin të takohem sot me ju, të rejat dhe të rinjtë, që punoni me entuziazëm e me vetëmohim për ndërtimin e Hekurudhës së re Rrogozhinë-Fier.

Dua të përfitoj nga ky rast që, nëpërmjet jush, ndërtuesve të hekurudhës, në emër të Komitetit Qendror të Partisë dhe të Qeverisë, të përshëndes edhe shokët e shoqet tuaja, që punojnë për ndërtimin e rrugës së Malësisë së Madhe, të përshëndes gjithë rininë e vendit tonë, atë rini të mrekullueshme revolucionare, e cila kudo, anembanë atdheut e në çdo fushë, tregon heroizma, pjekuri të lartë politike dhe besnikëri të pakufishme ndaj Partisë, ndaj interesave të popullit dhe ndaj çështjes së socializmit.

Në mënyrë të veçantë ju përshëndes ju, shokë studentë dhe nxënës, që përbëni numrin më të madh të vullnetarëve për ndërtimin e hekurudhës dhe të rrugës së Malësisë së Madhe dhe ju përgëzoj që, krahas përpjekjeve për të zotëruar shkencën, për t'u pajisur me kulturë dhe për të përvetësuar bazat e botëkuptimit tonë marksist-leninist, ju keni rrëmbyer kazmën e lopatën dhe, bashkë me punëtorët e fshatarët, jepni kontributin tuaj të çmuar për ndërtimin e atdheut socialist në aksionet e mëdha të rinisë.

Aksionet janë bërë një traditë e lavdishme e rinisë sonë. Të gjithë ne, si dhe shokët tuaj më të rritur, të cilët tani punojnë e krijojnë me sukses në fushat e ndryshme të ndërtimit socialist, ndër ta mjaft nga pedagogët dhe mësuesit tuaj, që bashkë me ju derdhi sot djersën këtu, në ndërtimin e hekurudhës, në Malësinë e Madhe apo në aksione të tjera të rinisë, i kemi të gjalla në kujtesën tonë ditët e paharruara të aksioneve të para të rinisë në rrugën Kukës-Peshkopi apo në ndërtimin e Hekurudhës Durrës-Elbasan e Tiranë-Durrës. Ju po e vazhdoni dhe po e ngrini akoma më lart këtë traditë të lavdishme të rinisë sonë. Ju punoni pa u lodhur dhe jepni një kontribut të rëndësishëm në ndërtimin e veprave të mëdha, gjë për të cilën Partia dhe mbarë populli ju përgëzojnë dhe ju falënderojnë me gjithë zemër.

Por rinia jonë, me aksionet e saj, nuk ndërton vetëm vepra të rëndësishme ekonomike. Mbi të gjitha, aksioni shërben si një shkollë e madhe për kalitjen e brezit të ri, për edukimin e tij me koncepte të drejta për punën, shërben për ngulitjen te të rinjtë të frymës

së kolektivizmit, të luftës për kapërcimin e vështirësive, të dashurisë për shokun, të miqësisë së pastër, të vendosmërisë revolucionare. Duke punuar e duke jetuar së bashku, rinia punëtore, fshatare dhe ajo e shkollave, njihen dhe miqësohen me njëra-tjetrën, mësojnë e përfitojnë reciprokisht nga njëra-tjetra. Në punën dhe në jetën e përbashkët brumosen konceptet dhe morali komunist, flaken tej mbeturinat mikroborgjeze, patriarkale e intelektualiste të së kaluarës, hidhen poshtë mezhdat e vjetruara të dallimeve të ndryshme artificiale, të ngritura nga ideologjitë dhe nga klasat e përmbysura. Aksioni është një terren konkret ku vihet në jetë parulla e Partisë për të menduar, për të punuar e për të jetuar si revolucionarë.

Në aksione, në gjithë punën e madhe ndërtimtare, në gjithë luftën tonë për socializmin dhe për mbrojtjen e atdheut, rinia ka shkruar dhe shkruan përditë faqe të mrekullueshme heroizmi. Këtë e dëshmoi më së miri me heroizmin e saj cuca e malësisë, komunistja 15-vjeçare Shkurte Pal Vata, e cila, këtu në Hekurudhën Rrogozhinë-Fier, i ngriti një monument krenar brezit të ri të sotëm revolucionar të Shqipërisë socialiste. Ajo vazhdoi traditën e lavdishme të të rejave heroike mirditore Marta Tarazhi, Prenda Tarazhi, Mrikë Lokja dhe Shkurte Cara, traditat e vetëmohimit për çështjen e përgjithshme, si të Muhamet Shehut e Myrteza Kepit, të rënies në krye të detyrës, si të ushtarit trim Hekuran Zenuni dhe të shumë shoqeve e shokëve të tjerë që kanë vënë e vënë interesin e përgjithshëm të revolucionit mbi çdo gjë

tjetër, që, kur është e nevojshme, japin për revolucionin, pa ngurruar për asnjë çast, edhe jetën e tyre, duke ecur kështu në gjurmët e pavdekshme të heronjve të Luftës Nacionalçlirimtare dhe të dëshmorëve të rinisë — Qemal Stafës, Misto Mames, Manush Alimanit e të qindra e mijëra të tjerëve.

Populli ynë, si dhe gjithë rinia do t'i kujtojnë me nderim dhe respekt këto bija dhe bij të lavdishëm të tij, ashtu si nderon dhe do të nderojë kurdoherë trimat, si Fuat Çela dhe heroizmin e gjithë rinisë në luftën për lulëzimin dhe për përparimin e vendit tonë. Ky heroizëm është bërë sot një fenomen masiv, një tipar themelor i njerëzve tanë.

Pjesëmarrja aktive dhe e ndërgjegjshme e rinisë sonë në aksionet dhe në lëvizjet masive, që kanë shpërthyer në të katër anët e atdheut për revolucionarizimin e mëtejshëm të gjithë jetës së vendit, është një demonstrim i fuqishëm i vetive të reja të njeriut tonë të ri, të rritur dhe të edukuar nga Partia me ideologjinë dhe me moralin e vërtetë komunist. Kjo është një provë tjetër, që dëshmon se brezi ynë i ri, i bashkuar në organizatën e tij heroike të Bashkimit të Rinisë së Punës të Shqipërisë, qëndron i patundur në pozita të shëndosha revolucionare, se ai është plotësisht i denjë dhe i aftë për të marrë në duart e veta e ta çojë më përpara stafetën e revolucionit e të socializmit.

Fryma luftarake e revolucionare e rinisë sonë, vendosmëria e saj për të ecur, si deri më sot, e patundur në rrugën e marksizëm-leninizmit, gatishmëria e saj për ta vënë veten pa lëkundje në shërbim të

popullit në të gjitha frontet ku i bën thirrje Partia, është një nga fitoret tona më të mëdha, është një ndër garancitë e së ardhmes së ndritur të vendit tonë.

Këto veti e kanë burimin në kujdesin e madh që ka treguar e tregon Partia jonë e Punës për edukimin e brezit të ri, në realitetin tonë socialist, në fitoret e mëdha historike që ka arritur vendi ynë nën udhëheqjen marksiste-leniniste të Partisë sonë të Punës, në perspektivat e qarta e të sigurta që i ka hapur Partia rinisë të ne.

Rinia jonë nuk e ka bërë kurrë dysh fjalën e Partisë. Në kohë të mira e të vështira ajo u është përgjigjur me entuziazëm thirrjeve të Partisë dhe ka punuar e ka luftuar plot vendosmëri e vetëmohim për arritjen e objektivave që i ka treguar Partia. Rinia jonë u edukua jo në shtretër të ngrohtë, as me libra të mykur skollastikë; ajo është kalitur si çeliku dhe është brumosur me shpirt të paepur revolucionar në zjarrin e betejave të ashpra me armiqtë e egër, të jashtëm e të brendshëm, me vështirësitë kolosale që na është dashur të kapërcejmë për shkak të prapambetjes së thellë që trashëguam nga regjimet antipopullore, në luftën e ashpër për thyerjen e bllokadave armiqësore imperialisto-revizioniste që iu imponuan vendit tonë.

Në këto beteja populli ynë, nën udhëheqjen e Partisë, ka dalë kurdoherë fitimtar. Me luftën e tij të vendosur e parimore kundër armiqtë të ndryshëm, ai ka fituar simpatinë dhe dashurinë e popujve dhe të forcave revolucionare në botë. Pozita ndërkombëtare e Republikës sonë është forcuar shumë. Partia jonë edhe në të ardhmen do ta mbajë lart flamurin e luftës

revolucionare kundër imperializmit e revizionizmit dhe do të jetë kurdoherë në pararojë të kësaj lufte të drejtë. Republika Popullore e Shqipërisë do të rrojë në shekuj e fortë e socialiste dhe çdo armik yni do të thyejë kokën përpara unitetit të çeliktë të popullit me Partinë dhe me ushtrinë tonë heroike.

Imperializmi dhe revizionizmi ushtrojnë kurdoherë presion ideologjik mbi popullin tonë, në mënyrë të veçantë mbi rininë. Por lufta aktive e Partisë, e të gjithë popullit dhe e rinisë sonë, kundër këtij presioni, ka qenë dhe është me të vërtetë heroike. Rinia e vendit tonë shkelmon me përbuzje çdo ndikim të huaj të ideologjisë borgjeze dhe revizioniste, çdo shenjë të çoroditjes dhe të degjenerimit, nga çdo anë që të vijë. Ajo, sipas mësimëve të Partisë, e ka kuptuar mirë se një nga qëllimet kryesore të armikut është infiltrimi i ideologjisë së tij në radhët tona, është helmatisja e mendjes dhe e ndërgjegjes së të rinjve e të rejave. Prandaj, nën udhëheqjen e Partisë, ajo lufton për të ruajtur pastërtinë ideologjike dhe morale të saj. Ne vërejmë me kënaqësi se në vendin tonë po rritet një rini e shëndoshë dhe e pastër, e brumosur me idealet revolucionare të Partisë.

Por sot kudo luftohet për të ngritur edhe më lart frymën revolucionare, për të thelluar procesin e revolucionarizimit të jetës së vendit, për ta çuar përpara revolucionin socialist në të gjitha fushat. Rinia jonë nuk duhet të kënaqet me sukseset që ka arritur, ajo nuk duhet ta ndalë për asnjë çast hovin e vet revolucionar. Bashkimi i Rinisë së Punës të Shqipërisë duhet t'i vazhdojë akoma më me këmbëngulje për-

projekjet për të nxitur gjithë rininë që të ngrejë vazhdimisht nivelin e saj ideologjik e politik, duke studiuar marksizëm-leninizmin, duke përvetësuar akoma më mirë teorinë tonë revolucionare, që është kyçi për arritjen e fitoreve akoma më të mëdha në të ardhmen.

Të rinjtë punëtorë, fshatarë dhe studentë duhet t'i shtojnë përpjekjet që të mësojnë sa më shumë, të zotërojnë kulturën dhe shkencën, që janë kusht i domosdoshëm për përparimin e vendit, të mësojnë duke punuar dhe të punojnë duke mësuar.

Në shembullin e klasës punëtoresh dhe të të gjithë punonjësve, rinia jonë shkollore dhe studenteske, krahas luftës për përvetësimin e marksizëm-leninizmit dhe të shkencës, është hedhur e tëra jo vetëm në aksione politike e ideologjike, por edhe në aksione të mëdha të punës ndërtimore. Në këtë mënyrë ajo përzbaton porosinë e Partisë për t'u lidhur me masat punonjëse, me jetën, për ta lidhur mësimin me punën, për t'u kalitur në kudhrën e punës fizike.

Një luftë e tillë e rinisë shkollore e studenteske në frontin e mësimin dhe të punës i përgjigjet thelbit të detyrës që ka shtruar Partia për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës sonë, rreth të cilit në vendin tonë po zhvillohet një diskutim i gjerë popullor. Në këtë aksion të thellë ideologjik rinia është një forcë e madhe shtytëse dhe revolucionarizuese. Rinisë sonë, në mënyrë të veçantë rinisë shkollore e studenteske, i përket të marrë pjesë aktive në këtë luftë dhe në këtë diskutim, në mënyrë që të realizohen sa më mirë qëllimet e Partisë për ta bërë shkollën tonë, në përmbajtje dhe në strukturë, një qendër revolucionare

ku të përgatiten njerëz të formuar si komunistë dhe specialistë të zot. Rinia shkollore e studenteske e kupton mirë se revolucionarizimi i shkollës shtron detyra të mëdha para saj, se asaj i takon të bëjë një luftë këmbëngulëse për të mësuar, për të përvetësuar shkencën dhe kulturën, për t'u përgatitur për jetën dhe për punën praktike.

Të rejtat dhe të rinjtë e vendit tonë duhet të jenë kudo dhe kurdoherë në ballë të luftës për revolucionarizim, të jenë të parët në mbështetjen e të gjitha masave revolucionarizuese. Në këtë luftë pararoja e gjithë rinisë është rinia heroike punëtore. Fryma e saj revolucionare, fryma e klasës duhet të përshkojë gjithë organizatën e Bashkimit të Rinisë së Punës të Shqipërisë. Rinia punëtore është gjenerata e re që mbush radhët e klasës punëtore, e cila është shtyllë kurrizore e sistemit tonë socialist, e klasës që është zot i vendit dhe që me ideologjinë e saj marksiste-leniniste e shembullin e saj revolucionar, nën drejtimin e Partisë sonë, frymëzon dhe udhëheq në luftë dhe në revolucion të gjitha masat punonjëse. Rinia punëtore duhet të jetë në ballë edhe në fushën e prodhimit. Ajo të jetë iniciatore dhe nxitëse për tejkalimin e planit, për përvetësimin e teknikës, për thellimin e revolucionit tekniko-shkencor.

Rinisë i bie një barrë e rëndë për thellimin e mëtejshëm të revolucionit tonë socialist në fshat. Anëtarët e organizatës së rinisë në fshat janë dhe duhet të jenë gjithnjë luftëtarë të vendosur për të renë në të gjitha fushat, për përhapjen e arsimit e të kulturës, për futjen e agroteknikës moderne, për higjienën dhe

pastërtinë, për lulëzimin e gjithanshëm të fshatit tonë socialist. Në këtë luftë ata frymëzohen nga shembulli heroik i rinisë punëtore të vendit tonë dhe mësojnë nga fryma dhe edukata revolucionare e aksioneve të mëdha të rinisë.

Gjithë rinia jonë, duke ndjekur mësimet e Partisë, është hedhur në luftë për zhdukjen e zakoneve prapanike, për emancipimin e gruas dhe kundër mbeturinave të huaja në ndërgjegjen e njerëzve. Kjo luftë kërkon, veçanërisht nga të rinjtë, që të ndihmojnë shoqet e tyre për të ecur krah për krah, sepse kështu do të shkallmohen më shpejt të gjitha mbeturinat e së kaluarës. Partia çmon shumë faktin se direktivat e saj për luftën kundër patriarkalizmit dhe çdo gjëje të vjetër janë kuptuar drejt. Lufta në këtë fushë po zhvillohet në terrenin ideologjik, duke mos cenuar dashurinë dhe respektin që të rinjtë duhet të ushqejnë për prindërit e tyre, për pleqtë. Rinia jonë, me pjekurinë e saj, e kupton se ndonjë pengesë apo moskuptim, që vjen nga më të moshuarit, e ka burimin në faktin se këta kanë jetuar në kohë të tjera dhe, megjithëse tani janë të lidhur ngushtë me Partinë, prapë e kanë më të vështirë për t'u shkëputur nga e vjetra, nga ato zakone e mbeturina që më parë ishin pjesë përbërëse e jetës së tyre.

Rinia jonë po i zbaton dhe do t'i zbatojë akoma më mirë këto detyra të shtruara nga Partia, pasi ajo është brumosur e brumoset vazhdimisht me mësimet e Partisë në kushtet e luftës për ndërtimin e socializmit. Rinia e sotme ka lindur dhe është rritur në vitet e pushtetit popullor. Ajo i ka parë e i ka jetuar

vetë transformimet e thella që janë kryer e po kryhen në vendin tonë. Në Shqipërinë dikur primitive e të prapambetur është ngritur një industri e tërë moderne shumëdegëshe. Para syve të rinisë ka ndryshuar e po ndryshon me ritëm të shpejtë pamja e fushave, e kodrave dhe e maleve tona. Shumë nga ju e mbajnë mend se si kënetat e moçallet kishin mbuluar tokën e begatshme të Myzeqesë, mbi të cilën ju shtrini tani shinat e hekurudhës. Ju imbani mend kasollet e tymosura dhe fshatarët e shtypur të kësaj zone. A mund të bëhet ndonjë krahasim me fshatin e ri kooperativist dhe me kooperativistët e sotëm të Myzeqesë? Kështu ka ndryshuar e gjithë Shqipëria, kështu ka ndryshuar mbarë populli ynë. Sot nuk ka te ne asnjë fshat që të mos ketë shkollë dhe asnjë fëmijë që të mos marrë arsimin e nevojshëm. Më 1971 të gjitha fshatrat e Shqipërisë do të ndriçojnë nga drita elektrike. Dhe ne i kemi arritur këto suksese kur në shumë vende të «Evropës së qytetëruar» akoma edhe sot një përqindje e mirë e fëmijëve mbetet analfabete, kur mijëra e mijëra fshatra jetojnë akoma si në kohën e mesjetës.

Në vendin tonë të mrekullueshëm socialist, jeta e popullit po zbukurohet çdo ditë, po ngrihet niveli i tij i jetesës, niveli ekonomik, arsimor dhe kulturor. Po kalitet një shpirt revolucionar dhe një heroizëm i pashembullt në njerëzit e atdheut tonë.

Planet tona ekonomike po kapërcehen me një vrull të paparë ndonjëherë. Po thyhen norma në industri, në ndërtim, në transport e në të gjithë sektorët. Bujqësia jonë socialiste po ecën me një hov të madh përpara. Sivjet ne do të korrим drithëra të bollshme,

saqë edhe parashikimet tona më optimiste do të tejkalohen.

Një rezultat i tillë nuk u detyrohet kushteve atmosferike, të cilat, siç dihet, kanë qenë jo të mira, por vijës së drejtë të Partisë dhe të pushtetit, i detyrohet hovit revolucionar të të gjithë popullit dhe, në veçanti, heroizmit, pjekurisë dhe ngritjes së dukshme që ka bërë në lëmin e agroteknikës fshatarësisë jonë punëtore dhe e palodhur.

Kjo është një fitore e madhe për popullin, i cili këto ditë do të festojë me gëzim të papërshekruar 25-vjetorin e ushtrisë së tij të lavdishme, që e çliroi dhe që qëndron vigjilente, syshqiponjë, e përgatitur më së miri në mbrojtje të atdheut dhe të popullit.

Kjo është një fitore që na forcon dhe na nxit që, në vitin jubilar të 25-vjetorit të Çlirimit të Atdheut, të korrим me siguri, në çdo fushë, fitore akoma më të mëdha për popullin tonë.

Socializmi krijon përparimin, bollëkun, siguron lirinë, demokracinë e vërtetë për popullin.

Pushteti popullor, rendi ynë socialist i ka siguruar ririsë të gjitha të drejtat dhe kushtet materiale për t'i gëzuar këto realisht. Të rinjtë dhe të rejtat tona nuk i njohin shfrytëzimin dhe shtypjen e egër çifligare e borgjeze, nuk e njohin jetën e urisë, të mjerimit e të varfërisë, nuk e njohin shtypjen dhe sundimin barbar të regjimeve antipopullore dhe të imperialistëve të huaj. Rinia jonë nuk e ka ndier mbi supet e saj barrën e rëndë të analfabetizmit e të errësisës. Në Shqipërinë socialiste dyert e shkollave, që nga fillorja e deri në universitet, janë të hapura gje-

rësisht për bijtë e punëtorëve, të fshatarëve dhe të inteligjencies popullore. Brezi ynë i ri nuk i njeh papunësinë dhe pasigurinë për të ardhmen, këtë plagë të rëndë, nga e cila vuajnë e lëngojnë masat e gjera të rinisë edhe në vendet më të zhvilluara kapitaliste, si edhe në vendet revizioniste. Demokracia jonë socialiste i ka garantuar të riut tonë punën sipas aftësive dhe dijeve të fituara, i ka siguruar atij pjesëmarrjen aktive dhe një rol të pakufizuar krijues në të gjitha fushat e jetës sonë shoqërore.

Rinia jonë shikon me besim në të ardhmen. Kjo ndodhet në duart e saj, të gjitha rrugët janë të hapura për të. Ja përse ajo është e lidhur si mishi me kockën me Partinë e me pushtetin popullor, me marksizëm-leninizmin, ja përse ajo është revolucionare dhe luftëtare e paepur për çështjen e socializmit.

Preokupacioni i të riut tonë, i studentit apo i intelektualit, krejt ndryshe nga vendet ku sundojnë kapitalistët e revizionistët, nuk është fati personal, problemi për të siguruar diku një vend sa të mbajë gjallë frymën e tij e të familjes. Ai nuk mëson e nuk lufton «për të dalë në dritë» që të mos e shtypin të tjerët, që të mos e hanë ujçit e mëdhenj. Ideali i studentit ose i intelektualit tonë nuk është sigurimi ose aftësimi i vetes për t'u bërë ballë furtunave të shoqërisë shtypëse e shfrytëzuese. Ideali i tij është shumë i madh, shumë luftarak dhe shumë frymëzues.

I riu ynë revolucionar mëson dhe aftësohet jo për interesin e ngushtë personal, «për të zënë një vend në jetë», po për t'u shërbyer më mirë popullit të tij, socializmit, atdheut. Ai mëson e punon jo «për të grum-

bulluar kulturë» për veten e tij, as për t'u dalluar si erudit midis të tjerëve, po për ta ngritur në një shkallë më të lartë ekonominë e vendit, për t'i bërë fushat më pjellore, për ta përhapur më gjerë e më thellë kulturën edhe në skajet më të largëta të atdheut, për ta bërë shkencën të masave e për masat. Ne na gëzon fakti që të rinjtë tanë, të cilët mbarojnë shkollat, thujse pa asnjë përjashtim shkojnë atje ku ka nevojë vendi, pa kërkuar ndonjë qoshe të rehatshme. Kjo është një karakteristikë e çmueshme e inteligjencies sonë të re. Shërbimi i devotshëm, pa asnjë kusht, për çështjen e Partisë dhe për interesat e popullit, që buron nga kushtet ekzistuese në vendin tonë, nga vetë sistemi socialist dhe nga bindja e thellë e brendshme — ja cili është ideali dhe motivi i jetës i të riut tonë, qoftë ky punëtor, fshatar apo student e intelektual.

Natyrisht, me këto nuk dua të them aspak se ne në vendin tonë kemi arritur gjithçka, se i kemi kapërcyer pa përjashtim të gjitha pasojat e prapambetjes së trashëguar e vështirësitë dhe i kemi zgjidhur të gjitha problemet. Ne jemi krejtësisht të ndërgjegjshëm se na duhen akoma një luftë dhe punë e madhe, këmbëngulëse dhe e gjatë për të ndërtuar plotësisht socializmin, për të edukuar njeriun e ri, për të rritur më tej e pareshtur mirëqenien e popullit, për ta bërë jetën tonë më të begatshme, më të bukur, më të gëzueshme e më të gjallë. Por ne jemi në rrugë të drejtë, jemi të vendosur të shkojmë përpara të paepur dhe askush nuk do të na ndalë në marshimin tonë. Populli dhe rinia jonë e shohin të ardhmen me optimizëm.

Kurse një tablo krejt tjetër paraqet gjendja në vendet kapitaliste dhe revizioniste. Para nesh shohim dy botë të kundërta dhe dy fate krejt të ndryshme të rinisë. Një dëshmi e gjallë për këtë janë demonstratat e fuqishme të studentëve, që janë vërtetuar këto kohët e fundit në Evropë dhe në kontinente të tjera, si në vendet kapitaliste, ashtu edhe në disa vende revizioniste.

Karakteri i këtyre demonstratave nuk ka qenë i njëjlojtë kudo. Studentët e Pragës dhe ata të Varshavës ishin haptazi krahu i djathtë i revizionizmit modern, të organizuar nga reaksioni i brendshëm dhe i jashtëm, nga agjencitë e zbulimit imperialist dhe kishin për qëllim liberalizimin e mëtejshëm të regjimeve revizioniste në fuqi, shkëputjen e plotë të shteteve të tyre nga varësia e hegjemonisë revizioniste sovjetike dhe, më në fund, po t'ia arrinin, rrëzimin e klikave në fuqi dhe zëvendësimin e tyre me klika të reja, të hapëta kapitaliste, të lidhura dhe në shërbim të shteteve kapitaliste. Grevat dhe demonstratat e tyre nuk kishin, pra, asgjë përparimtare, përkundrazi, ishin kundërrevolucionare.

Në Çekoslovakia këto demonstrata i dhanë një ndihmë ardhjes në fuqi të grupit të ultrarevizionistëve, kurse, në Poloni, Gomulka me forcë mundi t'i shpartallonte përkohësisht. Në këto vende, të tillë studentë janë bërë avangarda e reaksionit. Nga një avangardë e tillë trembet edhe garda revizioniste në Bashkimin Sovjetik, në Bullgari, në Republikën Demokratike Gjermane etj.

Në këto vende studentët revolucionarë, nga frika

e represionit ose e komprometimit me studentët huliganë, nuk dolën në manifestime. Ata, sidoqoftë, nuk përfituan nga rasti për të dalë në rrugë, të përlesheshin me studentët huliganë dhe të sulmonin, njëkohësisht, klikat revizioniste në fuqi, të bëheshin një shkëndijë për të ndezur të gjithë fushën, për të nxitur klasën punëtore në këto vende, që të futej në valle seriozisht dhe në anën që duhet. Kjo nuk u bë. Prandaj u la përshtypja e rreme sikur në Çekoslllovakë «rinia është me revizionistët», në Poloni sikur Gomulka «mbron socializmin» kundër studentëve reaksionarë dhe në vendet e tjera, ku s'pati trazira, sikur revizionistët «janë në qetësi». Por kjo qetësi është false. Në vendin e sovjetëve, ku kanë ardhur në fuqi revizionistët hrushovianë, mitralozët kanë hyrë në funksionim me kohë kundër punëtorëve dhe rinisë revolucionare. Në Bashkimin Sovjetik, në Poloni, në Bullgari arrestohen me qindra e me mijëra revolucionarë, burgosen komitete të tëra partie, pasi kundërshtojnë tradhtinë, që klikat revizioniste në fuqi po u bëjnë atdheut dhe popujve të tyre.

Në Jugosllavinë titiste, siç e dini, klika Tito-Rankoviç ka bërë kërdrinë mbi revolucionarët. Të rrëqethshme janë vrasjet, torturat, kampet famëkeqe të UDB-së që, për 20 vjet me radhë, gjakosën popujt e Jugosllavisë dhe popullin kosovar, vëllanë tonë, për të hedhur themelet dhe për të ngritur regjimin e kalbur kapitalist.

Po ç'doli nga kjo? A u shua shpirti kryengritës i popullit jugosllav? Jo. Titoja dhe njerëzit e tij e shitën Jugosllavinë te kapitali amerikan, anglez e

ndërkombëtar, ata majmën klasën e re kapitaliste shfrytëzuese të qytetit dhe të fshatit, ata kanë ngritur më këmbë një diktaturë fashiste për t'u ruajtur pasuritë që i kanë grabitur nga populli dhe që ta shtypë e ta gjakosë këtë. Më kot flet klika titiste për njëfarë vetadministrim. Çfarë «të vetadministrojë» populli jugosllav, fabrikat që janë të kapitalit të huaj dhe të kapitalistëve të rinj apo fushat që i sundojnë kulakët?

Është zor të gënjeshtër të gjithë popullin dhe për një kohë të gjatë, thotë një fjalë e urtë. Populli jugosllav dhe rinia e tij nuk mund të gënjehen kur Titoja u flet për njëfarë socializmi, për njëfarë vetadministrimi, kur, nga ana tjetër, ata s'kanë liri, kur ata shohin se matrapazët po e shesin vendin e tyre në ankand të kapitalistët e huaj, kur shohin se klasa e re sunduese po spekulon paturpësisht dhe punëtorët e rinia enden pa punë nëpër rrugë, ose me qindra mijë në vit largohen në mërgim nëpër botë, pasi vendi i tyre, gjoja socialist, nuk ka t'i ushqejë.

Në Jugosllavinë titiste mbretëron kaosi. Studentët e guximshëm të Beogradit u ngritën në revoltë kundër këtyre poshtërsive dhe tradhtive të mëdha. Regjimi i Titos u drodh nga themelitet. U vunë në veprim bombat lotsjellëse dhe shkopinjtë e udbashëve. Studentët e revoltuar i bënë ballë dhunës fashiste me dhunë revolucionare. Fitorja ishte e studentëve. Titoja u përul, por gënjeu, mashtroi, bëri demagogji, siç e ka zakon. Por vallë bindi njeri Titoja? Asnjëri. Të gjithë jugosllavët e ndershëm e dinë se ai është autori i kësaj gjendjeje, se, për ta ndrequr këtë gjendje, duhet të kalojë fshesa e hekurt e revolucionit dhe

këtë u përket ta bëjnë marksistë-leninistët revolucionarë, në krye të klasës punëtore dhe të popujve të Jugosllavisë dhe jo renegatët, të shiturit, agjentët dhe shërbëtorët e ndyrë të kapitalit ndërkombëtar.

Prandaj revolucioni në vendet revizioniste është në ngritje, kurdoherë në ngritje, revizionizmi është në krizë të madhe.

Kurse tjetër karakter kanë demonstratat e studentëve në vendet kapitaliste. Ato janë më revolucionare. Studentët u ngritën në demonstrata të fuqishme kundër pushtetit kapitalist të vendit të tyre. Ata u goditën, u gjakosën me policinë, ngritën barrikada, sulmuan, u plagosën dhe u vranë. Plagosën, gjakosën dhe vranë edhe policë.

Në Francë ata i dhanë zjarr grevës më të madhe të punëtorëve, u solidarizuan me ta dhe bënë që qeveria e këtij vendi, aq shumë e reklamuar si e fortë, të tronditej nga themeli, të vinte në lëvizje ushtrinë rreth Parisit, të ndryshonte disa ministra, të shpërndante Asamblenë Kombëtare dhe të vendoste për të bërë zgjedhje të reja etj.

Pavarësisht nga arsyet që i shtynë studentët të ngrihen në demonstrata, dhe këto janë të ndryshme — arsimore, ekonomike, politike, ideologjike, strukturore, universitare, ato vërtetuan se rinia, po të frymëzohet, është një forcë luftarake e guximshme. Rrymat e ndryshme politike që ndikuan në fillim, nuk dukeshin qartë, pasi, po të gjykohet në përgjithësi nga lajmet, është fakt se partitë politike, sidomos në Francë, kjo çështje i gjeti në befasi dhe revizionistët francezë tok me reaksionin, haptazi, i sulmuan dhe i

diskredituan studentët, që u hodhën në demonstrata kundër pushtetit.

Rëndësi ka se të tilla demonstrata u zhvilluan dhe po zhvillohen në Republikën Federale të Gjermanisë, në Spanjë, në Itali, në Angli, në Belgjikë, në Francë, në Jugosllavi, në Turqi, në Amerikën Latine etj. Pavarësisht nga larmia e mendimeve, e pikëpamjeve politike që mbretërojnë në radhët e tyre, një gjë është e dukshme: të gjithë sulmojnë fuqitë shtetërore kapitaliste të vendosura. Këto demonstrata janë provat e para, janë fillimi i shijimit dhe i përdorimit të dhunës revolucionare kundër dhunës borgjezo-fashiste. Këtu, në këto momente dhe në këto turma të guximshme të rinjsh, duhet të futen partitë e reja marksiste-leniniste, shokët tanë revolucionarë, për të punuar e për të luftuar tok me ta, për t'i sqaruar dhe për t'i udhëhequr.

Ky është një zjarr që u ndez dhe që zor të shuhet. Ai mund të shtypet përkohësisht, por prapë do të pëlçasë. Ky zjarr do të pëlçasë, pasi çështja që e fryn është çështje politike, janë kundërshtimet e rinisë dhe, në veçanti, të studentëve kundër pushtetit kapitalist që i shtyp, që i shfrytëzon, që u ka mbyllur perspektivat e jetës. Këto janë shkaqet kryesore të revoltës, arsyet dhe shkaqet e tjera këtu e kanë burimin. Horizonti i rinisë është i mbyllur nga kapitalizmi.

Rinia nuk e ka jetën të sigurt në regjimin kapitalist dhe, kur ajo arrin një moshë pjekurie në gjykime dhe në punë, i sheh më qartë pengesat e pakapërcyeshme që i kanë vënë kapitalizmi, prona private, organizimi i trusteve dhe teknokracia. I riu që do të

edukohet, të shkollohet, nuk i ka mundësitë financiare, sepse taksa të rënda e me dhjetëra pengesa të tjera ekonomike, administrative, universitare, klasore, raciale e pengojnë atë të plotësojë një nevojë të jetës dhe aq të domosdoshme në një botë kapitaliste, ku diploma është bërë mjeti më i vogël i mundshëm për nxjerrjen e bukës, përndryshe i riu është i destinuar që më parë të shtojë radhët e të papunëve. Kështu që të tilla kufizime për studime i vihen vazhdimisht e në një numër të pambaruar rinisë në vendet kapitaliste. Bëhet, kështu, seleksionimi i parë kolosal. Pastaj fillon i dyti, seleksionim në provime, dhe i treti, seleksionim i gjetjes punë për ata që mbeten, si të thuash, mbi shoshë. Kështu, rininë e presin mjerimi, vuajtjet, papunësia, poshtërimi.

Në të gjitha këto faza është rinia popullore ajo që e pëson, prandaj është ajo që lëviz, e shkundur nga të gjitha këto pakënaqësi dhe padrejtësi flagrante, që formulohen në rivendikime me karakter të ndryshëm, mjaft herë edhe me prirje politike të paformuluara qartë, por që në bazë të tyre qëndrojnë çështje politike dhe vetëm çështje politike.

Në bazë të problemit të studentëve dhe të rinisë në përgjithësi, në vendet kapitaliste qëndron çështja e revolucionit, e përmbysjes me dhunë të pushtetit të borgjezisë, i cili është burimi i të gjitha fatkeqësive të tyre.

Fakt është se deri tani organizimi i komunistëve në gjirin e rinisë dhe të studentëve në vendet kapitaliste është akoma i dobët, për arsyen e tradhtisë së revizionistëve, por ideja e revolucionit tek ata është e madhe dhe frymëzuese. Ata ndiejnë çdo ditë shtyp-

jen materiale dhe shpirtërore, ata po kuptojnë metodat e degjenerimit që përdor kundër tyre kapitali, ata shohin rezultatet shkatërruese të këtyre metodave në kurrizin e tyre. Pikërisht kësaj dare ata kërkojnë t'i shpëtojnë dhe për këtë kërkojnë rrugët.

Rrugën e socializmit ua errësuan përkohësisht revizionistët modernë, ndërsa kapitalizmi monopolist, tok me revizionistët, përpiqet t'u krijojë atyre një kaos të ri pa rrugëdalje, ose t'u farkëtojë një skllavërim të ri.

Siç ka njoftuar shtypi, studentët e Parisit, në demonstrata e në barrikada, u shquan nga hovi revolucionar kundër forcave të qeverisë dhe kundër bonzëve të partive politike dhe të sindikatave. Pra, studentët nuk kishin besim në ta. Tendenca e tyre e dukshme dhe e zbatuar në praktikë ishte bashkimi i çështjes së tyre me atë të punëtorëve, pavarësisht se te studentët kishte lloj-lloj rrymash politike. Kështu, studentët, të papunët e nesërm e panë qartë se ku duhet të mbështeten dhe cila ideologji duhet t'i udhëheqë.

Edhe qeveritë kapitaliste, edhe revizionistët francezë, edhe Titoja e panë këtë rrezik dhe manovruan me të gjitha mjetet që kjo lidhje e shëndoshë të mos bëhej, që lëvizja e studentëve të diskreditohej, të izolohej. Revizionistët francezë i dhanë një ndihmë kolosale kapitalit francez. Kreu i kapitalit francez, kur deklaroi se armiku i tij ishte komunizmi, nuk gabohej. Ai me këtë kuptonte klasën punëtore dhe marksizëm-leninizmin dhe jo revizionistët francezë, të cilët u treguan lakej të vërtetë të kapitalit francez.

Por revolta e studentëve në vendet kapitaliste nuk do të shuhet. Ajo do të shkojë kurdoherë në ngjitet

dhe do të kanalizohet në dallgën e madhe të revolucionit proletar, ajo do të kristalizohet ideologjikisht dhe politikisht. Idetë ngadhënjimtare të marksizëm-leninizmit do të pushtojnë mendjen dhe zemrën e studentëve të të gjithë botës dhe do t'i bashkojnë ata plotësisht me klasën e proletarëve në revolucionin botëror, për të përmbysur me armë pushtetin e kapitalit dhe për të ndërtuar socializmin, siç vepruam ne.

Rinisë së botës kapitaliste, studentëve të kësaj bote dhe rinisë e studentëve të vendeve revizioniste duhet t'u hapen perspektivat e qarta të revolucionit proletar. Rrëzimi i borgjezisë me dhunë, vendosja e diktaturës së proletariatit dhe ndërtimi i socializmit në bazat shkencore të marksizëm-leninizmit, do të zgjidhin gjithë problemin e madh brenda të cilit qëndron edhe zgjidhja e problemeve nga më kapitalet të jetës së një populli, problemet e rinisë, të rritjes, të edukimit dhe të pjesëmarrjes së saj aktive në punë e në çdo drejtim, në mënyrë që ajo ta ndiejë veten plotësisht të lirë, plotësisht të lumtur në atdheun e saj, që vetë e ndërton, që vetë e drejton, që vetë e zbukuron, ku vetë përgatit për brezat e ardhshëm një jetë kurdoherë e më shumë të harmonishme.

Për këtë problem merr një rëndësi të madhe vlera e ndërtimit të socializmit në vendin tonë. Në veçanti, me anë të materialeve tona që paraqesin realitetin shqiptar, rinia e botës është në gjendje të kuptojë rëndësinë dhe drejtësinë e revolucionit tonë proletar, të udhëhequr nga Partia jonë marksiste-leniniste, si dhe rëndësinë e thellë të reformave tona, të përparimit tonë në të gjitha fushat. Prapambetja jonë ma-

teriale në disa sektorë, që edhe kjo do të kapërcehet, nuk u detyrohet sistemit tonë socialist dhe ideologjisë sonë marksiste-leniniste. Ajo i detyrohet shtypjes së mëparshme feudalo-borgjeze. Le të shohë rinia e botës se sa përpara jemi ne nga bota kapitaliste, nga shumë pikëpamje, dhe pikërisht në ato çështje për të cilat ajo lufton dhe do t'i duhet të luftojë akoma.

Shokë e shoqe,

Idetë e revolucionit dhe të luftës çlirimtare gjithnjë e më shumë po bëjnë për vete popujt dhe revolucionarët e vendeve të ndryshme. Stuhia e luftës revolucionare kundër imperializmit dhe revizionizmit është në ngritje.

Bota kapitaliste dhe revizionizmi modern po kalojnë një krizë të madhe politike dhe ekonomike. Kjo është pa dyshim rezultat i hovit revolucionar të popujve, i luftërave të tyre në të katër anët e kontinenteve, kundër shtypjes dhe shfrytëzimit kapitalist, kundër kolonializmit të vjetër dhe neokolonializmit, kundër rrymave ideologjike mashtruese, që përdorin në një larmi të madhe imperializmi, borgjezia dhe revizionizmi për të trullësuar mendjen dhe imagjinatën e njerëzve, për t'u dhënë gjoja një shpjegim teorik politikës së tyre të luftërave grabitqare imperialiste, shfrytëzimit shtazarak të popujve, shantazhit atomik, ëndrrës së «botës pa armë e pa luftëra», ndarjes së botës në sfera influence, sundimit të popujve nga dy «superfuqi atomike», nën maskën e «bashkekzistencës paqësore» etj.

Kjo krizë e madhe e botës kapitaliste dhe revizioniste, që është shkaktuar nga ngjitja e revolucionit dhe që do të përfundojë, në një proces zinxhir të pashmangshëm, në revolucionin e madh proletar botëror, mund të kuptohet, të shpjegohet dhe të thellohet vetëm me teorinë e pavdekshme dhe kurdoherë të re, marksizëm-leninizmin.

Imperializmi, borgjezia, revizionizmi modern e dinë se ngjitja e revolucionit është vdekjeprurëse për ta, prandaj ata përdorin çdo mjet, që nga demagogjia e deri tek armët, për ta shtypur, nën çdo formë që ai të paraqitet, në çdo fazë të zhvillimit të tij.

Revolucioni, në çdo formë fillestare dhe në çdo etapë, i udhëhequr nga marksizëm-leninizmi, është ai që del fitues mbi çdo pengesë. Prandaj teoricienët e imperializmit, të borgjezisë dhe të revizionizmit modern bëjnë të gjitha përpjekjet të eliminojnë nga mesi, po të jetë e mundur, marksizëm-leninizmin dhe, në pamundësi që t'ia arrijnë kësaj, bëjnë çmos ta deformojnë atë, ta bëjnë të parrezikshëm, ta revizionojnë kokë e këmbë.

Teoria e Marksit dhe e Leninit për kalbëzimin dhe për shkuarjen drejt shembjes definitive të kapitalizmit dhe të imperializmit, nëpërmjet revolucionit të armatosur dhe dhunës revolucionare, jo vetëm nuk është vjetruar, jo vetëm nuk është kapërcyer, sikundër thonë armiqtë tanë, por ajo është e re, si në ditët e saj të rinisë, dhe jeta e vërteton këtë. Asnjë shpikje e re, qoftë kjo përkohësisht në duart e një grushti kapitalistësh, nuk mund as të ndryshojë ecjen e revolucionit përpara dhe as të errësojë teorinë e pararojës, marksiz-

zëm-leninizmin. Nuk janë kapitalistët ata që kanë krijuar përparimin teknik dhe, ca më pak, mirëqenien ekonomike. Krijimtaria është e tjetërkujt dhe sistemi e ka bërë pronë të tjetërkujt, të një grushti shfrytëzuesish. Zhvillimi në vendet kapitaliste është gjaku dhe djersa e klasës punëtore dhe e punonjësve që shfrytëzohen.

Asgjë nuk mund ta shpëtojë klasën kapitaliste nga vdekja. Revizionistët modernë sovjetikë, titistë dhe revizionistët e tjerë janë kapitalistë dhe imperialistë të rinj, që shtuan radhët e të vjetërve dhe që tani mund të themi me siguri se ata identifikohen plotësisht me kapitalistët dhe me imperialistët e vendeve të tjera. Këta u shkaktuan dëme të mëdha vendeve të tyre socialiste, i shndërruan ato në vende kapitaliste; këta i shkaktuan dëme revolucionit botëror, e frenuan atë dhe përpiqen ta frenojnë; këta u shkaktojnë dëme luftërave çlirimtare të popujve, të cilat i pengojnë, i shuajnë, por ligjit të revolucionit nuk kanë ç'i bëjnë, revolucionin as në vendet e tyre e as në botë ata nuk mund ta ndalojnë. Ai ecën përpara. Këtë e vërtetojnë faktet.

Revizionistët modernë sovjetikë dhe revizionistët e tjerë, që kanë marrë fuqinë në vendet e tyre ish-socialiste, përpiqen, brenda dhe jashtë, të propagandojnë se kapitalizmi që ata kanë restauruar, qenka kurdoherë «socializmi», bile më i avancuar, më puro, në Bashkimin Sovjetik është fare «komunizmi».

Kurse teoria që e udhëheq këtë farë socializmi dhe komunizmi është, sipas tyre, marksizëm-leninizmi më i kulluar, ai i vërteti. Kuptohet, pra, ç'rol po

luajnë këta tradhtarë të marksizëm-leninizmit. Ata janë avangarda e diversionistëve, e kolonës së pestë kapitaliste në lëvizjen komuniste ndërkombëtare.

Duke qenë, pra, të tillë, këta janë të detyruar politikisht, ideologjikisht, organizativisht, ekonomikisht ta shohin botën dhe zhvillimin e saj në të njëjtin prizëm me kapitalistët e vendeve dhe të kontinenteve të tjera, të koordinojnë punët dhe veprimet, të lidhin marrëveshje dhe aleanca të reja me njëri-tjetrin, të krijojnë koniunktura të reja.

Në mes tyre ka kontradikta të mëdha dhe të tjera do t'u lindin. Këto janë kontradikta të pashmangshme në gjirin e ujqve kapitalistë. Kontradiktat e revizionistëve sovjetikë me imperialistët e tjerë janë të po asaj natyre dhe e kanë burimin në ato kroje që e kanë, për shembull, edhe kontradiktat në mes Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Francës. Por revizionistët blofojnë për të fshehur natyrën e vërtetë të këtyre kontradiktave. Ata thonë që «kemi kontradikta pasi ne jemi komunistë dhe ata janë kapitalistë», por kjo është një rrenë me bisht, se të dy palët janë kapitalistë.

Revizionistët sovjetikë, që udhëheqin këtë stan tradhtarësh, me teoritë dhe me analizat e tyre antimarksishte, antishoqërore, kërkojnë të shpjegojnë ngjarjet që po zhvillohen sipas recetave që po shpërndan nëpër botë kreu i imperializmit botëror, receta që konkretizohen në marrëveshje, në aleanca famëkeqe të shumëllojta dhe në ndërtime urash në mes Bashkimit Sovjetik e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në mes kapitalistëve të ndryshëm dhe klikave revizioniste. Kë-

saj tradhtie hrushoviane i është vënë emri «bashkekzistencë paqësore».

Por me gjithë këto e të tjera si këto, ç'po ngjet në botë?

Kudo që ka këmbë amerikani, si në Vietnam e gjetkë, ka luftë popullore me armë, ka revolta, ka rezistencë. Kundër tyre luftojnë popujt, komunistët, patriotët në të gjitha kontinentet. Brenda, vetë Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë në krizë të madhe, negrit sulmojnë, studentët sulmojnë. Kingu, dy Kenedët vriten si qentë në vreshtë. Dollari është në krizë të madhe, saqë Xhonsoni u shtrëngon rripin popullit amerikan dhe satelitëve të tij evropianë e aziatikë. Kudo ku ndërhyt, imperializmi amerikan financon me armë për agresion, si: Izraelin kundër popujve arabë, fashistët indonezianë për të vrrarë gjysmë milioni komunistë e patriotë etj. Në Amerikën Latine luftohet kudo kundër thundrës janki. Me një fjalë, s'ka ku vete më qartë, aleat i denjë për revizionistët sovjetikë!

Anglia kalon një krizë shumë të rëndë ekonomike, natyrisht, edhe politike, ajo është bërë si pulë e lagur, rron nën hijen e daj Samit. Në të njëjtën gjendje janë edhe vendet e tjera kapitaliste të Evropës dhe të kontinenteve të tjera. Kazani zien kudo dhe në disa prej tyre kapaku fluturon në erë.

Kurse vendet revizioniste, me Bashkimin Sovjetik dhe me Jugosllavinë në krye, janë në krizë të madhe, në kaos të brendshëm e të jashtëm.

Kriza ekonomike që po thellohet në botën kapitaliste, ka zënë për gryke e po mbyt edhe vendet revizioniste, me Bashkimin Sovjetik, në radhë të parë.

Kjo krizë e madhe në këto vende është konsekuenca e transformimit kapitalist në ideologji, në politikë, në ekonomi, në organizim, në mënyrën e jetesës, janë lidhjet e aleancat e shumëllojta që ata kanë lidhur me kapitalistët e ndryshëm, janë kreditë skllavëruese që ata kanë marrë prej tyre, është futja, pra, progresivisht e tyre nën varësinë ekonomike dhe politike të kapitalit botëror. Pra, goditjet e krizës botërore kanë pushtuar njëlloj si vendet kapitaliste ashtu edhe ato revizioniste. Tradhtarët revizionistë sovjetikë kalojnë një nga krizat më të rënda, pasi e gjithë politika e tyre u demaskua, falimentoi, si brenda edhe jashtë. Klika e tradhtarëve të Kremlinit gjendet në mes shumë zjarreve që do ta përpijnë. Ajo përpiqet të imponohet me forcë, me gënjeshtër, me masa të përkohshme mbi klikat satelite revizioniste në vendet e tjera, të cilat, edhe ato, manovrojnë me kapitalistët, me revizionistët sovjetikë, me djallin dhe me të birin, për të zgjatur jetën e tyre, që nuk e kanë të gjatë.

Por tradhtarët e Kremlinit po sulmohen edhe nga brenda, ata po shqyhen dhe bëjnë çmos të paraqiten se janë në unitet. Por fshati që duket s'do kallauz. Tradhtarët e Kremlinit blegërijnë skutave se gjoja po realizojnë gabimet, se Stalini, sipas ndonjë mareshali të vënë prej tyre, ishte njeri i madh, ishte njeri i zoti, se gjoja Titoja është një tradhtar e një agjent i amerikanëve, se Stalini i kishte parë drejt këto çështje etj.

E njohim me kohë këtë taktikë hrushoviane. E dimë fare mirë se ç'fshihet prapa këtyre frazave demagogjike. Por kjo, megjithatë, tregon se klika tradh-

tare e Kremlinit i ka punët keq dhe çdo ditë që kalon më keq do t'i ketë. Tradhtia do të mposhtet, do të triumfojë prapë marksizëm-leninizmi në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e tjera, ku tani sundojnë revizionistët modernë.

Të dashur shokë dhe shoqe të rinisë,

Rinia e vendit tonë dhe organizata e saj luftarake, Bashkimi i Rinisë së Punës të Shqipërisë, të edukuara nga Partia me idetë e marksizëm-leninizmit e të internacionalizmit proletar, shikojnë me simpati dhe përkrahin luftën e drejtë e të vështirë që zhvillojnë të rinjtë e të rejtat në vendet e ndryshme kundër zgjedhës së kapitalit dhe tradhtisë revizioniste. Ne kemi bindjen e thellë se shpejt a vonë, lufta e tyre, duke u përfshirë në rrymën e fuqishme të lëvizjes revolucionare të klasës punëtore dhe nën udhëheqjen e partive marksiste-leniniste, do të arrijë fitoren.

Për sa i përket brezit tonë të ri, ai, i rritur me kujdes nga Partia jonë e Punës, i brumosur me idealet e mëdha të socializmit dhe i sigurt për të ardhmen e tij, do të ecë i patundur në rrugën që i tregon Partia, si një forcë e gjallë e revolucionit proletar dhe e ndërtimit socialist në vendin tonë.

Ato të drejta, kushte e mundësi që gëzon sot rinia jonë, të arritura me gjak, me djersë e me sakrificë të panumërta, janë fitore të mëdha historike, të cilat duhet t'i kuptojmë e t'i vlerësojmë me pjekuri e me vetëdije të plotë, t'i ruajmë si dritën e syrit dhe

t'i zhvillojmë më tej me luftën dhe me punën tonë të palodhur.

Të gjithë, populli dhe rinia jonë, t'i shtrëngojmë akoma më fort radhët, të çelikosim përditë e më shumë unitetin luftarak rreth Partisë dhe, nën udhëheqjen e saj, të çojmë kurdoherë përpara revolucionin tonë fitimtar. Të mos harrojmë për asnjë çast rrethimin imperialisto-revizionist, prandaj, kurdoherë, ta mbajmë barutin të thatë, të mos harrojmë armiqtë e jashtëm e të brendshëm, të zhvillojmë, kurdoherë, me guxim luftën e klasave, të jemi gjithnjë në sulm, në revolucion, me kazmën në njërën dorë dhe me pushkën në tjetrën, luftëtarë të paepur për lulëzimin dhe për përparimin e atdheut tonë socialist, mbrojtës të vendosur të lirisë dhe të pavarësisë dhe të të gjitha fitoreve që ka arritur populli ynë.

Duke përfunduar, dua t'ju uroj juve, ndërtuesve të palodhur të Hekurudhës Rrogozhinë-Fier dhe gjithë të rinjve e të rejave të Shqipërisë, suksese të mëtejshme të mëdha në çdo gjë: në punë, në mësim dhe në jetën tuaj prej revolucionarësh të rinj.

Rroftë rinia jonë e lavdishme!

Të rrojë Partia e Punës, edukatorja dhe mësuesja e brezit tonë të ri!

Lavdi marksizëm-leninizmit!

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 155 (6194), 29 qershor 1968

Botohet me ndonjë shkurtim sipas librit: Enver Hoxha. «Raporte e fjalime 1967-1968», f. 417. Tiranë, 1969

**PUNË DHE SHKENCË, PUNË DHE DITURI — KJO
ËSHTË DETYRË E RËNDËSISHME PËR
TË GJITHË PUNONJËSIT**

*Bisedë me kuadro dhe me punëtorë të qytetit
të Patosit*

29 qershor 1968

Të dashura shoqe dhe shokë punëtorë,

Jam shumë i gëzuar që erdha sot në qendrën e rëndësishme të naftës në Patos. Ju e mësuat se dje në hekurudhë unë u poqa me vullnetarët e rinisë, të cilëve u fola për disa çështje që më kishte porositur Byroja Politike dhe jam i bindur se jeni dakord me ato që thashë.

Rinia jonë, me rininë punëtore në krye, i meriton vlerësimet që Partia u bën punës dhe patriotizmit të saj të madh, vendosmërisë, dashurisë së pakufishme të saj për Partinë, për popullin dhe për punën. Vetëm me punë do të ecë akoma më përpara atdheu ynë socialist, prandaj, në shembullin e klasës sonë punëtore, duhet të edukohen të gjithë, i madh dhe i vogël. Në rrugën e saj të ecë, të punojë, të edukohet e të kalitet edhe rinia. Kjo është direktiva e Partisë.

Edhë në drejtim të edukimit, klasa punëtore zë vendin kryesor. Jo vetëm nuk është e drejtë, po nuk është as reale të mendohet tani se janë të tjerë ata, ose është ndonjë klasë tjetër më e zonja dhe më e ngritur se klasa punëtore. Koha kur mendohej dhe flitej në këtë mënyrë ka kaluar njëherë e përgjithmonë te ne, bashkë me klasat shfrytëzuese që e ushqenin atë. Aktualisht, klasa jonë punëtore është klasa më e ngritur politikisht dhe ideologjikisht, ashtu siç është e para edhe në punë. Për këto arsye të ecim të tërë në shembullin e saj, të mësojmë dhe të udhëhiqemi nga ajo, të korrigjohemi kur bëjmë gabime. Klasa punëtore nuk duhet të na fërkojë krahët edhe kur punojmë mirë, sepse, fundi i fundit, ai që punon mirë, bën detyrën, asgjë më shumë. Çdo qytetar i Republikës e ka për detyrë patriotike të punojë mirë, të punojë me ndershmeri, të punojë për interes të popullit dhe sipas orientimeve të Partisë, të punojë në rrugën e klasës punëtore, që udhëheq te ne gjithë jetën e vendit.

Ju punëtorët e naftës jeni të ndërgjegjshëm se në gjirin e mbarë klasës sonë punëtore zini një vend të rëndësishëm nderi për të gjitha arsyet që thashë e që janë çështje parimore, por edhe për një arsye tjetër, që është, gjithashtu, shumë e rëndësishme dhe parimore: ju punoni dhe jetoni në një sektor që është jetik dhe nga më të rëndësishmit e ekonomisë sonë popullore. Nafta ka rëndësi të jashtëzakonshme për përparimin e vendit e këtë rëndësi ajo do ta ketë edhe në të ardhmen, edhe po të ngremë reaktorë atomikë për prodhimin e energjisë. Shkenca do të ecë

përpara, prandaj do të vijë medoemos koha që edhe ne të ndërtojmë objekte të fuqishme për prodhim energjie, megjithatë, edhe kur të kemi mjete të tilla, nafta do të mbetet prapë një nga prodhimet më të nevojshme për zhvillimin e pandërprerë të ekonomisë sonë.

Ju, vazhdimisht, keni punuar dhe vazhdoni të punoni me vetëmohim për t'i dhënë atdheut sa më shumë naftë. Krahas plotësimit të kësaj detyre Partia është kujdesur që ju të lartësoheni në çdo drejtim. Dhe ju, ashtu siç keni shfaqur zotësi në punë, jeni shquar edhe në mësim. Tani ne vëmë re me kënaqësi se punëtorët tanë të naftës s'janë më si përpara, ata kanë arritur një shkallë të mirë zhvillimi kulturor dhe janë ngritur mjaft në përgatitjen e tyre profesionale që është e shumëllojtë dhe e ndërlikuar. Kjo do të thotë se për të nxjerrë naftë është e domosdoshme të gërshetohen dhe të gjejnë zbatim disa disiplina shkencore. Për këtë qëllim nuk mjafton vetëm një kategori, por shumë kategori shkencëtarësh, nuk mjafton vetëm një kategori punëtorësh, por edhe shumë punëtorë të specializuar në profile të ndryshme. Në sektorin e naftës punojnë, pra, në kombinim të shumëfishtë dhe të harmonishëm me njëri-tjetrin, shumë kategori punëtorësh, teknikësh, specialistësh e shkencëtarësh.

Partia konstaton se përpjekjet e punëtorëve, të teknikëve dhe të drejtuesve, të gjithë punonjësve të naftës, për të mësuar e për të përvetësuar shkencën dhe teknikën, kanë qenë të lavdërueshme. Në radhët e tyre shihet një ngritje e gjithanshme. Ishin puna, zotësia dhe niveli i diturisë suaj, të cilat bënë që vendi ynë të kapërcente me sukses disa vështirësi, që mund

të rrezikonin ecjen tonë përpara në rrugën e socializmit, me ritmet e dëshiruara, që mund të rrezikonin pavarësinë ekonomike të vendit tonë. Arritjet në ekonominë tonë do të vareshin nga nafta që do të prisnim të na vinte nga jashtë, po të mos ishin kontributi dhe zotësia juaj. Në kushtet e krijuara pas prishjes me revizionistët, çështja për ne shtrohej kështu: Ose të prananim prapambetjen, ose të bëheshim skllavër të revizionistëve modernë. Sigurisht, skllavërinë ne nuk do ta prananim kurrë. Pavarësisht se do të mbeteshim të varfër, do të preferonim të vuanim, por frymën revolucionare do ta mbanim kurdoherë lart, do të luftonim me shpirt në dhëmbë dhe atdheun do ta ruanim si sytë e ballit. Por veç këtë zhvillim të madh që kemi realizuar, nuk do ta kishim.

Ju, naftëtarët, jeni nga ajo pjesë e klasës sonë heroike punëtore që keni kontribuar fuqimisht qysh në fillim në ndërtimin e socializmit, në ruajtjen e lirisë e të pavarësisë së atdheut. Juve ju kujtohet fare mirë se si, pas Çlirimit, nuk kishim, ose kishim shumë pak kadro. Partia, atëherë, u kujdes dhe dërgoi pa vonesë, për këtë qëllim, djem e vajza nëpër shkolla për përgatitjen e për ngritjen e kuadrove teknike të mesëm e të lartë, që do të na duheshin për të gjithë sektorët. Por fakt është se në vitet e para të jetës sonë të re ne kishim shumë nevojë për ndihmë dhe specialistët e kuadrot e huaj, që na u dërguan në fillim, kur ishte gjallë Stalini, qenë njerëz të mirë, pse pikërisht orientimi dhe vija e Partisë në Bashkimin Sovjetik në atë kohë ishin të drejtë. Mirëpo pas vdekjes së Stalinit, atje mori të përpjetën revizionizmi,

filloi degjenerimi, kështu ndryshoi krejt edhe orientimi dhe kuadrot që na dërgoheshin mbanin qëndrim krejt ndryshe nga përpara.

Të gjitha këto ju i dini mirë, se e keni jetuar këtë periudhë, prandaj nuk po zgjatem, vetëm dëshiroj të përmend se, pikërisht në ato momente të vështira, kur revizionistët menduan se ne do të falimentonim, ne nuk falimentuam, nuk u mposhtëm në asnjë drejtim, në asnjë sektor, bile as në sektorin e vështirë të naftës. Ju, shokë punëtorë, teknikë e specialistë i vutë një qëllim të madh vetes dhe me zotësi e me vendosmëri, të frymëzuar nga vija e drejtë luftarake e Partisë, u gjendët në krye të detyrës, me një patriotizëm të shquar dhe, si bolshevikë të vërtetë, i vutë gjoksin punës për të siguruar nxjerrjen e naftës vetë, me forcat tuaja dhe ia arritët këtij qëllimi. Populli dhe Partia ushqejnë respekt të madh për ju që punoni në këtë sektor të rëndësishëm të ekonomisë sonë popullore, për përpjekjet, për luftën dhe për punën tuaj, për të gjithë ata punëtorë, teknikë, inxhinierë, gjeologë, kimistë e të tjerë, të cilët punuan menjëherë pas prishjes me revizionistët sovjetikë dhe me zotësinë, me eksperiencën, me trimërinë e tyre, udhëhoqën në ato kohë të vështira punimet dhe i çuan ato përpara me sukses. Partia dhe populli, në mënyrë të veçantë, kanë një respekt të madh për ta, ashtu si për të gjithë ju, pra, për shokët tuaj të vjetër, që janë njerëz me cilësi të mira, me aftësi e me eksperiencë të madhe dhe që tani janë bërë punonjës të kualifikuar. Kjo tashmë është një gjë e njohur dhe e fituar.

Merret me mend ç'do të ndodhte në vendin tonë

sikur në ato periudha të vështira të mos kishim naftë. Do ta blinim, mund të thotë dikush. Mirë, mund ta blinim dhe kjo s'është ndonjë punë e zorshme, po vihet pyetja: Me se ta paguanim, me ç'mjete ta sillnim? «I zoti e di ku i pikon shtëpia», thotë një fjalë e urtë popullore dhe në ato kushte ç'të sillnim më parë? E kuptoni, pra, se ç'vlerë të madhe kishte dhe se ç'vlerë të madhe ka akoma një pikë naftë për ne? Revizionistët sovjetikë, që kanë tradhtuar marksizëm-leninizmin, kanë tradhtuar popullin e tyre, siç kanë tradhtuar edhe popullin çekoslovak, popullin hungarez e popujt e tjerë të vendeve të ish-demokracisë popullore, ku kanë ndërtuar me qëllim vajgursjellës, me të cilët vërtet u çojnë naftë satelitëve të tyre, po kjo është edhe një mjet skllavërimi, se, po të lëvizin këta sadopak e të mos u binden, revizionistët sovjetikë ua presin naftën. Kurse neve, revizionistët sovjetikë nuk kishin ç'na bënë, sepse ne as i ngritëm dhe as i ngremë duart, përkundrazi, u kemi treguar dhe u tregojmë grushtin dhe vendin, atje ku e kanë, gjithë tradhtarëve dhe armiqve të socializmit dhe të çështjes së madhe të lirisë e të pavarësisë së popujve.

Nafta që nxjerrim ne, ndihmon shumë në zhvillimin e industrisë dhe të bujqësisë sonë. Sigurisht, ne nuk notojmë në bollëk nafte dhe ju e dini që kemi akoma nevoja të mëdha. Ju vetë jeni të ndërgjegjshëm për detyrat e shumta e të vështira që keni përpara, por si punëtorë të pararojës në atdheun tonë socialist, si një shtyllë e klasës sonë punëtore, ju e kuptoni se ç'detyra të mëdha e të rënda keni akoma për të kryer. Perspektivat e zhvillimit të industrisë së naftës

te ne janë të mira. Të dhënat e deritashme për naftën, siç më raportuan shokët në Visokë, janë optimiste.

Gjer tani ne kemi zbuluar disa vendburime nafte dhe kemi bindjen se në të ardhmen do të zbulojmë të tjera të reja. Kur të arrijmë t'i zbulojmë këto vendburime të reja dhe sasia e naftës të shtohet, atëherë edhe rafineritë ekzistuese do të jenë të pamjaf-tueshme për të përpunuar të gjithë sasinë e naftës që do të prodhojmë në vend. Veç kësaj, niveli aktual teknik i përpunimit të naftës sonë në rafineritë ekzis-tuese nuk është në nivelin botëror. Prandaj, për të ardhmen, na del detyrë t'i shkojmë deri në fund ra-finimit të plotë të naftës sonë, t'ia marrim asaj të gjitha nënproduktet, që s'kemi mundur t'i prodhojmë dot deri tani. Këtej e tutje ne duhet t'i krijojmë këto mundësi dhe ta shfrytëzojmë në maksimum naftën tonë, të nxjerrim prej saj të gjitha nënproduktet, ta trajtojmë plotësisht, siç e trajtojnë edhe në vendet kapitaliste, që e blejnë nga ne.

Një perspektivë e madhe i hapet industrisë sonë të naftës. Që ta realizojmë këtë perspektivë duhet të vazhdojmë të mësojmë, të marrim dituri, pra, bashkë me punën të mos lëmë pas dore mësimin. Punë dhe shkencë, punë dhe dituri, kjo është detyrë e rëndësi-shme jo vetëm për drejtuesit e teknikët e naftës, por deri edhe për punëtorin më të thjeshtë. Të gjithë të mësojnë, si kudo edhe këtu te ju, sepse kjo perspek-tivë e madhe nuk realizohet vetëm me punë. Sigurisht, duhen edhe makina, mjete e fabrika moderne, sepse pa to nuk bëhet. Ato ne do t'i sigurojmë, por më parë të bëjmë vetë atë që na përket.

Në vendin tonë çdo gjë ecën në rrugën marksiste-leniniste, ekonomia fuqizohet, industria rritet vazhdimisht, perfeksionohet, modernizohet dhe prodhon për popullin. Çdo vepër të re që ngremë, e realizojmë në sajë të ekonomizimeve që bëjmë, shpeshherë të mëdha. Jo rrallë ka ndodhur që neve të na mungojnë shumë gjëra, nganjëherë nuk kemi ngrënë aq shumë djathë e ullinj, se na është dashur t'i eksportonim që të blenim diçka tjetër që na duhej, një vegël, një punishte të vogël, një fabrikë apo një makinë. Duke ekonomizuar kështu, duke bërë sakrifica, ne, dalngadalë, arritëm në nivelin e tanishëm të një ekonomie të shëndoshë. Natyrisht, ne nuk eksportojmë artikuj ushqimorë, si: djathë e ullinj, në atë masë sa të mos ketë tregu ynë, sepse politika e Partisë ndjek parimin që mirëqenia e njerëzve tanë të vijë gjithnjë duke u rritur, që populli, në radhë të parë, të ketë të hajë dhe tani gjendja jonë ekonomike është më e mirë. Por të gjitha këto që kemi realizuar, deri në nivelin që kemi arritur sot, u detyrohen punës dhe sakrificave, zotësisë e vendosmërisë së popullit të udhëhequr nga Partia.

Duke kryer detyrat që na janë ngarkuar për realizimin e planit të naftës, të punojmë pa u lodhur për të ngritur në një nivel më të lartë kulturën tonë të specialitetit, që nevojitet për nxjerrjen e për shfrytëzimin e naftës, të mekanikës, të kimisë dhe, në kompleksitetin e tyre, të të gjitha degëve të shkencës e të teknikës që kanë lidhje me naftën. Kjo do të na bëjë të jemi plotësisht të përgatitur e të mos themi asnjëherë se s'kemi njerëz, shpues, montues, saldatorë,

mekanikë, inxhinierë, kimistë e të tjerë. Të gjithë këta t'i përgatitim me kohë, me punë e me mësim, në mënyrë që, kur të sjellim më shumë sonda ose mjete të tjera moderne për shfrytëzimin e naftës sonë, të kemi edhe specialistë të përgatitur që t'i vënë ato në shfrytëzim. Këtë duhet ta bëjmë me kujdes dhe me mend. Pra, krahas realizimit të planit të prodhimit, të kemi parasysh medoemos edhe detyrën për përgatitjen e njerëzve të mësuar, të edukuar, bile të punojmë që të kemi të tillë më shumë nga ç'kërkon plani i prodhimit të naftës sot, për t'i dalë përpara perspektivës së madhe që Partia po i hap atdheut. Kështu do të sigurojmë edhe planet aktuale që kemi përpara, edhe ato perspektive. E nesërmja është akoma më e ndritur për popullin. Ajo do të vijë medoemos, Partia po e përgatit atë me urresti.

Veç naftës të mos harrojmë pastaj mineralet si: bakrin, kromin etj., që kanë rëndësi të madhe dhe perspektivë në të ardhmen për ekonominë e vendit tonë. Ne do të bëjmë përpjekje më të mëdha që në planet e ardhshme pesëvjeçare t'i japim një shtytje të mëtejshme fuqizimit të sektorit të minierave, sigurisht, pa lënë pas dore degët e tjera të industrisë, si dhe industrinë e lehtë, duke prodhuar, krahas mineraleve, edhe të gjitha mallrat e nevojshme për jetën e përditshme të popullit. Partia mendon që çdo sektor të zhvillohet në përpjesëtimin e duhur, të ketë harmonizim të drejtë midis tyre, sipas nevojave të vendit dhe të popullit, ndryshe prishet ekuilibri midis degëve të ekonomisë, gjë që nuk do të

ndodhë kurrë në ekonominë tonë, e cila është e planifikuar dhe e centralizuar.

Ne kemi një popull të mrekullueshëm dhe kjo ka rëndësi të madhe për fatet e vendit tonë. Niveli i përgatitjes së tij politike dhe ideologjike është i atillë që ai i kupton drejt disa mungesa e mosbalancime, që ekzistojnë në furnizimin e tij. Është fakt që disa gjëra në tregun tonë nuk janë akoma në sasinë e duhur, po populli ynë, i ngritur politikisht, e kupton drejt këtë gjë. Arsyeet për këtë ai mund të mos i dijë si një specialist që merret me planet, por njeriu i thjeshtë i popullit tonë e kupton se këto janë mundësitë aktuale dhe ka besim të plotë në vijën e Partisë, e pranon se, për një kohë, duhen bërë akoma sakrificat, që nesër të kemi më shumë. Ai e kupton që ne akoma i kemi me krëk shumë gjëra, po ka bindjen e plotë se nesër gjendja do të bëhet përherë e më e mirë dhe kjo nëpërmjet punës së tij vetëmohuese dhe udhëheqjes së drejtë të Partisë. Ja, pra, ç'rëndësi të madhe ka ngritja politike e masave, kjo i bën ato ta kuptojnë qartë vijën e drejtë të Partisë.

Populli ynë e di se vija politike dhe ekonomike e Partisë është e drejtë, ai e shikon çdo ditë se fondet e ekonomisë popullore nuk hallakaten pa kriter, as nuk keqpërdoren apo bëhen rrush e kumbulla, po përdoren për të mirën e përgjithshme. Populli shikon se çdo investim që ka bërë shteti gjer tani ka qenë i domosdoshëm. Ai kupton, gjithashtu, se investimet kanë angazhuar fonde të mëdha. Ndokush mund të thoshte se për hidrocentralin «Karl Marks», për hidrocentralin «J.V.Stalin» apo për termocentralin, që po

ndërtojmë në Fier, janë harxhuar miliarda, prandaj ç'ishte nevoja të bëheshin për to gjithë këto shpenzime, po masat e popullit e kuptojnë dhe janë të ndërgjegjshme se këto investime, vërtet të mëdha, kanë qenë të domosdoshme dhe se pa elektrifikim s'mund të kishte industri të përparuar, bujqësi të kolektivizuar, kulturë dhe arsim në masat e gjera, s'mund të ndërtohej socializmi. Vendimi që mori Plenumi i 4-t i Komitetit Qendror, për elektrifikimin e krejt fshatrave të vendit, bëri që edhe plaku 85-vjeçar i krahinave më të largëta të atdheut ta ketë të qartë politikën largpamëse të Partisë në fushën e ekonomisë dhe jo vetëm kaq, por ai tani është i sigurt që ky aksion do të kryhet medoemos. Këtë besim ai e ka të plotë sepse ia ka vërtetuar jeta, se çdo gjë që i ka thënë Partia popullit është realizuar, prandaj, që tani, kur akoma s'i ka vajtur drita elektrike në shtëpi, ai mendon të blejë radion dhe fillon të bëjë investime të parakohshme në buxhetin e tij, kursen disa mijëra lekë, sepse sheh dhe kupton që, në kohën e sotme, as atje lart në mal, njeriu nuk rron dot pa këtë mjet të mrekullueshëm, që i çon fjalën e Partisë.

Bujqësia është një sektor tjetër shumë i rëndësishëm dhe jetik për popullin tonë, pas industrisë. Për këtë nuk po zgjatem se ju jeni në dijeni, mbasi rroni në një zonë me bujqësi të përparuar intensive. Sivjet rrethi juaj do të ketë prodhime të mira bujqësore, por, me sa shoh, nuk do të zërë vendin e parë, këtë vend nderi mund ta zërë Lushnja, gjitonia juaj, jo se fshatarësia kooperativiste e rrethit të Fierit nuk ka punuar, por e vërteta është se lushnjarrët kanë punuar

më mirë. Nga të dhënat që kemi, rezulton se lushnjarët do ta realizojnë premtimin që, nga 1/3 e sipërfaqes së mbjellë me grurë dhe nga 1/4 e sipërfaqes së mbjellë me misër, të marrin respektivisht 30 dhe 40 kuintalë grurë dhe misër për hektar, bile thonë se zotimin në misër hamullor do ta tejkalojnë. Kurse Fieri zotimin për grurin nuk e ka realizuar, megjithëse fondin e drithit, duke përfshirë hamullorët, do ta realizojë. Edhe ky është një rezultat i kënaqshëm.

Ky vit bujqësor është i mbarë. Në përgjithësi, shokë, sivjet, bujqësia po na shkon mirë. Planin e drithërave për të gjithë Republikën do ta realizojmë më mirë se gjer tani. Kjo, siç ua thashë dje të rinjve të hekurudhës, u detyrohet vijës së drejtë dhe udhëheqjes së urtë të Partisë, punës së palodhur të fshatarësisë sonë kooperativiste, fitores së socializmit në fshat dhe jo aq kushteve atmosferike. Për misrin shirat na ndihmuan ca, po, përkundrazi, po t'i analizojmë këto kushte, do të na dalë se kanë qenë të këqija, sidomos për grurin, i cili u mboll në kushte të vështira thatësire, më pas dimri ishte i keq dhe, së fundi, pranvera me shira të pandërprera. Prandaj themi me bindje se faktor kryesor i këtyre rezultateve është, në radhë të parë, udhëheqja e Partisë dhe puna, mobilizimi i plotë dhe i ndërgjegjshëm i kooperativistëve tanë patriotë, hovi i madh revolucionar i tyre.

Ne kemi kudo në botë miq që na duan të mirën. Kur Partia dha orientimin për marrjen e zotimeve për këto rendimente, qëlloi që shumë prej tyre erdhën në atë kohë në Shqipëri dhe na thanë të mos e

komprometojmë Partinë, duke marrë një vendim të tillë kaq të guximshëm. Ne u thamë të mos kishin frikë dhe asnjë dyshim në realizimin e këtij vendimi. Kur njëri prej tyre, më vonë, shfaqti dëshirën të shikonte një kooperativë dhe shkoi në Divjakë, kur u fut nëpër ara që të maste grurin, atëherë e pa se nuk kishte pasur arsye për frikën që shprehu. «Nuk ka në botë si Partia, si populli dhe si fshatarësia juaj, — theksoi ai, — që kur thonë diçka e kur marrin një vendim, e realizojnë. Është e pamundur të ndodhë një fenomen i tillë në një vend tjetër dhe brenda një viti të rritet rendimenti nga 11 kv në 27 kv grurë për hektar. Unë nuk mund as ta imagjinoj një gjë të tillë, kurse ju e realizoni», — shtoi ai. Mendojmë se kudo në vendin tonë do të merren në masë mesatarisht 2, 3, 4 e më tepër kuintalë grurë për hektar mbi planin, kurse misri është edhe ai i mbarë, bile ka parcela, dhe nuk është fjala për parcela eksperimentale, po për disa qindra hektarë në gjithë Republikën, në të cilat kooperativistët po luftojnë të marrin nga 70, 80 kv për hektar, si, për shembull, në Këmishtaj të Lushnjës.

Edhe pambuku e gjithë bimët e tjera pranverore paraqiten, gjithashtu, të mbara. Do të kemi, pra, një vit të mirë bujqësor. Ky është një gëzim i madh për popullin. Natyrisht, populli ynë është i thjeshtë, ekonomik. Ai do të përpiqet ta administrojë mirë prodhimin që do të marrë dhe do të vërë të gjitha forcat që vitin tjetër prodhimi të jetë edhe më i bollshëm. Jo vetëm kaq, por do të përpiqet të shtojë edhe prodhimet blegtorale, qumështin, djathin, gjalpin etj. S'ka

dyshim që prodhimi i këtij viti do të shërbejë si bazë për shtimin e prodhimit vitin tjetër. Tani, kudo, edhe vezë ka plot e shpresojmë mot të ketë më shumë. Kjo erdhi ngaqë misri vjet u bë më mirë dhe kooperativat i ushqyen pulat më shumë. Dihet se po pati misër, ka edhe vezë, ka edhe pula dhe kështu popullsia mund të përdorë më shumë prej tyre për ushqim. Po shtimi i prodhimit të misrit ndikon edhe në shtimin e prodhimit të qumështit. Po të kemi misër me bollëk, mund t'u hedhim të hanë edhe lopëve dhe ato e rritin sasinë e qumështit. Po t'i japësh kafshës, edhe ajo ta shpërblen. Rritja e drithërave, pra, do të ndikojë edhe për shtimin e blegtorisë, të pulave e të vezëve etj. Te ju në Myzeqe është kuptuar mirë çështja e lopës, e rritjes dhe e shërbimit të mirë që duhet t'i bëjmë asaj në të gjitha ekonomitë tona bujqësore. Pa lopën nuk ka bujqësi intensive, nuk ka bollëk: qumësht, djathë, gjalpë, nuk ka pleh, i cili ndihmon të merren më shumë prodhime për hektar në grurë, në misër etj.

Rendimentet që po marrim ne sivjet s'i kanë marrë kurrë as Bashkimi Sovjetik, as Bullgaria, as Rumania, as Çekosllovakia, që kanë qenë vende me bujqësi më të përparuar se ne. Në Evropë vetëm Franca, Gjermania dhe Italia marrin rendimente të larta në drithëra. Sivjet në Rumani do të merren rendimente të ulëta, në Bullgari do të ketë deficite në planet e drithërave. Ky është rezultat i vijës së tradhtisë të udhëheqësve revizionistë në këto vende.

Radio Moska po na qan hallin, duke thënë se në Shqipëri kanë rënë shira dhe se, sido që të bëhet

prodhimi, sipas tyre, ne s'do të jemi në gjendje ta korrim shpejt e ai do të na humbasë, ngaqë s'kemi mjete. Kështu shprehen revizionistët. Dhe ne themi: «I qajnë hallin kalorësit se i varen këmbët».

Në vendet ku sundojnë revizionistët ka kudo rrëmujë. Tradhtarët në udhëheqje të këtyre vendeve nuk i kanë dorëzuar akoma armët dhe nuk kanë për t'i dorëzuar shpejt, por qysh tani duket sa i lëkundur është regjimi i tyre. Në Bashkimin Sovjetik punëtorët kanë bërë greva dhe mbi ta janë ushtruar shtypje e goditje nga ana e klikës revizioniste. Në udhëheqjen sovjetike ka shenja përçarjeje, të cilat, natyrisht, vijnë jo se midis tyre ka marksistë-leninistë. Kontradiktat po acarohen, sidomos, në mes udhëheqësve të grupit revizionist sovjetik si për shkak të shtypjes e të presionit të brendshëm, ashtu edhe për shkak të disfatave në politikën e jashtme. Këtë gjendje e favorizojnë edhe qëndrimet oportuniste të Rumanisë pavarësisht se maskohet si socialiste; e favorizojnë, gjithashtu, qëndrimet e Çekosllovakisë, e cila, ashtu si Rumania, s'është aspak në pozita socialiste, por kapitaliste e revizioniste.

Për problemin çekosllovak ka shumë kontradikta në udhëheqjen revizioniste sovjetike. Udhëheqësit ushtarakë janë për ndërhyrje të hapët dhe për pushtimin e Çekosllovakisë me forcë¹, të tjerët kanë frikë, duke menduar se, po të bëhet një hap i tillë, do të ketë pasoja të hidhura që s'i parashikojnë dot dhe pastaj

¹ Kjo u vërtetua më 20-21 gusht 1968, kur Bashkimi Sovjetik socialimperialist pushtoi ushtarakisht Çekosllovakinë.

do t'u dalë boja si agresorë para popujve të botës. E tillë vazhdon të jetë gjendja atje. Si do të rrjedhin ngjarjet, këtë do ta shohim, po është fakt se politika e udhëheqësve revizionistë hrushovianë po falimenton dita-ditës.

Vendet e tjera revizioniste kanë vazhdimisht kontradikta me revizionistët e Bashkimit Sovjetik për shkak të politikës shoviniste të këtyre të fundit. Do të vijë koha të vërtetohet ajo që ka parashikuar Partia jonë, që vendet satelite të shkëputen nga Bashkimi Sovjetik dhe të lidhen me imperializmin. Kjo gjë, natyrisht, nuk u intereson revizionistëve sovjetikë, prandaj këta po përdorin gjithfarë planesh e intrigash për t'i mbajtur satelitët pas qerres së tyre. Tani në Çekosllovakia janë duke u bërë manovra ushtarake të vendeve të Traktatit të Varshavës, ku marrin pjesë rreth 20 000 ushtarë sovjetikë. Kjo është shpallur gjoja si lojë shtabesh, po çekët e kuptojnë qëllimin e revizionistëve të Moskës dhe po dridhen nga frika e nga numri i madh i ushtarëve sovjetikë, që janë futur në vendin e tyre. Do të largohen sovjetikët apo jo nga toka çekosllovake, këtë do ta shohim, po jemi të bindur se ata do të trillojnë shumë gjëra, bile mund të krijojnë situata të ndërlikuara për të acaruar marrëdhëniet me Gjermaninë e Bonit, me qëllim që të justifikojnë qëndrimin në Çekosllovakia dhe këtë ta shpjegojnë sikur mbrojnë vendet e kampit socialist nga rreziku i Republikës Federale të Gjermanisë. Njëkohësisht, ata i bëjnë presion edhe Dubçekut që të bëhet njësh me sovjetikët dhe, po të mos bindet, me siguri, do t'i kurdisin ndonjë komplot për ta rrëzuar.

Siç po shohim, ngjarje të reja do të zhvillohen në Çekoslllovakë. Udhëheqësit çekoslllovakë janë tradhtarë. Partia jonë ka dënuar e dënon qëndrimin e tyre prej tradhtari.

Popujt, kudo në botë, duan të dinë dhe janë të etur të lexojnë artikujt e «Zërit të popullit», për të mësuar qëndrimin e Partisë sonë. Kudo në vendet revizioniste, në Çekoslllovakë, në Bullgari, në Gjermaninë Lindore, në Bashkimin Sovjetik apo gjetkë, elementët revolucionarë e aprovojnë qëndrimin e Partisë sonë dhe janë plotësisht dakord me të. Situata atje zhvillohet në disfavor të revizionistëve.

Në Bullgari gjendja zhvillohet, gjithashtu, në disfavor të revizionizmit. Bullgarët janë njerëz të ndershëm e revolucionarë, por elementët e rinj, besnikë të marksizëm-leninizmit e të revolucionit, nuk dinë akoma të organizohen dhe burgjet janë mbushur plot me ta. Kudo kanë arrestuar shumë njerëz, bile komitete të tëra, që veprojnë kundër klikës së Todor Zhivkovit dhe të gjithë udhëheqjes revizioniste të këtij vendi.

Në vendet e tjera revizioniste ka konfuzion të madh dhe shthurje. Në Poloni revizionisti i regjuri Gomulka i shtypi revoltat e studentëve, po gjendja e «qetësisë», e krijuar me anë të forcës, është diçka provizore. Do të shohim si do të zhvillohen punimet e kongresit të partisë së tyre, që revizionistët polakë do ta bëjnë këtë vit¹. Gomulka është një tradhtar

¹ Kongresi i 5-të i PPB Polake u zhvillua nga 11 deri më 16 nëntor 1968.

dhe antisovjetik i tërbuar, por nevoja ia do tani të hiqet si prosovjetik, se e sheh që kundërshtarët përpiqen t'ia ngrenë këmbët. Ai mbështetet te sovjetikët vetëm e vetëm për të frikësuar kundërshtarët e tij brenda në Poloni, që janë njëloj reaksionarë si edhe ai vetë. Ne jemi të bindur se do të vijë koha që ata t'ia ngrenë këmbët, prandaj edhe atje, në të ardhmen, do të ketë përsëri turbullira. Gomulka ka arrestuar njerëz, i ka futur nëpër burgje, po i torturon dhe jemi të bindur se situata në Poloni do të ngrihet me siguri, koha do ta bëjë punën e vet edhe atje.

Në Jugosllavi ka filluar në shkallë të gjerë dekompozimi i situatës së brendshme, saqë Titoja ditët e fundit u detyrua të flasë vetë për këtë në Kongresin e 6-të të Sindikatave¹. Në këtë fjalim ai pohoi me gojën e tij të gjitha ato që Partia e Punës e Shqipërisë i ka thënë me kohë, gjatë këtyre 20 vjetëve, për Jugosllavinë, e cila është krimbur nga koka gjer në këmbë.

«Ku e kemi pasur mendjen ne që nuk e kemi dëgjuar popullin, — tha Titoja, duke bërë gjoja auto-kritikë. — Kritikën që na bëheshin nga masat, nga një vesh na hynin, nga tjetri na dilnin. Vamë dhe ndërtoam fabrika moderne, që na lanë me dhjetëra mijë punëtorë rrugëve. Përveç kësaj, kemi bërë gabim të madh, — vazhdoi ai në mënyrë demagogjike, — duke mbyllur fabrikat e vogla, lamë kështu popullin

¹ Kongresi i 6-të i Lidhjes së Sindikatave të Jugosllavisë filloi punimet më 26 qershor 1968.

pa bukë, rrugëve dhe prandaj u detyrua të merrte rrugën e arratisë për të gjetur punë jashtë».

Po për rrogat ç'tha Titoja? Ai iu drejtua delegatëve të sindikatave, duke u thënë se rrogat nuk janë në rregull, ca janë shumë të mëdha, të tjerat fare të vogla, prandaj «...këtë punë, — u tha ai punëtorëve, — bëni ç'bëni, e rregulloni ju vetë».

«Ka njerëz në Jugosllavi që janë bërë kapitalistë, — përmendi pastaj Titoja, — që kanë nga 4-5 vila, ka bile nga ata që kanë ndërtuar shtëpi të mëdha, me shumë shtretër dhe bëjnë tregti me to. Ata që kanë 4-5 vila le t'i mbajnë, këshilloi ai, kurse atyre që kanë shtëpi të mëdha, t'u merren. Ai tregoi se si një mjek, që nuk i mjaftonin të ardhurat e mëdha nga profesioni, bleu edhe 4-5 kamionë, me të cilët bënte tregti. Kundër njerëzve të tillë duhen marrë disa masa, predikoi Titoja, por kini mendjen, theksoi pastaj, mos bëni si ata nga ana tjetër (dhe me këtë ai bën aluzion për ne), mos i rrafshoni të tërë, leruni ca gjëra këtyre kapitalistëve të vegjël». Në fakt Titoja përmend gjërat e vogla, se të mëdhatë, që kushedi si janë, as që i zë fare në gojë.

«Ç'do të thotë të jesh pa punë?, — pyeti Titoja. Kjo do të thotë të mos kesh mundësi të punosh, — shpjegoi ai, — por nuk është e tillë gjendja në Jugosllavi, duhet parë ndryshe kjo çështje, shokë punëtorë. Dhe unë kam menduar se si duhet parë. Gratë që kërkojnë punë, fjala vjen, s'është nevoja të vendosen të tëra, shumica mund të rrinë në shtëpi, pse edhe atje punojnë ato, prandaj të mos konsiderohen

të papuna. Për sa u përket burrave, kur nga e njëjta familje punojnë 3-4 veta, dy prej tyre t'i heqim nga puna dhe të vëmë në punë të tjerë, nga ata që s'punojnë, që kështu të ushqehen të gjithë dhe të pushuarit nga puna të ushqehen prej pjesëtarëve të tjerë të familjes, që punojnë. Në fshat, — vazhdon ai, — ka, gjithashtu, njerëz që ankohen se janë pa punë. Megjithatë, fshatari e nxjerr një copë bukë në fshat, mjaft të ketë një çikë tokë, prandaj më mirë le të rrijë atje të nxjerrë bukën dhe të mos ankohet që s'ka punë, si dhe të mos konsiderohet i papunë», — arsyeton Josip Brozi. Ja, kështu mendon t'i rregullojë Titoja këto probleme kaq të mëdha e jetike për popullin.

Më pas, në fjalimin e tij, ai u qa për miqtë e tij të Lindjes (për sovjetikët), disa nga të cilët, pasi vizitojnë Jugosllavinë, megjithëse shikojnë atje ndërtime «të shumta», pallate, fabrika etj., kur kthehen në vendin e tyre propagandojnë se në Jugosllavi nuk po ndërtohet socializmi. Titoja ankohet se kjo është e pandershme dhe se do të jenë sovjetikët ata që do të vijnë në rrugën e Jugosllavisë, përfundoi ai në fjalimin e tij.

Ne e njohim Titon ç'demagog, ç'gënjeshtar i madh dhe i poshtër është. Të gjitha ato që tha, ai i pohoi nga e keqja, sepse i ka ardhur litari në grykë. Pakenaqësia popullore në Jugosllavi është aq e madhe, saqë e detyroi të pohojë vetë realitetin e hidhur të vendit të tij. Natyrisht, kjo s'është autokritikë, por regjimin dhe veten e tij ai i bëri leckë dhe këtë e gjeti si të vetmen rrugë për të lehtësuar gjendjen, për të krijuar iluzione sikur paskëtaj diçka do të bëhet,

por jemi të bindur se asnjë nga çështjet që preku nuk do të ndreqet. Kjo mund të arrihet vetëm kur të shkatërrohet regjimi titist.

Si mund të zhduken në Jugosllavi diferenecat e mëdha në rroga? Ndërsa rrogat në vendin tonë janë në proporcion 1 me 2, në Jugosllavi janë 1 me 75. Shikoni pra ç'ndryshim kolosal! A lejojnë njerëzit e shtresave të privilegjuara të ndryshojë kjo gjendje, t'u ikin nga dora këto rroga të majme? A mund të lejojë borgjezia e re kapitaliste titiste t'i merren vilat që ka në pronësi private, edhe pse tha për to, diçka si nëpër dhëmbë Titoja? Jo! Kjo është e pamundur! Edhe po të shpallin ndonjë dekret, sa për të gënjyer masat, do të ndodhë si te ne në kohën e Zogut, pronari një vilë ia bën përsipër hallës, tjetrën gruas, një xhaxhait dhe një e mban në emrin e tij. Kështu, formalisht, do të konsiderohet sikur ka vetëm një vilë. Edhe ai që ka disa kamionë një ia bën përsipër shoferit, një djalit të tezes e një e mban mjeku në emrin e tij dhe kështu, në thelb, nuk lëviz gjë, gjendja dhe pronësia e sendeve mbeten po ato, ashtu siç mbeten edhe varfëria dhe gjendja e mjeruar e popullit. Pra, tërë kjo është vetëm demagogji.

Mirëpo situata që po zhvillohet e ka inkurajuar shumë popullin jugosllav. Sipas lajmeve që kemi, në Beograd dhe kudo në Jugosllavi, njerëzit kanë filluar të flasin dhe të thonë se ky regjim është i kalbur, se këtë e pohoi vetë Titoja. Fialimi që mbaiti Titoja do të siellë patietër të kundërtën e rezultateve që priste ai. Njerëzit do ta kenë më kollaj të shprehen për titistët dhe po t'i akuzojë ndokush se pse flasin

ashtu, do t'i përgjigjen menjëherë se këtë e ka thënë vetë Titoja. Një tha Titoja, njëqind e një do të thonë njerëzit dhe asgjë të tepërt nuk do të thonë veç të vërtetën.

Titoja në fjalimin e tij, për të zënë kyçet, përmendi edhe një gjë tjetër. Ai nënvizoi se disa, brenda vendit, kërkojnë të peshkojnë në ujëra të turbullta, të krijojnë parti të tjera, me qëllim që të fitojnë të drejtën për të dërguar në Skupshtinë, në parlamentin jugosllav, përfaqësuesit e vet. Me një fjalë, sipas tij, ata duan ta rrëzojnë regjimin titist, po nuk do t'ia arrijnë dot, se do të merren masa. Kjo do të thotë se do të lëvojë kërbaçi, do të vazhdojnë burgjet dhe kampet e përqendrimit ca më shumë. Mirëpo kjo do të bëjë që situata të acarohet më tej.

Çështja nacionale në Jugosllavi është bërë shumë e mprehtë. Kontradiktat janë shtuar shumë. Shqiptarët në Jugosllavi janë elementi më revolucionar. Bëri ç'bëri gjer tani me shqiptarët Titoja, pas rënies së Rankoviçit, situata e detyroi t'u japë ca të drejta të vogla, kurse në kohën e Rankoviçit bënte kërdrinë në Kosovë. Kosovarët po përfitojnë nga kjo gjendje, kanë filluar të flasin, të lëvizin. Ata hapin dhe dëgjojnë Radio Tiranën.

Më falni se duke folur gjatë, ju lashë edhe pa ngrënë. Dhe t'i lësh punëtorët pa ngrënë, nuk është mirë, sepse ata kanë punuar tërë ditën, janë lodhur e kanë nevojë për pushim. Po mendoj se nuk do të ma vini re këtë, pasi e bëra ngaqë dëshiroj të rri ditë e natë me ju dhe nga kjo nuk ndiej fare lodhje.

Keni ndonjë pyetje për të më bërë, ndonjë vërejtje, ndonjë mendim për të shprehur, ndonjë hall

për të qarë apo ndonjë fletërrufe? Si shkojnë fletërrufetë te ju, a ecin, a vini fletërrufe, shoqe dhe shokë? Mos i lini të qetë njerëzit që s'punojnë mirë. Edhe neve, andej nga qendra, të na vini fletërrufe dhe të na kritikoni pa frikë kur ndonjë problem nuk shkon mirë. Ne kemi shumë nevojë për vërejtjet dhe për kritikën tuaj, mos mendoni se s'kemi nevojë. Sa pengesa keni ju, shpesh, nga ne të qendrës, që ju ngadalësojmë, në disa raste, zgjidhjen e problemeve, kur ju themi prisni sa ta studiojmë çështjen. Ne e luftojmë burokratizmin, por, nganjëherë, nuk e luftojmë si duhet. Ja, ne kemi vendosur disa rregulla, të cilat me të vërtetë duhen zbatuar për të mirën e punës. Këto rregulla janë të nevojshme, se disiplina në punë është e domosdoshme dhe këtë, më mirë nga të gjithë, e vlerëson klasa punëtore. Pa rregull, pa disiplinë nuk ecën puna përpara. Por këto çështje duhet të shihen vazhdimisht në zhvillim, t'u përshtaten kohës dhe situatave, pra, të gjenden forma gjithnjë më të përsosura pune, sepse një rregullore e vendosur sot, nesër mund të dalë nevoja që, në kushte të reja, të zëvendësohet nga një tjetër më të përsosur. Kështu duhet vepruar me disa rregullore ose me disa vendime, që i kemi marrë në të kaluarën për zgjidhjen e disa problemeve, por shumë nga ato tani mund të jenë vjetruar e na pengojnë.

Njerëzit tanë janë të mrekullueshëm, të zotë, heroikë, ata i duan Partinë, popullin, vijën e drejtë në të cilën na udhëheq Partia dhe e kanë kuptuar se të gjitha ato që thotë Partia kanë rëndësi të madhe. Prandaj u duhet besuar atyre, u duhet dhënë inicia-

tivë, po s'u besove dhe po s'u dhe iniciativë njerëzve, bën një gabim të madh. Vetëm në luftë dhe në punë konkrete shokët do të mësojnë të punojnë gjithnjë e më mirë. Edhe kur gabojnë njerëzit, këto u bëhen mësim për të ardhmen. Ata që mendojnë, që punojnë, që luftojnë, bëjnë, natyrisht, edhe gabime. Në raste të tilla njerëzit duhen ndihmuar që të ndreqen, pra, të kritikohen dhe njerëzit e ndershëm e presin mirë kritikën e drejtë. Prandaj ai që drejton kritikën, këtë duhet ta bëjë me zemër të hapur dhe të kritikuarin të vazhdojë ta dojë si vëlla. Po të përsëritet gabimi, kritika duhet të jetë më e ashpër, kurse, herën e tretë, akoma më e ashpër. Po të vazhdohet me të njëjtat gabime atëherë «duhet përdorur druri i madh». Edhe ju, gratë, «rrëmbeni drunë» ndaj atyre burrave që s'janë në rregull, që tregohen konservatorë ndaj jush, sepse ka të tillë, bile edhe në radhët e klasës punëtore. Kur vizitova Mirditën, ku siç e dini ka punëtorë shumë të mirë, heroikë e patriotë, që luftojnë të çojnë të renë në fshat, unë fola gjatë rreth këtij problemi, sepse një grua trimëreshë më tregoi se disa punëtorë janë vërtet shumë të mirë në punë, po duhet të punojnë akoma më mirë në familje, që punët të mos rëndojnë vetëm mbi gruan. Prandaj këtu s'po flas për këtë çështje.

Ju faleminderit shumë për vëmendjen që treguat. Biseda ime me ju ishte një diskutim intim midis nesh.

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në AQP

**DIREKTIVAT E PARTISË PËR BUJQËSINË
T'I ZBËRTHEJMË E T'I THELLOJMË
VAZHDIMISHT**

*Bisedë me anëtarë të Kooperativës Bujqësore
të Grecallisë në rrethin e Fierit*

29 qershor 1968

Pasi u takua dhe u përshëndet me anëtarë të kooperativës dhe si dëgjoi fjalën e kryetarit të saj, shoku Enver Hoxha zhvilloi me ta një bisedë shumë të përzemërt.

SHOKU ENVER HOXHA: Sa komunistë ka kooperativa juaj, në sa organizata-bazë militojnë këta?

SHOKU ARQILE BANI¹: Kemi 51 komunistë, në tri organizata-bazë.

SHOKU ENVER HOXHA: Po gra e vajza sa keni në Parti?

SHOKU ARQILE BANI: Kemi 16.

SHOKU ENVER HOXHA: Si jeni me sektorin e blegtorisë?

1 Në atë kohë kryetar i kooperativës bujqësore.

SHOKU ARQILE BANI: Gjer tani kemi 200 lopë foragjere, kurse në vitin 1980 do t'i dyfishojmë¹. Atëherë do të kemi mesatarisht rreth 35 krerë për 100 hektarë.

SHOKU ENVER HOXHA: Sa litra qumësht merrni në vit nga këto lopë?

SHOKU ARQILE BANI: Ne kemi dy ferma në kooperativën tonë, në njërën marrim mesatarisht 1 800 litra qumësht nga çdo lopë foragjere, kurse në tjetrën, që është prapa me përmirësimin racor, marrim gjer në 1 280 litra për kokë.

SHOKU ENVER HOXHA: Po shokët kooperativistë mbajnë lopë në oborret e tyre?

SHOKU ARQILE BANI: Po, mbajnë, lopë e dhi.

SHOKU ENVER HOXHA: Çfarë dhish kanë, malteze apo të llojeve të tjera?

SHOKU ARQILE BANI: Kanë edhe dhi malteze edhe të tjera, të vendit.

SHOKU ENVER HOXHA: Në këtë tokë kaq pjellore mbajtki dhi ju?

SHOKU ARQILE BANI: Mbajnë disa nga kooperativistët, se e quajnë më të leverdishme të mbajnë në oborret e tyre dhi, sesa lopë, sepse lopa, thonë ata, do të hajë më shumë, kurse dhia ka më pak kërkesa. Megjithatë, të pakta janë familjet që kanë dhi në kooperativën tonë, më të shumtat e tyre, rreth 370 familje, kanë lopë.

SHOKU ENVER HOXHA: Mirëpo, duhet pasur

¹ Në fakt, në vitin 1982, numri i lopëve foragjere të kësaj kooperative u trefishua.

parasysh se nga lopa mund të merren deri 3 500 litra qumësht në vit, bile dhe më shumë, sasi kjo që nuk e marrim dot as nga 50 dhi. Në toka si këto tuajat, që janë kaq pjellore dhe që ujitën, ku vajza e djem punojnë e luftojnë me të gjitha forcat për të marrë nga 80 e 90 kuintalë misër për hektar, nuk ka leverdi të mbash lopë nga ato që japin shumë-shumë gjer 1 500 litra qumësht në vit. Ne duhet të luftojmë që të marrim nga çdo lopë 3 000 litra e lart.

Po prodhimin e misrit për hektar sa e keni realizuar?

SHOKU ARQILE BANI: Planin e kemi 26 kuintalë për hektar, ndërsa nga 1/4 e sipërfaqes parashikojmë të marrim 65 kuintalë për hektar, bile ka brigada që do të marrin edhe 80 kuintalë për hektar.

SHOKU ENVER HOXHA: A ujitën dhe a u bëhet shërbimi i nevojshëm tokave prej të cilave merrni 26 kuintalë për hektar dhe sa herë i prashitni ato?

SHOKU ARQILE BANI: Po. Parcelat e rendimenteve të larta i ujitim, u hedhim edhe pleh më shumë dhe i prashitim 3-4 herë.

SHOKU ENVER HOXHA: Sikur të keni më shumë lopë të racës së mirë, do të merrni me siguri më shumë qumësht, pleh, gjithashtu, do të keni më tepër dhe, duke përdorur plehun në masën e duhur, do të keni edhe më shumë misër, nga i cili do të na teprojë që t'u japim edhe lopëve. Ne luftojmë që të prodhojmë më shumë misër, me qëllim që një pjesë të tij ta kthejmë në qumësht, në mish dhe në gjalpë, domethënë, të ushqejmë me të lopët, pulat dhe derrat, pse kështu ato do të na japin më shumë. Mos vallë ekzis-

ton te ju ndonjë pengesë për rritjen e derrit? S'ka dyshim që në të kaluarën shumë mbeturina na kishin lidhur këmbët, kurse tani gjithnjë e më shumë po çlirohemi prej tyre.

Duhet të kuptojmë që mbeturinat fetare kanë rrënjë të thella shekullore, janë ideologji e krijuar nga klasat shfrytëzuese, posaçërisht për të shfrytëzuar popujt dhe për t'i mbajtur ata në errësirë dhe në shtypje. Feja kurdoherë është përpjekur të mashtrojë popujt, duke predikuar se gjoja kjo botë është skëterrë për njerëzit dhe vetëm diku lart, në qiell, ekziston xheneti. Dhe, sipas fesë, për të vajtur atje, duhen bindje e nënshtrim i plotë, gjithë jetën, prandaj fetarët u kërkonin besimtarëve të robtoheshin ditë e natë në punë, t'i lejonin shfrytëzuesit t'u hipnin në zverk, kurse këta kurrë të mos ngriheshin kundër tyre, se kjo konsiderohej si gjynahu më i madh kundër Krishtit, kundër Muhametit, kundër perëndisë etj. Duke predikuar vuajtje në këtë botë dhe lumturi në «botën» tjetër, feja i këshillonte besimtarët të mos hanin e të mos pinin, po të mbanin kreshmë e ramazan, martesat t'i bënin sipas ligjeve të fesë, të ishin të lidhur me klerikët e t'u besonin verbërisht nuskave dhe dogmave të fesë etj. Të gjitha këto, për qindra e qindra vjet me radhë, të përsëritura në gjithfarë mënyrash, i ishin bërë njeriut si buka e përditshme. Në këto kushte, po të guxonte dikush të gjykonte për absurditetin e predikimeve fetare, ai jo vetëm përbezej e luftohej, por edhe rronte në ankthin e frikës se «do ta vriste» perëndia. Po të qëllonte që t'i binte rrufeja ndonjërit, prifti, këtë fenomen të rastit, e shpjegonte si hakmarrje të

perëndisë, mbasi viktima një ditë të diel nuk paskësh vajtur në kishë, ose paskësh fyer priftin, që i kërkonte meshën kur fshatari kishte kalamanët pa bukë etj.

Shumë rite e besime fetare ekzistojnë akoma në ndërgjegjen e njerëzve, prandaj duhet të punojmë t'i zhdukim gjer në fund, sepse kështu e hapim më tej rrugën e madhe të përparimit. Pikëpamjet fetare kanë qenë pengesë e fortë, që nuk e lejonin femrën të dilte jashtë mureve të shtëpisë, të vente në shkollë, në punë etj., duke i quajtur këto gjëra «turp». Gruaja më parë nuk mund të dilte të fliste përpara burrave, ajo ishte e detyruar të rrinte brenda shtëpisë, si qyqe, të mbetej gjithë jetën injorante, të mos i njihte jetën dhe botën. Partia na mëson çdo ditë se shumë të këqija i kanë sjellë njerëzimit fetë dhe besimet. A pati humbje dhe poshtërim gruaja shqiptare tani që ka dalë në mënyrë aktive në jetë? Jo! Përkundrazi, ajo është bërë më e respektuar, më e nderuar, më e fortë, ka fituar besim në vetvete, është bërë e zonja jo vetëm për veten e saj, por edhe për Shqipërinë. Me punë të palodhur ajo ka fituar respektin e babait, të vëllait, të burrit, të shokut, me të cilët ecën krahas në të njëjtën rrugë. Në rrugën për emancipimin e gruas, ne vepruam sipas mësimëve të Partisë, prandaj arritëm rezultate dhe përparime që, si kudo, shihen edhe në kooperativën tuaj.

Ju keni tani një kooperativë të përparuar, po fëmijët tuaj mbase s'e dinë se dikur në tokat tuaja mbretëronin moçali dhe mushkonjat, se në jetën e njerëzve të varfër bënte kërëdinë malërja, se banesat e tyre ishin kasolle prej balte, kurse tani, çdo gjë ka ndryshuar.

Në radhë të parë e mbi të gjitha, keni ndryshuar

ju, njerëzit, që e keni bërë kaq të përparuar kooperativën. Po përse nuk ndryshonin më përpara njerëzit? Kjo vinte ngaqë ata nuk dinin rrugën ku duhej të ecnin, e cila ka shumë rëndësi. Nga cila rrugë duhej të shkonin njerëzit tanë drejt botës së re, drejt jetës së lumtur e të begatshme, pa shtypje e pa shfrytëzim, këtë na e thanë Marksi dhe Engelsi, Lenini dhe Stalini, na e tha Partia. Këta na mësuan se duhet bërë revolucionin i armatosur, se duhen rrëzuar, për të mos u ngjallur kurrë më, ata që popullin e kanë shtypur në shekuj. Partia dhe udhëheqësit e mëdhenj të klasës punëtore ndërkombëtare na kanë mësuar, gjithashtu, që, pas përmbysjes së armiqve dhe vendosjes së diktaturës së proletariatit, të mos na zërë kurrë gjumi, po të rrimë zgjuar e në gatishmëri të përhershme për mbrojtjen e fitoreve, derisa të zhduken njëherë e përgjithmonë klasat shfrytëzuese kudo në botë, deri në ndërtimin e shoqërisë komuniste në të gjithë botën, pse vetëm atëherë do të jetë zhdukur rreziku i restaurimit të kapitalizmit.

Pra, sipas mësimëve të Partisë, armiqtë e popullit i përmbysëm, populli mori fuqinë në dorë, pastaj u hartuan planet se ç'duhej të bënim në të ardhmen. Realizimi me sukses i planeve u arrit, në radhë të parë, me mendjen dhe me zotësinë e popullit, që udhëhiqej me urtësi nga Partia. Natyrisht, për arritjen e sukseseve të gjertanishme na ndihmuan edhe miqtë me disa kredi. Ne kurrë nuk do ta harrojmë ndihmën internacionaliste të Bashkimit Sovjetik në kohën e Stalinit. Stalini na ka dhënë kredi me të cilat kemi ndërtuar fabrikat e uzinat e para, por ndihma e miqve, sado e

madhe e bujare që të jetë, është diçka e vogël përpara forcës së madhe të popullit.

Tani dua të flas diçka për kooperativën tuaj. Ju keni tokë shumë pjellore dhe konstatoj se përparimet i keni të dukshme. Por, e para, dëshiroj të theksoj të mos kënaqeni me rezultatet e arritura dhe, e dyta, t'i vini vetes detyra që, këtej e tutje, të prodhoni gjithnjë e më shumë për veten tuaj dhe për të gjithë Shqipërinë. Keni parasysh se këtu në fushën tuaj shteti ka harxhuar miliarda dhe këto kanë dalë nga munda, nga gjaku, nga djersa juaj dhe e mbarë popullit shqiptar. Partia dhe Qeveria kanë ditur t'i administrojnë si duhet, si nikoqire të përsosura, të ardhurat nga ekonomia popullore, me qëllim që të ngrihet niveli i jetesës i masave tona punonjëse dhe, njëkohësisht, t'i mësojnë këto si ta përmirësojnë vazhdimisht ekonominë, si të shtojnë dhe të zhvillojnë më shumë prodhimin. Prandaj dhe janë investuar gjithë këto shuma kolosale.

Kësaj toke, që është pronë e mbarë popullit, duhet t'i nxjerrim prodhim, t'i marrim rendimente sa më të larta. Gjersa po përpiqeni të merrni, në disa parcela deri në 80 kuintalë misër për hektar, përse të mos merrni edhe mbi 100 kuintalë për hektar? Si është e mundur, do të pyesë dikush. Çdo gjë është e mundur. A mund të imagjinohej që Shqipëria e prapambetur e së kaluarës, me klimën dhe me kushtet atmosferike jo të favorshme të këtij viti, për rritjen e grurit (sepse për misrin ranë shira), të vihej, për sa i përket rendimentit për hektar, në një radhë me Italinë dhe me Francën, që janë vende nga më të përparuarat në lëmin e bujqësisë? Po t'ia themi botës

këtë, vështirë se do ta besojë, por ja që flasin faktet. Ka njerëz jashtë që habiten dhe thonë: Si është e mundur që Shqipëria të marrë të tilla prodhime të larta? Po, është e mundur. Shqipëria para dy vjetësh merrte mesatarisht 11,3 dhe 12,4 kuintalë grurë për hektar, në një kohë kur Bashkimi Sovjetik merrte më pak. Kur Shqipëria merrte 10 kuintalë pambuk për hektar, Shtetet e Bashkuara të Amerikës merrnin 8 kuintalë për hektar. Ne ua kaluam SHBA-së në prodhimin mesatar për hektar, natyrisht, jo në sasinë e prodhimit të përgjithshëm, sepse ato kanë hapësira të pafund, prej dhjetëra milionë hektarësh dhe një mekanizim shumë të zhvilluar e, si rrjedhim, marrin sasira të mëdha drithi, po kur vjen puna për mesataren, kjo del më e lartë për ne, pra, në njësinë e sipërfaqes ata marrin rendimente të ulëta. Duke parë statistikat e përgjithshme ne e shohim se nuk mund të barazohemi me Turkistanin, po ka edhe në vendin tonë kooperativa që marrin nga 20 kuintalë pambuk për hektar. Ju merrni 14-15 kuintalë pambuk për hektar, kurse Mëminasi merr 18 kuintalë për hektar, ka kooperativa që marrin edhe më shumë. Kjo na forcon mendimin se ka mundësi të marrim rendimente më të larta, po këto mundësi duhet t'i krijojmë, ashtu si i keni krijuar ju për të arritur sukseset e gjertanishme. Kjo është arritur me punë dhe me mësim, pse, pa punuar dhe pa mësuar, rezultatet nuk mund të arriheshin. Po t'i llogaritim mirë këto suksese, do të arrijmë në përfundimin e drejtë se, duke shtuar përpjekjet, mundësitë për të ecur gjithnjë përpara janë të mëdha.

Partia këshillon që çdo kooperativist, i madh e, i

vogël, t'i futet studimit të thellë të agronomisë, në teori dhe në praktikë, t'i qepet e t'i vejë gjer në fund, t'i njohë, si i thonë fjalës, dhëmbë e dhëmballë sektorit të tij, bimëve që kultivon. Ai duhet të dijë për to jo vetëm kur dhe si duhet të mbillen e të prashiten, por edhe çdo shërbim tjetër, deri edhe ndikimet që mund t'i bëjnë bimës një ndryshim i vogël atmosferik, një sëmundje etj. A ka mundësi të arrihen këto? Po, ka mundësi. Dituritë e njerëzimit janë shkruar në libra dhe mund të mësohen, por ato mësohen, njëkohësisht edhe në praktikën e përditshme të punëve bujqësore. Kur vërehet bima si rritet, si gjallërohet apo si thahet, mendja e njeriut punon për këto dhe nxjerr mësim për të ardhmen. Këto mësimë kooperativisti i mirë i ruan në kokë. Në qoftë se ne e zhvillojmë këtë dituri, atëherë bujqësisë sonë do t'i japim një zhvillim të jashtëzakonshëm.

Partia ka krijuar dhe përsëri në të ardhmen do të krijojë mundësi dhe mjete të tjera, që do ta ndihmojnë bujqësinë të zhvillohet më tej. Këto mundësi qëndrojnë, së pari, te mekanizimi. Tashti që keni mekanizma, ju vetë thoni nganjëherë: «Si mund t'i punonim ne gjithë këto fusha kaq të gjera, po të mos kishim traktorë?». Mund të bënim ne vetëm me plugun e drunjte? Jo! Po mjetet i siguroi Partia, edhe kushtet i ndryshoi Partia. Megjithatë, shkalla e tanishme e mekanizimit nuk është e mjaftë dhe, ne duhet ta shtojmë akoma, sidomos nëpër fusha. Mekanizimi do të shtohet dhe do të ndjekë dy qëllime: e para, me ndihmën e tij të shtohen akoma më shumë prodhimet bujqësore e blegtorale, që të rritet begatia e popullit

tonë, të ngrihet niveli i tij i jetesës, që është objektivi kryesor i Partisë dhe, e dyta, që njerëzit, kur punojnë, të mos harxhojnë energji aq të mëdha, pra, të lodhen më pak.

Partia mendon të arrihen prodhime të bollshme jo vetëm në fusha, por edhe në zona malore, të cilat të përpiqemi t'i transformojmë e t'i bëjmë, gjithashtu, pjellore si dhe fushat. Që të bëhen të tilla zonat malore duhen njerëz, pse atje është i paktë numri i fëmijëve punëtorë. Kështu, kur në fusha punën e njeriut ta zëvendësojmë me makina do të krijohet mundësia që djem e vajza nga zonat fushore dhe qytetet, të shkojnë e të punojnë në zonat malore. Në malësi ata do të ngrenë banesat, do të krijojnë familjet e tyre duke u martuar me vajza e djem malësorë. Atje do të kenë kinema, teatër, dyqane, rrobaqepësi, shkollën, ambulancën etj., njëlloj siç i keni edhe ju këtu, siç i kanë në qytete. Edhe në zonat malore do të shtohet, gradualisht, mekanizimi. Në të ardhmen kudo te ne do të korret e do të shihet me makina, gjer edhe pulat do të ushqehen në mënyrë të mekanizuar. Këto që sot na duken si çudira, patjetër do t'i bëjmë në të ardhmen, sepse këtë e kërkon interesi i zhvillimit të vendit. Ne do t'i krijojmë këto kushte vetë, me anën e shtimit të prodhimit, duke ngritur rendimentet për hektar në çdo prodhim bujqësor, gjë që do të kërkojë të sjellim makina korrëse të vogla, me anën e të cilave ta korrin grurin brenda pak ditësh që të mos kemi as firo. Këto lloj makinash janë më të manovrueshme se kombajna, që është tepër e madhe, e rëndë dhe nuk futet dot në tokë të lagët, as në parcela të vogla ose në tarracat malore.

Me misrin, që do të jetë me bollëk, do të ushqehen edhe viçat, të cilët do të shiten me dollarë; do të rriten kafshë me mishin e të cilave do të bëhet sallam, që kërkohet shumë në tregjet e jashtme; do të prodhohen domate për eksport, me të cilat do të sigurojmë blerjen e mijëra mëshqerrave të racës Ost-friz [Laramane e zezë] etj. Shikoni, pra, se si, me të ardhurat që do të marrim nga eksportimi i prodhimeve tuaja bujqësore, do të sigurojmë mjete, farëra të zgjedhura dhe kafshë race për zhvillimin e bujqësisë dhe të blegtorisë në nivelet më të përparuara.

Fara e grurit «Myzeqeja» na ka dalë e mirë, sa që i ka habitur fshatarët me rendimentin e saj të lartë, po vetëm se duhet korrur shpejt. Sivjet na pengoi shumë shiu që ra, mbasi u vonuam, kurse kjo lloj fare ka nevojë për mekanizmat që thashë, që të korret shpejt, brenda 10-12 ditësh.

Të gjitha këto probleme do t'i zgjidhim me forcat tona, prandaj direktivat e Partisë për zhvillimin e bujqësisë t'i studiojmë e t'i thellojmë vazhdimisht më mirë. Udhëzimet që jepen, në lidhje me direktivat e Partisë dhe dijenitë për zhvillimin e bimëve bujqësore, kanë rëndësi të madhe. Ato nuk lëshohen kot, po janë rezultat i një eksperience të madhe shumëvjeçare të njerëzve të punës dhe të njerëzve të mësuar. Natyrisht, ato mund edhe të ndryshohen e të përmirësohen më tej me eksperiencën tuaj të pasur, por kurrë nuk duhet të hidhen poshtë. Çdo njeri, çdo kooperativist, së pari, t'i lexojë ato, pastaj të mendohet dhe, në punë e sipër, të marrë masa për shtimin e prodhimit. Askush të mos i nënvleftësojë aftësitë e tij,

përkundrazi, të përpiqet t'i shumëfishojë ato në procesin e punës, si dhe duke mësuar në kurse e në shkolla. Kërkonte me këmbëngulje që kurse e shkolla të hapen kudo dhe të frekuentohen rregullisht nga të gjithë. Çka do të mësoni në to, të përpiqeni t'i zbatoni me kujdesin më të madh në praktikë.

Shokë dhe shoqe, dëshiroj të theksoj edhe një herë se rezultatet që keni arritur janë të mira. Ju keni një kooperativë nga më të mirat e zonës fushore. Ajo është mjaft e përparuar, sepse, në radhë të parë, keni përparuar ju, anëtarët e saj. Kjo është kryesorja. Nga sa shoh, kooperativa juaj ka ndryshime shumë të vogla me qytetin e Fierit. Unë kam vizituar edhe kooperativa të tjera, që edhe ato kanë bërë përparime të konsiderueshme, megjithatë, dallimet në mes qytetit dhe fshatit atje janë akoma të mëdha.

Përparimi juaj, ashtu si dhe i të gjithë vendit tonë, u detyrohet vijës së drejtë të Partisë, zotësisë suaj, kuptimit të drejtë nga ana juaj të direktivave të Partisë dhe të zbatimit të mirë të tyre në jetë. Rezultatet e mira që keni arritur, në asnjë mënyrë nuk duhet t'ju dehin. Ju duhet ta vazhdoni punën edhe më me vullnet, se keni akoma jashtëzakonisht shumë për të bërë, si në bujqësi dhe në blegtori, ashtu edhe në ngritjen e nivelit të jetesës. Unë nuk munda të hyj brenda nëpër shtëpitë tuaja, por vizitova një çerdhe, si edhe ndërtimet e artizanatit dhe, pa ju bërë lëvdata, mund t'ju them se më pëlqyen shumë. Çerdhja juaj është e re dhe me të vërtetë model i pastërtisë, prandaj i përgëzova të tri shoqet që punojnë atje. Ato që pashë në këtë çerdhe janë pasqyrim i zhvillimit tuaj të pandërprerë, përherë

në rritje dhe tregojnë se ju keni ndryshuar pikëpamjet në dobi të mënyrës së re të jetesës në kooperativën tuaj. Kjo na gëzon pa masë, se për këtë luftojmë.

Zhvillim në rrugën socialiste do të thotë të përqafosh të renë, përparimtarë, të ruash vlerat morale më të mira të njeriut, si: ndershmërinë, pastërtinë e shpirtit, të trupit, të ruash zakonet e mira dhe të luftosh për të zhdukur çdo gjë të keqe e të prapambetur. Këto kërkesa arrihen vetëm në rrugën e Partisë, duke i kuptuar çështjet, në radhë të parë, politikisht dhe ideologjikisht. Kështu mund të rriten vlerat morale dhe të spastrohen të ligat. Por duhet pasur parasysh se me dekrete dhe me urdhra nuk mund të ndalohet tjetri, për shembull, të mos e rrahë apo të mos e shajë gruan, kurse me punën bindëse dhe edukuese, sipas mësimëve të Partisë, çdo njeri do ta kuptojë se gruaja është njeri si dhe burri, me të drejta të barabarta, se ajo duhet nderuar e jo keqtrajtuar.

Kodi Penal e ndëshkon rreptë marrjen e shpërblimit për martesë, megjithatë, shfaqje të tilla në këtë fushë vazhdojnë të ngjasin aty-këtu. Me këtë dua të them se, për parandalimin e të këqijave, rëndësi të dorës së parë ka çështja e kuptimit ideologjik të çdo problemi. Po u kuptuan këto drejt nga ana ideologjike dhe politike, atëherë të këqijat zhduken më lehtë. Në këtë rrugë duhet të luftojmë ne. Merret me mend se edhe në këtë drejtim, me gjithë sukseset e shumta, kemi akoma mjaft për të bërë. Ja sepse ky zhvillim duhet të kuptohet drejt nga burrat, nga gratë, nga djemtë edhe nga vajzat tona.

Vajzat e djemtë duhet ta kuptojnë seriozisht pro-

blemin e martesës dhe të familjes. Ata vërtet janë të lirë të zgjedhin njëri-tjetrin, por këtë ta bëjnë me mend në kokë, të mendojnë se martesë nuk bëhet për tri, për pesë ditë ose për një muaj, por për të kaluar jetën. Prandaj të rinjtë të përpiqen të gjejnë bashkëshortin me të cilin të kalojnë një jetë të gëzuar, të lumtur, të krijojnë një familje të shëndoshë, anëtarët e së cilës të punojnë me nder dhe të rrojnë me dinjitet. Prandaj, në zgjedhjen e shoqes ose të shokut, duhet vepruar me pjekuri. Por në asnjë mënyrë nuk duhet kaluar në të kundërtën, pra, nuk është i drejtë as qëndrimi liberal, që djali të shkojë «si bleta nëpër lule», sepse kjo nuk përputhet me moralin tonë socialist. Një qëndrim i tillë s'është i denjë as për djalin, as për vajzën.

I riu apo e reja duhet ta zgjedhin vetë shokun e jetës, po ata e kanë, njëkohësisht, për detyrë që edhe me prindërit të këshillohen, kështu do të arrihet në zgjedhjen me pjekuri të bashkëshortit të ardhshëm. Kur vajza t'i thotë nënës ose babait se ka dëshirë të fejojë me një djalë, këta, si prindër, do të interesohen patjetër dhe, po të jetë djali i mirë, do të gëzohen dhe do ta urojnë të bijën, po në rast se djali s'është aq i mirë, prindi e ka për detyrë t'ia thotë këto vajzës së vet dhe ta këshillojë që ta shikojë më mirë çështjen. Kur djali është i biri i një armiku të pushkatuar, babai dhe nëna, që kanë më tepër eksperiencë në jetë dhe që e kanë më të qartë qëndrimin tonë klasor, e kanë për detyrë ta këshillojnë vajzën të mos përzihet me një familje të tillë, po të zgjedhë një nga djemtë e mirë që ka në fshat. Djali ose vajza ka të drejtë, në

këto raste, t'i kërkojë një mendim ose ndihmë gjer edhe sekretarit të organizatës-bazë të Partisë, me qëllim që të mos gabojë në këtë hap shumë me rëndësi për jetën e njeriut.

Në përgjithësi ne duhet ta njohim këtë fakt, xhaxho¹, që vajzat dhe djemtë tanë tregohen me të vërtetë të pjekur e me karakter të lartë, ashtu si i do Partia. Ne shumë rrallë konstatojmë ndër ta sjellje të papëlqyera, të kritikueshme dhe të dënueshme. Morali i tyre është i lartë. Kjo na gëzon dhe na forcon, sepse siguria e atdheut tonë, e ardhmja e tij është te të rinjtë. Rinia jonë rritet me moral të shëndoshë, me patriotizëm të flaktë, me parime të drejta socialiste, ajo ushqen një dëshirë të zjarrtë për punën, për mësimin, prandaj s'ka forcë në botë që ta tundë Shqipërinë të ecë me vendosmëri në rrugën e socializmit.

Pastaj shoku Enver iu drejtua disa të re'jave:

Ka shkuar ndonjëra prej jush në kursin e grave dhe të të re'jave?

SHOKU ARQILE BANI: Ka shkuar vetëm përgjegjësja e gruas.

SHOKU ENVER HOXHA: Domethënë, nga ju të tjerat asnjëra nuk paska shkuar. Në kursin që vizitova në muajin maj në Durrës, kanë vajtur gra e vajza nga Mirdita, ku kanë mësuar si pritet një fustan, një bluzë etj. Ato, pasi të mësojnë për vete, kur të kthehen në Mirditë do t'ua mësojnë këto edhe grave e vajzave të tjera. Në Mirditë gratë janë mjaft të zonjat, atyre u

¹ Shoku Enver Hoxha i drejtohet një të moshuari, që ndodhet aty afër, në mbledhje.

zë dora të presin, të qepin e të qëndisin me mjeshtëri të rrallë rrobat e tyre të bukura. Duhet disa vjet që të mësosh të bësh një punë të tillë artistike, e cila kërkohet për qepjen e kostumit të një gruaje mirditore. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për gratë tuaja. Cila nga ju nuk di të përdorë gërshërën e gjilpërën, ose nuk di të presë e të qepë të paktën ndërresat e fëmijëve? Me siguri, të gjitha dini dhe këtë e tregon veshja juaj. Ndodh që nënvleftësohet kjo zotësi e madhe e grave dhe e vajzave tona, ky nuk është qëndrim i drejtë. Partia na mëson që këtë zotësi krijuese të popullit ta vlerësojmë dhe ta ngremë në një nivel më të lartë. Shoqet dhe shokët, që drejtojnë kurset, nuk duhet të shkojnë me mendimin se ato që kanë ardhur për të mësuar në këto kurse janë analfabete, po të kenë parasysh se vajzat dhe gratë tona, edhe me një kurs të vogël, mund të mësojnë e të bëjnë gjëra të mëdha.

Ka kooperativistë të thjeshtë, që, megjithëse ligjet e agroteknikës nuk i dinë në teori, bujqësinë e njohin shumë mirë, se kanë praktikë, horizont të gjerë dhe eksperiencë të madhe në këtë sektor. Nganjëherë, bile shumë herë, kuadrot tanë drejtues bëjnë gabim që nuk i dëgjojnë kooperativistët kur sinjalizojnë për kohën kur duhet mbjellë ose jo një bimë e caktuar, po këmbëngulin në të tyren, duke menduar se ai që e jep këtë këshillë përton të fillojë mbjelljen në kohë, pra, qenka dembel etj. Mirëpo, disa herë, del që ai «dembeli» ka të drejtë, se e vërteta është që fshatari ka eksperiencë të madhe dhe e njeh më mirë se kushdo tokën që ka rrotull. Natyrisht, bashkë me eksperiencën, ai ka pasur

edhe një sërë vështirësish që ekzistonin në të kaluarën, si mungesa e mjeteve të ndryshme mekanike etj., por, sidoqoftë, këtë eksperiencë duhet ta studiojmë dhe të përfitojmë prej saj. Gjithashtu, ka me mijëra shembuj që flasin për një përvojë të pakufishme në praktikën e popullit tonë në shumë drejtime. Po të dimë ta shfrytëzojmë këtë përvojë, do të ecim shumë përpara.

Sa veta ka këtu te ju që kanë kryer shërbimin ushtarak? S'ka dyshim se këtu duhet të ketë me dhjetëra, që gjatë shërbimit ushtarak kanë qenë artilierë, marinarë, teknikë në oficinë, tankistë etj. Ata janë teknikë të mesëm rezervë që, në rast nevojë, do të jenë të gatshëm dhe të zotë të marrin në dorë çdo armë dhe ta vënë në lëvizje për mbrojtjen e atdheut tonë socialist. Kjo është një gjë shumë e mirë dhe e domosdoshme. Të gjithë këta djem, që kanë kryer shërbimin ushtarak, mund t'i sjellin shumë shërbime edhe kooperativës, sipas nevojave që mund të ketë kjo. Ai, që në ushtri ka mësuar për infermier, fare mirë mund t'i bëjë shiringën një të sëmuri, ose të mjekojë një plagë. Ai që ka qenë tankist mund të bëhet me lehtësi ndihmëstraktorist e kështu ju kenë në radhët tuaja elektrikistë, muratorë e të tjerë. Pa lënë mënjanë punët e mëdha të bujqësisë, i aktivizoni këta djem ta vënë në shërbim të kooperativistëve specialitetin që kanë mësuar gjatë shërbimit ushtarak.

Ne jemi rrethuar nga të katër anët me armiq dhe kështu po jetojmë me dhjetëra vjet, por asgjë s'kanë ç'na bëjnë. Ata na kanë halë në sy, po edhe ne i demaskojmë pa mëshirë armiqtë e popujve dhe të socializ-

mit, duke filluar nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës e deri te revizionistët e të gjithë reaksionarët. Edhe pse të gjithë armiqtë duan të na shkatërrojnë, asnjë nuk guxon të na prekë. Ata vërtet kanë fuqi të madhe, por dhe ne nuk i kemi të vogla, ata nuk na mundin dot, nuk mund t'i mposhtin dot popullin dhe Partinë tonë se këta udhëhiqen nga një forcë e pamposhtur, nga marksizëm-leninizmi dhe janë bërë flamurtarë të çështjes së lirisë, të pavarësisë së popujve, të çështjes së madhe të socializmit në gjithë botën. Kjo ka rëndësi të madhe, pse, në qoftë se guxojnë të na sulmojnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës ose Bashkimi Sovjetik, Italia ose Jugosllavia, apo kushdo tjetër qoftë, popujt e tyre, që janë me ne, do të ngrihen më këmbë dhe do t'u qesin vështirësi të jashtëzakonshme klikave sunduese të këtyre vendeve, përveç luftës së madhe që do t'u bëjë agresorëve populli shqiptar. Në rast se do të nisin luftën me ne, armiqtë do ta kenë pisk në Shqipëri dhe këtë ata e dinë fort mirë, prandaj nuk guxojnë të na sulmojnë, sepse, po të fillojnë konfliktin e armatosur kundër nesh, nuk do të fitojnë, me siguri do të humbasin.

Shikoni ç'ngjet në Vietnam. Atje një popull i vogël po i bën ballë fuqisë së madhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, që as me avionë e as me çfarëdo mjete tjetër që përdorin, nuk po e mposhtin dot vullnetin e popullit vietnamez. Vetëm nëpërmjet tradhtisë së revizionistëve sovjetikë e të qëndrimit oportunist në udhëheqjen e partisë e të shtetit të Vietnamit, është bërë e mundur që të zhvillohen bisedime në Paris me imperialistët amerikanë. Ata kanë rreth një

muaj që kanë hyrë në pazarllëqe, duke arsyetuar se gjoja Shtetet e Bashkuara të Amerikës do t'i pushojnë bombardimet kundër Vietnamit të Veriut.

Udhëheqësit vietnamezë na kanë pyetur edhe ne se ç'mendojmë për këto bisedime dhe ne ua kemi thënë hapur pikëpamjen tonë, sipas së cilës na duket se ata po bëjnë një gabim të rëndë që po bisedojnë me imperialistët agresorë amerikanë. Përkundrazi, ne mendojmë ta vazhdojnë luftën deri në fund, deri në fitore, sepse bisedimet nuk janë tjetër veçse manovra të amerikanëve dhe të sovjetikëve për të gënjer popujt.

Arsyeja që armiqtë nuk kanë ç'na bëjnë është se ne, Parti e popull, jemi në pozita të drejta luftarake, të bashkuar fort, si një grusht i vetëm. Populli shqipëtar është i lidhur si mishi me thoin me Partinë, me ideologjinë e saj marksiste-leniniste, asnjë të çarë nuk ka në radhët tona.

Partia jonë ka kaluar nga një mijë e një halle. Lufta dhe vështirësitë e panumërta atë e kanë kalitur, e kanë bërë vigjilente dhe vigjilenca e lartë e ka ndihmuar kurdoherë të zbulojë armiqtë, të cilët i ka spastruar me kohë, pasi ka analizuar veprimtarinë e tyre. Nga kjo Partia jonë ka ditur të nxjerrë mësim. Kuadrot e Partisë sonë janë të kalitur dhe çdo ditë po kaliten. Gjithë ky revolucionarizim i madh që ka shpërthyer, i udhëhequr nga Partia, ka pikërisht këtë qëllim: të forcojë Partinë e popullin, të forcojë unitetin midis tyre.

Kur Partia rekomandon të forcohet puna me masat dhe populli të flasë lirisht e zëri i tij të dëgjohet

me vëmendje e të bëhet ajo që kërkon populli, ka parasysh se kjo është me rëndësi vendimtare, mbasi forcon lidhjet popull-Parti. Ajo parti që ka popullin kundër, është e destinuar të dështojë dhe nuk mund të quhet parti marksiste-leniniste. Partia jonë quhet marksiste-leniniste pikërisht sepse është e lidhur ngushtë me popullin dhe komunisti gjithnjë futet sa më thellë në popull. Kjo i bën komunistët të jenë të thjeshtë, jofodullë. Komunisti, po u bë fodull, po gënjeu e po pati vese të tjera, mbaron së qeni komunist, pra, nuk është më as për partinë, as për popullin. Komunisti duhet të jetë më punëtori nga të gjithë, të jetë jashtëzakonisht i ndershëm, të mos i ngjitë gjë në dorë, të ketë ndërgjegje kurdoherë të pastër.

Populli duhet të dijë çdo gjë për komunistët, për çdo anëtar partie, atij asgjë nuk duhet t'i fshihet. Sa më shumë të dijë populli si është komunisti, aq më mirë është; sa më shumë t'i heqë populli veshët komunistit, kur ky vepron keq, aq më mirë është për Partinë. Prandaj kritika dhe autokritika, brenda në Parti dhe jashtë saj, janë të domosdoshme. Fletërrufetë, gjithashtu, janë të domosdoshme. Ka akoma njerëz që nuk e kanë kuptuar si duhet qëllimin e tyre, që kanë frikë dhe mendojnë se, po t'i vënë një fletërrufe, për shembull, kryetarit të kooperativës, sekretarit të organizatës-bazë të Partisë ose cilitdo tjetër, mund t'u bjerë këtyre autoriteti, ose nesër ata mund të hakmerren ndaj atij që bën fletërrufe. Por, të nxjerrësh një fletërrufe, s'ka asgjë të keqe, përkundrazi, ka shumë të mira. Për sa kohë që fletërrufenë e ke menduar mirë, e ke të argumentuar dhe nuk e bën

me zemërligësi, mos ngurro ta bësh, mos ki frikë ta vësh dhe për të duhet të marrësh përgjigje. Nuk është e drejtë të ngurrohet në të tilla raste, duke menduar ç'më duhet mua, kam djaln ose vajzën që më punon këtu ose atje dhe kush e di ç'do të më bëjnë. Po të mendohet kështu, nuk do të na ecin mirë punët. Interesi i përgjithshëm duhet vënë mbi interesin personal, se, në radhë të parë, duhet parë interesi i popullit, i Partisë. Kur ke të drejtë, ajo patjetër do të të jepet nga populli dhe nga Partia, në mos sot, nesër. Te ne e drejta del në shesh, kurse gënjeshtria, siç thotë populli ynë, i ka këmbët e shkurtra, nuk mund të ecë gjatë dhe një ditë, i turpëruar, gënjeshtari do të bëhet leckë, kurse ai, në dëm të të cilit u drejtuan gënjeshttrat, do të jetë përsëri i nderuar dhe i respektuar nga të gjithë. Duke u dhënë rëndësi të veçantë çështjeve që kanë lidhje me jetën e njerëzve, i kushtoni kujdes forcimit të moralit të shëndoshë komunist të tyre.

Më falni që ju vonova shumë, u bë natë dhe ju lashë pa ngrënë. Do të bëhen një çikë merak plakat në shtëpi, por besoj se s'do t'ju thonë gjë, ato e dinë që erdha unë këtu dhe këtë herë do t'jua falin vonesën. Duke qëndruar midis jush, në një ambient kaq gazmor si ky, njeriu e ka vështirë të largohet.

Jam shumë i gëzuar për këtë takim dhe nuk do ta harroj kurrë këtë ditë që kalova me ju. Po ju keni vënë përpara edhe këta fiq, që besoj janë nga të kooperativës. Hajde, pra, mirë se ju gjeta dhe me gëzime e me suksese!

Edhe një herë ju uroj nga zemra suksese në punë

dhe qofshi të gëzuar! Do t'u them shokëve të Komitetit Qendror të Partisë për pritjen shumë të ngrohtë që më bëtë. Ky respekt e kjo dashuri që treguat, i përkasin Partisë sonë të dashur që na udhëheq dhe që ju, me plot të drejtë, e doni shumë, pse ajo çliroi Shqipërinë dhe po e çon atë me hapa të sigurt drejt socializmit dhe komunizmit. Flamuri i Shqipërisë do të qëndrojë kurdoherë lart e krenar. Prandaj le të brohorasim:

Të rrojë Partia!

Të rrojë populli shqiptar!

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në AQP

**TE POPULLI JANË MENÇURIA, DITURIA,
ZOTËSIA. TEK AI PARTIA MERR FORCËN E SAJ**

*Nga biseda me kuadro dhe me kooperativistë
të kooperativës së bashkuar «Shkurte Pal Vata»
të rrethit të Lushnjës*

1 korrik 1968

Së pari, dëshiroj t'ju shpreh gëzimin e madh që ndiej për këtë vizitë në kooperativën tuaj të bashkuar, që mban emrin e komunistes 15-vjeçare, Shkurte Pal Vata. Kooperativa juaj përmbledh 9 fshatra dhe ka një të ardhme shumë të mirë.

Kryetari i kooperativës më foli shkurt dhe qartë për zhvillimin dhe për gjendjen në kooperativën tuaj. Gjithashtu, sekretari i parë i komitetit të Partisë të rrethit, shoku Rrapi Gjermani, na ka folur mirë për ju, për punën tuaj.

Ne vëmë re se ju keni bërë shumë përparime, keni ecur përpara, duke zbatuar drejt vijën e Partisë, direktivat e saj. Ju, më parë, i keni përpunuar në kokë këto direktiva, i keni kuptuar e i keni zbërthyer drejt, prandaj i keni zbatuar. Dhe kjo jep rezultate

pozitive, ashtu siç bëhet e mirë dhe e shijshme buka kur e bluajmë mirë misrin ose grurin. Pra, kur direktivat e Partisë zbërthehen mirë, kur u shpjegohen e u sqarohen drejt masave, bëhen të kuptueshme prej tyre, bëhen një forcë e madhe udhëheqëse për to, të cilat, duke i zbatuar, krijojnë gjëra të mrekullueshme.

E kam njohur edhe unë Ali Kuçin¹ që përmendi kryetari i kooperativës suaj dhe bile jam zënë ashpër me të.

— Kujton se do të fitoni ju? — më tha Aliu.

— Po, — ia ktheva, — ne do të fitojmë, populli do të fitojë!

— Ju, — vazhdoi Aliu, — s'fitoni dot! E kush ju njeh ju?

Dhe unë iu përgjigja:

— Ne jemi njerëz të thjeshtë të popullit dhe ndofta populli akoma nuk na njeh, por idetë që përfaqësojmë ne, idetë e komunizmit populli i ka në zemër. Ai akoma nuk e di, or Ali, ç'do të thotë komunizëm, por ka të qartë një gjë, që po shtypet e po shfrytëzohet pa mëshirë nga ti, nga Ali bej Këlcyra, nga Vrionasit, nga gjithë bejlerët e agallarët e tjerë, prandaj do të jetë patjetër me ne dhe jo me ju.

Dhe vërtet populli ishte me ne, luftoi dhe fitoi.

Idetë e mëdha të Partisë udhëhoqën dhe çuan popullin në fitore, i cili u brumos me to, luftoi dhe mundi Italinë fashiste, Gjermaninë e Hitlerit. Më vonë u ndesh me revizionistët jugosllavë të Titos.

¹ Është fjala për ish-pronarin e tokave të kësaj kooperative para Çlirimit.

Me to u bëri ballë kërcënimeve të mëpastajme të monarko-fashistëve, të neofashistëve italianë, të imperialistëve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të revizionistëve sovjetikë. Ne nuk ia kemi frikën kurrkujt se jemi në rrugën e drejtë dhe se idetë e Partisë, idetë e komunizmit janë futur thellë në masat punonjëse, janë bërë mish e gjak i gjithë popullit. Populli i ka përqaftuar ato dhe është bërë një me Partinë. Pikërisht kësaj ia ka frikën armiku, cilidoqoftë. Sikur edhe të bashkuar të jenë të gjithë armiqtë kundër nesh, prapë na kanë shumë frikë, dhe kanë arsye, sepse ne, pavarësisht se jemi popull i vogël në numër, nga vepra, nga qëndrimi, nga idetë që mbrojmë, jemi të mëdhenj. Dhe në qoftë se armiqtë na godasin, me siguri do të thyhen. Ata e dinë se, po të sulmojnë kufijtë tanë, nuk mund të fitojnë dot as për një vit, as për dy dhe as për dhjetë vjet. Fitorja do të jetë medoemos jona, prandaj armiqtë i ruhen shumë këtij rreziku. Po të mos e shihnin këtë rrezik, do të na kishin sulmuar me kohë. Mos vallë ishte budalla Aliu? Jo, përkundrazi, ai dhe të gjithë shokët e tij ishin shumë finokë e të poshtër. Edhe miqtë e tyre të jashtëm, imperialistë e revizionistë, budallenj nuk janë dhe llogari bëjnë, po me ne llogaritë nuk u dalin mbarë, se e dinë që Partia është e lidhur si mishi me thoin me popullin, dinë, gjithashtu, se popujt kurrë nuk do t'i përkrahin, përkundrazi, do të ngrihen kundër tyre.

Ahmet Zogu, në kohën e vet, bërtiste se ishte mbret i Shqipërisë dhe kishte njerëz që i thurnin lëvdata këtij farë mbreti, i cili, në fakt, s'ishte tjetër

veç një kukull në duart e të huajve, por populli nuk e bëri këtë, sepse popullin ai s'e kishte me vete. Kurse tani armiqtë tanë, për të na trembur, bërtasin se janë të pajisur me gjithfarë armësh, por ata harrojnë se Shqipëria nuk është më si në kohën e Ahmet Zogut, nuk është pa mbrojtje dhe pa udhëheqje, pastaj ata nuk kanë njerëzit me vete, nuk kanë shpirtin e vullnetin e tyre, pa të cilat armët s'vlejnë. Njerëzit dhe popujt nuk rrinë duarlidhur, ashtu siç nuk ndejtëm duarlidhur ne gjatë pushtimit fashist që, duke e gërryer nga pak e nga pak e duke bërë luftë të madhe, të paprerë, e rrëzuan më së fundi kalanë e fashizmit, që dukej si e palëkundur. Kështu do të ngjashë nesër edhe me vendet kapitaliste e revizioniste, popujt do t'i gërryjnë nga themelitet regjimet antipopullore në vendet e tyre dhe, një mëngjes, ashtu siç ngjau te ne, ose në Bashkimin Sovjetik në kohën e Leninit dhe të Stalinit, revolucioni do të shpërthejë dhe tradhtarët do t'i përmbysë njëherë e përgjithmonë.

Imperialistët dhe revizionistët kanë shumë frikë nga revolucioni. Ata kanë frikë nga ne, sepse e dinë që udhëhiqemi nga idetë marksiste-leniniste. Shqipëria tani ka marrë një emër të madh në botë, është bërë pishtar i revolucionit. Njerëzit e thjeshtë kudo e përmendin Shqipërinë me nder e me respekt, «S'ka si shqiptarët, — thonë ata, — janë të drejtë dhe trima, prandaj nuk duhen ngarë». Dhe kur thonë këtë, kanë arsye. Bota e shikon se ne, pa frikë, u kemi ngritur mitralozin gjithë armiqtë. Ne jemi të armatosur gjer në dhëmbë, dyfekun e mbajmë në sup dhe barutin kurdoherë të thatë.

Nga ana tjetër, ne jemi të fortë jo vetëm me pushkë, po edhe në punë. Me punë të paprerë kemi rritur rendimentet e grurit, të misrit, sasinë e qumështit nga çdo lopë etj., kemi ngritur një industri të fuqishme, që po e rritim dita-ditës etj., etj. Kjo do të thotë se shqiptarët janë një popull trim në luftë e trim në punë dhe këtë tashmë e di gjithë bota. Njerëzit e mirë e duan trimin, kurse frikamanin jo. «Shqiptarët, — thonë njerëzit përparimtarë, — janë të ndershëm, po të dhanë fjalën, e mbajnë». Dhe njeriun e ndershëm e duan të gjithë, të pandershmin, të pabesin, tradhtarin s'e do njeri. Prandaj e do gjithë bota Shqipërinë dhe flet me admirim për të.

Partia Komuniste e Shqipërisë, sot Partia e Punës, me programin e saj të qartë, udhëhoqi gjer në fitore luftën për çlirimin e Shqipërisë nga pushtuesit e tradhtarët. Pas kësaj, ajo i bëri thirrje popullit për të ndërtuar atdheun, për të zhdukur prapambetjen dhe varfërinë e plotë të trashëguar nga e kaluara. Në vendin tonë mungonte pothuaj çdo gjë: veshmbathja, buka, shkolla, lëre pastaj që nuk bëhej fjalë për fabrika e uzina, për rrugë automobilistike e hekurudha. Shkalla e zhvillimit të bujqësisë e të blegtorisë ishte tepër e ulët. Çdo sektor te ne ishte shumë i prapambetur. Na duhej t'ia ndërronim krejt faqen Shqipërisë. Mirëpo hallet tona s'kishin të mbaruar, sepse ata armiq të popullit, që shpëtuan nga thika e nga litari dhe që, në vitet e para pas Çlirimit, s'ishin të paktë dhe me zemër ishin tek Ali Kuçi me shokë, thoshin për ne se shpejt do të na merrte lumi, se ditët i kishim të shkurtra, se shpejt do të dorëzohe-

shim, se nuk dinim të qeverisnim etj., etj. Po ata gaboheshin rëndë, ashtu siç kishin gabuar kurdoherë. Kur thoshin që ne s'dinim, kjo kishte diçka të vërtetë. Ne nuk i dinim ca gjëra, por dinte populli, dinin dëshira dhe dashuria jonë e madhe për Shqipërinë, që u vumë gjoksin kërkesave të kohës e situatave, dinte Partia, që u tha anëtarëve të vet: «Shkoni në popull se atje është dituria. Mbështetuni te populli dhe bashkë me të ia ndërroni faqen Shqipërisë. Te populli janë mençuria, dituria, zotësia. Tek ai Partia merr forcën e saj». Dhe komunistët u bashkuan ngushtë me popullin, ashtu si gjatë viteve të luftës u përveshën punës.

Ju e dini se në fillim, pas Çlirimit, inxhinierët në vendin tonë numëroheshin me gisht, mjekët, profesorët, gjithashtu, ishin shumë të paktë, megjithatë, brenda dy vjetëve pas Çlirimit, ne ndërtuam të gjitha rrugët dhe urat e vendit, që na i patën shkatërruar pushtuesit. Reaksionarët habiteshin, si ishte e mundur të bëhej një mrekulli e tillë. Po, shoqe dhe shokë, kjo mrekulli u bë nga masat tona punonjëse, me ata inxhinierë e teknikë të paktë, pse bashkë me ne ishte populli, që dinte shumë gjëra dhe që i donte shumë atdheun dhe Partinë. Njerëzit e thjeshtë të popullit, që gjer atëherë kishin ndërtuar vetëm kasolle, u ngritën me një hov të paparë entuziazmi revolucionar dhe ndërtuan të gjitha urat, rrugët, shtëpitë e djegurat etj.

Një nga arritjet më të mëdha të politikës së Partisë ishte edhe fitorja e rendit kooperativist në fshat, bashkimi i fshatarëve në kooperativat bujqësore. Disa thoshin se ne do ta kishim të zorshëm

organizimin e fshatarëve në kooperativa, por Partia kishte besim në realizimin e këtij orientimi. Ata që dyshonin, mundoheshin ta shpjegonin këtë me faktin që fshatari ynë është i lidhur shumë me tokën dhe shprehnin frikën se fshatari do të kundërshtonte, po t'i thuhej të bashkonte tokën. Mirëpo Partia kishte besim se fshatari ynë përparimtar do ta kuptonte rrugën e drejtë, do të kuptonte që toka, edhe pas kësaj, mbetej pronë e tij dhe jo e një grushti njerëzish. Prandaj ajo këshillonte të punohej me fshatarët dalngadalë, pa u shpejtuar, me durim. Mund të ndodhë, parashikonte Partia, që të ketë fshatarë, të cilët nuk do ta kuptojnë menjëherë, po kini besim se, gradualisht, të gjithë do ta kuptojnë fjalën e Partisë, qëllimin e saj të madh. Dhe eci Partia me kujdes e me durim, derisa, më së fundi, e bindi fshatarësinë, i shpjegoi asaj se kolektivizimi është e vetmja rrugë shpëtimi, që do ta nxjerrë fshatarin në dritë. Bujqësia është një nga të dy këmbët e ekonomisë socialiste. Pa bujqësinë e kolektivizuar, nuk mund të ndërtohet socializmi në asnjë vend. Industria socialiste, nga njëra anë, dhe, bujqësia socialiste, nga ana tjetër, të dyja së bashku përbëjnë kolonat bazë mbi të cilat mbështetet fort dhe do të ecë përpara, pa u penguar, ekonomia jonë socialiste.

Për zhvillimin e shpejtë të bujqësisë ne bëme investime të mëdha, gjersa krijuam situatën që kemi sot. Po vallë e kemi krijuar plotësisht atë që mendon Partia? Jo, akoma nuk e kemi krijuar. As ju mos u kënaqni me sukseset që keni arritur. Ditë edhe më të mira, që akoma nuk i përfytyron dot njeriu, do të

kemi përpara dhe do t'i arrijmë me punë të palodhur. Nuk duhet habitur me rendimentet që marrim. Ka shokë fshatarë që mendojnë se u arrit kulmi, duke marrë në disa parcela 45 kv për ha grurë. Është me të vërtetë një gjë e madhe ta marrësh këtë rendiment nga disa parcela, por do të vijë koha që jo në 80 hektarë, po në të gjitha tokat e vendit, të marrim mesatarisht 45 kv për ha grurë. Dhe atëherë do të kemi të drejtë të themi se kemi arritur të ngremë një bujqësi me të vërtetë të përparuar moderne. Në këtë drejtim duhet ta bëjmë luftën dhe kemi besim se do t'ia arrijmë kësaj dite.

Fshatarësia e Lushnjës e pa me sytë e vet ç'investime të mëdha kanë bërë Partia dhe Qeveria në fushat e vendit tonë, sa miliarda janë derdhur edhe këtu pranë jush, ku më parë mbretëronin moçalet, mushkonjat, mezhdat e ferrat. Po nga dolën gjithë këto para? Natyrisht, ato nuk ranë nga qielli, po u siguruan me punën e tërë popullit. Partia dhe Qeveria ditën si t'i administronin mirë të ardhurat e ekonomisë popullore. Së pari, duke përmbysur nga themelitet pushtetin reaksionar, pushtetin e kusarëve të dikurshëm, që i pinin gjakun popullit. Pas Çlirimit të vendit, Partia paralajmëroi, gjithashtu, se kush do të orvatej të vidhte pasurinë e popullit, do të dënohej. Pra, të ardhurat që arkëtonte Qeveria jonë Popullore i përdorte në interes të jetës së popullit, thante kënetat, ndërtonte kanale kulluese dhe ujitëse, blinte traktorë, farëra të zgjedhura, hapte shkolla, universitetin për kuadro të lartë, inxhinierë, agronomë, mjekë e të tjerë, sipas nevojave të vendit, ndërtonte indu-

strinë, rrugët, hekurudhat dhe i bëri fushat e Shqipërisë në gjendjen që i shohim sot, ku ju tash, me punë të palodhur e me metoda të përparuara, arrini të merrni rendimente më të larta se në të kaluarën.

Sivjet ju do të siguronim të korrura të mira. Është i treti vit me radhë që ne po ecim mirë në bujqësi. Kjo është një fitore e madhe. Në vitin e parë të pesëvjeçarit patëm rezultate mjaft të kënaqshme, vjet më mirë, sivjet akoma më mirë dhe në të ardhmen në këtë rrugë do të ecim. Për të mirën e popullit dhe për inat të armiqve ne do të korrim vazhdimisht suksese dhe do ta ngremë kurdoherë nivelin e jetesës së masave punonjëse. Kjo le të jetë një nxitje për suksese më të mëdha në vitet e ardhshme. Ju tash e kuptoni, se qoftë për misrin, por veçanërisht për grurin, nuk ju ndihmoi aspak koha apo «perëndia», «pejkamberi», «Krishti» apo «shën Nikolli», por djersa e ballit, puna që keni bërë pa u kursyer, prandaj dëshiroj, me këtë rast, në emër të Komitetit Qendror dhe të Qeverisë, t'i përgëzoj të gjithë kooperativistët e Lushnjës dhe ju për punën e lavdërueshme që keni bërë.

Muajin që kaloi ne thirrëm në raport sekretarin e parë të Komitetit të Partisë të Rrethit tuaj, për të na raportuar për gjendjen e grurit dhe të misrit. Ai na dha, në udhëheqje, një pasqyrë reale të gjendjes së rrethit tuaj, sidomos për rendimentet e mira që keni arritur në bujqësi. Ju të gjithë, gra e burra, i keni kuptuar direktivat e Partisë dhe i keni zbatuar mirë. Kur Partia ju këshillonte si ta mbillnit grurin, ju vepruat siç ju udhëzuan; kur Partia ju mësoi si të prashitej gruri, që s'ishte prashitur kurrë, ju u

mobilizuar të tërë dhe e prashitët jo vetëm një herë, por në shumë parcela dy herë; kur Partia ju udhëzoi të grumbullonit urinën dhe të plehëronit bimët, ju e bëtë këtë si nikoqirë të mirë; në kohën e lagështirës së madhe ju morët litarin dhe e shkundët grurin sipas porosisë dhe s'pyetët për gjumin, po natën e bëtë ditë dhe kështu shpëtuat prodhimin. Ja ç'do të thotë të punosh si njeri i socializmit, prandaj ju i meritoni përgëzimin e Partisë dhe respektin e mbarë popullit. Puna e madhe që keni bërë, ju gëzon jo vetëm ju, që tani shikoni frytin e saj, po gjithë Shqipërinë.

Kohët e fundit Qeveria vendosi të sjellë nga jashtë shumë mallra që i nevojiten fshatit. Do të merren masa, gjithashtu, për të hedhur në treg më shumë materiale ndërtimi dhe do t'i kushtojmë më tepër rëndësi organizimit në furnizimin me këto materiale, për të plotësuar në shkallë më të kënaqshme nevojat e kooperativave. Kjo duhet të shërbejë e të ndihmojë në nxitjen e mëtejshme të shtimit të prodhimeve.

Rezultatet kaq të mira që keni arritur në kooperativë, siç përmendi edhe kryetari juaj, janë fryt i punës politike të Partisë, i atij revolucionarizimi për të cilin ju flasin ngaherë shokët komunistë, në të gjitha drejtimet, si, për shembull, për emancipimin e gruas shqiptare, për luftën kundër zakoneve prapanike etj., etj. Të gjitha këto masa kanë sjellë ndryshime të mëdha si në gjithë jetën e vendit, edhe në bujqësi, në industri e kudo.

Disa mund të thonë se rritja e prodhimit nuk ka lidhje me çështjen e gruas. Jo, shokë, këto kanë

lidhje të ngushtë me njëra-tjetrën. Të gjithë e dimë mirë se gjysma e popullsisë përbëhet nga gratë e vajzat, nga mëmat e motrat tona, të cilat kanë dhe duhet të kenë po ato të drejta që kemi edhe ne. Ashtu siç jemi ne njerëz me zemër, me mendje, me ndjenja, ashtu janë edhe ato. Por vallë, është e drejtë të ketë ndryshim në trajtimin e tyre? Partia na mëson se të gjithë, si burri dhe gruaja, duhet të trajtohen njëjloj. Ndryshimi që ekzistonte në të kaluarën ishte rrënjosur prej klasave shfrytëzuese. Atëherë gratë shtypeshin nga burrat, siç shtypej mbarë populli nga bejlerët. Burrat, meqenëse ishin të shtypur e të përbuzur nga klasat sunduese, të cilave s'kishin ç't'u bënin, hakmerreshin për këtë në shtëpi, duke keq-trajtuar nënat, gratë e motrat, që s'kishin asnjë faj, por këtë ata s'e kuptonin. Vetëm tani është kuptuar drejt kjo çështje. Partia ia ka hapur sytë popullit duke i treguar se edhe gratë janë të zonjat për punë, se edhe ato janë të zgjuara, prandaj duhet të lihen të lira jo vetëm të punojnë, por edhe të drejtojnë, të mendojnë e të krijojnë. Pra, gruaja mund të drejtojë njëjloj si burri, shumë prej tyre i kanë të gjitha mundësitë dhe aftësitë për t'u bërë brigadiere, drejtuese, komuniste, sekretare partie.

Partia u tërheq vëmendjen komunistëve kur këta ngurrojnë të pranojnë gra në radhët e saj. Ajo kërkon me këmbëngulje që, krahas me burrat, të pranohen në Parti gratë më revolucionare. Dhe organizatat-bazë të Partisë kanë filluar të mendojnë ndryshe për këtë çështje.

Të gjithë tani, në fshat dhe në qytet, punojnë

së bashku, burra e gra. Kështu, të dy palët, shtojnë të ardhurat në familje. Po të shtrojmë pyetjen se si është më mirë, të punojë vetëm burri dhe të ushqejë 10 veta në familje, apo të punojë edhe gruaja edhe vajza kur është në moshë pune. Sigurisht, është më mirë të punojnë më shumë veta, sepse kështu rritet mirëqenia e njerëzve, ndërtohet socializmi, lulëzon e fuqizohet atdheu. Kështu na mëson Partia, prandaj është ngritur e punon me hov të paparë gjithë kjo masë e madhe e grave, e cila më parë rrinte si një forcë e fjetur.

Partia i zgjoi energjitë e fjetura të grave të vendit tonë. Tani u bie detyrë e madhe burrave t'i ndihmojnë gratë, në punë, në familje, në shoqëri. Kjo ndihmë është shumë e nevojshme, veçanërisht në fillim, se pjesëmarrja e gruas në jetën ekonomike dhe shoqërore, në shkallë kaq të gjerë, vetëm disa vjet ka që ka marrë hov. Një brigadiere e re ka nevojë të ndihmohet dhe asaj duhet t'i jepet kjo ndihmë e jo përnjëherë të thuhet për të se nuk e bën dot punën, se nuk e ka realizuar këtë ose atë detyrë. Le ta ndihmojmë më mirë që t'i realizojë detyrat. Gjithashtu, kur shohim se ndonjë burrë synon t'i zërë vendin ndonjë gruaje që ngrihet në përgjegjësi dhe për këtë qëllim hap fjalë të këqija kundër saj (se ndodhin edhe të tilla gjëra, shumë të dëmshme), ta mbrojmë, kur është grua apo vajzë e ndershme. Në rast se ndonjë llafazan, kur ajo shkon në punë me një anëtar të brigadës, pëshpërit ose shpif, kundër tij duhet të mbahet qëndrim dhe njëkohësisht të shpjegohet se ajo u shoqërua me këtë njeri se e ka në

brigadë. Shpifësi, kur gjen kundërshtim, tërhiqet, po, megjithatë, helmin që ai lëshon, duhet ta pastrojmë dhe e vërteta të vihet në vend, ndryshe dëmtohet gruaja ose vajza.

Thashethemet, shokë e vëllezër, duhet të luftohen, se janë të huaja për shoqërinë tonë socialiste, për unitetin tonë. Po vallë mund të bëhet edhe ndonjë gabim nga gratë ose vajzat? Sigurisht, po. Ashtu sikurse një djalë mund të gabojë, ashtu mund të bëjë gabim edhe një vajzë. Kjo mund të ndodhë dhe për të dy palët duhet të mbajmë qëndrim të drejtë, të mos ua mbulojmë gabimin. Natyrisht, duhet të kemi pak më tepër kujdes për vajzat, pa e bërë bujë gabimin, por t'i vihet në dukje ai, kur është nevoja, në Parti ose në kryesi, të këshillohet, t'i flitet politikisht etj. Me masa të tilla edukohen njerëzit dhe jo duke pëshpëritur vesh më vesh mureve dhe qosheve, ose duke futur grindje midis tyre për gjëra të qena e të paqena. Shpifjeve t'u vihet fre dhe të goditen pa mëshirë.

Ndaj grave e vajzave në të kaluarën mbaheshin qëndrime aspak njerëzore, bile të ulëta. Kur njërit i lindte vajzë, miku i tij, që kishte një djalë të rritur, ia kërkonte atë nuse për djalin, megjithëse ajo ishte akoma foshnjë, e fejonte vajzën që në djep, si pa gjë të keq, 15-20 vjet më parë se ajo të bëhej për martesë, pavarësisht si do të ishte djali që do ta merrte. A ishte e drejtë një gjë e tillë? Sigurisht, jo. Pastaj, kur rritej çupa, babai e shiste me para, si të ishte një berr apo një send. Partia i lufton këto zakone të mbrapshta, që rëndonin mbi gruan. Gruaja është jeta, është e ardhmja, është ajo që rikrijon jetën. Vetëm

për përtëritjen e jetës gruaja meriton një respekt shumë të madh nga burrat. Të tërë kemi pasur nëna dhe baballarë dhe e dimë sa i kemi dashur, prandaj të gjithë duhet t'i respektojmë ata, po sidomos nënat, plakat. Partia porositi, gjithashtu, të mos shiten më vajzat, po të edukohen me kujdes nga prindët, të cilët t'i duan si shpirtin. T'i respektojnë gratë e vajzat edhe për punën e tyre, sepse ato nuk mbeten pas burrave.

Partia i këshillon vajzat t'i duan dhe t'i respektojnë babanë dhe nënën se prindërit ua kanë bërë kokën. Po, kur vjen koha për martesë, vajza duhet të pyetet, se ka të drejtë ta zgjedhë vetë të fejuarin dhe jo ta shesë babai. Dhe kur asaj i pëlqen një djalë, është e mira që më parë ajo ta bisedojë këtë me nënën, t'i kërkojë mendimin dhe ndihmën për ta realizuar këtë dëshirë. Prindi, sigurisht, do të pyesë për këtë djalë dhe, kur të marrë vesh se është punëtor apo bujk i ndershëm, do ta urojë vajzën. Neve, prindërve, na vjen mirë kur na pyesin. E shpjeguar si duhet nga ana e Partisë dhe e kuptuar drejt nga fëmijët dhe nga prindërit, çështja e dashurisë dhe e martesës do të ndihmojë që punët të na ecin drejt. Mirëpo në jetë lindin mjaft probleme, nuk ngjasin të tëra kështu si thotë Partia. Ka raste që ngjasin gjëra të papëlqyera, por, në çdo moment, po të shikohen çështjet drejt dhe me urtësi nga komunistët, edhe do të zgjidhen drejt.

Partia punon dhe këshillon që zemrat e njerëzve të mos jenë të brengosura, por të gëzuara. Ka shumë rëndësi që zemrat e njerëzve të jenë të pastra, që këta

të rrojnë në ndershmëri, që dora e njerit të mos ngjitet në plaçkën e tjetrit, që askush të mos gënjejë, po të thotë drejt e pa frikë ç'mendon për cilindo dhe askush të mos e marrë për keq kritikën. Njerëzit tanë janë në gjendje ta kuptojnë nëse një njeri është i mirë ose jo. Kur ti shpreh një mendim, shoku të thotë nëse ke apo nuk ke të drejtë. Në rast se ai të vuri në dukje një të metë a një gabim, duke të treguar arsyet dhe duke u përpjekur të të bindë, ti duhet t'i shtrëngosh dorën, të përpiqesh ta korrigjosh gabimin dhe të mendosh drejt për shokun dhe për ndihmën që të dha. Në qoftë se nuk mendon dhe nuk vepron kështu, bën gabim. Puna bindëse e sqaruese e Partisë na mëson të komunikojmë sa të jetë e mundur më shumë me njerëzit, të dëgjojmë fjalët e popullit që vija e saj të kuptohet drejt nga të gjithë. Edhe kur bëjmë një leksion, çdo problem ta shpjegojmë me gjuhë të kuptueshme për popullin dhe, gjatë diskutimit, të dëgjohen me vëmendje mendimet e gjithsecilit.

Kurrë, motra dhe vëllezër, mos rrini pa thënë mendimin për çdo problem. Kur hapet një bisedë, qoftë për bujqësinë, qoftë për rendimentet, për fondin e paprekshëm, për normat, për sjelljet e kryetarit apo për punën e agronomit, për sekretarin e Partisë e të tjerë, gojën mos e mbyllni, thoni atë që keni në mendje dhe të jeni të bindur se s'do t'u merret për keq. Kjo është shumë e mirë. Ne duam që gjendja në vendin tonë të jetë e shëndoshë dhe një gjë e tillë do të na forcojë. Për të qenë e tillë duhet të luftojmë të tërë, edhe duke thënë hapur mendimin tonë, duke mbrojtur

vijën e Partisë kundër kujtdo qoftë. Partia dhe shteti kanë ligjet e veta. Në Kongres Partia ka aprovuar Statutin, të cilin duhet ta lexojnë e ta përvetësojnë të gjithë dhe duke u bazuar në të, të matim punën e çdo komunisti. Kur shikoni se ndonjë komunist nuk ecën në rrugën e Partisë, siç përcaktohet në Statut, atëherë i kërkoni atij llogari në mbledhje, në konferencë e kudo. Kur shikoni që një shitës komunist ose i paorganizuar në Parti, nuk e mat mirë, fjala vjen, vajin, po duke mbushur shishen largon enën e cila kishte akoma disa gram dhe nga një veprim i tillë ai çdo 15 ditë përvetëson disa kilogram vaj, t'i kërkohet llogari për këtë dhe të këmbëngulet që të largohet prej andej e në vend të tij të vijë si shitës një grua e ndershme. Të mos u mbetet hatëri burrave, por duhet të themi se gratë janë më të ndershme, prandaj të vini sa më shumë gra në vende me përgjegjësi materiale.

Të gjitha këto probleme duhet t'i marrë në dorë Partia e populli dhe të mos shkohet me mendimin e gabuar se çdo gjë e dinë udhëheqësit në qendër apo në rreth, ose kryetari i kooperativës. Këto i dimë ne, po duhet t'i dini edhe ju, jo vetëm ju t'ju kontrollojnë nga lart, po edhe ju të kontrolloni nga poshtë. Po si ta realizojmë ne kontrollin e popullit? Kjo arrihet duke i dhënë mundësi atij të thotë kudo fjalën e vet. Besoj se me këto që them jemi dakord, prandaj t'i vini në zbatim, ashtu siç keni vënë në zbatim atë që më mirë agroteknikën e grurit. Me një të tillë kujdes i shikoni këto gjëra se kështu do të përparojë më shumë kooperativa juaj e bashkuar.

Unë, ashtu si dhe organizata e Partisë në rreth.

kemi besim të plotë se ju do të ecni edhe më përpara. Me të vërtetë e prapambetur ka qenë kooperativa juaj, por hapat që ka bërë tregojnë sa i drejtë është besimi i Partisë te ju. Këmbëngulja juaj për të shtuar rendimentet qoftë në bujqësi, qoftë në blegtori, është e bazuar dhe kemi besim se do t'i realizoni ato mededmos. Ju keni arritur të merrni mesatarisht mbi 1 000 litra qumësht nga çdo lopë, po kini kujdes që mëshqerrrat më të mira të oborreve t'ia jepni kooperativës, e cila duhet t'ju paguajë për to paratë në dorë.

SHOKU FASLLI KORESHI¹: Viçat meshkuj i kemi marrë falas nga anëtarët, ndërsa mëshqerrrat me të holla.

SHOKU ENVER HOXHA: Falas apo me të holla, këtë ta shikojmë. Ngahera falas s'do t'ua marrim anëtarëve gjërat.

(Një fshatar nga masa lëviz në shenjë aprovimi.)

Sa mirë ta gjeta zemrën, — *i drejtohet atij shoku Enver.* — Të lumtë, të shprehësh hapur, kudo, mendimin dhe ndjenjat e tua, ky është një kuptim i drejtë i vijës së Partisë. Ne duhet ta kemi parasysh se mund të ketë ndonjë kooperativist që ka nevojë për të holla dhe nuk është në gjendje t'ia dhurojë viçin kooperativës, prandaj kjo çështje duhet parë. Sidoqoftë, mëshqerrrat i duhen dhënë kooperativës dhe kjo t'ia paguajë paratë menjëherë anëtarit, të cilit mund t'i duhen për të ndërtuar shtëpinë apo për të blerë një krevat, mobilie etj.

Ne do ta marrim në studim këtë problem dhe do

1 Në atë kohë kryetar i kooperativës bujqësore.

ta rritim ca fondin për shtimin e lopëve, me qëllim që të mbani të gjithë lopë në oborre. Partia tani po mendon që tokat si këto tuajat, që nuk janë të thata, t'i shndërrojë në toka pjellore, me shfrytëzim intensiv. Në këto kushte nuk ka për të mbetur më kullotë për dhi dhe për dele. Kjo gjë, sidomos këtej fushave, do të bëhet më shpejt, prandaj është e mira të mbani më shumë lopë, edhe këto të jenë nga ato që japin 2 000-2 500 litra qumësht e më shumë në vit. Kështu do të keni qumësht për vete dhe për të shitur. Që të merrni 2 000 litra qumësht e më shumë duhet t'i siguronit lopës ushqim të mjaftueshëm. Veç qumështit, rritja e lopës ka leverdi të madhe edhe për plehun, për të cilin ka shumë nevojë bujqësia. Ne kemi ngritur dy fabrika për plehra dhe, në të ardhmen, do të ngremë të tjera. Tani ju mburreni që merrni 20 ose 25 kuintalë grurë ose 30 kuintalë misër për hektar, mirëpo të jeni të bindur se, pas disa vjetësh, do të thoni ku kemi qenë, kur të shikoni që rendimentet do t'i ngremë më shumë.

Ç'do të bëjmë me gjithë këtë misër? Do t'u japim edhe lopëve të kooperativës dhe të anëtarëve. Dhe kështu, duke ngrënë silazh të njomë, lopa e anëtarit do të prodhojë më shumë qumësht, që do të ketë edhe sasinë e duhur të gjalpit etj. Rritja e rendimenteve do ta krijojë medoemos këtë situatë. Përpara nuk flitnim dot kështu për këtë problem, kurse tani, me orientimet dhe me punën këmbëngulëse të Partisë, gjendja ka ndryshuar dhe bashkë me të edhe mendimi i njerëzve. Duke pasur parasysh botën dhe formimin e njerëzve, Partia eci dhe ecën me kujdes, duke thënë

sot një fjalë, nesër dy, ashtu siç vepron edhe për përparimin e ekonomisë së vendit, duke hedhur sot një hap, nesër dy në rrugën e zhvillimit.

Kur të qëllojë të vij ndonjëherë tjetër këtu, do të bisedojmë ndryshe bashkë. Atëherë nëpër fushat tuaja do të kemi makina e shumë mjete të tjera, që do të ndihmojnë për rritjen e prodhimit dhe për lehtësimin e punës suaj. Kështu e parashikon Partia të ardhmen. Po kush do ta bëjë këtë? Populli do ta bëjë, me Partinë në krye, e cila na udhëzon si të punojmë e si të mësojmë.

Partia na këshillon të ndjekim shkolla e kurse, sepse vendi ynë, ekonomia jonë kanë nevojë për njerëz të mësuar. Sidomos djemtë dhe vajzat, ta prishin një çikë gjumin, të venë në kurse e në shkolla, të përpjekin kokën andej-këndej që, kur t'i kryejnë ato, të punojnë më mirë. Bile, këtu te ne, edhe pleqtë venë e mësojnë, pa lëre burrat e gratë nga 40 vjeç. Me punë dhe me mësim, ne do ta ndërtojmë më të bukur, më të pasur, më të lumtur të ardhmen tonë. Partia porosit të mësojmë, të lexojmë me kujdes shtypin e librat, na porosit, gjithashtu, të punojmë pa pushim, të derdhim djersë, të luftojmë për të ngritur nivelin e jetesës dhe t'i mbrojmë atdheun dhe jetën tonë, pra, të mbajmë kazmën në një dorë dhe pushkën në tjetrën, të jemi gjithnjë sypishë e vigjilentë dhe të zhvillojmë luftën e klasave. Armiku, kur shikon se çdo gjë është në lëvizje, në revolucion, s'ka ç'bën, e ndien veten të çarmatosur dhe hesht, por ai pret dhe kur sheh se të zë gjumi, ashtu si nga uji i fjetur që dalin mushkonjat dhe të pickojnë, ashtu vepron për të të goditur

dhe për të të dëmtuar, prandaj të jemi kurdoherë zgjuar.

Edhe në vendet ku sundojnë revizionistët populli lëviz, ai shikon që këta njerëz tradhtuan idetë e Leninit dhe të Stalinit. Për ta kuptuar më mirë këtë gjendje, ka ndihmuar edhe Partia e Punës e Shqipërisë me qëndrimin e saj revolucionar e të papërkulur. Ky qëndrim u hap sytë jo vetëm komunistëve të Bashkimit Sovjetik dhe atyre të të gjitha vendeve ku revizionistët janë në fuqi, po gjithë komunistëve në botë, që kanë për flamur të tyre marksizëm-leninizmin. Këtë nuk e themi ne, këtë e thonë ata vetë.

Në vendet kapitaliste ka tronditje të mëdha. Edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, vendi i peshkaqenëve kapitalistë më të mëdhenj të botës, vendi më i pasur kapitalist, ka tronditje. Masat popullore brenda në vend dhe popujt e botës kundërshtojnë politikën e tyre agresive. Vite me radhë, imperializmi amerikan bën një luftë të padrejtë kundër Vietnamit, që ka një popull të vogël, po trim. «Kavaleria» amerikane, e pajisur me aeroplanë të panumërt, s'ka ç'u bën partizanëve të Vietnamit. Ushtria amerikane në Vietnam është katandisur në atë gjendje saqë është mbyllur në disa porte, kurse gati gjithë territorin tjetër të Vietnamit të Jugut e kanë partizanët. Nga flota që kanë në det ngrihen avionët që sulmojnë partizanët. Mirëpo partizanët vietnamezë ditën mbrohen nëpër guva e pyje, kurse natën sulmojnë deri nëpër rrugët e qyteve, nëpër portet e kudo. Për dhjetë vjet me radhë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës po hanë grushte në Vietnam dhe vazhdimisht humbasin. Shpenzimet për

këtë luftë janë kolosale, prandaj monedha e vendit më të pasur kapitalist, dollari amerikan, ka filluar të zhvlerësohet. Brenda Shteteve të Bashkuara të Amerikës rreth 20 milionë zezakë, që janë në gjendje skllavërie të vërtetë, po luftojnë vazhdimisht për të drejtat e tyre. Ata hidhen në demonstrata, sulmojnë dhe djegin dyqanet e të bardhëve, si në Nju-Jork, ku janë rrahur e janë gjakosur me policinë etj. Për t'i trembur zezakët, krerët e monopoleve organizuan vrasjen e tyre. Kjo shkaktoi përlëshje të përgjakshme, që e tronditën qeverinë amerikane, e cila lëshoi reparte të tëra ushtarake kundër zezakëve. Edhe rinia e studentët janë ngritur, sepse nuk duan të venë në luftë në Vietnam. Të gjitha këto ngjarje i kanë tronditur Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Në Francë dhe në vende të tjera kapitaliste të botës po zhvillohet, gjithashtu, një lëvizje e madhe nga punëtorët dhe studentët. Vetëm po të llogaritësh studentët që janë ngritur në revoltë, kundër regjimeve qeveritare, si: në Francë, në Itali, në Angli, në Gjermani, në Turqi, në vendet e Amerikës Latine e gjetkë, janë me qindra mijë. Ata pushtojnë ndërtesat e universiteteve, dalin rrugëve në demonstrata të fuqishme, përmbysin automobilat, ngrenë barrikada dhe luftojnë me policinë, e cila i godit demonstruesit me bomba me gaz lotsjellës, me shkopinj, kurse studentët i goditin me gurë policët, të cilët qëllon shpesh të vriten.

Në Francë, në muajin maj, u ngritën në greva të papara ndonjëherë mbi 10 milionë punëtorë e studentë. Për ditë me radhë Parisi s'kishte as dritë elektrike, as ujë, as bukë, as automobila, as shërbim telegrafonik

etj. Merreni me mend si u qelbën rrugët, se s'kishte kush hiqte plehrat. Punëtorët pushtuan fabrikat dhe pezulluan prodhimin. Kjo lëvizje e fuqishme u kostoi kapitalistëve francezë tre-katër miliardë franga në ditë.

Lëvizje greviste të masave punonjëse e të studentëve, që kundërshtojnë shtypjen dhe shfrytëzimin kapitalist, ka edhe në vendet e tjera kapitaliste. Kapitali ushtron shtypje të egër mbi masat, po këto, gjithnjë e më shumë, ngrihen kundër tij, duke kalitur ndër-gjegjen klasore. Kapitali godet pa mëshirë, por proletariati prapë vazhdon të ngrihet, derisa të hidhet në revolucion dhe të ndodhë ajo që ka thënë Lenini. Kur e pyetën Leninin si zhvillohet çështja e revolucionit, ai mori një shkop në dorë dhe tregoi se në pjesën e sipërme të tij ishte cari, ndërsa poshtë populli. Kur u bë revolucioni shkopi u përmbys, tha ai, fundi doli në krye, kurse cari shkoi në fund, pra, u përmbys. Kështu do të ndodhë në të gjitha vendet kapitaliste, punëtorët do të dalin në krye, pas revolucionit fitimtar proletar, kurse kapitalistët do të futen në gropë.

Revolucioni tani është kudo në ngjitje. Në këtë luftë merr pjesë dhe kontribuon fuqimisht edhe vendi ynë. Te ne, nga më i madhi, deri tek i vogli, të gjithë punojnë dhe mësojnë, ruajnë me vigjilencë fitoret dhe me entuziazëm brohorasin për Partinë e Punës. Prandaj, të gjithë, shoqe dhe shokë, kur hedhim shatën e kazmën, të mendojmë për të mirën e atdheut, për forcimin e socializmit, të mendojmë me dashuri të madhe për popullin dhe për Partinë tonë, të mendojmë dhe për atë pjesë të madhe të popujve të botës, që vuan akoma nën shtypjen dhe shfrytëzimin kapitalist

dhe që lufton për çlirimin e vet. Kur ne hedhim shatën dhe lopatën në punë, të mendojmë se bëjmë diçka edhe për atë, për revolucionin botëror. Prandaj le të punojmë më shumë e më mirë për popullin, për atdheun, për Partinë dhe për fitoren e madhe të komunizmit në botë.

Jam shumë i gëzuar që erdha sot te ju dhe ju siguroj se nuk do ta harroj kurrë këtë takim. Shokëve të mi në Tiranë do t'u tregoj që erdha këtu, në Golem-Gramsh, që u takova me disa nga kuadrot dhe me anëtarë të kësaj kooperative, që bisedova gjerë e gjatë me ta, që mësova me gëzim për situatën e mirë që keni krijuar dhe që akoma më të mirë do ta bëni në të ardhmen, të udhëhequr nga Partia, tek e cila ju keni besim të madh.

Ju uroj me gjithë zemër, vëllezër e motra, shumë suksese në punë, jetë të lumtur e të gëzuar!

Të rrojë Partia!

Të rrojë populli!

Të rrojë fshatarësia jonë kooperativiste!

Të rrojnë kooperativistët e Golem-Gramshit!

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në AQP

PASQYRIM I DEGJENERIMIT DHE I FALIMENTIMIT TË VETADMINISTRIMIT TITIST

Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»

6 korrik 1968

Para disa ditësh, kreu i klikës së Beogradit mbajti një fjalim të gjatë, drejtuar gjithë vendit nga tribuna e Kongresit të 6-të të Sindikatave të Jugosllavisë. Megjithëse nuk kishte shumë kohë — më 9 qershor ai kishte folur në televizion edhe në radio — Titoja u detyrua të dalë përsëri përpara publikut, pasi situata në vend është bërë shumë kritike, kazani i pakënaqësisë e i revoltës popullore zien në të katër anët dhe është gati të shpërthejë përsëri dhe me forcë më të madhe nga ç'ndodhi me studentët muajin e kaluar. Ai doli vetë në skenë, kur pjesëtarët e tjerë të klikës dështuan në përpjekjet e tyre, për të qetësuar e për të kufizuar zemërimin e punonjësve, kur duhej luajtur karta e fundit e demagogjisë ekstreme dhe e kërcënimit të përdorimit të dhunës kundërrevolucionare për të pabindurit.

Vetë mbledhja e kongresit të sindikatave paraqiste një moment shumë delikat për udhëheqësit jugosllavë. Kongresi mbahej menjëherë pas revoltës së guximshme të studentëve të Beogradit, e cila kishte demaskuar keq poshtërsitë e regjimit titist dhe e kishte tronditur atë nga themelet. Lëvizja e studentëve dhe çështjet e mëdha të ngritura nga ata kishin prekur drejtpërsëdrejti punëtorët, të cilët, nëpër uzina e fabrika, ishin shprehur hapur dhe me forcë kundër sistemit kapitalist ekzistues, kundër padrejtësive shoqërore dhe zullumeve të rënda të regjimit. Për t'i dalë përpara më të keqes, Titoja e mori i pari fjalën në kongres dhe u hoq sikur ai e di ç'mendojnë punëtorët, ç'i preokupon ata, përse janë të pakënaqur, sikur e ka kuptuar gjendjen e tyre shpirtërore, prandaj do të flasë hapur, në mënyrë autokritike, bilc, pa kursyer njeri.

Por fjalimi i tij ishte një fjalim i shturur nga çdo pikëpamje, me pohime skandaloze, me pranime të hapura të dështimit në të gjitha fushat dhe të degjenerimit të gjithanshëm të regjimit titist. Një rënie e tillë është me të vërtetë e padëgjuar dhe rrallë mund të ketë ndodhur në histori. Duket se Titoja nuk ka pasur nga t'ia mbajë, katundi ka rënë aq poshtë sa logjika e përmbajtja s'kanë më kuptim.

Fjalimi i tij i fundit është një shprehje e gjendjes së dëshpëruar në të cilën ndodhet ndërtesa e kalbur titiste, është një pasqyrim i degjenerimit dhe i falimentimit të reformave kapitaliste, që ai i ka quajtur «socialiste», «vetadministrim» etj. Ai e kupton se regjimi i tij është në agoni, se kursi i tij tradhtar është

diskredituar, se shpresat të «reformat» e tij ekonomike e shoqërore u shembën. Si i mbyturi, që kapet pas flokëve të tij, tani ai kërkon të shpëtojë me disa manovrime bajate, me premtime boshe e me kërcënime, që tanimë nuk trembin njeri. Për vite me radhë klika titiste ka sunduar me këtë mënyrë. Por tani nuk është më fillimi. Në gjithë Jugosllavinë gjendja është acaruar dhe populli jugosllav, rinia jugosllave, nuk mund të gënjehen më me socializmin e Titos, kur ata e shohin se si vendi i tyre është bërë çiflig i kapitalistëve të vendit e i të huajve, kur atyre u mungojnë edhe mjetet më elementare të jetesës, kur me qindra mijë janë të detyruar të braktisin atdheun e tyre dhe të shkojnë të punojnë për një kothere bukë në puset e errëta të minierave të Belgjikës apo të Gjermanisë Perëndimore.

Sigurisht, Titoja në «autokritikën» e tij nuk zbuloi ndonjë gjë të paditur, as për popujt e Jugosllavisë, as për të tjerët. Ka më se njëzet vjet që Partia e Punës e Shqipërisë ka folur haptazi për vijën tradhtare, renegate të klikës titiste dhe për pasojat shkatërrimtare, që rivendosja e kapitalizmit u ka sjellë popujve të Jugosllavisë. Ne kemi demaskuar vazhdimisht krimet e shëmtuara të diktaturës fashiste titiste, të klasës së re borgjeze të qytetit e të fshatit jugosllav dhe kemi paralajmëruar për fatkeqësitë dhe për pasojat e rënda, që u kanosen punonjësve jugosllavë. Por tani vetë Titoja pohon me gojën e tij shumë nga këto krime e fatkeqësi tronditëse, vetë pohon për falimentimin e «reformës» së tij, për falimentimin e «socializmit specifik» të tij.

«Shfaqjet e ndryshme negative, — tha Titoja në fjalimin e vet, — u grumbulluan aq shumë, saqë shkaktuan edhe revoltë të njerëzit tanë. E di se kjo revoltë është shprehur për vite me radhë poshtë, por tani ajo shpërtheu te brezi ynë i ri, i cili duhet të mendojë, i cili kuptohet se duhet të mendojë për të ardhmen e tij, për atë se çfarë do të trashëgojë dhe si do të punojë në të ardhmen».

Pohim shumë i hidhur, sigurisht. Por Titoja është i detyruar ta bëjë tani, kur i plasi bomba në duar, kur studentët u përleshën me policët e tij, kur punëtorët kryqëzojnë duart nëpër fabrika, kur rreth e rrotull fryma e revoltës popullore kërcënon të shpërthejë në një stuhi edhe më të madhe. Por ai nuk flet për revoltat e mëparshme, nuk flet si i ka shtypur e i ka masakruar ato, nuk flet për burgjet dhe për kampet e tmerrshme të përqendrimit, nuk flet si ka mashtruar e ka gënjyer për vite me radhë. Për më tepër, ai nuk thotë ku qëndron shkaku i revoltimeve dhe kundër kujt kanë qenë drejtuar ato. Tani, ai mundohet ta parashtrrojë çështjen jo në kuadrin e luftës klasore midis punonjësve e borgjezisë, që është krejtësisht e natyrshme për një sistem shoqëror tipik kapitalist, si ai që ekziston në Jugosllavi, por në një plan moralist, që nuk ia mbush mendjen njeriu e, aq më tepër, punëtorëve e studentëve jugosllavë, që janë ngritur kundër sistemit titist dhe pasojave të tij.

Por vetë, më poshtë, në fjalimin e tij, pasi nuk mund t'u shpëtojë kontradiktave, sado pehlivanllëqe që të bëjë, Titoja, kur pranon gjendjen katastrofale të ekonomisë së vendit, spekulimet, korrupsionin dhe stu-

hinë që mbretëron në të, ai ka pranuar, njëkohësisht, se burimi i revoltës së punonjësve jugosllavë, i urrejtjes dhe i zemërimit të tyre është shfrytëzimi kapitalist, është politika e grabitjes dhe e pasurimit të klasës së re borgjeze me punën dhe me gjakun e punëtorëve e të fshatarëve jugosllavë. Ja ç'thotë vetë ai: «Në zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë dhe të prodhimit tonë vitin e kaluar ndodhi qëndrimi në vend. Cilat janë arsyet e kësaj amullie? Këtu ka shumë shkaqe objektive dhe subjektive. Organet drejtuese në ekonominë tonë shumë ngadalë i kanë zgjidhur çështjet e sistemit bankar që bankat vërtet të ndodheshin në duart e prodhuesve. Janë zgjidhur shumë ngadalë problemet valutore». Që bankat nuk janë në duart e prodhuesve, domethënë, të popullit, Titoja e pranon, pasi nuk mund të thotë, në një mbledhje sindikale, që bankat janë të punëtorëve. Por ajo që mbetet pa përgjigje është se në duart e kujt janë bankat dhe çështjet valutore? Ato janë në duart e kapitalistëve të rinj të pangopur, të afaristëve, të spekulantëve dhe të hierarkëve titistë, të atyre që, praktikisht, kanë në duart e tyre fatin dhe jetën e popullit fukara. Këta zotër të rinj të kapitalit financiar as që bëhen merak se, për shkak të interesave të tyre të ngushtë, ata lënë pa punë me qindra mijë punëtorë, se miliona njerëz vuajnë nga uria, ose se shkatërrohen degë të tëra të ekonomisë. Ata veprojnë njëjloj si bankierët e Nju-Jorkut apo të Londrës, si Morganët apo Rotshildët dhe gjithë fajdexhinjtë e botës së madhe financiare kapitaliste. Ligji i tyre është ligji i xhunglës, ligji i kapitalit gjakatar, që nuk zhduket, as nuk përmirësohet me vërej-

tje e me qortime, siç bën Titoja për t'u hedhur pluhur syve punonjësve. Por le ta lëmë atë të flasë vetë për pasojat e politikës së këtyre «bankierëve socialistë»: «Edhe politika e importimit nuk ka qenë e drejtë, — thotë ai. — Ja, për shembull, kemi rritur importimin e atyre prodhimeve, të cilat nuk duhej t'i importonim, gjë që na ka dëmtuar; për shembull, në kohën kur prodhuesit tanë ishin orientuar me të gjitha fuqitë me prodhimin, si: të mishit, të hekurit, të çelikut dhe të shumë gjërave të tjera, ne lejojmë që të importohen mishi, çeliku dhe të tjera me çmimet e dumpingut etj».

«Kjo, — vazhdoi ai, — çoi në amullinë e prodhimit. Punëtorët u nxorën nga puna. Fuqia blerëse e prodhuesve u dobësua dhe, posa dobësohet fuqia blerëse e punonjësve tanë, e qytetarëve tanë, bie në amulli edhe prodhimi, ose grumbullohen stoqet e mallrave, të cilat nuk mund të shiten».

Kushdo që lexon këto radhë nuk e ka vështirë të konstatojë se Titoja vazhdimisht përpiqet t'i shkëputë pasojat nga shkaku. Ai thotë se «janë të këqij sistemi valutë e bankar». Por mos vallë këta janë të shkëputur nga sistemi shoqëror e shtetëror? Mos vallë ata janë të shkëputur nga vija politike e klikës sunduese? Deri sot nuk kemi dëgjuar për një gjë të tillë. Sistemi bankar në Jugosllavi është pjesë dhe pjellë e sistemit kapitalist shfrytëzues që sundon aty, është i egër e i keq, ashtu siç është vetë regjimi.

Në mënyrë më të papërgjegjshme, në fjalimin e tij Titoja trajton problemin e papunësisë, të kësaj plage të tmerrshme, që ka nxirë gjithë jetën e popujve

jugosllavë. «E gjithë kjo¹, — thotë Titoja, — kontribui për amullinë në zhvillimin e ekonomisë sonë. Siç thashë, u rrit papunësia. Mirëpo ne nuk ndërmorem ndonjë masë të efektshme që ta zvogëlonim papunësinë. Ne u qetësua me faktin që njerëzit shkojnë për të punuar në vendet e jashtme». Dhe me cinizëm shtoi: «Është fakt se ne e kemi bërë veshin shurdh... neve kritikant na kanë hyrë në njërin vesh dhe na kanë dalë nga tjetri».

Mund të duket se, meqë pranon botërisht fakte të tilla tronditëse, regjimi titist ka ndër mend të marrë ndonjë masë për të luftuar papunësinë. Dhe vërtet Titoja propozon disa masa, por ato u ngjajnë më tepër fjalëve të një magjistari sesa të një burri shteti, që ndien njëfarë përgjegjësie përpara popullit të vet. Në radhë të parë, sipas recetës së tij, organet shtetërore, ekonomike, të statistikës etj. duhet «të përcaktojnë se kush konsiderohet i papunë», meqë Titoja paska bërë një zbulim të madh në këtë lëmë. «Unë, — thotë ai, — konsideroj të papunë atë person i cili nuk ka punë, por që jeton me krahët e tij, konsideroj gjysmë të papunë fshatarin e varfër, i cili, megjithatë, e ka një copë bukë, do të thotë, një copë tokë që e punon». Gratë, sipas teorive të tij, nuk mund të futen në listat e të papunëve. Ato mund që duan të punojnë, por më mirë do të ishte të rrinë në shtëpi. Prandaj, shoqëria për to s'ka asnjë detyrim.

Pasi të jenë bërë këto «zbritje», domethënë. pasi t'u jenë mbyllur dyert e punës këtyre masave të më-

1 Sistemi bankar, politika e importit, e kredive etj

dha të të papunëve, për pjesën tjetër që mbetet, Titoja premtonte se mund t'u gjendet punë, në qoftë se do të aktivizohen ato degë të industrisë që punojnë sot me 50 për qind të kapacitetit të tyre. Por, shtoi menjëherë Titoja: «Kuptohet se nuk është çështja vetëm e prodhimit, por edhe e gjetjes së tregut të prodhimit. Kur të sigurohet tregu këtu, mund të inkuadrohen në punë dyfishi i punëtorëve, në qoftë se kalohet në punën me dy turne». Me fjalë të tjera, papunësia mund të lehtësohet, sipas Titos, po të kalohet në dy turne, po të futet në punë dyfishi i punëtorëve, po të rritet prodhimi dhe... po të gjendet tregu i prodhimit! Kësaj i thonë të shohësh ëndrra me sy hapur, të presësh të bien petulla nga qielli! Mos ka gjëkundi në botë tregje të lira, mos ia kanë ruajtur ato Titos partnerët e tij kapitalistë, që janë konkurrentë më të aftë e të fuqishëm dhe që kacafyten me njëri-tjetrin, për të siguruar shitjen e prodhimeve të tyre kudo, qoftë edhe në cepin më të largët të rruzullit? Titoja, pra, edhe këtu gënjen punëtorët, sepse ai e di mirë se jo vetëm nuk ka ku të gjejë treg të lirë, por ai, duke ua çelur të gjitha dyert e Jugosllavisë peshkaqenëve monopolistë perëndimorë, as nuk mund të mbrojë tregun e brendshëm nga konkurrenca dhe nga depërtimi i mallrave perëndimore, që me anën e dumpingut po mbytin industrinë jugosllave dhe po hedhin në rrugën e madhe punëtorët vendës. Këtë detyrohet ta pohojë edhe vetë Titoja kur thotë nëpër dhëmbë se «industria po jeton me ankthin se dikush do t'ia mbyllë portën edhe në vetë tregun e saj, në tregun e brendshëm» jugosllav!

Në demonstratat e studentëve të Beogradit, një nga kërkesat themelore të protestës së tyre e që u përkrah fuqimisht edhe nga punëtorët, ishte ndalimi i grabitjes së mëtejshme të pronës shtetërore nga kapitalistët e rinj dhe denoncimi i pasurimit të paligjshëm të «borgjezisë së kuqe» titiste. Kuptohet se Titoja nuk mund të mos e prekte këtë temë. Por ai u mundua t'i zvogëlojë dimensionet e saj, t'i paraqesë faktet e lindjes dhe të zhvillimit në masë të kapitalistëve të rinj si çështje që kanë të bëjnë me delikuencën e zakonshme dhe jo një proces të thellë shoqëror, si pasojë e vetë sistemit dhe e vijës së tij politike. Ai foli për njerëz që sigurojnë fitime të mëdha, që kanë nga tri-katër shtëpi, «që ndërtojnë një vilë me dhjetë, njëzet, dyzet e gjashtëdhjetë shtretër, të cilat pastaj ua lëshojnë me qira të huajve», për njerëz, midis tyre «edhe mjekë, me dy-tre kamionë dhe shoferë». «Te ne, — pohon ai, — po futet praktika e përvetësimit të mjeteve të prodhimit, si, për shembull, traktorë të mëdhenj etj.», «që disa grumbullojnë para në mënyrë të ndryshme, grumbullojnë mjete e blejnë shtëpi, bile disa ndërtojnë edhe fabrika, kurse të tjerët mezi grumbullojnë disa dinarë në mënyrë që ta kalojnë disa jetën». Por Titoja nuk thotë cili është shkaku i këtyre fenomeneve, nuk guxon t'u thotë punëtorëve se kjo është pasojë e politikës dhe e sistemit kapitalist, të vendosur nga klika e tij, se vetë Titoja dhe hierarkët e tij janë të parët që grumbullojnë pasuri nga gjaku e nga djersa e punëtorëve jugosllavë dhe i depozitojnë ato në bankat e huaja, ose i investojnë në shoqëritë e ndryshme monopoliste.

Megjithëkëtë, a do t'u pritet rruga këtyre fenomeneve? Si me zemërim Titoja premtoi se do të merren masa kundër këtyre fenomeneve, sepse, shtoi ai me demagogji, «ne nuk luftuam për këtë (e ka fjalën që disa të pasurohen e disa të vuajnë), gjithë jetën tonë». Por kaluan pak ditë dhe shtypi jugosllav, me dashje ose pa dashje, e demaskoi këtë bluf të Titos. Në një lajm nga Zagrebi, të datës 1 korrik, Tanjugu njoftonte se udhëheqja e Lidhjes Socialiste të Kroacisë vuri në dukje se kërkesat që të bëhet e pamundur çdo iniciativë private dhe masat të cilat po propozohen për këtë qëllim, nuk të çojnë drejt likuidimit të pasurimit të tepërt, por drejt likuidimit të çdo veprimtarie private të dobishme prodhimi me mjete personale. Në këtë mbledhje u tha se «Lidhja Socialiste nuk mund t'i përkrahë tendencat e tilla».

Titoja tha, gjithashtu, se njëra nga arsyet që krijojnë pakënaqësi është edhe diferenca e madhe në rroga. «Në shumë fabrika, administrata, — tha ai, — ka pasur rroga fikse, edhe kur ka punuar, ose nuk ka punuar me rentabilitet kjo fabrikë, sepse ka paguar punëtorin, i cili ka marrë më pak, 80 ose 70 për qind të rrogës së tij. Pra, përgjegjësia për rentabilitetin ose jo rentabilitetin ka rënduar mbi klasën punëtore, mbi prodhuesit. Ka degë që kanë diferenca të mëdha në rroga dhe sindikatat duhet të bëjnë përpjekje energjike për ta zgjidhur këtë». Por edhe këtu Titoja bloufon. Në fakt, menjëherë pas fjalimit të tij, Komiteti Ekzekutiv i Lidhjes Socialiste të Kroacisë, në një mbledhje që bëri, i quajti «të rrezikshme, masa të rastit dhe të ashpra... kërkesat për të likuiduar të

gjitha ndryshimet në të ardhurat personale, në caktimin administrativ të kuotës së të ardhurave e të tjera».

Titoja u premtoi punëtorëve rritjen e nivelit të jetesës. Por, jo më larg se të nesërmen e mbylljes së kongresit të sindikatave, ku ishin dëgjuar, midis të tjerash, edhe kritika të rrepta për ngritjen e vazhdueshme të kostos së jetesës, duke përfshirë edhe shpenzimet e transportit, klika e Titos, si për t'iu përgjigjur këtyre kritikave të ligjshme të punëtorëve, i ngriti çmimet e transportit hekurudhor dhe të shërbimeve publike!

Për të dalë i larë edhe kësaj here dhe për ta shkëputur veten nga fajtorët e gjendjes katastrofike, në të cilën ndodhet sot Jugosllavia, Titoja përmendi se «të gjitha këto i kam thënë unë me kohë, por s'më ka dëgjuar njeri». Ai vazhdoi se «jo vetëm nuk pata përkrahje, por pata rezistencë, bile edhe të fshehur, dhe me këtë rast thuhej: «Po, ai foli ashpër, porse kjo nuk është aq e rëndësishme, ai nuk mendoi ashtu seriozisht, e gjithë kjo do të kalojë etj.» Kështu nuk u bë asgjë. Gjithçka vazhdoi me të vjetrën».

Por kontradiktat që brejnë brendapërbrenda klikën titiste zhvillohen dhe acarohen jo pse një palë titistësh mbrojnë interesat e punonjësve dhe një palë jo, por vetëm mbi bazën se si të mbahet më mirë në fre populli, si të konsolidohet sistemi kapitalist titist, si të shtohen më tepër shtypja dhe shfrytëzimi i punonjësve jugosllavë. Prandaj punëtorët nuk u besojnë më profkave të Titos, ata po bëhen të ndërgjegjshëm se gjendja kaotike e ekonomisë jugosllave, papunësia, shtypja dhe varfëria nuk janë çështje indisi-

plinimi të këtij ose të atij funksionari, se fatkeqësitë e tyre nuk vijnë, pse disa udhëheqës të bazës apo të kreut nuk e dëgjuakan Titon. Tanimë, siç e provoi edhe revolta e studentëve të Beogradit e të qyteteve të tjera, punonjësit ia kanë vënë gishtin plagës. Fajtorët janë vetë Titoja, gjithë klika titiste dhe rrethi i saj, janë ata që restauruan kapitalizmin në Jugosllavi dhe shfrytëzojnë popullin. Siç njoftonin agjencitë e lajmeve nga Beogradi, shumë pjesëmarrës në kongresin e sindikatave ua përplasën në fytyrë zemërimin dhe padurimin e tyre Titos dhe shokëve të tij.

Stuhia, — thonë lajmet, — ishte e fortë në Kongresin e 6-të të Sindikatave Jugosllave, ku një grup delegatësh punëtorë dhe fshatarë jugosllavë refuzuan të vazhdojnë të marrin pjesë në punimet e komisioneve dhe imponuan një mbledhje plenare të papara-shikuar. «Mjaft me rezoluta dhe me dokumente që nuk zbatohen, ne duam një gjë konkrete», thanë ata.

«Ne i këputëm zinxhirët e kuislingëve dhe të fashistëve, tani ne duhet të këputim zinxhirët e burokracisë», tha një përfaqësues i Smederevos në Serbi. «Klasa punëtore nuk mund ta durojë më burokracinë», tha një orator tjetër. «Janë të tjerët që marrin të ardhurat e prodhuesve», deklaroi një i tretë, i cili dënoi nëpunësit, administratorët e komuneve ose të bankave, që blejnë automobila e vila në kurriz të punonjësve. «Në Beograd, — shtoi ai, — të ardhurat nga veprimtaritë ekonomike janë rritur vetëm 1 për qind dhe ato nga veprimtaritë joekonomike 4 për qind. 20 000 punëtorë janë pushuar, ndërsa 27 000 kontribues kanë deklaruar të ardhura më të larta nga 2

milionë dinarë». «Një punëtor a mund të rrojë me 300 dinarë në muaj?», — tha një punëtor tjetër, duke kërkuar një rishqyrtim të plotë të të ardhurave personale.

Titoja e ndien furtunën që po afrohet. Prandaj, në fjalimin e tij, ai, krahas demagogjisë, nuk mungoi të tregojë edhe grushtin e të bëjë kërcënime të hapura ndaj atyre që mbrojnë interesat e punonjësve dhe kundërshtojnë regjimin e tij. Ndërsa në fjalimin para televizionit, më 9 qershor, ai i buzëqeshi rinisë, iu përul asaj, duke mbajtur të fshehur prapa shpine hanxharin, kësaj here e nxori sheshit atë. Titoja bëri një krahasim të bukur. Regjimin e tij ai e krahasoi me atë të knjaz Milloshit. «Knjazi serb, Milloshi, — tha Titoja, — kur bëhej fjalë për tatimin, pyeste se çfarë thonë njerëzit. Atij iu përgjigjën se njerëzit mermëritnin dhe knjazi tha: «Shtrengojeni edhe më»». Titoja ia kaloi edhe knjazit serb. Në fjalimin e tij ai kërcënoi hapur se «në fund të fundit, duhet të marrim edhe masa administrative», kundër të gjithë atyre që nuk do të binden, kundër «dogmatikëve» që «shpresojnë se do të vijë dita e tyre» etj.

Por, sado përpjekje që të bëjnë Titoja dhe klika e tij, sado demagogji e kërcënime që të përdorin, ata nuk mund ta ndalojnë rrokullisjen drejt greminës të regjimit dhe të sistemit të vet.

Punëtorët jugosllavë po e provojnë në kurrizin e tyre se vetadministrimi që Titoja vazhdon të reklamojë, është maskimi i restaurimit të sistemit të shfrytëzimit kapitalist, është legalizimi i zbatimit të ligjeve kapitaliste të anarkisë në prodhim e të fitimit në-

përmjet konkurrencës, është mënyra e konsolidimit të «borgjezisë së re» titiste, që disponon për vete makinën shtypëse shtetërore dhe mjetet e prodhimit.

Dhe ata nuk mund dhe nuk do ta durojnë gjatë këtë gjendje. Ata nuk mund të mos e kuptojnë se Titoja është autori kryesor i tragjedisë jugosllave, se ai dhe klika e tij janë shkaktarët kryesorë, përgjegjësit kryesorë të kaosit politik dhe ekonomik në të cilin ndodhet sot Jugosllavia, përgjegjësit kryesorë për shndërrimin e saj në një plasdarm të avancuar të imperiaлизmit amerikan, në një bazë shfrytëzimi të egër të monopoleve perëndimore. Ata nuk mund të mos e kuptojnë se rruga e daljes nga kjo gjendje tragjike është lufta e vendosur kundër atij regjimi dhe asaj klike, që e kanë pjellë këtë kaos.

Dhe ngjarjet e fundit në Jugosllavi, revolta në universitetin e Beogradit, që i tronditën themelet e regjimit titist, treguan se demagogjisë dhe dhunës fashiste mund t'u bëhet ballë me dhunë revolucionare, se vetëm me fshesën e hekurt të revolucionit mund të shembet regjimi i kalbur titist dhe të gjithë renegatët, tradhtarët, të shiturit, agjentët dhe shërbëtorët e ndyrë të kapitalit ndërkombëtar të hidhen në koshin e plehrave të historisë.

Botuar për herë të parë në gazetën: «Zëri i popullit», nr. 161 (6200), 6 korrik 1968

Botohet sipas librit: «E vërteta marksiste-leniniste do të triumfojë mbi revizionizmin», vëll. VIII, f. 169. Tiranë, 1969

USHTRIA JONË ËSHTE ARMË E DASHUR DHE E FUQISHME E POPULLIT

*Fjala në drekën e shtruar në Labinot, me rastin
e 25-vjetorit të krijimit të Ushtrisë Popullore
të Shqipërisë*

10 Korrik 1968

Të dashur shokë e shoqe,

10 Korriku është një ditë e shënuar në historinë e popullit tonë. Atë e feston me gëzim të madh i gjithë populli shqiptar. Pikërisht për këtë arsye ne shohim sot këtu në Labinot mijëra e mijëra njerëz, që kanë ardhur për të festuar 25-vjetorin e lavdishëm të ditës në të cilën u themelua Shtabi i Përgjithshëm, që Partia e konsideroi si ditën e themelimit të Ushtrisë sonë heroike Nacionalçlirimtare.

Lufta jonë për çlirim, e udhëhequr nga Partia jonë heroike, kishte filluar kohë më parë, por, me krijimin e Shtabit të Përgjithshëm, ajo u organizua më mirë. U ngrit një ushtri e vërtetë, që do të kryente dhe kreu jo vetëm veprime taktike, por edhe veprime strategjike të rëndësishme.

Edhe 25 vjet më parë ishte një datë si kjo e sotmja, 10 korrik, por gjendja e atëhershme ishte krejt ndryshe nga tani, për arsye se populli ynë jetonte ditë të errëta dhe shumë të vështira, prandaj për ne shtrohej çështja: Të dilnim me armë në dorë për të siguruar lirinë, apo të qëndronim duarlidhur dhe të mbeteshim përgjithmonë të robëruar? Pra, ishin çaste vendimtare, sepse në atë kohë vihej në balancë fati i atdheut, përcaktohej nëse do të fitonim apo do të humbitnim.

Vendi ynë në ato ditë të vështira ishte i shkelur, armiku vriste e masakronte njerëzit tanë, digjte kra-hina të tëra, por asnjëherë ai nuk arriti të shuan-te shpirtin e madh revolucionar të popullit shqiptar. Prandaj, çdo ditë që kalonte, kryengritja e popullit tonë bënte hapa të rinj përpara. Thirrja që i bënte popullit Partia Komuniste e Shqipërisë, e zgjonte, i hapte sytë dhe e bënte të ndërgjegjshëm për luftën që duhej të ndërmerrete, e sqaronte se vetëm me një luftë të paepur, me sakrifica në njerëz dhe në materiale, mund t'i arrihej qëllimit të shenjtë, çlirimit të atdheut përgjithmonë.

Vija e drejtë e Partisë u kuptua nga populli, por u desh mjaft punë, u desh këmbëngulje, u deshën shembuj heroizmi e vetëmohimi, nga ana e anëtarëve të Partisë sonë të lavdishme, u desh të derdhej shumë gjak që të krijohej bindja e vërtetë për këtë vijë. Bindja te vija e drejtë e Partisë erdhi vazhdimisht duke u ngjitur dhe arriti kulmin e vet kur mbarë populli shqiptar u hodh në kryengritjen e përgjithshme të armatosur. Dhe një nga kërkesat e domosdoshme, me

rëndësi të madhe historike, që konceptoi Partia jonë, për të kaluar në kryengritjen e përgjithshme të armatosur, ishte edhe krijimi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare.

Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare, i konceptuar, i krijuar dhe i drejtuar nga Partia dhe nga Komiteti i saj Qendror, nuk ishte diçka e rastit, nuk ishte një krijesë formale, përkundrazi, ai ishte i domosdoshëm dhe kishte rëndësi të jashtëzakonshme, të brendshme dhe të jashtme.

Krijimi i Shtabit të Përgjithshëm kishte rëndësi të brendshme për arsye se, në ato momente, në vend të çetave e të batalioneve që kishin marrë gjer në atë kohë një zhvillim të madh në të katër anët e Shqipërisë dhe, si kurdoherë, udhëhiqeshin nga Partia, nga Komiteti Qendror, nga shokët e Komitetit Qendror si të deleguar në to, nga komitetet qarkore, nga komandantët dhe nga komisarët, të zgjedhur e të dalë nga gjiri i Partisë dhe i popullit, ishte e domosdoshme të organizoheshin njësite më të mëdha dhe të veprime me plane më të gjera e të koordinuara mirë kundër forcave të armikut. Kjo nevojë, duke marrë parasysh se armiqtë tanë, qysh më parë, i kishin vënë vetes detyrën e ngutshme për të asgjësuar Luftën Partizane Nacionalçlirimtare në vendin tonë, kuptohet, ishte e domosdoshme. Prandaj perspektiva për goditjen në shkallë më të gjerë të armiqve, perspektiva e çlirimit sa më parë të vendit tonë në shkallë kombëtare dhe, lidhur me këtë, krijimi qysh më parë i zonave të çliruara të përhershme, në të cilat armiqtë të mos mundnin të futnin dot më këmbët, kërkonte (dhe këtë

detyrë vuri përpara Partia) të krijohet Shtabi i Përgjithshëm, që do të organizonte drejtimin e këtyre njësive të mëdha.

Krijimi i Shtabit të Përgjithshëm u vendos nga Partia disa muaj më parë, në Konferencën e Parë të Vendit, që u mbajt po këtu, në Labinot, më 17-22 mars 1943. Pas Konferencës, siç dihet, ne filluam punën për krijimin e brigadave sulmuese. Brigadat tona heroike shënuan faqe të lavdishme në historinë e Shqipërisë dhe, më pas, me bashkimin e tyre, u bë i mundur krijimi i formacioneve të tjera, akoma më të mëdha, i divizioneve dhe i korparmatave, që luftuan me heroizëm të rrallë në të katër anët e atdheut, zbatuan me shumë sukses strategjinë dhe taktikën e Partisë, mposhtën pushtesit italianë e gjermanë dhe tradhtarët ballistë e zogistë, i shporrën përgjithmonë gjithë armiqtë nga vendi ynë dhe çliruan atdheun.

E parë në këtë vështrim, kjo datë kishte një rëndësi të madhe në historinë e vendit. Gjithashtu, me krijimin e Shtabit të Përgjithshëm, duhet të zhdukej edhe mendimi i mëparshëm për luftërat që pati bërë populli shqiptar në të kaluarën, me çeta, të cilat vërtet kishin luftuar kurdoherë me trimëri të rrallë, por vepronin të izoluar dhe ishin të lidhura shumë pak me njëra-tjetrën. Ato udhëhiqeshin nga qëllimi i lartë i çlirimit të vendit, i shpëtimit të Shqipërisë nga synimet grabitqare të serbëve, të grekëve, të italianëve e të imperialistëve të tjerë, që synonin ta copëtonin truallin e atdheut. Mirëpo historia e popullit tonë dhe e luftërave të tij në të kaluarën ka vërtetuar se, me gjithë përpjekjet, heroizmat dhe sakrificat e panu-

mërta të luftëtarëve të organizuar nëpër çeta, dëshirat e zjarrtë të popullit dhe të patriotëve tanë nuk mund të realizoheshin. Dihet se kryengritjet e armatosura, luftërat çlirimtare të popullit tonë të atyre kohëve, edhe pse udhëhiqeshin nga ide përparimtare për kohën, nuk kishin karakterin e revolucionit popullor si ai që udhëhoqi dhe ndërmoi Partia jonë Komuniste, që frymëzohej nga ideologjia e pagabueshme marksist-leniniste. Ato ishin kryengritje të armatosura, të frymëzuara nga idealet e një politike liberalo-borgjeze, brenda së cilës kishte lloj-lloj mendimesh e botëkuptimesh, që e mbanin këtë lëvizje të përçarë, të palidhur e të paorganizuar, të cilat, në fund të fundit, bënë që Shqipëria të mbetej kurdoherë në diell, siç thotë populli. Masat kanë luftuar dhe luftonin gjithnjë me trimëri dhe kjo është një e vërtetë e madhe, por, për arsyt që përmenda, ishin të tjerët që fitonin; megjithëse populli derdhte lumenj gjaku, ishin kurdoherë bejlerët dhe agallarët ata që merrnin fuqinë.

Eksperiencia e madhe e popullit shqiptar dhe idetë e marksizëm-leninizmit, nga të cilat udhëhiqej dhe udhëhiqet vazhdimisht Partia jonë, e ndihmuan këtë të analizonte në mënyrë të drejtë historinë e përpjekjeve për liri e pavarësi të popullit të vet dhe nga kjo të dilte me konkluzionin se pikëpamjet e elementëve liberalë e demokratë, që ekzistonin te ne, duhej të sqaroheshin përfundimisht në këtë moment. Partia jonë pati kujdes që këta elementë, që kishin dashuri të madhe për atdheun, që urrenin pushtuesit, por mendonin si në kohët e kaluara, kurrë të mos i fyente. Qëllimi i Partisë ishte që këta njerëz t'i bashkonte.

Borgjezia e vendit tonë akoma nuk kishte arritur t'i kanalizonte dhe t'i konkretizonte idetë e saj, të krijonte partitë e saj, siç ka ndodhur në vendet e tjera. Kështu, Partia jonë Komuniste ishte e vetmja parti politike në vend. E udhëhequr me urtësi nga mësimet e marksizëm-leninizmit, ajo mori përsipër dhe përgatiti terrenin që këto pikëpamje t'i kanalizonte në hovin e madh revolucionar të masave të gjera të popullit. Një punë e tillë shërbeu shumë për mënjanimin, për izolimin dhe për shpartallimin e elementëve të reaksionit, të tradhtarëve ballistë e zogistë dhe të të gjithë elementëve të tjerë, të cilët vepronin kundër Luftës Nacionalçlirimtare.

Shumica nga ne këtu nuk jemi të rinj në moshë. Sigurisht, në mes nesh ka edhe shokë të rinj, 25 e 35-vjeçarë, që në atë kohë porsa kishin lindur ose kanë qenë nga 10 vjeç. Ne të tjerët jemi nga ata që kemi bërë luftën. Atëherë ne ishim kush 20 e kush 30 apo 40 vjeç, kurse sot jemi me flokë të bardhë. Kohët ishin të trazuara dhe neve na u desh të ecnim në rrugë të vështira, jo në bar të njomë, po nëpër ferra e gjemba, dhe kjo nuk është thjesht një figurë letrare. Elementët e reaksionit, për të cilët fola, ishin një pengesë e madhe në luftën për çlirimin e vendit. Nga ana tjetër, ata nuk ishin të panjohur në popull, bile ishin shumë më të njohur se ne. Në ato kohë ne ishim njerëz të thjeshtë, vajza e djem të rinj të popullit, bija dhe bij të punëtorëve, të fshatarëve, të qytetarëve të varfër e të mesëm dhe nuk na njihte njeri, kurse ata ishin të kaluar nga mosha, ishin njerëz të njohur, bile disa kishin një të kaluar gjoja patriotike e, po të flasim

edhe për tradhtarët, ata kishin krijuar rrethet e tyre shoqërore.

Ishte e lavdishme, e mençur, heroike dhe e drejtë puna e Partisë në atë kohë dhe në vazhdim, prandaj populli e kuptoi drejtësinë e vijës së saj dhe e përqafoi këtë. Ai e kuptoi dhe e përqafoi këtë vijë, sepse kjo ishte në mbrojtje dhe në interes të tij. Dhe për këto u ngritën pikërisht këta djem të thjeshtë, siç ishin komunistët, e jo të tjerët që s'ishin veç xhambazë të lirisë e të jetës së popullit, ishin njerëz gjakpirës që e shitnin atdheun për një grosh. Ata hanin e pinin në kurriz të popullit, e vritnin dhe e grabitnin atë. Partia i bëri thirrje popullit të ngrihej i tëri më këmbë dhe të rrëmbente armët, pse kishte ardhur fundi, duhej ngritur ose atëherë ose kurrë. Ne, komunistët, kishim bindje të pathyeshme se populli do të na kuptonte që luftonim për çështjen e tij, se idetë e Partisë ishin aspiratat e tij, prandaj ai e kuptoi Partinë dhe luftoi nën udhëheqjen e saj.

Në këtë drejtim, formimi i Shtabit të Përgjithshëm, për krijimin e të cilit mendoi Komiteti Qendror i Partisë, ka një rëndësi të madhe, se ndihmoi të përdorej drejt eksperiencia e kaluar e luftës popullore, e cila duhej të ecte në rrugën marksiste-leniniste revolucionare. Në këtë rrugë duhet të ecte revolucioni popullor, prandaj çetat duhej të merrnin formën e njësiteve të organizuara, populli të kishte ushtrinë e vet, e cila duhej të përbëhej e të komandohej nga njerëzit e popullit, të mbronin interesat e tij, të frymëzohej nga këta interesa. Ushtria jonë duhej të dilte nga zjarri i luftës, të armatosej me ideologjinë e Partisë

dhe të ishte vigjilente për të mbrojtur gjer në fund fitoret e popullit. Çdo gjë, pra, për popullin. Ky ishte një nga qëllimet kryesore të krijimit të Shtabit të Përgjithshëm.

U luftua shumë për këtë çështje dhe nuk e njohin të tërë këtë luftë, se në atë kohë na luftonin hapur, po na luftonin edhe në mënyrë të fshehtë. Na bëhej një luftë e ashpër edhe nën rrogëz, sidomos nga ballistët, nga zogistët, nga agjentët e anglezëve, të futur brenda në frontin tonë, bile deri në përbërjen e Shtabit të Përgjithshëm. Vallë a i njihnim ne këta? Po, i njihnim. Atëherë përse nuk i flaknim qysh në atë kohë? Partia ishte gjithnjë vigjilente dhe e matur. Do të vinte koha që t'i flaknim këta armiq, se Partia nuk kishte shpresa tek Abaz Kupi, te Murat Basha¹ e të tjerë si këta, po ajo mendonte se me këta njerëz duhej të bënim përpjekje që të dilnin hapur me fytyrën e tyre të vërtetë përpara masave të popullit dhe të mos mund ta gënjenin më atë. Partia punoi dhe luftoi që ata ose të bëheshin me ne ose me armiqtë, sikundërqë edhe u bënë, rrugë tjetër nuk kishte.

Brenda radhëve tona kishte edhe të tjerë, agjentë të maskuar të Intelixhens Servisit, që përpiqeshin të sabotonin formimin e Shtabit të Përgjithshëm, por s'ia arritën qëllimit, se ne i zbuluam. Njëri u kap prej forcave tona dhe pohoi që ishte në shërbim të agjunkturës angleze. Atij i bëmë thirrje ta braktiste këtë rrugë, të ecte në rrugën tonë të drejtë e të ndershme. Ai premtoi dhe deklaroi se do të mbante qëndrim të drejtë

1 Shef i «Shtatmadhorisë» së Abaz Kupit.

të. Ne e dinim që gënjente dhe koha vërtetoi se, pasi u krijua Shtabi, ai u përpoq të ndihmonte për krijimin e një qeverie shqiptare në mërgim në Londër, të kryesuar nga Mehdi Frashëri, me qëllim që t'i nxirrte popullit tonë vështirësi të panumërta. Ai ishte një nga ata që synonte dhe u përpoq të sabotonte punimet e Kongresit të Përmetit, i cili vuri ato themele historike që të gjithë i dimë. Për këto arsye, që në ato momente, atij iu tha ndal, po ai nuk e pushoi punën e tij armiqësore, duke u orvatur të pengonte edhe marshimin e divizioneve të Ushtrisë sonë Nacionalçlirimtare për në zonat e Veriut, çlirimi i të cilave ishte një nga detyrat më kryesore të asaj kohe. Agjentura angleze kërkonte që Veriu i Shqipërisë të mbetej nën drejtimin e reaksionit, të bandave tradhtare të Bazit të Canës, të krerëve reaksionarë të Dibrës e të tjerë, që, kështu, nga një anë ata në Veri, nga një anë të tjerët, në Jug, të na vinin midis dy zjarresh kur të çlirohej Shqipëria. Prandaj marshimi i forcave tona drejt Veriut donte të thoshte likuidim i reaksionit në këtë zonë. Ai, pra, u orvat përsëri të na pengonte, por mbaroi, u likuidua.

Edhe nën rrogoz, pra, ka pasur luftë. Po përse? Ka pasur luftë, sepse armiqtë e kuptonin që këto ngjarje, këto data, siç ishin krijimi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare apo Kongresi i Përmetit e të tjera, kanë qenë jashtëzakonisht të rëndësishme për Partinë, për kryerjen deri në fitore të Luftës sonë Nacionalçlirimtare, për kryerjen e detyrave të shenjta të çlirimit të atdheut, për ushtrinë tonë, për forcimin dhe për kalitjen e saj, për kriji-

min e pushtetit tonë popullor në të katër anët e vendit dhe për ligjërimin e tij gjë që s'i pëlqente reaksionit.

Lufta jonë kishte, gjithashtu, një rëndësi të madhe edhe nga pikëpamja ndërkombëtare, se fuqitë e mëdha imperialiste ishin mësuar që fatin e vendeve të vogla, por sidomos të Shqipërisë, ta vendosnin jashtë. Caktimi i fatit të Shqipërisë, jashtë vendit tonë, donte të thoshte të vendosej për të si t'i donte qejfi njërit ose tjetrit. Partia Komuniste e Shqipërisë, sot Partia e Punës, dhe populli shqiptar, që kur e filluan Luftën Nacionalçlirimtare, kishin vendosur që fati i Shqipërisë të caktohej me armë në dorë nga vetë populli shqiptar dhe brenda truallit të atdheut.

Bashkimi Sovjetik, Ushtria e Kuqe, shoku Stalin kanë qenë për ne një faktor ndihmës i jashtëm, por, në qoftë se ne nuk do të luftonim dhe nuk do ta drejtonim luftën siç e drejtuam, në qoftë se nuk do të krijonim Ushtrinë tonë Nacionalçlirimtare dhe nuk do të luftonim për çlirimin e vendit vetë, me gjak e me sakrifica, në qoftë se nuk do të kishim vendosur, siç vendosëm, që nga themelet pushtetin tonë popullor, në qoftë se nuk do të spastronim vendin nga armiqtë, nga tradhtarët, nga fashistët, në qoftë se nuk do të bënim, sikundër bëmë, që në fillim të gjitha reformat që kishin për qëllim vendosjen dhe çelikosjen e diktaturës së proletariatit, pra, në qoftë se nuk do të vendosnim vetë për jetën dhe për të ardhmen, atëherë dihej ç'fat do t'i rezervohet Shqipërisë, nga jashtë, nga fuqitë imperialiste. Fatin e Shqipërisë sonë, pra, e vendosi vetë populli ynë, me pushkë në dorë dhe me Par-

tinë e vet heroike marksiste-leniniste në krye dhe askush tjetër. Prandaj krijimi i Shtabit të Përgjithshëm 25 vjet më parë pati një rëndësi të madhe për vendin tonë edhe në arenën e jashtme.

Me aleatët tanë anglezë dhe amerikanë, ne i ruanim me kujdes caqet, nuk kishim kurrë besim në ta, sepse e dinim që ata ishin kapitalistë. Atyre nuk u vinte mirë për ato që ndodhnin në Shqipëri, prandaj dërguan këtu misionarë, me qëllim që të likuidonin Luftën tonë Nacionalçlirimtare, por qëllimit s'ia arritën dot. Ata i dërguan misionarët për të krijuar me kuadrot tanë rrjetet e tyre të spiunazhit në Shqipëri, por dështuan, pse morën kudo përgjigjen e merituar. Prandaj u detyruan të drejtoheshin nga Veriu i vendit, sepse atje kishin mbetur shpresat e tyre. Në Veri ata filluan të organizonin reaksionin jo vetëm ushtarakisht, por edhe politikisht. Po edhe këtu Partia dhe populli, forcat partizane u treguan vendin.

Krijimi i Shtabit të Përgjithshëm ishte për armiqtë një çështje vdekjeprurëse, një veprim i dëmshëm që ata absolutisht nuk e donin. Por, përpara vullnetit e vendosmërisë së popullit dhe të komunistëve shqiptarë, armiqtë e Luftës Nacionalçlirimtare nuk kishin ç'bënin.

10 Korriku, shokë, është një datë me rëndësi të madhe për ushtrinë dhe për vendin tonë. Që këtej ushtria jonë mori hov dhe fitoi forcë. Po ta krahasojmë ditën e sotme me 10 Korrikun e vitit 1943, do të shohim se midis tyre ka shumë ndryshime. Ne sot rrojmë në socializëm, punojmë në një vend të lirë e të lulëzuar, me një industri dhe me bujqësi të përp-

ruar, që çdo ditë ecin me vrull të pandalshëm përpara. Këto u detyrohen vijës së drejtë të Partisë, mobilizimit të madh të masave, edukimit të tyre me botëkuptimin marksist-leninist. Gjatë gjithë kësaj periudhe masat tona punonjëse fituan gjëra kolosale, ato kanë bërë një shkollë të madhe politike, që nuk mund të kryhej as brenda 100 vjetëve.

Nënë Zyhraja e Orenjës, në kohën e luftës, kishte vetëm tri gjëra të shtrenjta: Së pari, kishte një djalë që ia quanin Beqir Koçi, i cili doli partizan, luftoi për atdheun dhe ra dëshmor. Kishte edhe diçka tjetër të dashur nënë Zyhraja, një dhi të vetme për t'i marrë një komb qumësht. Por një natë dimri të ftohtë e me furtunë, gjatë kohës së luftës, mua më zuri nata dhe u futa në haurin e saj. Ajo ia preu kokën dhisë dhe mbeti e vetme në atë haur të vjetër, ku ç'binte jashtë, binte dhe brenda. Por, me të ikur ne, fashistët gjermanë, që kishin marrë vesh ç'ishte për ne nënë Zyhraja, i vunë zjarrin e i dogjën edhe haurin, që ishte gjëja e tretë që kishte më të vyer dhe që i kishte mbetur asaj akoma. Nënë Zyhraja humbi gjithçka kishte të shtrenjtë në jetë, po fitoi gjënë më të madhe, fitoi Partinë, fitoi popullin, fitoi atdheun, të tërë Shqipërinë.

Lufta na vrau dhjetëra mijë djem e vajza, na dogji shtëpi e katandi, por, pas Çlirimit, të udhëhequr nga Partia, ne e bëmë më të bukur Shqipërinë dhe shumë herë më të bukur do ta bëjmë në të ardhmen; populli shqiptar u bë më i fortë dhe do të bëhet akoma më i çeliktë në vitet që vijnë; ai u bë i mësuar dhe në të ardhmen do të mësojë akoma më shumë, që ta zbu-kurojë më mirë jetën e vet, që të bëhet akoma më i

lumtur dhe të kenë më shumë bollëk sofrat tona. Ato që ka thënë, Partia i ka bërë të gjitha. Çfarë thotë sot Partia, ne, gjithashtu, do ta bëjmë, do ta realizojmë. Dhe gjithçka do ta realizojmë vetë, me krahët dhe me mendjet tona, se kemi vullnet të hekurt dhe, mbi të gjitha, kemi Partinë që udhëheq me drejtësi, sepse kemi popullin tonë punëtor e patriot dhe që është i lidhur si mishi me thoin me Partinë. Është për këtë arsye që ne jemi të sigurt në ato që themi. Ato që thotë Partia, janë të lidhura ngushtë me ato që dëshiron populli.

Një nga gjërat më të shtrenjta, që populli ynë e do me gjithë shpirt, është ushtria. Ai e do ushtrinë e vet, sepse ajo e çliroi dhe sot e mbron nga çdo armik. Populli shqiptar nuk mund ta kuptojë qenien e tij të lirë pa ushtrinë e vet. Ai e kupton shumë mirë politikisht që ushtria duhet të qëndrojë më këmbë, e fortë, e armatosur, mbasi rreth e rrotull kemi armiq, që janë gati në çdo moment të na shqyejnë, po të jemi të dobët. Por, kur jemi të armatosur dhe vigjilentë, armiq të na kanë frikë, tmerrësisht na kanë frikë dhe le të na kenë. Frika atyre u vjen ngaqë e dinë se në vendin tonë jecen një popull trim, se këtu është më këmbë kurdoherë e gatshme një ushtri e fortë, që i përngjet popullit të vet. Ushtria jonë është e edukuar dhe e armatosur më së miri me armë moderne. Ajo është arma e dashur dhe e fuqishme e popullit për të mbrojtur fitoret e arritura, nga armiq të tanë të jashtëm e të brendshëm. Këtë e kupton mirë te ne çdo njeri, i gjithë populli.

Rëndësia e ushtrisë konsiston edhe në diçka tjetër.

Ushtria është, përveç të tjerash, edhe një shkollë e madhe. Gjithë këta qindra e mijëra djem, që kryejnë shërbimin ushtarak, përveç stërvitjes, gjatë jetës ushtarake mësojnë të paktën dy, po shpesh tri, bile edhe katër zanate. Ndodh, jo rrallë, që shumëve prej nesh nuk u shkon në mendje një gjë e tillë. Kryesia e çdo kooperative bujqësore, po të interesohet të dijë sa profesione zotërojnë ata që kanë mbaruar ushtrinë, pra, po të pyeten ata me radhë, do të zbulojë që secili di të paktën dy profesione. Çfarë profesionesh janë vallë këto? Profesionit i mekanikut, i betonistit, i muratorit, i karpentierit, i hekurkthyesit etj., etj. Me të tilla profesione ata janë në gjendje të bëjnë çdo gjë në fshat, por nëpër kooperativat tona shumë pak i shfrytëzojnë këto aftësi, që ata i kanë fituar gjatë kohës së shërbimit në ushtri.

Para pak ditësh vizitova disa nga kooperativat në rrethet e Fierit dhe të Lushnjës. Atje ka me dhjetëra specialistë të përgatitur në ushtri, energjitë krijuese të të cilëve flenë. Natyrisht, ata janë anëtarë të kooperativës dhe punojnë bashkë me kooperativistët e tjerë në ara ose në çdo punë tjetër, por secili prej tyre, kur pyeta disa nga ata që takova, më tha se gjatë viteve të kryerjes së shërbimit ushtarak kishte mësuar edhe profesione të tjera. Kur vizitova kuzhinën e kooperativës bujqësore të Golem-Gramshit, në rrethin e Lushnjës, pashë një djalë të ri plot shëndet, që përgatiste gjellë për qindra kooperativistë. E pyeta nëse në ushtri kishte mësuar vetëm për të bërë gjellë dhe ai m'u përgjigj se kishte mësuar për mekanik dhe mbante kategorinë e gjashtë të mekanikut të nëndetëseve. Ber-

beri i kooperativës, që kishte mbaruar edhe ai shërbimin ushtarak, më tha se kishte mësuar për radist dhe se ishte, njëkohësisht, edhe elektrikist, shofer, berber, po edhe nga punët bujqësore të kooperativës nuk shkëputej. Pastaj takova këpucarin e kooperativës, i cili më tregoi se ishte përgatitur në ushtri si betonist, hekurkthyes dhe shofer. Një tjetër më tregoi se ishte radist, telefonist dhe elektrikist. Krahas tij takova një infermier, i cili e kishte mësuar këtë profesion gjatë kryerjes së shërbimit ushtarak. Të gjithë këta i gjeta në një qendër kooperative, por të tillë ka në të gjitha kooperativat bujqësore të Shqipërisë. Në një fshat tjetër takova djem të rinj, nga ata që kanë mbaruar shërbimin ushtarak, të cilët kishin ndërtuar një rrugë të gjatë prej 10 kilometrash, tamam si rrugët tona nacionale, po aq të gjerë, të shtruar bukur me kalldrëm, me zhavor, anash me kanalizime të rregullta dhe me vija të prera drejt.

Kur shkoi ministri i Ndërtimit në një repart, për të parë tunelet e betonuara, që janë ndërtuar atje nga ushtarët, kërkoi të takohej me inxhinierin që kishte drejtuar punimet, që ta përgëzonte për punën, por në çast iu paraqit, duke e përshëndetur, një ushtar i thjeshtë. Ministrit as që i shkante ndër mend që ai ishte drejtuesi i punimeve aq të vështira të tuneleve, prandaj theksoi edhe një herë t'i sillnin inxhinierin, por ushtari e vuri në dijeni se ishte ai vetë që i kishte drejtuar punimet e këtij objekti. Atëherë ministri u gëzua shumë dhe e përgëzoi këtë djalë të thjeshtë të popullit, të cilin ushtria e kishte mësuar të bënte punë të këtilla kaq të vështira.

Përse i them këto? Këto i them që të kuptojmë mirë të gjithë se ushtria është, njëkohësisht, edhe një shkollë e madhe kuadrosh. Ajo i mëson djemtë e popullit si të mbajnë në dorë të sigurt pushkën, si t'i përdorin më së miri topat, avionët, anijet, që t'i kenë kurdoherë të gjitha në gatishmëri. Por, njëkohësisht, u mëson edhe profesione të ndryshme. Prandaj, kur ata kthehen në fshat, sipas nevojave të kooperativës t'u kërkohet atyre t'i vënë në zbatim profesionet që kanë mësuar gjatë kryerjes së shërbimit ushtarak; organizata-bazë e Partisë dhe kryesia e kooperativës duhet t'i ngrenë më këmbë të gjitha këto forca që qëndrojnë pa u shfrytëzuar, për të ndërtuar çdo gjë në fshat, pse, po t'u jepen materialet e nevojshme dhe modelet, ata janë në gjendje të bëjnë potkonj, shata, lopata dhe sende të tjera që u nevojiten kooperativistëve.

Përse të mos i vëmë djemtë tanë të na i bëjnë këto, kë presim të na i bëjë? Le t'i vëmë, pra, të gjithë këta djem në lëvizje sa herë na del nevoja për gjëra të tilla. Për të gjitha këto populli është i lidhur ngushtë me ushtrinë e tij, sepse ajo është ushtri e popullit.

Shokë dhe vëllezër,

Në këtë ditë të 25-vjetorit të krijimit të ushtrisë, populli ynë është shumë i gëzuar. Në të katër anët e atdheut ai po e feston me entuziazëm këtë datë të shënuar. Populli ynë e do shumë ushtrinë e vet, jo se është luftëdashës, përkundrazi, ai kurrë nuk i ka rënë

tjetrit më qafë, por sepse e do lirinë dhe i ruan fitoret e tij nga armiqtë grabitqarë. Populli ynë nuk është nga ata që i lejon të tjerët ta shkelin me këmbë, ai është trim, luftëtar, që armiqtë i ka kurdoherë në majë të pushkës. Kundër imperialistëve amerikanë, revizionistëve sovjetikë dhe gjithë reaksionarëve të botës, pushkën ne do ta mbajmë kurdoherë ngritur, kurrë nuk do ta ulim, pse ata janë armiqtë tanë dhe të të gjithë popujve të botës, prandaj kundër tyre do të jemi kurdoherë gati dhe do të luftojmë deri në fund.

Por ne nuk jemi vetëm. Forcat revolucionare dhe përparimtare të botës janë me ne. Do të vijë koha që armiqtë të marksizëm-leninizmit t'u vijë fundi dhe ne do të fitojmë, se jemi në rrugë të drejtë. Këtë besim ne e kemi pasur dhe e kemi shprehur edhe në kohë shumë të vështira, siç ishin ato të Luftës Nacionalçlirimtare.

Ju, fshatarë të Shmilit dhe të Labinotit, e mbani mend kur italianët e gjermanët, ballistët dhe gjithë reaksioni shqiptar, kur Shefqet Vërlaci me shokë ishin në fuqi dhe ne ishim akoma të paktë, të zhveshur e të pangrënë, pa armë e municione. Ju e mbani mend kur ne vinim në vatrën tuajë dhe plot besim ju thoshim se do të fitonim dhe vërtet fituam, se ishim në rrugë të drejtë. Tani përsëri ne themi se do të fitojmë dhe e themi këtë jo thjesht se kështu duam ne, por sepse jemi të fortë, sepse me ne është e drejta, është e ardhmja, janë shumica e njerëzve në botë, se kemi zemrat e njerëzve, kemi popullin, që është faktori vendimtar në luftë, pastaj vijnë armët. Sa për armë edhe ne kemi,

prandaj le ta dinë armiqtë se kush prek Shqipërinë, i bën varrin vetes.

Vëllezër dhe motra të Labinotit, të Shmilit dhe të gjithë rrethit të Elbasanit,

Ju sjell juve me këtë rast të gëzueshëm përshëndetjet më të ngrohta të Komitetit Qendror, sepse në kohën e luftës ne kemi ardhur shumë herë pranë jush dhe, ashtu si në të gjitha krahinat e atdheut, ju na keni mbajtur, na keni ushqyer, na keni mbrojtur e na keni strehuar. Ne nuk i harrojmë kurrë miqtë tanë të vjetër, disa nga të cilët, si: Ali Disha, Ram Çeka e të tjerë, kanë vdekur, po kemi edhe të tjerë të gjallë, si: Sherifi, Aliu, Buzhiqët, nënë Zyhraja në Orenjë, kemi djemtë e Ballës e shumë e shumë të tjerë.

Në emër të Komitetit Qendror dhe të të gjithë shokëve të pranishëm dëshiroj të përshëndes me këtë rast bashkëpunëtorët tanë më të ngushtë, shokët e vyer, heronjtë e Luftës Nacionalçlirimtare, oficerët tanë, të dalë nga radhët e popullit, të cilët kanë mbajtur mbi supet e tyre barrën më të rëndë të luftës. Ata, duke luftuar në fillim si partizanë të thjeshtë, me kohë ngjiten shkallët, duke udhëhequr njësitet heroike nacionalçlirimtare, treguan zotësi të rrallë në betejat e ashpra të luftës dhe i mundën oficerët e armikut, kapërcyen vështirësi të panumërta, duke u treguar me të vërtetë ushtarë të lavdishëm të Partisë, bij të denjë të popullit, marksistë-leninistë të shquar. Partia dhe populli kurrë nuk do të harrojnë zotësinë,

mençurinë dhe sakrificat e tyre të panumërta. Prandaj ju thërres, shokë të dashur, të brohorasim për partizanët e vjetër, për oficerët trima të Ushtrisë sonë Popullore.

Le ta pimë këtë doli për Partinë tonë heroike!

Të rrojë Partia!

Të rrojë populli!

Të rrojë ushtria!

*Botohet për herë të parë sipas
shënimeve të mbajtura në këtë
takim që gjenden në AQP*

REVIZIONISTËT SOVJETIKË DHE ÇEKOSLLOVAKIA

Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»

24 korrik 1968

Populli çekoslovak po kalon ditë të vështira, ai po kërcënohet nga brenda dhe nga jashtë. Ky është rezultati i tradhtisë së revizionistëve hrushovianë, të revizionistëve çekoslovakë, të reaksionit të brendshëm çekoslovak, të koalicionit revizionist të jashtëm dhe të koalicionit imperialisto-kapitalist botëror.

Armiq të shumtë i janë qepur popullit çekoslovak, për ta robëruar përgjithmonë. Të gjithë këta i hiqen si «miq besnikë», të gjithë flasin «për t'i dhënë popullit çekoslovak lirinë, demokracinë që po e humbet», por të gjithë i përgatitin atij varrin. Varrin e tij filloi ta hapë klika revizioniste e Novotnit, e cila i lidhi fatet e Çekoslovakisë me hrushovianët. Novotni ishte biri i dashur e i nderuar i Hrushovit. Pas «vdekjes» së këtij, pozitat e Novotnit qëndruan përsëri të palëkundshme, si brenda, ashtu edhe në stanin revizionist. Por, edhe kur filluan të lëvizin fort for-

cat centrifugale nga epiqendra e revizionizmit modern, Novotni dhe klani i tij qëndronte i patundur pranë Brezhnjev-Kosiginit, si mbrojtës i zjarrtë i tyre dhe luftëtar antimarksist i dorës së parë.

Gjithashtu, qëndrimi i Novotnit dhe i klanit të tij ndaj Republikës Demokratike Gjermane, pikë kjo shumë sensibil e stantit revizionist, ishte «shumë i mirë», domethënë, pro Ulbrihtit dhe nuk u duk asnjë shenjë afrimi, si e rumunëve me Republikën Federale të Gjermanisë. Bile, në këtë çështje, vetë revizionistët sovjetikë kishin shumë gjynahe dhe hesape për të dhënë.

Asnjë krizë e veçantë dhe më katastrofike e brendshme në ekonomi dhe në degjenerimin moralopolitik të Partisë Komuniste Çekoslllovakë dhe të Republikës Çekoslllovakë nuk ngjau më tepër nga ato që ngjanë në Bashkimin Sovjetik e në vendet e tjera revizioniste. Por këtu ngjau diçka e papritur, këmbët e Novotnit dhe të klanit të tij u lëkundën dhe, më në fund, atë e likuiduan.

Largimi i Novotnit dhe i klikës së tij, që dukej me pozita nga më të fortat në vendet revizioniste, u bë nga klika e Dubčekut, njeri deri dje i panjohur dhe pa ndonjë autoritet, i rrethuar nga njerëz revizionistë dhe nga «ultra», të dalë edhe nga burgjet. Për çudi, njerëzit e klikës së Novotnit s'bënë as më të voglën rezistencë, përkundrazi, ndihmuan vetë shpartallimin e tyre, dhanë dorëheqjen dhe u tërhoqën si qen të zgjebosur, sikur t'i komandonte dikush nga prapaskena për të vepruar në një mënyrë të tillë.

Të gjitha këto tregojnë se çështja e Çekosllova-

kisë, në fakt, nuk duhet të jetë kaq e thjeshtë. Këtu ka një komplot të madh kundër një populli, kundër një vendi, që ka një pozitë strategjike të rëndësishme në Evropë. Çekosllovakia, pra, ka qenë fusha e shahut dhe klikat që ikën, që erdhën e që do të vijnë, janë pionët e lojës në duart e revizionistëve sovjetikë dhe të imperializmit amerikan. Mafia ndërkombëtare vepron mbarë e prapë në Çekosllovakë.

Procesin e dezintegritimit të kampit revizionist, PPSH e ka parashikuar me kohë, e kemi shpjeguar dhe e kemi arsyetuar në rrugën marksiste-leniniste dhe nuk jemi gabuar. Ngjarjet e Çekosllovakisë, që janë një pjesë e këtij procesi, i vërtetojnë edhe një herë tjetër konkluzionet e PPSH.

Revizionistët modernë të vendeve të ndryshme luftojnë për shkëputje të plotë nga revizionizmi sovjetik dhe farkëtojnë lidhje, aleanca e ura të reja me imperializmin amerikan dhe me kapitalizmin botëror. Shembullin më të madh, më konkret, më real në këtë drejtim e jep vetë revizionizmi sovjetik, i cili është i lidhur kokë e këmbë, në një aleancë pa mbarim, me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me kapitalizmin botëror. Kjo aleancë dominon sot botën kapitalisto-revizioniste. Dy fuqitë e mëdha kapitaliste luftojnë të sundojnë botën dhe të ndajnë sferat e influencës, duke pasur në plan të parë luftën kundër marksizëm-leninizmit, kundër socializmit, kundër revolucionit. Në këtë luftë të tyre për sferat e influencës hyn edhe çështja e ruajtjes nën varësinë e vet të satelitëve. Natyrisht, kjo sjell me vete edhe shkëputjen e satelitëve nga njëra fuqi dhe varësinë nga tjetra. Zhvillohen, pra,

një luftë ujqish, komplete dhe intriga në kurriz të popujve të shumë vendeve, një nga të cilët është edhe ai çekoslovak.

Çekosllovakia, një satelit revizionist i revizionistëve sovjetikë, lufton tani të shkëputet nga hrushovianët dhe të lidhet me amerikanët e me kapitalizmin perëndimor. Në këto përpjekje reaksioni dhe revizionistët çekë kanë ndihmën e kapitalizmit botëror.

Revizionistët sovjetikë, polakë e gjermanë, në radhë të parë, pastaj më pak bullgarët dhe sa për të thënë se «jemi edhe ne në këtë mes» — hungarezët, po i bëjnë shantazhe e presione të njëpasnjëshme klikës së Dubçekut që t'u nënshtrohet atyre, të mos largohet nga stani i tyre etj., etj. Klikën revizioniste të Dubçekut këta e akuzojnë për të gjitha ato që vetë i kanë bërë më parë dhe i kanë bërë në një shkallë kolosale. Me fjalë të tjera, këta i thonë klikës së Dubçekut: «Ti s'duhet të kesh lidhje me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kurse ne po; ti s'duhet të kesh lidhje diplomatike me Republikën Federale të Gjermanisë, kurse ne po; ti s'duhet të marrësh kredi nga kapitalistët, kurse ne po» e kështu me radhë. Kërcënimet sovjetike arritën edhe deri në ndërhyrje të ushtrisë së tyre në Çekosllovakë, nën maskën e Traktatit të Varshavës dhe gjoja të manovrave të trupave. Dhe ky kërcënim brutal akoma nuk ka marrë fund. Tani me mijëra «turistë» sovjetikë e të vendeve të tjera revizioniste, që në të vërtetë janë ushtarake, po invadojnë Çekosllovakinë dhe, praktikisht, po zëvendësojnë ushtritë e rregullta.

Që revizionistët sovjetikë e çekoslovakë do të arri-

nin deri në këtë pikë, ne nuk çuditemi aspak, pse e dimë dhe e kemi thënë se banditët në mes tyre i që-rojnë hesapet me mënyra banditeske.

Por mund të bëhet pyetja: Përse sovjetikët e lanë Novotnin, njeriun e tyre, si gunën e vjetër dhe tani arrijnë të bëjnë të tilla presione e shantazhe skandaloze? Ç'mund të ketë ngjarë?

Le të përqijemi të analizojmë ato fakte që, hëpër-hë, janë bërë të njohura. Kriza e klikës së Novotnit filloi që vitin e kaluar, por ajo ishte akoma një krizë e lehtë, që nuk linte të dukej asgjë tragjike. Dukeshin sikur ishin kundërshtime të zakonshme në mes pjesëtarëve të saj. Bënin zhurmë disa studentë në ditë feste, kundërshtonin herë pas here disa nacionalistë sllovakë, por asgjë s'të linte të kuptoje se do të ngjiste ajo që ngjau. Dubçeku u shfaq më vonë, doli nga «bas-fonds» të Sllovakisë dhe nga Shkolla e Partisë në Mëskë, ku kishte mësuar. E vetmja «përleshje», në qoftë se mund ta quajmë të tillë, u bë në një mbledhje plenumi të Komitetit Qendror të partisë revizioniste çekosllovake në mes Novotnit dhe Dubçekut, kur emri i këtij për-herë të parë doli në dritë. Novotnin filluan ta braktisin me radhë, më parë shokët dhe mbështetësit e tij, si: Hendrih, Koucki e të tjerë. Përse? Po udhëheqja sovjetike, e cila ndoqi në hollësitë më të vogla debatet në Komitetin Qendror të PKÇ, që kishte kontakte dhe biseda të gjata e të drejtpërdrejta me novotnistët e me kundërshtarët e tyre, që njihte mendimet e veprimet e tyre të hapëta e të fshehta, që dinte, ndoshta më mirë se vetë çekët, gjendjen politike, ekonomike e ushtarakë të vendit, nuk e shikonte se ç'drejtim po merrnin

ngjarjet? Vështirë është të përfytyrohet që një udhëheqje e një fuqie të madhe, e cila ndjek një politikë shoviniste imperialiste, të mos e ndiejë nga fryjnë erërat në zonat e saj të influencës. Revizionistët sovjetikë jo vetëm kanë qenë në dijeni të plotë të asaj që po ngjiste në Çekosllovakia, por ata ishin instigatorët, komplotuesit, organizatorët. Versioni i kundërt, që ata të mos dinin gjë, përjashtohet absolutisht. Atëherë, po të gjujkojmë nga ngjarjet, del se udhëheqja revizioniste sovjetike e braktisi Novotnin për dikë tjetër, për klikën e Dubçekut.

Po si është e mundur një gjë e tillë, në rast se pranojmë që Novotni dhe klika e tij ishin të lidhur ngushtë me udhëheqjen revizioniste sovjetike? Duket sikur kjo është kontradiktore. Çelësi i shpjegimit duhet kërkuar në Moskë, në luftën dhe në kompromiset e grupeve të ndryshme revizioniste sovjetike rivale.

Duket se jo e tërë udhëheqja revizioniste sovjetike ishte pro Novotnit dhe klikës së tij. Një pjesë e saj nuk e donte Novotnin, donte ta qëronte, ta hiqte qafe dhe ta zëvendësonte me një klikë tjetër më liberale. Del, pra, se për këtë problem kyç udhëheqja revizioniste sovjetike është e çarë, se në rrugëkryq nuk është vetëm Çekosllovakia, por edhe udhëheqja revizioniste sovjetike. Pra, duhet të pranojmë versionin se në udhëheqjen revizioniste sovjetike ka pasur dy korrente, nga të cilët njëri, ai më liberali, dominoi, organizoi intrigën çekosllovake, e la dhe e ndihmoi të zhvillohet e, më në fund, e konsumoi. Novotni u rrëzua, Dubçeku erdhi në fuqi, udhëheqja revizioniste sovjetike «nuk ndërhyri në punët e brendshme të Çe-

kosllovakisë» etj. Mirëpo, reaksioni çekoslovak ngriti krye, u aktivizua, po përsëritej ajo që ndodhi në Hungari, pa çak, pa bam. Atëherë, dhe vetëm atëherë, konservatorët revizionistë dhe ushtria duhet të kenë marrë përsëri preponderancën dhe filloi kështu faza e dytë e skandalit nga ana e revizionistëve sovjetikë.

Klika revizioniste çekosllovake e Dubčekut duket se kishte marrë sigurime të mira nga udhëheqja revizioniste sovjetike për arritjen e suksesit të saj. Në procedurat e saj ajo përdori taktikat e vjetra të Hrushovit për demaskimin e revizionistit Novotni, të cilin e mbiquajti «stalinist», filloi të akuzojë Gotvaldin, u ringjall Slanski, filluan të rehabilitohen tradhtarët, të atakohet 1948-a dhe të akuzohet Stalini për ndërhyrje në punët e gjyqeve çekosllovake e të tjera poshtërsi të tilla.

Mirëpo, ky komplot revizionist, i krijuar dhe i mbështetur nga revizionistët sovjetikë, nuk duhet të ketë qenë një objektiv i vetmuar. Po i njëjti proces filloi të zhvillohej në Poloni kundër Gomulkës dhe klikes së tij revizioniste. Këtu u ngritën studentët, kurse krerët e komplotit qëndruan «publikisht» në hije.

Ndërkaq, në Republikën Demokratike Gjermane nuk lëvizi asgjë. Duhet të nxjerrim konkluzionin se faza e parë ishte rrethimi i Republikës Demokratike Gjermane nga shtete me qeveri krejtësisht të shkëputura nga Bashkimi Sovjetik, ose në ujdi me një Bashkim Sovjetik, ku edhe atje, në një fazë të dytë, pasi të kishte sukses faza e parë e komplotit, të ishte në krye një grup i ri udhëheqës, pikërisht ai që organizoi komplotin në Çekosllovaki e në Poloni. Pra, në

rast se Dubçeku vinte në fuqi, në rast se Gomulka rrëzohej dhe Republika Demokratike Gjermane izolohej, në Bashkimin Sovjetik do të ngjisnin medoemos ndryshime. Komplotistët brenda komplotistëve shpresonin në suksesin e tyre.

Në Poloni Gomulka i shtypi hëpërhë kundërshtarët, komploti kundër tij dështoi. Ai «luajti» kartën e ushtrisë sovjetike që ndodhet në territorin polak, kartën konservatore revizioniste sovjetike.

Duket se komploti i fshehtë revizionist sovjetik në Çekosllovakia dhe rrëzimi i Novotnit janë bërë pa dijeninë e Ulbrihtit dhe të Gomulkës, të cilët, qind për qind, ishin kundër këtij komploti dhe këtë e manifestuan që në fillim. Mbledhja e Dresdenit u bë me kërkesën e tyre, manovrat e ushtrive të Traktatit të Varshavës në territorin çekoslovak u bënë me insistimin e tyre dhe, tash së fundi, mbledhja e të pestëve pa çekoslovakët, që nuk u shkuan, me siguri është bërë po me kërkesën e vendosur të tyre.

Revizionistët sovjetikë e panë se klika e Dubçekut u doli nga fjala që kishin ujdísur së toku. Kjo e fundit pasi e vuri nën këmbë klikën e Novotnit, i dha liri reaksionit të brendshëm, për të siguruar përkrahjen e reaksionit të jashtëm, i cili filloi të interesohet fuqimisht, duke e përkrahur liberalizimin çekoslovak, por pa i djegur duart hapur, si në kundërrevolucionin hungarez. Kohët nuk ishin të njëjta. Aleanca sovjeto-amerikane duhej ruajtur, pse nën hijen e saj zhvilloheshin të gjitha këto transformime, duhej të lihej përshtypja se kjo ishte një çështje e brendshme e çekoslovakëve, ishte vazhdimi normal

i Kongresit të 20-të, i politikës së bashkekzistencës dhe i «destalinizimit» e, sepse, më në fund, shumë lidhje të fshehta të komplotit ishin në duar të për-bashkëta amerikano-sovjetike dhe amerikano-gjermanoperëndimore.

Nuk është e rastit që Boni e përshëndeti me aq zjarr ekipin e ri revizionist që mori pushtetin në Pragë dhe që udhëheqja e Republikës Demokratike Gjermane dha alarmin e përpara për këtë ndryshim. Ata e ndienë se ndryshimet në Çekoslovakia i përshtateshin shumë dhe në mënyrë të papritur «politikës së re lindore» të Bonit, se hapja e Pragës drejt Republikës Federale të Gjermanisë ishte jo vetëm një shenjë shpresëdhënëse, por dhe një hap konkret që kishte miratimin dhe inkurajimin e Moskës. Në mos zyrtarisht, por në fakt, Republika Demokratike Gjermane u vu në shitje dhe çmimet mund të jepeshin të ndryshme. Fakt është se ndryshimet në Pragë shpejtuan përfundimin e një sërë marrëveshjesh të rëndësishme midis SHBA-së e Bashkimit Sovjetik, që më përpara ishin bllokuar. Të tilla janë: ratifikimi i marrëveshjeve konsullore sovjeto-amerikane, nënshkrimi i traktatit për mospërhapjen e armëve bërthamore, vendosja e linjës ajrore Moskë — Nju-Jork, fillimi i bisedimeve për çështjen e raketave e të antiraketave e mjaft të tjera.

Fakt është, gjithashtu, se për çështjen çekoslovakë, shtypi amerikan dhe ai i Bonit, në përgjithësi, qëndrojnë disa hapa prapa për të dhënë përshtypjen gjoja të mospërzierjes në këtë katrahurë, që është e gjitha në favorin e tyre. Veprimet e tyre, në përkrahje

të revizionizmit dhe të reaksionit çekoslovak, janë të shumta e të fuqishme, por të nëndheshme dhe të pakapshme nga revizionistët sovjetikë, që këta të mos kenë mundësi t'i përdorin dhe të bëjnë bujë.

Revizionistët sovjetikë, duke parë se u iku zogu nga duart, se po e humbisnin kontrollin mbi Çekoslovakinë, vunë në lëvizje «masat e mëdha», shantazhin, kërcënimet, kërkimet llogari klikës së Dubčekut, e cila nuk u tërhoq nga rruga e saj, por u duk qartë se dha urdhër për ta ulur diçka tonin e britmave triumfale komprometuese të reaksionit çekoslovak.

Por Novotni dhe novotnistët s'ktheheshin dot më në fuqi. Çervonjenko dhe ambasada sovjetike në Pragë më kot provokonin, duke u takuar me Novotnin e rrëzuar. Filluan të shtypen trakte në ambasadën sovjetike në emër të «popullit çekoslovak», në emër të «milicisë punëtore çekosllavake», të «punëtorëve çekosllavakë», që, gjoja të alarmuar se po rrezikohej socializmi, arrinin gati deri në atë që të kërkonin ndihmën e «vëllezërve sovjetikë». Të gjitha ishin punë revizioniste, komplotiste, shantazhi, kërcënimi. Të gjitha këto mbështetnin ardhjen me shumicë të marsshalëve sovjetikë në Pragë, të Greçkos, të delegacioneve e, më në fund, edhe të vetë Kosiginit, gjoja për pushime, por, në fakt, për presione. Por ata asgjë nuk arritën, përveç lojës ushtarake të Traktatit të Varshavës, e cila bënte pjesë në planin e madh të presioneve.

Mirëpo, në pamundësi t'ia arrinin qëllimit, revizionistët sovjetikë, gjermanë, polakë, bullgarë e hungarezë i drejtuan atëherë nga një letër kërcënuese

Çekoslovakisë dhe e thirrën atë në gjyqin e Varshavës. Dubçeku nuk u vajti atje. Ai nuk ua vuri veshin kërcënimeve të revizionistëve të tjerë. Revizionistët sovjetikë dështuan me turp në të gjithë vijën. Ata jo vetëm e humbën dominimin në Çekoslovakë, por humbën edhe atë besim që u kishte mbetur te klikat e Gomulkës e të Ulbrihtit, për të mos folur për klikën e Kadarit, të cilit i ka ardhur radha «të çlirohet» publikisht prej tyre.

Revizionistët çekoslovakë kanë mbështetjen e imperializmit dhe të reaksionit të jashtëm. Ata kanë mbështetjen e hapët të Titos, i cili, me deklaratën që bëri, lë të kuptojë se është në dijeni të fijeve të komplotit sovjeto-Dubçek-imperialist. Ata kanë, gjithashtu, përkrahjen e Rumanisë.

Edhe më thellë u zhytën në disfatën e tyre revizionistët sovjetikë me letrën kolektive, të adoptuar nga udhëheqja sovjetike në mbledhjen qesharake që ajo organizoi ditët e fundit në kryeqytetin polak me udhëheqësit revizionistë të Polonisë, të Republikës Demokratike Gjermane, të Hungarisë e të Bullgarisë, me anën e së cilës u kërkohet Dubçekut e shokëve të tij të mos e kalojnë cakun e asaj që do të lejonte Moskë në politikën e brendshme e të jashtme të Çekoslovakisë.

Nënshkruesit hipokritë dhe mashtrues të letrës së Varshavës janë si kusarët, që bërtasin se kapën kusarin. Këta tradhtarë të marksizëm-leninizmit dhe të popujve të tyre akuzojnë tradhtarët çekoslovakë se tradhtuan marksizëm-leninizmin dhe Çekoslovakinë. Por letra në fjalë e tregon në mënyrë të qartë kom-

plotin e kurdisur kundër popullit çekoslovak, nga revizionistët sovjetikë, nga klika e Dubčekut dhe nga kundërrevolucionari botëror. Në këtë letër pohohet se sovjetikët kanë qenë dakord me klikën e Dubčekut që të qërohej nga mesi klika e Novotnit. Në të tregohet se klika e Dubčekut nuk e mbajti fjalën e dhënë për pazarllëqet e ndyra që ishin bërë në kulisa. Pra, pasi u lanë hesapet me Novotnin, «treni doli nga binarët» e paravendosur.

Ndryshimi i gardës revizioniste në Çekosllovakia nuk mund të bëhet pa disa arsye të mëdha politike. Një nga këto çështje kryesore, që revizionistët sovjetikë dëshironin të merrte një kurs të ri, ishte çështja gjermane, likuidimi i mosmarrëveshjeve politike me Republikën Federale të Gjermanisë në lidhje me të dy shtetet gjermane. Për çështjen gjermane, Antonin Novotni nuk mund të gjykohej më liberal nga Dubčeku.

Atëherë vihet pyetja: Përse «këta trima» revizionistë, që na u mblodhën në Varshavë, janë aq shumë të alarmuar që klika e Dubčekut po rrezikon sigurinë e vendeve të Varshavës dhe aprovojnë, njëkohësisht, spastrimin e Antonin Novotnit? Ata kanë frikë procesin zinxhir. Ç'do t'i ngjiste vallë Ulbrihtit, pas spastrimit të Novotnit? Klika revizioniste sovjetike a nuk mund t'i gjejë atij gjynahe? Jo vetëm mund t'i gjejë, po ai i ka ato me barrë.

Askush nuk mund të gënjehet se sovjeto-amerikanët nuk po përgatitnin një komplot të madh: spastrimin e pengesave për bashkimin e të dy shteteve gjermane, sipas ujdive dhe planeve të tyre. Britmat që po lëshojnë revizionistët nga Varshava janë, gjith-

ashtu, të planëzuara, mbasi këto plane djallëzore sovjeto-amerikane nuk realizohen kurdoherë siç duan ata. Këto disave u pëlqejnë, disave s'u pëlqejnë, disa i kuptojnë shpejt, ka të tjerë që i kuptojnë me vonesë, disa mashtrohen, disa jo, disa nënshtrohen e disa nuk nënshtrohen.

Letra e Varshavës, pra, e shkruar nga tradhtarë, nga komplotistë dhe nga njerëz antimarksistë, është një dokument fals, i gënjeshtërt. Asgjë çka thuhet në të nuk përfaqëson të vërtetën. E tëra është demagogji. Revizionistët sovjetikë, duke pohuar komplotin me terma gjoja të rregulluar: «politikë, shoqërorë, partië», kërkojnë t'i dalin punës përpara. Nesër, për këtë vepër të ndyrë, populli sovjetik do t'u kërkojë llogari. Duke pohuar komplotin e tyre me këta terma, sovjetikët pohojnë, nga ana tjetër, ndërhyrjen në punët e brendshme të partive dhe të shteteve të tjera. Ata në Çekosllovakia rrëzuan Novotnin, sekretarin e parë të partisë dhe presidentin e Republikës Çekosllovaqe. Çdo gjë të kundërt që thonë për këtë çështje, është gënjeshtërt dhe demagogji.

Letra famëkeqe e Varshavës vë mirë në dukje se nënshkruesit antimarksistë janë plotësisht dakord me çfarëdo ndryshimi strukturor dhe ekonomik që ka bërë e do të bëjë klika revizioniste e Dubçekut. Do të ngrihej një e qeshur kolosale në botë, në rast se këta revizionistë, që kanë restauruar kapitalizmin në vendet e tyre, do t'i rekomandonin Çekosllovakisë një regjim socialist në *de facto* dhe *de jure*.

Por ç'kërkojnë në të vërtetë këta ideologë revizionistë nga Varshava?

Ata kërkojnë që klika e Dubçekut të ndjekë kursin e Moskës, siç u vendos në prapaskenë, me një fjalë, të ndërtojë kapitalizmin në Çekosllovakia, por pa bujë të madhe, të ruajë format e gënjeshtërtat dhe demagogjike, të mos lërë të bëjnë shumë zhurmë reaksionarët çekosllovakë. Pra, revizionistët sovjetikë u këshillojnë revizionistëve çekosllovakë «mishi të piqet dhe helli të mos digjet».

Revizionistët sovjetikë dhe revizionistët e tjerë janë të tmerruar nga disfatat e tyre të njëpasnjëshme. Disfata në Çekosllovakia do t'u kushtojë shumë, prandaj letra e Varshavës, që tregon hutimin e madh të tyre, frikën e disfatës, s'mund të ketë asnjë bazë politike, ideologjike dhe morale.

Tradhtarët e falimentuar më kot përpiqen të vënë shenjën e barazimit në mes kësaj letrë tradhtarësh dhe letrave historike marksiste-leniniste të Stalinit të madh, drejtuar Partisë Komuniste të Jugosllavisë në vitin 1948.

Letrat historike të Stalinit, drejtuar Partisë Komuniste të Jugosllavisë, janë dokumente të pavdekshme marksiste-leniniste, mbasi ato janë të bazuara në realitetin objektiv, të frymëzuara nga një frymë e lartë revolucionare, nga një marksist-leninist i madh, nga një parti bolshevike, siç ishte në atë kohë Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik, dhe nga Bashkimi Sovjetik, atdheu i madh i socializmit, siç ishte ai sa rronte Stalini.

Po letra e Varshavës nga kush nënshkruhet? Nga një Brezhnjev, nga Kosigini e Podgorni, nga tre tradhtarë mbi tradhtarë, që vetë janë lidhur ngushtë

me imperializmin amerikan dhe akuzojnë revizionistët çekoslovakë se po lidhen me amerikanët, që vetë kanë degjeneruar partinë dhe i këshillojnë Dubçekut «rregulla e norma partie», që në vendin e tyre kanë vendosur kapitalizmin dhe Dubçekut i thonë të bëjë si duan ata, që vetë kanë lidhje e allishverishe të mëdha me Bonin dhe i thonë Dubçekut të mos ketë lidhje me Republikën Federale të Gjermanisë.

Por kjo demagogji e madhe dhe kjo letër famëkeqe u duhen revizionistëve të mbledhjes së Varshavës për opinionin e tyre të brendshëm. Ata i tremben shumë sidomos presionit të revolucionarëve dhe të pjesës së shëndoshë të ushtrisë sovjetike dhe të oficerëve të saj, të edukuar nga Stalini dhe nga Partia Bolshevike, të cilët e shohin se revizionistët e kanë tradhtuar amanetin e Leninit, të bolshevikëve, të Stalinit, se u kanë vënë kazmën fitoreve të Revolucionit të Tetorit dhe sakrificave mbinjerëzore të popullit sovjetik. Prandaj, diçka u duhet thënë popullit sovjetik, popullit bullgar e të tjerëve. Pra, u krijua rasti, diversioni, që të lëvojnë artikujt në «Pravda», në «Izvestia» dhe deri te «Rabotniçesko Dello» e Bullgarisë, e cila shkruan një artikull me titull «Duhet ta shkullim nga rrënjët kundërrevolucionin», në një kohë kur në Bullgari burgjet mbushen çdo ditë me bijtë më revolucionarë të popullit bullgar. Po kush nuk e di se në Bullgari, klika revizioniste pa asnjë vlerë e Zhivkovit, mbahet në fuqi nga agjentina e Andropovit?

I duhet kjo letër revizionistit Gomulka për të forcuar pozitat e tij të lëkundura të brendshme dhe, njëkohësisht, u duhej revizionistëve të Varshavës për

t'u thënë kolegëve sovjetikë të kenë mendjen, të mos ua punojnë edhe atyre si ua punuan çekoslovakëve.

Me britmat historike kundër Çekoslovakisë, me të rënat e gjoksit, revizionistët sovjetikë duan të tregohen të zellshëm dhe të fshehin komplotin. Por zelli i tyre shkoi aq larg, saqë vetë letra pohon se Traktati i Varshavës, i nënshkruar për të tjera qëllime, në duart e banditëve revizionistë sovjetikë, është kthyer në një mjet sulmi dhe agresioni kundër vetë pjesëmarrësve, që nuk u binden revizionistëve sovjetikë.

Partia e Punës e Shqipërisë dhe Qeveria e RP të Shqipërisë, që i denoncuan me kohë qëllimet djallëzore, agresive dhe armiqësore të revizionistëve sovjetikë, nuk u gabuan. Mjerë ata që tremben nga revizionistët sovjetikë, qofshin këta vetëm apo të bashkuar me miqtë e tyre të ekipit të Varshavës, qofshin vetëm apo të bashkuar me imperialistët dhe me kapitalistët në botë. E dinë mirë revizionistët sovjetikë dhe çdo armik tjetër se ç'i pret, po të preket Shqipëria. Traktati i Varshavës për Republikën Popullore të Shqipërisë është bërë i pavlefshëm.

Çfarë akuzash u bëjnë, më në fund, revizionistët sovjetikë revizionistëve çekoslovakë?

Sipas tyre, gjynahu i madh na qenka botimi i deklaratës me «2 000 fjalë». Revizionistët sovjetikë bërtasin se «u rrezikua socializmi në Çekoslovaki», pse në krye ka ardhur njëfarë Cezar dhe sepse i është dhënë «liri shtypit». Por pse i është dhënë «liri shtypit», pse erdhën këto gjëra, ku e kanë burimin? Natyrisht, nuk mund të jenë revizionistët sovjetikë dhe as të tjerët ata që mund t'ia ngrenë petën lakrorit.

Revizionistët, me ata sovjetikë në krye, i akuzojnë çekoslovakët pikërisht për atë pse shkuan më tej e më shpejt se vetë ata, se lanë të vepronte hapur dhe me shpejtësi logjika e tradhtisë dhe nuk ditën ose nuk deshën të mbanin nën kontroll propagandën, e cila po ua nxjerr të palarat në shesh çekoslovakëve, realitetin e tyre, që e dëshironin dhe e fituan, që u nxjerr sovjetikëve, po ashtu, realitetin, që këta përpiqen ta maskojnë. Radioja, televizioni dhe kontrolli i shtypit, është një nga armët që u ka ngelur revizionistëve sovjetikë dhe satelitëve të tyre, për të gënjyer botën.

Pas letrës skandaloze që ata i dërguan Çekosllovakisë nga Varshava, pasi e humbën davanë e parë dhe u diskredituan, revizionistët sovjetikë kërkojnë tani një takim miqësor vetëm për vetëm me çekoslovakët. Intriga vazhdon për të gjetur një kompromis, për t'u shpëtuar faqen sovjetikëve, por që, në fakt, do t'u nxihet akoma më shumë.

I falimentuari Valdek Roshe, që vajti në Moskë për këtë punë e pastaj në Pragë, kërkoi që të bëhet një mbledhje e partive revizioniste evropiane për ta gjykuar mosmarrëveshjen sovjeto-çekosllovake. Kryetari i revizionistëve francezë për këtë propozim kishte aprovimin e krerëve të Kremlinit. Po kur këta e panë se shumica e partive revizioniste të Evropës u shprehën në përkrahje të Dubčekut, nxituan të këshillojnë shërbëtorin e tyre që ta tërhiqte propozimin, mbasi, një mbledhje në këto kushte, do të ishte një paradështim i konferencës së dështuar të Moskës, që thuhet se do të mbahet në nëntor.

Edhe Titoja u fut personalisht në arenën e luftës.

Thuhet se ai mund të shkojë edhe në Pragë. Perspektivë «e bukur»! Do të asistojmë në përlëshje të reja.

Pozitat e revizionistëve çekoslovakë forcohen, revizionistët sovjetikë s'kanë ç'bëjnë veçse të diskreditohen më tej, ose të rrëzohen dhe të vijnë të tjerë që «të pranojnë statukuonë aktuale», «të rregullojnë» gjoja konfliktin. Kriza po thellohet në gjirin e revizionistëve. Kjo është e mirë për forcat revolucionare në këto vende dhe në botë.

E gjithë zhurma e revizionistëve hrushovianë do të jetë një flluskë sapuni. Klika e Dubčekut, duke manovruar, po ecën përpara në punën e vet reaksionare. Letërpërgjigjja e saj, gjoja e moderuar, shpjeguese, zë pikat dhe qoshet, bën akuza dhe u përgjigjet akuzave, shpjegon situatat e rrethanat dhe luan rolin e të habiturit për çka i thuhet dhe i kërkohet. Që të dyja palët përgatiten për kongresin e jashtëzakonshëm të partisë revizioniste çekoslovakë, çekët si zot të shtëpisë, sovjetikët si diversionistë. Gjatë kësaj kohe do të lëvojnë polemikat, thirrjet dhe organizimet e fshehta, kush e kush të fitojë terrenin.

Ç'do të rezultojë nga e gjithë kjo? Është e vështirë ta parashikojmë plotësisht, por mjaft gjëra duken qartë që tani.

Për revizionistët sovjetikë kjo është një disfatë e madhe, që nuk do të mbetet pa pasoja të rënda për ta. Komploti çekoslovak dhe humbja e Çekosllovakisë nuk mund të qëndrojnë pa ndëshkim në gjirin e vetë revizionistëve. Përgjegjësit kryesorë të kësaj disfate do të bëhen «kurbanët» e dasmës. Por çështja nuk do të qëndrojë me kaq: ose Çekosllovakia do të liberali-

zohet më tej, ose do të acarohen më shumë kontraktat.

Humbja e Çekosllovakisë nuk do t'i ndihmojë tezat e revizionizmit modern. Kufijtë e Bashkimit Sovjetik, me shkëputjen e Çekosllovakisë, me lëvizjet dhe me instabilitetin në Poloni, po bëhen më pak të mbrojtur, ata tani janë drejtpërdrejt të kërcënuar. Çështja gjermane do të sjellë patjetër acarimin, pra, edhe dobësimin e mbrojtjes së Bashkimit Sovjetik. Traktati i Varshavës u bë një leckë, një traktat që «miqtë» nuk i mbron më, por i sulmon dhe komploton kundër tyre. Krahu revizionist konservator në Bashkimin Sovjetik do të reagojë dhe do të gënjejë, por reagimi i tij do të zbulojë edhe më shumë tradhtinë e revizionistëve sovjetikë. Dhe në Bashkimin Sovjetik ka forca, ka revolucionarë që nuk flenë dhe që do t'i shfrytëzojnë momentet. Në Bashkimin Sovjetik asgjë nuk mund të pritet nga ndryshimet që mund të bëhen në gjirin e klikës. E mira do të dalë vetëm nga revolucioni, nga gryka e pushkës, nga spastrimi rrënjësor i qelbësirës dhe i kalbëzimit revizionist.

Duke kaluar një krizë të madhe të brendshme, revizionistët sovjetikë do të përpiqen të japin përshtypjen se kanë unitet të brendshëm, sidomos tani në prapësinë e konferencës «ndërkombëtare» të Moskës, që po përgatitin për muajin nëntor, konferencë që paraqitet, ashtu siç e kemi parashikuar, shumë e komprometuar.

Revizionistët sovjetikë janë në hall, edhe Çekosllovakinë duan përsëri ta sundojnë, por edhe nuk mund të marrin dot masa për të riparuar gafën ndaj Novotnit. Gomulka, Ulbrihti dhe, si duket, ushtria sovje-

tike janë për «dorë të hekurt» në Çekosllovakia. Por një veprim i tillë do të ishte një skandal i madh botëror. Të gjithë revizionistët e botës janë kundër një mase të tillë. Roshe, Pajeta e të tjerë vrapuan në Moskë, sigurisht, për t'u thënë sovjetikëve të mos e bëjnë një gjë të tillë, se përndryshe edhe ata do t'i braktisin. Atëherë s'ka as konferencë të Moskës dhe as djall me të birin. Shantazh mbi shantazh. Kështu që revizionistët sovjetikë janë zënë prej gryke nga vetë tradhtia e tyre. Ata do të përpiqen të bien në kompromis me Dubčekun dhe, për të shpëtuar nderin, do të gjejnë një *modus vivendi*. Këta, nga ana e tyre, do të ndjekin rrugën e vet, do t'u marrin sovjetikëve edhe kredi, do të bëhen krejt të pavarur, do të lidhen me amerikanët, me Bonin e me kë të duan dhe, hëpërhë, sa për të folur, do të llototitin për «miqësinë» me Bashkimin Sovjetik etj.

Më vonë ne do të shohim të realizohen plane të reja, të kurdisura nga imperializmi amerikan dhe nga Boni. Qëllimi kryesor i tyre është gllabërimi i Republikës Demokratike Gjermane nga Gjermania Federale. Kjo do të arrihet pa luftë, me kapitullimin e revizionistëve sovjetikë, nën hijen e aleancës së shenjtë amerikano-sovjetike dhe me transferimin e epiqendrës së luftës kundërrevolucionare në Azi.

I gjithë ky komplot i revizionistëve sovjetikë, në fillim për të likuiduar klikën e Novotnit dhe për të sjellë në fuqi klikën e Dubčekut, në fazën e dytë, për rrëzimin e klikës së Dubčekut, me të gjithë gamën e njohur të shantazheve, të kërcënimeve dhe të letrës famëkeqe të Varshavës, në fazën e tretë, me kurorëzi-

min e disfatës së revizionistëve sovjetikë, me vajtjen e tyre në Kanosa, e cila, me siguri, do të përfundojë me një komunikatë pompoze, se u arrit «kulmi i miqësisë së sinqertë e të pavdekshme, në mes Bashkimit Sovjetik dhe Çekosllovakisë», u sollli atyre vetëm një fitore, atë që shërbëtori i tyre Todor Zhivkovi, kryeministri i Bullgarisë, dëboi ambasadorin dhe të gjithë funksionarët e ambasadës së RPSH nga Bullgaria. Kjo, të paktën, le të jetë një ngushëllim për humbjen e Çekosllovakisë dhe, kur të humbasin edhe satelitët e tjerë, mund të vazhdojnë të korrin fitore të tilla, se Republikës Popullore të Shqipërisë nuk i priset asnjë punë. Malet tona më të larta.

Me ardhjen në fuqi të Dubçekut, në lëvizjet diplomatike të dyshimta të jugosllavëve, të rumunëve, të hungarezëve, u fol për ringjalljen e pakteve të vjetra të Antantës së Vogël. Jugosllavia e Rumania lidhën marrëdhënie diplomatike me Bonin dhe marrin kredi prej tij. Dë Goli pritet si perëndi në Rumani, kurse Titoja e lavdëron atë për politikën e urtë ekonomike. Tani do të punohet që reaksioni në Çekosllovakia të stabilizohet, që kjo të marrë gradualisht rrugën e Jugosllavisë e të Rumanisë, të braktisë *de facto* të gjitha aleancat dhe marrëveshjet me Lindjen. Gjatë kësaj kohe do të punohet në këtë drejtim për Gjermaninë, të heqin qafe Ulbrihtin dhe klikën e tij, të sjellin në vend të tij një më «liberal», i cili mund të fillojë ujdira më të guximshme me Bonin dhe Bashkimi Sovjetik, dashka nuk dashka, do të ndodhet në rrjetën e merimangës që endi vetë.

Të gjitha këto veprime, që po ndërmarrin revizio-

nistët sovjetikë ndaj Çekosllovakisë, synojnë të bindin grupin e Dubçekut të ruajë disi aparenecat e një miqësie formale me ta, në mos më shumë. Dhe ata do të bëjnë çmos që, me lloj-lloj lajkash, manovrash e gënjeshtrash, ta afrojnë klikën e Dubçekut dhe të normalizojnë disi gjendjen, të paktën përkohësisht.

Revizionistët sovjetikë rrojnë me sot, me nesër. Me lajka, me kërcënime, ose me diversione, ata do të përpiqen të riparojnë gabimin tragjik që bënë, duke abandonuar Novotnin, në mënyrë që, në pamundësi për ta sjellë këtë përsëri në fuqi, në udhëheqjen e re çekosllovake, që do të dalë nga kongresi i vjeshtës, të kenë një shumicë të madhe novotnistë, partizanë të tyre. Po kjo është ëndërr me sy hapur. Tentativa të shumta skandaloze do të bëjnë revizionistët sovjetikë deri në këtë kongres për t'ia arritur një qëllimi të favorshëm për ta. Prandaj ata do të demaskohen edhe më shumë në sytë e botës dhe miqtë e tyre revizionistë do të revoltohen akoma më shumë kundër tyre.

Pra, skandale dhe disfata në perspektivë për revizionistët modernë dhe, në radhë të parë, për ata sovjetikë. Ata që kritikuan dhe hodhën baltë mbi veprimet e drejta, të rregullta e të peshuara mirë të Stalinit, kur ai i shkroi letër Partisë Komuniste të Jugosllavisë dhe e ftoi atë në mbledhjen shoqërore të Informbyrosë, sot kërcënojnë me ndërhyrje ushtarake, pikërisht për ato gjëra që këta tradhtarë janë iniciatorët, krijuesit, predikuesit, mbrojtësit dhe zbatuesit më të mëdhenj, në teori dhe në praktikë.

Koha dhe veprimet i demaskojnë tradhtitë. Prapë koha ngre lart veprën e lavdishme dhe marksiste-lenin-

niste të Josif Stalinit, i cili, duke dënuar Titon dhe titizmin, i dënoi të gjitha këto plehra.

Njerëzit sovjetikë dhe të gjithë popujt e vendeve ku sundojnë revizionistët, nuk mund të mos shikojnë se ku po i çon, vetë Bashkimin Sovjetik e vendet e tjera revizioniste, vija tradhtare revizioniste. Ngjarjet e Çekoslovakisë i ndihmojnë ata të kuptojnë që qendra e tradhtisë ndaj marksizëm-leninizmit, revolucionit e socializmit është në Moskë, se drejtuese e saj është klika e Brezhnjev-it-Kosiginit-Podgornit dhe e kaporionëve të tjerë revizionistë dhe, se pa likuiduar këtë qendër, nuk mund të largohet rreziku që kërcënon vendin e Revolucionit të Tetorit e të Sovjetëve. Tradhtia e Gomulkës, e Dubçekut dhe e të tjerëve nuk është gjë tjetër veçse një pjesë përbërëse e kësaj tradhtie të madhe. Prandaj, që të luftohen me sukses klikat sunduese të vendeve të ndryshme revizioniste, tehu i luftës duhet drejtuar jo vetëm kundër revizionistëve të vendit, por, njëkohësisht, edhe kundër qendrës sovjetike ndërkombëtare të revizionizmit modern.

Gjendja për popullin çekoslovak është e rëndë, po jo e dëshpëruar. Vetëm besimi në forcat e veta dhe në forcat e shëndosha marksiste-leniniste ndërkombëtare do t'ia çelin atij rrugën e shpëtimit. Marksistë-leninistët revolucionarë çekoslovakë duhet të krijojnë Partinë Komuniste Çekoslllovakë të re, të vërtetë, marksiste-leniniste, e cila t'u hapë luftë të pamëshirshme partisë revizioniste të Dubçekut, të gjitha partive të tjera të borgjezisë çekoslllovakë dhe të luftojë për grumbullimin e klasës punëtore dhe të popullit çekoslovak për luftë, për revolucion të armatosur, kundër të gjithë revizio-

nistëve të brendshëm, të çdo ngjyre e të çdo partie, kundër reaksionit borgjez çekoslovak dhe partive të tij, kundër revizionistëve sovjetikë, titistë, polakë, gjermanë, hungarezë etj., kundër imperializmit amerikan dhe gjithë borgjezisë e kapitalizmit botëror. Këtë rrugë, që është rruga e lirisë, e marksizëm-leninizmit, duhet të ndjekë edhe populli punëtor çekoslovak. Rruga tjetër është ajo e kompromisit dhe e robërisë. Ne e këshillojmë të zgjedhë të parën, pse i duam të mirën dhe do ta ndihmojmë në këtë rrugë me të gjitha forcat tona.

Një popull që, qoftë edhe për një periudhë të shkurtër, humbet vigjilencën revolucionare, dobëson ose humbet frymën luftarake për të mbrojtur pavarësinë dhe të drejtat e tij, e presin shumë të këqija, që ia kurdisin armiqtë e brendshëm dhe të jashtëm. Rrojmë dhe luftojmë në kohë të atilla, kur popujt nuk duhet t'i zërë gjumi, kur ata nuk duhet të nanurisen si foshnjat në djep nga demagogjia e një grushti tradhtarësh, që i farkëtojnë zinxhirë të rëndë. Popujt duhet të bëhen të ndërgjegjshëm për forcën dhe për rolin e tyre dhe nuk duhet të lejojnë që këtë forcë ta përdorin si mburojë për vete një grup matrapazësh, renegatësh e tradhtarësh, të shitur te borgjezia e vendit dhe te kapitali i huaj. Popujt, të cilëve u mungoi vigjilenca dhe si konsekuncë të rëndë humbën lirinë dhe të drejtat e tyre, të fituara me sakrificë e me gjak, jo vetëm duhet të bëhen të ndërgjegjshëm se në ta dhe vetëm në ta ekziston ajo forcë kolosale e shpëtimit, por këtë forcë ata duhet ta organizojnë sa më parë e në mënyrë luftarake, për të goditur për vdekje dhe

pa humbur kohë armikun e brendshëm dhe aleatin e tij të jashtëm.

Të fitosh ndërgjegjen e forcës, do të thotë të dallosh cilat janë forcat e tua dhe ato të armikut, do të thotë të organizosh forcat e tua dhe t'u hapësh luftë të pamëshirshme e pa kompromis forcave të armikut, deri në fitoren e plotë.

Të fitosh ndërgjegjen e besimit në forcat e veta, do të thotë të mos të zbutet kurrë zemra kundër armikut, të mos kesh as më të voglin besim e shpresë tek ai kurrë, të mos u zësh besë manovrave e dredhive të tij dhe as pas fitores të mos tregohesh zemërgjerë ndaj tij. Gjarprit i duhet prerë koka kurdoherë.

Popujt e Bashkimit Sovjetik dhe popujt e tjerë të vendeve të ish-demokracisë popullore të Evropës, përveç popullit shqiptar, e humbën vigjilencën dhe armiku i popujve, i marksizëm-leninizmit, i socializmit dhe i komunizmit, revizionizmi modern, i zuri në grykë, po i skllavëron, po i shtyp, po i shet tek imperializmi botëror.

Kriza çekosllovake nuk është një fenomen i rastit e i papritur dhe as një krizë e veçuar. Ajo bën pjesë në krizën e madhe të revizionizmit modern, epiqendra e të cilit është në Bashkimin Sovjetik. Kjo krizë ndihet edhe në periferitë e Bashkimit Sovjetik, në satelitët e tij, që kërkojnë ta hedhin tej zgjedhën e revizionizmit sovjetik.

Revizionizmi sovjetik kalon disa kriza të rënda, të cilat po i paguan shtrenjtë dhe pikërisht në tradhtinë e madhe të hrushovianëve duhet kërkuar e keqja e madhe, që duhet djegur me zjarr e me revolucion.

Tradhtia ndaj kampit të socializmit lindi me Titon, u forcua me Hrushovin e po konsumohet me klikën Brezhnjev-Kosigin dhe me të gjithë tradhtarët revizionistë modernë, që u venë pas, ose që u lanë pendët dhe veprojnë në liri të plotë.

Tradhtarët e marksizëm-leninizmit u ngritën si ujë të tërbuar për të mbytur zërin e Partisë së Punës të Shqipërisë, që demaskoi pa mëshirë tradhtinë e tyre. Si heroinë, Partia e Punës e Shqipërisë u bëri ballë furtunave, shpartalloi armiqtë e saj ideologjikë, i demaskoi ata, parashikoi ato që po ngjasin dhe, duke u bazuar në marksizëm-leninizmin, parashikon më tej zhvillimin e krizës revizioniste dhe shpërthimin e revolucionit të dytë proletar në Bashkimin Sovjetik.

Revizionistët sovjetikë do të japin llogari përpara proletariatit sovjetik dhe atij botëror. Kjo llogari do t'u kërkohet atyre dhe do të paguhet me gjak.

Populli sovjetik do t'u kërkojë atyre llogari se ç'u bë me veprën dhe me trashëgimin e Tetorit të Madh, të Leninit dhe të Stalinit, ç'u bë me miqtë e vërtetë të Bashkimit Sovjetik dhe të Partisë së Lenin-Stalinit, që luftojnë thikë më thikë me imperializmin dhe me revizionizmin modern, që mbrojnë marksizëm-leninizmin, revolucionin e socializmin, ç'u bë me Bullgarinë e Dimitrovit, me Rumaninë, me Hungarinë, me Poloninë e me vendet e tjera ku kanë ardhur në fuqi revizionistët.

Vallë, klika e Dubčekut i solli këto situata? Dubčekët, Gomulkët e Novotnët janë pjesëmarrës aktivë të një tragjedie të madhe që u luajt në kurriz të komunizmit dhe të popujve pas vdekjes së Stalinit. Por

vallen e madhe të tradhtisë e hapën dhe e udhëhoqën tradhtarët revizionistë sovjetikë. E hapën ata me Kongresin e 20-të e me Hrushovin, me shpifjet monstruoze kundër Stalinit, me aleancën kundërrevolucionare sovjeto-amerikane, me tradhtinë e pabesë kundër RP të Shqipërisë e Partisë sonë të Punës e një mijë e një tradhti të tjera.

Këtë nuk e harrojmë ne, nuk e harron populli sovjetik, s'e harrojnë marksistë-leninistët e të gjithë botës. Vallen e tradhtisë vazhdojnë ta hedhin revizionistët sovjetikë, partneri kryesor i të cilëve është imperializmi amerikan. Këta të dy janë armiqtë më të mëdhenj e më të rrezikshmit në botë. Të dy këta janë puthur e janë shtrënguar fort me njëri-tjetrin. Revizionistët sovjetikë, me paturpësinë më të madhe, gërthasin se klika e Dubçekut po rrezikon socializmin, se ajo po puqet me kapitalistët, ndërsa ata vetë kanë vënë nën zgjedhë, tok me imperializmin amerikan, Bashkimin Sovjetik e vendet satelite ku akoma sundojnë dhe luftojnë së bashku për të vënë nën zgjedhë të gjithë botën.

Ju pyesim: Ato pyetje që ju po i bëni klikës së Dubçekut në letrën famëkeqe të Varshavës, a ia keni bërë ndonjëherë vetes, pse kur të vijë dita e gjyqit të madh të revolucionit kundër jush, pyetjet me siguri do të jenë jo si ato, por thika.

Por çdo gjë që do të bëni është demaskim për ju, se çdo gjë juaja është bluf, është pa parim, ju jeni mbytur në kontradikta të brendshme e të jashtme, çdo hap që hidhni është një hap drejt greminës ku do të thyni qafën. Tradhtia ju ka zënë prej gryke e prej

këmbe dhe nuk ju lëshon. Tradhtarët nuk i do kush. Fati juaj është litari dhe plumbi. Ju krekoseni tani dhe mendoni se jeni të fortë, se keni forcën e armëve të një shteti të madh. Por gaboheni. Ju jeni nga më frikacakët dhe me armët tuaja mund të frikësoni vetëm njerëzit me nerva të dobët. Ju e dini mirë sa ju vlejnë forca juaj dhe mburrjet tuaja përpara forcës së popujve, forcës së proletariatit, forcës së bolshevikëve, e cila një ditë, që nuk do të jetë e largët, do t'ju fshijë nga faqja e dheut.

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 176 (6215), 24 korrik 1968

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha. «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1968-1970», f. 149*

L E N D A

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 38-TË V-VIII

1968

PËR T'I SHKUAR GJER NË FUND ÇDO PROBLEMI, MË PARË TË MENDOHEM PËR MASAT ORGANIZATIVE — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (8 maj 1968) 1-12

VAZHDIMISHT TË TREGOJMË VËMENDJE PËR PUNËN ME RININË — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (8 maj 1968) 13-26

T'I MËSOJMË NJERËZIT TË MENDOJNË ME PJEKURI — Nga diskutimi në mbledhjen e organizatës-bazë të Partisë ku bën pjesë (9 maj 1968) 27-30

JU FALËNDEROJ, SHOKË PUNËTORË, PËR KËTË VEPËR KAQ TË ÇMUAR — Nga biseda me një grup punëtorësh të shtypshkronjës «Mihal Duri» (9 maj 1968) 31-42

LE TË SHPËRTHEJË E FUQISHME STUHIA E REVOLUCIONIT — Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit» (17 maj 1968) 43-78

KËTO QË MËSUAT NË KURS, I VINI NË ZBATIM, I BËNI JETË TË DYTË — Fjala me të rejtat e malësisë së Veriut, pjesëmarrëse në kursin që u organizua në Durrës (20 maj 1968) 79-99

KLASA PUNËTORE FRANCEZE NË LUFTE PËR TË DREJTAT E SAJ – Artikulli i botuar në gazetën «Zëri i popullit» (24 maj 1968)	100–109
PUNËTORËT T'I KUPTOJNË MIRË DETYRAT, RO- LIN DHE RËNDËSINË E MADHE TË KLASËS – Nga biseda me punëtorë, me kooperativistë e me kua- dro të Rubikut (27 maj 1968)	110–149
ÇONI NË FSHAT FRYMËN REVOLUCIONARE TË KLASËS PUNËTORE – Nga biseda me një grup metalurgësh në Rubik (27 maj 1968)	149–156
KUJDESI PËR SHËNDETIN E NJERIUT – DETYRË E MADHE E PARTISË – Nga biseda me anëtarët e byrosë së komitetit të Partisë të rrethit të Rrëshenit (27 maj 1968)	157–181
POPULLI YNË MENDON, PUNON, KRIJON DHE MBRON FITORET E TIJ – Nga fjala në drekën e shtruar në mensën e punëtorëve të Minierës së Kurbneshit (28 maj 1968)	182–219
PËR PUNËT E BUJQËSISË TË MENDOJMË TË GJITHË – Nga biseda me kooperativistë të Perlatit në rrethin e Mirditës (28 maj 1968)	220–241
PARTIA DHE POPULLI KANË BESIM TË MADH E TË PALËKUNDUR TË NJËRI-TJETRI – Fjala në mitingun e popullit të Mirditës (29 maj 1968)	242–283
KURRË TË MOS DEHEMI NGA SUKSESET DHE TË MOS E ULIM VIGJILENCËN – Nga biseda me kuadro të rrethit të Mirditës (29 maj 1968)	284–295
NË SOCIALIZËM PLANET KANË NË THEMEL IN- TERESIN JETIK TË POPULLIT – Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (10 qer- shor 1968)	296–308

- TRADITAT DHE AFTËSITË KRIJUESE TË POPULLIT T'I PËRDORIM MIRË EDHE PËR PRODHI-MET E ARTIZANATIT — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (10 qershor 1968) 309—313
- ZHVILLIMI I DREJTË I LUFTËS SË KLASAVE KËRKON PJEKURI DHE PARTISHMËRI TË LARTË — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (11 qershor 1968) 314—322
- KUSHTET E JETESËS SË PUNËTOREVE T'I SHIKOJMË ME KUJDES TË VEÇANTË — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (11 qershor 1968) 323—336
- BREZI YNË I RI MARSHON NË RRUGËN REVOLUCIONARE TË PARTISË — Nga fjala në mitingun e madh në sektorin e Gradishtës të Hekurudhës Rrogozhinë-Fier (28 qershor 1968) 337—365
- PUNË DHE SHKENCË, PUNË DHE DITURI — KJO ËSHTË DETYRË E RËNDËSISHME PËR TË GJITHË PUNONJËSIT — Bisedë me kuadro dhe me punëtorë të qytetit të Patosit (29 qershor 1968) 366—389
- DIREKTIVAT E PARTISË PËR BUJQËSINË T'I ZBËRTHEJMË E T'I THELLOJMË VAZHDIMISHT — Bisedë me anëtarë të Kooperativës Bujqësore të Grecallisë në rrethin e Fierit (29 qershor 1968) 390—411
- TE POPULLI JANË MENÇURIA, DITURIA, ZOTËSIA. TEK AI PARTIA MERR FORCËN E SAJ — Nga biseda me kuadro dhe me kooperativistë të kooperativës së bashkuar «Shkurte Pal Vata» të rrethit të Lushnjës (1 korrik 1968) 412—434
- PASQYRIM I DEGJENERIMIT DHE I FALIMENTIMIT TË VETADMINISTRIMIT TITIST — Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit» (6 korrik 1968) 435—448

- USHTRIA JONË ËSHTË ARMË E DASHUR DHE
E FUQISHME E POPULLIT – Fjala në drekën e
shtruar në Labinot, me rastin e 25-vjetorit të krijimit
të Ushtrisë Popullore të Shqipërisë (10 Korrik 1968) 449–467
- REVIZIONISTËT SOVJETIKË DHE ÇEKOSLLOVA-
KIA – Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»
(24 korrik 1968) 468–495

Shtypur: Kombinati Poligrafik

Shtypshkronja «Mihal Duri» – Tiranë, 1983